

ENVER HOXHA

VEPRA

31

PROLETARE TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNII

ENVER HOXHA

VEPRA

BOTOHET ME VENDIM TË KOMITETIT
QENDROR TË PARTISË SE PUNËS TË
SHQIPERISË



ENVER HOXHA

**INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE - LENINISTE
PRANË KQ TË PPSH**

ENVER HOXHA

VELLIMI

31

JANAR 1966 – MARS 1966

SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»
TIRANE, 1980

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 31-TE

Vëllimi i 31-të i Veprave të shokut Enver Hoxha përfshin materiale të periudhës janar-mars 1966. Një pjesë e madhe e tyre botahe për herë të parë.

Fjalimet, artikujt, diskutimet dhe bisedat e këtij vëllimi janë një dëshmi tjetër e zbatimit të parimeve të marksizëm-leninizmit me konsekuencë, me guxim dhe inençuri nga Partia, në kushtet konkrete të ndërtimit të socializmit në Shqipëri.

Ndër problemet që trajtohen gjerësisht e që i kanë preokupuar Partinë dhe jetën e vendit në atë periudhë të revolucionit tonë socialist, ishte edhe lufta kundër burokratizmit, për një metodë dhe stil revolucionar në punë. Kjo luftë pasqyrohet veçanërisht në materialet: «Disa konkluzione fillestare mbi punimin e vendimit të Byrosë Politike për luftën kundër burokratizmit», «Të punojmë me ritmin e punëtorëve» etj. Në këto e në dokumente të tjera del në pah se si Partia jonë e thelloi nga dita në ditë procesin e njohjes së burokratizmit dhe si e dendësoi ajo luftën kundër tij, si nxori konkluzione e detyra në punë e sipër dhe ngriti masat në këmbë kundër kësaj sëmundjeje të rrezikshme për diktaturën e proletariatit. Partia orientoi t'i bëhet një luftë e ashpër burokratizmit, veçanërisht në organet e pushtetit dhe,

në të njëjtën kohë, porositi që kjo çështje të shihet me vigjilencë edhe në radhët e saj, ku të luftoheshin zyrtarizmi e formalizmi, si shfaqje të burokratizmit.

Masat që u morën në atë kohë ishin vazhdim i një politike të tërë që kishite ndjekur e ndiqte Partia për t'i prerë rrugën çdo rreziku që i kanosej socializmit. «Eshtë, pra, urgjente dhe e domosdoshme — thekson shoku Enver Hoxha — të vazhdojmë me këtë rast të punojmë për një edukatë të thellë teorike e politike për Partinë, për kuadrot dhe popullin, që me shembuj të gjallë nga jeta të kuptojnë ç'është burokratizmi, si vjen ai, si vendoset, c'rreziqe mbytëse sjell ai për Partinë dhe për shtetin dhe si duhet t'i bëhet një luftë e fortë e organizuar teorike, politike dhe në praktikën e përditshme në punë».

Në materialet e këtij vëllimi, si një problem tjetër të rëndësishëm, shohim preokupimin e Partisë, kujdesin e saj të vazhdueshëm për afirmimin e organeve të zgjedhura të pushtetit, si përfaqësuese të popullit. Në saje të këtij kujdesi, pushteti ynë popullor ka ecur gjithmonë drcjt forcimit dhe konsolidimit të tij në luftë të ashpër me armiqtë e brendshëm e të jashtëm dhe kundër presionit që ushtron burokratizmi. Këtu gjejmë edhe një herë mësimin, rrugën, mjetet se si duhet të luftojë çdo komunist, kuadër e punonjës, çdo i zgjedhur, këshilltar a deputet, që organet e zgjedhura të pushtetit të shprehin dhe të mbrojnë në çdo kohë interesat e popullit e të socializmit.

Për zgjidhjen e problemeve të rëndësishme të kohës Partia u mbështet te masat. Vlerësimin e lartë që u bën Partia rolit të masave dhe tërheqjes së mendimit të

tyre, si kurdoherë, do ta gjejmë edhe në shumë materiale të këtij vëllimi, e sidomos në takimet e shokut Enver Hoxha me popullin. Këto takime janë një shembull i lartë i stilit revolucionar në punë dhe i komunikimit të lirë, të hapët Parti-popull, jashtë kornizave të zyrtarizmit. Partia e vë popullin në dijeni për situatën, për rëndësinë e masave që po merr, për perspektivat që i hapen vendit në pesëvjeçarin e ri. Partia e pyet popullin ç'probleme ka, konsultohet me të dhe orienton si mund të punohet më mirë për rritjen e nivelit dhe të kulturës së jetesës, për emancipimin e gruas, për edukimin e brezit të ri, për zgjidhjen e mjaft problemeve shoqërore etj.

Në materialet e kësaj periudhe del qartë metoda shkencore e punës së Partisë, e cila në çdo kohë i ka trajtuar problemet më të rëndësishëm të jetës së vendit të gërshtetura me njëra-tjetrën. Duke e përqendruar punën e saj në luftën kundër burokratizmit, Partia trajtoi në mënyrë serioze edhe problemet ekonomike, të mbrojtjes, të zhvillimit të situatës në botë etj. Në materiale të tilla si «Ky është një plan i balancuar, tek i cili kemi besim e siguri», «Në rrugën e kolektivizimit fshatarësia jonë po ndëronton një jetë të re» etj., shihet forma revolucionarizuese e direktivave të Partisë, të cilat rritën entuziazmin dhe mobilizimin revolucionar të klassës punëtore, të fshatarësise kooperativiste, të masave të gjera punonjëse për të hartuar një plan të ngjeshur, tej parashikimeve dhe për të realizuar detyrat e muajve të parë të vitit në të gjitha degët e ekonomisë.

Një vend të rëndësishëm zënë në këtë vëllim edhe materialet që flasin për mbrojtjen e atdheut, për revo-

lucionarizimin e mëtejshëm të ushtrisë. Këto çështje trajtohen në fjalimet dhe në diskutimet, si «T'i drejtoheni me një letër të hapur gjithë Partisë, gjithë popullit dhe ushtrisë», «Ushtritë revolucionare i bën të forta marksizëm-leninizmi» etj., ku gjejmë argumentin bindës përsë është momenti të merren masa të tilla si vendosja e komisarëve politikë, heqja e gradave etj., dhe ku qëndron rëndësia e tyre. Në këto materiale autor i trajton me një theks të veçantë probleme të rëndësishme, si roli udhëheqës i Partisë në ushtri, lidhjet e ushtrisë me popullin, marrëdhëniet oficer-ushtar, karakteristikat revolucionare të Ushtrisë sonë Popullore si vazhduese e Ushtrisë Nacionalçlirimtare etj.

Në fjalimet, artikujt dhe bisedat e vëllimit të 31-të trajtohen edhe probleme të situatës ndërkombëtare. Ngjarjeve që zhvillohen në botë në këtë periudhë u bëhet një analizë e thellë shkencore, në prizmin e materializmit dialektik dhe historik. Në këto dokumente pasqyrohet kontributi i çmuar i Partisë sonë në mbrojtje të marksizëm-leninizmit e të lirisë së popujve dhe lufta e ashpër, konsekuente e saj kundër imperializmit, me atë amerikan në krye, dhe kundër revizionizmit modern, me atë sovjetik në krye. Lexuesi gjen analizën e fakteve e të ngjarjeve dhe konkluzionin se imperializmi amerikan vazhdon të jetë agresiv, gjakpirës i madh i popujve, një forcë e egër për skllavërimin e tyre. Nga ana tjetër, shoku Enver thekson se edhe «klikat hrushoviane jo vetëm shtypin e shfrytëzojnë popujt që kanë nën sundim, por synojnë të skllavërojnë edhe popujt e vendeve të tjera». Vlerësimi objektiv dhe real që i bëhet karakterit agresiv të dyja superfuqive është një mësim

aktual për të gjithë revolucionarët dhe marksistë-leninistët, për të kuptuar rrezikshmërinë e tyre dhe për t'i luftuar të dyja njëloj, pa ushqyer asnje iluzion.

Gjithashtu theksohet se po kaq të rrezikshme janë edhe variantet e tjera të revizionizmit modern. Në artikullin «Me çfarë po shkojnë revisionistët italianë në kongresin e tyre të 11-të» shoku Enver Hoxha shkruan se «revisionistët toliatistë, krahas atyre hrushovianë e titistë, kanë qëndruar në «radhët e para» të predikuvesve të së ashtuquajturës bashkekzistencë paqësore me imperializmin, sidomos me atë amerikan». Në këtë artikull demaskohen pikëpamjet e tyre pacifiste dhe vija oportuniste e reformiste e revisionistëve toliatistë, duke nxjerrë konkluzionin se këto veç dështime të reja më të mëdha do të sjellin për ta, se «disfata e revisionistëve në luftën me marksistë-leninistët është e pashmangshme». Shoku Enver Hoxha thekson se është detyrë themelore e partive marksiste-leniniste të luftojnë me këmbëngulje për mbrojtjen dhe për zbatimin e parimeve të marksizëm-leninizmit, te të cilat «qëndron forcë jonë, baza e sukseseve tonë».

Studimi i materialeve të vëllimit të 31-të do t'i shërbejë edukimit të mëtejshëm ideopolitik të komunistëve, kuadrove dhe masave punonjëse. Këto do të janë një fryshtësim i ri, një burim tjetër force dhe energjish për të realizuar çdo detyrë në ndërtimin e socialistëve përmes mbrojtjen e atdheut, në forcimin e diktaturës së proletariafit.

TE MESOJMË NGA BAZA DHE TE PERGJITHESOJMË

*Diskutim në mbledhjen e organizatës-bazë të Partisë
të Drejtorisë së Organeve të Partisë, të Rinisë
dhe të Bashkimeve Profesionale pranë aparatit
të KQ të PPSH*

5 janar 1966

Shokët sekretarë i kanë shpjeguar e detajuar bordinë dhe rëndësinë e vendimit të Byrosë Politike të Komitetit Qendror «Mbi luftën kundër burokratizmit, për një metodë dhe stil revolucionar në punë». Këtë vendim të gjithë e kanë pritur me entuziazëm të madh dhe me të drejtë e quajnë historik. Tani ne nuk jemi akoma në gjendje të shikojmë tërë madhështinë e tij, por më vonë do të shihet sa i rëndësishëm, sa i nevojshëm, i domosdoshëm e urgjent ishte ai. Për marrjen e këtij vendimi udhëheqja u ndihmua, në radhë të parë, nga Partia, nga baza, u gjetën momenti dhe forma e përshtatshme dhe kjo përbën një sukses të madh.

Thirrja e Komitetit Qendror dhe e Këshillit të Mistrave dhe ky vendim nuk kanë qenë të rastit. Këto dokumente nuk u poqën vetëm në mendjen e një ose të

pesë vetave, por janë rezultat logjik i të gjithë punës së Partisë, i përpjekjeve të vazhdueshme të saj për zbatimin e shumë formave të mira dhe në luftë me të metat në punë. Dokumente të tilla do të pasohen më vonë me të tjera, sepse Partia për çdo gjë vepron në mënyrë dialektike dhe në kohën e duhur, ajo më parë kap hallkën kryesore, pastaj të gjitha hallkat e tjera.

Këto probleme s'janë të reja për ne, sepse janë ngritur qindra herë. Dhe nuk do të ishte e drejtë të thuhej se nuk kemi pasur rezultate sa herë janë ngritur probleme të tilla. Rezultate kemi pasur, por ato nuk kanë qenë të mjaftueshme sa duhet. Ne kemi folur për burokratizmin, për pengesat që ekzistojnë në punën tonë dhe në fakt janë zgjidhur shumë probleme, por mjaft gjëra nuk ndreqeshin si duhej dhe me shpejtësinë që kërkohej.

Ju shkonit në bazë dhe që andej sillnit shumë çështje. Edhe ne ju jepnim juve shumë gjëra, thërrisnim sekretarë të komiteteve të Partisë të rretheve, kryetarë të komiteteve ekzekutive, drejtorë e kuadro të tjerë, i kritikonim kur kishin të meta në punë, bënин autokritikë, mbeteshim dakord për ato që do të bënim dhe puna ecte në njëfarë mënyre, megjithatë jo si duhet. Kjo e preokuponte udhëheqjen, e cila përpinqej të gjente se çfarë pengonte në këtë mes. Gjersa Partia jonë ka vitalitet të madh këto nuk duhej të ndodhnin. Udhëheqja mendoi dhe arriti në konkluzionin se duhej bërë diçka tjetër, ndryshe nga herët e tjera, duhej t'u bëhej thirrje popullit dhe Partisë që të gjithë të thoshin fjalën e tyre se si mund të ecte më mirë puna.

Përse u vendos të bëhej kjo thirrje për luftën kun-

dër burokratizmit? Ka shumë rëndësi që kjo të kuptolet thellë, sepse të metat në punë, mënyra e shtruarjes së çështjeve, metoda dhe stili i punës kishin shumë defekte, të cilat ishin trashur, dhe nuk ishin më karakteristikë vetëm e një personi, enti ose ministrie, por e shumë aparatave, në radhë të parë, të aparatave-të pushtetit, pastaj të Partisë. S'ishte fjala të kritikoheshin disa persona, por të shkundeshin të gjithë e në radhë të parë ata, te të cilët këto të meta kishin lëshuar rrënje më shumë.

Burokratizmi duhet pastruar jo vetëm në fushën e shkresave, të cilat përbëjnë vetëm njérën anë, një shfaqje të kësaj sëmundjeje të madhe; por sidomos në mentalitetin e njerëzve, të cilët duhet të janë gjithnjë në kërkim të metodës më të mirë të punës për zgjidhjen e problemeve. Po sjellim si shembull metodën e punës që u përdor për përgatitjen e projektplanit të pesëvjetarit të katërt. U mendua një herë t'i bëhej një letër e brendshme Partisë, ashtu siç kishim bërë ngahera, por e pamë se kjo nuk do të na jepte rezultatet e duhura. U tha pastaj të bëhej një letër e hapur drejtuar gjithë popullit e firmosur nga Sekretari i Parë i Komitetit Qendror, por dhe kjo u gjet se nuk ishte e drejtë. Atëherë u vendos të bëhej Thirrja nga ana e Komitetit Qendror dhe e Këshillit të Ministrave drejtuar gjithë Partisë dhe popullit, sepse janë komunistët dhe tërë punonjësit ata që punojnë dhe në kurrizin e tyre bie e gjithë barra, ata i ndiejnë më shumë se kushdo vësh-tirësitë e mëdha për realizimin e detyrave. Komiteti Qendror dhe Qeveria dhanë disa orientime, për shembull, që në bujqësi etj., gjithkush ta bënte vetë planifi-

kimin, të liheshin mënjanë dhënia e shifrave të planit nga lart, format e metodat e vjetra të punës dhe baza të planifikonte vetë. Udhëheqja kishte besim në këto orientime dhe ç'ngjau? Një entuziazëm i papërshkruar u duk, u ngritën të gjithë punonjësit në këmbë dhe u përgatit një projektplan i mrekullueshëm, u tejkaluan të gjitha shifrat e parashikuara lart në mënyrë «shken-core».

Zbatimi i një metode të tillë pune ka rëndësi të madhe ekonomike, por rëndësi më të madhe ka edhe ajo që Komiteti Qendror u tha Partisë dhe popullit se udhëheqja ka pasur edhe gabime. Dhe ja rezultati, populli e ndoqi Komitetin Qendror me entuziazëm, gjë që tregon besimin e madh të tij ndaj udhëheqjes së Partisë.

Masat e marra kohët e fundit ishin një provë e madhe për të gjithë ne, se në metodën tonë të punës kishte disa gjëra që nuk na lejonin të shkonim përpara, kishte disa koncepte e pikëpamje të fiksuar, jo të drejta, që vinin nga mendjemadhësia. Përpara thuhej, për shembull, se te ne nuk mund të merreshin më tepër se 12 kuintalë drithë për hektar, por ç'ngjau? Vetëm Fieri dha 150 000 kuintalë më tepër. Kjo na shkundi të gjithë, ky ishte një frymëzim i madh që rrëzoi ato koncepte jo të drejta, të cilat ishin rrënjosur në mendjen e shumë njerëzve.

Me mobilizimin total të popullit dhe të Partisë për zbatimin e Thirrjes, do të mund të bëhej më me lehtësi lufta kundër burokratizmit. Në Byronë Politike ka pasur unanimitet për këto gjëra, por duhej gjetur hallka kryesore për ecjen me vrull përpara dhe kjo hallkë u gjet.

Në vendimin e Byrosë Politike thuhet hapur se ne kemi gabuar në metodën tonë të punës. Vendimet e Komitetit Qendror, me gjithë ndonjë të metë që kanë pasur, kanë qenë kurdoherë të drejta, por në praktikë janë bërë shtrembërime për të cilat edhe ne shokët e Byrosë Politike e të Qeverisë dolëm me autokritikë, gjë që pati rëndësi vendimtare. Partia ka respekt për ata që bëjnë autokritikë, ajo të kupton dhe të ndihmon, por kur nuk bën autokritikë, kjo është gjë e keqe, e dëmshme, sepse tregon që nuk e ke kuptuar gabimin.

Më vonë, shokë, kur ne të kemi fituar një eksperiencë më të madhe e të jemi kalitur në këtë luftë që po i bëjmë burokratizmit, do të mbledhim edhe Plenumin e Komitetit Qendror. Atje do të thellohet më shumë autokritika, do të analizojmë shkaqet, me qëllim që këto fenomene negative të mos përsëriten më në trupin e shëndoshë të Partisë dhe të pushtetit tonë, që barin e egër ta shkulim nga rrënjet, ta djegim dhe të kemi kujdes që farën të mos e marrë era e të na e sjellë për të mbirë përsëri.

Ne themi me të drejtë se për këtë gjendje ka faj udhëheqja, kemi ne përgjegjësi, por edhe ju, shokë, nuk jeni të larë. Po të sillnit në udhëheqje problemet më të mëdha që kanë preokupuar Partinë dhe jetën e vendit, po të paraqitnit para saj më shumë përgjithësime, atëherë do të kishim më shumë rezultate në punë. Problemet që na ngriheshin nga ju ishin të vogla, prej tyre nuk mund të arrije në konkluzione më të rëndësishme. Partia reagonte kundër një metode të tillë pune dhe kjo ishte një gjë e mirë, sepse na ndihmoi të shihnim realitetin. Po të mos reagonte Partia, punët

do të na shkonin keq. Pârtia luftonte, ndërhynte, detyrohej të merrte edhe kompetencat e të tjerëve, megjithëse kjo nuk ishte rruga e zgjidhjes. Partia në bazë e bënte këtë, se nuk e duronte vetë gjithë këtë burokratizëm, se e shikonte që gjérat nuk lëviznin. Po pse ky ose ai komunist, që ishte drejtues ose me detyrë më të thjeshtë në organet e pushtetit, nuk lëvizte? Sepse ishin gjithë këto hallka që e pengonin.

Nuk është e vërtetë që udhëheqja, Partia, baza si dhe shumë individë nuk e shikonin ku ishte sëmundja. Ata i shikonin gabimet e të metat dhe i reklamonin, duke propozuar të hiqej kjo ose ajo hallkë. Një pjesë e këtyre propozimeve merrej parasysh, por disa të tjera nuk merreshin, kishte propozime që hidheshin edhe në shportë. Përse ndodhët një gjë e tillë? Sepse ato që kishim vendosur i quanim si të mira, nuk u bënim analizën atyre gjëra që shumë herë nuk i ka vërtetuar jeta dhe këtu qëndron edhe shprehja e mendjemadhësisë. Ato, që patëm vendosur, ta zëmë, para dy vjetëve, tani nuk shkonin më, por nuk preokupoheshim që për ato të reflektonim, t'i studionim me kujdesin më të madh për t'i ndrequr, t'i vinim vetes pyetjen: «Pse ngjet kjo gjë, cila është arsyaja që nuk shkojnë këto punë?» etj. Pastaj nuk merreshin parasysh mendimet dhe vërejtjet e njerëzve, nuk shikohej që një fenomen i tillë dilte në shumë vende.

Ne zbatuam për një kohë eksperiencën sovjetike dhe nuk bëmë keq. Atëherë, kur nuk kishim eksperiencën tonë, ajo na ndihmoi, por më vonë duhej rishikuar se kishte kaluar koha dhe eksperiencia sovjetike nuk u përshtatej më në shumë raste e drejtime kushteve e

kërkesave të reja në vendin tonë. Ja, të marrim si shembull Kodin e Punës. Ky Kod është socialist, por është ca i rëndë. Është e vërtetë 'që ne e kemi shikuar kur e morëm nga sovjetikët, por nuk i kemi bërë të gjitha ndryshimet e duhura, në të lihet përshtypja sikur punëtori ynë është në luftë të përditshme, orë e çast, me pushtetin, me Partinë, me ndërmarrjen, sikur punëtori ka të bëjë me padronë e jo me Partinë dhe pushtetin e tij, me shokët e tij. Ne duhet të bëjmë me të vërtetë një kod pune socialist, ku të parashikohen edhe sanksione dhe shpërblime, por këto të janë mbi baza marksiste. Në këtë prizëm duhet të shikojmë edhe ligjin e sigurimeve shoqërore.

Ose të marrim çështjen e nxjerrjes së disa ligjeve e rregulloreve të pastudiuarë si duhet. Nuk është e drejtë që, pse spekulon një vagabond, të bëhet një rregullore aq e rreptë sa edhe për të shitur vezët një fshatar duhet të nxjerrë letërnjoftimin. Këtë fakt skandaloz e dëgjova të më thuhet kohët e fundit nga një shok i bazës. Ne kemi një popull xhevahir, pra, përsë u dashka një formë e tillë kontrolli? Fshatari mund t'i thoshte me plot të drejtë punonjësit të kooperativës së konsumit se nuk ta jap letërnjoftimin, prandaj, po deshe merri vezët, po deshe jo, letërnjoftimin e paragjës në bazë të ligjit.

Megjithëse këto janë probleme politike dhe kemi kaq vjet që po merremi me to, juve shokë nuk ju kanë bërë sa duhet përshtypje dhe nuk i keni ngritur me forcë. Këto veprime të padrejta që bëhen për të lehtësuar një njeri të pandërgjegjshëm cenojnë vijën e

drejtë të Partisë, megjithatë nuk duhet t'i përgjithësojmë rastet e veçanta.

Kështu duhet të reflektoni edhe ju dhe jo të merrni me cikërrima, se filani ka këtë apo atë të metë etj. Pra, ju, si punonjës të aparatit të Komitetit Qendror, i shikonit shumë pak këto çështje dhe kjo dëshmon përnënvleftësim të mendimit të bazës. Ne flasim përvijën e masave, themi ta dëgjojmë zërin e popullit, por këto që ndodhin tregojnë se nuk i dëgjojmë kurdoherë me kujdes vërejtjet, mendimet, propozimet që bëjnë masat përmëndyeshme ligje, urdhëresa etj., ngaqë jemi nisur nga mendimi se këto i ka vendosur udhëheqja dhe ajo nuk gabon. Një pikëpamje e tillë e gabuar çoi edhe në marrjen e kompetencave të tjerëve. Kjo duket, sidomos, në marrëdhëniet e Qeverisë me dikasteret. U krijua një situatë e tillë që dikasteri s'kishte të drejtë të shpenzonte, të paktën edhe fondet e veta. Përse nuk kemi besim te një ministër që t'i shpenzojë fondet e dikasterit që drejton? Mos vallë mund ta bëjë më mirë këtë punë një shok në aparatin e Komitetit Qendror ose në Kryeministri? Kështu ndodhi që vetë ministritë, edhe ato pak kompetenca që u kishin mbetur, ia shtynë pak nga pak udhëheqjes, derisa ka arritur puna që edhe përgjëra të vogla të jepet urdhër nga lart. Edhe ato pak kompetenca që u kanë mbetur ministritë nuk gjejnë si duhet zbatim se ministritë janë ngatërruar kaq shumë midis tyre me lidhje kontratash të ndryshme, saqë justifikonin moskryerjen e detyrave duke thënë: «Për këtë s'të lë financa», «për këtë s'ka transport», «këtë s'e jep industria» etj., etj. dhe punët nuk kryheshin.

Të gjithëve u kemi bërë kritikë, por edhe ne duhet të kishim bërë për vete më shumë autokritikë. Është e vërtetë që këto gjëra kanë ngjarë, por ju, shokë, pse nuk keni reaguar? Tani ne po i spastrojmë këto dhe do t'ia dalim në krye patjetër sepse Partia është e shëndoshë.

Kësaj çështjeje t'i vemi gjer në fund. Të përpinqemi të gjenden jo vetëm arsyet objektive të këtyre dobësive, por edhe ato subjektive. Secili të analizojë mirë veten e tij, të bëjë autokritikë, në mos këtu, në organizatë, në sektor. Ndonjëri mund ta bëjë në mënyrë të heshtur me vetveten, por e mira është ta bëni që këtu autokritikën dhe të gjithë të spastrojmë vetveten sa më parë. Kjo duhet bërë nga secili, sepse burokratizmi është si magneti që tërheq çdo gjilpërë, me kokë e pa kokë. Edhe në Parti ka elemente të burokratizmit. Për shembull, janë kërkuar të dhëna statistikore nisur nga dëshira për ta pasur sa më mirë në dorë gjendjen e Partisë, por kjo u ekzagjerua shumë. Për këtë kanë influencuar edhe statistikat shtetërore. Në aparatet e Partisë shkresat e tepërtë do të hiqen shpejt, kurse në aparatet e shtetit do të duhet më shumë kohë. Krahas kësaj duhen bërë përmirësimë në metodën dhe stilin në punë të njerëzve.

Me gjithë masat që do të merren në këtë drejtim, duhet pasur kujdes se mund të ketë keqinterpretime në disa çështje. Pasi të bëjmë pastrimin, shkurtimin e organikave etj., të shihen me vëmendje kompetencat. Ato duhen kuptuar drejt, se mund të ndodhë që shokët tanë t'i thonë njëri-tjetrit: «Ti ke punët e tua, unë të miat»; «unë si aparat shtetëror kam këto detyra ekonomike, ti

si Parti duhet të më përgatitësh terrenin nga ana politike»; «unë jam specialist dhe i di më mirë se ti, punëtor i Partisë, këto probleme» etj. Pra, dua të them të kemi shumë kujdes, se mund të na lindë rreziku i teknokratizmit. Për shembull, në Ministrinë e Bujqësisë, nga gjithë ai aparat që ka tanë, do të mbeten shumë më pak njerëz. Këta, natyrisht, do të jenë nga më të mirët, teknikët e specialistët më të zotë, por, duke qenë të tillë, mund të lindë rreziku që tekniku t'i thotë punëtorit të Partisë të mos ndërhyjë në «punët e tij», se ai është specialist. Dakord, ai mund të jetë specialist shumë i mirë, por duhet të ketë të qartë se është Partia ajo që udhëheq, dhe ajo udhëheq jo në mënyrë burokratike, por kolegjialisht dhe nëpërmjet levave të saj. Këtij t'i themi se ti si drejtues apo teknik që je do t'i realizosh detyrat në radhë të parë si komunist, planet do t'i ndjekësh në bazë të direktivave dhe të vendimeve të Komitetit Qendror të Partisë, kurse unë si punëtor partie nuk të them bëj kështu apo ashtu, por rëndësi ka çështja që bashkërisht të vendosim çfarë duhet të bëjmë për të realizuar, për shembull, rendimente të larta në drithë. Njerëzit tanë duhet të orientohen kurdoherë nga vendimet e Partisë. Ti si drejtor drejtoje fabrikën, unë nuk të pengoj të kryesh detyrën, por si Parti do të të shtyj ta bësh mirë punën. Ti nga kjo anë dhe unë nga ana tjetër do të mobilizojmë masat për të realizuar detyrat. Pra, edhe ti, megjithëse je drejtor a specialist, nuk duhet të veprosh në rrugë komandimi, por në rrugë partie. Edhe në ushtri ka shumë rëndësi kush vendos dhe mbi ç'parime vendos. Këtu ka rëndësi çështja që të merret vendim i drejtë se si ta

moshtim më lehtë armikun, ta goditim ku duhet e t'i shkaktojmë humbje të rënda me sa më pak humbje përvete. Vendim për këtë merr komiteti i Partisë, në të cilin zgjidhen shokët më të mirë që mund të udhëheqin drejt, kurse komandanti jep urdhër, komandon në bazë të vendimit të Partisë. Në rast se nuk i kuptojmë mirë këto çështje, Partia do të vyshket dhe në krye do të dalin teknikët. Në rast se gjer tanë të tjerëve u ishin marrë kompetencat, duhen parë me kujdes rrethanat përsë u ishin marrë.

Me këto rregullime që po bëjmë do të lehtësohen Partia dhe pushteti. Ju e kuptoni vijën e Partisë, reflektoni në kohë e mirë për këto probleme, çfarë duhet hequr e çfarë nuk duhet hequr, si do të jepet ndihma nga ju e si do ta kërkonit ju ndihmën etj. Tani ju jepen kohë dhe mundësi materiale të mendoni që, kur të shkoni në bazë, të jeni në gjendje të kapni problemet më kryesore që të mund t'u jepni komiteteve të Partisë ndihmë konkrete e të efektshme në atë mënyrë e në ato drejtime ku është më e nevojshme. Ndërkaq duhet të pastroni kokën nga ndonjë mendim që mund të keni se ju jeni më të zotë nga ata të bazës. Të mos jeni kurrë fodullë e mendjemëdhenj, të mos ekzistojë mendimi se vetëm ju dini dhe ata në bazë presin xhevahire prej jush. Ruhuni nga konsideratat jo të drejta që mund të krijoni për njërin kuadër ose për tjetrin. Kuadrot duhen vlerësuar nga rezultatet e punës së përgjithshme të Partisë, nga mobilizimi i masës së popullit dhe të mos kapemi nga ndonjë e metë e shkëputur e ndonjërit e ta zmadhojmë atë, sepse të meta e gabime do të gjenden në çdo kohë. Natyrisht, këto jo t'i lëmë të tra-

shen, por t'i kritikojmë, t'ua themi kuadrove ashtu siç janë dhe aq sa janë. Atje ku gabimi është i vogël të mos u flasim me vrazhdësi. Sa më i lartë të jetë funksioni që ke, aq me zë më të ulët të flasësh, që tjetri të të kup-tojë se e respekton. Pra, jo me të rrëmbyer. Me gjak-nxehtësi e arrogancë tjetrin mund ta trembësh se ke pozitën, por dije se, po nuk e binde, nesër ai do të hedhë gurin i pari kundër teje, por jo kundër Partisë. Të mos udhëhiqemi nga pikëpamje subjektive e të rrëmbyera, por t'i bëjmë gjérat me mend e me kujdes. Për t'i bërë mirë punët, gjendet gjithmonë kohë.

Me masat që po marrim, mos pandehni se tani çdo gjë mori fund, mos mendohet se me këtë fushatë vumë çdo gjë në vend, prandaj të punojmë me kujdes që ta mbajmë vazhdimisht të ngritur problemin, ta mësojmë drejt bazën dhe të mos kemi turp t'i themi asaj që kemi gabuar. Tani kemi përpara mjaft punë. Për t'i kryer sa më mirë ato, na duhet të reflektojmë për çdo gjë, të punojmë pa u lodhur, të mësojmë nga baza dhe pastaj të përgjithësojmë. Të mos quhen kohë e humbur ngritja e problemeve dhe këmbimi i mendimeve. Kërkoni me këmbëngulje të studiohen nga udhëheqja çështjet që ngrini dhe e bindni atë me argumente pse nuk është kështu ose ashtu, që ajo të ndihmohet për të marrë masa të drejta. Jemi komunistë, shokë, dhe përgjegjësinë e kemi njëloj para Partisë.

Kur të shkojmë poshtë, të dëgjojmë mirë zërin e bazës, pavarësisht nga eksperienca që ka udhëheqja në rreth. Udhëheqja atje, ta zëmë, ka menduar për një problem, mund të ketë arritur edhe në disa konkluzione, por ne të kërkojmë të aktivizohet mendja e çdo

komunisti, e qdo punonjësi. Komitetet e Partisë për masat që do të marrin në luftën kundër burokratizmit të dëgjojnë më parë edhe bazën, që ajo t'i aprovojë. Ju, kur të vini nga baza këtu, mos na sillni shifra duke na thënë se u hoqën kaq ose aq shkressa. «Makina» është vënë në lëvizje dhe do t'i qërojë të panevojshmet, por udhëheqja e Partisë ka nevojë që ju t'i thoni arsyen pse kanë qenë vënë, q'të këqija kanë sjellë ato etj. Kjo ka rëndësi. Po ta dimë arsyen, ajo do të na djegë si me zjarr dhe nuk do të biem më në ato gabime.

Vija e Partisë për dëgjimin e zërit të masave të jetë lajtmotivi që të na udhëheqë kurdoherë në punë jo me formula, por duke e kuptuar dhe duke e zbatuar atë në jetë, duke i ngritur peshë masat për të thyer burokratizmin. Do të ketë edhe njerëz që do të flasin çapraz, por mos u mërzitni prej tyre. Mund të ketë edhe nga ata që nuk do ta kuptojnë menjëherë këtë punë, prapë mos u mërzitni. Do të ketë edhe ndonjë armik, edhe nga ky mos u mërzitni. Shpjegojuni njerëzve një herë, dy herë, më vete dhe përpara gjithë kolektivit. S'ka njerëz që të mos i ndreqë Partia, por ka nga ata që e kuptojnë menjëherë direktivën e Partisë, siç ka dhe nga ata që e kuptojnë më vonë.

Planifikimi u bë në frymën e Thirrjes, mbasi u vunë në lëvizje masat punonjëse. Ky u përgatit me komisione, dhe jo me komisione burokratike, por me komisione pune, të gjalla, të lidhura me masat. Në rast se humbet kjo frymë, atëherë biem në ato komisione që ka dënuar Lenini.

Vërejtjet dhe propozimet që u bënë në këtë mbledhje të studiohen dhe të na paraqitet se kush duhet të

qëndrojë, kush duhet të hiqet, përse duhet të hiqet e ku duhet të shkojë. Për ata që do t'u shkurtohet vendi i punës orientimi është që të venë në prodhim. Kjo punë duhet menduar e bërë mirë. Edhe më parë kemi bërë shkurttime, por nuk kemi pasur shumë sukses, sepse nuk ishin përcaktuar mirë kompetencat e secilit. Kështu, fjala vjen, diku u shkurtuan vendet e punës, por pas një kohe jo të gjatë ato u shtuan përsëri, domethënë mbetëm në vend numëro. Tani do të shkurtohen plot kuadro në qendër, por do të shkurtohen edhe në bazë. Ata që do të shkurtohen në qendër, duhet t'ia dërgojmë bazës për në prodhim. Në qoftë se komiteti i Partisë i rrethit do të mendojë se ky që i dërgojmë ne është më i zoti nga ai që ka në këtë apo atë vend, le ta zë-vendësojë.

Një çështje që ka rëndësi për të gjithë në këtë luftë të madhe kundër burokratizmit është studimi. Ne gjithnjë kemi studiuar vepra të klasikëve të marksizëm-leninizmit, por studimi i secilës prej tyre në kohën e duhur ka rëndësi të veçantë, prandaj t'i lidhim mësimet e klasikëve të marksizëm-leninizmit me eksperiencën e Partisë sonë.

Botohet për herë të parë si-pas shënimeve të mbajtura në mbledhjen e organizatës-bazë të Partisë, që gjenden në AQP

USHTRIA ËSHTË SHKOLLË

Nga fjala para efektivit të repartit ushtarak N

7 janar 1966

Të dashur shokë ushtarë, nënoficerë dhe oficerë,

Jam shumë i gjëzuar që erdha sot këtu, t'ju shoh ju në radhë të parë, dhe këtë vepër të madhe që keni ndërtuar, si dhe t'ju uroj nga zemra në emër të Partisë e të Komitetit Qendror për gjithë këtë punë që keni bërë.

Ku qëndron madhështia e punës suaj për ndërtimin e këtyre objekteve në mënyrë kaq të përsosur, sa të jepin përshtypjen sikur nuk ndodhesh në zemër të malit, por në dhoma të pastra e të ajrosura? Madhështia e veprës që ndërtuat qëndron te ju, shokë ushtarë, nënoficerë e oficerë, qëndron në mendjen e në zemrën tuaj, në aftësitë dhe në forcën tuaj fizike, qëndron në brumosjen tuaj me pikëpamje politike dhe ideologjike.

Pra, vetëm me njerëz të tillë si ju, të pajisur me këto virtute të larta e të rralla, të pajisur me pikëpamje të drejta politike e ideologjike mund të ndërtohen me qindra vepra të tillë. Pikërisht në këto ide qëndrojnë forca juaj e madhe, edukata juaj, fryshtimi juaj në punë. Të gjitha këto virtute jua ka dhënë vija marksiste-

-leniniste e Partisë sonë, jua ka dhënë ai realitet i madh që qëndron në lidhjet e popullit tonë me Partinë, në lidhjet e ushtrisë me popullin dhe Partinë, në lidhjet tuaja me komandën, me Ministrinë e Mbrojtjes Populllore. Këto lidhje, këtë unitet ne i kuptojmë në praktikë ashtu si lidhjen e hekurit me çimenton, nga i cili del betoni i fortë e i pathyeshëm. Ideologjia marksiste-leniniste, politika jonë proletare, dituria, teknika, që janë vënë në shërbim të kësaj politike, hapën horizonte të gjera dhe i bënë njerëzit tanë të guximshëm, të fortë si çeliku, të pathyeshëm si malet tona. Njeriu nuk lind me këto cilësi. Ai i fiton ato në jetë, duke u rritur si shpirtërisht dhe fizikisht. Por ka rritje e rritje. Kur lind në një vend ku sundon ideologjia borgjeze, njeriu rritet duke qenë nën presionin e pikëpamjeve të kësaj ideologjie. Borgjezia me ideologjinë e saj luftonte dhe lufton për t'i çuar njerëzit drejt skllavërisë morale dhe fizike. Ideologët borgjezë, bashkë me ta edhe feja, në çdo kohë janë përpjekur për t'i mbajtur mendjet e njerëzve të ndrydhura, «të shtrënguara me një rrip të hekurt», që këta t'u shërbenin interesave të klasave sun-duese dhe klikës së fetarëve. Megjithatë, njerëzimi ka bërë përpjekje të pareshtura për t'u çliruar prej tyre.

Pak nga pak u arrit që mendimi njerëzor të përparronte mbi bazën e forcës dhe të eksperiencës së popujve. Dolën njerëz gjenialë si Marks i Engels që e morën këtë eksperiencë, e përpunuani dhe, në luftë të ashpër për t'u çliruar nga skllavëria, u kristalizua teoria marksiste-leniniste. Kjo teori armatosi proletariatin e popujt dhe i ngriti në luftë, tashmë në një luftë të re për një

shoqëri të re, ku ata do të ishin zot të vetes. Teoria marksiste-leniniste u pasurua me eksperiencën e revolucioneve popullore nga dolën gjenitë e mëdhenj Lenini e Stalini, vazhdueshit e veprës së Marksit e të Engelsit; u pasurua me luftërat e popujve, sidomos në epokën e imperializmit, kur u bënë kthesa të mëdha dhe imperialistët hengrën grushte të forta; u pasurua edhe me eksperiencën e popullit tonë, i cili ka derdhur gjak për t'i përmbysur klasat sunduese. Kështu me luftë fitoi revolucioni në Rusi, kështu fitoi edhe te ne.

Dua të them se njerëzit e Shqipërisë së re, të brumosur me këto ide të përparuara, revolucionare, që pasqyrojnë aspiratat e popullit, i ka edukuar dhe i ka frymëzuar Partia jonë, e cila i ka bërë të pamposhtur, si në luftën kundër armiqve feudo-borgjezë, ashtu edhe në luftën kundër fenomeneve të natyrës. Këto fenomene më përpara, njerëzit i besonin si një forcë të mbinatyrshme dhe u trembeshin, sepse ata nuk i njihnin ligjet e natyrës, por më vonë, kur mësuan ligjet dialektike, ata i kuptuan dhe shumë prej tyre i bënë zap. Teoria marksiste-leniniste u dha çelësin për të zgjidhur çdo problem, çdo vështirësi, për të luftuar e për të arritur ndërtimin e një shoqërie të re pa shtypje e shfrytëzim, ku njerëzit të punojnë mirë, të rrojnë mirë, të mësojnë e të çlodhen.

Partia jonë ka luftuar dhe lufton heroikisht për t'ia bërë popullit jetën sa më të mirë. Dhe tani është akoma koha e punës, koha e luftës. Kudo në Shqipërinë e re punohet që njerëzit tanë të luftojnë me këmbëngulje për t'u pastruar nga mbeturinat e së kaluarës dhe të fryshtëzohen nga vepra e madhe e Partisë, e cila i udhë-

heq drejt së ardhmes. Partia ju ka mësuar edhe ju që të punoni e të ndërtoni kaq mirë dhe shembulli juaj duhet të përgjithësohet. Te ju, ushtarët, nën oficerët dhe oficerët janë nga krahina të ndryshme, janë fshatarë dhe punëtorë, por ata janë bashkuar me njëri-tjetrin e janë bërë një e të pandarë, në unitet të çeliktë rreth Partisë, në unitet mendimi dhe veprimi. Ju keni bërë një punë të mirë për të luftuar në maksimum mbeturinat që ekzistojnë në ndërgjegje. Shokët më kanë folur për këtë. Ju nuk keni njojur as lodi as mundimin, nuk keni dashur të bëni as pushimin e ditës as atë të javës. Kjo ka ndodhur se për ju ka qenë gjë e madhe vënia në vend e porosive të Partisë. Puna është një akt heroizmi dhe patriotizmi, jo i pamenduar, por i menduar e i gjykuar thellë. Qëndrimi që mbanë ju ndaj detyrës ka rëndësi të madhe politike, sepse tregon se, kur Partia na ngarkon me detyra dhe kuptojmë rëndësinë politike të tyre, atëherë të gjitha dituritë që kemi, i përqendrojmë dhe i vëmë në shërbim të atdheut, duke i zbatuar ato në mënyrë të shkëlqyer.

Këto objekte që keni ndërtuar ju, ushtarë heroikë të këtij reparti, kanë një rëndësi të jashtëzakonshme përmbrojtjen e atdheut. Nga gjithë sa keni bërë, del se ju, ushtarët dhe oficerët, e keni kuptuar shumë mirë rëndësinë politike të detyrave që keni kryer. Ka rëndësi të madhe për ushtrinë që njerëzit që militojnë në radhët e saj t'i kuptojnë mirë këto gjëra dhe t'i zbatojnë sipas të gjitha rregullave dhe me disiplinë të lartë. Por rregullat dhe disiplina duhet të janë sipas vijës së Partisë, në interes të popullit. Kur çdo detyrë kuptohet politikisht, puna për realizimin e saj kryhet me sukses, pa

qenë nevoja t'i bërtitet ushtarit, vëllait, shokut me të cilin, kur ta lyp nevoja, do të luftosh krah për krah kundër armikut, do ta mbash ose do të të mbajë në krahë në llogore.

Kur ta kemi edukuar ushtarin mirë, nuk është nevoja, që të ngremë zërin, sepse edhe ushtari ka po ato cilësi morale që ka edhe oficeri. Mjafton t'i themi me ngrohtësi dhe me mënyrë bindëse se duhet kryer kjo punë ose kjo detyrë, jo për mua, por për atdheun, për të mirën e babait tënd, nënës, motrave, gjithë të afërmve, prandaj të jesh i disiplinuar, ta ruash pasurinë e shtetit dhe atëherë ushtari do ta bëjë detyrën pa fjalë, qoftë natë apo ditë. A është nevoja t'u bërtasim ushtarëve? Jo. Si mendoni ju, a do ta donit më shumë apo më pak atë oficer që nuk do t'ju bërtiste? Sigurisht që më shumë, kurse atë që do t'ju bërtiste ju do ta përshëndetnit me gjest, por jo me zemër. Më kanë treguar se, kur punohej këtu, në këtë vepër që keni ndërtuar, nuk mund të dalloje dot se kush ishte ushtar dhe kush oficer. Që të gjithë punonin dhe zbardhonin nga pluhuri. Mos vallë kështu u ra autoriteti oficerëve, komandantëve tuaj? Përkundrazi, ju thoshit për ta: «U lumtë» dhe i përshëndetnit me zemër.

Në ushtrinë tonë çdo problem duhet kuptuar politikisht dhe ideologjikisht. Shërbimi ushtarak te ne nuk është angari, por një nga detyrat më të shenjta. Ushtria është shkollë. Ju mësoni këtu të përdorni me mjeshëtëri armët, por fitoni në të njëjtën kohë edhe profesione të tjera dhe kështu, kur të ktheheni në fshat apo në qendrën e punës, ju këto mund t'i ushtroni, si dhe do të çoni atje frymën e unitetit të fortë, disiplinën

e ndërgjegjshme komuniste, fryshtë e kolektivitetit të ushtrisë sonë.

Partia i ka thënë popullit që të marrë shembull nga ushtria, të punojë me temp ushtarake, me disiplinë ushtarake, me organizim ushtarake. Minatorët tanë bëjnë një punë të madhe plot heroizëm për të ndërtuar atdheun socialist, por në qoftë se ata do të vinin ta shikonin punën tuaj këtu, do të entuziazmoheshin për veprat tuaja të ndërtuara në një kohë rekord, me më pak njerëz dhe me mjete të pakta. Po cilët janë këta minatorë? Në Memaliaj apo në Bulqizë qofshin, janë vëllezërit tuaj, janë shokët dhe prindërit tuaj. Në qoftë se ju i kaluat ata, duke bërë një punë kaq të madhe, këtë e arritët me disiplinën e ndërgjegjshme, me shpirtin luftarak, me shpirtin e kollektivitetit, me të cilët ju ka edukuar Partia jonë. Partia është e lumtur që ka një ushtri të tillë, pasqyrë e popullit. Ajo është forca kryesore e armatosur që qëndron në gatishmëri të përditshme për mbrojtjen e atdheut.

Gjersa ekziston imperializmi, ekziston edhe irreziku i luftës. Imperializmi amerikan po armatoset çoditë e më shumë. Edhe shërbëtorët e tij, revisionistët sovjetikë, po bëjnë të njëjtën gjë. Qëllimi i tyre është që të skllavërojnë popujt, sidomos vendet sociale, të zhdukin komunizmin, sepse ky do t'i futë ata në varr.

Prandaj vendi ynë socialist duhet të përgatitet në mënyrë të vazhdueshme, në përshtatje me situatat e reja që krijohen, me kushtet e brendshme e të jashtme, duke vlerësuar drejt si forcat tona, ashtu edhe ato të armikut. Asnjë lëshim nuk duhet bërë, asnjë sakrificë nuk duhet të marrim parasysh në këtë drejtim. Imperializmi për të fituar e për të nënshtuar-

popullin tonë përpinqet të dobësojë e, po të mundet, të degjenerojë Partinë, ashtu siç bëri me anën e revizionistëve në vendet ish-socialiste. Por te ne si populli ashtu dhe ushtria janë lidhur me Partinë si mishi me kockën.

Nën udhëheqjen e Partisë me kemi arritur kudo suksese si në bujqësi, në industri, në arsim, dhe më forcimin e mbrojtjes së vendit. Të gjitha këto e kanë ngritur edhe më tej nivelin e jetesës, megjithëse populli ka bërë sakrifica dhe është i gatshëm gjithnjë të zbatojë me vendosmëri porositë e Partisë. Vetëm një Parti si jona, marksiste-leniniste, mund të udhëheqë popullin përmes vështirësish e sakrificash të mëdha dhe të sigurojë gjithnjë fitore. Kjo është arritur, sepse në vendin tonë ekzistojnë forca kolosale mendore, morale, fizike, të cilat Partia i drejton dhe i kanalizon në rrugën e drejtë për t'ia arritur objektivit të caktuar. Populli ynë sheh me kënaqësi të madhe se jeta ecën përpara, se atdheu socialist zhvillohet e forcohet.

Duke pasur në udhëheqje Partinë e vet, populli ynë ka një besim të patundur se, po na prekën armiqtë, ai do t'i shpartallojë ata me siguri. Kjo është e llogaritur, e arsyetuar mirë. Ne luftuam kundër armiqve që ishin shumë herë më të mëdhenj dhe më të armatosur se ne gjatë Luftës Nacionalçirimitare, luftuam atëherë kur nuk kishim depo me armë e me municione, por kishim zemrën të fortë, kishim besimin e madh te Partia, e cila na nxori në dritë. Gjatë luftës ne s'kishim as bukë. Atë na e jepnin mënrat tuaja. Kur se tani ne kemi gjithçka. Partia dhe Qeveria kanë ma-

rrë masa dhe e kanë siguruar ushtrinë me çdo gjë të nevojshme. Çfarë suksesi i madh është për ne tani, kur ju kemi ju, shokë ushtarë, që dini më shumë nga sa dinin partizanët në kohën e Luftës Nacionalçlirimtare, që kemi ushtarakë të zotë, të cilët dinë gjithashtu më shumë nga sa dinim ne të Luftës Nacionalçlirimtare.

Ne kemi tani armë dhe municione të shumta, të të gjitha llojeve. Por këto armë dhe kjo teknikë do ta luajnë rolin e tyre të madh kur ju do t'i përdorni me mjeshtëri të lartë. Ju duhet të mësoni përdorimin e metodave të ndryshme të luftimit, të përfitonit sa më shumë nga eksperienca e Luftës Nacionalçlirimtare, sepse vetëm kështu do të bëni maksimalen me këto armë në këto male e gërxhe, në fushat tona, për t'i mbrojtur ato nga çdo gjë armik.

Ushtria jonë mëson tani Artin Ushtarak të Luftës Popullore jo sipas rregulloreve, taktikës e strategjisë së vjetër, por me rregullore, me taktikë dhe me strategji të re. Ajo disponon armë nga më modernet dhe përvetëson përdorimin e tyre me zell. Me një ushtri të tillë të armatosur nga të gjitha pikëpamjet nuk kanë q'na bëjnë as avionët, as gazrat, as raketat e armikut. Ja, pra, provat. Të gjitha këto e bëjnë Ushtrinë Popullore një mijë herë më të fortë se Ushtrinë Nacionalçlirimtare.

Ushtria jonë ecën përpara gjithnjë duke u forcuar. Ajo duhet të bëhet shembull për popullin në punë e përpjekje, të përgatitet për situata të vështira, në mënyrë që, po të vijnë këto situata, po të vijë rreziku, t'i kalojmë me guxim e vendosmëri. Të mos ndodhë që të biem në rehati, të hamë e të flemë pa merak, sepse kështu do të na mbulonin dembellëku e burokratizmi,

të cilët janë burim i shumë të këqijave, por të gjithë ushtarët tanë duhet të punojnë e të përgatiten me të tëra forcat, me vetëmohim e me vigjilencë të lartë dhe po të jetë nevoja, të jenë të gatshëm të bëjnë çdo sakrificë.

Mund të them se Partia dhe komandat në ushtri, pavarësisht nga të metat, punojnë mirë. Por të jeni të sigurt, shokë, se ju ushtarët përbëni pjesën vendimtare të ushtrisë. Pa ju, pa këshillat tuaja, pa mendimet tuaja, pa eksperiencën tuaj, pa kritikën tuaj oficerët fishken, u rritet mendja. Ju duhet të respektoni epro-rët tuaj, t'i zbatoni urdhrat, por ju duhet edhe t'i ndihmoni duke ua thënë të metat që kanë, që punët të ecin gjithnjë më mirë. Mund të ndodhë që oficeri të të flasë me inat, por ti si ushtar nuk duhet të nxehesh. Mendo se edhe oficeri yt ka vështirësitë, ka hallet e tij, ka edhe ndonjë çështje personale dhe mund të jetë ndodhur pikërisht në një moment të tillë kur të bërtiti. Kije parasysh këtë, lëre sa t'i kalojë inati dhe pastaj ia thuaj se ai e ka pasur gabim.

Të njëjtën gjë duhet të ketë parasysh edhe oficeri kur një ushtar gabon. Oficeri nuk duhet që menjëherë të rrëmbehet dhe t'i bërtasë atij. Ai duhet të shqetësohet, të pyesë mirë veten pse gaboi ushtari, si e ka hallin. Mos vallë ka ditë që s'ka marrë ndonjë le-tër nga shtëpia? Mos ka të sëmurë babanë ose nënën? Mos ka ndonjë hall tjetër familjar? Për të gjitha këto duhet të interesohet oficeri, t'ia qajë hallin ushtarit si babai të birit, si vëllai më i madh vëllait më të vogël dhe të mos marrë inat e të bërtasë, se njerëzit kanë ndjenja. Të jesh oficer do të thotë, para së gjithash,

të jesh pedagog i fortë, edukator i aftë i vartësve. Të tillë oficerë, të tillë eprorë, ushtari i do me zemër. Pra, në këtë drejtim Partia punon dhe punon shumë dhe pikërisht si rezultat i punës së saj ne e kemi ushtrinë të fortë, të dashur me popullin, të ashpër me armikun.

Këto suksese, këto vepra të mëdha, nuk i bënë gradat, por i bënë njerëzit me zemër të fortë, me ndërgjegje të lartë, me shpirt revolucionar. Ju e dini fort mirë, shokë, se në luftë ne nuk kemi pasur grada dhe prapë e dini se sa mirë kanë luftuar partizanët e kanë fituar mbi armiqjtë. Të gjithë janë entuziastë e plotësisht dakord me mendimin e Partisë për heqjen e gradave. Një oficer që vjen me shërbim në repart dhe ha bashkë me ty, me gavetë, fle bashkë me ty në fjetore, a nuk do ta duash dhe ta respektosh më shumë? Me siguri që ti do ta presësh atë me dashuri dhe do të jesh i kënaqur nga veprimi i tij. Ja, kështu duhet të veprojë oficeri ynë, sepse kështu ai do të lidhet më ngushtë me ushtarin dhe vlera e tij në sytë e ushtarit do të rritet shumë.

Po në qoftë se na duhet të bëjmë përsëri luftë, a do të kemi grada? Jo. Ç'na duhen ato? Ne do të luftojmë edhe pa grada dhe, kur të jetë nevoja, edhe pa xhaketë, edhe pa këpucë, ashtu si partizanët dje, sepse avioni armik na bombardon dhe mund të na e presë furnizimin. Mos vallë këto do të na pengojnë të luftojmë? Jo. Ne do të luftojmë me çdo kusht, sepse kështu na ka përgatitur dhe na përgatit Partia. Partia po i sheh këto çështje me kujdes dhe do të vendosë për to ashtu si është më mirë, për ta forcuar

më shumë ushtrinë tonë dhe për të rritur më shumë shpirtin luftarak të sëj. Ja, pra, pse ne e duam aq shumë Partinë, sepse ajo është zemra e popullit tonë, zemra e ushtrisë sonë, është arkitektja e së ardhmes sonë. Ta forcojmë Partinë, ta kalitim atë më tepër, sepse kështu kalitim ushtrinë tonë dhe gjithë popullin.

Ne, shokë, jemi shumë më të fortë se imperialistët. Vendi ynë socialist qëndron më lart se vendet imperialiste dhe kjo, sepse te ne sundon ideologjia e pavdekshme e marksizëm-leninizmit.

Imperialistët përgatiten për luftë, bile e kanë ndezur atë në shumë vende. Por me gjithë forcën, me gjithë armatimet e tyre të shumta, kudo po pësojnë disfata të pariparueshme. Vietnami është një shembull që po tregon kalbëzimin e imperializmit. Imperializmi nuk mundi ta llogariste mirë forcën e madhe të popullit dhe të partizanëve vietnamezë. Agresorët amerikanë mendonin se me makinat dhe me armët e tyre do të thyenin qëndressën e këtij populli, por i bënë hesapet pa hanxhinë. Imperialistët amerikanë bombardojnë ditë e natë në Vietnam, por bombardimet e tyre nuk janë efektive as në Veri as në Jug, ku 4/5 e vendit janë çliruar.

Në Vietnamin e Jugut amerikanët ndodhen të rrethuar nga të gjitha anët. Ata janë përqendruar vetëm nëpër qendrat kryesore të banuara dhe kanë marrë të gjitha masat për t'u mbrojtur nga rreziku. Ata dalin dhe sulmojnë kundër partizanëve me helikopterë dhe me forca këmbësorësh, të shoqëruara nga «ballistë» vietnamezë, por gjithnjë gjenden nën frikën e

sulmit dhe të shkatërrimit nga ana e partizanëve. Në luftime ata kanë humbje të mëdha, grijen nga partizanët, të cilët përdorin të gjitha llojet e armëve, që nga thika me kallam, gjer te dhokani i hekurt që i kap dhe i mbërthen ushtarët amerikanë pas këmbëve.

Po në bazat e tyre a janë të siguruar amerikanët? Jo, shokë. Ata morën masa në fillim dhe i rrethuan bazat me gjithfarëlloj mjetesh. U shkuan edhe një brez të gjerë, të lyer me të bardhë rreth e rrotull bazave, në mënyrë që edhe miza, po të kalonte, të dukej e të linte gjurmë. Gjithë natën e natës e mbanin këtë brez nën prozhektorë. Dhe kështu pandehën se ishin të sigurt, të mbrojtur nga çdo rrezik. Ata menduan se s'kishte bir nëne të depërtonte midis gjithë atyre pen-gesave, midis armëve e mjeteve të shumta e moderne. Mirëpo ç'ngjau? Një mëngjes Danangu, një nga bazat ushtarake më të mëdha të Vietnamit të Jugut, u hodh në erë. Dhe kjo u bë vetëm nga një grup i vogël partizanësh vietnamezë. Këta partizanë, që s'marrin parasysh asgjë kur është puna për të luftuar dhe për të shpartalluar imperializmin amerikan dhe shërbëtorët e tij, i bënë trima të tillë të guximshëm edukimi politik, ndërgjegjja e tyre e lartë, dashuria e madhe për atdheun.

Tani amerikanët përpiken të dalin nga ky kurth, ku hynë vetë, por e kanë të vështirë. Atyre u ndodhi siç thotë një fjalë e urtë e popullit: «Dhashë një pare e hyra në valle, jap pesëqind e nuk dal dot». Ata po zhvillojnë një aktivitet diplomatik të madh në të gjithë botën për të treguar sikur gjoja janë për paqen në

Vietnam. Jo, shokë, ata nuk e duan kurrë paqen. Këtë e bëjnë për demagogji. Atyre u kanë mbetur vetëm dy rrugë: ose të tërhiqen, të largohen nga Vietnami me turp e humbje, gjë që s'e gjelltin dot kollaj, ose të zgjerojnë luftën më shumë, ta ngjitin më lart, duke tërhequr në të edhe vende të tjera imperialiste.

Shikoni, pra, shokë, ja se si gjithë kjo Amerikë, e armatosur gjer në dhëmbë me lloj-lloj armësh, edhe me bomba atomike dhe me hidrogjen, nuk është në gjendje që të thyejë një popull të vogël, kur ai reziston me heroizëm, siç po bën populli vietnamez.

Në vendet ish-socialiste të Evropës kanë ardhur në fuqi revizionistët. Këto klikë tradhtarësh të marksizëm-leninizmit janë vënë në shërbim të imperializmit. Ashtu si imperialistët, edhe revizionistët modernë duan që të shkatërrojnë socializmin, sepse vetëm kështu do t'i hapin rrugë realizimit të qëllimeve të tyre antipopullore, armiqësore. Për t'ia arritur kësaj, revizionistët, në vendet ku sundojnë, po bëjnë me shpejtësi transformimin e partisë dhe të pushtetit në parti dhe pushtet që t'u shërbejnë interesave të tyre. Asnjë iluzion nuk duhet pasur për këta. Por në këto vende nuk kanë humbur ndjenjat revolucionare të njerëzve të ndershëm. Klikat revizioniste kanë hasur dhe do të hasin në një luftë të vendosur të popullit dhe të komunistëve. Është ligj që tradhtarët do të izolohen nga populli dhe populli do t'ua gjejë vendin. Kur? Kjo është çështje kohe dhe varet nga lufta e masave revolucionare. Sa më shpejt e me vendosmëri të veprojnë forcat revolucionare brenda vendeve ish-socialiste të Evropës kundër udhëheqjeve revizioniste, aq më

shpejt do të vijnë shpartallimi i tyre, fitorja e popullit dhe e revolucionit.

Revisionistët hrushovianë po e shohin fundin e tyre. Atyre po u dridhet toka nën këmbë. Ata mbështeten në shtresën e burokratëve, të cilëve po u japid rroga të majme për t'i bërë më parazitarë dhe për t'i përdorur si xhelatë kundër popullit. Por ata janë pakica, shumicën e bën populli. Këtij i takon fitorja.

Për t'ia arritur qëllimit armiqësor, revisionistët gjithashtu bashkëpunojnë me padronët e tyre, me imperialistët, sidomos me ata amerikanë. Politikën e jashume të tyre ata e mbështetin te bashkëpunimi me imperializmin amerikan, me të cilin bëjnë komplotë dhe llogari për ta ndarë botën në sfera influence dhe për t'i sunduar ato. Pra, «bashkekzistenca paqësore» dhe «rruga paqësore» e revisionistëve hrushovianë, bëjnë pjesë në planet e tyre të tradhtisë, të bashkëpunimit me imperialistët amerikanë. Qëllimi i përba-shkët i këtyre armiqve të egër të popujve është që të godasin forcën e madhe të sistemit socialist, të godasin Republikën Popullore të Shqipërisë dhe Partinë e saj të Punës, të vogël në numër, por të madhe ideologjikisht. Prandaj është koha që ne të zhvillojmë një luftë frontale edhe kundër imperializmit, edhe kundër revisionizmit modern. Partia e Punës e Shqipërisë është një shembull frymëzues për të gjithë marksistë-lininistët dhe për të gjithë popujt e botës në luftën e tyre për liri, se si të luftojnë e të fitojnë kundër armiqve. Kjo është arsyaja që imperialistët dhe revisionistët i kanë drejtuar të gjitha bateritë kundër Partisë sonë dhe partive të tjera marksiste-leniniste. Por a ka-

në pasur sukses? Jo. Fakti më i madh, më i gjallë jemi ne, Partia jonë, populli ynë. Të gjitha ç'u erdhën përdoresh, ata i bënë kundër Partisë dhe vendit tonë, por nuk fituan asgjë. Në këtë lëftë të ashpër fituam ne. Popujt e botës e panë mirë fytyrën prej tradhtari të revizionistëve hruščovianë, të cilët bashkëpunojnë me armikun më të egër të njerëzimit, me imperializmin amerikan.

Partia jonë ka fituar një popullaritet dhe dashuri të madhe edhe jashtë vendit, sepse ato që thotë ajo janë të drejta, prandaj punonjësit e vendeve të tjera e duan dhe e respektojnë. Imperialistët duhet të mendojnë shumë para se të prekin Shqipërinë. Kushdo që do të guxonte të prekte vendin tonë, do të tërhiqte mbi vete kundërshtimin dhe unitetin luftarak të popujve të botës, sepse, po të preket Shqipëria, kjo bëhet menjëherë një çështje e madhe e opinionit publik botëror dhe ky opinion është një forcë e madhe.

Revizionistët përpilen me të gjitha forcat që të gjenjejnë naivët, të bëjnë politikën e tyre djallëzore, ashtu siç e bënë në Afrikë, do ta bëjnë në Havanë¹, por prapë do të mbeten me gisht në gojë. Do të mbarojnë këto konferenca dhe ata përsëri do të qafohen e do të puthen me imperialistët amerikanë. Atëherë popujt do të shohin edhe një herë se sa larg janë fjalët nga veprat e revizionistëve, do ta shtojnë urrejtjen kundër tyre.

Në këtë situatë, shokë, punët neve na shkojnë mirë dhe kjo sepse kemi një popull dhe një Parti të

1 Shih: Enver Hoxha. Vepra, vëll. 30, shënim 1, f. 513.

fortë. Ne tani po përgatitim planin e katërt pesëvjeçar. Partia iu drejtua popullit dhe ai e hartoi vetë këtë plan, duke tejkaluar çdo parashikim të bërë nga organet tona shtetërore. Nuk është parë kurrë ndonjëherë një entuziazëm i tillë në vendin tonë si ky që u manifestua tani nga populli ynë për t'iu përgjigjur Thirrjes së Partisë dhe të Qeverisë. U ngrit i madh e i vogël, mori pjesë aktive duke dhënë mendime e duke bërë propozime dhe filloi punën për t'i zbatuar ato në jetë. Populli iu përgjigj Thirrjes me revolucionarizëm. Ai na tha neve: «Tani shikoni dhe ju punën brendapërbrenda, e përmirësoni atë më shumë». Dhe ju e dini, shokë, se Byroja Politike bëri autokritikë për shfaqjet e burokratizmit. Burokratizmi është si ajo dhembja që të zë avash-avash dhe vjen një ditë e të bllokon, prandaj Partia jonë ka luftuar me kohë kundër tij dhe tani ka filluar një luftë më të fortë e më të gjerë. Çdo ditë që kalon na armatos me eksperiencë të re, na jep mundësi që të thellohem më shumë, që të mësojmë më shumë.

Mendoj, shokë, se edhe ju në ushtri duhet t'i shikoni mirë rregulloret dhe t'i pastroni nga gjërat e panevojshme. Neve na duhet që në rast lufte, oficeri të mbledhë ushtarët, të këshillohet me ta dhe pastaj të vendosë se si dhe në ç'mënyrë do ta godasë armikun për ta shpartalluar plotësisht. Mendimi i masës së ushtarëve është një forcë e madhe.

Pra, shokë, duke përfunduar, po ju them edhe një herë se si në gjendjen ndërkombëtare ashtu edhe në gjendjen e brendshme, punët na shkojnë mirë. Ne po përgatitemi për Kongresin e 5-të të Partisë. Pa

sillni ndër mend Kongresin e 4-t dhe kujtoni se me ç'unitet, me ç'vendosmëri i zhvilluam ne punimet e tij! Akoma më mirë, me një forcë edhe më të madhe, më të zjarrtë, do t'i zhvillojmë punimet e Kongresit të 5-të. Shumë gjëra të mira do të sillni edhe ju me rastin e këtij Kongresi.

Ju uroj, shokë, nga zemra, në emër të Komitetit Qendror, në emër të të gjithë shokëve që ndodhen këtu, suksese të reja!

Të rrojë Partia!

Të rrojë Ushtria Popullore!

*Botohet për herë të parë si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

ME ÇFARË PO SHKOJNË REVIZIONISTËT ITALIANË NË KONGRESIN E TYRE TË 11-TË

Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»

9 janar 1966

Revisionistët italianë po përgatiten për kongresin e tyre të 11-të, i cili do të mbahet nga fundi i janarit 1966. Lidhur me këtë, ata në një plenum të posaçëm të Komitetit Qendror e të Komisionit Qendror të Kontrollit, që u zhvillua nga 26 deri më 30 tetor 1965, diskutuan dhe adoptuan «Projekttezat për Kongresin e 11-të të PK Italiane». Tani fushata e përgatitjeve për kongresin ndodhet në kulmin e saj.

Nga çfarë karakterizohen përgatitjet e revisionisteve italianë për këtë kongres? Me çfarë po shkojnë ata në kongresin e tyre?

Tërë puna përgatitore për kongresin, dhe veçanërisht plenumi i lartpërmendur që adoptoi projekttezat përkatëse, karakterizohen, para së gjithash, nga vështirësi serioze e kontradikta për çështje taktike në gjirin e udhëheqjes revisioniste të PK Italiane, të shkaktuara nga disfatat e rënda që ka pësuar vija e saj antimarksiste në tërë frontin.

Por, nga ana tjetër, përgatitjet për kongresin e 11-të tregojnë qartë se, me gjithë disfatat e pësuara, udhëheqja e PK Italiane, me L. Longon në krye, po ecën me këmbëngulje më tej në rrugën tradhtare revizioniste, gjë që s'i premton asaj asgjë tjetër veçse disfata të reja gjithnjë më të rënda e më diskredituese.

Përgatitjet e revizionistëve toliatistë italianë për kongresin paraqesin interes, sepse vija e tyre është tipike për të studuar fizionominë e vërtetë politike e ideologjike të të gjithë revizionizmit modern ndërkombetar, është një pasqyrë tepër e qartë e thelbit të revizionizmit modern, që tregon se në ç'llum oportunist e në ç'pasoja të rënda i shpie partitë komuniste revizionizmi, gjë nga e cila nxjerrin konkluzione të rëndësishme gjithë komunistët e revolucionarët e vërtetë, për të cilët janë të shtrenjta parimet e marksizëm-leinizmit dhe idealet e socializmit e të komunizmit.

I

GJENDJA E SOTME NDËRKOMBËTARE DHE DËSHTIMI I PREDIKIMEVE PACIFISTE TË REVIZIONISTËVE

Një grusht i rëndë kundër predikimeve pacifiste të revizionistëve toliatistë

Nuk është sekret për asnjeri se revizionistët toliatistë, krahas atyre hrushovianë e titistë, kanë qëndruar në «radhët e para» të predikuesve të së ashtuquajturës bashkekzistencë paqësore me imperializmin, sidomos

mos me atë amerikan, dhe në përputhje me këtë «bashk-ekzistencë» e në frymën e saj kanë përhapur një mijë iluzione të bucura për krerët e imperializmit. Janë pikërisht ata që kanë predikuar se e ashtuquajtura politikë e bashkekzistencës paqësore, e ndjekur nga udhëheqja revisioniste sovjetike, çoi gjoja në uljen e tensionit në marrëdhëniet ndërkontinentare dhe se krerët e imperializmit, si Ajzenhaueri, Kenedi e Xhonsoni, qëndronin gjoja në pozita paqësore, ndërsa shtytja për një politikë agresive e luftënxitëse paska ardhur gjoja vetëm nga disa qarqe ekstremiste «të tèrbuarish». Janë pikërisht udhëheqësit e PK Italiane ata që nga tribuna e kongresit të 10-të të saj predikonin një «garë paqësore» midis shteteve socialiste dhe «klasave drejtuese borgjeze» për ndërtimin e një rendi ekonomik e shqëror në të cilin të kënaqen të gjitha dëshirat e njerezve e të popujve për liri, për mirëqenie, për pavarsësi, për zhvillimin e plotë dhe për respektin ndaj personit, për bashkëpunimin paqësor midis të gjitha shteteve (shih «Tezat për Kongresin e 10-të të PK Italiane»), «për të zgjidhur problemet e mëdha që qëndrojnë para njerezimit». (P. Toliati.)

Të gjitha këto janë kritikuar rreptë nga partitë marksiste-leniniste si iluzione të rrezikshme, të cilat vënë në gjumë vigjilencën e popujve, dobësojnë luftën e tyre kundër imperializmit dhe rrezikojnë paqen.

Dhe cila është gjendja sot? Acarimi i marrëdhënieve ndërkontinentare dhe shtimi i rrezikut të luftës në kohën e sotme, që e kanë burimin në intensifikimin e veprimeve agresive të imperializmit amerikan, sidomos në agresionin barbar e të paturpshëm të tij

në Vietnam, u ka dhënë një grusht dërrmues të gjitha predikimeve e iluzioneve pacifiste të revisionistëve italianni e të të gjithë revisionistëve modernë.

Tani vetë ata janë të detyruar ta pranojnë se «gjendja ndërkontaktare sot është shumë e rëndë», se «procesi i uljes së tensionit — që përbën një kusht të domosdoshëm për vendosjen e një sistemi marrëdhënieh ndërkontaktare, të mbështetur mbi bashkekzistencën paqësore — ka pësuar, në tërësi, një ngecje të dukshme në vend». («Projekttezat për Kongresin e 11-të të PK Italiane».) Duam t'i pyesim udhëheqësit revisionistë italianni: Si është e mundur të ndodhin «mrekulli» të tillë?! Si është e mundur që qeveria e Xhonsonit — të cilin revisionistët e shpallën, ashtu si dhe paraardhësin e tij, Kenedin, «kampion të paqes» dhe rizgjedhjen e të cilit si president e shpallën fitore të madhe të kursit të paqes, të bashkekzistencës paqësore e të arsyes në SHBA — është hedhur tani në aventura të tillë «të paarsyeshme», si agresioni në Vietnam apo në Dominikë?! Cili është sot fati i garës paqësore me «klasat drejtuese borgjeze» për krijimin e një «rendi ideal» mbi tokë?! Është bërë akoma më e qartë se ëndrrat e dështuara pacifiste të revisionistëve tolalistë nuk vlejnë asnjë grosh, se jo duke përhapur iluzione për imperializmin e krerët e tij, por vetëm me një luftë të vendosur kundër imperializmit, e në radhë të parë kundër atij amerikan, duke e demaskuar atë pa mëshirë dhe duke u dhënë kundërgoditje të fuqishme veprimeve të tij agresive e luftënxitëse, duke ngritur peshë në një luftë aktive antiimperialiste popujt, mund të zembrapset ai, të prishen planet e tij kriminale, të mbro-

het paqja dhe të arrihet çlirimi i popujve të robëruar.

Eshtë me të vërtetë qesharake dhe e neveritshme kur sheh se me sa demagogji revizionistët italianë «kritikojnë» sot dhe «ngarkojnë me përgjegjësi» për acharimin e gjendjes ndërkombëtare... laburistët anglezë dhe socialdemokratët! Në «Projekttezat» thuhet: «Të mëdha janë... përgjegjësitë e lëvizjes socialdemokrate, e sidomos të laburistëve anglezë, të cilët, pasi erdhën në fuqi, vazhduan dhe intensifikuan aventurën imperialiste në Malajzi dhe politikën koloniale «në lindje të Suezit», ruajtën armatimin bërthamor të Britanisë së Madhe» etj. Ç'zbulim i bukur e origjinal! Kësaj i thonë me të vërtetë të zbulosh Amerikën për të dytën herë! (Mund të shtojmë këtu, për të plotësuar atë që «kanë harruar» revizionistët italianë, se qeveria laburiste angleze dhe krerët e djathtë socialdemokratë përkrahin plotësisht luftën e ndyrë agresive të imperializmit amerikan në Vietnam.) Por dihet se janë pikërisht po këta revizionistë toliatistë dhe shokët e tyre në vendet e ndryshme që kanë përhapur gjithfarë iluzionesh për krerët socialdemokratë e laburistë, duke thënë se «po anojnë nga e majta», po ndjekin një politikë paqësore dhe janë rikthyer ose po rikthehen në pozitat e socializmit. A nuk ishte vallë P. Toliati ai që e quante të mundur kalimin në socializëm në Angli edhe nën drejtimin e Partisë Laburiste? A nuk ishte ai që e ka karakterizuar partinë socialdemokrate si një parti që është për socializmin dhe që shtroi në rendin e ditës çështjen e unitetit me të? Faktet e sotme vërtetojnë akoma më hapur e në kundërshtim të

plotë me iluzionet e përhapura nga revizionistët se krerët socialdemokratë, laburistë dhe njerëzit e kallëpit të tyre janë tradhtarë të regjur të klasës punëtore e të çështjes së socializmit dhe agjenturë e rrezikshme e borgjezisë dhe e imperializmit.

Acarimi i gjendjes ndërkontinentale në kohën e sotme si rezultat i intensifikimit të veprimtarisë agresive të imperializmit amerikan, i ka vënë revizionistët italianni, si dhe ata hrushovianë e gjithë revizionistët modernë, në pozita shumë të rënda, sepse i diskreditoi ata, i detyroi të manovrojnë për të justifikuar qëndrimet e tyre pacifiste dhe, për më tepër, vështirësoi shumë ndjekjen e politikës së tyre kapitulluese e tradhtare, e cila synon, nga njëra anë, bashkëpunimin e ngushtë e të gjithanshëm me imperializmin amerikan, ndërsa nga ana tjetër, mashtimin e popujve duke u paraqitur si miq e përkrahës të tyre «të zjarrtë». Tani kjo politikë demagogjike ndodhet në krizë të thellë. Përpëlljet në plenum lidhur me përcaktimin e gjendjes së sotme ndërkontinentale dhe të qëndrimit që duhet mbajtur ndaj imperializmit amerikan janë shprehje kuptimplotë e kësaj pozite të vështirë e antimarksiste në të cilën e kanë vënë veten revizionistët me politikën e tyre tradhtare.

Justifikimet revizioniste nuk mund të mashtrojnë popujt

Përballë disfatës dhe diskreditimit të pozitës së tyre pacifiste, udhëheqësit revizionistë italianni përpipi-

qen të manovrojnë e të justifikohen duke shtrembüuar shkaqet e vërteta të acarimit të gjendjes ndërkombe-tare në kohën e sotme:

Së pari, ata përpiken të justifikojnë e të mbrojnë politikën e jashtme kapitulluese të udhëheqjes revizioniste sovjetike, të cilën e kanë përkrahur fuqimisht e pa rezerva. Ata thonë se iniciativa paqësore e Bashkimit Sovjetik qysh nga viti 1954 arriti suksesë të dukshme, i shkaktoi disfatë «luftës së ftohtë», e detyroi imperializmin të heqë dorë nga qëllimi i përmbytjes së regjimeve socialiste ekzistuese me anën e forcës dhe të kërkojë rrugë të reja e të ndryshme për të mbrojtur pozitat e veta të sundimit, favorizoi fitoren e pavarësisë politike nga dhjetëra e dhjetëra popuj, kontribuoi për të ndryshuar në një drejtim pozitiv kushtet e luftës politike e shoqërore brenda shumë vendeve kapitaliste, ndryshoi thellësisht përbërjen e OKB-së etj., etj. (Shih «Projekttezat» dhe raportin e L. Longos në plenum për paraqitjen e tyre.)

Ata përpiken gjithashtu të mbulojnë e të justifikojnë kompromisin e turpshëm të udhëheqjes revizioniste hrushoviane me imperializmin amerikan për ndarjen e zonave të influencës në kurriz të interesave jetike të popujve, kompromis që u zbulua në tërë lakuriqësinë e tij të shëmtuar gjatë krizës në zonën e Karaibeve, ndërsa kohët e fundit edhe në çështjen e konfliktit indiano-pakistanez, apo në çështjen e Vietnamit. Lidhur me këtë thuhet, se në kërkim të rrugëve të reja përuajtjen e sundimit imperialist dhe me qëllim që t'i ruajë SHBA dhe tërë botën nga një katastrofë atomike, presidenti Kenedi përpunoi të ashtuquajturën

strategji të paqes, e cila synonte që, «nëpërmjet marrëveshjesh të pjesshme, të arrihej një marrëveshje e përgjithshme midis dy superfuqive atomike, e cila të ishte në gjendje të ndalonte një luftë të re botërore, si dhe të garantonte disa masa të caktuara çarmatimi dhe një zhvillim të caktuar të bashkëpunimit ekonomik në shkallë botërore, por me kusht që kjo marrëveshje të bazohej në ndarjen e botës në «sfera influence», ndarje që parashtrohej si e vetmja bazë e mundshme për bashkekzistencën paqësore». («Projekttezat për Kongresin e 11-të të PK Italiane».) Revizionistët italianë kërkojnë tani t'u mbushin mendjen njerëzve se gjoja udhëheqja sovjetike e refuzoi dhe e hodhi poshtë ofertën e Kenedit për një marrëveshje dypalëshe prapa shpinës së gjithë popujve e shteteve të tjera të botës, megjithëse ajo do të mund të krijonte një klimë më të favorshme në marrëdhëniet ndërkombëtare, e sidomos midis SHBA-së e BS, refuzim që paska gjetur shprehjen e tij në marrëveshjen e arritur për çështjen kubane. «Kompromisi i arritur në atë rast — deklaroi Longoja në raportin e tij në plenum — ishte një disfatë e qartë e tezës amerikane të ndarjes së botës në «sfera influence»».

Së dyti, duke u përpjekur të justifikojnë pozitën pacifiste në të cilën ndodhen dhe iluzionet e përhapura prej tyre për krerët e imperializmit, udhëheqësit revizionistë italianë thonë se, nën qeverisjen e presidentit Kenedi, ndiqej e ashtuquajtura strategji e paqes dhe vetëm pas vrasjes së tij ajo u braktis nga grupet drejtuese të imperializmit amerikan, iniciativa kaloi në duart e «grupeve ekstremiste e reaksionare», të cilat

u rikthyen në metodat e «luftës së ftohtë», të shantazhit atomik e të ndërhyrjes së armatosur kundër lëvizjeve çlirimtare e demokratike.

Së treti, duke dashur të justifikojnë pozitat e veta pacifiste e kapitulluese dhe të fshehin qëndrimin tradhtar të udhëheqjes së sotme sovjetike e të përkrahësve të saj lidhur me agresionin imperialist në Vietnam, revizionistët italianë përpinqen që, të paktën, një pjesë të përgjegjësisë për gjendjen e nderë ndërkombëtare në kohën e sotme, t'ua ngarkojnë «politikës adventureske» të partive marksiste-leniniste, si dhe «mungesës së dëshirës» së tyre për «veprime të përbashkëta kundër imperializmit».

Por sido që të manovrojnë udhëheqësit revizionistë italiane, ata nuk do të mund të fshehin të vërtetën dhe ta shesin sapunin për djathë. Faktet hedhin poshtë pa mëshirë demagogjinë e tyre.

- Para së gjithash, për çdo marksist e revolucionar të vërtetë, për çdo njeri me mend që kuption nga politika, është fare e qartë se acarimi i gjendjes ndërkombëtare nuk mund të shpjegohet me të tilla gjëra si vrasja e Kenedit apo ardhja e Xhonsonit në fuqi, që në fakt s'janë shkaqet, por pasoja sekondare të politikës së qarqeve imperialiste në këto apo ato momente. Në të vërtetë, acarimi i marrëdhënieve ndërkombëtare në kushtet e sotme është shprehja e natyrës agresive e luftënxitëse të pandryshueshme të imperializmit, sidomos të atij amerikan, gjë që rrjedh nga vetë thelbi i tij si sistem shoqëror. Por pikërisht këtë nuk duan e nuk mund ta pranojnë revizionistët, sepse pranimi i kësaj të vërtete do të thotë refuzim e disfatë e tërë

strategjisë së «bashkekzistencës paqësore» që predikojnë ata, e cila mbështetet kokë e këmbë në iluzionet mbi ndryshimin e natyrës agresive e luftënxitëse të imperializmit, mbi pranimin nga ana e tij të «garës paqësore» të dy sistemeve e të tjera dokrra si këto.

Për sa i përket së ashtuquajturës strategji të paqes të Kenedit, me anën e së cilës udhëheqja revizioniste e PK Italiane përpinqet tani të justifikojë qëndrimin e saj pacifist dhe iluzionet e përhapura për imperializmin amerikan dhe krerët e tij, ajo është një blof. Tërë bota e di se pikërisht nën drejtimin e Kenedit u zhvillua me një intensitet të padëgjuar gara e shfrenuar e armatimeve, u morën masa për forcimin e blloqeve ushtarake agresive të imperializmit, u shtuan veprimet për ringjalljen dhe armatimin e militarizmit revanshist në Gjermaninë Perëndimore, u krijuan vatra zjarri në pika të ndryshme të botës, u nxit regjimi kukull i Çan Kai Shisë për të sulmuar RP të Kinës, u shtuan forcat e armatosura amerikane në Azinë Juglindore, dhe sidomos u ndërmorën veprime të egra armiqësore e agresive kundër Republikës Kubane, gjë që shkaktoi krizën e rrezikshme në rajonin e Karaibeve. Ishte Kenedi ai që shpërtheu luftën e ndyrë agresive në Vietnam. Ishte pikërisht Kenedi «paqedashës» ai që pati deklaruar se «në rrëthana të caktuara ne mund të marrim iniciativën në konfliktin bërthamor me Bashkimin Sovjetik». Si mund të thuhet, pra, siç bëjnë revizionistët italianë, se politika e ndjekur nga Kenedi dhe qeveria e tij imperialiste «hapi një terren të ri për iniciativën e forcave të paqes dhe favorizoi zhvillimin e një klime më të favorshme në marrëdhëniet

ndërkombëtare»? A nuk është e qartë se kjo është një orvatje e trashë për ta paraqitur të zezën si të bardhë?

Por jo vetëm për Kenedin kanë përhapur iluzione pacifiste udhëheqësit revisionistë italianë dhe shokët e tyre. Të njëjtat gjëra ata kanë thënë edhe për presidentin e sotëm të SHBA-së, agresorin e tërbuar Lindon Xhonson, të cilin tanë detyrohen «ta kritikojnë». Ja, për shembull, ç' shkruante për të gazeta «Unita» e 15 nëntorit 1964 në tërë faqen e parë, nën një titull të madh «Angazhimi paqësor i Xhonsonit», lidhur me rastin e zgjedhjes së tij: «Xhonsoni dhe bashkëpunëtorët e tij më të ngushtë, gjatë fushatës elektorale, u angazhuan seriozisht në mbrojtje të një politike që ka si objektivin e saj kryesor ruajtjen e paqes». Dhe më tej: «Sot është puna që jo vetëm të ndiqet kjo rrugë¹, por edhe të thellohet e të zgjerohet ajo për t'i bërë Shtetet e Bashkuara njërin prej protagonistëve më të mëdhenj të një politike të paqes, në një botë që ecën drejt objektivave të drejtësisë, të lirisë e të përparimit».

2. Nuk qëndrojnë dot në këmbë orvatjet për të justifikuar politikën kapitulluese të udhëheqjes revisioniste sovjetike duke e paraqitur atë si një faktor që paska çuar gjoja në uljen e tensionit ndërkombëtar, në disfatën e «luftës së ftohtë», në sigurimin e vendeve socialistë etj., etj. Përkundrazi, faktet provojnë se politika e jashtme tradhtare e udhëheqjes sovjetike, politika e

¹ Është sfala për rrugën e politikës «paqësore» që gjoja la trashëgim Kenedi.

kapitullimit para shantazhit imperialist, e lëshimeve pa parim ndaj imperializmit, e bashkëpunimit dhe e ndarjes së «zonave të influencës» me të, inkurajoi veprimet agresive të imperializmit amerikan, duke u bërë kështu një ndër shkaqet kryesore të acarimit të gjendjes ndërkombëtare. Nuk ka asnje dyshim se me raportin e sotëm të forcave në botë në favor të socializmit e kundër imperializmit, imperialistët amerikanë nuk do të kishin guxuar kurrsesi të shpërthenin agresionin e tyre të paturpshëm kundër RD të Vietnamit, po të mos ishin inkurajuar nga politika kapitulluese e udhëheqjes sovjetike në krizën kubane e në çështjet e tjera ndërkombëtare, veçanërisht nga qëndrimi tradhtar i udhëheqjes së sotme sovjetike lidhur me Vietnamin.

Eshtë krejt qesharak pretendimi se udhëheqja sovjetike gjoja refuzoi ofertën e Kenedit për ndarjen e «sfereve të influencës», gjë që qenka shprehur sidomos gjatë krisës së Karaibeve. Në të vërtetë, eshtë e kundërtë dhe tërë bota e di se në atë rast grupi i N. Hrušovit tradhtoi e la në baltë popullin kuban, bile u përpoq me të gjitha forcat t'i imponojë atij kontrollin amerikan, duke e konsideruar, me sa duket, Kubën zonë të kontrolluar nga SHBA. Për më tepër, vetë udhëheqja e PK Italiane detyrohet ta pranojë faktin se ka ekzistuar tek udhëheqësit sovjetikë tendenca për «sfera influence». Për këtë bën aluzion Longoja në raportin e tij kur thotë se disa herë eshtë dukur që Bashkimi Sovjetik «ka pasur tendencën për t'u paraqitur në arenëndërkombëtare si përfaqësuesi i vetëm i të gjitha shteteve socialiste», por se gjoja më pas ka bërë deklarata pozitive mbi barazinë e të gjitha shteteve të botës.

A nuk dëshmojnë vallë për orvatjet e udhëheqjes sovjetike për ndarjen e sundimit botëror me imperializmin amerikan edhe të tilla fakte të njoitura si përfundimi i traktatit famëkeq sovjeto-amerikano-anglez për ndalimin e pjesshëm të provave bërthamore, apo përpjekjet e saj për përfundimin e një traktati për «mospërhapjen e armëve bërthamore»?

3. Nuk mund të justifikojnë pozitat e gabuara e thellësisht antimarksiste të revisionistëve italianë në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare as sulmet e tyre shpifëse kundër partive marksiste-leniniste gjoja për «politikë aventureske», për përçarje të forcave anti-imperialiste etj.

Këtu kemi një përsëritje të avazit të vjetër të Titos e të Hrushovit se gjoja sot rreziku i luftës mund të vijë edhe nga disa vende socialiste, ndërsa tendenca paqësore edhe nga disa qarqe imperialiste. Kjo është një ndër «shtojcat krijuese» që i kanë bërë marksizëm-leninizmit revisionistët modernë! Por ç'kërkojnë vallë revisionistët toliatistë? Mos duan që partitë marksiste-leniniste të heqin dorë nga politika e kundërshtimit të vendosur të agresionit imperialist, të kapitulojnë para shantazhit imperialist dhe t'u luten imperialistëve amerikanë për «bisedime paqësore» në Vietnam? Mirëpo ku do të qëndronte, në këtë rast, dallimi midis marksistë-leninistëve revolucionarë dhe revisionistëve, midis luftëtarëve të vendosur kundër imperializmit e përlirinë e popujve dhe kapitullantëve e bashkëpunëtorëve të imperializmit?! Në të vërtetë, duke akuzuar partitë marksiste-leniniste për «politikë aventureske» dhe për «eksportim të revolucionit» me anën e një lufte botë-

rore, revizionistët modernë radhiten në anën e imperializmit dhe justifikojnë veprimet e tij agresive e luftënxitëse që ai ndërmerr nën pretekstin e «ruajtjes së botës së lirë nga ekspansioni komunist». Për sa i përket problemit të përçarjes së forcave antiimperialiste, dihet botërisht se përçarësit janë pikërisht revizionistët modernë, të cilët jo vetëm janë larguar prej kohësh nga lufta e vendosur kundër imperializmit dhe përpilen të pengojnë edhe të tjerët të bëjnë një luftë të tillë, por edhe ndërmorën një fushatë sulmesh të rënda shpifëse kundër partive marksiste-leniniste në Kongresin e 22-të famëkeq të PK të BS e pas tij. Por në këtë çështje do të kemi rastin të kthehemë përsëri më poshtë.

Gjithmonë në të njëjtën rrugë kapitulluese e tradhtare

Një ndër metodat kryesore të njerëzve dhe partive politike serioze është të mësuarit nga gabimet e veta. Me të drejtë lind pyetja: Pas deziluzioneve e disfatave të pësuara, ç'mësime ka nxjerrë udhëheqja e PK Italiane dhe ç'vijë predikon ajo për të ardhmen në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare? Studimi i materialeve të plenumit të tetorit të KQ të PK Italiane tregon në mënyrë bindëse se revizionistët italianë nuk kanë nxjerrë asnjë mësim dhe predikojnë me këmbëngulje të njëjtën vijë kapitulluese e tradhtare. Ja predikimet e tyre kryesore:

1. Në «Projekttezat» thuhet: «... ndërtimi në paqe i një rregulli të ri të botës është më i domosdoshëm se

kurrë në një kohë si jona, kur një luftë botërore do të mund të shkatërronte vetë bazat e qytetërimit botëror». Pra përsëri «paqe me çdo kusht», kapitullimi i plotë përballë shantazhit atomik të imperializmit, vënia e luftës për socializëm dhe për çlirimin e popujve në varësi nga çështja e evitimit të një lufte të re botërore! Kjo do të thotë të sakrifikosh çështjen e socializmit e të çlirimt të popujve, ta tradhtosh atë.

2. Në «Projekttezat» thuhet gjithashtu: «Sidomos përballë ndryshimeve cilësore që kanë ndodhur në karakterin e luftës, shpëtimi i paqes botërore është për marksistët një çështje parimi». Nga ana tjetër, «parulla e luftës për paqen, të cilën Lenini e hodhi poshtë me të drejtë atëherë kur, në kohën e Luftës së Parë Botërore, po pijej një situatë revolucionare e mprehtë dhe duhej luftuar për ta shndërruar luftën imperialiste në luftë civile, bëhet sot parulla më e drejtë, më popullore dhe më efektive në vetë luftën për çlirimin përfundimtar të mbarë botës nga zgjedha imperialiste». (Toliati.) Ndërsa L. Longoja, duke paraqitur këtë ide, shton: «Është fakt... që kur imperializmi është sulmuar nga të gjitha forcat antiimperialiste në terrenin e uljes së tensionit dhe të paqes, ai është detyruar të heqë dorë nga preteksti i tij absurd për të mbrojtur statukuonë me anën e forcës. Është fakt që ulja e tensionit në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe lufta për paqe kanë treguar se janë terreni më efektiv për të izoluar dhe për të detyruar të zmbrapsen forcat reaksionare e agresive. Është fakt që vetëm në një klimë të uljes së tensionit ndërkombëtar, vetëm me përfundimin e garës së armatimeve atomike dhe me çarmatimin, vetëm me ven-

dosjen e një regjimi të bashkekzistencës paqësore, dhe jo nëpërmjet luftërash vëllavrasëse, vendet e zonës së mjerimit e të urisë do të mund të zgjidhin problemet e tyre dramatike dhe të vihen në rrugën e një zhvillimi efektiv demokratik e shoqëror»:

C'del nga këto?

Para së gjithash, në pikëpamjet e revisionistëve italianë «bashkekzistenca paqësore» paraqitet si njëfarë «shkopi magjik» për zgjidhjen e të gjitha problemeve botërore dhe lufta për «bashkekzistencë paqësore» si detyra themelore e gjithë popujve të botës. Është e qartë se këtu nuk mbetet vend, e as që ka nevojë, për luftë antiimperialiste, për luftë çlirimtare e revolucionare!

Veç kësaj, predikimi revisionist për t'iу përgjigjur veprimeve agresive të imperializmit me «sulm në terrenin e paqes» ngjan si dy pika uji me predikimet e doktrinës kristiane: «Po ju qëlluan në njérën faqe, kthejeni edhe faqen tjetër». Ja gjer në ç'qëndrime të përbuzshme për një revolucionar kanë arritur revisionistë duke ecur në rrugën e tyre kapitulluese! Me fjalë të tjera, të hiqet dorë nga kundërshtimi i vendosur i imperializmit, nga kundërpërgjigjja e vendosur ndaj veprimeve të tij aggressive e luftënxitëse, të hiqet dorë nga lufta kundër imperializmit — ja përse bëjnë thirrje renegatët revisionistë!

Bile L. Longoja e tha fare hapur në plenum: «Nuk duhet bërë gabimi i identifikimit të luftës antiimperialiste dhe të luftës për paqe, i reduktimit të tyre në njërat-tjetrën». Kjo është një pikëpamje krejt absurde dhe një tallje cinike me luftën për paqe. Sepse ç'kuptim do të kishte një luftë abstrakte për paqen «në përgjithësi» pa treguar se nga vjen rreziku i luftës dhe cilët janë luftë-

nxitësit, në mënyrë që të mobilizohen e të ngrihen kundër tyre popujt? Një luftë e tillë për «paqe» nuk do të kishte kurrfarë vlerë, bile do të ishte tepër e dëmshme për çështjen e paqes, sepse do të largonte vëmendjen e popujve nga veprimet e luftënxitësve imperialistë dhe do t'u linte këtyre duart e lira për veprime të rrezikshme, kundër paqes e sigurimit të popujve.

Nuk duhet ndonjë mprehtësi e madhe për të kupuar tërë absurditetin e këtyre predikimeve revisioniste. Por, me sa duket, revisionistët toliatistë italianë janë betuar t'i shërbejnë me çdo kusht imperializmit, bile edhe duke e vënë veten në pozita të tilla qesharake e të palavdishme.

3. Revisionistët italianë vazhdojnë të predikojnë tezat e tyre bajate e antikomuniste mbi «eksportimin e revolucionit». Në «Projekttezat» thuhet se bashkekzistenca paqësore «duhet të bazohet në respektimin e së drejtës së çdo populli... për të përcaktuar vetë fatin e tij: pa eksportim me forcë të revolucionit, por as të kundërrevolucionit».

Ku e paskan parë revisionistët italianë «eksportimin e revolucionit»? Ç'duan të thonë ata me këtë? Është e qartë se të ngresh tezën antimarksiste të «eksportimit të revolucionit» do të thotë në fakt të justifikosh veprimet agresive të imperializmit për të eksportuar kundërrevolucionin në vende të ndryshme të botës, nën pretekstin cinik të luftës kundër «ekspansionit komunist». Imperialistët amerikanë prej vitesh vazhdojnë të eksportojnë kundërrevolucionin, duke ndërhyrë brutalisht me armë, shpeshherë bile të maskuar me flamurin e OKB-së, në punët e brendshme të popujve të ndryshëm, duke

kryer agresione dhe duke shtypur me zjarr e me hekur luftën e tyre çlirimtare e revolucionare. Ata ndërhyjnë për të mbytur luftën e drejtë të popullit të Kongos e të Dominikës, kanë ndërhyrë e ndërhyjnë në Amerikën Latine, në Afrikë e në Azinë Juglindore. Ata kanë vite që po eksportojnë kundërrevolucionin në Vietnam. Ndërsa revizionistët modernë, e në radhë të parë udhëheqësit revizionistë sovjetikë, vazhdojnë të mbajnë marrëdhënie të «bashkekzistencës paqësore» me SHBA-në, bile në raste të ndryshme, si ai i Kongos, kanë votuar bashkë me imperialistët amerikanë për të eksportuar kundërrevolucionin, të ambalazhuar në pakon e lustruar të OKB-së. Përse, pra, udhëheqja e PK Italiane nuk ngrihet me forcë kundër këtyre veprimeve kundërrevolucionare e tradhtare, por llomotit për «eksportim të revolucionit»? E përsëritim se udhëheqësit revizionistë italianë me të vërtetë janë betuar t'i sjellin me çdo kusht shërbime imperializmit amerikan.

4. Në «Projekttezat» dhe në raportin e L. Longos thuhet se elementë esencialë për uljen e tensionit, për zhvillimin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe për mbrojtjen e paqes në botë janë marrëveshjet midis dy superfuqive atomike — Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Sovjetik. Sidomos theksohet domosdoshmëria e një marrëveshjeje për «mospërhapjen e armëve bërthamore».

Pra, «bashkekzistencë paqësore» mbi bazën e marrëveshjeve e të kompromisit midis dy superfuqive atomike! Me fjalë të tjera, përsëri ndarje e «zonave të influencës» dhe ruajtje e monopolit bërthamor nga dy fuqitë e mëdha! Asnjë fjalë për domosdoshmërinë e një

qëndrimi të fortë e të vendosur ndaj imperializmit amerikan, për t'i kundërvënë politikës së tij agresive forcën e madhe ekonomike, politike e ushtarake të vendeve socialiste.

Është e qartë për cilindo se udhëheqja revisioniste e PK Italiane, me L. Longon në krye, vazhdon të qëndrojë në pozitat e së ashtuquajturës strategji të bashkekzistencës paqësore hrushoviane, e cila ka shkaktuar pasoja të rënda dhe ka rrezikuar seriozisht paqen e sigurimin e vendeve socialiste e të popujve të ndryshëm. Këtë e deklaroi hapur L. Longoja në raportin e mbajtur në plenum, ku midis të tjerash tha: «A mund të thuhet... se politika e bashkekzistencës paqësore ka hyrë në krizë, siç thonë disa shokë? Janë rrëzuar ose po rrëzohen arsyet që e kanë diktuar atë? Gjendja ndërkombëtare a ka ndryshuar kaq shumë sa të kërkojnë ndryshimin e asaj politike e të asaj strategjie? Projektet e ja-pin këtyre pyetjeve një përgjigje të prerë e të saktë: kjo politikë dhe kjo strategji duhen konfirmuar».

Por është gjithashtu e qartë dhe e sigurt se ecja me këmbëngulje në këtë rrugë nuk ka për t'u sjellë revolucionisteve veçse deziluzione e disfata të reja, duke i shtyrë njëkohësisht ata gjithnjë më tej në rrugën e tradhtisë.

II ,

**MBI FATIN DHE PERŠPEKTIVAT
E SË ASHTUQUAJTURËS PARTI UNIKE
TË KLASËS PUNËTORE DHE «RRUGË ITALIANE
DREJT SOCIALIZMIT»**

**Çfarë u solli revizionistëve italianë vija e tyre
oportuniste e reformiste**

Tërë kursi antimarksist i udhëheqjes së PK Italiane lidhur me të ashtuquajturën rrugë italiane drejt socializmit mbështetej në një varg shpresash e iluzionesh: shpresa e iluzione për një proces të «spostimit nga e majta» në lëvizjen «socialiste» e katolike në Itali; shpresa e iluzione për krijimin e një «partie unike të klasës punëtore italiane»; shpresa e iluzione për një «qeveri demokratike të qendrës së majtë»; shpresa e iluzione për një spostim gradual të raportit të forcave në shtetin italian në dobi të klasës punëtore e kundër monopoleve kapitaliste dhe, mbi bazën e të gjitha këtyre, shpresa e iluzione për një rrugë «demokratike» e «paqësore» të kalimit në socializëm në Itali nëpërmjet realizimit të «reformave të strukturës».

PPSH dhe partitë e tjera marksiste-leniniste i kanë kritikuar me të drejtë këto pikëpamje si «ëndrra në diell» dhe si një vijë thellësisht oportuniste, reformiste e antirevolucionare.

Tani duket sheshit se tërë kjo vijë antimarksiste, të tëra këto shpresa e iluzione të revizionistëve italianë

kanë pësuar një deziluzion të hidhur e shumë diskreditues. Le ta shohim këtë:

1. Dështuan plotësisht iluzionet revizioniste lidhur me të ashtuquajturën qendër të majtë, tek e cila ata kishin varur shpresa të mëdha për një përparim demokratik në Itali, i cili do të hapte rrugën e gjerë për të çuar, sipas tyre, drejt socializmit. Faktet provuan se qeveria e «qendrës së majtë», nën kryesinë e demokristianëve dhe me pjesëmarrjen e socialdemokratëve të Saragatit e të socialistëve të Nenit, është një shërbëtore e bindur e monopoleve të mëdha kapitaliste dhe armike e betuar e socializmit.

Tani udhëheqja revizioniste e PK Italiane po përpipet me demagogji të fshehë qëndrimin e vet antimarksist, duke folur për «dështimin e iluzioneve reformiste të qendrës së majtë», bile hedh edhe ndonjë kritikë për «ata» (cilët janë këta?!) që paskan pasur iluzione të kota për «qendrën e majtë»!! Kështu, L. Longoja theksoi në raportin e tij në plenum për «evolucionin në të djathëtë të qendrës së majtë, e cila, kur u krijuar, pati ngjallur shpresa edhe në disa pjesë të klasseve punonjëse». Ai tha gjithashtu: «Shembja e ambicieve reformiste të qendrës së majtë është, në thelb, shembja e iluzionit se për të realizuar një plan reformash mjafton të manovrohet makina e shtetit, pa prekur ekilibrin e përgjithshëm të sistemit, pa një luftë rrënjosore kundër forcave konservatore, domethënë pa një mobilitim dhe një luftë unitare të masave, që të hapin rrugën për veprimin reformator e ta mbështetin atë, duke ndryshuar raportin e forcave në parti e në shtet».

Lidhur me këtë lindin disa çështje:

Kush vallë janë ata që kanë pasur iluzione për eksperimentin e «qendrës së majtë»? Edhe gjatë vetë diskutimeve në plenum u vu në dukje se ishte pikërisht udhëheqja e PK Italiane, me P. Toliatin në krye, ajo që ushqente shpresa e iluzione për «qendrën e majtë». Kështu, për shembull, në diskutimin e vet, anëtari i KQ të PK Italiane, Natoli vuri në dukje se në vitin 1962 grupi drejtues i partisë tregonte kujdes që të mos aca-roheshin gjërat, të mbahej ndaj «qendrës së majtë» një qëndrim mirëdashës pritjeje (Amendola e quajti këtë «vijë e opozicionit konstruktiv» ndaj «qendrës së majtë») dhe të vendosej kontakt me ato forca që në qendrën e majtë punonin për disa reforma («Unita», 31 tetor 1965.)

Dhe ku qëndron, sipas Longos, thelbi i «gabimeve reformiste» të «qendrës së majtë»? Përse e kritikon sot atë udhëheqja e PK Italiane? Në fund të fundit, tërë thelbi i kësaj kritike, megjithëse kjo nuk thuhet hapur, qëndron në faktin që «forcat reformiste» të «qendrës së majtë» refuzuan bashkëpunimin me PK Italiane, gjë që gjoja bëri të pamundur spostimin e raportit të forcave në shtetin italian dhe, për pasojë, bëri të pamundur edhe zbatimin e reformave të parashikuara. Pra, Longoja nuk i kritikon aspak në thelb vetë këto reforma si një mashtrim që ka për qëllim të largojë masat nga lufta revolucionare e të përjetësojë rendin kapitalist, por vetëm «rrugën e padrejtë» që u ndoq dhe që gjoja bëri të pamundur realizimin e tyre. Një «kritikë» e tillë fort «parimore» e tepër «revolucionare», tregon qartë se udhëheqja e PK Italiane qëndron edhe vetë në të njëjtat pozita strategjike oportuniste e tradhtare të krerëve të

djathët socialistë e socialdemokratë dhe ka me ta vetëm divergjenca taktike.

Në realitet, nuk është aspak e vërtetë se «qendra e majtë» dështoi, siç përpiken t'u mbushin mendjen një-rëzve revizionistët italianë. Përkundrazi, ajo i arriti që-limet e veta: përcarjen e mëtejshme të lëvizjes punëtore e të forcave të majta, zgjerimin e procesit të socialdemokratizimit, mbrojtjen e pozitave të monopoleve të mëdha kapitaliste. Bile edhe gjatë diskutimit në plenum u shtrua pyetja: Si shpjegohet atëherë që, megjithëse flitet për «dështimin e qendrës së majtë», në vend të një animi nga e majta, ndodhi fitorja dërrmuese e Nenit në kongresin e PS Italiane; domethënë një anim i theksuar nga e djathta? Është e qartë se nuk është «qendra e majtë» që ka dështuar, por iluzionet e revisionisteve për «qendrën e majtë».

2. Kanë pësuar dështim iluzionet revisioniste për të realizuar të ashtuquajturat reforma të strukturës në kuadrin e rendit të sotëm shtetëror e shoqëror të Italisë, të cilat të hapin gjoja rrugën për të përparuar drejt socializmit «në demokraci e në paqe». Për marksistë-le-ninistët kurdoherë ka qenë dhe është fare e qartë se predikime të tilla reformiste nuk mund të kenë asnje rezultat tjetër praktik përveç mashtimit të klasës punëtore. Por dyshime mbi efektivitetin e këtyre «reformave të strukturës» u shprehën bile edhe në vetë plenumin e KQ të PK Italiane, ku gjatë diskutimeve u tha: «Për sa i përket luftës për reformat duhet të shpjegojmë përsë deri tani lëvizja klasore e popullore nuk ka arriturasnje objektiv. Aq sa dikush shtron pyetjen se cila nga reformat e strukturës mund të përbëjë një objektiv

të realizueshëm». (Shih diskutimin e Pistillo, botuar në «Unita», 30 tetor 1965.)

3. Pësuan gjithashtu dështim të plotë iluzionet e përhapura prej kohësh nga revizionistët toliatistë mbi një «spostim nga e majta» të forcave «socialiste» e «demokratike» në Itali. Tani vetë ata detyrohen ta pohojnë se, përkundrazi, vihet re një spostim i theksuar në të djathëtë dhe një proces i theksuar socialdemokratizimi i «së majtës» dhe bile i një pjese të lëvizjes punëtore e populllore. «Socialdemokracia — tha Longoja në plenum — që ka braktisur prej kohësh çdo pozitë antiimperialiste dhe çdo koncept klasor mbi shoqërinë dhe shtetin, pranon sot teoritë dhe praktikat neokapitaliste... Edhe një pjesë e rëndësishme dhe sot mbizotëruese e grupit drejtues të PS Italiane është spostuar në pozitat e hqjes dorë totalisht nga lufta dhe nga traditat e saj më të mira». Ndërsa në «Projekttezat» thuhet: «PS Italiane është në rrezik të degjenerojë në një formacion politik shtojcë të demokracisë kristiane, të shndërrohet në një forcë nënqeveritare dhe... të hidhet në krahët e socialdemokracisë».

Dhe për të fshehur deziluzionin e pësuar «kritikojnë» tani «tendencat e atyre që besonin se kishte filluar tanimë një proces i vazhdueshëm spostimesh në të majtë». («Projekttezat».)

Por kush vallë ka përhapur iluzione të tilla? Faktet tregojnë se ata janë vetë udhëheqësit revizionistë të PK Italiane, të cilët shtruan bile si detyrë imediate krimjin e një «partie unike të klasës punëtore» në Itali. Spostimi i hapët e zyrtar nga e djathta i PS Italiane të Nenit që një grusht i rëndë për këto iluzione. Aq është

e vërtetë saqë në plenumin e fundit të KQ të PK Italiane dikush tha bile se «jemi duke e «ndjekur» Partinë Socialiste Italiane si një lepur që na ikën»!

4. Goditja më e rëndë kundër vijës së udhëheqjes së PK Italiane është dështimi plot zhurmë i tezës së tyre mbi të ashtuquajturën parti unike të klasës punëtore në Itali. Ajo ndeshi në refuzimin e hapët e përbuzës të Partisë Socialiste të Nenit për t'u bashkuar me revizionistët italianë, të cilët akuzohen se nuk kanë dhënë akoma «prova të mjaftueshme» se janë të denjë për një «nder» të tillë. Kjo u vulos sidomos në kongresin e fundit, të 36-të, të Partisë Socialiste Italiane, ku P. Neni, i cili pati atje shumicën dërrmuese prej 80 për qind, deklaroi në mënyrë të prerë: «Paaftësia e lëvizjes komuniste italiane e ndërkontëtare për të bërë një rishikim të parimeve, të metodave e të drejtimeve politike të papajtueshme me ato të socialistëve ia heq çdo vlerë thirrjes së PK Italiane për një parti të vetme të punonjësve». Dhe jo vetëm kaq, por atje u shpall hapur kursi i socialistëve të Nenit për unifikim me Partinë Socialdemokrate të Saragatit, pra, për një unifikim socialdemokrat e antikomunist.

5. Por ç'do të thotë dështim i kursit të revizionistëve toliatistë italianë për «partinë unike»? Ai nuk është dështim për një çështje të pjesshme, por dështim i tërë strategjisë së tyre të së ashtuquajturës rrugë italiane drejt socializmit, e cila, sipas vetë thënieve të revizionistëve italianë, do të realizohej pikërisht me anën e «partisë unike».

Para së gjithash, «partia unike» u duhej revizionistëve për të kërkuar e për të gjetur rrugën «origjinale»

italiane drejt socializmit, e cila nuk dihet as nga vetë predikuesit e saj se si do të jetë përfundimisht. Të gjithëve u kujtohet që në «Hipotezat» e veta famëkeqe për «riunifikimin» G. Amendolá thoshtë: «...nevoja e një partie të vetme për klasën punëtore italiane lind nga konstatimi kritik që vijon: asnjëra nga të dyja zgjidhjet që i janë paraqitur klasës punëtore të vendeve kapitaliste të Evropës Perëndimore — as zgjidhja socialdemokrate dhe as zgjidhja komuniste — nuk është treguar deri më sot e aftë të realizojë transformimin socialist të shoqërisë dhe ndryshimin e sistemit... Këtë kërkim origjinal të një rruge të re drejt socializmit le ta bëjmë së bashku, me një parti të re, me një parti të vetme të klasës punëtore italiane — ja, ky është propozimi që ne u bëjmë shokëve socialistë të rrymave dhe organizatave të ndryshme». Ai përfundonte se «partia e vetme e klasës punëtore» duhet të jetë «partia e rrugës italiane drejt socializmit». Dhe këto nuk janë pikëpamje vetëm të Amendolës, por të tërë udhëheqjes revizioniste të PK Italiane, e cila, në një plenum të posaçëm të KQ kushtuar problemit të unifikimit që u mbajt në qershor 1965, pasi vinte në dukje se as socialdemokratët dhe as komunistët nuk kanë gjetur akoma një zgjidhje të kënaqshme për kalimin në socializëm në vendet e zhvilluara kapitaliste të Perëndimit, theksonte: «Për ta çuar përpara e për ta shpënë në fitore çështjen e demokracisë e të socializmit në vendet e kapitalizmit të zhvilluar, është esenciale të bëhet një kërkim i ri dhe origjinal, i cili të marrë parasysh të gjitha eksperiencat e së kaluarës dhe të gjitha mendimet kritike, por duke qenë i lirë nga çdo skemë e paravendosur. Pi-

kërisht në këtë qëndron vlera evropiane e ndërkombëtare e procesit të unifikimit të forcave socialiste të vendit tonë». (Shih raportin e P. Bufalinit në KQ të PK Italiane botuar në «Unita», 4 qershor 1965.) Pra, me dështimin e orvatjeve për krijimin e «partisë unike» është prerë rruga për zbulimin «e rrugës italiane drejt socializmit»!

Veç kësaj, dështimi i «partisë unike» është dështim i tërë «rrugës italiane drejt socializmit» edhe për faktin që, sipas vetë predikimeve të revizionistëve italiannë, për realizimin e kalimit «paqësor» e «demokratik» në socializëm duhet siguruar «shumica e majtë». «Vija politike që ne propozojmë — tha Longoja në plenumin e KQ — kërkon një radhitje të re politike, një shumicë të re demokratike». Ai tha gjithashtu: «Është puna që të kërkohet një marrëveshje, e cila të angazhojë e të bashkojë në veprim të gjitha forcat punëtore e demokratike rreth drejtimesh të reja dhe objektivash konkretë të politikës së jashtme, të politikës ekonomike, të ripërtëritjes demokratike». Edhe anëtari i KQ të PK Italiane Oketo, si një ndër dy kushtet themelore për realizimin e «reformave të strukturës» dhe për përparimin drejt socializmit, përmendi pikërisht «luftën për një shumicë të re, domethënë për një qeveri të klasave punonjëse». («Unita», 30 tetor 1965.) Por me cilin do të arrihet kjo «shumicë» kur edhe socialistët refuzojnë të bashkëpunojnë me PK Italiane për formimin e saj? Është e qartë se edhe nga kjo pikëpamje «rruga italiane drejt socializmit», e predikuar nga revizionistët toliatistë, është e myllur dhe ka pësuar një disfatë të pashërueshme.

Pikërisht dështimi i bujshëm i tezës së «partisë së

vetme të klasës punëtore», e bashkë me të, i gjithë kursit antimarksist të «rrugës italiane drejt socializmit», është shkaku themelor i vështirësive të reja serioze në gjirin e udhëheqjes revizioniste të PK Italiane, vështirësi që u shprehën qartë në plenumin e fundit të saj.

Të tilla janë pasojat e hidhura të kursit oportunist e revizionist të udhëheqjes së PK Italiane.

Rruja oportuniste e udhëheqjes së PK Italiane nuk mund të çojë veçse në dështime të reja e më të mëdha

Lind pyetja: A vuri mend udhëheqja e PK Italiane pas dështimeve të pësuara dhe a i bëri ajo një rishikim kritik vijës së saj të deritanishme? Jo. Faktet tregojnë se ajo është e vendosur të ecë me çdo kusht në rrugën e saj oportuniste, duke ngulur këmbë me kokëfortësi në gabimet e veta, duke u larguar gjithnjë më shumë nga çdo qëndrim marksist-leninist e revolucionar. Këtë e provon më së miri vija e predikuar prej saj në luftën për demokraci e socializëm me të cilën ajo po përgatit Kongresin e 11-të të PK Italiane. Ku konsiston kjo vijë?

1. Udhëheqja revizioniste e PK Italiane vazhdon të predikojë të njëjtën vijë reformiste të diskredituar mbi «rrugën italiane drejt socializmit», e cila mund të përmblidhet shkurtazi në këto gjëra kryesore:

Së pari, hartim i një programi ekonomik demokratik dhe luftë për zbatimin e tij kryesisht nëpërmjet rivendikimeve të pjesshme, gjë që gjoja do të çojë në vendosjen graduale të kontrollit të klasës punëtore mbi

prodhimin etj. Pasi flitet për realizimin e një «programi përtëritjeje ekonomike e shoqërore», i cili, me anë «reformash të strukturës» e duke kufizuar fuqinë e monopoleve, t'u japë zgjidhje problemeve themelore të masave popullore të vendit, në «Projekttezat» thuhet: «Fusha e parë në të cilën duhet të lëvizim për ta çuar përparrë këtë alternativë është sot, si kurrë ndonjëherë, ajo e luftës së rivendikimeve për mbrojtjen dhe ngritjen e pagave, për mbrojtjen dhe shtimin e punësisë dhe të të drejtave kontraktuale të punonjësve të qytetit, të fshatit dhe të nëpunësve të shtetit». Duke zhvilluar këtë ide në «Projekttezat» thuhet gjithashtu: «Sot ka një ndryshim cilësor në raportin midis luftës përvendikime, lëvizjes për reforma dhe luftës politike të përgjithshme. Rivendikimet në lidhje me pagat dhe ato që synojnë me rrugë të ndryshme drejt një kontrolli rrënjësor mbi proceset e prodhimit në nivelin e ndërmarrjeve, shtrojnë objektivisht problemin e vendosjes së një kontrolli edhe në shkallë kombëtare, pra të një programimi ekonomik të tipit demokratik».

Me një fjalë, lufta përvendikime të pjesshme do të shpjerë gjoja gradualisht e në mënyrë mekanike në zgjidhjen e problemeve të mëdha, në transformime rrënjësore dhe në vendosjen e kontrollit të klasës punëtore mbi tërë jetën e vendit! Asnjë fjalë për domosdoshmërinë e përbysjes revolucionare të borgjezisë e të marrëdhënieve kapitaliste në prodhim! Kjo, në thelb, s'është gjë tjetër veçse një variant i modernizuar i pikëpamjeve të «ekonomistëve», të demaskuara e të hedhura poshtë prej kohësh nga V. I. Lenini.

Së dyti, udhëheqja e PK Italiane predikon një «re-

formë rrënëjësore» të pushtetit shtetëror në të gjitha hallkat, në drejtim të «demokratizimit» të tij, të forcimit gradual të pozitave e të ndikimit të klasës punëtore në të etj. Longoja në raportin e tij thekson në plan të parë «nevojën e një reforme të përgjithshme të shtetit, e cila të ndryshojë në një drejtim demokratik reportin midis pushtetit ekonomik real e organeve përfaqësuese dhe midis organeve përfaqësuese e masave popullore». Kjo reformë e «demokratizimit» të shtetit parashikon tri momente kryesore:

Nga njëra anë, decentralizimin e pushtetit dhe dhënen e një autonomie demokratike më të gjerë pushtetit regional. «Krijimi i rajoneve — thuhet në «Projekttezat» — mund të bëhet një nga elementët kryesorë për shkatërrimin e atij përqendrimi burokratik historik të shtetit italian, që është bërë sot një nga mbështetjet themelore të ekspansionit monopolist. Nuk është fjala për të krijuar aparatet burokratike të reja që t'i shtohen aparatit burokratik qendror, por për ta bërë më të zhërvjellët dhe për të siguruar një demokratizim efektiv të shtetit, si dhe për të vënë në jetë një sistem më të pasur e rihë të lirë autonomish».

Nga ana tjeter, «demokratizimin» e pushtetit në drejtim të forcimit të kontrollit demokratik e «popullor» mbi organet shtetërore. «Demokratizim i shtetit — thuhet në «Projekttezat» — do të thotë, në radhë të dytë, kryesisht krijim formash e instancash të reja kontrolli demokratik të afta për të kufizuar dalngadalë e për të zhdukur arbitraritetin politik, ashtu edhe mbizoërimin e interesave e të vullnetit të grupeve të mëdha private».

Reforma «demokratike» e shtetit parashikon, më në fund, rritjen e rolit të parlamentit dhe ndryshimin e raportit të forcave në të në dobi të partive që përfaqësojnë interesat e punonjësve. «Nga tërë vija jonë — thuhet në «Projekttezat» — del se ne luftojmë jo vetëm pér mbrojtjen e parlamentit e të institucioneve të tjera përfaqësuese, po pér një rritje të kompetencave të tyre të ndërhyrjes e të kontrollit dhe luftojmë pér të siguruar në parlament e në të gjitha forumet e zgjedhura një ndryshim rrënjosor të raportit të forcave në favor të klasës punëtore e të aleatëve të saj. Pikërisht në këtë kuadër hyn pjesëmarrja e partisë punëtore dhe e partive punëtore në qeveritë e koalicionit me forcat demokratike josocialiste».

Në «Projekttezat», si dhe në raportin e L. Longos, «rruga italiane drejt socializmit» karakterizohet në formë të përbledhur si luftë pér zhvillimin e vazhdueshëm të demokracisë dhe pér transformime strukturore, nëpërmjet të cilave t'u jepet një zgjidhje pozitive problemeve të mëdha të vendit dhe të realizohet një pjesëmarrje gjithnjë më e madhe dhe efektive e klasës punëtore në drejtimin e ekonomisë dhe në të gjitha fushat e jetës shoqërore. Nëpërmjet këtij procesi duhet të arrihet në formimin dhe ardhjen në fuqi të një klase të re drejtuese, të përbërë nga klasa punëtore dhe aleatët e saj, gjë që është kusht i domosdoshëm pér ta çuar transformimin e shoqërisë deri në socializëm e komunizëm. «Në Itali ekzistojnë kushtet që klasa punëtore, në kuadrin e regjimit kushtetues, të organizohet në klasë drejtuese, duke bashkuar rreth programit të saj të transformimit socialist të shoqërisë e të shtetit shumicën

dërmuese të popullit». (Deklarata programatike e PK Italiane.)

Pra, asgjékundi asnjë fjalë për domosdoshmérinë e revolucionit socialist, të përblysjes revolucionare të borgjezisë, të shkatërrimit të aparatit shtetëror burokratik e ushtarako-policor borgjez, asnjë fjalë për vendosjen e diktaturës së proletariatit. Është absolutizuar plotësisht rruga paqësore e kalimit në socializëm, e cila është kuptuar në mënyrë krejt antimarksiste e oportuniste dhe nuk parashikohet qoftë edhe si mundësi varianti i revolucionit të armatosur, me gjithë tezat e qarta të doktrinës marksiste-leniniste dhe eksperiençën e pasur historike për këtë çështje. Të gjitha këto mësime themelore të marksizëm-leninizmit revolucionar, që përbëjnë thelbin e tij, as që figurojnë fare në fjalorin e udhëheqjes revizioniste të PK Italiane, ato janë hedhur poshtë prej saj si një leckë e vjetruar pa vlerë. Por secili mund të vërejë me lehtësi se predikimet «origjinal» e «krijuese» të revizionistëve toliatistë janë një ringjallje e teorive të vjetra të Kautskit, i cili, këtu e 50 vjet më parë, duke polemizuar me Panekukun, që qëndronte në pozita të drejta revolucionare, shkruante: «Detyra e grevës së masave kurrë nuk mund të jetë që të shkatërrojë pushtetin shtetëror, por vetëm që ta shtyjë qeverinë të bëjë lëshime në ndonjë çështje të caktuar, ose të zëvendësojë një qeveri armike të proletariatit me një qeveri që pranon kërkeshat e tij... Por kjo nuk mund të çojë kurrë në shkatërrimin e pushtetit shtetëror, por vetëm në njëfarë zhvendosjeje të raportit të forcave brenda pushtetit shtetëror... Dhe qëllimi i luftës sonë politike

mbetet, si edhe deri më sot, marrja në dorë e pushtetit shtetëror duke fituar shumicën në parlament dhe duke e bërë parlamentin zot mbi qeverinë. Por jo shkatërrimi i pushtetit shtetëror. Dhe si mundet Panekuku të vendosë mënyrën socialiste të prodhimit ndryshe përveçse me anën e masave të ligjshme... shtetëzimi... i degëve të industrisë... (etj.)? Me çfarë mjetesh mundet Panekuku t'i rregullojë këto marrëdhënie veçse me ndihmën e pushtetit shtetëror proletar? Por nga do të dalë ky pushtet në rast se çdo pushtet shtetëror do të shkatërhohet nga veprimi i masave?... Unë mbetem me të njëjtin mendim të cilin, duke përfunduar një vit më parë serinë e artikujve të mi mbi veprimin e masave, e kam formuluar në këtë mënyrë: «Ndërtimi i organizatës, pushtimi i të gjitha pozitave të pushtetit që jemi në gjendje të pushtojmë e të mbajmë fort me vetë forcën tonë, studimi i shtetit e i shoqërisë dhe sqarimi i masave: detyra të tjera ne nuk mund të shtrojmë më mënyrë të ndërgjegjshme e të planifikuar as para vetes, as para organizatave tona»». Lidhur me këto teza të Kautskit V. I. Lenini shkruante:

«Konkluzioni i përgjithshëm = socializëm pa revolucion!! Ose revolucion pa shkatërrimin e pushtetit politik, të «makinës shtetërore» të borgjezisë!! Ja një perlë e idiotizmit!! Ky është falimentim i plotë i marksizmit!! të gjitha mësimet dhe doktrina e Marksit dhe Engelsit të viteve 1852-1891 janë harruar e shtrembëruar. «Të thyhet makina shtetërore ushtarako-burokratike» na kanë mësuar Marksit dhe Engelsit. Asnjë fjale për këtë. Dik-

tatura e proletariatit është zëvendësuar me uto-pinë filistine të luftës për reforma. Socializmi realizohet në mënyrë reformiste; greva e masave për reforma — në këtë reduktohet çdo gjë»¹.

Ja në ç'llum oportunist janë zhytur e po zhyten gjithnjë më thellë revizionistët toliatistë italianë! Ata, me predikimet e tyre, e kanë merituar plotësisht të quhen nxënës të denjë e besnikë, por njëkohësisht mosmirënjohës ndaj renegatit Kautski, sepse po ecin me besnikëri në gjurmët e tij, por nuk kanë guximin dhe ndershëmërënë ta pranojnë hapur këtë dhe t'i njo-hin Kautskit meritën që ka zbuluar qysh gjysmë shekulli më parë të ashtuquajturën rrugë italiane drejt socializmit!

Së treti, udhëheqja e PK Italiane, në dokumentet e plenumit të tetorit, vë në dukje, nga njëra anë, se programi i propozuar prej saj nuk është akoma një program drejtpërdrejt socialist, ndërsa, nga ana tjetër, thekson se ai përfaqëson gjoja rrugën efektive të përparimit drejt socializmit.

Kështu, L. Longoja thotë në raportin e tij: «Modeli i zhvillimit, programimi demokratik që ne i kundërvëmë riorganizimit monopolist në vazhdim... nuk ka karakter socialist, por synon të goditë e të thyejë fuqinë e grupeve të mëdha monopoliste, të sigurojë një mbizotërim efektiv të interesit publik mbi zhvillimin ekonomik... Lufta për një programim demokratik, e cila t'i kundërvihet programimit kapitalist, mund të bëhet kështu «një formë dhe një mjet i ri

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 14, bot. rus., viti 1930, f. 379-380.

për të shkuar drejt socializmit»» (Toliati, Promemorja e Jaltës.). Gjithashtu, në «Projekttezat» dhe në raportin e Longos thuhet: ««Rruga italiane drejt socializmit» ka për qëllim t'i japë një përgjigje problemit të revolucionit socialist në Itali dhe është një aspekt i kërkimit, akoma në vazhdim, të rrugëve për të arritur në socializëm në vendet kapitaliste të zhvilluara, ku sundimi politik i kapitalit të madh nuk mbështetet vetëm mbi kontrollin e aparatit shtetëror të detyrimit, por mbi një varg të ndërlikuar ndërmjetësimësh dhe ku shoqëria lëviz në forma relativisht të pavarura».

Pra, asgjékundi nuk jepet qartë se cilat janë detyrat e luftës së **drejtpërdrejtë** për socializëm, kufizohet lufta e partisë dhe e klasës punëtore me disa detyra demokratike, nuk bëhet një dallim i saktë midis detyrave demokratike **brenda kuadrit** të sistemit kapitalist dhe detyrave socialiste që dalin jashtë këtij kuadri. Longoja e shtron problemin në këtë mënyrë: «Partisë i bëhet thirrje qysh sot të luftojë në mënyrë efektive për reforma shoqërore e politike, për të fituar vazhdimisht pozita të reja pushteti, për t'i ripërtëritur shtetin dhe shoqërinë në një drejtim demokratik e socialist. Kjo përban nevojën dhe aftësinë për të luttuar për objektiva imediatë, të afërt e ndërmjetës, për të shkëputur fitore të pjesshme, për t'i koordinuar e lidhur në një vijë të përgjithshme përparimi demokratik e socialist». Me një fjalë, janë fshirë krejtësisht detyrat e luftës revolucionare për socializmin, ngushtohet tërë veprimtaria e partisë me një luftë të vogël, të përditshme, për disa fitime të pjesshme në kuadrin e rendit kapitalist, lihen mënjanë interesat

rrënjosore dhe qëllimi i fundit — socializmi. Kjo të sjell menjëherë ndër mend parullën famëkeqe të oportunistit me damkë Bernshtajn: «Qëllimi i fundit s'është asgjë, lëvizja është gjithçka». Kjo është politikë oportuniste e revizioniste tipike, për të cilën V. I. Lenini ka shkruar:

«Oportunizëm do të thotë sakrifikim i interesave të përhershme dhe esenciale të partisë për interesat e çastit, për interesat e përkohshme e të dorës së dytë»¹.

Dhe më tej:

«Të përcaktojë herë pas here qëndrimin e vet, t'u përshtatet ngjarjeve të ditës, kthesave të shkaktuara nga ngjarje të vogla politike, të harrojë interesat jetësore të proletariatit dhe tiparet themelore të gjithë rendit kapitalist, të gjithë evolucionit kapitalist, t'i bëjë fli këto interesa jetësore për hir të përfitimeve reale ose të supozuara të çastit, — kjo është politika revizioniste»².

Duke hequr dorë në mënyrë oportuniste nga lufta efektive për përbysjen e borgjezisë e për socializmin dhe duke i kufizuar detyrat e klasës punëtore e të partisë me disa kërkesa «demokratike» që nuk prekin e nuk mund të prekin thelbin e rendit borgjez

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 11, f. 265.

2 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 15, f. 27.

(bile edhe ato janë ëndrra të parealizueshme pa përmbytjen revolucionare të borgjezisë), udhëheqja revolucioniste italiane përpinqet në këtë mënyrë të mos trembë «aleatët» e mundshëm, me bashkëpunimin e të cilëve shpreson të krijojë të ashtuquajturën shumicë të re, të cilën e konsideron si element themelor të luftës me sukses për «rrugën italiane drejt socializmit». Këtë e zbuloi mjaf qartë në diskutimin e tij në plenum Modika, i cili tha se «ka një rëndësi të madhe riafirmimi i përbajtjes demokratike e jo imediatisht socialiste të programimit që ne kërkojmë»; dhe shtoi: «Bërja e vendosur dhe e qartë e këtij dallimi është themelore për t'i dhënë perspektivë luftës punëtore, luftës për reforma, për t'u dhënë jetë e ushqim shumicave të reja». («Unita», 29 tetor 1965.)

Nuk kemi ndër mend dhe nuk e shohim të nevojshme të ndalemi këtu për të analizuar e për të hedhur poshtë një për një pikëpamjet e predikimet krejt antimarksiste, reformiste e antirevolucionare të revolucionistëve toliatistë lidhur me «rrugën italiane drejt socializmit», që përbëjnë një largim të hapët nga lufta e vërtetë dhe efektive për socializëm. Këtu do të mjaf-tohami vetëm me një krahasim të shkurtër me idetë përkatëse të Leninit. Dhe ja se ç'thoshte ai:

«Do të ishte krejt e gabuar të mendohej se gjoja ne, që të luftojmë drejtpërsëdrejti për revolucionin socialist, mund ose duhet të heqim dorë nga lufta për reforma. Në asnjë mënyrë. Ne nuk mund ta dimë se sa shpejt do të mund

të arrihet suksesi, se sa shpejt kushtet objektive do të lejojnë shpërthimin e këtij revolucioni. Ne duhet të përkrahim çdo përmirësim, çdo përmirësim të vërtetë si të gjendjes ekonomike ashtu edhe të gjendjes politike të masave. Ndryshimi midis nesh dhe reformistëve... nuk është se ne jemi kundër reformave, kurse ata janë për reformat. Aspak. Ata kufizohen me reformat dhe për këtë arsy... kanë arritur deri aty sa të lozin rolin e «çirakëve të kapitalimit». Ne u themi punëtorëve: votoni për zgjedhjet proporcionale etj., por mos e kufizoni veprimtarinë tuaj vetëm me këtlë, vini në plan të parë përhapjen sistematike të idesë së revolucionit të menjëhershëm socialist, përgatituni për të dhe bëni në të gjitha drejtimet ndryshimet rrënjosore përkatëse në gjithë veprimtarinë e partisë. Kushtet e demokracisë borgjeze na detyrojnë shumë shpesh të mbajmë këtë ose atë qëndrim në lidhje me një varg të tërë reformash të vogla dhe shumë të vogla, por duhet të dimë ose të mësohemi të mbajmë një qëndrim të tillë për reformat (të veprojmë në mënyrë të tillë) që ne — po të shprehemi pak më thjesht, për të qenë më të qartë — në çdo fjalim që vazhdon gjysmë ore, 5 minuta të flasim për reformat dhe 25 minuta për revolucionin e ardhshëm»¹.

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 23, f. 187-188.

Kjo me të vërtetë i godet revizionistët toliatistë italianni jo në vetull, por drejt e në sy, dhe duket sikur është shkruar apostafat për ta!

Lidhur me çështjen e krijimit të «shumicës» V. I. Lenini shkruante:

«Pikërisht këtë dialektikë nuk kanë mundur ta kuptojnë kurrë tradhtarët, mendje-shkurtërit dhe pedantët e Internacionales së Dytë: proletariati nuk mund të fitojë pa bërë me vete shumicën e popullsisë. Por ta kufizosh ose ta kondicionosh këtë me marrjen e shumicës së votave në zgjedhjet kur sundon borgjezia, do të thotë të tregosh një varféri mendore të palejueshme, ose të tallesh me punëtorët. Për të bërë me vete shumicën e popullsisë proletariati duhet, së pari, ta përmbyse borgjezinë dhe ta marrë pushtetin shtetëror në duart e tij; së dyti, ai duhet të vendosë Pushtetin Sovjetik duke e bërë copë-copë aparatin e vjetër shtetëror, sepse në këtë mënyrë ai e min non menjëherë sundimin, autoritetin dhe influencën e borgjezisë dhe të partizanëve mikro-borgjezë të kompromisit në radhët e masave punonjëse joproletare»¹.

Edhe kjo tregon se revizionistët e sotëm italianni i kanë braktisur plotësisht mësimet e Leninit dhe ecin në gjurmët oportuniste të renegatëve të Internacionales së Dytë.

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 30, f. 296-297.

Nuk duhet ndonjë mprehtësi e veçantë për të kuptuar se pikëpamjet e predikuara nga udhëheqësit revizionistë italianë mbi «rrugën italiane drejt socializmit» dhe «reformat e strukturës» janë fund e krye në interes të borgjezisë, së cilës, me sa duket, ata gjithash tu janë betuar t'i sjellin shërbime me çdo kusht. Është me vend të kujtojmë këtu fjalët e Leninit të madh, i cili thoshte:

«Borgjezia ka n e v o j ë për shërbëtorë të tillë, të cilëve një pjesë e klasës punëtore t'u besojë dhe të cilët ta zbukurojnë, ta lustrojnë borgjezinë me fjalë mbi mundësinë e rrugës reformiste, t'ia zënë sytë popullit me këto fjalë, ta largojnë popullin nga revolucioni duke i përshkruar bukuritë dhe mundësitë e rrugës reformiste»¹.

2. Udhëheqja revizioniste e PK Italiane, edhe pas dështimit të bujshëm e diskreditues të orvatjeve të saj për krijimin e «partisë së vetme të klasës punëtore», vazhdon të predikojë përsëri të njëjtën vijë likuidatore.

Në «Projekttezat» deklarohet se objktivi esençial i Kongresit të 11-të të PK Italiane është «t'u propozojë masave popullore, militantëve socialistë, Partisë Socialiste të Unitetit Proletar dhe Partisë Socialiste Italiane, së majtës laike dhe asaj katolike një alternativë lufte për të dalë nga kriza ekonomike dhe

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 29, f. 571.

politike aktuale, për të përbysur qeverinë e qendrës së majtë, për t'i dhënë jetë një shumice të re, për të filluar një proces unifikimi të forcave socialiste mbi një bazë klasore dhe revolucionare». Pra, krijimi i «partisë unike» mbetet përsëri një ndër objektivat aktualë themelorë.

Për më tepër, si në «Projekttezat» ashtu edhe në raportin e Longos theksohet në mënyrë të veçantë se «duhet luftuar çdo tendencë që synon ta ngushtojë politikën e unitetit të klasës punëtore vetëm me marrëdhëni me PSIUP-in dhe të kufizojë kështu mundësinë e një veprimi unitar pozitiv në të gjitha nivelet, në drejtim të PS Italiane dhe të gjitha forcave të majta. Në frysmin e solidaritetit më vllazëror dhe të një diskutimi të singertë duhen kapërcyer vështirësitë dhe keqkuptimet që shfaqen herë pas here lidhur me probleme themelore, të karakterit politik imediat, si dhe orientimi e perspektive».

Lind pyetja: Si është e mundur të shtrohet në mënyrë të tillë problemi kur, siç e theksojnë edhe vetë revizionistët totalistikë, tanë vihet re një proces i theksuar socialdemokratizimi dhe, për më tepër, kur ata morën refuzimin e hapët e plot përbuzje të PS të Nenit, i cili u vuri revizionistëve kushte ultimative të rënda për të denjuar të bisedojë për unifikim? Udhëheqja e PK Italiane, me L. Longon në krye, përpinqet të dalë nga situata e vështirë dhe të justifikojë qëndrimin e saj poshtërues duke përdorur dy argjumente krejt absurde:

Nga njëra anë, udhëheqësit e PK Italiane thonë se pikërisht procesi i theksuar i socialdemokratizimit

që vihet re në «të majtën» bën gjoja shumë aktuale çështjen e unifikimit e të krijimit të «partisë së vetme të klasës punëtore», se procesit të socialdemokratizimit dhe refuzimit të Partisë Socialiste për unifikim me komunistët u duhet përgjigjur me një iniciativë të re e të dyfishuar unitare! Kështu, në raportin e tij, Longoja, pasi vë në dukje zhvendosjen e PS Italiane në pozitat socialdemokrate, e sidomos planin e saj të unifikimit me Partinë Socialdemokrate të Saragatit, bën këto konkluzione të papritura: «Kundër këtij pështjellimi politik e ideologjik të së djathës të PS Italiane duhet zhvilluar një kritikë energjike, por që nuk duhet të katandiset kurrë në sharje dhe **nuk duhet** të çojë në qëndrime të mbyllura sektare. Përkundrazi, ajo duhet të plekset me një aksion unitar pozitiv». Ndërsa Xhankarlo Pajeta, në diskutimin e vet, tha: «Duhet ta pranojmë se kërkesa unitare është përfocuar sot nga shpejtimi i procesit të unifikimit socialdemokrat që duan të bëjnë PSD Italiane dhe e djathë socialiste». («Unita», 30 tetor 1965.) Kjo është me të vërtetë shumë interesante: vetëm disa muaj më parë ata e justifikonin vijën e tyre të unifikimit me pretekstin se në radhët e lëvizjes socialiste e demokratike gjoja vihet re një spostim i theksuar nga e majta (shih, për shembull, artikujt e G. Amendolës mbi «partinë unike»), kurse tani e nxjerrin nevojën e unifikimit për shkak se vihet re një proces i theksuar i spostimit nga e djathë! Që këtej rrjedh vetëm një konkluzion: që revisionistët italianë kërkojnë bashkim «me çdo kusht», pozitë e cila nuk mund të mos shpjerë në kapitullim «pa kushte» përpara presioneve të kërçeve të djathtë

socialistë, sepse është e qartë që në kushtet e një procesi të theksuar të socialdemokratizimit të «së majtës» që vihet re më Itali, unifikimi nuk është i mundur vegse mbi baza socialdemokrate. Dhe pikërisht këtu qëndron likuidatorizmi i renegatëve revisionistë.

Nga ana tjetër, udhëheqësit e PK Italiane përpinqen ta justifikojnë pozitën e tyre absurde të unifikimit në kushtet e sotme të spostimit në të djathtë të PS Italiane dhe të refuzimit të saj ikategorik për bashkëpunim me komunistët me pretekstin se duhet ecur me perspektivë dhe nuk duhet bazuar në qëndrimet e sotme. Kështu, Xhankarlo Pajeta, në diskutimin e vet në plenum, tha: «Partia është sot e bindur mbi nevojën e një procesi të unifikimit, dhe e përsëritim se duhet të jetë e qartë që duke i dhënë rrugë këtij procesi, **nuk mund të presupozojmë se nuk ka asgjë për të mësuar nga bashkëbiseduesit tanë** (po ashtu siç nuk mund të presupozohet se nuk ka asgjë për t'u ofruar atyre). Nuk mund të mos e kemi parasysh se një proces i një rëndësie të tillë duhet t'i shtrojë vetes për detyrë jo aq që të mbajë shënim për pozitat dhc kristalizimet aktuale, sesa që të synojë për t'i ndryshuar ato». Pra, përsëri shpresa e iluzione për një anim të të djathtëve në «të majtë». Dhe njëkohësisht një premtim të djathtëve se edhe PK Italiane (ose më saktë: udhëheqja e saj revisioniste) është gati të mësojë prej tyre, të bëjë ndryshime të tjera në pozitat e saj të tanishme dhe t'u dalë atyre në shtegun e unifikimit, domethënë të zhvendoset në të djathtë, për të arritur kështu në binarë të përbashkët.

Edhe në fushën e politikës së brendshme vazhdimi

me kokëfortësi i së njëjtës vijë reformiste, antirevolutionare e likuidatore nuk mund t'u sjellë revisionistëve toliatistë asgjë të mirë. Nuk mund të ketë kurrfarë dyshimi se kjo rrugë do t'u shkaktojë atyre dështime e vështirësi të reja, do t'i shtyjë të heqin dorë përfundimisht nga çdo trashëgim e traditë komuniste.

III

DISFATA E REVIZIONISTËVE NË LUFTËN ME MARKSISTË-LENINISTËT ËSHTË E PASIIMANGSHME

Një vend të rëndësishëm në materialet dhe në punimet e plenumit të tectorit 1965 të KQ të PK Italiane, si dhe në tërë përgatitjet e revisionistëve toliatistë për kongresin e 11-të, zuri çështja e qëndrimit ndaj partive e forcave marksiste-leniniste. Edhe në këtë fushë revisionistët italianë, si dhe gjithë revisionistët modernë me ata sovjetikë në krye, kanë pësuar një dështim serioz.

Para së gjithash, kanë pësuar fiasko edhe taktikat e reja revisioniste ndaj partive marksiste-leniniste të rekomanduara nga P. Toliati në «Testamentin» e tij për të zëvendësuar metodat «e trasha» të N. Hrushovit, ato të sulmeve banale publike, të cilat i diskredituan revisionistët, rrëzuan prestigjin e autoritetin e tyre dhe i vunë ata në pozita të vështira. Taktika toliatiste kërkonte: të mos acaroheshim punët në mënyrë të tepruar dhe të mos ndërmerrreshin hapa që të çonin

në përçarjen e plotë e përfundimtare, por të përdo-rej gjerësish demagogjia «unitare», më qëllim që të frenohej procesi i diferencimit në lëvizjen komuniste dhe t'u hidhej përgjegjësia e përçarjes partive marksiste-leniniste; të hiqej dorë nga polemika për çështjet ideologjike parimore, të spostohej ajo në terrenin e çështjeve të përditshme, të vogla e të pakontrollueshme, me qëllim që t'u hiqej partive marksiste-leniniste mundësia për të luftuar efektivisht dhe për të demas-kuar revizionizmin; me fjalë të tjera, t'u mbyllej goja partive marksiste-leniniste me anë të demagogjisë «uni-tare» dhe duke spostuar boshtin e polemikës në atë drejtim që u interesonte revizionistëve, ndërsa, nga ana tjetër, të vazhdohej nën rrugoz e me veprime kon-krete kursi tradhtar revizionist. Dihet se kjo taktikë toliatiste u përqafua në fakt edhe nga udhëheqja e re sovjetike pas rrëzimit të N. Hrushovit, duke kaluar bile deri në adoptimin e metodës së «heshtjes» përballë luftës së partive marksiste-leniniste.

Tani është e qartë për cilindo se kjo taktikë e re e revizionistëve ka dështuar plotësisht: partitë marksiste-leniniste, në radhë të parë PPSH, vazhduan e vazhdojnë pa lëkundje e në mënyrë konsekiente pole-mikën parimore kundër vijës antimarksiste e vepri-meve tradhtare të revizionistëve, duke demaskuar gjithnjë më tej fytyrën e tyre të vërtitetë prej renega-tësh të marksizëm-leninizmit, të çështjes së socializmit e të çlirimit të popujve, prej bashkëpunëtorësh e agjen-tësh të imperializmit; partitë marksiste-leniniste hodhën poshtë me vendosmëri demagogjinë «unitàre» të revizionistëve dhe demaskuan fytyrën e tyre të vërtetë

si përçarës të kampit socialist, të lëvizjes komuniste ndërkombe të, të forcave antiimperialiste e paqeda shëse; procesi i diferencimit në lëvizjen komuniste vazhdon në mënyrë të pandalshme në favor të forcave marksiste-leniniste dhe në dëm të revizionistëve, duke minuar çdo ditë e më shumë pozitat e tyre dhe duke u kallur frikën në zemër. Për më tepër, dështimi i tak-tikës së re i ka vënë udhëheqësit revizionistë italiane, si dhe ata sovjetikë e përkrahësit e tyre, përpara alternativës së vështirë: ose të kthehen përsëri në taktkën e vjetër të luftës së hapët e të sulmeve publike, e cila nuk u premtion asgjë të mirë, por vetëm disfata të hidhura (për këtë dëshmon me qartësinë më të madhe fundi i palavdishëm i N. Hrushovit), ose t'i bëjnë bisht polemikës me marksistë-leninistët dhe të diskreditohen krejtësisht, duke pranuar botërisht disfatën e tyre.

Ja përsë në plumin e KQ të PK Italiane u shpreh një shqetësim i thellë për pozitën e papërkulur e parimore të partive marksiste-leniniste në luftën dhe polemikën me revizionistët modernë. Anëtari i KQ të PK Italiane Oketo u ankua fare hapur në plenum se përgatitjet për kongresin e 11-të po hapen në një moment të vështirë, për shkak të mosmarrëveshjeve në lëvizjen punëtore e komuniste. («Unita», 30 tetor 1965.)

Udhëheqja revizioniste e PK Italiane shprehu shqetësimin e saj të thellë edhe për rritjen e forcave marksiste-leniniste në Itali, për zgjerimin dhe forcimin e luftës së tyre kundër revizionistëve.

Natyrisht, lëvizja marksiste-leniniste revolucionar-

re në Itali është akoma në hapat e saj të parë, por ajo çdo ditë po rritet, po merr fuqi, po organizohet, po piqet e po shkon përpara në mënyrë të pandalshme, ndërsa radhët e revizionistëve po shthuren e çorganizo-hen dita-ditës më shumë. E reja, përparimtarja, revolu-cionarja, sado e vogël, e pafuqishme dhe e parëndë-sishme që të duket në fillim, ka të ardhmen përpara dhe do të triumfojë në mënyrë të pashmangshme mbi të vjetrën, reaksionaren, sado e madhe dhe e fuqishme të duket kjo në fillim. Ky është një ligj i përgjithshëm objektiv i zhvillimit të natyrës dhe të shoqërisë nje-rëzore. Këtë po e ndiejnë çdo ditë e më thellë udhë-heqësit revizionistë të PK Italiane, është pikërisht kjo që i ka shqetësuar e trembur ata pa masë.

Ç'vijë adoptoi udhëheqja e PK Italiane lidhur me problemet e lëvizjes komuniste ndërkombe-tare, ose, më saktë, lidhur me qëndrimin ndaj partive marksiste-le-niniste?

1. Në raportin e vet në plenum L. Longoja tha: «Partia jonë... duhet të japë kontributin e vet për korrige-jimin e dobësive e të gabimeve që janë shfaqur në vitet e fundit në fushën e lëvizjes punëtore e revolu-cionare botërore, por duke kundërshtuar çdo qëndrim me karakter armiqësor e thjesht hakmarrës». Thekso-het gjithashtu se PK Italiane e quan si detyrë të japë një kontribut gjithnjë më efektiv në përpjekjet për të rivendosur një unitet të ri në lëvizjen punëtore e revolucionare botërore. (Shih «Projekttezat».)

Problemi është shtruar në mënyrë të paqartë, ten-dencioze e demagogjike.

Së pari, për çfarë dobësish e gabimesh është fjala?

Përse udhëheqja revizioniste italiane nuk ka dëshirën e guximin t'i kritikojë hapur, sheshit, veprimet anti-marksiste e përçarëse të grüpuit revizionist hrušovian, por kufizohet me disa fraza të errëta, ndërsa nuk mungon aspak të bëjë sulmet shpifëse më të rënda kundër partive marksiste-leniniste? Ku janë «principialiteti» dhe «objektiviteti» për të cilët mburren shumë krerët revizionistë italianë?

Së dyti, udhëheqësit e PK Italiane ia njojin plotësisht të drejtën vetes «të japid kontributin» për problemet e lëvizjes komuniste, me fjalë të tjera, i lejojnë vetes të sulmojnë publikisht partitë marksiste-leniniste e të bëjnë kundër tyre akuzat më të rënda për «përçarje», «politikë adventureske», «qëndrim raciste» e shumë të tjera si këto, ndërsa përgjigjet e tyre i quajnë «të papranueshme», «armiqësore», «hakmarrëse», «provinciale» etj., etj. Por ata nuk do të mundin kurrë me manovra të tillë t'u mbyllin gojën partive marksiste-leniniste dhe t'i shpëtojnë demaskimit të rreptë e parimor nga ana e tyre.

Duket, pra, qartë se revizionistët toliatistë nuk i preokupon aspak uniteti i vërtetë i lëvizjes komuniste e revolucionare, por lufta kundër partive marksiste-leniniste nga pozitat më të favorshme për revizionistët.

2. Duke i qëndruar besnikë taktikës toliatiste të «mosacarimit të tepëruar të gjérave», udhëheqja e PK Italiane shprehet hapur kundër çdo veprimi që mund të shpjerë në thellimin e mëtejshëm të përçarjes: «Ne — tha Longoja — themi se duhet evitar, si e dëmshme dhe e rrezikshme, çdo procedurë që mund të shpjerë në thellimin e ndarjeve e përçarjeve të tanishme, siç

mund të ishte, për shembull, thirrja në kushtet e sotme e një mbledhjeje të re ndërkombejtare të partive punëtore e komuniste». Si forma të përshtatshme të marrëdhënieve midis partive rekomandohen takimet dy-palëshe e shumëpalëshe etj.

Siq e kemi vënë në dukje edhe më lart, preokupimi i revizionistëve toliatistë, kur ata mbajnë një qëndrim të tillë, është frika nga shpejtimi i procesit të diferencimit midis marksistëve revolucionarë e revizionistëve në lëvizjen komuniste, si dhe orvatja për të manovruar me kartën e «unitetit». Por në të njëjtën kohë këtu duken edhe divergjencat që ekzistojnë midis revizionistëve toliatistë, të cilët duan të jenë të lirë e të pavarur në ndjekjen e vijës së tyre, dhe revizionistëve sovjetikë, të cilët, me mënyra të ndryshme, përpilen të ruajnë një pozitë sunduese në frontin revizionist. Është kuptimplotë që plenumi i KQ të PK Italiane u shpreh në mënyrë të prerë kundër mbledhjes ndërkombejtare të partive komuniste e punëtore pikërisht në një kohë kur udhëheqja revizioniste sovjetike dhe përkrahësit e saj hodhën përsëri publikisht parullën për thirrjen e një mbledhjeje të tillë.

Në këtë frysë, udhëheqja e PK Italiane flet tanë për «baza të reja» të internacionalizmit proletar. Në «Projekttezat», si dhe në raportin e Longos, thuhet: «Internacionalizmi duhet e mundet sot të mbështetet mbi baza të reja, mbi parimin e unitetit në diferençë. Domethënë, nga njëra anë, mbi njohjen e ndryshimeve që ekzistojnë midis këtyre forcave, mbi njohjen e barazisë, pavarësisë dhe autonomisë së tyre të plotë, mbi mospranimin e çfarëdo kthimi në forma drejtimi drejt-

përdrejt ose tërthorazi të centralizuara». Natyrisht, është një shtrembërim i trashë i së vërtetës dhe një absurditet të thuhet se gjoja barazia e pavarësia e partive komuniste e punëtore përbëkan «baza të reja» të internacionalizmit proletar dhe se format e centralizuara të organizimit të lëvizjes komuniste i përjashtokan barazinë e pavarësinë. Përkundrazi, barazia e plotë dhe pavarësia e çdo partie motër për të përcaktuar politikën e saj mbi bazën e mësimeve revolucionare të marksizëm-leninizmit e në përshtatje me kushtet kombëtare konkrete të vendit të vet, kanë qenë kurdoherë pjesë përbërëse e parimeve internacionliste të marrëdhënieve midis partive komuniste, pavarësisht nga format konkrete organizative që kanë marrë marrëdhëniet e bashkëpunimi midis pjesëtarëve të lëvizjes komuniste botërore në rrëthanat e ndryshme historike. Por tani na intereson jo kjo anë e problemit, por fakti që revizionistët toliatistë italianë i kundërvënë vijës së «dëjtimit unik», të ndjekur nga udhëheqja revizioniste sovjetike, vijën e «decentralizimit» e të «pavarësisë» nga çdo zotim ndërkombëtar, qoftë ky edhe revizionist.

3. Ashtu si edhe udhëheqja revizioniste sovjetike, revizionistët italianë po manovrojnë me të madhe me parullën e «unitetit të veprimeve» në luftën kundër «armikut të përbashkët» — imperializmit, sidomos kundër agresionit imperialist amerikan në Vietnam. Longoja theksoi nevojën që të përqendrohen përpjekjet «në gjetjen e formave të unitetit të veprimeve, jo vetëm midis të gjitha forcave punëtore e komuniste, por midis të gjitha forcave antiimperialiste, rrëth objektivash të përbashkëta, nga të cilat më e rëndësishmja është sot

dhënia fund e agresionit amerikan në Vietnam». Edhe anëtari i KQ të PK Italiane R. Leda theksoi domosdoshmërinë që «të vazhdohet lufta me këmbëngulje për arritjen e këtij uniteti, qoftë edhe të pjesshëm, të përkohshëm, të kufizuar, kudo që ai është i nevojshëm, për të kundërshtuar agresionin imperialist». («Unita», 30 tetor 1965.)

Kjo është një parullë demagogjike e mashtruese, e cila ka për qëllim të fshehë pozitat dhe veprimet proimperialiste e përcarëse të revisionistëve nën flamurin e irremë të «antiimperializmit» e të «unitetit», ndërsa përgjegjësinë për përcarjen, që favorizon veprimet agresive të imperializmit, t'ua ngarkojë, partive marksiste-leniniste. Në të njëjtën kohë, revizjonistët përpiken që me pretekstin e «unitetit të veprimeve» t'i detyrojnë partitë marksiste-leniniste të pushojnë polemikën parimore kundër revisionistëve.

Po për ç'unitet veprimesh kundër imperializmit midis partive marksiste-leniniste dhe revisionistëve modernë mund të bëhet fjalë kur dihet se divergjencat kryesore midis tyre qëndrojnë pikërisht në faktin që revizjonistët modernë janë larguar nga lufta kundër imperializmit dhe çdo qëndrim të vendosur ndaj tij e shpallin «aventurizëm»? Nuk janë partitë marksiste-leniniste, por revizjonistët modernë, me ata sovjetikë në krye, që, për hir të «bashkëpunimit të gjithanshëm sovjeto-amerikan», pengojnë me çdo mjet luftën efektive antiimperialiste, gjë që është vërtetuar me fakte të shumta të pakundërshtueshme në materialet e botuara nga partitë motra. Bile aq është e vërtetë saqë edhe në vetë plenumin e KQ të PK Italiane u vu në

dukje se formulimet e propozuara në «Projekttezat» lidhur me vlerësimin e imperializmit amerikan janë bile më të dobëta nga ato që përdornin më parë, me gjithë faktin e agresionit të tij në Vietnam.

Prandaj lufta për demaskimin e revizionizmit modern, për shpartallimin ideopolitik të tij, nuk e dobëson aspak frontin e luftës kundër imperializmit, përkundrazi, është kusht i domosdoshëm për forcimin e tij, sepse, siç thoshte V.I. Lenini, nuk është e mundur lufta me sukses kundër imperializmit pa një luftë të vendosur kundër oportunizmit e revizionizmit në lëvizjen punëtore.

Demagogjia «unitare» e revisionistëve nuk do të mund të mashtrojë komunistët e popujt, ajo do të pësojë dështim të plotë, si edhe të gjitha takтикat e mëparshme revizioniste. Ata nuk do të arrijnë kurrë, sidomë që të manovrojnë, të ndalojnë luftën e partive dhe forcave marksiste-leniniste kundër tradhtisë revizioniste. Dhe në këtë luftë disfata e revisionistëve është e pashtmagshme.

IV

GJENDJA E RËNDE NË PK ITALIANE – PASOJE E PASHMANGSHME E VIJËS REVIZIONISTE TË UDIHËHEQJES SË SAJ

Të tilla janë dështimet e vështirësítë e revisionistëve toliatistë italianë, ku i ka çuar ata në mënyrë të pashtmagshme vija e tyre antimarksiste. Kjo pati, e nuk mund të mos kishte, pasoja tepër të rënda për Partinë Komuniste Italiane.

Çorganizimi dhe shthurja — bashkudhëtare të revizionizmit në fushën organizative

Udhëheqësit revisionistë italianë janë të detyruar ta pranojnë se që prej disa vjetësh është vënë re një proces i theksuar shthurjeje, çmobilizimi, rënieje të aktivitetit, braktisjeje, uljeje të nivelit ideopolitik etj. në radhët e PK Italiane. Ja ç'thonë vetë ata lidhur me këtë:

- a) Në «Projekttezat», si dhe në raportin e Longos në plenum, flitet për «tendencat që janë shfaqur, duke filluar qysh nga viti 1954,... për pakësimin e numrit të të regjistruarve në parti dhe uljen e aktivitetit», të cilat «me kalimin e kohës mund të prekin karakterin masiv të partisë dhe vetë influencën e saj elektorale».
- b) Në këto dokumente thuhet gjithashtu se «qysh nga Kongresi i 10-të e këtej është krijuar sidomos një hendek midis përpunimit të vijës së përgjithshme politike të partisë dhe aftësisë së saj për ta zbatuar atë me vazhdimësi e në masën e duhur».
- c) Në raportin e Longos vihet në dukje se, siç u konstatua edhe gjatë punimeve të komisionit që përgatiti «Projekttezat», «rënia e aktivitetit e ka burimin në rënien e hovit ideor e të vetëdijes për lidhjen që ekziston midis betejave të pjesshme dhe qëllimeve socialistë».
- ç) Ndër shfaqjet negative në jetën e partisë në «Projekttezat» dhe në raportin e Longos përmenden «forma elektoralizmi, dobësimi të disiplinës organiza-

tive e politike, kundërvënieje midis punës praktike e studimit, frazeologjje «revolucionare», lodhjeje në punë». Dhe më tej: «Shkëputja e diskutimit dhe e kërkimit nga vëprimi, duke çuar drejt një shkëputjeje nga masat dhe nga problemet e mëdha kombëtare, favorizon, siç e ka favorizuar, futjen në vetë gjuhën të një zhargoni të stërholluar, që shumë herë fsheh zbrazësinë politike, mungesën e rreptësisë kritike, varfërinë ideore».

d) Në «Projekttezat» flitet, midis të tjerash, për «tendenca empirizmi e konservatorizmi. Tendenca për të mos njojur disa parime esenciale të teorisë marksiste e të natyrës së partisë, për të nënveftësuar thesarin e madh që ka grumbulluar lëvizja komuniste në dhjetëra vjet lufte dhe eksperience revolucionare».

dh) Atje flitet, më në fund, për «tendenca intelektualiste, që çojnë... drejt varfërimit të veprimtarisë së partisë, duke e kufizuar praktikisht atë me një funksion propagande».

Përpara këtyre pohimeve të hidhura, edhe pse ato nuk e tregojnë plotësisht gjendjen e rëndë në të cilën ndodhet PK Italiane, tingëllojnë krejt qesharake deklaratat e Longos se gjoja «kuadri i përgjithshëm i partisë është sot në thelb i shëndoshë e luftarak» e të tjera si këto. Ato janë një orvatje e trashë për të mbuluar diellin me shoshë.

Megjithëse detyrohen ta pranojnë, qoftë edhe me lehtësime e zbukurime, faktin e shthurjes ideopolitike e organizative në PK Italiane, udhëheqësit revisionistë të saj i bëjnë bisht sqarimit të çështjes së rëndësishme se ku e kanë burimin këto shfaqje negative në parti.

Dhe kjo është krejt e kuptueshmë: ata nuk mund ta pranojnë të vërtetën në këtë çështje — dhe e vërteta është se burimi i vetëm i thellë i tërë këtyre të këqijave është via revizioniste e udhëheqjes së PK Italiane, e cila prej kohësh ka hequr dorë nga marksizëm-leninizmi dhe nga parimet leniniste të jetës së partisë:

Së pari, ka hequr dorë nga parimet e mësimet themelore të marksizëm-leninizmit, duke i shpallur ato «të vjetruara», dhe ka hedhur poshtë në fakt eksperiencën revolucionare më se 100-vjeçare të lëvizjes komuniste e revolucionare ndërkombe të, duke e shpallur atë «të papështatshme për vendet kapitaliste të zhvilluara». Ajo ka hequr dorë bille nga traditat revolucionare të dikurshme të vetë PK Italiane. Këtë e ka thënë fare hapur P. Toliati, i cili pati deklaruar se ajo që bën tanë udhëheqja e PK Italiane, 30 vjet më parë dënohej me të drejtë prej saj si oportunizëm i kulluar!

Së dyti, udhëheqja e PK Italiane ka hequr dorë prej kohësh nga lufta e vërtetë revolucionare për përmbysjen e borgjezisë dhe triumfin e socializmit dhe merret me mbjelljen e iluzioneve boshe mbi «rëndësinë esenciale të luftës rivendikative» e mbi «reformat e strukturës».

Së treti, ajo ka hequr dorë prej kohësh nga puna e gjallë revolucionare me njerëzit dhe është futur në rrugën e diskutimeve akademike sterile, gjë për të cilën dëshmon qartë qoftë dhe gjuha intelektualiste, e turbullt, e ngatërruar dhe e pakuptueshme për masat punëtore me të cilën flasin e shkruajnë shefat revizionistë italianë edhe për gjërat më të thjeshta. Aq është e vërtetë sa dikush tha bille në plenum se PK Italiane

dhe grupi drejtues i saj kanë frikë ta përqendrojnë veprimin e tyre në fabrikat.

Së katërti, udhëheqja revizioniste italiane ka hequr dorë prej kohësh nga parimet leniniste të ndërtimit të partisë, me pretekstin e shndërrimit të saj në një «parti masash». Në këtë fryshtë ajo ka hequr dorë nga parimi i unitetit ideologjik të partisë, duke mos e kon sideruar pasjen e bindjeve marksiste-leniniste si kusht për pranimet dhe qenien në parti. Kështu, për shembull, në raportin e P.. Bufalinit, mbajtur në plenumin e KQ të PK Italiane në qershor 1965 kushtuar çështjes së «partisë unike», thuhet: «Baza e unitetit të saj është, para, së gjithash, aderimi në programin e saj politik. Ne jemi një parti politike dhe, pra, aderimet që nxitim e pranojmë — pavarësisht nga bindjet filozofike e fetare të secilit — janë aderime në një program politik». («Unita», 4 qershor 1965, f. 11.) Kjo pozitë rikonfir mohet plotësisht edhe në «Projekttezat për Kongresin e 11-të të PK Italiane».

Dhe jo vetëm kaq. Për më tepër, udhëheqja revizioniste italiane i ka hapur dyert për çdo simpatizant që të futet në parti, mjafton që ai të votojë për komunistët në zgjedhjet.

Është e qartë se në këto kushte largimi nga radhët e partisë, shkeljet kronike të disiplinës, rënia e aktivitetit të partisë në bazë, indiferentizmi kundrejt detyrave të shtruara në parti, rënia e nivelit ideopolitik të partisë, humbja e fryshtës revolucionare të saj etj. janë krejt të natyrshme e të pashmangshme. Disiplina e partisë dhe aktiviteti i saj mund të jenë të forta e të shëndosha vetëm në rast se ka një vijë politike të drejtë

e revolucionare. Çorganizimi dhe shthurja janë bashk-udhëtare të pashmangshme të revizionizmit në fushën organizative.

Përse udhëheqja e PK Italiane është aq e shqetësuar për unitetin në parti?

Një ndër problemet më preokupante që përshkoi punimet e plenumit të tetorit 1965 të KQ të PK Italiane, si dhe tërë përgatitjet për kongresin e 11-të të saj, është problemi i unitetit në parti, e sidomos në udhëheqjen e saj. Lidhur me këtë, në dokumentet e plenumit (në «Projekttezat» dhe në raportin e Longos) thuhet se në parti janë shfaqur «tendenca të rrezikshme të frysë së grupeve e të fraksioneve» dhe theksohet nevoja e ruajtjes së unitetit të partisë.

Është kuptimplotë që në konkluzionet e veta në mbyllje të punimeve të plenumit («Unita», 31 tetor 1965) Longoja nuk u ndal fare në brendinë konkrete të diskutimeve që u bënë në plenum, por nguli këmbë me të madhe te domosdoshmëria e ruajtjes së unitetit të partisë dhe te rreziku serioz i fraksionizmit dhe i përçarjes që e kërcënon partinë. Duke kritikuar ashpër disa drejtues të rëndësishëm të partisë për «frymën e dëmshme», «jounitare» të qëndrimeve e diskutimeve të tyre si gjatë përgatitjes së «Projekttezave», por sidomos në plenum, Longoja tha: «Besoj se duke folur për partinë është kurdoherë e dobishme dhe e nevojshtme t'i tërheqim asaj vëmendjen kündër një rreziku që mund të jetë vdekjeprurës për veprimin e saj dhe

për të ardhmen e saj. Por duhet ta saktësoj se paralajmërimi nuk është bërë vetëm për konsiderata të përgjithshme. Ai i përgjigjet një kërkese të saktë aktualc». Bile Longoja foli edhe për një «letër anonime të përmuajshme, të redaktuar nga një grup shokësh që bëjnë thirrje për të krijuar një fraksion të vërtetë në parti». Prandaj ai theksoi se është i mendimit që «paralajmërimet kundër rrezikut të fraksioneve e rrymave duhet të mbeten në tezat, bile po qe e nevojshme edhe të përforcohen».

Edhe përkrahësit e Longos ngritën me forcë të madhe në plenum rrezikun e përçarjes dhe domosdoshmërinë e ruajtjes së unitetit në parti, sidomos në udhëheqjen e saj. Në diskutimin e vet Kosuta tha: «Duhen evituar e kundërshtuar kundërvëniet në udhëheqje, në qoftë se duam të evitojmë që nga udhëheqja ato të zbresin në bazë, të kristalizohen, të shndërrohen në rryma, pavarësisht nga vullneti i mirë i secilit, duke degjeneruar kështu debatin kongresual». («Unita», 30 tetor 1965.) Duke kritikuar ata që mbajtën qëndrime «jounitare», Fabrini tha në plenum: «Kjo gjë nuk është pa pasoja politike, sepse partisë... i krijohet në këtë mënyrë përshtypja e një uniteti fals». («Unita», 30 tetor 1965.) Anëtari i KQ Oketo deklaroi: «Mendoj se është një çështje parimore që, sidomos në këtë moment, çdo militant komunist duhet, midis një ideje të tijën dhe unitetit të partisë, të zgjedhë unitetin e partisë dhe që idetë, kontributet kritike nuk duhet të shndërrohen në fraksione». («Unita», 30 tetor 1965.) Ndërsa anëtari i udhëheqjes së PK Italiane G. Amendola deklaroi: «Pikërisht uniteti më duket sot objktivi që

partia duhet ta konsiderojë si themelor në këtë moment, për të reaguar ndaj agresioneve, ndaj presioneve të jashtme e jo të jashtme që po i bëhen asaj». Dhe shtoi më tej: «Duke qenë se ky është kongresi i parë pas humbjes së Toliatit, të gjithë shokët duhet të zotohen me një ndjenjë më të madhe përgjegjësie; me një modesti më të madhe, me një disiplinë më të rrapëtë». («Unita», 31 tetor 1965.)

Paralajmërimet kaq të hapëta e kaq këmbëngulëse të Longos e të përkrahësve të tij kundër fraksionizmit e përçarjes nuk mund të mos tërheqin vëmendjen, aq më tepër që në plenumin e mëparshëm të KQ në qershor 1965 kushtuar çështjes së «unifikimit» me socialistët, megjithëse edhe atëherë pati «debate të gjalla», nuk u ngrit hapur çështja e përçarjes, bile u tha se «organizimi i rrymave në gjirin e një partie mund të përbëjë në disa raste një formë të dialektikës së brendshme e të demokracisë».

Përse, pra, Longoja dhe shokët e tij revizionistë janë tanë kaq të shqetësuar për «unitetin»? Përse u shprehën ata me kaq gjaknxehtësi kundër «debateve të gjalla», të cilat deri dje i cilësonin si shprehje e qartë e «demokracisë së vërtetë» dhe e «konfrontimit të lirë të pikëpamjeve»? Çfarë ka ndodhur në udhëheqjen e PK Italiane që shkaktoi debate kaq «të gjalla» e preokupime kaq të mëdha për unitetin?

Është tanimë një fakt i pamohueshëm se në udhëheqjen e PK Italiane janë kristalizuar të paktën tri rryma kryesore, gjë që u duk qartë si gjatë punës përpunimin e «Projekttezave» ashtu edhe gjatë punimeve të plenomit që i adoptoi ato, pa folur këtu për

grupëzimet e vogla dhe grindjet individuale midis kre-rëve të ndryshëm revizionistë. Sido që të përpiken udhëheqësit revizionistë italianë, me L. Longon në krye, të justifikojnë ato që ngjanë dhe të fshehin shkaqet e vërteta të kontradiktave që janë shfaqur në një formë mjaft të acaruar, saqë grapi drejtues i Longos dhe i përkrahësve të tij refuzuan bile të botonin materialet e plota të diskutimit dhe të informonin me hollësi partinë për debatet e zhvilluara, ata nuk do të mundin kurrë të mbulojnë të palarat e tyre. Dhe shkaqet e vërteta të kontradiktave që kanë lindur janë:

Së pari, lufta parimore dhe e vendosur e partive dhe e forcave marksiste-leniniste, e cila ka demaskuar thelbin antimarksist, antirevolucionar e tradhtar të pikëpamjeve e qëndrimeve të udhëheqjes revizioniste italiane, duke e detyruar atë të ndryshojë takikat e saj.

Së dyti, deziluzionet dhe dështimet e rënda që ka pësuar vija revizioniste e toliatistëve, të cilat i kanë vënë ata në pozita shumë të vështira.

Së treti, fakti që revizionistët nuk mund të kenë një unitet të shëndoshë, sepse ata nuk kanë një bazë ideologjike të përbashkët e të përcaktuar qartë. Ideologjia e tyre është një grumbullim eklektik pikëpamjesh, të huajtura nga ideologjia borgjeze dhe nga oportunistët e së kaluarës e të përziera me frazeologji pseudomarksiste dhe secili, sipas nevojës e sipas rastit, mund të shtojë, të heqë e të ndryshojë. Uniteti i vërtetë, i shëndoshë e i qëndrueshëm është i mundur vetëm mbi bazën e ideologjisë shkencore marksiste-leniniste. Nuk është aspak e rastit që kontradiktat në gjirin e udhëheqjes së PK Italiane, të cilat, si thëngjilli nën hi, ekzistonin edhe më

parë, shpërthyen hapur menjëherë pas vdekjes së P. Toliatit, i cili ruante një unitet të sipërfaqshëm duke shfrytëzuar autoritetin e tij të dikurshëm.

Por cili është thelbi i kontradiktave që janë shfaqur në udhëheqjen e PK Italiane? Cili është profili ideopolitik i rrymave që janë kristalizuar në të?

Për sa i përket pozitës së grupit drejtues me L. Longon në krye, ajo është paraqitur në mënyrë pak a shumë të hollësishme në tri pjesët e para të këtij artikulli. Prandaj këtu do të shohim shkurtimisht se ç'përfaqësojnë dy rrymat e tjera.

Nga studimi i materialeve të plenumit të tetorit 1965 të KQ të PK Italiane, megjithëse materialet e kundërshtarëve të grupit drejtues të Longos janë botuar në një formë shumë të përbledhur e të cunguar, del se kundërshtimet e «fraksionit» të kryesuar nga anëtari i udhëheqjes së partisë Pietro Ingrao konsistojnë në këto gjëra kryesore:

1. Ata u shprehën për përpunimin e disa objektivave «më të avancuar» në luftën për të vënë në jetë «rrugën italiane drejt socializmit». Vërejtja kryesore e Ingraos dhe e përkrahësve të tij në këtë drejtim është se udhëheqja e partisë, me Longon në krye, mbështetet shumë te lufta rivendikative dhe nënvleftëson luftën efektive për «reforma strukturore rrënjosore», sidomos për reforma që synojnë transformimin rrënjosor të aparatit shtetëror, duke e kufizuar këtë të fundit vetëm me një propagandë të përgjithshme mbi nevojën e reformave dhe pa zhvilluar në shkallën e duhur një luftë të gjerë masive për këto reforma.

Kështu, Ingrao kërkoi që të shtrohen «objektiva të

rinj» në krahasim me Kongresin e 10-të të PK Italiane dhe tha: «Sigurisht sot, ashtu si dje, platforma jonë është ajo e një lufte antimonopoliste, por me përbajtje më të avancuar, që shtron në mënyrë më të afërt çështje të pushtetit». Ai tha gjithashtu se «është e nevojshme të transformohet makina shtetërore dhe të mbështetemi mbi një lëvizje të gjerë të masave», se «është iluzor një kontroll i kapitalit duke vepruar vetëm në rrugë politike e nga lart, por jo edhe në rrugë shoqërore e nga poshtë» etj. («Unita», 29 tetor 1965.)

Kurse Seri deklaroi në plenum se «do të ishte e gabuar t'i besohej vetëm zhvillimit të luftërave rivendikative zgjidhja e një varg problemeve politike». («Unita», 29 tetor 1965.) Edhe Reiklini theksoi se partia ka qëndruar në skemën e luftërave rivendikative dhe bën vetëm një agjuracion të përgjithshëm për reforma.

2. Ingrao dhe përkrahësit e tij shprehën dyshimet e veta se grapi udhëheqës i partisë, me Longon në krye, nënveftëson rrezikun e socialdemokratizimit që vihet re në lëvizjen punëtore italiane dhe mbivlerëson të ashtu-quajturin dështim të qendrës së majtë. Ata theksuan domosdoshmërinë e formimit të një «shumice të re» me ato forca të cilat «me të vërtetë» janë për socializmin.

Duke trajtuar këtë çështje Pintori tha në plenum: «Ka akoma një nënveftësim të karakterit që po merr procesi i socialdemokratizimit dhe i orientimeve të shumicës së PS Italiane. Kjo mund të dobësojë iniciativën tonë kundrejt të gjitha atyre forcave të së majtës socialistë e josocialiste që jo vetëm kanë kundërshtuar e kundërshtojnë socialdemokratizimin, por edhe kanë orientimin të rikërkojnë një strategji të përbashkët me ne

dhe, pra, nuk lehtëson por pengon veprimin tonë për të tërhequr punonjësit socialistë, bile edhe ata katoikë». («Unita», 31 tetor 1965.) Kurse M. Alikata, i cili bëri në plenum bilancin e diskutimeve, e interpretoi kështu pikëpamjen e Ingraos: «Na u duk se, për shembull, kur Ingrao, në diskutimin e tij, sforcon disa aspekte negative të procesit të socialdemokratizimit e të integrimit të klasës punëtore, duke i paraqitur ato më të gjera nga ç'janë në të vërtetë, ai nxjerr nga kjo që tërë politika jonë e aleancave dhe e kombinimeve duhet kufizuar vetëm me PSIUP-in dhe lombardianët. Nuk flitet më për të majtën katolike, po për disa grupime të rinjsh, intelektualësh etj. «jashtë partive». Nuk flitet më për veprim unitar në drejtim të bazës autonomiste të PS Italiiane dhe të disa kuadrove të saj, veprim që, paravësisht nga çdo gjë, duhet të vazhdojë». («Unita», 31 tetor 1965.)

3. Ingrao dhe përkrahësit e tij kërkuan një demokraci më të madhe në jetën e brendshme të partisë, me fjalë të tjera një liri më të madhe për të shprehur pikëpamje në kundërshtim me grupin udhëheqës dhe përt'i cuar ato në tërë partinë.

Lidhur me këtë Ingrao u shpreh kundër të ashtuquajturit monolitizëm, kur çdo mosqenie dakord shpallet «deviacion», «përçarje», «hapje e rrugës për armikun» etj. dhe shtroi problemin se «si të zbatohet një metodë e ndërtimit të unitetit të partisë, e cila të bazohej gjithnjë më shumë mbi konfrontimin e hapët të ideve e të kundërshtimeve të mundshme, pa e socialdemokratizuar partinë, pa përfunduar në fraksione e rryma dhe pa humbur kompaktësinë në luftë». Në këtë

frymë ai kërkoi që «të përqendrohet më tepër puna e KQ në përcaktimin e orientimeve politike vendimtare: duke bërë të qarta kërkimin dhe konfrontimin e ideve nëpërmjet të cilave udhëheqja ka arritur në formulimin e propozimeve të ndryshme; dhe kjo duhet bërë edhe kur kërkimi ka nxjerrë në shesh divergjenca në gjirin e organeve drejtuese. Pikërisht kjo do të bëjë që KQ të mund të kryejë më mirë detyrën e tij të përcaktimit të orientimeve dhe që tërë partia — duke u vënë në dijeni mbi punimet e KQ — të mund të marrë pjesë më shumë e më mirë në përpunimin e vijës, në debatin, në iniciativat politike». («Unita», 29 tetor 1965.) Pintori kërkoi gjithashtu diskutim kongresual të lirë «pa u marrë e pa u luftuar diferencimet si kundërvënie». («Unita», 31 tetor 1965.)

L. Longoja dhe përkrahësit e tij (Alikata, Amenda, Kosuta, Triveli, Alinovi e të tjerë), në përpjekjet e tyre për të mposhtur kundërshtarët e vet, e paraqitën çështjen sikur pikëpamjet dhe pretendimet e Ingraos e të shokëve të tij janë gjoja në kundërshtim me vijën e përgjithshme të deritanishme të PK Italiane dhe përbëjnë një orvatje për t'i kundërvënë asaj një vijë tjetër. Longoja në konkluzionet e veta tha se në qëndrimet, diskutimet dhe kërkesat e përsëritura këmbëngulëse të Ingraos e të njerëzve të tij duket «tendenca për të futur në vijën e përgjithshme të partisë ndryshime cilësore dhe jo korrigjime të veçanta». («Unita», 31 tetor 1965.) Kurse Alinovi deklaroi në plenum se «në diskutimin e këtyre muajve të fundit nuk kanë munguar sugjerime e stimulime për të kërkuar një vijë e strategji të përgjithshme «të re»». («Unita», 30 tetor 1965.)

Në këtë mënyrë grupei udhëheqës, me L. Longon në krye, u përpoq të justifikonte qëndrimin e vet të ashpër ndaj «frakcionit» të Ingraos, që është në kundërshtim të plotë me predikimet e bujshme të vetë udhëheqësve revizionistë italianë mbi «demokracinë e vërtetë» në parti. Alikata, në konkluzionet e tij, tha: «Jo kurdoherë një debat i gjallë është i dobishëm... As nuk duhet të habitë njeri ashpërsia e debatit kur, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, vihen në diskutim pikat esenciale të vijës së përgjithshme të partisë; kjo nxit reagimin e shokëve që kanë ndër mend ta mbrojnë këtë vijë dhe nuk mund të konsiderohet kurrsesi si një frikësim». («Unita», 31 tetor 1965.) Duket sheshit se sa demagogjike janë mburrjet e revizionistëve toliatistë mbi «demokracinë» në parti, të cilën ata nuk ngurrojnë ta shqelmojnë apo shohin edhe rrezikun më të vogël për pozitën e tyre sunduese.

Në të vërtetë, vërejtjet dhe kundërshtimet e Ingraos e të përkrahësve të tij nuk prekin aspak thelbin dhe frymën e vijës së përgjithshme revizioniste të udhëheqjes së PK Italiane, por janë plotësisht brenda caqeve të saj. Protagonisti kryesor i «kritikave», P. Ingrao, e bashkë me të edhe përkrahësit e tij, e theksuan qartë e paekuivoke se mbështetin plotësisht vijën e përgjithshme të udhëheqjes, vijën e «rrugës italiane, demokratike e paqësore» drejt socializmit, të unifikimit me socialistët, të «bashkekzistencës paqësore» hrushoviane, të luftës kundër partive e forcave marksiste-leniniste etj. Ingrao e tha fare hapur në plenum: «Jam dakord me riafirmimin që projekttezat dhe raporti i Longos i bëjnë strategjisë sonë të ecjes demokratike drejt socializmit... luf-

të për një regjim të bashkekzistencës paqësore; shumicë e re; dialog me katolikët; unitet veprimi me forcat socialiste për t'i hapur rrugën procesit të unitetit politik e të unifikimit në një parti të vetme të të gjitha forcave revolucionare». («Unita», 29 tetor 1965.) Kurse Reiklini, i cili qëndronte krah për krah me Ingraon në «kritikat» e tij, deklaroi se për realizimin e tyre «nuk është e nevojshme të braktisët strategjia jonë, strategjia e reformave të strukturës dhe e rrugës italiane për në socializëm. Por është e nevojshme që ajo t'i përshtatet situatës së re». («Unita», 30 tetor 1965.)

Atëherë ç'kérkojnë këta njerëz? Cilat janë qëllimet e tyre? Për çfarë nuk janë dakord ata me grupin udhëheqës të Longos e të përkrahësve të tij? Tërë thelbi dhe fryma e kundërshtimeve të tyre është që të adoptohet një taktikë tjetër, më e moderuar dhe më e matur, e cila t'i ruajë revizionistët nga demaskimi i plotë dhe njëkohësisht të sigurojë realizimin e vijës themelore revolucioniste. Ata kérkojnë një qëndrim më të matur e më demagogjik lidhur me «rrugën italiane drejt socializmit», në mënyrë që të krijohet përshtypja se ata me të vërtetë dhe efektivisht luftojnë për socializmin (të ashtuquajturat objektiva të avancuar). Ata kérkojnë gjithash tu një qëndrim më të matur lidhur me çështjen e unifikimit me socialistët, i cili t'i ruajë nga deziluzione të tillë të hidhura e diskredituese siç qe refuzimi brutal i Partisë Socialiste të Nenit për të pranuar bashkimin me revizionistët në një «parti të vetme të klasës punëtore».

Pra, këtu kemi të bëjmë me kundërshtime e kontradikta për çështje taktike midis dy rrymash në themel njëloj oportuniste e revolucioniste. Midis tyre zhvi-

llohet një luftë e paparim për udhëheqje, për pushtet në parti. A. Kolombi e tha hapur këtë në plenum: «Nga debati i tanishëm shokët e dinë se ka mosmarrëveshje dhe bëjnë pyetjen se cilat janë shkaqet e vërteta të mosmarrëveshjes: nëse është fjala për luftë për parime e probleme politike, apo për luftë personash për pushtet». Dhe në këtë fryshtë, domethënë duke pasur para-sysh se kemi të bëjmë me një luftë për pushtet, ai mbrojti Longon duke thënë: «Partia ka besim te shoku Longo..., ka besim në grupin e shokëve që mbajnë përgjegjësitë më të larta». («Unita», 30 tetor 1965.) Ja përse Longoja, Alikata, Amendola dhe përkrahësit e tyre u ngritën me kaq «vendosmëri» e këmbëngulje në mbrojtje të «unitetit» dhe dënuan me ashpërsi të ashtu-quajturat qëndrime «fraksioniste» e «përçarëse».

Pati në plumin e KQ të PK Italiane edhe disa njerëz të tjerë të cilët, me gjysmë zëri, me druajtje e pakurajë parimore, si ndonjë mëkatar që prek «mollën e ndaluar», shprehën dyshime, vunë pikëpyetje dhe bënë kritika të mbytura edhe për disa çështje themelore të strategjisë revisioniste të udhëheqjes së PK Italiane. Vërejtjet dhe kundërshtimet e tyre mund të përmblidhen shkurtimisht në këtë mënyrë: Në materialet e plenumit nuk vlerësohet si duhet karakteri dramatik i gjendjes së sotme ndërkombëtare lidhur me veprimet agresive të imperializmit amerikan, për më tepër tani jepet bile një gjykim më pak i ashpër mbi imperializmin amerikan nga ç'jepej më parë; rezistenca e popullit të Vietnamit duhet të ketë një ndihmë konkrete më të madhe në armë e mjete të tjera, me veprime diplomatike dhe me një mobilizim të përgjithshëm të lëvizjes punëtore e të lë-

vizjes për paqe; nuk përballohet fare në materialet e plenumit problemi i rrugës paqësore ose me dhunë të procesit revolucionar demokratik e socialist; projekt-tezat ndalen tepër gjatë rreth asaj që dikur quhej «programi minimum»; ngjall dyshime çështja se sa është reale vija e «programimit demokratik» dhe e «reformave të strukturës»; udhëheqja nënveftëson rrezikun e kthimit në aventurat reaksionare e antidemokratike në Itali pas «dështimit të qendrës së majtë»; nuk përcaktohet qartë se ç'karakter do të kenë «shumica e re» dhe «partia unike» që propozohen dhe ç'forca do të përfshijnë ato etj. Edhe këta kërkuan më tepër demokraci për shprehjen e lirë të mendimeve në parti dhe kundërshtuan theksimin e rrezikut të «përçarjes» e të «fraksioneve» nga ana e grupit udhëheqës.

Këto janë, pa dyshim, çështje esenciale. Por autorët e këtyre kritikave nuk patën kurajën t'i thoshin gjërat drejt, pa dredhime e rezerva dhe ta dënonin vijën e sotme të udhëheqjes revizioniste të PK Italiane si një vijë thellësish antemarksiste, reformiste e tradhtare. Përkundrazi, u betuan se vërejtjet e tyre janë brenda kuadrit të vijës së përgjithshme revizioniste të partisë dhe shpejtuan të deklarojnë besnikërinë e tyre ndaj saj. Ata asgjë nuk i kundërvunë kësaj vije antemarksiste.

Por një qëndrim i tillë i pavendosur, i paqartë, ekuivok e oportunist nuk mund të japë kurrfarë rezultati pozitiv; përkundrazi, është i dëmshëm dhe mund të shpjerë vetëm në dështim. Dhe në fakt kritikat e argumentet e tyre gjysmake e jokonsekuente, pikërisht sepse ishin të tilla, u hodhën poshtë me lehtësi nga Longoja, Alikata dhe përkrahësit e tyre.

Marksistë-leninistët e vërtetë, që qëndrojnë seriozisht në pozita parimore e revolucionare, në vështirësitë e kontradiktat e lindura në gjirin e revisionistëve toliatistë italianë shohin shenjat e dobësimit e të dekompozimit të këtij grupei renegat, por ata nuk ushqejnë kurrfarë iluzionesh të kota për asnjërrën rrymë. Nuk është hera e parë dhe as e fundit që revisionistët detyrohen të ndryshojnë taktikat e veta e të përdorin pa kursim demagogjinë përballë disfatave e për të shpëtuar nga falimentimi i plotë. Marksistë-leninistët kanë tanimë në këtë drejtim një eksperiencë të gjatë dhe nuk mund t'i mashtrosh. Ata janë plotësisht të bindur se edhe taktikat e reja revisioniste që mund të adoptohen, do të pësojnë të njëjtin fund fatkeq si dhe ato të mëparshmet.

Një gjë është krejt e qartë: PK Italiane, e sunduar nga revisionistët toliatistë, ndodhet në një krizë të thellë. Rruja e daljes nuk është as ajo e Ingraos dhe as ajo e kritikave të druajtura e me gjysmë zëri, por shqelimi i vendosur, konsekuent e parimor i tërë vijës revisioniste të udhëheqjes së PK Italiane, organizimi dhe bashkimi i të gjitha forcave të shëndosha revolucionare për krijimin e një partie të vërtetë marksiste-leniniste të klasës punëtore në Itali. Sido që të përpilen revisionistët, ata nuk do të mundin kurre ta frenojnë këtë proces të pandalshëm, që është pasojë e pashmangshme e tradhtisë së tyre ndaj marksizëm-leninizmit dhe çështjes së socializmit.

Të tillë janë «dhuratat» që po shpien revisionistët toliatistë italianë në kongresin e tyre të 11-të: dështime, vështirësi, kontradikta dhe shkarje gjithnjë e më

thellë në llumin e oportunizmit e të tradhtisë së interesave jetike të klasës punëtore. Janë cinike fjalët e revizionistit dhe likuidatorit me damkë G. Amendola se kongresi i 11-të «nuk është një kongres të mundurish..., por një kongres luftëtarësh që i kanë hapur vete, me gjithë vështirësitë e gjendjes, rrugën e fitores». Ajo «fitore» për të cilën mburret Amendola është vetëm fitore e tradhtisë, e cila mban në vetvete farën e disfatave të reja, akoma më të mëdha, më të rënda e më diskredituese përballë vrullit të pandalshëm të forcave revolucionare në rritje. Revizionistët i pret i njëjti fat i palavdishëm i paraardhësve të tyre, që nga Bernstajni e Kautski e deri te Nikita Hrushovi. E tillë është logjika e pamëshirshme e historisë.

Botuar për herë të parë në gazeten «Zëri i popullit», Nr. 7 (5417), 9 janar 1966

Botohet sipas librit: «E vërteta marksiste-leniniste do të triumfojë mbi revizionizmin», vëll. V, f. 139. Tiranë, 1966

BUROKRATIZMI ëSHTË VDEKJEPRURËS PËR DIKTATURËN E PROLETARIATIT

*Nga biseda me një delegacion të Bankës Popullore
të Kinës*

11 janar 1966

*Pasi u përshëndet me mysafirët dhe i pyeti për
përshtypjet nga vendi ynë, shoku Enver Hoxha tha:*

Miqësia në mes dy vendeve tona është e fortë, e sinqertë dhe vëllazërore. Kjo është arsyjeja që shokët kinezë, kur vijnë te ne, e ndiejnë veten sikur të ishin në atdheun e tyre, në Kinë, ashtu si dhe njerëzit tanë kur shkojnë në Kinë e ndiejnë veten si në Shqipëri.

Takimet tuaja me punonjësit e Bankës së Shtetit Shqiptar dhe të financave kanë shërbyer për shkëmbimin e eksperiencës. Sektori i financave është mjaft i rëndësishëm për zhvillimin e një vendi, prandaj ai duhet perfektionuar vazhdimisht. Kjo arrihet në luftë me konceptet dhe me praktikat burokratike në këtë fushë. Jeta tregon se elementet e burokratizmit që shfaqen në këtë sektor në kushtet e socializmit, futen gradualisht, pa u kuptuar. Pa qenë nevoja, dikush vë një rregull,

tjetri shton një nen, një i tretë diçka tjetër dhe të gjitha këto bëhen gjoja në interes të shtetit socialist, për të ruajtur lekun e popullit, për të mbrojtur pasurinë e përbashkët. Nën këtë maskë lind e rritet dalngadalë një mal i tërë me nene e rregullore, i cili rëndon mbi vijën tonë të përgjithshme dhe, në qoftë se nuk pastrohet me kohë, arrin, siç thonë Lënini e Stalini, që në një moment burokratizmi të zë në grykë.

Mania për të kodifikuar gjithçka dhe tendenca përti besuar më shumë këtij kodifikimi sesa frymës politike, iniciativës dhe kontrollit politik të masave, janë shprehjé të burokratizmit që duhen evituar sa më parë, sepse këto në sektorin e financës ndikojnë drejtpërsë-drejti në gjithë aparatin shtetëror.

Burokratizmi është vdekjeprurës për diktaturën e proletariatit, gjë që na e provon eksperienca e hidhur e Bashkimit Sovjetik dhe e vendeve të ish-demokracisë popullore. Për ta luftuar me sukses atë, është e domosdoshme, që t'i kuptojmë thellë politikisht dhe ideologjikisht problemet, por edhe të jemi vigjilentë, ta mbajmë të pastër aparatin shtetëror.

Me gjithë vështirësitë e shumta që na kanë krijuar armiqtë imperialistë e revisionistë, lufta kundër tyre dhe kundër shfaqjeve të burokratizmit ka bërë që ndërtimi i socializmit në vendin tonë të ecë vazhdimisht përrpara. Në saje të vijës së drejtë marksiste-leniniste, të hovit të madh të Partisë dhe të popullit, u realizuan vepra madhështore përvendin dhe kushtet tona. Kjo trigon për vitalitetin e madh të Partisë dhe të popullit shqiptar, për forcën e shpirtit të tyre revolucionar. Por këto suksese nuk na bëjnë të myllim sytë përrpara shfa-

qjeve negative, të metave tona subjektive dhe dobësive të punonjësve, qofshin këta me parti, ose pa parti. Mbeturinat e të metat që shfaqen në disa nga njerëzit tanë janë rezultat i presionit të brendshëm dhe të jashtëm të armiqve, rezultat i ndikimit të psikologjisë mikroborgjeze, të rrënjosur prej shekujsh, sidomos te fshatarësia. Por mbeturina mikroborgjeze sjellin në Parti e në aparatet e shtetit edhe vetë komunistët, sepse edhe këta vijnë nga shtresa të ndryshme të popullsisë dhe ndeshen me presionin e ideologjisë së armiqve të brendshëm e të jashtëm. Këto mbeturina, në qoftë se nuk luftohen, ndikojnë për të mpirë shpirtin revolucionar të komunistëve. Prandaj Partia i kalit vazhdimisht anëtarët e saj dhe i bën ata që të kenë mprehtësinë dhe vendosmërinë e duhur për të luftuar çdo mbeturinë e shfaqje të huaj porsa të ndeshen me to. Për ta bërë një gjë të tillë ajo kërkon prej tyre të jenë të ngritur politikisht dhe ideologjikisht dhe të kuptojnë në radhë të parë politikën e çdo gjëje. Po nuk e kuptuan këtë, me gjithë vullnetin dhe shpirtin e lartë të sakrificës që karakterizojnë komunistët tanë, do të arrihen disa rezultate, por jo ato që dëshirohen nga Partia.

Në saje të vijës së drejtë marksiste-leniniste të Partisë sonë edhe në sektorin e financave, ashtu si në të gjithë sektorët e tjera, vendi ynë ka arritur suksese të mëdha. Por gjatë veprimtarisë së madhe e të shumanshme të Partisë dhe të shtetit, në punë e sipër mund të bëhen edhe gabime, të cilat nuk na trebin, sepse Partia, porsa i sheh, porsa i zbulon, i ndreq shpejt ato. Duke pasur si busull marksizëm-leninizmin, Partia ndriçon dhe udhëheq drejt të gjitha fushat e jetës, të akti-

vitetit tonë dhe në qoftë se në ndonjë sektor shfaqet një e metë, puna e Partisë e spastron, vë në vend në mënyrë dialektike çdo gjë dhe shëndosh gjendjen.

Partitë marksiste-leniniste, që udhëhiqen dhe ndriçohen nga marksizëm-leninizmi, jo vetëm njojin dhe luftojnë me sukses të metat e gabimet që shfaqen në punën e në të gjithë veprimtarinë e tyre, por janë në gjendje të shohin edhe situatat e vështira në të cilat ndodhen Bashkimi Sovjetik, vendet e tjera ish-socialiste dhe partitë revisioniste që janë atje në fuqi, të kuptojnë e ëdhe demagogjinë e parullat pseudomarksiste që revisionistët modernë i përdorin për të fshehur tradhtinë dhe natyrën e tyre të vërtetë. Nuk kanë qenë të lehtë zbulimi e demaskimi i tradhtisë së revisionistëve sovjetikë, të cilët, për t'u maskuar, kanë përdorur dhe përdorin autoritetin e madh që kishte fituar PK(b) e BS, e udhëhequr nga Lenini e Stalini në revolucion dhe në ndërtimin e socializmit. Partitë marksiste-leniniste mundën ta çajnë mjegullën demagogjike të lëshuar nga revisionistët sovjetikë, ta zbulojnë tradhtinë e tyre, sepse drita e ideve të pavdekshme të marksizëm-leninizmit është depërtuese dhe gris çdo maskë.

Marksizëm-leninizmi na mëson se ata që gabojnë, duhen ndihmuar me durim për t'i sjellë në rrugë të drejtë. Kështu vepruam ne me udhëheqjen sovjetike kur akoma nuk ishim të bindur për tradhtinë e saj. Por kur ajo u fut hapur në rrugën e tradhtisë, ne duhet të kalonim dhe kaluam në një ofensivë të pandërprerë kundër Hrushovit dhe pasuesve të tij, filluam luftën pa kompromis, që do ta vazhdojmë gjer në shpartallimin

e tyre të plotë. Të përpinqesh dhe të shpresosht akoma se revisionistët hrushovianë, titistë, gomulkistë e të tjerë do të heqin dorë nga tradhtia dhe do të vihen në rrugë të drejtëështë mjaft e rrezikshme, sepse përhap e ushqen iluzione dhe dobëson luftën e proletariatit dhe të partive marksiste-leniniste kundër këtyre armiqve të tërbuar të popujve, të revolucionit dhe të socializmit. Kjo është në kundërshtim me partishmërinë proletare dhe me gjithë përbajtjen e teorisë marksiste-leniniste. Partive marksiste-leniniste nuk u lejohet kurrë t'i shkelin parimet, të bëjnë pazarllëqe me to. Në mbrojtjen dhe zbatimin me konsekuencë të parimeve marksiste-leniniste qëndron forca jonë, baza e sukseseve tona.

Revisionistët modernë janë konsekuentë në rrugën e tyre të tradhtisë dhe bëjnë të gjitha përpjekjet për të sabotuar luftën e popujve, revolucionin proletar, për të shkatërruar partitë marksiste-leniniste e vendet socialistë. Për këtë qëllim ata përdorin jo vetëm sulmet e hapëta të tyre, të aventurierëve të ndryshëm dhe të qeverive reaksionare, por edhe organizimin e konferencave e bisedimeve ndërkombëtare, të cilat, sipas tyre, qenkan gjoja në shërbim të interesave të popujve dhe kundër imperializmit!

Tani revisionistët që kanë shkuar në konferencën e Havanës kërkojnë gjoja të forcojnë unitetin e popujve në luftën kundër imperializmit, duke krijuar një organizatë të re afro-aziatike-amerikane, që në fakt synon të sabotojë vetë këtë konferencë dhe luftën çlirimtare të popujve në përgjithësi. Në Havanë revisionistët modernë bëjnë zhurmë për mbrojtjen e Vietnamit, por në të vërtetë synojnë ta shuanë rezistencën e tij dhe të

popujve të tjerë ndaj imperializmit amerikan dhe reakcionit. Por kartat që do të kurdisin ata në këtë konferencë dhe në të tjera si kjo nuk do të bëjnë asnjë efekt, sepse zjarri i madh i vërtetë i frysmezuar nga marksizëm-leninizmi do të vazhdojë të ndizet i fuqishëm nga partitë marksiste-leniniste, nga lufta heroike e Vietnamit dhe e të gjithë popujve të botës.

Edhe takimi i Tashkentit¹ nuk dha asnjë rezultat. Sipas mendimit tonë ky takim ishte një komedi e organizuar pas disfatës së turpshme që pësuan imperialistët amerikanë, indianë e revisionistët sovjetikë dhe tregoi kalbësirën e tyre.

Në bazë të gjithë kësaj veprimtarie, që imediatisht drejtohet kundër Pakistanit, qëndron armiqësia kundër Republikës Popullore të Kinës, qëndron organizimi i komplotit të madh imperialisto-revisionist kundër saj. Ky sulm është një moment i kësaj veprimtarie për realizimin e qëllimit të tyre strategjik kundër Kinës. India e sulmoi Pakistanin e shtyrë nga imperialistët amerikanë dhe revisionistët sovjetikë për të likuiduar pavarësinë e Pakistanit, Ajub Kanin dhe grupin e tij që mbajnë marrëdhënie miqësore me Kinën dhe tregohen dashamirës ndaj saj, po nuk ia arriten qëllimit.

Imperialistët amerikanë dhe revisionistët sovjetikë, kur panë se sulmi i Indisë i kurdisur prej tyre kundër Pakistanit dështoi, u detyruan të tërhiqeshin dhe propozuan organizimin e një takimi për zgjidhjen «paqë-

1 U bë nga 4-10 janar 1966 midis kryeministrat të Indisë, Shastri, dhe presidentit të Pakistanit, Ajub Kan. Në këtë takim mori pjesë edhe kryetari i qeverisë sovjetike, Kosigin.

sore» të konfliktit, sepse ndryshe rrezikoheshin planet e tyre strategjike. Përsëri qëllimi kryesor i këtij takimi është minimi i marrëdhënieve miqësore të Ajub Kanit me Kinën. Por edhe kjo me sa duket s'po u jep rezultat, gjë që është pa dyshim disfatë për ta. Tani sa do të qëndrojë Ajub Kani në fushën e marrëdhënieve të mira me Kinën, është një çështje tjetër. Sa do të rezistojë dhe çfarë taçi i ka vënë në kokë Khonsoni, kur Kani shkoi në SHBA është gjithashtu tjetër punë.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës i lejuan shërbëtorët e tyre, revisionistët sovjetikë, ta bënin këtë takim në Tashkent. Kjo është një taktikë e amerikanëve, jo e sovjetikëve. Kuptohet se, po ta organizonin takimin amerikanët, si agresorët më të mëdhenj e më të egër që kanë fituarurrejtjen e popujve, do të dukej qartë loja, prandaj ranë dakord dhe ngarkuan Kosiginin ta merrte «iniciativën» për takimin e Tashkentit. Çështja ishte të mos zbulohet dora e vërtetë e përgjakur e imperializmit amerikan.

Revisionistët sovjetikë gjer më sot kanë pësuar disfata të turpshme të njëpasnjëshme dhe në gjithë politikën e tyre të brendshme e të jashtme kanë ngrënë vazhdimisht grushte të rënda nga ne dhe partitë e tjera marksiste-leniniste. Në këto kushte të vështira revisionistëve sovjetikë u duhej medoemos një lustër. Për këtë janë të interesuar edhe imperialistët amerikanë, sepse veprimtaria tradhtare e revisionistëve sovjetikë që zhvillohet nën maskën e paqes e të komunizmit u shërbën më mirë atyre në luftën kundër popujve e socialistëve dhe sidomos për të gjunjëzuar popullin e Vietnamit. Prandaj imperialistët amerikanë dhe revisionis-

tët sovjetikë u munduan me të gjitha mënyrat të realizonin njëfarë suksesi, qoftë edhe formal, në takimin e Tashkentit. Po t'i ndiqje me vëmendje çdo ditë punimet e këtij takimi, dukej qartë komedia e luajtur nga imperialistët amerikanë dhe revizionistët sovjetikë. Për rezultatet e tij qe përhapur gjoja një pesimizëm i madh, bile, gjer në orën e fundit agjencitë amerikane dhe ato të vendeve të tjera të Perëndimit jepnin lajmin se takimi i Tashkentit dështoi, se Kosigini nuk arriti asnjë sukses. Por orën e fundit u dha lajmi i bujshëm se takimi ia arriti qëllimit. Kjo paraqitet si një fitore e madhe e udhëheqësve sovjetikë dhe personalisht e Kosiginit, i cili gjoja paska ditur me diplomaci të hollë të bënte që të dyja palët, indianët dhe pakistanezët, të merren vesh në mes tyre dhe të bëhej i mundur nënshkrimi i një deklarate, për popullarizimin e së cilës tanë po i bien daulles nga të katër anët. Miqtë e revizionistëve thonë: «Nuk ka si sovjetikët, ata janë njerëz të zotë, vija e tyre paqësore marksiste-leniniste fitoi!». Këtë «fitore» do ta përdorë edhe propaganda amerikane dhe e vendeve të tjera borgjeze, e cila do të kërkojë që edhe Vietnamit të dëgjojë «këshillat» e të dërguarit të Moskës, Shelepinit, ta pushojë luftën dhe të ulet në tryezën e bisedimeve. Këto janë qëllimet e gjithë kësaj loje, e kësaj komedie.

Por, po ta shikosh me vërejtje, në Tashkent nuk u arrit asnjë marrëveshje për çështjet bazë, në radhë të parë për Kashmirin, problemi i të cilit mbeti pa u zgjidhur. Në deklaratë thuhet se duhet të tërhojen trupat, por nuk përcaktohet se cilët trupa. Dihet se indianët sulmuan, prandaj janë indianët që duhet të

qërohen e të shkojnë andej nga erdhën. Një pikë tjetër e deklaratës rekomandon që të dyja palët të mbajnë marrëdhënie të mira diplomatike. Mirëpo dihet se Pakistani nuk kishte refuzuar ndonjëherë që të kishte marrëdhënie me Indinë. Iшин indianët ata që e hapën konfliktin.

Por megjithëse në thelb takimi nuk zgjidhi asgjë, revisionistët i bëjnë një bujë të madhe për të nxjerrë prej tij përfitime politike, për të mbuluar disfatën që pësuan në aventurën kundër Pakistanit imperialistët amerikanë, ata vetë dhe reaksionarët indianë. Kjo bujë do të vazhdojë edhe për disa kohë, por pa efekt, sepse shpejt ka për t'u dukur përsëri qartë poshtërsia e revisionistëve sovjetikë, agresiviteti i SHBA-së. Këto shihen edhe në bashkëpunimin e tyre në luftën agresive në Vietnam.

Përpara disfatave të njëpasnjëshme që po pësojnë, revisionistët sovjetikë kërkojnë të arrijnë ndonjë fitore, por këto janë si ato të Pirros. Tani ata e kanë drejtuar vëmendjen nga Vietnam. Natyrisht, revisionistët sovjetikë po korrin atje edhe ndonjë fitore, gjersa kanë mundur t'i bindin udhëheqësit vietnamezë që të zhvillohen bisedime me amerikanët. Gjithashtu është një anë tjetër negative ajo që shokët vietnamezë flasin për Bashkimin Sovjetik, për ndihmat e mëdha që gjoja marrin prej tij. Megjithatë, kryesorja është që lufta e popullit në Vietnam vazhdon, kjo ka rëndësi vendimtare. Pavarësisht, pra, nga anët negative që përmenda, dhe këto për mendimin tim kështu janë, sepse i zgjatin ca jetën demagogjisë së revisionistëve sovjetikë, baza është populli dhe lufta që bëhet në Vietnam, ven-

dosmëria e popullit për të luftuar gjer në fitore. Prandaj kemi besim se edhe Shelepini jo vetëm që nuk ka për të nxjerrë gjë me vajtjen e tij atje, por ka për të dalë, siç thotë populli ynë, «si rruar, qethur». Unë e njoh Shelepinin, është njeri pa kurrfarë merite, autoriteti dhe konsiderate saqë të tjerët e përbuznin. Kur isha një herë në Moskë, në një pritje u ndodha në mes disa mareshalëve sovjetikë. Ata flitnin fare lirisht për Shqipërinë, po kur erdhi fjala për Gjermaninë, thanë hapur se atje janë të gjalla tendencat revanshiste. Në këtë kohë erdhi si ndonjë mi në mes nesh Shelepini, u fut në muhabet dhe zuri të bëjë politikë duke thënë se gjermanët janë njerëz të mirë, të zotë. Një nga mareshalët u hodh menjëherë dhe i tha me përbuzje: «Hë more ti, ikë këtej, ku di ti nga këto gjëra, ti do të më mësosh mua se ç'janë gjermanët? Unë e di kush janë ata. Kur unë luftoja kundër tyre, ti i bije maces me lugë» dhe këto ia tha Shelepinit që atëherë ishte ministër i sigurimit të shtetit. Shelepini u zverdh në ftyrë dhe si erdhi, ashtu iku. Nga kjo pashë sa e vlerësonin atë kuadrot.

Ne jemi të sigurt se fjalët e këtij revizionisti nuk do t'i dëgjojë njeri në Vietnam. Llafet e tij apo ato të Kosiginit, i cili është më dinak dhe shumë më i zgjuar se Shelepini, nuk janë gjë tjetër veçse premtimet e kota. Marksistë-leninistët nuk mashtrohen nga demagogjia dhe nga dredhitë e imperialistëve e të revizionistëve, sado të holla që të janë, sepse janë kalitur në rrugën e vështirë, por të lavdishme të zhvillimit të revolucionit dhe të ndërtimit të socializmit në bazë të marksizëm-leninizmit. Për këtë ata kanë dhënë prova

si në Revolucionin e Madh Socialist të Tetorit, në revolucionet proletare në vendet e tjera, japid edhe sot në luftën që bëjnë për të mbrojtur me besnikëri markizëm-leninizmin.

Gomulka na ka dërguar një letër, të cilën përfaqësuesi i ambasadës polake deshi ta dorëzonte «shpejt e shpejt», «me urgjencë», por n'e ia shtymë për disa ditë duke i thënë se «jemi të zënë me punë». Mendojmë se kjo letër do të ketë ndonjë propozim për mbledhjen e përfaqësuesve të vendeve pjesëmarrëse të Traktatit të Varshavës që do të bëhet për të diskutuar për «ndihmën» që duhet t'i jepet popullit vietnamez. Por fjalët e gënjeshtrat e tyre nuk do të kenë asnje sukces, sepse Partia jonë, partitë marksiste-leniniste dhe «i zoti i hanit», domethënë populli vietnamez, nuk do t'i pranojnë këto dredhi e demagogji të revisionistëve, të këtyre bashkëpunëtorëve të imperialistëve amerikanë.

Tradhtia e revisionistëve sovjetikë, natyrisht, i ka sjellë një dëm të madh lëvizjes komuniste ndërkombëtare, çështjes së revolucionit. Por zbulimi i kësaj tradhtie ishte një shërbim i madh që i sollën partitë marksiste-leniniste kësaj lëvizjeje, sepse, po të mos qe zbuluar ajo, revisionistët modernë do të na dëmtonin më shumë.

Çdo ditë që kalon vërteton parashikimin tonë dhe të partive të tjera marksiste-leniniste se këta tradhtarë janë të pandreqshëm, se ata do të lidhen e do të bashkëpunojnë me imperializmin, veçanërisht me atë amerikan, prandaj duhen luftuar gjër në fund, gjër në likuidimin e tyre të plotë. Kjo kërkon që marksistë-leni-

nistët e të gjitha vendeve të forcojnë unitetin dhe të bashkohen në luftë kundër imperializmit dhe revizionizmit modern.

Lufta frontale e partive marksiste-leniniste dhe e tërë proletariatit botëror jo vetëm u shkatërron planet revizionistëve modernë në arenën ndërkombe të, por ndihmon edhe ngritjen e revolucionit në vendet ku revisionistët janë në pushtet. Edhe në BS nuk mund të mos ketë marksistë-leninistë, të cilët duhet të organizohen, sepse forcat e kundërrevolucionit, për të evituar e për të shtypur revolucionin, përdorin jo vetëm demagogjinë, por edhe diktaturën e egër, goditjet e terrorin. Flitet, për shembull, që brenda në Moskë policia ka goditur punëtorët që kanë bërë grevë. Sa është realle kjo nuk e dimë, por që në disa republika sovjetike të Azisë, si në Gjeorgji e Armeni, policia ka goditur demonstruesit, kjo është e vërtetë.

Një gjë tjetër që e vështirëson organizimin e revolucionit, zbatimin e metodave dhe taktikave të luftës kundër armikut nga revolucionarët sovjetikë, është se tradhtarët që janë në fuqi i njojin mirë metodat e punës revolucionare dhe e përdorin këtë njojje për të evituar revolucionin. Por s'ka dyshim se gjatë veprimtarisë revolucionare do të lindin edhe forma të reja për të goditur kundërrevolucionin dhe me siguri metodat e revizionistëve sovjetikë do të dështojnë. Këtë na e provon edhe eksperiencia e madhe e popullit vietnamez, i cili gjatë luftës zbuloi e përdori metoda e taktika të reja që po neutralizojnë armatimet e mëdha moderne të imperialistëve amerikanë, bëjnë të paefektshme raketat, aeroplanët, helikopterët dhe gazrat helmuese.

Ne, marksistë-leninistët, i shohim gjërat realisht. Jeta ka edhe të mira, edhe vështirësi e të këqija, ka edhe gëzime edhe hidhërimë. Lufta që bëjmë për t'i kapërcyer vështirësitë dhe sukseset që arrijmë i japid përmbajtje jetës sonë, e bëjnë të gëzuar e të lumtur. Atë e bën akoma më të gëzueshme lufta që zhvillojmë për revolucionin, për socializmin, për çlirimin e popujve, për imposhtjen e imperializmit, të revisionizmit dhe të të gjitha rrnymave tradhtare antipopullore.

*Botohet për herë të parë si-
pas shënimeve të mbajtura në
këtë takim që gjenden në AQP*

MBLEDHJET TONA DUHET TË JENE KONSTRUKTIVE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH*

17 janar 1966

E kërkova këtë mbledhje për të shtruar dy çështje: përgatitjen e planit të punës të Byrosë Politike dhe format e punës të Sekretariatit të Komitetit Qendror.

I. Përgatitja e planit të punës të Byrosë Politike

Ju, ditët e fundit, shkuat në rrethe në lidhje me çështjen e madhe të shtrimit në Parti të vendimit «Mbi luftën kundër burokratizmit për një metodë e stil revolucionar në punë», prandaj nuk kishit si të preokupo heshit e të mendonit edhe për planin e punës të Byrosë Politike.

Gjatë kohës kur ju dhe shokët e tjerë të Byrosë Politike ishit në rrethe, unë kam menduar ca mbi këtë

çështje. Edhe shokët e Qeverisë kanë menduar dhe më kanë dërguar një listë të problemeve që mendojnë se janë më të ngutshme për t'i analizuar.

Propozoj që preokupacioni ynë kryesor, gjer në thirrjen e Kongresit të 5-të të Partisë, të jetë përgatitja e tij, prandaj t'i vihem i punës menjëherë dhe efektivisht për çdo çështje që ka të bëjë me Kongresin, si për raportet, për vendimet e kandidaturat. Të mendojmë gjithashtu edhe për çështjet organizative të Partisë, si edhe për orientimet që duhen dhënë lidhur me diskutimet.

Në radhë të parë, mendoj të fillohet puna për përgatitjen e tezave të raporteve sepse, sikurse e dini, tezat janë baza e tyre. Na takon, neve, sekretarëve të Komitetit Qendror, t'i formulojmë këto teza sipas sektorëve që drejtojmë. Në këtë punë është e domosdoshme të marrin pjesë edhe të gjithë anëtarët e Byrosë Politike dhe secili, sipas problemeve me të cilat merret në rrugën shtetërore, për përgatitjen e tezave duhet të bashkëpunojë ngushtë me sekretarin e Komitetit Qendror që i ndjek ato probleme. Duhet të përgatiten pastaj edhe tezat për çështjet që i përkasin anës organizative të Partisë. Pra, tezat duhet të hartohen nga ne dhe jo nga vartësit. Këta le të janë ndihmësit tanë, por orientimi, idetë kryesore duhet të jepen nga ne; ne gjithashtu t'i hedhim ato edhe në letër.

Me njëri-tjetrin do të bëjmë edhe diskutime për problemet që do të shtrohen në Kongres për të përcaktuar drejt si, qysh dhe në ç'masë do të shtrohen ato. Pra, secili nga ne duhet të marrë përsipër detyrat që i takojnë dhe të fillojë menjëherë nga puna se koha nuk

pret. Qëllimi është që Kongresi të përgatitet e të zhvillohet në një nivel të lartë.

Edhe për problemet ekonomike, si për ato të bujqësisë etj., në përgjithësi nuk duhet të presim sa të na vijnë zyrtarisht të dhënët, planet, ose të mendojmë që këto më parë t'i diskutojmë në Byronë Politike, pastaj të nisim nga përgatitja e tezave. Kjo pritje më duket është formale, prandaj të fillojmë menjëherë nga puna. Mendoj që me shokët bashkëpunëtorë të përcaktojmë kriteret kryesore për përgatitjen e tezave, se një plan ku mund të bazohemi ekziston.

Sipas meje, pra, gjatë kohës që na mbeten, përgatitja e raporteve të Kongresit duhet të jetë puna jonë kryesore. Kjo nuk eksklidon vajtjen në bazë të shokëve sekretarë të Komitetit Qendror, se gjer në Kongres janë edhe disa muaj akoma. Por, çdo sekretar i Komitetit Qendror, po ta ndiejë nevojën për të shkuar në bazë, duhet të llogaritë se ka, në radhë të parë, një tjetër detyrë shumë të rëndësishme me precedencë mbi të tjerat, përgatitjen e tezave, prandaj edhe atje le të vejë, por vetëm për një kohë të shkurtër. Nuk ka rëndësi vetëm çështja që kjo punë të kryhet medoemos në kohën e caktuar nga secili prej nesh dhe të bëhet mirë, por të kemi parasysh edhe kohën rezervë, se, sado të përpinqet cili do nga ne që ta bëjë mirë këtë punë, përsëri, kur ta shikojmë kolektivisht atë, mund të dalë nevoja për njëfarë rishikimi, mund të rihartohen pjesë përkatëse të materialit etj. Prandaj koha duhet të llogaritet mirë nga të gjithë ne.

Tani na kanë mbetur edhe disa probleme të tjera që duhen shqyrtuar shpejt, siç janë studimi dhe apro-

vimi i planit të katërt pesëvjeçar, si dhe i projektdi-rektivave të këtij plani. Shokët e Qeverisë propozojnë që këto çështje të merren në shqyrtim në muajin shkurt. Jam dakord me këtë propozim.

Mendoj se është gjithashtu e domosdoshme që pas vajtjes suaj në rrethe, ku punuat vendimin e Byrosë Politike «Mbi luftën kundër burokratizmit për një metodë dhe stil revolucionar në punë» (nuk kam parasysh këtu vetëm ju të katër sekretarët e Komitetit Qendror, por edhe anëtarët e tjerë të Byrosë Politike që punojnë në organet qeveritare dhe që shkuan në bazë me këtë rast) të paraqitet një raport tjetër për Byronë Politike, mbi konkluzionet e para që dalin nga punimi i këtij vendimi. Nga punimet që po bëhen në Parti mbi këtë problem të madh dhe nga konstatimet tuaja, nga shembujt që ekzistojnë në sektorë të ndryshëm për shtrembërimet që janë vërtetuar në praktikë në zbatimin e vendimeve dhe të vijës së Partisë, ne duhet të nxjerrim konkluzione politike, teorike dhe organizative. Kjo, më duket mua, është e domosdoshme të bëhet që të shohim se në cilët sektorë është shtrembëruar vija e Partisë, të nxjerrim konkluzionet e nevojshme mbi shkaqet pse kanë ndodhur këto shtrembërime dhe të propozohet çfarë duhet bërë, të thuhet se ç'masa jemi duke marrë e duhet të marrim për të ecur përpara. Kjo punë duhet të bëhet në bashkëpunim me shokët e Byrosë Politike që kanë vajtur në bazë dhe që janë në dijeni të këtyre çështjeve. Pra, mbi këtë bazë, të hartohet rapporti që propozoj t'i paraqitet Byrosë. Konkluzionet duhet të na shërbejnë për të përcaktuar orientime të drejta mbi punën e Partisë, të ci-

lat do të jenë edhe si një parapërgatitje për plenumin që do të bëjmë për këtë çështje pas Kongresit.

Ky raport, mendoj unë, ka lidhje drejtpërdrejt edhe me fushatën për dhënie llogari dhe zgjedhjet e reja në Parti. Konkluzionet e para të punës që është bërë gjer tani lidhur me punimin e vendimit për luftën kundër burokratizmit të na shërbejnë që, kur të shkojmë në mbledhjet e Partisë për dhënie llogari e zgjedhje, ta shtrojmë mirë këtë çështje, t'i themi Partisë konkrektisht si venë punët, në mënyrë që secili ta ketë të qartë ç'duhet bërë dhe diskutimet e komunistëve të zhvillohen në këtë frysë. Pra të vihen në dukje edhe të mirat, edhe të metat që janë vërtetuar në punën e Partisë dhe mbi këtë bazë të zgjidhen edhe njerëzit që do të drejtojnë organizatat e Partisë.

Kam mendimin se duhet të kujdesemi më tepër që në raport të nxjerrim konkluzionet politike dhe ideologjike lidhur me shtrembërimet e vijës së Partisë në drejtimet themelore, në mënyrë që të gjithë të shikojnë qartë ç'dëm të madh i ka kushtuar Partisë sëmundja e burokratizmit, duke filluar që nga kalitja e njerëzve dhe gjer në rezultatet konkrete të planit, që njerëzit të kuptojnë se, po të mos ishte kjo pengesë, rezultatet tona do të ishin shumë më të mëdha në të gjitha drejtimet. Partia, në radhë të parë, por edhe masat, duhet ta kuptojnë mirë se burokratizmi është një sëmundje shumë e rrezikshme.

Një problem tjeter për Byronë Politike mendoj të jetë paraqitja e çështjeve ushtarake në lidhje me reformën që kemi menduar të bëhet. Kam biseduar me shokët e ushtrisë për problemin e drejimit të

Partisë dhe për demokratizimin e vërtetë të jetës së organizatave-bazë të Partisë në ushtri, për rikthimin te funksioni i komisarëve si dhe për heqjen e gradave, por tani këto çështje duhen paraqitur për aprovim në Byronë Politike, duke dhënë edhe arsyet e marrjes së këtyre masave. Lidhur me këto, të përgatitet edhe vendimi përkatës në rrugën shtetërore, nga ana e Presidiumit të Kuvendit Popullor.

Është e nevojshme të diskutojmë dhe të vendosim gjithashtu për Kodin e Punës dhe për problemin e sigurimeve shoqërore. Këto dy çështje mund të shqyrtohen edhe para Kongresit, por mund të lihen edhe pas tij. Shqyrtimi i Kodit të Punës është diçka më e thjeshtë, kurse problemi i sigurimeve shoqërore është më i komplikuar, sepse ka lidhje me pagat, prandaj duhet parë mirë dhe me kujdes. Kodi i Punës mendoj të thjeshtohet, por gjithnjë duke ruajtur parimet.

Çështja e marrëdhënieve midis kooperativave të konsumit dhe kooperativave bujqësore është gjithashtu me rëndësi të madhe. Neve na intereson ta marrim në analizë këtë problem edhe nga ana politike, edhe nga ana ideologjike që të shohim ç'shtrembërime të vijës së Partisë janë bërë në marrëdhëniet midis tyre. Kjo lyp të studiohen mirë këto marrëdhënie dhe t'i shohë qartë, në radhë të parë, Partia, prandaj ne të vendosim se kur mund ta marrim në shqyrtim, përpëra apo pas Kongresit.

Edhe çështja e shpërbimit të punës në kooperativat bujqësore meriton vëmendje të veçantë, prandaj mendoj të merret në shqyrtim përpara Kongresit.

Tani mbeten disa probleme të tjera për t'u paraqitur, siç është ai mbi punën kërkimore-shkencore, për një organizim rrënjosor në këtë fushë. Unë e pasë materialin, titullin e ka të madh, por në të, përmendimin tim, nuk ka asgjë «rrënjosore». Rrënjosore është që instituteve kërkimore-shkencore që kemi, t'u japim mundësi në drejtim të zgjerimit të bazës materiale, për forcimin e lidhjeve të drejtpërdrejta me prodhimin, për bashkëpunim me kooperativat bujqësore etj. Për sa i përket tematikës së problemeve të tyre, kjo mund të caktohet me vendim të Qeverisë, sepse nuk është diçka parimore e asaj shkalle që kërkon medoemos të merret një vendim nga Byroja Politike.

Edhe çështja e metodologjisë së planifikimit në vetvete është problem, por mendoj që këtë ta shqyrtojmë pas Kongresit. Shikojeni dhe ta vendosim.

Është edhe një çështje tjetër, lidhur me perfekcionimin e mëtejshëm të organizimit socialist të punës. Të gjitha problemet që lidhen me këtë çështje kanë rëndësi të madhe, por kjo s'na pengon, sepse propozohet të merret në shqyrtim nga fundi i vitit.

Sipas listës mbeten, pra, vetëm dy probleme që nuk i futim në planin e Byrosë Politike. Këto që ju thashë mendoj se janë të mjaftueshme të merren në shqyrtim nga Byroja Politike gjatë këtyre muajve. Prandaj e kuptioni sa serioze është gjendja, koha është shumë e shkurtër dhe ditët po na ikin pa u kuptuar fare.

Keni ndonjë vërejtje për këto?

Në qoftë se jemi dakord kështu, atëherë mbetet që të caktojmë datat kur do të shqyrtohen këto çë-

shtje, si dhe masat konkrete që duhen marrë për zërthimin e tyre.

Kemi edhe çështjen e sistemit të pagave, e cila ka lidhje edhe me masat që do të merren në ushtri dhe me problemet e tjera shtetërore. Ne do të shkëmbejmë mendime për këto probleme. Jam i mendimit që problemin e pagave ta lëmë më mirë për ta parë pas Kongresit. Të tërë e kuptojnë rëndësinë e këtyre masave, po shkurtimi i organikave dhe çështja e pagave ka edhe anën subjektive. Organikat e Partisë mund t'i marrim në shqyrtim më parë, kurse ato të organeve shtetërore t'i shikojmë në prill. Atëherë duhet të vendosim gjithashtu nëse do t'i vëmë në zbatim menjëherë organikat e reja, apo do ta lëmë këtë çështje për ta zbatuar pas Kongresit.

Direktivën që njerëzit të shkojnë në prodhim Partia e ka dhënë, tani ajo duhet zbatuar. Gjëja më me rëndësi që duhet të bëjë Partia është që këtë problem të madh ta kuptojnë mirë të gjithë. Kjo kërkon që nga organizatat e Partisë të bëhet vazhdimesh një punë e përditshme edukative me të gjithë punonjësit, pa i vënë askujt gishtin, pa thënë ku do të vejë ky ose ai, por duke i përgatitur psikologjikisht të tërë që, me shkurtimin e organikave, çdo punonjës për të cilin do të dalë nevoja të largohet nga vendi që i shkurohet, të shkojë në bazë, në prodhim. Prandaj kushdo të tregohet i gatshëm me ndërgjegje për zbatimin e kësaj porosie, për të shkuar pa hezitim atje ku do të caktohet. Një qëndrim i tillë të konsiderohet si një detyrë e rëndësishme patriotike, si përgjigje thirrjes së Partisë për zbatimin e plotë të vendimit të drejtë të

Komititetit Qendror për zhdukjen e burokratizmit, për lehtësimin e aparateve të pushtetit dhe të Partisë nga njerëzit e panevojshëm. Prandaj t'u bëhet e qartë të gjithëve që çdo kuadër, në momentin kur t'i bëjë thirrje Partia, ta mirëpresë këtë dhe ta zbatojë pa lëkundje. Një punë e tillë sinqeruese përgatitore do të bëjë që njerëzve kjo të mos u vijë papandehur.

Organet e pushtetit dhe Partia do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet që kuadrot t'i vendosin në punë, por secili ka për detyrë të mendojë për çështjen kryesore që na prekupon të gjithëve, për forcimin e sektorëve prodhues. Prandaj në qoftë se një kuadri do t'i thuhet të shkojë në prodhim, ai duhet të punojë për të kalitur ndërgjegjen dhe të shkojë kudo që do të dërgohet në frontin e prodhimit. Një gatishmëri e lartë për të shkuar atje ku e kërkon nevoja e prodhimit, do të jetë një indeks i mirë që do të tregojë sa besnik është kuadri dhe komunisti për vijën e Partisë, sa luftëtar është ai për zbatimin e këtij vendimi, ç'ndërgjegje ka ai për t'iu përgjigjur thirrjes së Partisë me një disiplinë dhe gatishmëri shembulllore. Një punë të tillë duhet të bëjë tani Partia me njerëzit. Në qoftë se kjo punë përgatitore do të bëhet mirë tani, më vonë nuk do të ketë rëndësi kush duhet të shkojë në prodhim dhe kush do të mbetet në administratë, se njerëzit do të janë të përgatitur shpirtërisht, prandaj, kur të fillojë zbatimi në praktikë i vendimit mbi shkurtimin e organikave, çdo gjë do të bëhet me lehtësi. Ky problem duhet të përbëjë objektin politik dhe ideologjik të diskutimeve në mbledhjet e organizatave-bazë të Partisë për dhënie llogari e zgjedhje, të jetë sumumi i tyre. Në këto

mbledhje, të gjithë, pa ditur kush do të shkojë në prodhim dhe kush do të qëndrojë në administratë, të diskutojnë me një fryshtësuar të shëndoshë partie. Puna paraprake, që do të bëhet, do të shërbejë për përgatitjen morale, politike dhe ideologjike të njerëzve që do të venë në prodhim. Zbatimi praktik i vendimit do të vijë më pas dhe nuk do të ndeshë në vështirësi të mëdha.

II. Format e punës të Sekretariatit të Komitetit Qendror

Si mund të vendosim ne një metodë më të mirë pune në Sekretariatin e Komitetit Qendror? Unë mendoj se duhen zgjeruar format e punës dhe të mos mbetemi në formën e vetme e të zakonshme që keimi praktikuar gjer tanë. Ja ç'propozoj:

E para, mbledhja që bëjmë sot, mendoj të jetë një formë pune jona. Në fakt kjo është një mbledhje e rregullt e Sekretariatit të Komitetit Qendror, por pa raport të përgatitur më parë dhe pa ftuar drejtorët e drejtorive të aparatit të Komitetit Qendror dhe njerëz të tjerë. Në mbledhje të tillë, kur të jetë nevoja, ne do të nxjerrim edhe disa konkluzione kryesore, mund të marrim edhe disa vendime.

Një formë e dytë pune mund të jetë mbledhja e Sekretariatit e kërkuar nga çdo sekretar i Komitetit Qendror, për një problem që ai do ta shikojë të arsyeshëm. Edhe në këtë mbledhje të Sekretariatit, e cila mund të jetë e shkurtër si e para, do të diskuto-

het mbi problemin dhe, sipas nevojës, mund të merrret edhe vendim, po me kusht që çështja që do të shtrohet për diskutim e vendim të jetë e rëndësishme dhe për probleme që dalin jashtë kompetencave të sekretarit të Komitetit Qendror, që e shtron atë problem, ose jashtë kuadrit të masave që mund të merren nga dy sekretarë të Komitetit Qendror së bashku, ose jashtë kuadrit të konsultimeve që një sekretar i Komitetit Qendror mund të bëjë me Sekretarin e Parë të Komitetit Qendror. Pra çdo sekretar i Komitetit Qendror mund të propozojë një mbledhje të shkurtër të Sekretariatit për një problem të rëndësishëm.

Një formë e tretë pune, mund të jenë mbledhjet e Sekretariatit të Komitetit Qendror pa raport, duke ftuar ose jo drejtorët e drejtorive të aparatit të Komitetit Qendror. Një mbledhje e tillë mund të bëhet kur dy ose më shumë sekretarë të Komitetit Qendror kthehen nga baza, ku kanë qenë për ndihmë e kontroll. Të tilla mbledhje kanë rëndësi informative lidhur me situatën që ekziston në bazë për një problem të caktuar, ose lidhur me zbatimin e një vendimi dhe masat e mëtejshme që duhet të merren për zbatimin e tij gjer në fund. Natyrisht, sekretari i Komitetit Qendror, para se të shkojë në rreth për një problem të caktuar, duhet të përgatitet mirë në bazë të një plani. Nuk duhet shkuar në rrethe pa plan, apo për gjëra të vogla që na dalin përpëra. Kur të kthehet në qendër, ai duhet të raportojë në Sekretariat si e ka zbatuar planin dhe të paraqesë konkluzionet e punës që ka bërë, por pa u futur në cikërrima. Edhe

për çështje të kësaj natyre ne mund të marrim vendim në Sekretariat, por, natyrisht, kur një vendim i tillë të jetë i domosdoshëm dhe jo i përsëritur. Në mbledhje të kësaj natyre të Sekretariatit të Komitetit Qendror duhet të vlerësohet edhe puna që ka bërë sekretari që ka shkuar në rreth, me qëllim që t'i jepet ndihmë nga shokët e tjerë sekretarë. Kuptohet që vajtja e një sekretari të Komitetit Qendror në bazë duhet të konsiderohet si një ngjarje me rëndësi për rrethin dhe puna e tij gjatë qëndrimit atje duhet të ndihet. Prandaj ka rëndësi të madhe që përgatitjet të bëhen si duhet para nisjes, që edhe kur të vejë në vend ta përmirësojë gjendjen, edhe kur të vijë në qendër t'i bëjë Sekretariatit të Komitetit Qendror një raport informativ, ku të vërë në dukje problemet që kanë dalë, të tregojë si zbatohet vija e Partisë, nëse ka raste që është shkelur apo jo etj. Natyrisht, raporti që do të jepet në Sekretariat do të shihet me sy kritik, prandaj shokut që ka shkuar në bazë duhet t'i kërkojmë çfarë gjëra ka parë, t'i vëmë në dukje mungesat në punën e tij, çështjet që nuk i ka kapur e që duhet t'i shikonte, çështjet të cilave nuk u ka shkuar gjer në fund etj. Me një fjalë në këto mbledhje do të bëhet edhe vlerësimi i punës së sekretarit të Komitetit Qendror që ka shkuar në rreth, me qëllim që ai të ndihmohet. Siç thashë, sipas rastit, në Sekretariat mund të merret vendim, kur është e domosdoshme, por mund edhe të mos merret; në mbledhje mund të janë të pranishëm drejtörët e drejtoreve të aparatit të Komitetit Qendror, edhe mund të mos janë.

Forma e katërt, mendoj të jetë mbledhja me ra-

porte. Në të tilla mbledhje do të marrin pjesë drejtoret e drejtorive të aparatit të Komitetit Qendror dhe të ftuar të tjerë, të cilët kanë lidhje me problemet që ngrihen në raport. Natyrisht, raporti duhet të jetë i qartë. Ai mund të jetë i shoqëruar edhe me projektvendim, në qoftë se për problemin që do të shqyrtohet nuk ka ndonjë vendim të mëparshëm, të njëlllojtë me të. Në qoftë se ka, atëherë raporti duhet të shërbejë si një material informativ për Sekretariatin dhe si ndihmë për sektorët për të cilët do të bëhet fjalë.

Pra, mendoj që në të ardhmen të përdorim katër forma mbledhjesh pune të Sekretariatit, nëpërmjet të cilave Sekretariatin do ta mbajmë në dijeni mbi çështjet që vërtetohen gjatë zbatimit të vendimeve. Ka rëndësi të kemi parasysh se situata e rëndë, që ka lidhje me burokratizmin, për zhdukjen e së cilës tan po marrim masa, na u krijua edhe për faktin se këtu nuk e kishim në rregull këtë çështje. Në qoftë se në të ardhmen do të bëjmë një punë më të organizuar dhe në bazë do të ushtrojmë një kontroll më të rregullt e do të japim një ndihmë më të efektshme, gjëra të tilla të dëmshme nuk kanë për të na ndodhur.

Kur theksoj të kemi kurdoherë parasysh kontrollin e zbatimit të vendimeve, me këtë nuk dua të them se ne nuk e kemi pasur në vëmendje këtë çështje, por, kur ne t'u japim më shumë rëndësi mbledhjeve të Sekretariatit, ku të bëhet raportimi i punës së kryer në bazë nga ana e sekretarit të Komitetit Qendror dhe puna e tij atje të shihet në mënyrë kritikë, kur këtu të bëhen edhe konkluzione mbi këtë punë, atëherë kontrolli do të shërbejë për ta ndihmuar më mi-

rë edhe bazën, edhe shoku-shokun. Në këtë mënyrë kur ne të pesë sekretarët, pasi të jemi kthyer nga baza, të raportojmë këtu në mbledhjen e Sekretariatit, të bëjmë edhe vlerësimin e punës së njëri-tjetrit, atëherë te çdonjëri nga ne do të forcohet më shumë ndjenja e përgjegjësisë që kemi. Edhe përpala ndihej përgjegjësia nga secili prej nesh kur shkontë në bazë, por kur ktheheshim, për punën e bërë atje, diskutonim si në këmbë, kurse tani e tutje këto çështje do t'i shikojmë me një seriozitet më të madh në Sekretariat, me qëllim që të këmbejmë mendime dhe të marrim vendime të shpejta e të drejta, në përshtatje me situatat konkrete.

Në të gjitha rastet, për çdo sekretar të Komitetit Qendror, për drejtoret e drejtorive të aparatit të Komitetit Qendror dhe për të ftuarit e tjerë që do të vijnë në mbledhjen e Sekretariatit, çështjet kryesore të raportimeve dhe të diskutimeve të tyre do të janë dy: **c** para, kontrolli i zbatimit të vendimeve dhe i direktivave të lëshuara nga Komiteti Qendror dhe, **c** dyta, kontrolli i ruajtjes së vijës së Partisë gjatë punës në praktikë.

Këtë detyrë ne e kemi pasur edhe më përpala, por, me sa po shohim, nuk e kemi kryer si duhet. Tani po nxjerrim një mësim të madh që tregon se në praktikë nuk e kemi ndjekur me seriozitetin e duhur kontrollin e zbatimit të vendimeve dhe të direktivave të Partisë. Raportet dhe diskutimet tonë të mos mbushen tejetej me shembuj të mirë e të këqij, por ata të shërbejnë për të argumentuar mirë këto dy çështje bazë edhe vendimin që propozohet të merret.

Në punën tonë të nisemi nga parimi që çdo sekretar i Komitetit Qendror në sektorin e tij të ketë të drejtën të zbatojë pa kufizim kompetencat dhe përgjegjësitë që i ngarkohen dhe të përgjigjet për veprimet e tij përpara Sekretariatit sa herë që ky do ta gjykojë të nevojshme. Pra sekretari i Komitetit Qendror të jetë kompetent pa asnjë kufizim për sektorët që drejton dhe të japë shpjegime përsë ka vepruar kështu apo ashtu, ka bërë mirë apo ka bërë keq. Këtë ai ta bëjë përpara Sekretariatit të Komitetit Qendror. Këto kompetenca janë të domosdoshme t'i ketë ai, se ka gjëra që nuk presin sa të bëhet mbledhja e Sekretariatit, pasi duhen zgjidhur menjëherë. Prandaj, si përgjegjës për sektorët që i janë ngarkuar, sekretari i Komitetit Qendror merr përgjegjësi dhe vendos për zgjidhjen e një problemi dhe, kur vjen koha, raporton në Sekretariat si i ka zbatuar kompetencat, atje jep edhe arsyet e masave që ka marrë. Në mbledhje, po të ketë ndonjë çështje që nuk e ka zgjidhur drejt, ai do të kritikohet dhe do të ndihmohet.

Përcaktimi i kompetencave nuk përjashton aspak konsultimet e sekretarit të Komitetit Qendror me një sekretar tjetër të Komitetit Qendror dhe koordinimin e punëve me njëri-tjetrin, bile një gjë e tillë është e domosdoshme të bëhet. Këshillat reciproke janë të nevojshme, por ato kurrsesi nuk duhet të pengojnë kompetencat e atij që i ka.

Nga ana tjetër, çdo sekretar i Komitetit Qendror është njëkohësisht përgjegjës edhe për zbatimin e vendimeve të Sekretariatit, të marra kolegjialisht si udhëheqje, jo vetëm për ato që kanë të bëjnë me sek-

torin e tij, po edhe për problemet e një sektori tjetër, megjithëse drejtpërsëdrejti është tjetërkush që përgjigjet për atë sektor. Pra, kur merren vendime kolegiale, të tërë kemi të drejtë dhe detyrë t'i ndjekim e të shohim si zbatohen ato, se përgjegjësinë e kemi të përbashkët. Kjo nuk duhet të kuptohet as si ndërhyrje, as si ortakllëk në përgjegjësitë e njëri-tjetrit, por të kuptohet dhe të zbatohet drejt, se kompetencat nuk janë të ndara me mur, vija e Partisë është një dhe e vetme dhe për zbatimin e saj jemi përgjegjës që të gjithë, individualisht e kolektivisht.

Në bazë të këtyre parimeve ta organizojë punën e vet çdo sekretar i Komitetit Qendror edhe me varësit. Nga një punë e organizuar mirë nga çdo sekretar i Komitetit Qendror dhe bashkëpunëtorët e tij, në sektorët që drejton secili, varet edhe puna e mirë dhe e efektshme e Sekretariatit dhe e Byrosë Politike. Ndryshe, pa një punë të mirë të secilit nga ne, edhe puna e forumeve do të çalojë. Të kuptohet mirë se rëndësia më e madhe e drejtimit kolegjial qëndron në dhënen e orientimeve dhe në marrjen e vendimeve. Prandaj ne kemi përgjegjësi të madhe për vendimet që marrim, sidomos për ndonjë vendim, drejtësia e të cilit nuk është vërtetuar në jetë. Për këtë duhet të nxjerrim arsyet përse është marrë dhe të mendojmë e të propozojmë masat që duhen realizuar për ta korrigjuar atë.

Mbledhjet e udhëheqjes së Partisë janë të frytshme, kur bëhen në kohën e duhur dhe për çështje të rëndësishme që i diktojnë situatat dhe nevojat reale. Këto situata nuk mund të imagjinohen prej kohësh, ato diktohen ngajeta, nga lufta dhe nga kushtet e reja që

krijohen vazhdimisht. Për të përcaktuar drejt problemet që i duhen paraqitur udhëheqjes për shqyrtim, del nevoja të kuptojmë mirë se ç'rëndësi dhe ç'përgjegjësi të madhe ka puna e sekretarëve të Komitetit Qendror dhe e bashkëpunëtorëve të tyre, individualist dhe kolektivisht, në hartimin e tematikave. Për të organizuar secili mirë punën në këtë drejtim, rëndësi ka edhe forma e punës. Në qoftë se sekretari i Komitetit Qendror punon mirë për përgatitjen e projekt-vendimit që do t'i paraqitet forumit, atëherë edhe vendimet që do të merren do të jenë të mira, të drejta dhe do të shërbjnë. Përkundrazi, në qoftë se ai nuk punon mirë, kjo do të ndikojë negativisht edhe në marrjen e vendimeve. Një gjë e tillë ka rëndësi edhe për shokët që punojnë në aparatet e pushtetit.

Ne sekretarët e Komitetit Qendror kemi përgjegjësi të madhe për nxjerrjen e konkluzioneve politike, ideologjike dhe organizative nga problemet që ndjekim. Prandaj si rregull, ne duhet të na preokupojnë çështjet kyçë të Partisë, por edhe çështjet që duken si të vogla mund t'i shohim, kur këto na vlejnë për të nxjerrë konkluzione.

Të gjitha këto që thashë për mbledhjet, mendoj se nuk janë një çështje formale. Mbledhjet tona duhet të jenë konstruktive, të kenë brumë, të jenë me përmbytje. Po të veprojmë ndryshe, puna jonë, si udhëheqje, do të kthehej në punë praktike dhe kjo do të ishte e rrezikshme, ashtu sikurse është e rrezikshme po të përdoret vetëm forma e vjetër e punës që ndiqej në Sekretariatin e Komitetit Qendror, ajo e mbledhjeve vetëm me raporte, me plot të ftuar dhe shpesh me

probleme që ishin planifikuar që në fillim të vitit e që nuk ishin të kohës ose nga më preokupantet. Kjo formë pune nuk është e përshtatshme. Ne rrnim e mendonim ç'probleme do të merrnim në shqyrtim gjatë vitit. Po çdo sektor ka shumë probleme e ne përpinqeshim t'i radhitnim, u thoshim edhe shokëve më poshtë dhe ata na propozonin të futej në plan ky apo ai problem. Kështu na bëheshin shumë çështje për t'u paraqitur. A ishin këto problemet më preokupante, këtë nuk mund ta gjykonim si duhet një vit a shumë muaj përpara. Kur se Sekretariati duhet të jetë një organ operativ. Jeta, puna, kërkesat dhe nevojat i imponojnë atij problemet që duhet të shqyrtojë. Bile edhe pasi kishim përgatitur planin, jeta vazhdimisht na ka diktuar edhe probleme të tjera. Përsëri në të ardhmen jeta do të na nxjerrë probleme të tilla që edhe pa kaluar tri ditë nga një mbledhje e Sekretariatit, mund të detyrohemë të mbli-dhemi prapë për të shqyrtuar një problem që as e kemi menduar fare.

Nuk di ç'vërejtje keni ju për sa parashtrova, por mendoj se jeta do të na mësojë ta perfektionojmë vazhdimisht metodën tonë të punës dhe nëse i kemi drejt apo jo format që propozoj. Gjatë zbatimit në praktikë të këtyre formave të punës, ne do të shohim nëse e kemi ndihmuar Partinë me to apo jo. Jeta do të na mësojë të gjejmë më pas forma të tjera të reja, të cilat gjithashtu duhet t'i perfektionojmë më tej. Thelbi i çështjes nuk qëndron te forma, por te parimet, këto ne duhet t'i mbrojmhë.

Ja, për shembull, për dy problemet që diskutuam sot, përse duhet tëjenë medoemos në Sekretariat të

gjithë drejtorët? Çdo shok sekretar do të reflektojë për këto probleme, pastaj do të thërrasë drejtorët që varen prej tij dhe do t'i udhëzojnë si të veprojnë. Ka raste, pra, që është më mirë të veprohet kështu, sesa t'i thërrasim këtu të tërë. Kështu bashkëpunëtorët tanë do të shikojnë se vërtet nuk u thirrën në mbledhje, por sekretari i Komitetit Qendror nga i cili varen i thirri dhe u shtroi një numër problemesh, duke i vënë në lëvizje për shumë gjëra.

Pra, kështu mendoj të veprohet. Të gjejmë metoda pune dhe veprimi të dobishme për zgjidhjen e problemeve, t'i luftojmë format dhe mënyrat që nuk na japid rezultate. Duke na parë kështu, edhe shokët tanë në bazë do të veprojnë në shembullin tonë.

Ndryshe do të jetë puna për mbledhjet e Byrosë Politike. Çështjet që do të marrë ajo në shqyrtim, duhet t'i parashikojmë, t'i diskutojmë e t'i përcaktojmë, sepse vendimet e Byrosë Politike janë orientuese edhe për ne, për Sekretariatin. Prandaj, problemet që do të merren në shqyrtim në mbledhjet e Byrosë Politike, do të kërkojnë raporte e projektvendime, mbasi vendimet që do të marrë ajo do të konkretizojnë orientimet e dhëna në Kongresin e Partisë për çështjet për të cilat do të nevojiten të lëshohen udhëzime edhe për ne në Sekretariat. Ne duhet të kemi parasysh që shokët e Byrosë Politike që punojnë në Qeveri, kanë kompetencia dhe mbajnë përgjegjësi përpara Byrosë Politike për sektorët që drejtojnë dhe jo t'i ndajmë bashkërisht përgjegjësitë. Për problemen e pagave, për shembull, e kanë ata për detyrë t'ia paraqesin materialin përkatës Byrosë Politike.

Nuk e kam fjalën që në Byronë Politike të mos marrim në shqyrtim çështje ekonomike, jo, po të marrim çështjet kyçë, për të cilat do të punojë edhe Qeveria. Ne në Sekretariat duhet t'i kombinojmë këto gjëra. Nga Partia duhet kontroll politik, ideologjik dhe nxitje për zbatimin konkret të planit. Puna jonë duhet të anojë më shumë nga kontrolli i zbatimit të vendimit dhe i vijës së Partisë në drejtimet që thashë, por ama jo në mënyrë formale. Në qoftë se na del përpara një problem financier, ta shqyrtojmë edhe këtë çështje dhe të vendosim që ai të zbatohet mirë, por për zbatimin teknik përgjegjësinë ta mbajnë shokët e Qeverisë. Në qoftë se çështjet teknike na dëmtojnë vijën, atëherë duhet të ndërhyjmë menjëherë, njëkohësisht të shkojmë edhe më organizatat-bazë përkatëse të Partisë për të kërkuar nga komunistët përsë nuk i kanë parë këto çështje që cenojnë vijën e Partisë, përsë nuk kanë marrë masa për normalizimin e gjendjes dhe për të njoftuar organet më të larta të Partisë. Dhe jo të na paraqitet këtu për të marrë në shqyrtim çështjen e sharrave në atë formë që i takon ta shqyrtojë Qeveria.

Në Sekretariat ne të shkojmë çfarë masash partie, politike, ideologjike dhe edukative duhen marrë për mobilizimin e njerëzve për të evitar ato anë negative që krijojnë një situatë jo të mirë. Këto masa të vihen në funksion të realizimit të planit, sepse kështu do të shkojë mirë realizimi i tij.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH që gjendet në AQP

VEPRIMI JUAJ SIMBOLIZON VËLLAZERIMIN E POPUJVE TANË

Letër drejtuar mikes së Shqipërisë, Bozena Neumanova

17 janar 1966

Fort e nderuara dhe e dashura shoqe Neumanova,

Letra juaj më solli përsëri dashurinë e flaktë dhe miqësinë e rrallë që zemra juaj bujare ushqen për popullin shqiptar, për vendim e shqiponjave, siç e quajnë Shqipërinë tonë dashamirësit e saj, siç jeni ju, siç ka qenë i paharruari bashkëshorti juaj, S.K. Neuman.

Fjalët tuaja të thjeshta e të singerta më gjëzuan pa masë. Më gjëzuan dhe më prekën sepse ju, shoqe Neumanova, e sëmurë u ngritët nga shtrati dhe, si një trimëreshë që është e zonja të mposhtë vuajtjet fiziike me dashurinë për jetën që ruan në thellësitë e shpirtit të saj, shkuat në përfaqësinë tonë në Pragë për të shprehur urimet e zjarrrta, për të festuar, si të thuash në shtëpinë tonë, festën e lirisë së popullit shqiptar. Ky gjest simbolizon atë realitet të madh që flet për vëllazërimin e popujve tanë, vëllazërim që, sado të rënda të jenë situatat, nuk do ta ftohin e nuk do ta

shuajnë dot armiqtë e përbashkët, revisionistët hrushovianë, titistë e të tjerë.

Me këtë rast, me gëzim ju njoftoj juve, si mike besnikë e popullit tonë që shoqëroni me rrahjet e zemrës suaj optimiste dhe entuziaste përparimet dhe lulëzimin e vendit tonë, se Partia dhc populli shqiptar e mbyllën me sukses planin e tretë pesëvjeçar, duke kapërcyer me vendosmëri vështirësitë e mëdha të bllokadës së tërbuar të revisionistëve hrushovianë e të imperialistëve dhe përgatitën planin e ri pesëvjeçar, që do ta bëjë më të begatshme e më të bukur Shqipërinë. Këto ditë, më 11 Janar, ne festuam 20-vjetorin e Republikës sonë Popullore, e cila është bërë më e fortë e më trime. Forca e urtësia e saj qëndrojnë te besnikëria ndaj marksizëm-leninizmit, te populli, te miqtë e saj të shumtë në të gjithë botën, midis të cilëve ju zini një vend nderi.

E nderuara shoqja Neumanova,

Nexhmija, fëmijët dhe unë ju falënderojmë me gjithë zemër për urimet që na dërgonit me letrën tuaj e urojmë që zemra juaj të rrahë gjithmonë për gëzime. Ju urojmë, si gjithnjë, shëndet dhe të gjitha të mirat!

Juaji

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë si-pas originalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TA KALITIM EDHE FIZIKISHT POPULLIN PËR MBROJTJE¹

20 janar 1966

Partia bën një punë të madhe me rezultate të shkëlqyera për edukimin politik të masave. Këto janë të ngritura politikisht, e kanë mprehur vigjilencën kundër armiqve të jashtëm e të brendshëm dhe mbahen vazhdimisht në korent të gjendjes ndërkombëtare. Ato e njojin mirë ftyrën e egër të imperializmit, me atë të SHBA-së në krye, ndjekin me kujdes përgatitjet që bën ky përnjë luftë tjetër botërore, kësaj here atomike, duke fillouar nga luftëra lokale, luftëra të veçanta ose speciale për të mbërritur tek e madhja. Masat e popullit, në saje të punës politike dhe propagandistike që bën Partia, njojin mirë ftyrën e ndyrë të revisionistëve modernë hrushovianë, titistë etj., qëllimet, manovrat, takтикat dhe planet e tyre, njojin mirë dhe me faktë aleancën e fshehtë dhe të hapët me imperializmin amerikan, bashkëpunimin e tyre, renditjen dhe koordinimin e vepriimeve kundër nesh, kundër popujve, kundër marksizëm-lininizmi^t dhe paqes.

E gjithë kjo punë svaruese, e përditshme, bëhet e

¹ Ky material ka qenë përgatitur për një bisedë me kuadro.

do të bëhet më intensivisht nga Partia. S'ka dyshim se kjo punë ka edhe të meta që duhet të zhduken. Për këtë propaganda e puna politike të bëhen praktike, të thjeshta, të qarta, masive dhe të zhvishen nga formalizmi, frazeologjia boshe, e shterpët nga idetë dhe stereotipe nga format, nga stili e metoda.

Në përgjithësi e gjithë kjo punë është e lidhur ngushtë me kalitjen, me mbrojtjen e pastërtisë së Partisë, me forcimin e unitetit, ajo është e lidhur ngushtë me ndërtimin ekonomik socialist të vendit, ajo është e lidhur ngushtë gjithashtu edhe me mbrojtjen e atdheut nga armiqtë e jashtëm e të brendshëm.

Mirëpo, një nga të metat e punës politike te ne është se ajo nuk lidhet sa duhet konkretisht dhe kurdoherë me nevojat e kohës për mbrojtjen e atdheut, dua të them që në çdo çast, dhe sidomos në këto momente politike që kalojnë bota dhe vendi ynë, çdo gjë që bëhet, çdo vendim, çdo punë e veprim, të lidhet me interesat e larta të mbrojtjes së atdheut tonë socialist nga armiqtë, domethënë çështja e mbrojtjes të zotërojë në mendjen, zemrën dhe në ndërgjegjen e çdo njeriu dhe në funksion të kësaj ideje të madhe të vihen të gjitha energjitet fizike, mendore e shpirtërore të popullit tonë.

Prandaj mendoj se është urgjente dhe e domosdoshme, që Partia ta rishikojë rrënjosisht këtë çështje, ta riforcojë punën e agitacionit dhe të propagandës në këtë drejtim, duke gjetur forma mendimi e veprimi nga më të përshtatshmet për çdo sektor. Mendoj se nuk mund të jenë të mjaftueshëm një ose dhjetë artikuj në gazetë, nuk mund të jetë i mjaftueshëm ndryshimi kryekëput e me një frymë të re i të gjitha parullave

që shkruhen në beze, në mure, në tabela. Këto duhet të bëhen me një qartësi e intensitet të tillë që të orientohen dhe të veprojnë drejt gjithë komunistët dhe masat, duhet të bëhen me qëllim që Partia dhe masat të kenë para syve të tyre lajtmotivet kryesore për këtë çështje të madhe lidhur me punën dhe mendimin politik të çdo çasti. Mendoj se çështja e mbrojtjes së atdheut socialist nuk qëndron në parullat, por në punën sistematike, derisa ajo të bëhet shprehi absolute për çdo qytetar, të vogël e të madh.

Që të bëhet kjo, puna politike e Partisë duhet të jetë e gjerë dhe e thellë e t'i zgjidhë këto çështje jo në mënyrë burokratike, por në mënyrë revolucionare. Me këtë dua të them që Partia të mos kënaqet me disa ndryshime frazash e parullash të vjetruara e të thotë se e kreu detyrën, por kjo ide duhet ta rrethojë qytetarin e Republikës sonë dhe ta ndjekë që kur zgjohet në mëngjes e derisa bie të flejë në mbrëmje, ta ndjekë në shkollë, në punë, a në kohën e lirë kur merret me sport, teatër, kinema, kur bisedon me miqtë e me shokët, në klub, në shtëpi, kudo e në çdo kohë.

Kuptohet sa të efektshme bëhen propaganda e agitacioni kur ndërtohen rrjedhshëm, kur përputhen me jetën, me luftën, me idetë, kur përshtaten me kohën, kur paraqitet si një anë krejt e zakonshme e çdo gjëje çështja e mbrojtjes së atdheut tonë socialist. Një propagandë e tillë e zgjuar, dinamike, ngre lart ndërgjegjen e njerëzve, i edukon ata dhe nuk i mërzit. E kundërta ka për të ngjarë në rast se propagandën e kuptojmë si një punë boshe, prej llafazanësh, demagogësh e njerëzish pa ide e të ngathët. Propaganda jo-

në komuniste nuk mund të pranojë, përkundrazi ajo duhet t'i luftojë fort ngathtësinë, shterpësinë në mendime, formalizmin në stilin, në të menduarit dhe në veprimet praktike. Nga këto të meta vuan shumë propaganda e Partisë sonë. Në praktikë ndodh edhe një gjë tjetër, që propaganda disa herë shikohet dhe zhvillohet në mënyrë të shkëputur për një sektor pune ose për disa aktivitete dhe nuk ndjehet e nuk koordinohet në atë masë që të ndikojë si duhet në të gjithë sektorët dhe të zhvillohet kështu në të gjitha drejtimet, të ndiqet e të kontrollohet më mirë, me qëllim që një sektor të ndikojë mbi tjetrin në kohën e duhur. Ndryshe edukimi do të bëhet me hope, me fushata, ku njëri zhvillon një ide të mirë dhe lufton për të, tjetri qëndron tre vjet prapa. Këtej lind prapambetja në mendime e në veprime, nuk ecet kudo me ritmin e kohës dhe puna edukative nuk u përgjigjet më rëndësisë së problemit, rëndësisë së momentit.

Pra, duke e mbajtur gështjen e mbrojtjes së atdheut në qendër të propagandës sonë të shumanshme, ajo mund dhe duhet të na ndihmojë ne si rregullator i fuqishëm jo vetëm për këtë problem të madh në vete, por edhe si organizues i propagandës së Partisë për shumë probleme të tjera që tanë realizohen, por jo me atë gjallëri e shpirt revolucionar që kërkohet, jo vetëm në zhvillimin e ideve, por edhe në zbatimin praktik të këtyre ideve.

Të vijmë konkretisht edhe te kalitja fizike e mësave për mbrojtjen e atdheut. Duhet të njohim atë të vërtetë se ne, udhëheqja, asaj nuk i kemi kushtuar vëmendjen e duhur. Kemi marrë disa masa, janë caktuar

edhe fonde, janë zhvilluar edhe disa sporte dhe, po ta shikojmë këtë çështje me të kaluarën, s'ka krahasim, por duhet thënë se kultura fizike te ne është akoma shumë prapa. Te ne mund të themi se tifozë kemi boll, por ata që merren efektivisht me sport, relativisht jo vetëm janë të paktë, por edhe trajtohen si njerëz që «trutë i kanë në këmbë» dhe «bëjnë sport se janë të pazotë të bëjnë një punë tjeter».

Pra, padashur del se sporti te ne është «profesionalist» pa qenë i tillë, ose del që vetëm po të bësh pjesë në ndonjë skuadër futbolli a tjeter, je «sportist». Llojet e tjera të sporteve konsiderohen si të parëndësishme, sepse amatorët janë shumë të paktë. Sporti te ne duhet të përfshijë masat e gjera, e jo të mbetet i myllur, i kufizuar si në kuptimin, ashtu edhe në zbatimin e tij. Kjo do të ishte shumë e keqe për kombin tonë. Gjenda e sporteve te ne duhet të ndryshojë absolutisht dhe që të ndryshojë duhet të bëhet një kthesë rrënjosore, në radhë të parë në kuptimin e drejtë ideopolitik të sportit dhe të kulturës fizike dhe krahas kësaj në organizimin praktik të tyre. Do të ishte gabim dhe nuk do të arrinim rezultatet e duhura në rast se do ta fillonim këtë punë duke kërkuar më parë fonde, vetëm duke kërkuar stadiume, të cilat edhe janë ndërtuar, por në to venë fare pak njerëz të ushtrojnë vetë sportet e ndryshme, kurse më shumë shkojnë vetëm për sehir.

Çdo lloj sporti, mendoj unë, ka në bazë kulturën fizike. Duhet të zhvillosh pareshtur trupin me ushtrime fizike që të mundësh të zhvillosh një sport të veçantë. Mund ta fillosh punën edhe nga një sport i veçantë, po kulturës fizike nuk mund t'i shpëtosh, atë duhet ta

praktikosh patjetër. Por nuk është e mundur që e gjithë bota ta fillojë këtë gjë nga një sport i veçantë, por mund dhe duhet që të gjithë, i madh e i vogël, plak e i ri, ta fillojnë nga kultura fizike. Kjo gjë nuk bëhet si duhet në vendin tonë, pse nuk vlerësohet, kjo i sjell dëme serioze e të mëdha shoqërisë sonë.

I vetmi shembull i mirë dhe i vetmi vend ku zhvillohet si duhet kultura fizike, është ushtria. Atje, gjatë gjithë kohës së shërbimit ushtarëk, si nëpërmjet ushtrimeve, ashtu edhe në mënyrë të veçantë, kultura fizike dhe sportet zhvillohen në mënyrë masive, dhe e gjithë kjo punë zhvillohet nën parullën «për mbrojtjen e atdheut». Pra, përgatitja e ushtarit kërkon medoemos kalitjen e tij fizike. Kështu, që të jesh ushtar i mirë për atdheun e popullin, duhet ta kalitësh trupin fizikisht, të mos sëmuresh kurrë, të durosh çdo situatë të vështirë në çdo moment dhe ta kapercesh atë, të jesh i zoti të rendësh, të flesh, të luftosh në borë, në shi, më furtunë, në diell, i veshur e i zhveshur, me këpucë e pa këpucë, i ushqyer ose i uritur. Këtë gjë e lyp mbrojtja e atdheut. Ky është frymëzimi i madh politik i Partisë për ushtrinë dhe ushtari ynë frymëzohet orë e çast nga ky parim, ditën dhe natën, kur bën ushtrime dhe kur ha, kur vete në dhomën e leximit e në kinema, kur takohet me familjen ose në biseda të lira.

A bëhet kudo në sektorë të tjera në Republikë një gjë e tillë? Jo nuk bëhet; mund të themi pa u gabuar se s'bëhet fare sidomos në zyra, në ndërmarrje, në fabrika etj, Të bësh fizkulturë çdo ditë, është një çështje personale, e gjithsecilit. Kjo është e vërtetë, po jo gjithë e vërteta. Të bësh fizkulturë është një detyrë personale,

por njëkohësisht është edhe një detyrë patriotike, një detyrë e përbashkët kombëtare. Forca e gjallë e atdheut qëndron te njerëzit. Sa më të fortë të jenë ata fizikisht, aq më i fortë është atdheu; sa më të fortë fizikisht të jenë njerëzit, aq më mirë do të mendojnë, aq më mirë dhe aq më shumë do të punojnë e do të prodhojnë. Sa më të fortë e të kalitur do të jenë njerëzit, aq më pak do të vuajnë në vështirësi, aq më mirë, më shpejt dhe më me guxim e sukses do t'i kapërcejnë vështirësitë, pengesat, fatkeqësitet që do të takojnë në jetë ata vetë dhe atdheu i tyre.

Këtej, pra, del çështja që kultura fizike masive e gjithë popullit nuk është një «luks» për disa ose e «disa njerëzve që i kanë mendtë te këmbët», ose vetëm e ushtrisë, sepse gjoja ajo këtë detyrë të vetme ka. Kjo është një detyrë e dorës së parë me kuptimin më të gjerë e të madh politik për të gjithë qytetarët e Republikës, për mbrojtjen e saj (pa folur mbi dobinë shëndetësore që i sjell çdo njeriu në jetën e në punën e tij si individ).

Atdheu duhet të jetë i fortë, ai duhet të rrojë në shekuj, të mbrohet nga armiqtë e jashtëm e të brendshëm. Nën këtë parullë të madhe politike dhe në frymën me të cilën e ka zbërthyer ushtria jonë, Partia t'i ngrejë peshë të gjithë:

1) Rininë e vendit tonë, që nga fëmijët e vegjël. Në shkolla ne kemi mësimin e kulturës fizike, por ai bëhet keq, mënvleftësohet përpara lëndëve të tjera nga mësuesit dhe nga nxënësit. Në qoftë se këtu ne e fillojmë mirë, me themel, me kuptim të madh politik e patriotik, do të kemi hedhur bazën e madhe për punën fizike në shkallë të gjerë në të ardhmen. Të mendojmë seriozisht

se ne duam një brez të ri të mësuar, por jo të sëmurë fizikisht; ne duam jo vetëm brez të ri me intelekt të zhvilluar, por edhe njerëz të regjur në punë, që të mos ia kenë frikën punës, të mos kenë turp nga çdo lloj pune. Kjo veti ecën jo e ndarë nga kultura fizike. Prandaj duhet bërë menjëherë kthesa në këtë drejtë.

Por s'është vetëm kultura fizike në shkolla, janë edhe lodrat e kalamanëve jashtë shkollës, të cilat tashti janë lënë pas dore, quhen si një kohë e humbur dhe nuk bëhen me një qëllim të caktuar dhe nxitës, me një organizim, rregull e disciplinë të vërtetë sportive që t'u shërbejnë edukimit të karakterit dhe kalitjes së të riut.

Detyra paraushtarake është një detyrë serioze patriotike, është përgatitje fizike, morale, politike dhe ushtarake për mbrojtjen e atdheut. Kjo detyrë nuk kuptohet si duhet nga nxënësit, prandaj organizata e rinisë, me forma të ndryshme e të përshtatshme, t'ua bëjë të qartë vazhdimi i atyre dhe oficerët që i stërvitin të luajnë një rol të madh edukativ fizik, ushtarak e politik, ta marrin këtë punë me shumë seriozitet.

Por edhe këto forma, mendoj unë, nuk janë të mjaftueshme. Të dielat ose pushimet e nxënësve, sidomos nga 16 vjeç e lart, duhet të janë medoemos pushime aktive, të organizohen sporte masive, shëtitje e marshime në këmbë, pa marrë parasysh kohën e vendin. Natyrisht, në këto ekskursione edhe mund të lodhen, por ato duhet të zhvillohen me masë, të bëhen brenda rregullave e sipas moshave. Po kështu rëndësi të veçantë ka pjesëmarrja direkte e nxënësve në punë gjatë pushimeve verore.

2) Klasa punëtore duhet të japë shembull në punën

e madhe të kalitjes fizike dhe të përgatitjes ushtarake për mbrojtjen e atdheut. Përveç detyrimeve ushtarake, detyra të tjera jashtë tyre, ose bëhen angari, të çala, me mërzi, ose janë lënë fare pas dore, për arsyet e pajustifikueshme dhe politikisht jo të drejta. Shkohet nga mendimi i gabuar se «punëtori, duke punuar 8 orë, lodhet dhe duhet të pushojë». Në të vërtetë, që të mos lodhet duhet të jetë i përgatitur fizikisht dhe në mënyrë ushtarake. Sa më pak t'i bëjë këto, aq më shumë do të lodhet. Ose shkohet nga mendimi tjetër gjithashtu i gabuar: «meqenëse punëtori bën një punë fizike, ai ka bërë njëkohësisht edhe fizi-kulturë». Pjesërisht kjo është e vërtetë, sidomos për një kategori punëtorësh, por nuk është e mjaftueshme për kalitjen fizike dhe përgatitjen e tyre ushtarake. Puna dhe prodhimi nuk janë e vetmja detyrë patriotike e punëtorit, ato janë një detyrë e madhe që e kalitin atë më shumë se kategoritë e tjera të punonjësve si politikisht, ideologjikisht e fizikisht, por jo plotësisht. Prandaj Partia duhet të reflektojë thellë mbi këtë problem dhe të mos udhëhiqet nga kon siderata jorevolucionare në drejtim të «çlodhjes pas punë» që është parim i drejtë, por që shumë herë merret si mburojë për të mos bërë sakrifica, për të mos prishur «rehatinë, gjumin», kur nevoja imperative e atdheut dhe e mbrojtjes së tij e kërkon.

3) Edhe fshatarësia ka nevojë të madhe të përgatitet në këtë drejtim. Kushtet e punës ajo i ka shumë më të vështira se të tjerët, kalitja me elementet e natyrës dhe të punës veprojnë më mirë, por megjithatë, duhet të merren masa që stërvitjet ushtarake, paraushtarake, sportet dhe kultura fizike në përgjithësi në specifikën

e saj të zhvillohen në rregull, në mënyrë intensive, duke ua bërë të qartë politikisht, duke e lidhur ngushtë me përgatitjen për mbrojtjen e atdheut.

Prandaj Partia duhet të mendojë për të gjetur format më të përshtatshme të propagandës.

4) Me intelektualët dhe nëpunësit e administratës duhet të jemi shumë rigorozë për këtë punë. Këta janë të atillë që e kuqtojnë problemin, por i bëjnë bisht, janë «tifozë», për vete s'u bëhet vonë, ndërsa për të tjerët shesin mend dhe kërkojnë të zbatojnë detyrat.

Kultura fizike dhe përgatitja fizike për ta është, si të thuash, preokupacioni i tyre i fundit. Bile, ka shumë prej tyre që kanë turp të marrin pjesë në manifestimet gjimnastikore masive, sepse kujtojnë se u bie «nderi», ose se për ata, si punëtorë të mendjes ose të zyrave, është i huaj sporti, kultura fizike. Po shqyrr që s'janë të gjithë kështu, sepse Partia i ka kalitur politikisht dhe, po të ngrihet puna me ta në një domosdoshmëri patriotike për mbrojtjen e atdheut dhe po të merren masa të mira organizative, ata, si të gjithë patriotët e tjerë, do të janë në radhët e para.

Mendoj që kjo çështje në tërësinë e saj ka një rëndësi kolosale në këto momente kur nuk duhet të na zërë gjumi, kur duhet të punojmë pa u lodhur, me frymë luftarake, me vigjilencë të jashtëzakonshme. Çdonjëri nga ne duhet të bëjë sakrifica në çdo drejtim për të mirën e atdheut, për të tashmen dhe të ardhmen e tij. Situatat janë të rënda, lufta përgatitet nga imperialistët amerikanë dhe aleatët e tyre revizionistët modernë. Ajo mund të trokasë një ditë në dyert tona. Sa më të dobët të jemi ne, aq më parë do të trokasë dhe do të na dëm-

tojë. Sa më të përgatitur të jemi, aq më frikacak do të bëhet armiku dhe, po të na godasë, ai s'do të na gjejë në befasi, ne do t'i japim grushte për vdekje dhe do ta thyejmë.

Prandaj përgatitja jonë politikisht, ekonomikisht, ideologjikisht dhe ushtarakisht është e domosdoshme. Kjo duhet të jetë e tërë përbajtja e jetës sonë, e mendimeve tona, e veprimeve tona. Në qdo gjë, në çdo moment të mendojmë më parë nga të gjitha për atdheun tonë socialist, për popullin dhe vijën e Partisë sonë të lavdishme, ta kuptojmë thellë, ta zbërthejmë atë dhe ta vëmë në jetë si duhet, në mënyrë revolucionare. Prandaj të marrim masat e duhura dhe sa më parë përkalitjen fizike të popullit për mbrojtjen e atdheut.

*Botuar për herë të parë në
librin: Enver Hoxha «Raporte
e fjalime 1965-1966», f. 194.*

Tiranë, 1971

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

TË GJITHË ATA PUNONJËS QË VENDOSIN TË SHKOJNË NË FSHAT KRYEJNË NJË DETYRE PATRIOTIKE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

26 janar 1966.

Kam sugjeruar për mundësinë e daljes së një vendimi, i cili të mbështetë iniciativën patriotike të punonjësve për të kaluar nga administrata në prodhim dhe t'u vijë në ndihmë atyre. Gjatë kësaj kohe, përsëri kam menduar ca më tej për këtë problem. Ne, shokët e udhëheqjes, duhet të kemi parasysh që po bëjmë me të vërtetë një kthesë të madhe moralo-politike, prandaj të vazhdojmë me ngulm me metodë e stil revolucionar e në shkallë të gjerë për ta realizuar atë. Kjo ka rëndësi vendimtare për situatat aktuale dhe për të ardhmen.

Problemi i shkurtimit të organikave ka rëndësi të

1 Në këtë mbledhje u shqyrtua projektvendimi i Komitetit Qendror të PPSH lidhur me iniciativën patriotike të shumë punonjësve për të kaluar nga administrata në prodhim.

madhe, më shumë nga ana politike e morale sesa nga ana materiale, megjithëqë edhe kjo e fundit ka rëndësinë e vet për ne. Kjo masë ka rëndësi politike dhe morale, në radhë të parë, në drejtим të edukimit të njerëzve me një frymë të shëndoshë revolucionare, sepse ajo ndihmon për pastrimin e ndërgjegjes së tyre. Por pastrimi i ndërgjegjes është një punë shumë e vështirë dhe e gjatë. Masat organizative, ekonomike etj., që po marrim ndihmojnë mjafët në këtë drejtим, por vetëm ato nuk e zgjidhin problemin e madh të edukimit të njerëzve në një frymë të vërtetë revolucionare. Ne bëjmë mirë që përpinqemi t'i ndihmojmë materialisht të gjithë ata punonjës, të cilët vendosin të shkojnë në fshat, sepse, duke vajtur atje, ata kryejnë një detyrë patriotike. Por nuk duhet të piremi vetëm nga efekti i mirë i masave favorizuese që do të merren. Po ta pranojmë projektvendimin e paraqitur ashtu siç është, efekti që do të bëjë ai do të jetë shumë i madh, për këtë jemi të bindur, por ne duhet të shikojmë më thellë, nëse me këtë vendim i shërbejmë plotësisht qëllimit të madh që synojmë për të pastruar ndërgjegjen e njerëzve nga disa koncepte jo të drejta, të cilat mund të bëhen të rrezikshme në të ardhmen. Në situatat aktuale politike dhe ekonomike të gjithë duhet të bëjmë sakrifica për forcimin e atdheut, Republikës sonë Populllore. Këto sakrifica janë kryesisht ekonomike, por ne duhet të bëjmë medoemos kthesë morale dhe politike në drejtим të zhdukjes së disa koncepteve të gabuara, gjë që do të ndihmojë edhe për të përballuar më mirë sakrificat materiale. Prandaj mendoj të mos marrim masa që i ushqejnë dhe i mbajnë të gjalla në ndërgjegjen e puno-

njësve këto koncepte, përkundrazi, masat që do të marrim të jenë të tilla që të ndihmojnë të bëhet revolucion në pikëpamjet politike dhe morale të tyre. Mendoj se kjo duhet të na preokupojë në radhë të parë. Partia me punën e saj ka arritur të krijojë një ndjenjë të lartë politike te njerëzit e thjeshtë dhe te kuadrot, të cilët në përgjithësi e kuptojnë drejt që atdheu duhet të fuqizohet nga ana ekonomike dhë të mbrohet. Në këto drejtime Partia ka punuar, por prapëseprapë në jetën e përditshme, në punë e sipër, ekzistojnë edhe elementë që nuk e kuptojnë konkretisht, politikisht dhe realisht e gjer në fund se këto detyra, në këto rrethana e situata që kalojmë nuk mund të kryhen pa bërë disa sakrifica dhe kryesisht pa çrrënjosur këto koncepte nga ndërgjegjja e tyre. Këto sakrifica janë në interes të së sotmes dhe të së ardhmes.

Kuadrot tanë, të cilët politikisht janë të ngritur, duhet të kuptojnë thellë se ku synon Partia me masat që po merr për shkurtimin e organikave, të nxjerrin konkluzione përsë ngjanë gjithë ato gjëra të hidhura në Bashkimin Sovjetik, përsë erdhën atje në fuqi revisionistët. Mos vallë atje e sollën këtë gjendje vetëm një numër revisionistësh? Jo, shokë. Vetë ne po konstatojmë që revizionizmin hrushovian, këtë tradhti të madhe, në Bashkimin Sovjetik e mbështetën dhe po e mbështetin, me dashje ose pa dashje, shumë njerëz, bile edhe nga ata që kanë bërë Revolucionin e Madh të Totorit dhe Luftën e Madhe Patriotike, që kanë vuajtur pa bukë e pa strehë, që i kanë dashur si shpirtin partinë e tyre dhe Stalinin. Për shembull Konjevi që kur ishte 15-16 vjeç ka luftuar, po ku përfundoi ky e sa e sa të

tjerë me radhë në Bashkimin Sovjetik? Direktivat në kohën e Stalinit ishin të drejta. Për afér 40 vjet me radhë u bë një punë e gjerë revolucionare. Kur u bënte thirrje Stalini, të gjithë ata ishin gati të hidheshin në zjarr dhe në fakt u hodhën, por erdhi një mëngjes që vetë këta njerëz e mbështetën rrymën revizioniste. Kjo ndodhi pikërisht se në ndërgjegjen e tyre, me dashje ose pa dashje, qoftë te kuadrot e partisë, të pushtetit, te mareshalët, gjeneralët, kolonelët e majorët, ashtu edhe tek ata të ndërmarrjeve ekonomike, dalngadalë u zhvilluan tendenca dhe mbeturina mikroborgjeze në atë masë saqë shtresa të tëra ranë në një llum të tillë, pra zunë vend disa gjëra që nuk pajtoheshin me frymën revolucionare të Partisë Bolshevik, sikurse ishte tërheqja pas interesit të ngushtë personal dhe vënia e tij mbi interesin e përgjithshëm, derisa ndodhi tragjedia.

Duke pasur kurdoherë parasysh se revizionizmi paraqet një rrezik të madh, për ne ka rëndësi jo vetëm ta kuptojmë këtë rrezik, por edhe ta luftojmë me të gjitha forcat. Si besnikë të Partisë sonë, ne e luftojmë hapur e pa bërë lëshime revizionizmin modern, me atë sovjetik në krye dhe në të njëjtën kohë i zëmë këtij armiku të gjitha shtigjet që ai të mos depërtojë në radhët tona. Te njerëzit tanë, ku më shumë e ku më pak, ka edhe disa koncepte të gabuara, që po të mos i zbulojmë e pastaj t'i luftojmë në rrënjet e tyre, në bazën e tyre politike, ideologjike dhe ekonomike, nuk mund të arrijmë ato qëllime të larta që synon Partia jonë. Prandaj, në qoftë se është punë sakrfice, se kështu e duan interesat e atdheut dhe të Partisë, në qoftë se duam që atdheu të rrojë e të lulëzojë përjetë dhe Partia jonë,

ashtu si gjer tani, të jetë vazhdimisht një parti e vërtetë revolucionare marksiste-leniniste në të gjitha drejtimet, atëherë të gjithë duhet t'i bëjmë këto sakrifica.

Ne, shokët e udhëheqjes, duhet të reflektojmë thellë për këtë. Lufta kundër mbeturinave në ndërgjegjen e njerëzve ka rëndësi vendimtare jo vetëm në koniunkturat aktuale, por edhe në të ardhmen. Duke e gjykuar kështu këtë çështje, në vendimin që po marrim dhe në të tjera që do të marrim akoma më pas, në radhë të parë, të kemi parasysh kuptimin e thellë politik dhe ideologjik të këtij problemi të madh. Të jemi të qartë se gjatë zbatimit të këtyre masave do të ketë edhe pëshpëritje, edhe pakënaqësi. Disa njerëz nuk do t'i kapërcejnë dot vështirësitë dhe do të ngecin në vend, disa të tjerë edhe mund të armiqësohen. Kjo është luftë, prandaj qëndrime të tillë nuk duhet të na frikësojnë. Ne jemi të bindur se të gjitha do t'i kapërcejmë.

Për Partinë tonë ka rëndësi të madhe që e shohim qartë një gjë të tillë, që e kuptojmë rëndësinë politike të këtyre masave që po marrim dhe të problemeve që po zgjidhim. Rëndësi të madhe ka gjithashtu që luftohen dhe u pritet rruga të tillë mbeturinave, të cilat nuk lejohen të bëhen gangrenë te ne. Partia jonë po bën 25 vjet që jeton, lufton e punon me popullin. Ky është shumë i thjeshtë, edhe anëtarët e Partisë sonë, që kanë dalë nga ky popull, po ashtu janë të thjeshtë. Partia e njeh dhe e vlerëson këtë cilësi të mrekullueshme të popullit tonë dhe të anëtarëve të saj, por ajo njeh në të njëjtën kohë edhe mbeturinat që kanë njerëzit në ndërgjegjen e tyre. Kundër këtyre mbeturinave ka punuar e ka luftuar Partia si në qendër dhe në bazë;

ajo i ka edukuar njerëzit vazhdimisht në këtë drejtim, por këto nuk zhduken lehtë. Mbeturinat ekzistojnë, shfaqen e zhvillohen në shumë forma. Një nga rru-gët për të shpëtar prej tyre është pastrimi dhe marrja e masave për shkurtimin e organikave dhe për vajtjen e kuadrove në prodhim që po bëjmë tani. Por duhet pasur parasysh se, në qoftë se nuk i futemi kësaj pune, në qoftë se nuk e bëjmë vazhdimisht dhe nuk e çojmë gjer në fund luftën tonë kundër këtyre të këqijave, ato do të ringjallen përsëri dhe do të bëhen edhe më të rrezikshme. Prandaj, tani që i zbuluam dhe po i luf-tojmë, të mos e pushojmë për asnje çast luftën kundër tyre, se vetëm kështu ato nuk do të mund të na dëmtojnë.

Çështjen e kam këtu që të gjithë këta që do të largohen nga administrata dhe do të shkojnë në prodhim t'i ndihmojmë, por vetëm më kuadrin që thashë, që të ruhen ky hov revolucionar dhe shpirt sakifice ndaj atdheut te njerëzit tanë, të cilët gjithnjë e më shumë të kuptojnë mirë se këto ndryshime janë të domosdoshme të bëhen se ato janë të lidhura me revolucionarizimin e jetës së vendit.

Shteti dhe kooperativat bujqësore të mendojnë edhe për kushtet e banimit të këtyre kuadrove që do të venë në fshat. Jam dakord që të japim kredi për meremetim dhe ndërtim shtëpish për ta, për këtë në parim nuk kemi kundërshtim, por të mos u premtojmë që, sapo të shkojnë atje, do t'u sigurojmë shtëpi aq sa kanë nevojë. Vështirësitet e para t'ua bëjmë të qarta edhe atyre në mënyrë që t'i përgatitim. Aktualisht në fshat nuk ka mungesë shtëpish. Ata që do të venë tani atje do të

jenë gjithsej shumë-shumë një mijë veta, kurse ne kemi mbi dy mijë fshatra, kështu që çdo dy fshatrave do t'u bjerë të presin një familje. Pra nuk kanë mundësi këto fshatra t'u sigurojnë këtyre nga një dhomë pér të jetuar? Po, kanë mundësi. Nuk është e thënë që menjëherë dhe brenda vitit këta të kenë nga tri dhoma e një kuzhinë, po le të rrinë ca kohë shtrënguar me gjithë familje në një ose dy dhoma. Më vonë të marrim masa pér të ndërtuar shtëpi pér ta, të cilat t'ua japim pa qira pér disa vjet ose t'u themi t'i blejnë, po të duan, sepse, duke punuar në fshat, me të ardhurat që do të sigurojnë, ata do të kenë mundësi ta bëjnë shtëpinë të vetën jo pér 50 vjet, por edhe brenda 10-15 vjetëve. Kjo do të jetë e mundshme se në fshat kërkesat e jetesës janë më të thjeshta, si pasojë edhe shpenzimet më të pakta. Propozoj që këtyre që venë në fshat t'u jepet gjithashtu kredi pér të blerë lopë apo bagëti të tjera, aq sa i lejon statuti i kooperativave bujqësore. Veç kësaj Partia të interesohet që koooperativa bujqësore t'u japë edhe oborrin kooperativist. Edhe pér këtë besoj jemi të tërë dakord. Rëndësi ka çështja që këtyre njerëzve t'u jepet mundësia të vendosen në fshat, ku të arrijnë të krijojnë po ato kushte që kanë krijuar edhe fshatarët që kanë jetuar atje vazhdimisht.

Për sa i përket problemit të dhënies së bursave fëmijëve të atyre që do të venë tanë në fshat me rastin e shkurtimit të organikave, jam dakord që ta shohim më vonë, mbasi të kemi të qartë sa do të jenë këta fëmijë, ose ta lëmë në kompetencën e Qeverisë, e cila ta shohë bashkë me problemet e tjera, si ato të pagës e të dhënies së banesës pa qira këtyre kuadrove. Problem,

mendojmë, është për ata fëmijë që aktualisht janë nëpër shkollat e mesme dhe të larta, të cilëve s'ke si ua ndërron tani profilin. Në qoftë se janë disa dhjetëra veta nuk është ndonjë gjë e madhe, por më duket se do të jenë më shumë. Jam i mendimit të mos u japim bursë ose gjysmë burse të gjithëve, por vetëm atyre që janë nevojtarë. Ministria e Arsimit të marrë masat e nevojshme për këtë çështje. Kështu pra ka vend t'i shikojmë më me kujdes disa gjëra, por në të njëjtën kohë Partia të punojë politikisht me këta njerëz.

Për sa i përket vendimit Nr. 410¹ të Qeverisë, mendoj ta konsiderojmë si të paqenë. Për këtë të mos presim sa të na vijë ndonjë propozim nga poshtë, por këtej e tutje duhet të bëjmë edhe ne propozime të kësaj natyre. Ne përvetësojmë eksperiencën e masave dhe të Partisë dhe këtë, pasi e përpunojmë, ua kthejmë përsëri atyre. Pikërisht eksperiencia na tregon se ka ardhur koha ta shfuqizojmë këtë vendim, të mos ketë më njerëz që të përfitojnë prej tij, sepse në fshat na krijohen dy kategoritë njerëzish: një kategori që ndihmohet nga shteti dhe kategoria tjeter, fshatarët, që rrojnë vetëm me të ardhurat që marrin nga ditë-punët që bëjnë në kooperativë. Prej këtyre që do të venë tani në fshat ne të kërkojmë që të bëhen propagandistë të mirë partie përtu thënë shokëve më të vjetër, që kanë shkuar atje dhe përfitojnë nga vendimi Nr. 410, që nuk është e drejtë të përfitojnë më, prandaj vullnetarisht dhe me ndërgje-

1 Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 410, datë 20.9.1960 «Mbi shpërbllimin e kuadrove drejtues dhe të specialistëve të kooperativave bujqësore» u shfuqizua me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 37, datë 6.6.1966.

gje të heqin dorë nga favoret që parashikon ai vendim. Me një fjalë, prej këtyre që do të venë tani të bëhet një punë e dendur politike që të arrihet më lehtë në abrogimin e vendimit. Për këtë vendim u shfaqën mendime të ndryshme. Disa thonë se ai duhet të qëndrojë në fuqi edhe nga dy vjet. Po të ishte fjala për ndonjë muaj, favoret e këtij vendimi mund t'ua linim edhe këtyre që do të venë tani në fshat, por që ta lëmë akoma kaq gjatë në fuqi, them se një gjë të tillë duhet ta shikojmë mirë. Mua më duket më i drejtë mendimi i atyre shokëve që thonë të mos lihet më ky privilegj, prandaj ta shoshitim me kujdes të madh se kur e kemi marrë këtë vendim, ne jemi përpjekur që këtë çështje të madhe politike ta rregullonim me paga, se kuadrot në atë kohë nuk e kishin këtë formim, këtë bindje që kanë sot dhe nuk na venin në fshat. Kur vendosëm pagat ata shkuan, por as paga nuk e zgjidhi plotësisht këtë çështje, sepse pas një kohe shumë prej tyre u rikthyen në qytet. Kurse tani këtë çështje ne duhet ta kapim nga ana politike. Të mos shkojmë nga parimi që, po të abrogohet ky vendim, në fshat nuk do të vejë njeri etj. Po të mendohet kështu, kjo do të thotë, në radhë të parë, se ne nuk e kemi bërë mirë punën me njerëzit. Përkundrazi, ky hov mendoj se do të dhjetëfishohet, sidomos në qoftë se ata që do të venë në fshat nuk do të lidhen pas favoreve të këtij vendimi, por çështjen do ta kuptojnë drejt nga ana politike. Nuk e kam fjalën të mos i ndihmojmë fare këta punonjës që venë në fshat, ne duhet t'i ndihmojmë, por jo të teprohet. Pra, ata të ndihmohen gjer në atë masë sa vetë ta ndiejnë moralisht dhe

politikisht se po bëjnë një sakrificë. Ne duhet të kemi gjithashtu kujdes që favorizimet për ta të mos jenë të mëdha, me qëllim që diferenca midis nivelit të jetesës së tyre dhe atij të fshatarësisë të mos jetë e madhe, se pastaj do të krijohet pakënaqësi te fshatarët.

Pra, kërkohet që, në radhë të parë, problemin ta shtrojmë politikisht e ideologjikisht. Të jemi të ndërgjegjshëm se në fillim do të ketë ca vështirësi. Por kjo çështje s'ka pse të bëhet tragjike, gjersa edhe vetë punonjësit që po kërkojnë të venë në fshat nuk e shohin si të tillë, por me një fjalë të Partisë, menjëherë, vetëm nga qyteti i Durrësit 200-300 veta janë gati të shkojnë nga qyteti në fshat. Kjo do të thotë se ata do të shkojnë atje me vullnet. Natyrisht, disa sakrifica i kanë marrë përsipër, por ama kanë edhe bindjen se edhe në fshat do të jetojnë mirë. Partia ka bërë aq shumë për popullin gjatë këtyre 21 vjetëve pas Çlirimt, saqë edhe niveli i jetesës në fshat është përmirësuar. Një shtëpi e re që ndërton fshatari jo vetëm në Korçë, po edhe në Kukës është po aq e mirë sa një apartament në qytet. Me këtë dua të them se sa për shtëpi, fshatari ynë është mirë. Sigurisht në fshat sot nuk ka çdo natë kinema, teatër, muzikë, atje s'ka bulevardë për shëtitje, por kjo nuk do të thotë se njerëzit atje vuajnë e bëjnë një jetë të zymtë, përkundrazi edhe punojnë e mësojnë, por edhe argëtohen, këndojnë, kërcejnë, lodrojnë, shumica e familjeve kanë radio, në fshatra tani shfaqen filma, venë grupe teatrale e artistike, në shumë prej tyre po shtrihet rrjeti elektrik, telefonik e rrugët automobilistike. Partia gjithnjë ka punuar dhe punon për t'i ngush-tuar dallimet midis fshatit dhe qytetit, por egalitarizëm

nuk mund të ketë, një gjë të tillë nuk e bëjmë dot, sepse disnivelet ekzistojnë në socializëm, bile disa ndryshime edhe në komunizëm do të ekzistojnë. Por ky disniveli që ekziston nuk na jep të drejtën të mendojmë *a priori* se ai që vete në fshatë i sakrifikuar për tërë jetën. Sakrifica e vetme që bëjnë njerëzit që shkojnë nga qyteti në fshatë se në qytet lënë disa anë të jetës, të cilat nuk i ka fshati, po edhe në fshat, gjejnë disa favore që s'i ka qyteti.

Gjithashtu edhe për përgatitjen me anën e kurseve të atyre që s'kanë zanat, jemi dakord me masat që propozohen. Këto kurse të mos organizohen vetëm për llogaritarët, por edhe për profesione të tjera. Dikush nga këta që do të mbetet jashtë organikës mund të dojë, për shembull, të bëhet tornitor, por këtë mjeshtëri ai nuk e di. Atëherë ta mësojmë, vetëm se është e domosdoshme që në këtë drejtim të vihet një afat, e shumta 6 muaj, që këta njerëz të paguhen me pagën e vjetër, pastaj të paguhen sipas vendit ku do të jenë vendosur.

Shkuarjen e kuadrove në zonat malore ne ta inkurajojmë, por të mos kalojmë në ekstrem, të kemi kujdes në shpërndarjen e tyre. Ne mendojmë se e kemi pasur kurdoherë të drejtë orientimin që në ndërmarrjet bujqësore shtetërore të dërgonim dhe kemi dërguar më shumë kuadro, se atje edhe prodhimi është më i madh. Por në qoftë se edhe kooperativa e Zharrëzës ka prodhim të madh, edhe atje të dërgojmë aq agronomë sa ka nevojë, se e vlen.

Sikurse e vutë në dukje edhe ju, këto favore që do të specifikohen me rastin e shkurtimit të organikave, do të jepen vetëm për nëpunësit dhe specialistët që do

të kalojnë nga administrata në prodhim. Pastaj ka rën-dësi edhe ajo që tha Mehmeti që këto favore të jepen vetëm për një kohë të caktuar, domethënë vetëm tani me rastin e shkurtimit të organikave. Më vonë nuk do të ketë më të tilla.

Këto që u thanë këtu t'i vëmë në vendim. Në vendimin e Komitetit Qendror të porositet Qeveria që të marrë masa konkrete në lidhje me ndihmat dhe lehtësítë materiale që u duhen dhënë këtyre punonjësve.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

GJALLERIMI I JETES SE PARTISE — PROBLEM KRYESOR¹

2 shkurt 1966

Diskutimet shumë të gjalla që u bënë në Parti dhe në popull gjatë punimit të Thirrjes së Komitetit Qendror të PPSH dhe të Këshillit të Ministrave të RPSH, si edhe të vendimit të Byrosë Politike të KQ të Partisë «Mbi luftën kundër burokratizmit për një metodë dhe stil revolucionar në punë», treguan drejtësinë e këtyre vendimeve historike dhe pjekurinë e Partisë sonë, e cila në momentin e duhur di të kapë atë hallkë që do të revolucionarizojë më tej të gjithë punën. Ato janë një tregues i pakundërshtueshëm i asaj force të shëndoshë marksiste-leniniste që përfaqëson Partia e Punës e Shqipërisë.

Komunistët dhe i gjithë populli i mbështetën me të gjitha forcat Komitetin Qendror, Partinë tonë në këtë ndërmarrje shumë të rëndësishme. Kjo flet edhe një herë për ato lidhje të ngushta që ekzistojnë midis Par-

1 Ky dokument është botuar si broshurë e veçantë për përdorim të brendshëm në Parti me titull: «Orientime të Byrosë Politike të KQ të PPSH kundër formalizmit dhe zyrtarizmit në jetën e Partisë, për gjallërimin e organizatave-bazë të Partisë».

tisë dhe popullit, për atë besim të patundur që kanë ata për njëri-tjetrin, për patriotizmin e lartë të popullit tonë heroik.

Byroja Politike konsideron se problemi kryesor për t'iu përgjigjur sot këtij hovi të madh revolucionar të masave për realizimin e detyrave të mëdha që kemi përpëra, është forcimi dhe gjallërimi i organizatave-bazë të Partisë.

Organizatat-bazë të Partisë të vihen plotësisht në krye të të gjithë jetës në sektorët ku veprojnë

Që Partia të kryejë rolin e saj të repartit pararожë të organizuar të klasës punëtore, si forca frymëzuese dhe udhëheqëse e të gjithë jetës së vendit, është e domosdoshme që organizata-bazë, si themeli i saj i shëndoshë, të vihet plotësisht në rolin e vet në ndërmarrje, kooperativë, fshat, repart ushtarak, administratë e kudo. Kjo do të thotë që fatet e ndërmarrjes, kooperativës, repartit etj., nuk janë në duart e një njeriu, por të organizatës-bazë si tërësi. Për këtë qëllim duhet të jenë të qarta mirë çështjet e mëposhtme:

1. — Ajo që përcakton mbarëvajtjen e punëve në çdo kolektiv është niveli i punës ideologjike, politike, organizative e mobilizuese të organizatës-bazë të Partisë. Pa nënveftësuar rëndësinë shumë të madhe që kanë kuadrot për Partinë, pasqyra e punës në një kooperativë, ndërmarrje ekonomike, shkollë, repart ushtarak e gjetkë nuk janë sekretari, drejtori, kryetari apo komandanti, por është kryesisht organizata-bazë e Partisë.

Është vazhdimisht puna e kujdeshme e Partisë, ajo që ka nxjerrë nga gjiri i masave kuadrot tanë.

Detyra e organizatës-bazë të Partisë nuk është vetëm të mbështetë urdhrat e drejtorit, të kryetarit apo të komandantit. Organizata e Partisë është ajo që udhëheq tërë punën, që vendos se çfarë duhet bërë nga komunistët dhe nga të gjithë punonjësit për të shkuar punët përpara, çfarë detyrash duhet të plotësohen, si duhet të mundet armiku në luftë etj. dhe, në bazë të kësaj, gjithsecili të kryejë detyrat që i janë besuar. Të gjitha organet, organizatat ose organizmat e tjerë janë leva të Partisë. Si të tilla ato duhet të punojnë për të vënë në jetë vijën dhe vendimet e Partisë, orientimet e saj të drejta, pa u shmangur aspak nga të gjitha kërkesat e centralizmit demokratik të shtetit dhe të organizatave të tjera të masave.

Nuk ka problem për të cilin të mos jetë e interesuar organizata-bazë e Partisë, po ajo nuk mund t'i kryejë vetë të gjitha punët. Ajo duhet të udhëheqë dhe të qëndrojë në atë pozicion nga i cili syri i saj të ketë një kënd të gjerë vështrimi. Organizata-bazë duhet të luftojë kundër sektarizmit, kundër çdo përpjekjeje për t'i monopolizuar punët. Sektarizmi ndrydh iniciativën e kuadrove dhe të masave, dobëson e vyshk Partinë. Organizatat-bazë të Partisë duhet të rritin vazhdimisht aftësitë e tyre për të vënë në lëvizje gjithçka që duhet, që anëtarët dhe levat e saj, të gjithë punonjësit, të kryejnë plotësisht detyrat që u përkasin me ndjenjën e përgjegjësisë më të lartë.

Duke punuar për të zhvilluar iniciativën e për të rritur përgjegjësinë e kuadrove dhe të organeve të ndry-

shme, organizatat-bazë të Partisë nuk duhet të lejojnë prirjet lokale e dikasteriale, apo shfaqjet e teknokracisë, të cilat janë shfaqje të tjera të presionit burokratik mbi Partinë.

Jo format e ngurta, por ngritja ideologjike, politike, organizative e teknike e organizatave-bazë të Partisë, duhet të përbëjë sot shqetësimin kryesor të punës së organizatave të Partisë.

2. — Të hiqet tutela mbi organizatat-bazë të Partisë dhe të luftohet kundër çdo shfaqjeje mosbesimi ndaj tyre, kundër çdo metode të ngurtë administrative e të detyrimit që ndrydhin iniciativën e tyre. Të zëvendësohen këto me një ndihmë e kontroll të kualifikuar, që t'u hapin atyre, anëtarëve të Partisë dhe masave punonjëse, horizont të gjerë veprimi. Problemet që i përkasin t'i vendosë e t'i zgjidhë organizata-bazë të lihen t'i vendosë e t'i zgjidhë ajo. Në mënyrë të veçantë duhen ndihmuar organizatat-bazë në fshat, ku edhe detyrat janë më të vështira.

a) T'i jepet fund praktikës së dëmshme të diktimit nga lart të rendeve të ditës për mbledhjet e organizatave-bazë, nëpërmjet vendimeve, porosive dhe udhëzimeve të ndryshme, si për shembull, një herë në muaj të bëhet informacion politik, një herë në tre muaj të shqyrtohet problemi i kuotave, një herë në gjashtë muaj të shqyrtohen problemet e blektorisë etj.

b) Të zhvillohen gjerësisht iniciativa dhe përgjegjësia e organizatave-bazë të Partisë, veçanërisht në punën për zbërthimin dhe zbatimin krijues të direktivave dhe të orientimeve të Partisë. Organizatat-bazë të Partisë duhet të reagojnë menjëherë kur vendime, urdhra

e udhëzime të ndryshme bien në kundërshtim me vijën e Partisë, me politikën e saj të drejtë, me interesat e popullit. Partia nuk ka interesa të tjera nga ato të popullit, prandaj çdo gjë që bie në kundërshtim me këto interesa, vjen në kundërshtim njëkohësisht edhe me vijën e Partisë. Gjatë diskutimeve që janë bërë në Parti e në popull mbi luftën kundër burokratizmit dhe për përmirësimin e metodës e të stilit në punë, doli qartë se organizatat-bazë nuk kanë qenë mirë në roje kundër shtrembërimeve burokratike. Ky duhet të bëhet një mësim i mirë. Centralizmi demokratik kërkon që në rrugë partie ta ngremë fort zërin kundër çdo shtrembërimi të vijës marksiste-leniniste të Partisë sonë.

3. — Partia jonë është mbi të gjitha udhëheqëse, organizatore, edukatore, këshilluese dhe fryshtuese e masave punonjëse, për interesat e të cilave ajo rron e lufton. Gjithë veprimtaria kryesore e punës së organizatave-bazë të Partisë dhe e çdo komunisti duhet t'i kushtohet punës së gjallë për edukimin dhe mobilizimin e njerëzve, dëgjimit të zërit të tyre, respektit për ta. Nuk duhet të ketë asnjë problem që të diskutohet në organizatën-bazë të Partisë, ku të mos theksohet mendimi i masave, i njerëzve më të interesuar për zbatimin e detyrave që nxjerr ajo. Nuk duhet të ketë gjithashtu asnjë vendim, detyrë ose orientim që të mos u përgjigjet preokupacionit dhe zgjidhjes së kërkësave të masave. Të bëhet rregull që, pas mbledhjes së organizatës-bazë, të vihen në dijeni punonjësit për çështjet që u interesojnë dhe bashkë me ta të gjenden forma e mjete nga më të përshtatshmet për zbatimin e tyre.

Herë pas here, kur e lyp nevoja, duhet të prakti-

kohen edhe mbledhjet e hapëta të organizatave-bazë. Ato duhet të luajnë një rol të rëndësishëm në edukimin e punonjësve, në mobilizimin e tyre, në forcimin e lidhjeve me ta.

Aftësia dhe forca e organizatave të Partisë, e pushtetit popullor, e diktaturës sonë, do të rriten gjithnjë e më shumë nga lidhjet e tyre me masat. Përkundrazi, çdo veprim e qëndrim që dobëson këto lidhje, dobëson njëkohësisht Partinë dhe pushtetin tonë. Të dënhet me rreptësi, si krejt e huaj për ne, çdo zëvendësim i metodës së bindjes me urdhra, me diktate e arrogancë. Me mjete të tillë nuk bind njeri, mund të frikësosh përkohësisht ndonjë të dobët, por kurrën e kurrës Partinë dhe popullin.

Anëtari i Partisë duhet të zhvillojë luftën e klasave, duke u bazuar në parimet bazë të marksizëm-leninizmit, të vijës së drejtë të Partisë, duke u mbështetur në masat. Ai duhet të dijë të dallojë, pas një analize të plotë, të mirën nga e keqja, të rrezikshmen nga më pak e rrezikshmja dhe të përdorë metodën më të përshtatshme në punën me njerëzit.

Kërkesa më e rëndësishme për rritjen e rolit të organizatave-bazë të Partisë është aktivizimi i plotë i të gjithë komunistëve

1. — Për të rritur përgjegjësinë dhe veprimtarinë e çdo komunisti duhet të zhdukim sektarizmin dhe formalizmin që kemi në aktivizimin e komunistëve dhe të

shkojmë drejt një rindarjeje të detyrave në të gjitha organizatat-bazë të Partisë. Të bëjmë ashtu siç mësonët Lenini, krahas me centralizmin e shëndoshë në organizimin e Partisë, të decentralizojmë përgjegjësinë e çdo anëtar i të veçantë të saj, decentralizim që nuk është gjë tjetër veçse ndarja e detyrave midis anëtarëve të Partisë. Një decentralizim i tillë është kusht i domosdoshëm i centralizmit revolucionar.

a) Asnjë anëtar partie nuk duhet të mbetet jashtë veprimtarisë së organizatave-bazë të Partisë. Asnjë lloj indiferentizmi nuk duhet të tregojë komunisti për problemet e Partisë e të popullit. Shikimi i ngushtë i punës së caktuar, i interesit personal, përpjekjet për t'u struktur në «qoshe të ngrohtë», janë të huaja për komunistët. Në çdo vend që të punojë, ai duhet të jetë në rolin e luftëtarit pararожë për të luftuar për zbatimin e vijes së Partisë, të përgjigjet për punën e saj.

Anëtar i Partisë duhet të jetë njëkohësisht një aktivist politik e shoqëror i dalluar. Puna shoqërore vullnetare është në të gjitha tiparet e saj një punë thjesht komuniste. Në qoftë se nuk është në nivelin e një detyra të tillë, ai nuk mund të jetë anëtar partie. Sektarizmi që tregohet në ngarkimin e komunistëve me detyra, ndarja e tyre në «të aftë» dhe në «të paaftë», nuk ka asnjë bazë, ajo dëshmon për subjektivizmin dhe mungesën e aftësive të vetë drejtuesve të organizatave-bazë.

b) Ndarja e detyrave midis anëtarëve të Partisë nuk duhet të standardizohet, ajo të bëhet në lidhje të ngushtë me kushtet e punës, me kërkesat e reja.

Përveç ndarjes që kemi deri tani në organizatat-bazë, në organizatat e sektorëve dhe në byrotë e tyre,

komunistët veç e veç ose me grupe, në përshtatje me aftësitë e cilësitetë e tyre, mund të ngarkohen që të përgjigjen edhe për probleme që preokupojnë organizatën, si për shembull, për planifikimin, për çështjet e financës, për disiplinën, për emulacionin, për punët teknike, për kursimet, për grumbullimin e plehut etj., etj.

Komunistët janë njëkohësisht, e në radhë të parë, udhëheqës politikë, prandaj ata duhet të ngarkohen të punojnë me një masë të caktuar qytetarësh ose punonjësish, në mënyrë që asnë punonjës, asnjeri në qytet e në fshat të mos mbetet jashtë lidhjeve të gjalla me Partinë, pa u ushqyer me mësimet e saj. Komunistët e ngarkuar me këtë punë, si edhe ata që ngarkohen të punojnë me këshillat popullore, me organizatat e masave etj., janë përgjegjës para organizatës-bazë të Partisë, ku dhe duhet të raportojnë rregullisht për detyrat e ngarkuara. Komunisti nuk duhet ta reduktojë rolin e tij vetëm për të parë nëse u mblodh apo nuk u mblodh kjo formë edukimi apo kjo organizatë masash; ai nuk ka asnë të drejtë më tepër nga të tjerët,asnë masë partie ose shtetërore nuk mund të marrë ai kundrejt kurkujt, detyra e tij është që punët që i janë ngarkuar të shkojnë mirë, që njerëzit të edukohen dhe kudo të sundojë një frysë e shëndoshë partie.

c) Ndarja e forcave të Partisë gjithashtu nuk është diçka e pandryshuar. Komunisti në asnë mënyrë nuk duhet ta ndiejë veten të ndodhur rastësisht në këtë ose në atë pozicion, por ta ndiejë si pjesëtar luftarak i atij organizmi të centralizuar të Partisë që përfshin të gjitha anët e jetës së vendit.

Organizatat e Partisë të bëjnë një rishpérndarje më të drejtë të komunistëve, jo atje ku është më lehtë, por atje ku duhet, atje ku është fronti kryesor i prodhimit, në mënyrë që kudo, në të gjithë sektorët e hallkat, në të gjithë organizmat, të jetë dora e Partisë, të dëgjohen zëri, vija dhe këshillat e saj.

ç) Byrotë e organizatave-bazë të Partisë të bëhen bërthama të vërteta organizuese për aktivizimin e komunistëve. Ato duhet të organizojnë e të ndajnë mirë punën midis anëtarëve të tyre dhe mbi këtë bazë të sigojnë aktivizimin e gjithë anëtarëve të Partisë, ndihmën dhe kontrollin e nevojshëm. Kjo ndarje të zbatohet edhe nga komitetet e Partisë, të cilat mund të thërresin në mbledhje, në seminare, në aktive etj. për çështje të caktuara edhe anëtarë të byrove të organizatave-bazë të Partisë.

2. — Një nga shfaqjet më të shëmtuara e më të rrezikshme të burokratizmit e të sektarizmit, që ka dobësuar fryshtë luftarakë të komunistëve dhe të organizatave-bazë, është fakti që disa herë autokritika dhe kritika në Parti nuk janë në lartësinë e duhur. Në këto raste ato janë zëvendësuar me një kritikë të përgjithshme, për gjëra të dorës së dytë e me gjysmë zëri dhe është krijuar kështu në mjaft komunistë një lloj ftohtësie e frike për të kritikuar, kanë lindur tek ata shfaqje krejt të huaja, si servilizmi, arroganca e mbytja e kritikës nga ana e disa shokëve me përgjegjësi, e deri në raste hakmarrjeje në forma të ndryshme për ata që kritikojnë.

Të dënohen këto shfaqje me rreptësinë më të madhe, secili komunist të shikojë veten e tij në këtë drej-

tim dhe të vihet menjëherë në rrugën për të përdorur gjithnjë drejt armën e autokritikës e të kritikës, pa druajtje, pa kufi. Organizatat e Partisë janë qerdhe revolucionarësh, në to duhet të ziejëjeta e gjallë, aty duhet të bëjë komunisti kalitjen dhe edukimin e tij. Në organizatë komunisti të shfaqë lirisht mendimet e tij, sepse kështu ai vepron drejt, sillet me ndershmëri ndaj Partisë, ndihmon veten dhe shokët dhe, kur mendimet e tij mund të mos jenë të drejta, ai do të ndreget.

Në organizatën-bazë farkëtohet uniteti i çeliktë i komunistëve, jo vetëm për vijën e përgjithshme të Partisë, po edhe për të gjitha problemet që shtrohen e vendosen aty. Pa luftë mendimesh, pa tërhequr në këtë luftë të gjithë anëtarët e organizatës, nuk mund të ketë unitet të çeliktë mendimi e veprimi të njëjtë. Në këtë vështrim duhen mbrojtur si të shenja të drejtat e anëtarit të Partisë e organizatë-bazë duhet të marrin në mbrojtjen e tyre të gjithë ata që kritikojnë drejt dhe rreptë.

Forcimi i bindjeve në Parti është një kërkesë e domosdoshme edhe e disiplinës, e asaj discipline të ndërgjegjshme e të çeliktë, pa të cilën gjithashtu nuk mund të ekzistojë Partia, nuk mund të ketë veprimitari e jetë për komunistët. Veçanërisht, në kushtet e vendit tonë të rrethuar nga armiqtë imperialistë e revisionistë, në kushtet kur Partia është gjithnjë në gjendje lufte, forcimi dhe kalitja e vazhdueshme e disiplinës së ndërgjegjshme janë një domosdoshmëri e përditshme, e cila e bën Partinë të pathyeshme.

3. — Organet dhe organizatat e Partisë duhet të

drejtojnë nga afër aktivizimin e komunistëve, t'i mësojnë ata si të punojnë që të ecin si duhet në vijën e Partisë dhe të edukohen konkretisht me luftën, me vështirësitë e fitoret që arrihen. Organizatat e Partisë t'i edukojnë e t'i kalitin komunistët me çështjet që nxjerrin jeta, lufta dhe përvoja e përditshme e Partisë dhe e popullit.

Një punë e veçantë duhet bërë me komunistët e fshatit. T'u hapen atyre horizonte të gjalla pune, diturie, veprimi, t'u zhvillohet iniciativa. Komunistëve t'u punojë mendja vetë për çdo gjë, në bazë të vijës së Partisë, të orientimeve të saj, të vendimeve të organizatave-bazë të Partisë. Ata të organizojnë vetë punën politike që duhet të bëjnë me masat për çdo problem, në format më të përshtatshme për kushtet e tyre dhe të mos presin t'u dërgohen leksione ose urdhra nga lart.

Të mbahet mirë parasysh se të japësh vetëm urdhra është gjëja më e lehtë, por kjo përmban në vetvete shumë të këqija. Tek ata që veprojnë kështu krijohet ideja se «kanë lindur» për t'u diktuar të tjereve. Kjo gjë lind mendjemadhësinë, ndjenjën e komandimit, zhvililon arrogancën, të gjitha këto të huaja dhe të dënueshme nga via e Partisë sonë.

Një metodë e tillë e dëmshme u krijon shprehinë atyre që marrin urdhra e direktiva, që të japin edhe ata urdhra e direktiva. Kështu krijohet një rrëth vicioz i qelbur, burokratik, krijohet një shtresë që jep urdhra dhe një shtresë që duhet t'i zbatojë ata. T'u bëhet një luftë e ashpër dhe e pamëshirshme nga ana e organizatave-bazë të Partisë pikëpamjeve e veprimeve të tilla, sepse këto disa herë fillojnë pa dashur, si pa gjë të

keq; por, po nuk u luftuan, bëhen një vijë shumë e rrezikshme.

Një metodë e tillë pune i bën njerëzit të mos mendojnë me kokën e tyre, i bën të plogët, të frikshëm e servilë përpara eprorit, e bën anëtarin e Partisë të mos mendojë e të mos thellohet me kokën e tij. Si pasojë, njerëzve u pritet iniciativa aq e nevojshme, propozimet e tyre të vlefshme priten me këmbët e para dhe në këto raste, nuk mund të bëhet më fjalë as për kritikë dhe as për autokritikë marksiste-leniniste.

Të ngremë lart vigjilencën e komunistëve, shpirtin e tyre luftarak, për spastrimin e shfaqjeve të huaja të sipërpërmendura, porsa ato të nxjerrin kokën. Vigjilenca jonë revolucionare nuk duhet të jetë një formulë boshe që përsëritet orë e çast, vend e pa vend. Jo! Ajo duhet të zhvillohet në të gjitha drejtimet, të mbrojë çdo gjë të shëndoshë në Parti dhe në vendin tonë, të zbulojë dhe të luftojë nga rrënjet çdo të keqe. Kjo do të arrihet vetëm atje ku puna e Partisë zhvillohet me një diapazon masiv revolucionar, ku komunistët dhe populli i hyjnë mirë thelbit të problemeve, që do të thotë edhe anëve të mira, edhe të këqijave dhe punojnë, mendojnë e luftojnë në bazë të vijës së Partisë, si luttëtarë të vërtetë të saj. Këtë të mos e harrojë kurrë asnje anëtar partie.

4. — Të vëmë plotësisht në jetë mësimin e njohur të Partisë për t'i bërë organizatat-bazë qendrat më të rëndësishme të edukimit e të kalitjes së komunistëve. Edukimi i komunistëve është, në radhë të parë, detyrë e organizatave-bazë të Partisë; këto janë vendi më i mirë ku mishërohet lidhja e teorisë me jetën. Kështu

do të luftohet më me sukses edhe ndaj formalizmit e dogmatizmit që kemi në punën ideopolitike.

Çdo problem që shqyrtojmë, çdo masë që marrim, t'i shikojmë të pandara nga vija e përgjithshme e Partisë, të analizojmë gjithnjë përmbajtjen e tyre ideologjike e politike, të zbulojmë në këtë drejtim rrënjet e tyre. Të nisemi kurdoherë vetëm nga pozita të drejta parimore, nga interes i përgjithshëm, nga qëllimet e mëdha të Partisë sonë: ndërtimi i socializmit e i komunizmit, mbrojtja e fitoreve të popullit tonë, mbrojtja e atdheut socialist.

Në mbledhje të organizatave-bazë të Partisë të shqyrtohen, sa herë shihet me vend, probleme që kanë të bëjnë me edukimin dhe kalitjen e komunistëve, me rolin e tyre pararojë, të lidhura ngushtë me jetën e organizatave e të komunistëve.

Të luftojmë kundër kuptimit të ngushtë, sektar të formave të ndërtimit të Partisë, ashtu edhe kundër formalizmit e zyrtarizmit në mbledhjet e organizatave-bazë

Të mbajmë kurdoherë parasysh se format dhe normat organizative kanë themelin e tyre në jetë dhe përsëri në jetë e tregojnë ato gjallërinë e tyre. Lidhur me të ato duhet të pasurohen, po qe e nevojshme edhe të ndryshohen. Në jetë nuk mund të qëndrosh në vend, duhet të shkosh përpara, ndryshe mbetesh prapa. Marrëdhëniet reale, na mëson V.I. Lenini, nuk

janë gjë e vdekur, ato rrojnë e zhvillohen. Përcaktimet juridike mund t'i përgjigjen zhvillimit progresiv të këtyre marrëdhënieve, por ato gjithashtu (në qoftë se këto përcaktime janë të këqija) mund t'i «përgjigjen» regresit ose ngecjes në vend.

Jeta kërkon nga ne që t'i bëjmë më të zhdërvjellëta e më të shkathëta organizatat-bazë të Partisë, ndërtimin e punën e tyre, të pastrohen format dhe hallkat e tepërta, të zbatojmë ato forma që forcojnë punën e Partisë. Kjo ka rëndësi të madhe parimore e praktike.

1. — Të luftohet me forcë për gjallërimin e organizatave-bazë të Partisë. Jo forma, por përmbytja e tyre duhet të jetë kujdesi ynë kryesor. Në këtë drejtim duhet t'i ndryshojmë krejtësisht metodën tonë, kërkesat tona. Nuk janë as vendi i mbledhjes, as solemniteti bosh dhe as raporti i shkruar, ato që përcaktojnë brendinë dhe suksesin e punës së organizatës-bazë të Partisë. Përfundimi i zhvillimit të mbledhjeve duhet të matet me shqyrtimin e thellë të problemeve të ngutshme, me tërheqjen në zgjidhjen e tyre të të gjithë anëtarëve të Partisë, me përpunimin e masave që shpien në zgjidhjen e problemit dhe më në fund me zbatimin e tyre të plotë. Për mbledhjet e organizatës-bazë të Partisë duhet të përgatiten seriozisht të gjithë. Kjo është kryesorja. Mënyra e përgatitjes dhe e shqyrtimit të problemit mund të jetë e ndryshme. Raporti mund të jetë me shkrim ose me shënimë, mund të paraqitet vetëm projekti i masave që duhet të merren, mund të bëhen mbledhje të paparashikuara për gjëra që nuk presin ose të hidhet një çështje për diskutim, mund të shqyr-

tohen zbatimi i vendimeve ose çështje të ndryshme. Këtë duhet t'i zgjidhin vetë organizatat e Partisë, ashtu si duhet të zgjidhin edhe mënyrën e zhvillimit të mbledhjes, të drejtimit të saj etj. Rëndësi kanë përmrbajtja e analizës dhe sidomos përfundimi. Tre të katërtat e punimeve të mbledhjeve të organizatës-bazë të Partisë duhet ta zënë përpunimi, shqyrtimi dhe kontrolli i mësive që duhet të merren për zgjidhjen e problemeve. Vendimi duhet të jetë sinteza e të gjitha punimeve, rrahjes së mendimeve e propozimeve që bëhen në mbledhje.

Në punimet e mbledhjeve të organizatave-bazë nuk duhet të ketë as ngutje dhe as zvarritje. Ato mund të zgjatin gjysmë ore ose 10 orë. Koha varet nga problemi, nga mënyra e shtruarjes së tij, nga përgatitja etj. Nuk ka më të rëndësishme sesa mbledhjet e Partisë, prandaj asnjë nënveftësim nuk duhet lejuar.

2. — Komitetet e Partisë të rretheve, të mbështetura në parimet bazë, në Statutin e Partisë, tanë e tutje të zgjidhin vetë e me iniciativë ndërtimin e organizatave-bazë të Partisë.

Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH e konsideron me vend të ritheksojë se rregulli themelor në ndërtimin e organizatave-bazë të Partisë është kurdoherë bashkimi i të gjithë anëtarëve të Partisë që punojnë në një ndërmarrje, kooperativë bujqësore, institucion etj., në një organizatë-bazë të vetme të Partisë¹. Norma

¹ Më ndryshimet e pjesshme të bëra në Statutin e Partisë që miratoi Kongresi i 7-të i PPSH thuhet: «Organizatat-bazë të Partisë ngrihen në fabrika, uzina, ndërmarrje bujqësore, sta-

e domosdoshme për ngritjen e një organizate-bazë është 3 anëtarë partie. Mbledhja e përgjithshme e organizatës-bazë të thirret jo më rrallë se një herë në muaj. Njëkohësisht, deri në Kongresin e ardhshëm, derisa të bëhen ndryshimet përkatëse në Statutin e Partisë, Byroja Politike e Komitetit Qendror këshillon në mënyrë paraprake edhe këto masa:

a) Organizatat e Partisë të sektorëve¹ dhe grupet e Partisë të ngrihen atje ku shihet se një gjë e tillë është e dobishme, pavarësisht nga numri i përgjithshëm i komunistëve që ka organizata-bazë. Kujdesi kryesor i organizatave-bazë të Partisë dhe i komiteteve të Partisë, në këtë rast, nuk duhet të jetë si të sigurojë numrin e nevojshëm të komunistëve për t'i ngritur këto, po si është më e dobishme të organizohen forcat e Partisë. Ato duhet të ndërtohen drejt, sipas sektorëve të punës, atje ku komunistët zhvillojnë luftën më aktive për zbatimin e vijës së Partisë, mund të ngrihen për më shumë se njësi prodhimi, si për 1-2 ose 3 brigada të një fshati në kooperativat e bashkuara etj.

Komunistët kudo që punojnë, në sektor, repart,

cione të makinave e të traktorëve dhe në të gjitha ndërmarrjet e tjera ekonomike, në kooperativa bujqësore, në reparte të forcave të armatosura, në administratë, në institucione të ndryshme, si edhe në qendra të tjera pune e në lagje, ku ka jo më pak se 3 anëtarë partie».

1 Në vendimin e Byrosë Politike të KQ të PPSH Nr. 45, datë 8.4.1968, thuhet: «Në strukturën e ndërtimit të Partisë të mos ketë më organizata-bazë partie të ndara në organizata sektori, por të kemi si themel të Partisë organizatën-bazë të ngritur në reparte, sektorë, brigada, turne, kantiere...».

fshat etj., veç ose së bashku, të organizuar ose jo, të përgjigjen për mbarëvajtjen e punëve. Aq sa janë, ata duhet të mendojnë, të bisedojnë me njëri-tjetrin e të punojnë, të përcaktojnë qëndrime të përbashkëta. Ata duhet të vënë gjithashtu në lëvizje aktivistët që nuk janë anëtarë partie, të këshillohen me ta dhe së bashku të organizojnë zbatimin e detyrave.

Të drejtën për ngritjen e organizatave të Partisë në sektor dhe të grupeve të Partisë ta ketë vetë organizata-bazë e Partisë.

b) Në organizatat e mëdha, kur shikohet me vend nga komiteti i Partisë i rrëthit dhe me vendim të tij, mund t'u jepen organizatave të Partisë në sektorë e re-parate të gjitha të drejtat e organizatave-bazë të Partisë. Në këto raste, përveç mbledhjeve për dhënie llogari e zgjedhje, mbledhja e përgjithshme e organizatës-bazë të thirret kur dhe sa herë do të gjykohet e nevojshme.

c) Për drejtimin e të gjitha punëve të organizatoreve-bazë të Partisë zgjidhen sekretari, zëvendëssekretari (më shumë se një kur është e nevojshme), ose byroja e organizatës-bazë. Për të gjitha rastet, sipas nevojës dhe efektivit të Partisë, vendos organizata-bazë e Partisë. Të luftohet puna burokratike e sekretarëve dhe e byrove, ata të vendosin marrëdhënie të gjalla me komunistët dhe me punonjësit. Sekretarë funksionarë të organizatave-bazë, si rregull, të mos ketë më.

Në rastet kur organizatat e sektorit kanë të drejtat e organizatës-bazë të Partisë, byrotë e organizatave-bazë kanë të drejtë edhe të shqyrtojnë vendimet për pranimet e përjashtimet nga Partia. Kur këto i gjy-

kojnë të drejta, ia dërgojnë për aprovim organit më të lartë.

ç) Në raste të veçanta, kur ndërmarrjet apo institucionet janë mjaft të shpërndara, me sektorë të gjerë e të veçantë pune dhe me një numër të madh komunistësh, mund të krijohen sipas sektorëve, më tepër se një organizatë-bazë partie. Këto të lidhen drejtpërdrejt me komitetin e Partisë të rrëthit ose të rajonit ose me vendim të veçantë të Komitetit Qendror të Partisë mund të krijohen për këto organizata komitete partie me të drejtat e komiteteve të Partisë të rajoneve ose të zonave fshatare.

d) Në bazë të Statutit të Partisë në qendra prodhimi ose në sektorë të tjerë pune, ku ka më pak se 3 anëtarë partie, mund të krijohen grupe të Partisë dhe të rinisë. Të krijohen gjithashtu, atje ku paraqitet e nevojshme, grupe të Partisë dhe të bashkimeve profesionale. Në to, të bëjnë pjesë anëtarët dhe kandidatët për anëtarë partie dhe disa nga anëtarët e organizatës-bazë të bashkimeve profesionale. Një grup i tillë të drejtohet nga një anëtar partie i caktuar nga komiteti i Partisë i rrëthit, i rajonit ose i zonës.

Me këto orientime Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH nuk ka për qëllim të zëvendësojë një palë formash me një tjetër, ose të radhitë një sërë formash e metodash pune të gatshme për çdo rast, për çdo gjë që del në praktikë. Po të vepronim kështu, në vend që të arrijmë qëllimet e duhura dhe të gjallërojmë më tej jetën e Partisë, ne do ta fishknim e do ta burokra-

zonim atë. Këtë duhet ta mbajmë vazhdimisht parasysh në tërë punën.

Partia e Punës e Shqipërisë është Partia e revolucionit. Parimet dhe normat e organizimit të saj nuk përbëjnë një qëllim në vetvete, por i shërbejnë zhvillimit të saj revolucionar, janë kurdoherë në funksion të planeve madhështore që ajo harton për fitoren e socializmit e të komunizmit.

Tani detyra e parë është të rritet roli i luftëtarit pararojë, të rritet vrulli revolucionar e krijues i komunistëve dhe i organizatave të Partisë, që ato, si kurdoherë, t'i prijnë përpara lëvizjes së madhe që ka përfshirë të gjithë punonjësit.

Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH mendon se këto orientime do t'i shërbejnë pikërisht këtij qëllimi të madh. Të ngremë pra edhe më lart rolin e organizatave-bazë si qendra luftarake të Partisë sonë, si çerdhe të vërteta revolucionare, si shkolla të mëdha kulturale.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë si pas originalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

DISA KONKLUZIONE FILLESTARE MBI PUNIMIN E VENDIMIT TË BYROSEË POLITIKE PËR LUFTËN KUNDER BUROKRATIZMIT

*Fjala në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH*

3-4 shkurt 1966

Përpilimi i vijës së Partisë në të gjithë sektorët e jetës, duke u bazuar në vendimet e kongreseve dhe në zërthimin e këtyre vendimeve, ruajtja e pastërtisë marksiste-leniniste të vijës dhe zbatimi i saj korrekt, duhet të jetë preokupacioni ynë më i madh.

Praktika, lufta e përditshme e Partisë dhe e popullit dhe rezultatet e arritura, me anët e tyre të mira dhe të këqija, duhet të jenë ato që të na vërtetojnë saktësinë e vendimit, frymën e tij, domosdoshmërinë ose jo të marrjes së tij, lehtësitë ose vështirësitë e hasura gjatë zbatimit. Praktika dhe lufta duhet të na vërtetojnë saktësinë e vijës, ruajtjen e pastërtisë së saj dhe kur duhet e bëhet i domosdoshëm një korrigjim.

Këto parime nuk mund të themi se nuk i dimë. Do të ishte gjithashtu gabim të thoshim se i dimë, po nuk i kemi zbatuar. Unë mendoj se është e drejtë të njohim se këtyre parimeve udhëheqëse duhet t'u futemi e t'i kuptojmë më thellë, në teori e në praktikë dhe t'i zbatojmë më mirë nga sa i kemi zbatuar deri tanë.

Praktika dhe lufta na vërtetojnë se vija e Partisë ka qenë dhe është e drejtë, se Partia jonë monolite dhe në një unitet të çeliktë me popullin e ka përqafuar, e ka mbrojtur, e ka zbatuar atë me shumë sukses nëpërmjet shumë furtunash.

Të gjitha këto suksese kolosale materiale, morale, kulturore, politike, ushtarake, që janë arritur në Republikën tonë Popullore, vërtetojnë drejtësinë e vijës së Partisë sonë. Vetëm një parti marksiste-leniniste me një vijë të drejtë mund t'i arrijë këto rezultate në kushte të vështira dhe në koniunktura politike të jashtme të koklavitura.

Pra, fari i Partisë ka qenë i ndritur dhe bilanci është pozitiv. Kjo është kryesorja, është fitorja më e madhe, siguria përfitore të ardhshme, është siguria përfitoren e plotë edhe mbi anën tjetër të medaljes, mbi anën e bilancit negativ që është vërtetuar në punën tonë dhe që Partia, me Komitetin Qendror në krye, ka marrë përsipër ta likuidojë sa më parë.

Prandaj ne duhet të studiojmë dhe të analizojmë thellë gabimet e shtrembërimet që na janë vërtetuar në punën e Partisë dhe të pushtetit.

Ne, si kurdoherë, ashtu sikurse na edukon Partia, edhe në këto analiza vije për korrigjin e të metave dhe përvendosjen e disa parimeve të reja revolucionare.

nare në disa sektorë aktiviteti, duhet të ngrihem i lart mbi gjërat e vogla, të hedhim tej çfarëdo subjektivizmi, çfarëdo mbeturine, qoftë edhe e vogël, mikroborgjeze, të mos u vëmë rëndësi shprehjeve, por brendisë, qëllimit të madh që na frysmezon të gjithëve në këtë punë, të shprehim lirisht mendimet, qofshin këto edhe me gabime, t'i diskutojmë këto si marksistë, me gjakftohësi, pa *parti pris*, pa ngulur këmbë në një mendim, kur logjika e jetës nuk e vërteton.

Të analizohen me një sy kritik marksist-leninist zhvillimi i gjithë punës, puna dhe mendimet e cilidoshoku nga ne, të çdo anëtarë partie në çdo vend, në çdo kohë e në çdo pozitë që ai të ndodhet. Kjo është metoda më e drejtë që na ka frysmeuar dhe që duhet të na frysmezojë orë e çast, edhe tani, edhe në të ardhmen.

Rrallë gjenden në Partinë tonë njerëz që të kritikojnë shokun për ta denigruar. Zor të gjejmë shokë në udhëheqjen e çdo shkalle të Partisë dhe asnje shok në Komitetin Qendror që të kritikojnë me qëllim të keq shokun e tyre të punës dhe të luftës.

A duket këtu ndonjë dozë oportunizmi? Mendoj se jo. A ka këtu ndonjë dozë, qoftë edhe të vogël frikose druatjeje? Jam plotësisht i bindur se jo. Kritika parimore është një garanci e madhe e unitetit të Partisë sonë, e udhëheqjes së saj. Sa më shumë t'i forcojmë këto parime, sa më shumë t'i revolucionarizojmë ato, aq më tepër do të kalitet uniteti i mendimit dhe i veprimit, aq më shumë do të forcohen dashuria dhe respekti revolucionar për njëri-tjetrin, aq më shumë do të çmohet puna e njerëzve dhe rezultatet e punës së Partisë do të jenë edhe më të mëdha.

Për Partinë ne duhet të mendojmë kur flasim dhe veprojmë, të mendojmë e të luftojmë sot për nesër e për pasnesër që stafetën ta lëmë në duar të pastra, të çelikta, besnikë të Partisë dhe të popullit.

Puna e Partisë po vazhdon me vrull në të gjithë vendin për të spastruar ferrat dhe të këqijat që po na zinin këmbët. Ne gjendemi si përpara një kazani që vlon, për të ngritur cilësinë e punës.

Jeta po vërteton se vendimet që kemi marrë kohët e fundit kanë qenë plotësisht të drejta dhe absolutisht të nevojshme e të domosdoshme. U vërtetua se duhej të bëhej korrigjimi i të metave në disa drejtime në mënyrë revolucionare, sistematike e të organizuar mirë.

Nga ana tjetër u vërtetua edhe një herë parimi bazë i punës së Partisë sonë se vetëm duke u mbështetur në vijën e masave, domethënë duke ngritur në këmbë gjithë Partinë dhe popullin do të korrigjojen të metat dhe dobësitetë në punë.

Koha vërtetoi se arsyaja dhe qëllimet që e shtynë Byronë Politike për të marrë këto vendime ishin të drejta, thellësisht marksiste-leniniste, se ato u përqafuan me entuziazëm, u bënë të tyret nga e tërë Partia, nga i gjithë populli dhe se nga të gjithë luftohet me gjallëri për t'i zbatuar. Kjo vërtetoi pjekurinë e Partisë sonë dhe guximin e saj revolucionar.

Të vijmë tani te gabimet e të metat në punën tonë. Këto janë me të vërtetë shumë serioze, s'duhet të na shkojë në mendje t'i bëjmë ndonjë zbutje këtij mendimi, por edhe as ta nxjmë realitetin. Përpara këtyre të metave ne duhet të qëndrojmë si marksistë, t'i shohim këto në sy, pa frikë, t'i analizojmë, t'i kritikojmë

e t'i ndreqim pa atë «turpin» mikroborgjez. Këtë ta konsiderojmë një shkollë të madhe dhe nga të gjitha këto ndodhi të këqija të nxjerrim mësime që të mos na ngjasin më gjëra të tilla.

Por në fillim problemin po e shtroj kështu: A është e lehtë për ta kuptuar thellë të gjithë këtë punë, për ta zbatuar si duhet e deri në fund këtë orientim të drejtë? Edhe po, edhe jo. Kjo varet nga puna, nga metoda dhe stili i punës së Partisë. Kjo ka rëndësi të madhe.

Shumica dërrmuese e kupton drejt. Ka edhe prej atyre që kuptojnë disa aspekte të kësaj çështjeje, kurse disa aspekte të tjera nuk i kanë plotësisht të qarta dhe nuk shohin dot akoma perspektivën e gjerë. Disa, që përgjithësisht janë të lëkundurit, përpiken të kuptojnë esencën, por kanë tronditje dhe shohin akoma turbull. Megjithatë puna masive këta i shtyn përpara. Ka pastaj disa që nuk i kuptojnë këto ose nuk duan t'i kuptojnë. Partia e ka për detyrë imperative t'i bëjë të gjithë të qartë, t'i bindë dhe t'i kthejë të gjithë në luftëtarë të pararojës.

Kjo, pra, lyp një punë të zgjuar, të shkathët, të diferencuar, të përditshme, në të gjitha sferat, në të gjitha shfaqjet, në të gjitha hallkat e punës, të mendimit, të krijimit. Pikërisht dhe këtu, në radhë të parë, duhet të luftohen burokratizmi e rutina në format, në metodat dhe në stilin e punës së Partisë. Kjo duhet të fillojë që nga lart, ne duhet të japim shembullin, tonin. Kjo ka rëndësi të dorës së parë dhe do ta shpjegoj edhe më poshtë.

Por më parë dua të theksoj disa mendime e konstatime të miat:

Nga të katër anët po punohet në drejtim të përcaktimit të kompetencave, të organikave, të spastrimit të shkresave, të rishikimit të ligjeve, urdhëresave, rregulloreve, të zhdukjes së burokratizmit si koncept i urryer pune dhe si shfaqje në praktikë, po punohet me gjallëri dhe me fryshtë të lartë revolucionare për kalliten e ushtrisë, të punonjësve të Ministrisë së Punëve të Brendshme e të efektivit të tyre, për t'i bërë këto me tërë kuptimin e fjalës demokratike, sa më afër popullit, plotësisht nën drejtimin e Partisë dhe vijës së saj. Pra, po bëhet punë e madhe.

Konstatimet e mia janë se çdo ditë kjo punë po bëhet më e kualifikuar e më mirë, njerëzit po u futen çështjeve, kuptojnë më mirë parimet politiko-ideologjike dhe organizative që e fryshtojnë këtë punë dhe që janë kyçet *sine qua non* të suksesit.

Po, a mund të themi se çdo gjë është kuptuar themillë? Jo. Edhe vetë ne, këtu, nuk guxojmë ta themi këtë gjë. Unë, për personin tim, e pohoj se, po të afirmoj një gjë të tillë, do të gaboj dhe do të dëmtoj. Ne kemi shumë për të reflektuar, për të mësuar. Ne e kemi të qartë ku po shkojmë dhe përse po shkojmë, ne kemi dhënë edhe udhëzime e orientime si duhet të kuptohet dhe të punohet për këtë çështje dhe mund të themi se orientimet e përgjithshme janë të drejta, por nga ana tjetër nuk duhet të mendojmë se kemi gjetur format e metodat më të përsosura të punës. Ne kurdoherë kërkojmë, ne do të vazhdojmë të kërkojmë më të mirën për të zëvendësuar më pak të mirën ose atë që nuk e vërteton jeta.

Ku do ta gjejmë këtë të mirë? Në librat teorikë të klasikëve do të gjejmë parimet orientuese. Ne nga

ato do të nxjerrim mësime, do të frymëzohemi, ato do të jenë busulla jonë. Por, me këtë busull në dorë, ne duhet të orientohemi në terrenin shqiptar, në fushat dhe në fabrikat e Shqipërisë, në kushtet materiale të vendit tonë. Ne do të llogaritim punën me njerëzit tanë, me ndjenjat, botëkuptimet, ngritjen e nivelit politik e ideologjik të njerëzve tanë që nuk janë të standardizuar për çdo vend e për çdo kohë.

Të gjithë njerëzit që punojnë për spastrimin e burokratizmit dhe për të gjitha punët që përmenda më lart, a janë vallë të armatosur si duhet, a kanë bërë ata vetë në një muaj kthesën totale nga fryma, metoda dhe stili i vjetër i punës, a janë zhveshur ata nga fryma e repartit, nga fryma dikasteriale, nga nostalgjia e frysës së komandimit, nga konceptet e vjetra të organizimit etj., etj.? Do të tregoheshim naivë po të mendonim se çdo gjë është arritur.

Në gjithë këtë gamë çështjesh, çdo gjë ka anën politike, atë ideologjike, organizative e teknike dhe mendoj e këshilloj se edhe ai që në cilëndo nga këto fusha hiqet si më i armatosuri, ose më i dituri, duhet të jetë modest dhe i duhet akoma shumë të mësojë në shkollën e Partisë dhe të popullit.

Pra, e vetmja shkollë e drejtë, e vetmja zgjidhje e drejtë politike, teknike, organizative për të gjitha këto probleme që kemi në shesh, është shkolla e Partisë dhe e popullit në të gjitha format, në të gjitha hallkat e punës që dimë dhe që vazhdimisht duhet t'i përmirësojmë e t'i vëmë plotësisht në lëvizje. Ne kemi marrë dhe po marrim masat e para si nga ana e aparateve të Partisë, ashtu dhe nga ana e pushtetit.

Shkurtimi në maksimum i shkresave nga ana e aparatave të Partisë ishte një gjë e thjeshtë. Por kjo është një pjesë e vogël e punës. Kryesorja është që e tërë Partia duhet të çohet kudo në këmbë, të kryejë detyrën që ka në drejtimin e pushtetit. Në pushtet ka burokraci të madhe, atje është puna më serioze, më e rëndë, më e zorshme, më e koklavitur. Shthurja e lëmshit në pushtet, të mos gabohemi, nuk është një çështje vetëm specialistësh ose teknikësh të financës, të pagave ose të planit. Ajo, në radhë të parë, është çështje politike, është politika e teknikës, politika e ekonomisë, e planifikimit dhe e çdo gjëje më të vogël. Kështu duhet ta kuptojnë këtë të gjithë njerëzit, me parti e pa parti. Kjo çështje nuk duhet kuptuar gjithashtu sikur duhet të vijë një person nga aparati i Komitetit Qendror ose një sekretar i Komitetit Qendror të japë vijën. Ky do të ishte një gabim. Rruga e vetme, rruga e drejtë është ajo që gjithsecili t'i shkojë vetë, deri në fund, anës politike të problemit, të mos i qëndrojë këtij anës, në sipërfaqe dhe, kur nuk e kupton, kur nuk e ka të qartë, kur nuk e gjen dot, të përpjekë kokën te nëna Parti, te shoku i Partisë, te punëtori, te bujku dhe me siguri do ta gjejë rruqën e drejtë të zgjidhjes, sepse kjo zgjidhje e drejtë nuk mund të bëhet me skema, pa njojur thellë kuptimin politik dhe ideologjik të së tërës dhe të çdo pjese.

Tani do të shtroj një çështje tjeter që mund të duket sikur nuk ka lidhje me problemin që po diskutojmë, por që në fakt ka lidhje.

Para disa ditësh ne bëmë një mbledhje të shkurtër të Sekretariatit të Komitetit Qendror, ku u bëra shokëve disa propozime se si të provojmë disa forma e më-

toda të reja pune në Sekretariat. Shokët, mbasi diskutuan mbi propozimet e mia, ranë dakord.

Cilat ishin këto propozime? Të zgjerohen format e punës në Sekretariat e të mos mbetemi në format e vetme të zakonshme:

a) Forma e punës që zhvilluam atë ditë të jetë një formë. Ajo ishte një mbledhje e Sekretariatit pa raporte të parapërgatitura e pa të ftuar. Një formë të tillë ne mund ta praktikojmë, por kurdoherë me konkluzione.

b) Çdo sekretar i Komitetit Qendror mund të propozojë mbledhjen e Sekretariatit për një problem që ai e shikon të arsyeshëm se duhet të diskutohet dhe të merrët vendim në Sekretariat. Kjo mbledhje mund të jetë e shkurtër, por me kusht që çështja që shtrohet të jetë e rëndësishme dhe që del nga kompetencat e sekretarit të Komitetit Qendror i cili e shtron, që del nga kompetencat për të marrë masa nga dy sekretarë së bashku ose me një konsultim me Sekretarin e Parë të Komitetit Qendror.

c) Kur më shumë se dy sekretarë të Komitetit Qendror shkojnë në bazë për ndihmë e kontroll mund të provokohet mbledhja e Sekretariatit, pa raporte të përgatitura, duke thirrur ose jo edhe shokë kryesorë të aparatit. Mbledhje të tillë kanë rëndësi informative mbi gjendjen, mbi zbatimin e vendimeve, mbi masat evenuale që duhet të merren. Edhe në këtë lloj mbledhjeje të Sekretariatit merren vendime nga propozimet që mund të bëhen, por kurdoherë vendimet të merren kur janë të domosdoshme dhe të mos janë përsëritje të perifrazuara të vendimeve të marra më përpara. Në secilën nga këto mbledhje duhet të vlerësohet puna e sekre-

tarit të Komitetit Qendror, në mënyrë që ai të ndihmohet.

ç) Mbledhje me raport, ku të marrin pjesë shokë të aparatit të Komitetit Qendror dhe të ftuarit e interesuar për problemin. Raporti në këtë rast të jetë i qartë dhe mund të ketë vendim (i cili të jetë i qartë dhe vetëm në rast se nuk ka vendim tjetër të njëllojtë). Në rast se nuk ka vendim për një problem, atëherë konsiderohet si raport informativ për Sekretariatin dhe ndihmë e këtij dhënë sektorit për të cilin informon raporti.

Në të gjitha rastet, për çdo sekretar të Komitetit Qendror dhe për të ftuarit në Sekretariat, kryesorja e diskutimit dhe e raportimit duhet të jenë dy gjëra:

1. — Zbatimi dhe kontrolli i vendimeve e i direktivave.
2. — Kontrolli i ruajtjes pastër të vijës së Partisë në punën praktike.

Shembujt e mirë dhe të këqij, jo të zënë vendin kryesor, po të shërbejnë për të ilustruar dy të parat dhe vendimet që propozohen të merren.

Çdo sekretar i Komitetit Qendror ruan dhe zbaton kompetencat në sektorin e vet, pa asnjë kufizim dhe për çdo gjë mban përgjegjësi të plotë e përgjigjet përpara udhëheqjes kolektive sa herë që kërkohen shpjegime prej saj. Kjo nuk përjashton aspak konsultimet me shokët e tjerë sekretarë dhe koordinimin e punës me njëri-tjetrin. Përkundrazi kjo është e domosdoshme. Këshillimet me njëri-tjetrin janë shumë të nevojshme dhe nuk kanë e nuk duhet të kenë karakterin e marrjes së kompetencave të njëri-tjetrit ose të bëhen pengesë e iniciativës krijuese.

Nga ana tjetër, çdo sekretar i Komitetit Qendror është gjithashtu përgjegjës për zbatimin e vendimeve të sekretariatit të marra si udhëheqje kolektive edhe në sektorë jashtë sektorit të tij, ku përgjegjës është sekretari përkatës. Kjo nuk duhet të kuptohet e të zbatohet si ndërhyrje në punën dhe në përgjegjësinë e tjetrit, si ortakllëk në përgjegjësitë, por duhet të kuptohet e të zbatohet në kuptimin e drejtë realist që punët e Partisë dhe të sektorëve nuk janë të ndara me mure dhe se zbatimi e kontrolli i zbatimit të vendimeve është një çështje e tërë e Partisë e lidhur ngushtë me njëri-tjetrin, është çështje e njëjtë vije, për të cilën jemi përgjegjës të gjithë, si individualisht ashtu dhe kolektivisht.

Duhet kuptuar mirë e thellë se puna dhe drejtimi kolektiv kanë rëndësinë më të madhe vendimtare në marrjen e vendimeve dhe në orientimet. Mbledhjet e forumeve udhëheqëse dhe vendimet që merren do të jenë të frytshme e të drejta, vetëm atëherë kur ato bëhen në kohën e duhur dhe për çështje të rëndësishme që i lypin situata, nevoja reale. Këto situata, këto nevoja, nuk mund vetëm të imagjinohen, por duhet të diktohen nga puna, nga lufta, nga kushtet. Për t'i përcaktuar drejt këto, duhet, pra, të kuptojmë c'rëndësi e c'përgjegjësi ka puna e sekretarëve të Komitetit Qendror dhe e bashkëpunëtorëve të tyre, individualisht dhe si kolektiv, në hartimin e tematikës së problemeve të sektorëve të tyre; sa rëndësi dhe sa përgjegjësi ka pastaj për cilindo nga ne sekretarët e Komitetit Qendror të nxjerrim konkluzionet politike, ideologjike, organizative nga çështjet dhe këto të dimë t'i paraqesim në

kohën e duhur dhe si duhet për t'i diskutuar dhe për t'i vendosur kolegjialisht.

E gjithë kjo, mendoj, nuk duhet kuptuar si skemë, nuk është një çështje formale, sepse atëherë do të ishte shumë e thjeshtë të thoshim se «bëjmë katër lloje mbledhjesh të Sekretariatit të Komitetit Qendror dhe mbaroi». Në qoftë se këtë e kuptojmë formalisht, atëherë mbledhje do të bëjmë, por do të duket sikur s'bëjmë fare dhe takimet tona të përditshme do t'i quanim si mbledhje, kështu që puna jonë si udhëheqje do të kthehej në një punë të vogël praktike. Kjo është e rrezikshme, ashtu sikurse është e rrezikshme edhe metoda e parë e punës me raporte të gjata, me diskutime të gjata nga ne dhe nga ana e të ftuarve etj.

Metoda e punës e forumeve, lart dhe poshtë, ka një rëndësi të jashtëzakonshme për vetë udhëheqjet kollektive të Partisë dhe të pushtetit dhe influencon direkt, i jep tonin stilit të punës të çdo udhëheqësi, i cili i përshtatet kësaj metode dhe influencon edhe te të tjerrët.

Për metodën e punës sonë si udhëheqje partie dhe shtetërore ka vend për shumë kritika, po ashtu edhe për stilin tonë të punës. Shumë herë e kemi kritikuar këtë metodë dhe stil pune, kemi bërë korrigjime, por prapë duhet të bëjmë. Kjo është e natyrshme dhe s'duhet të na çuditë, por duhet të shohim faktet. Nga metoda e punës sonë kamë rrjedhur mjaft gjëra që po analizojmë sot.

Unë, shoku Mehmet e shokë të tjerë të udhëheqjes kemi qenë shumë herë të shqetësuar për metodën dhe stilin e punës në Qeveri dhe sidomos në Kryesinë e

Këshillit të Ministrave. Nuk kishte mbledhje Kryesie, ku të mos merreshin në studim minimumi 40 probleme, shumë herë ato arrinin edhe deri në 60-70. Të gjitha këto studime ishin mbushur me shifra, me statistika, me vendime, me rekomandime, me vërejtje të renditura me dy lloj numrash dhe me një sërë shkronjash të alfabetit. Këto, natyrisht, kthehen në ligje, urdhëresa, rregulllore etj. Administrata ishte pjellore dhe rrihte me valë të pandalshme Qeverinë. As mund të mendohet t'i dilej mbanë një pune të tillë.

Si është e mundur të studiohen seriozisht e të vendoset drejt mbi kaq shumë materiale? Si ishte e mundur të gjendej kohë brenda një mbledhjeje, ku të diskutohej e të rriheshin mendime për to? Një gjë e tillë rrridhte sepse ministritë nuk u kishin lënë sa duhej kompetenca, prandaj ato, për çdo gjë, bënин rapporte me kërkesa. Ne duhet të mendojmë jo vetëm për atë mori njerëzish që duheshin për t'i bërë gjithë këto materiale, ç'kohë u hante atyre kjo punë, në dërgim e në kthim të raportit, por edhe se këtej kanë gjetur portën hapur shumë nga urdhëresat, ligjet e rregulloret që ne tani po i kritikojmë.

Por, nuk është vetëm ky burimi i fajt. Të gjithë ne jemi fajtorë për një interesim të njëanshëm të problemit si tërësi dhe të çdo problemi në veçanti.

Në përgjithësi, gjëja që na ka preokupuar më shumë ishte çështja ekonomike. Kjo mund të thuhet nuk është keq, edhe unë kështu mendoj, por e keqja është se për probimet e tjera që janë të lidhura me problemen ekonomik nuk jemi interesuar si duhet dhe sa duhet.

Na ka hipur mania e shifrave dhe e statistikave, neve në qendër dhe atyre në bazë. Çdo gjë e shpjegojmë me këto dhe është arritur në mendimin se ai që mban mend dhe reciton shifra e përqindje, ai është i zoti, ai është ekonomist, ai di situatën dhe di të drejtøjë.

Porsa vete njëri nga ne në bazë, në kontaktin e parë me udhëheqjen, sekretari do të fillojë me përqindjet e realizimit të planit. Pas kësaj fillon bën kérkesat. Pasi e mbaron këtë «detyrë», udhëheqësi e pyet sekretarin ose kryetarin: «Ç'kemi gjë tjetër?», se ai nuk është mësuar të të thotë vetë. Ai të përgjigjet: «S'kemi gjë, qetësi, shumë mirë, populli është i kënaqur, kemi një popull patriot». Pastaj shokët të pyesin ku ke qejf të bësh vizita dhe më në fund të kërkojnë t'u flasësh kuadrove në një mbledhje, pa përsë t'u flasësh, atë e di vetë udhëheqësi në fjalë, ç'të dojë, çdo gjë do të jetë e mirë.

Unë personalisht kam qenë i revoltuar nga një gjë e tillë dhe kësaj i shtohej mërzia, sepse kudo është përhapur mendimi i gabuar se «nuk duhet ta shqetësojmë shokun Enver kur vjen në bazë». Pra, del se vajtja e shokut Enver në bazë konsiderohet si paradë, gjë që e kam urryer dhe e kam luftuar kurdoherë.

Çështja tjetër që do të them më poshtë është parimore dhe shumë serioze për Partinë.

Ç'është kjo çështje?

Kjo ka të bëjë me atë që kemi analizuar, kemi marrë masa, kemi dhënë udhëzime si të veprohet, por prapë Partia nuk e ka kuptuar si duhet dhe është absolutisht e nevojshme të punohet që ajo ta kuptojë drejt.

Çështja është te propagandimi im në mënyrë të tenuar.

Ne kemi udhëzuar të ndalohet skandimi i emrit tim, kurse ky vazhdon edhe më shumë se më parë. Kjo duhet të marrë fund.

Kemi udhëzuar që fotografitë e Byrosë Politike të vihen së toku. Kjo është forma më e drejtë, prandaj këtu përsëri Byroja Politike duhet të marrë masa dhe propozoj që të mbeten vetëm fotografitë kolektive të udhëheqjes. Kemi thënë gjithashtu se nuk është gabim, por pa ekzagjeruar, të vihen edhe fotografitë e veçuara të çdo shoku. Unë mendoj se fotografia ime në asnje mënyrë nuk duhet të lihet e veçuar dhe të hiqen të tjerat. Të ndalohet medoemos vënia dhe riprodhimi i busteve të mia. Mendoj se këtë e do interes i madh i Partisë. Partia dhe populli nga puna dhe lufta jonë ne na njeh, na do shumë e na respekton. Ç'nevojë kemi ne t'i bëjmë propagandë vetes? Ne duhet të jemi të thjeshtë.

Po ç'ngjet në lidhje me punën time në bazë? Ju, shokë e dini vetë, e thashë edhe më lart. Përpjekjet e mia janë të paefektshme, kudo që vete brohoritje, fjalime publike. As që mund të bëj dot një bisedim shtruar, të qaj një hall, të kërkoj shpjegime, të thelloj një problem.

Jam i mallëngjyer nga besimi që ka populli për Partinë, por mua më duket se shokët udhëheqës të bazës, çështjen e dallimit të kohës sime të punës dhe anës manifestive, as që e kanë parasysh. T'ju them të drejtëtë një situatë e tillë më shqetëson dhe më pengon në punë. Shumë herë ua përsërit shokëve në bazë këtë gjë,

por ata e marrin si modesti nga ana ime, kurse kjo ka anën e saj parimore, ka dhe atë që më pengon të punoj ashtu siç dua e mendoj unë se është më mirë dhe më e dobishme.

Prandaj i kërkoj Byrosë Politike t'i ndreqim këto.

Unë propozova një metodë pune për mbledhjen e Sekretariatit të Komitetit Qendror, se është krijuar një gjendje që mbledhje pune të konsiderohen vetëm ato me raporte të shkruara. Në këto mbledhje ne as që marrim mundimin të shtrojmë një problem serioz jashtë raportit, sepse edhe raportet nuk na lënë kohë. Kur ndonjë shok fillon të shtrojë ndonjë problem që atij i duket i rëndësishëm, atëherë i themi «të studiohet dhe të na paraqitet», domethënë ta studiojë aparati, administrata, pastaj ta marrim në diskutim.

A është e lejueshme dhe e frytshme që eksperiencia që sillet nga baza, nga një udhëheqës kryesor, gjenda e rrëthit në përgjithësi ose e një problemi në veçanti, masat që ai mori në vend ose ato që mendon të marrë, të thuhen fluturimthi, nëpër këmbë apo në formë muhabeti? Ne nuk përfitojmë kështu nga eksperiencia e njëri-tjetrit dhe nga ajo e bazës. Shoku që shkon me detyra në bazë, nuk e ndien si duhet përgjegjësinë përpara kolektivit dhe detyrën e tij, punën e tij, nuk ia shtron syrit kritik të kolektivit. Ai nuk mundohet kështu të nxjerrë kurdoherë konkluzione të përgjithshme dhe të veçanta që të përmirësojnë ose të ndryshojnë një situatë.

Rezultat i hidhur i një kompleksi të tërë që rrjedh nga një metodë pune me gabime, janë të gjitha këto që na kanë dalë, që i kemi parë dhe nuk i kemi parë,

që kemi marrë vendime të çala ose s'kemi marrë fare; që disave u kemi vënë rëndësi, disa të tjera i kemi trajtuar shumë lehtë, jemi përpjekur t'i korrigojmë efektet, por nuk kemi korrigjuar arsyet, jemi treguar më shumë udhëheqës prakticienë, sesa udhëheqës politikë.

Çështjen e politikës së gjërave, ne, udhëheqësit kryesorë në radhë të parë, jo se e kemi neglizhuar, jo se nuk e kemi pasur parasysh në ligjet, në urdhëresat, në shtruarjen e problemeve të çdo lloji, por nuk e kemi kontrolluar sa duhet këtë politikë gjatë zbatimit. Kjo ka mësuar keq edhe bazën, sepse ndryshe, në rast se i vinim rëndësi kësaj ane, me kohë do të ishim hedhur përpjetë edhe ne edhe baza, siç u hodhëm tanë, kur të shihnim se si e kemi rënduar atë me një mori gjérash.

Ne duhet të analizojmë në mënyrë kritike punën tonë në bazë, në rast se duam të gjejmë metodën dhe stilin më adapt. Mendoj se vajtja jonë në bazë ka dhënë rezultate të mëdha ekonomike, politike, ushtaraKE, arsimore dhe në çdo fushë tjetër, por gjithashtu ne duhet të njohim se vajtja jonë atje për ndihmë e kontroll nuk ka qenë kurdoherë dhe sa duhet e frytshme.

Ne shkojmë në bazë në dy mënyra, në mënyrë të organizuar e me plan, por edhe në mënyrë të lirë. Kur mbledhjet janë të caktuara, qofshin këto të çdo natyre, partie ose shtetërore, ne shkojmë disi të përgatitur, po jo plotësisht. Pasi e mbarojmë këtë detyrë të caktuar, atëherë ne na mbërthen rutina në rrith. Por sidoqoftë, në këto vajtje nuk ka karambolazhe.

Kurse kur shkojmë në mënyrë të lirë, jo se vemi në

bazë pa qëllim, një qëllim kurdoherë caktohet ose gjen-det, por në këtë rast ne vemi për çdo gjë që na del përpara dhe, si pa gjë të keq, të gjithë pa përjashtim, kryejmë edhe funksionin e detyrën e ministrit, të drej-torit, të inspektorit dhe jo të të njëjtë sektor, por të shumë sektorëve.

Baza na mbush me kërkesa dhe, kur e pyet si është situata, ajo të përgjigjet: «Çdo gjë është mirë». Mbi ci-lin, pra, bien efektet e këtyre të metave, të këtyre mungesave? Sigurisht mbi masat. Atëherë si mund të gjykohet se situata është e mirë? Kësaj i thonë të biesh në gjumë.

Por, kërkesat që na bëhen nevë udhëheqësve dhe që janë të drejta, duhet të na preokupojnë. Ministrat, drejtorët, inspektorët, shefat, moria e kontrollorëve që ndodhen me qindra çdo ditë nëpër rrethe dhe vijnë vërdallë për «kontroll e ndihmë», duhet të dëgjojnë më me vëmendje vërejtjet e kërkesat e bazës dhe kur ato janë të drejta të marrin masat e duhura pa vonësë.

Edhe ne anëtarët e Byrosë Politike, kur kthehem nga rrethi, nuk i nxjerrim si duhet konkluzionet e ne-vojshme, nuk shkëmbejmë eksperiencën dhe të gjemë mënyrën e shpejtë dhe efektive, t'u bëjmë të qartë shokëve se në filan vend gjeta një situatë të tillë, mora këto masa etj. dhe jo vetëm në sektorin e vet, po kudo.

Si këto ka mjaft defekte në metodën e në stilin tonë të punës, për të cilat ne duhet të reflektojmë thellë, sepse për çdo gjë, në kontaktet me bazën që duhet të zënë punën tonë kryesore, ne duhet të bëjmë një punë të gjallë, të efektshme, sepse kjo, ashtu

si ka ánët e mira, ka edhe anët e këqija, në rast se nuk bëhet me plan, bëhet jo e studiuar, për gjëra të vogla dhe nuk dilet me konkluzione. Në këtë rast puna jonë reduktohet në një prakticizëm, nuk marrim masa rrënjosore atje ku na dhemb, nuk e përgjithësojmë si duhet e kur duhet masën e marrë, ose marrim shumë masa të ndryshme, të shpejtuara, pa arsyё të shëndosha dhe nga të gjitha këto na dalin gjëra të pa-pëlqyera.

Mbi këtë temë mund të zgjatemi edhe më shumë po të duam, por unë dëshiroj të kuptojmë mirë se nga stili dhe metoda e punës sonë ka gjetur rrugë dhe terren burokratizmi në aparatet e Partisë dhe të shtetit.

Me qëllim që e gjithë Partia të bëjë një spastrim rrënjosor të elementeve burokratike në të gjitha aparatet e saj dhe të shtetit dhe që këtë ta bëjë si duhet e me baza, duhet të kuptojë, në radhë të parë, rrezikshmërinë e burokratizmit, prejardhjen e tij politikisht e ideologjikisht. Pa e kuptuar këtë çështje politikisht e ideologjikisht, spastrimi që po bëjmë mund të ketë përsëri karakter burokratik, thjesht teknik dhe ka rreziqe të shfaqet prapë në forma të ndryshme. Tani që po zhvillohet kudo kjo luftë, flitet ose mendohet me njëfarë habie: «Si na janë futur këto elemente burokratike në punën tonë? Si nuk i kemi parë si duhet qysh më parë dhe nuk kemi marrë masa rrënjosore me kohë për t'i penguar të zhvilloheshin dhe t'i zhduknim?». Këtë problem ne duhet ta kuptojmë thellë, ta shpjegojmë politikisht dhe ideologjikisht, sepse nuk kuptohet si duhet nga të gjithë. Rrezikshmëria shikohet, ky është një fakt pozitiv, njerëzit mendojnë dhe veprojnë për

ta zhdukur, por nuk thellohen sa duhet për të kuptuar si na erdhi kjo sëmundje.

«Kjo tani u bë, — thuhet, — përgjegjësi kemi të gjithë, na kaloi». Ky nuk është një mendim i thelluar, po një konstatim i thjeshtë që nuk vërteton asgjë, që nuk zgjidh gjë si duhet. Këtij i shtohen arsyetime të tjera: «S'kemi pasur eksperiencë dhe çdo gjë e bënim duke menduar se ishte mirë; eksperiencën e huaj që merrnim nuk e kemi parë me një sy kritik dhe pjesën e shëndoshë të kësaj eksperience nuk e kemi përshtatur si duhet në situatat tona objektive; ka pasur arsy Objektive, ka pasur mungesa që n'a është dashur t'i kapërcenim, pa vërejtur si duhet dhe sa duhet mënyrat, stilin, metodën e kapërcimit; pastaj ka ekzistuar presioni i armiqve të jashtëm, presioni i armiqve të brendshëm, presioni i vazhdueshëm i mentalitetit borgjez e mikroborgjez» etj., etj.

Të gjitha këto janë të vërteta, këtu qëndron çështja kryesore, por cilado prej këtyre të vërtetave e sidomos disa prej tyre, duhet të bëjnë objektin e një analizë marksiste-leniniste nga ana e Partisë. Të njihen këto arsy Objektive si të drejta, objektive, është një, por jo vetëm të numërohen, sepse atëherë pikërisht nuk kemi zgjidhur gjë, vetëm jemi shfajësuar.

Ne, dhe ne që jemi në krye në radhë të parë, nuk mund të shfajësohem, sepse kemi përgjegjësi të rëndë. Ne kemi influencuar shumë, bile shumë herë edhe direkt kemi dhënë shembullin c keq, neve na ka mbuluar vetëkënaqësia, na ka munguar vigjilencia e duhur.

Përgjegjësi, në radhë të dytë, kanë edhe udhëheqjet në të gjitha hallkat dhe kjo përgjegjësi nuk mund

të kuptohet vetëm nga disa masa teknike që janë marrë, ose që nuk janë marrë, por është edhe ana subjektive e gjithsecilit që ka influencuar deri diku negativisht në këtë rast dhe pikërisht për të mos parë si duhet anën politike dhe ideologjike të çështjeve.

Në përgjithësi dhe në themel vija e Partisë, në të gjitha çështjet, ka qenë dhe është e drejtë dhe pa gabime serioze. Kjo ka qenë garancia e madhe dhe këtë garanci e kanë siguruar Partia jonë marksiste-leniniste, uniteti i çeliktë, pastërtia e saj marksiste-leniniste, luftha revolucionare e komunistëve dhe e popullit. Kjo ka bërë që socializmi te ne të ndërtohet me sukses në të gjitha fushat, pa marrë parasysh edhe këto të meta serioze në punë.

Vija e drejtë e Partisë sonë, gjatë zbatimit të saj në jetë, natyrisht, është konkretizuar edhe në ligje bazë, me frymë socialiste, me vendime e urdhëresa që i duhen një shteti socialist dhe në përgjithësi fryma e tyre ka qenë e drejtë marksiste-leniniste. Këtu është pasur kurdoherë kujdes i madh e vigjilencë. Kjo ka qenë një meritë kolosale e Partisë dhe një meritë e popullit tonë patriot, i lidhur si mishi me thoin me Partinë.

Mirëpo, këtyre orientimeve bazë, këtyre ligjeve e urdhëresave të drejta në parim, në zbatimin e tyre në jetë, në shfaqjet e jetës dhe të punës së përditshme, iu shtuan një mori ligjesh, urdhëresash, rregulloresh me karakter disa herë parimor, shumë herë teknik, burokratik dhe këtu zunë vend «si pa të keq», «si përtë mirë», sikur «duheshin, ishin oportune» etj. shumë gjëra të këqija për shtetin tonë, për administratën tonë, për vijën tonë që në themel është e drejtë.

Këtu qëndron çështja e presionit të armikut të klasës mbi pushtetin popullor, këtu qëndron çështja e elementeve borgjezë e mikroborgjezë që infektojnë çdo ditë me mentalitetin dhe me metodën e punës së tyre, jo vetëm mënyrën e drejimit e të administrimit, por edhe komunistët, të cilët nuk janë imunizuar aspak nga këto mbeturina mikroborgjeze.

Presioni i armiqve të klasës dhe i armiqve të jashtëm të vendit tonë, metodat e tyre të luftës, kanë ndikuar të ne që, megjithëse pa e nënvleftësuar luftën politiko-ideologjike, pa e nënvleftësuar edukimin politiko-ideologjik të kuadrove dhe të popullit, të vendosim një metodë burokratike, e cila në fakt e errëson, e nën-vleftëson rolin e madh të masave në luftën kundër armikut, e ndryshk këtë rol, e kodifikon këtë luftë të gjerë politiko-ideologjike të Partisë dhe të masave në një sistem të padurueshëm burokratik dhe, me dashje pa dashje, dilte që puna politike dhe ideologjike në jetë duhej t'i përshtatej këtij kodifikimi burokratik. Këtej dilte ideja e gabuar se çdo gjë që ishte vënë ishte e drejtë, e nevojshme, udhëheqja e ka parë mirë, pa marrë parasysh se makina rënkonte nga burokratizmi.

Pra, nga burokratizmi, roli i politikës që duhet të zëré vendin e parë, në praktikë kalonte në dorë të tretë. Njerëzit kishin më shumë besim te shkresat, te sistemet e vendosura, te rregulloret, sesa te masat, te punonjësit, tek energjia e vitaliteti i tyre krijues. Në këtë drejtim është arritur në stërhollime skandaloze, të turpshme, saqë të administrohej ekonomia socialiste siç mund të administronte një tregtar i vogël dyqanin e tij; të stërholloheshin gjërat për vijën e drejtë të

ruajtjes së pasurisë së shtetit dhe të lekut të popullit, derisa të arrihej si pa të keq që asnjeri dhe për askënd të mos kishte besim, por të kishte besim më shumë në këtë kodifikim burokratik, nën të cilin fshiheshin shpeshherë vjedhësit që dinin t'i shtrembëronin ligjet e urdhëresat, sepse vigjilanca e kontrolli i masave nuk ishin sa duhej e si duhej operues; ishte krijuar një rrjet kontrolli burokratik që errësonte kontrollin e vetë masave, kontroll që Partia e rekomandonte si kryesoren dhe vendimtarin.

Në praktikën e administrimit dhe të drejtimit, në shtetin tonë populor 20-vjeçar, shumë elementë të vjetër të borgjezisë me mentalitet borgjez e mikroborgjez u morën në punë shtetërore. Këta nuk ishin aspak armiq, sepse armiqve iu mbyllën dyert me kohë, por këta kishin një kulturë borgjeze, një botëkuptim borgjez dhe një praktikë borgjeze të administratës dhe ideologjikisht nuk ishin të ngritur në rrugën tonë. Këta elementë u lidhën me regjimin populor, Partia pak nga pak i ngriti politikisht, këta iu adaptuan direktivave të drejta, por në punën, stilin e metodën e tyre, në botëkuptimin e thelli të tyre, ata ruanin mbeturina të theksuara mikroborgjeze, të cilat shfaqeshin, plekeshin, u adaptohen borgjezëve e direktivave të drejta. Këto mbeturina influenconin në punë, influenconin edhe te komunistët, të cilët sillnin edhe këta me vete mbeturinat e tyre.

Eshtë, pra, urgjente dhe e domosdoshme të vazhdojmë me këtë rast të punojmë për një edukatë të thellë teorike e politike për Partinë, për kuadrot dhe popullin, që me shembuj të gjallë nga jeta të kuptojnë

ç'është burokratizmi, si vjen ai, si vendoset, ç'rreziqe mbytëse sjell ai për Partinë dhe për shtetin dhe si duhet t'i bëhet një luftë e fortë e organizuar teorike, politike dhe në praktikën e përditshme në punë.

Nga punimi i parë i vendimit të Byrosë Politike mbi luftën kundër burokratizmit, përveç atyre që përmendëm, dalin edhe disa shkaqe të tjera që kanë lejuar burokratizmin, sidomos në aparatet shtetërore.

Përqendrimi i palejueshëm e i padrejtë në Qeveri dhe sidomos në Kryesinë e Këshillit të Ministrave e në Komisionin e Planit të Shtetit, i një barre kompetencash e të drejtash që u përkasin dikastereve dhe bazës. Kjo ka rrjedhur nga disa pikëpamje jo të drejta dhe si pasojë e padashur krijohej njëfarë mosbesimi tek institucionet dhe kuadrot, mosbesim në kapacitetin, zotësinë e tyre dhe nga ana tjetër ngrihej vetveti ideja e mbivlerësimit të kapacitetit e të zotësisë sonë si udhëheqës. Këtej ka rrjedhur vënia nën kontroll e nën tutelë e të gjithëve e për çdo gjë. Ne, udhëheqja, duhet të viheshim në dijeni gati për çdo gjë, të pyeteshim për çdo gjë, të jepnim udhëzimet e nevojshme për çdo gjë, këto të kodifikoheshin dhe pastaj të vaprohej. Jastë këtyre caqeve nuk mund të dilej. Merret me mend ç'burokraci krijonte kjo.

Nga një situatë e tillë administrata krijoi e stilizoi një metodë pune jo të përshtatshme, krijoi kompetenca, detyra e të drejta për vartësit në funksionin e këtij botëkuptimi pune e veprimi; organizmat që ekzistonin u zhvilluan në këtë frysë për t'iu përgjigjur kësaj situatë dhe u adaptua një metodë burokratike marrë-

dhëniresh, letrash, qarkoresh, ligjesh, rregulioresh, statistikash që t'i përgjigjeshin kësaj pune.

Çdo gjë bëhej e vendosej në këtë frysme dhe kri-jonte vetëkënaqësinë se ishte e drejtë, se ishte gjetur zgjidhja e përshtatshme. Kur shikohej se diçka nuk e cte, bëhej një shtesë, në mënyrë të njëanshme dhe kësaj i shtoheshin një mori e tërë shkresash.

Një ngjarje e zakonshme ndodhе, një send vidhej, një gjë thyhej, përnjëherësh nga administrata lindnin si kërpudha ligje e rregullore të veçanta të panumërtë që i paraqiteshin Qeverisë, që i bën presion asaj.

Ministritë jo vetëm kishin kompetenca të pakta, por fryma dhe veprimi ishin që të shkarkoheshin edhe nga ato përgjegjësi të pakta që kishin. Kështu, ato bënин çdo gjë që të shkarkoheshin nga përgjegjësitë dhe përato përgjegjësi që u mbeteshin përpinqeshin të bënин ortak edhe ministritë e tjera dhe të ktheheshin kështu në ekzekutues të thjeshtë, në fabrikues shkresash. Krijohet, pra, kjo situatë: udhëheqja s'kishte asnjë kundërshtim që t'u merrte përgjegjësitë dhe pranonte që ministritë me njëra-tjetrën të bënortakllék në mes tyre, kur duhet dhe kur s'duhej.

Del, pra, mendimi se udhëheqja mendon e krijon, baza zbaton dhe duhet të zbatojë brenda caqeve të caktuara.

Vihet pyetja: Gjithë këta kuadro me eksperiencë, me dituri, që kanë partishmëri dhe luftojnë me vësh-tirësitë, përse nuk e kanë hapur gojën dhe nuk e kanë ngritur zërin të thoshin se kjo punë, kjo formë, kjo metodë pune nuk bën, nuk është e drejtë, është e vjetruar, është bërë pengesë dhe pra, duhet ndryshuar?

Unë mendoj dhe dal me konkluzionin se ata disi kanë folur, disi kanë sinjalizuar, kanë propozuar, me gjithëse është fakt që nuk na kanë kritikuar kurrë, por për fat të keq ne udhëheqësit të gjithë, nuk ua kemi vënë veshin sa duhet, nuk kemi nxjerrë konkluzione serioze, kemi marrë masa të cekta brenda normave që përmenda më lart, por, që të preknin të gjithë këtë kala që ishte ngritur, ata nuk guxonin, pse edhe druheshin, por edhe se i kishte mbuluar konservatorizmi, i kishte mbuluar ideja se çdo gjë ishte vënë drejt, se s'kishte vend për ndryshime e korrigjime. Kuadrot, pra, kishin filluar të sklerozoheshin, t'i adaptohen një situate jo të shëndoshë.

Një sinjal dha Byroja Politike dhe kuadrot u çuan, u zgjuan, u gjallëruan, morën iniciativa e q'nuk po nxjerrin, sa gjëra të mrekullueshme, sa masa efektive! E ç'do të nxjerrin më tej! Ne do të fitojmë një eksperiencë kolosale. Forca e Partisë është e madhe, zotësia, dituria, guximi i saj nuk mund të përshkruhen. Të vazhdojmë punën në këtë drejtim, kjo është një nga detyrat kryesore aktuale. Shumë gjëra do të mësojmë dhe do të armatosemi më mirë.

Por, ka rëndësi të madhe që të kuptojmë, dhe ne kryesorët në radhë të parë, se fajet më të mëdha për këtë çështje qëndrojnë mbi ne. Njerëzit e bazës nuk kanë guxim të na i vënë në dukje me forcë këto faje tonat, kurse ne «me guxim» ua kemi vënë atyre të tyret.

Baza tani flet, edhe me takt, i kritikon gjërat në rrugë të drejtë, por përsëri për arsyen «respekti» nuk na kritikon për gabimet që kemi ne; udhëheqja kryesore.

S'ka njeri që të mos thotë: «Si na janë futur këto? Si i kemi vendosur këto gjëra?».

Këtu, natyrisht, ekzistojnë anët objektive, rrethanat e ndryshme, mungesa e eksperiencës, adaptimi jo me vend i eksperiencës së huaj. Të gjitha këto ekzistojnë; por këto nuk duhet të mbulojnë anën subjektive të kuadrove, botëkuptimet jo të drejta, mendimin jo të shëndoshë për formën dhe për mënyrën e drejtimit që kanë luajtur një rol negativ në këtë rast.

Këtë analizë të thellë na mbetet neve ta bëjmë dhe të dalim me autokritikë përpara Partisë dhe kuadrove, për t'i edukuar ata me mësimet që nxjerrim nga gabimet tonë, sepse ndryshe gabime të kësaj natyre, edhe sikur t'i spastrojmë rrënjosht, do të ngjallen e do të rriten përsëri.

Prandaj duhen zbuluar rrënjet, duhen luftuar e korrigjuar gjërat që nga rrënjet. Barërat e këqij duhen shkulur nga rrënjet që të mos mbijnë më.

Tani dëshiroj, lidhur kurdoherë me problemin që na preokupon, të diskutoj për një çështje që, sipas mendimit tim, është kapitale: parimet që udhëheqin pushtetin popullor, si janë kuptuar dhe si i zbatojmë.

Që këhillat popullorë të mos mbeten formalë duhet të ushtrojnë kompetencat, të cilat duhen rishikuar, sepse këto ne kemi lejuar që t'ia errësojë organi ekzekutiv.

Në parim, pushteti ynë është ndërtuar drejt, ai është një dhe i pandarë, duke mbajtur edhe anën legjislative edhe atë ekzekutive. Ekzekutivi del nga legjislativi dhe është përgjegjës përpara tij, por në fakt

funksionet e legjislativit kanë mbetur pothuaj formale. Prandaj të vrasim mendjen dhe nga praktika revolucionare të gjejmë zgjidhjen e drejtë praktike të këtij problemi.

E para, unë mendoj të gjenden format e përshtatshme dhe të flaket formalizmi në kontrollin e këshillave popullore mbi organin e tyre ekzekutiv.

E dyta, duhet t'u lihen këtyre këshillave një varg kompetencash buxhetore, ligjore që organi ekzekutiv të mos mund të veprojë pa marrë aprovimin e tyre.

E treta, duhet të përcaktohet qartë (dhe jo si bëhet tani) që këshilli populor t'i kërkojë llogari (po me të vërtetë llogari) organit të tij ekzekutiv për një varg çështjesh të rëndësishme.

E katërtë, këshillat popullore të ushtrojnë me të vërtetë revokimin e një anëtarit të organit ekzekutiv që është ose nuk është anëtar i këshillit, kur ai nuk e ka kryer detyrën. Pra, heqja ose vënia e një anëtarit të komitetit ekzekutiv, t'i lihet në kompetencë këshillit populor dhe popullit që e ka zgjedhur.

Të gjitha format e tjera të organizimit dhe të punës të këshillave popullore, të komisioneve, të lidhjeve me masat, unë mendoj se janë në rregull, por në to duhet luftuar formalizmi. Këto do të gjallërohen, parimet do të zbatohen dhe do të vihen në jetë në mënyrë revolucionare, vetëm në rast se ne, në mënyrë të organizuar, do ta vëmë pushtetin nën drejtimin dhe kontrollin e masave, nën një drejtim politik, ideologjik dhe praktik e joformal (duke trumbetuar vetëm me fjalë parimet, të cilat janë të drejta).

Ky nuk është një problem i thjeshtë, por një nga

problemet më të mëdha parimore të shtetit tonë të ri socialist. Kjo s'ndreqet me disa masa organizative zyre ose me disa mbledhje lagjesh. Ky është një botëkuptim i tërë politik dhe ideologjik bazë, pa kuptimin e thellë të të cilit punët nuk do të shkojnë kurrë mirë.

Po nuk e kuptuam mirë këtë parim, në vend që në fuqi të jetë populli, në realitet do të jetë administrata. Dhe përderisa administrata nuk është nën kontrollin e plotë të popullit, direkt dhe indirekt, në mënyrë masive dhe në mënyrë të organizuar, atëherë do të kemi burokratizëm, neve do të na duket sikur këtë e spastruam, do të na duket sikur i spastruam të këqijat nga ligjet e urdhëresat, por do të gabohemi, sepse ato të këqija do të na lindin përsëri.

Duhet ta kuptojmë mirë se i tërë ky problem që po studion Partia është çështja e pushtetit, e pushtetit popullor, e popullit në fuqi. Problemi që shtron përpara Partia është i madh dhe i thjeshtë në të kuptuarit e parë: Populli duhet të jetë i plotfuqishëm, ai duhet të jetë në fuqi dhe jo vetëm disa njerëz. Populli drejton e vendos dhe jo disa njerëz e disa administrata. Njerëzit dhe administrata janë vetëm në shërbim të popullit, ky duhet të vendosë mbi ta, t'i mbrojë kur veprojnë mirë, t'i ndreqë kur bëjnë gabime dhe t'i godasë kur e pengojnë në ecjen e tij përpara. Prandaj duhet të kuptojmë dhe të bëjmë mirë dallimin e një pushteti popullor, nga një pushtet burokratik. Po të kuptohet thellë kjo, atëherë çdo njeri do të kuptojë se, mbi kompetencat që i janë caktuar atij, mbi mendimet e sjelljet e tij e mbi çdo veprim të tij qëndron Partia, qëndron kolektivi, qëndron populli dhe askush nuk duhet të harrojë, në çdo

post që është, se ai, me kompetencat e caktuara në sferën e punës së tij, nuk mund të presë nga të dyja anët, pa menduar se mbi të ka një udhëheqje, një kolektiv, një Parti, një popull, të cilëve duhet t'u japë llogari për çdo gjë. Kompetencat duhet të zbatohen e të ushtrohen në rrugë të drejtë dhe brenda këtyre caqeve që përmendëm. Jashtë këtij kuptimi të madh politiko-ideologjik, kompetencat nuk mund të ushtrohen drejt, sepse rrëshqitet në greminë.

Prandaj ta vëmë këtë çështje sa më shpejt e sa më mirë në binarët e drejtë parimorë që kemi, sepse kjo është baza e bazave, është çështja themelore e revolucionit, e Partisë, e popullit, e socializmit.

Në lidhje me këtë problem kaq të madh jetik përvardin tonë, rëndësi të dorës së parë kanë njerëzit që zgjidhen në këta këshilla dhe deri në Kuvendin Popullor.

Duhet të njohim se kriteret e zgjedhjes së njerëzve kanë qenë të influencuara nga kuptimi jo i thellë politiko-ideologjik e praktik i çështjes së pushtetit. Është anuar më shumë nga disa kritere, të shëndosha natyrisht dhe që duhet t'i ruajmë si sytë e ballit, sikurse është përbërja politike e kandidatëve, lufta e tyre etj., por ka dominuar figura e tyre e pastër politike, që ne kurdoherë duhet ta ruajmë për deputetin e popullit, por që s'është vetëm kjo. Deputeti i popullit jo vetëm duhet të jetë figura më e kulluar, më e pastër, besnik i popullit dhe i Partisë, por ai duhet të jetë edhe njeri revolucionar, punëtor i madh, i guximshëm për të mbrojtur çështjen e Partisë dhe të popullit.

Ne jemi prirë më shumë nga çështja se punëtorët e Partisë dhe nëpunësit e pushtetit janë nga njerëzit

më të mirë dhe oburra të tërë janë vënë në këshillat popullorë e në Kuvend. Është e vërtetë se këta i do populli, i ka provuar në luftëra dhe mjaft prej tyre duhet të zgjidhen, po ka edhe të tjerë, me mijëra që punojnë në ara dhe në fabrika, ka me parti dhe pa parti që nuk janë funksionarë, por që janë popull punëtor. Nga këta ne duhet të zgjedhim në masë dhe Partia të merret me seriozitetin më të madh për edukimin e tyre të veçantë, për të trajtuar me ta probleme mbi pushtetin tonë socialist të popullit, si duhet kuptuar dhe si duhet të punojë ai, çfarë ngjyre duhet të ketë, si duhet të luftohet për mbrojtjen e zhvillimin e tij, cilat janë detyrat e si duhet të punojë këshilltari etj. Partia t'i edukojë veçanërisht që këta ta kuptojnë pushtetin jo vetëm e vetëm në anën administrative, ekzekutive, por sidomos të kuptojnë thellësisht anën e funksioneve legjislativë të pushtetit dhe kontrollin e vazhdueshëm e pa ndërprerje të masave mbi të.

Këtë ne duhet ta kemi parasysh në zgjedhjet dhe t'i kuptojmë mirë këto çështje. Këtu nuk është puna e hartimit formal të listave, duke menduar vetëm se mos kemi harruar ndonjë, ose të vëmë edhe këtë se e njeh populli, por në fakt atij «i rroftë mjekra dhe taçi që ka». Ky të respektohet për meritat që ka, por në këshillat duhet të vijnë revolucionarë konsekuentë, njerëz të punës dhe të luftës.

Pra, në radhë të parë vihet çështja që të kuptohen thellë esenca parimore e pushtetit tonë popullor, rëndësia e madhe si e anës së tij legjislativë, ashtu edhe e anës ekzekutive dhe të luftojmë me këmbëngulje për

t'i ruajtur të pastra parimet dhe për t'i zbatuar ato në mënyrë revolucionare.

Të marrim çështjen e Kuvendit Popullor dhe për analogji kemi marrë edhe ato të këshillave popullorë. E ndiejmë të gjithë dhe jemi të shqetësuar se ka formalizëm. Për Kuvendin Popullor ky formalizëm rrjedh se ne nuk i zbatojmë mirë parimet që duhet ta udhëheqin atë dhe i arsyetojmë këto shkelje me disa konsiderata politike, një nga të cilat është të ruajmë autoritetin e udhëheqjes nga kritika dhe vërejtjet. Kjo do të thotë të pranojmë *a priori* që ligji i paraqitur është i përsosur, i studiuar mirë, shkencor, prandaj ai nuk ka përsë të diskutohet dhe (ato diskutime që bëhen janë formale, të përgjithshme, me vend e pa vend, mburrje për Partinë dhe për Qeverinë) ligjet pranohen si në vaj. Me pretekstin se ekzistojnë komisionet, mendimi i deputetëve nuk kërkohet gjerësisht dhe as kemi nxitur iniciativën e tyre në këtë drejtim.

A është parim i drejtë ky? A e zbatojmë kështu drejt parimin bazë? Jo. Aspak. Po kështu ngjet edhe në këshillat popullorë të rretheve ku mbahet i njëjtë qëndrim formal e pasiv. As që i shkon ndër mend këshillit popullor të rrëthit apo të fshatit të kritikojë kur është rasti veprimet e Qeverisë, ligjet dhe Kuvendin Popullor. Ky është gabim i madh parimor që absolutisht dhe sa më parë duhet të ndreget.

Kjo duhet të bëhet më parë nga Partia, duhet të bëhet edukatë partie, duhet të japë shembullin Partia. Po në ç'mënyrë do ta japë ajo këtë shembull? Partia të kritikojë pa drujtje gabimet, shtrembërimet që mund të bëjnë Komiteti Qendror, Byroja Politike, Qeveria dhe

anëtarët e Komitetit Qendror dhe të Qeverisë. Kjo të bëhet në të gjitha instancat e Partisë dhe të pushtetit dhe të konsiderohet si një forcim i unitetit, si një kallitje, si një edukim marksist-leninist dhe jo si një denigrim. Kjo frymë e shëndoshë duhet të kalojë në këshillat popullorë dhe jo vetëm kur është për të kritikuar ose për të këshilluar komitetin ekzekutiv, por edhe Komitetin Qendror, edhe Qeverinë e Kuvendin Popullor kur të jetë rasti.

Për sa i përket Kuvendit Popullor mendoj që ne të mos kemi frikë nga kritika. Gjithashtu, sipas rastit, mund të bëjmë dhe mbledhje të myllura të Kuvendit Popullor, domethënë pa të huaj, por duhet të zhvillohet drejt edhe puna në komisionet e Kuvendit Popullor, të cilat duhet të ndërrohen krejtësisht si nga përbërja ashtu edhe nga metoda. Komisionet aktuale janë formale, ndreqin disa gjëra të projekteve dhe bëjnë raportin e paraqitjes.

Unë mendoj se i tërë Kuvendi i organizuar, para mbledhjes plenare, duhet të bëjë pjesë në komisione të ndryshme dhe atje çdo deputet, i informuar plotësisht mbi problemet, i konsultuar me zgjedhësit të diskutojë, të kritikojë, të propozojë, të kërkojë. Atje të venë ministrat t'u përgjigjen kërkesave të ndryshme, të rrihen mendimet, të ndryshohen vendimet dhe shifrat kur është e nevojshme etj. Varet nga ne se deri në ç'shkallë e kuptojmë këtë parim të madh dhe si e zbatojmë. Në qoftë se e bëjmë formalisht, duke shkuar nga parimi se të gjitha ç'po paraqesim janë të përsosura dhe të vendosura një herë e mirë, atëherë s'jemi në rregull. Por në rast se këtë parim e kuptojmë dhe e zbatojmë

drejt, në format organizative dhe në frymën demokratike që thashë më lart dhe në qoftë se diskutimet, vërejtjet, kritikat e ndryshme ezaurohen në komisione, ato nuk është nevoja të bëhen në seancën e hapët plenare, sepse ato u bënë gjetkë dhe u bënë mirë.

Me një punë të tillë bëhet edhe një gjë tjetër e mirë: deputeti i futet thellë problemit, e kupton atë, sjell mendimet dhe dëshirat e popullit, jep kontributin e tij, di ç't'i raportojë popullit që e ka zgjedhur, di edhe ta përgatitë dhe si ta përgatitë fjalimin e tij në Kuvend, pa ia sugjeruar kush.

U zgjata mbi-këtë çështje, mbasi ky është një parim i madh, nga shkelja e të cilit vijnë shumë të këqija. Në pamjen e parë mund të thuhet: Si është e mundur kjo? Le ta arsyetojmë më konkretisht.

Populli drejton nën udhëheqjen e Partisë sonë revolucionare, marksiste-leniniste. Prandaj çdo gjë, në parim dhe në ekzekutim, duhet të jetë marksiste-leniniste, revolucionare. Pra, njerëzit që populli i zgjedh në pushtet, në këshilla, në Kuvend, në komitetet ekzekutive dhe në Qeveri, duhet të kenë parasysh të edukohen dhe të veprojnë brenda kompetencave që kanë, në mënyrë marksiste-leniniste. Pra, pushteti legjislativ dhe ai ekzekutiv që është një dhe i pandarë, i zgjedhur dhe i revokueshëm nga populli, duhet t'i ruajë të pastra dhe t'i zbatojë drejt parimet.

Por ç'ngjet te ne? Duke i njobur këto parime, por në sipërfaqe, organi ekzekutiv që ka pa dyshim rëndësi të madhe, në praktikë shpeshherë është vënë mbi atë legjislativ dhe në këtë mënyrë parimi ka mbetur gati formal, ne kemi lejuar që zbatimi në praktikë i vijës së

Partisë të ketë edhe shtrembërime në drejtimin e kontrollit nga ana e organit legjislativ, pra, kemi lejuar që kontrolli direkt i popullit të jetë venitur. Partia përpinqet, lufton ta vërë në vend këtë parim më të gjitha hallkat, por pa suksesin që ajo dëshiron. Kjo ngjet sepse vetë njerëzit e Partisë, atje ku punojnë e drejtojnë, nuk i kanë shumë të qarta disa gjëra.

Ne, punonjësit e Partisë, nuk kemi shikuar drejt një çështje parimore dhe praktike, që pushteti ynë duhet të jetë sa më i thjeshtësuar, efektiv, revolucionar, aktiv dhe i lidhur fort me bazën dhe me prodhimin. Kështu duhet të jenë edhe pushteti legjislativ edhe ai ekzekutiv. Nën hundën tonë ne kemi lejuar të zhvillohen disa fenomene të rrezikshme: nga njëra anë legjislativin e kemi lënë formal, nga ana tjetër ekzekutivin e kemi rënduar, e kemi bërë imponent me një administratë të fryrë, pa pasur parasysh edhe vendin tonë me një territor të vogël. Administratën e kemi konsideruar të plotfuqishme e të pagabueshme, sikur pa të Republika jonë nuk mund të rrojë një orë, sikur asgjë nuk mund të ecë pa të. Një kuptim i tillë i gabuar na ka sjellë e po na sjell dëme.

Ne nuk duhet të lejojmë në asnjë mënyrë që administrata të mbërthejë ekzekutivin tonë revolucionar, punën krijuese në të gjithë sektorët, si kurpëli që mbërrthen bimën dhe e mbyt; nuk duhet lënë që ajo të na mbërthejë për gryke, të mbytë fryshtën revolucionare të pushtetit tonë, të neutralizojë parimet, ligjet, rregullat e drejta marksiste-leniniste të Partisë sonë.

Shihni ç'po na ngjet. Kudo ku hedh çapin, burokratizmi, administrata të thotë «ndal, jo më tej, kthehu

prapa». Kjo gjë e keqe na ka bërë ne të mendojmë dhe të veprojmë se administrata është mbi çdo gjë, se s'ka prodhim pa administratë, s'ka shkollë pa administratë, s'ka institut pa administratë! Akoma s'ka filluar kantieri, ne duhet të krijojmë administratën, peshqit janë në det, administrata është e gatshme. Më parë se çdo gjë ne do të bëjmë organikat dhe këtu duhet të parashikojmë që nga peri e deri te gjilpëra, se mos bëhet vonë!

Po a duhet të kemi administratë? Sigurisht, por ajo as që duhet konceptuar në parim dhe në zbatimin praktik, ashtu sikurse e konceptojmë dhe e zbatojmë sot. Administrata duhet të ndërtohet me parimet dhe në përputhje të plotë me detyrat e ekzekutivit, domethënë ajo të jetë e lehtë, dinamike, revolucionare. Këtë gjë s'e kemi parë dhe s'e kemi kuptuar si duhet. Këtu, mendoj unë, është gabimi ynë serioz dhe i rrezikshëm. Ne e kemi konfonduar administratën me pushtetin (që në praktikë nuk janë të ndarë). Por, duke kuptuar rëndësinë e pushtetit ekzekutiv, të drejtimit, ne kemi fetishizuar në heshtje administratën dhe kemi arritur në një kuptim jo të drejtë se ekzekutivi dhe udhëheqja në çdo hallkë, jo vetëm në pushtet, por kudo ku punohet, kudo që prodhohet dhe udhëhiqet, pa administratë nuk mund të punojnë, nuk mund të udhëheqin. Është kaluar, pra, në rrugën që, më parë se çdo gjë, duhet të vendoset organika. Dhe kjo organikë është standard, standard për komitetet (sigurisht me kategori), standard për ndërmarrjet e kategorive të ndryshme dhe, sikurse del nga praktika, kur i thuhet një ministrie nga ndonjë ndërmarrje se këto ose ato janë të tepërtë, ministria

përgjigjet: «Ju s'keni eksperiencë, do të shihni se ky ju duhet».

Nën shumë arsyе e pretekste organikat fryhen, «jo këta duhen për këto drejtime, duhen për këta sektorë, këta specialistë duhen për këtë specialitet, këta të tjerët duhen për këshilltarë, këta për kontrollorë» e një mori funksionesh që me titull futen në kategorinë e «udhëheqjes», por ata janë administratorë të thjeshtë që hiqen nga prodhimi, gjoja për të ndihmuar udhëheqjen, por që në fakt fabrikojnë në zyra ligje, urdhëresa, rregullore. Këtë e mbulojnë me shkuarjen disa herë në bazë për të justifikuar strehimin e tyre në administratë.

Ç'rezulton? Një mori shembujsh na vërtetojnë se ekzistojnë shumë gjëra jo të shëndosha:

1. — Ne bëjmë orvatje të shkurtojmë organikat, ndërsa bëhet rezistencë e madhe. Megjithatë i shkurtojmë ato dhe, si i shkurtojmë, ato prapë fryhen. Kjo tregon, në radhë të parë, se as ne që propozojmë shkurtimet, as ata që rezistojnë dhe që i fryjnë përsëri, nuk e kemi shumë të qartë këtë problem parimor.

2. — Kjo ka nxitur tendencën e theksuar borgjeze të memurllëkut të vjetër, domethënë sigurimin e rrogës në zyra, «në drejtim» dhe jo në prodhim.

3. — Ne kemi nxitur kështu idenë mikroborgjeze se, që të jesh nëpunës i çdo shkalle është nderi më i madh, pse drejton, jep urdhra, jep mend dhe mendja vlen më shumë nga puna dhe prodhimi. Pra, në radhë të parë është administrata, pastaj puna e prodhimi.

4. — Disa që e mbajnë hundën lart, arrijnë në mendimin se ata kanë lindur për të drejtuar, se çdo fjalë që del nga goja e tyre është flori, shtoji pastaj kë-

saj mbeturinat e tjera mikroborgjeze, si fodullëkun, arrogancën, hipokrizinë, ndjenjën e hakmarrjes e të arbitraritetit dhe një njeri i tillë të shndërrohet në një tiran të vogël, që është i bindur se ndërmarrja pa atë nuk ecën, se është ai faktori që ndërmarrja prodhon dhe jo punëtori, se ai na qenka krijuesi i të gjitha të mirave materiale! Dhe ai di t'u bëjë qejfin e prorëve syleshë, di t'u paraqitet, të arsyetojë mungesat e tij dhe t'ua hedhë fajin të tjerëve. Ai në fakt ka mbështetje burokratizmin, administratën me të gjitha shkresat e saj, mentalitetin borgjez e mikroborgjez dhe rutinën.

5. — Më në fund, këtë ne e kemi përkrahur edhe me sistemin e pagave më fuqi, të cilat favorizojnë punonjësit e administratës në dëm të njerëzve të punës, të prodhimit dhe është krijuar një mentalitet i tillë antirevolucionar në një sërë njerëzish që, po t'i transferosh në prodhim, bëhet gjëma, vënë kujën. Ata jo vetëm duan të ruajnë pagën që kanë marrë dhe mundësisht të marrin një pagë më të madhe, por nuk duan të venë as në prodhim dhe as të lënë qytetin.

Një situatë të tillë nuk mund ta lejojmë më. Partia nuk duhet të qëndrojë pa i sqaruar ideologjikisht dhe politikisht këto probleme kyçë dhe pa i zbatuar drejt në praktikë. Pastrimit të administratës ne duhet t'i vemi deri në fund, të lëmë në administrata aq sa duhet dhe ata që duhen dhe të mos konfondojmë kuptimin «udhëheqje dhe administratë». Parimet për këto çështje mjaft herë ne i kemi shtrembëruar dhe jemi ne përgjegjësit kryesorë në radhë të parë, por ka ardhur koha që këto t'i vëmë drejt në vend. Të mos hezitojmë t'i zbatojmë në qoftë se këto parime janë të drejta.

Duhet të kuptojmë mirë dhe në mënyrë revolucionare se, të rishikojmë organikat, nuk do të thotë vetëm të shkurtojmë njerëzit e tepërt, por duhet të shikojmë njëkohësisht edhe vetë strukturën e organikës, duke pasur parasysh tri gjëra: udhëheqjen, administratën dhe punëtorët e nevojshëm, si shoferë etj. Të mos i konfondojmë këto tri gjëra që formojnë organikën.

Është e domosdoshme dhe urgjente që, krahas me zhvillimin e luftës kundër burokratizmit dhe me spastrimin e organikave të administratës nga njerëzit e tepërt e të panevojshëm, Partia duhet të zhvillojë në mënyrë të thellë një punë të madhe politike bindëse me të gjithë ata që duhet të venë të punojnë në bazë, në prodhim. Kjo është një nga çështjet më delikate, jo nga ana organizative e futjes në punë e në prodhim të këtyre njerëzve, por nga kuptimi i vërtetë politik prej tyre i kësaj mase të drejtë.

Shumë njerëz, edhe komunistë në mes tyre, kur është fjala për «deklarata», i kanë në majë të gjuhës parullat: «Ne jemi ushtarë të Partisë», «Vemi ku të na dërgojë Partia», «Jemi në shërbim të popullit» etj., por kur vjen puna që këto parulla të vihen në jetë, atëherë përpiken t'u bëjnë bisht, të nxjerrin një mijë arsy, të vënë në lëvizje miqtë, hatëret, të kaluarën, moshën, prirjet, profilet e punës, fëmijët në shkollë, gruan në punë, e një mijë arsyet të tjera dhe të gjitha këto që të mos u prishet «rehati», «foleja e krijuar».

Krijohet kështu një ndërgjegje e turbullt, një shqetësim i madh, një preokupacion moral i sëmurë, që shumë herë transformohet edhe në botëkuptime politike të gabuara. Arsyetimet subjektiviste stërhollohen

në ndërgjegjen e tyre, mendimi i shëndoshë u errësos het në atë shkallë, saqë parullat e sipërme të drejta, jo vetëm bëhen të pavlefshme përpara arsyetimeve të tyre subjektiviste, të cilat zmadhohen, por për ta bëhen të pakapërcyeshme, konkludohet se ato janë të bazuara dhe pra, vendimi i marrë për të shkurtuar organikat e për të shkuar në prodhim «nuk mundet, nuk duhet, nuk është i drejtë të veprohet për rastin tim, për të tjerët po, por jo për mua».

Nga një gjendje e tillë psikologjike e sëmurë, është fare lehtë të kalohet në pakënaqësi pa baza, në konfuzion politik dhe, në qëndrime politike të gabuara, pa shkuar në qëndrime të hapëta armiqësore. Por edhe në këto të fundit do të ketë njerëz që mund të kalojnë në qoftë se ne nuk marrim të gjitha masat që t'i edukojmë.

Partia duhet t'i dalë përpara kësaj gjendjeje, të mos mendojë se do të kalojë fare lisho. Prandaj këtë punë politike, kuptimin politik dhe ideologjik të kësaj mase revolucionare të Partisë, në këto situata konkrete, të gjitha organizatat-bazë duhet ta ngrenë dhe ta shtrojnë drejt, vazhdimesht dhe jo një herë; jo vetëm kolektivisht, por edhe me një punë këshilluese, sqaruese, bindëse individuale.

Shumica dërrmuese e njerëzve me parti dhe pa parti e kuptojnë drejt këtë punë, janë entuziastë e të gatshëm, po kjo duhet të mos na vëré në gjumë, se ka edhe njerëz që s'e kuptojnë drejt. Prandaj përgatitja morale, politike e shpirtërore e njerëzve nga ana e Partisë, nga vetë ata për të forcuar ndërgjegjen, për ta spastruar atë nga mbeturinat, për të mos lënë barërat

e këqij të mbulojnë arsyen e shëndoshë dhe pamjen e drejtë të problemit e të perspektivës, duhet të jenë në rendin e ditës.

Partia dhe drejtuesit e çdo shkalle duhet t'i kuptojnë drejt njerëzit dhe shqetësimet e tyre. Në asnje mënyrë ata të mos jenë brutalë, arrogantë. Ata duhet të jenë të vendosur për të zbatuar direktivën, por përkëtë qëllim të përdoren bindja, këshillimi, durimi i madh, pse kemi të bëjmë me njerëz të mirë, të ndershëm, patriotë e punëtorë. Të merren masa të rrepta kundër atyre drejtuesve që nuk përdorin arsyen, bindjen, këshillat dhe durimin, por i trajtonë njerëzit e kësaj kategorie si «sabotatorë», «armiq», «antiparti» etj. T'i bindim se vendi ku do të venë të punojnë, qoftë edhe ai më i largëti, ka bukurinë dhe jetën e vet, puna atje ka kënaqësinë e vet dhe kënaqësia më e madhe për atë që do të vejë atje, është ajo që me punën e tij të frytshme ai do të zbukurojë veten, familjen, vendin e punës dhe atdheun.

Kam bindjen se çdo gjë do të kalojë mirë, sepse ne kemi një Parti të çeliktë, marksiste-leniniste, revolucionare, pra kemi edhe kuadro të shëndoshë dhe revolucionarë.

Mendoj gjithashtu se, meqë ky veprim është masiv dhe jo një masë e shkëputur nga një varg vendimesh të drejta, revolucionare, ne nuk do të ndeshemi në pakënaqësi të shumta. Vetëm se organizativisht ne duhet të përgatitemi që njerëzit që do të shkojnë të mos breshin rrugëve përfshirë faj të burokratizmit, të punojmë që të gjithë këta të gjejnë vende ku të flenë, ku të marrin familjen, të mos jemi shumë të rreptë në kohën e parë:

në marrjen e familjeve të tyre, kur nuk u kemi siguruar akoma strehimin, për të cilin duhet të marrim masa urgjente dhe të parashikojmë spostime fondesh për ndërtim baneshash në vende të ndryshme etj., etj.

Në lidhje me rishikimin e stilit dhe të metodës së punës, me spastrimin e elementeve burokratike në aparatet e shtetit dhe të Partisë që po ndërmarrim, duhet të rishikohen e të hartohen leksione të reja për Shkollën e Partisë dhe për gjithë Partinë.

Leksionet në fjalë, dhe sidomos në disa drejtime, me gjithë përmirësimet që kemi bërë herë pas here, kanë nevojë të madhe të shkunden nga pluhuri, të gjallërohen me një frymë të theksuar revolucionare dhe të janë të lidhura me jetën e luftën konkrete e të përditshme të Partisë.

Në hartimin e këtyre leksioneve, nën ngjyrën se janë leksione teorike, mendoj se është ndjekur një formë dogmatike e trashëguar nga programet teorike të Partisë Komuniste të BRSS dhe ata shokë që kanë mësuar në Shkollën e Partisë në Moskë e tani janë pedagogë në Shkollën e Partisë sonë, pak a shumë ruajnë po atë stil e metodë, jo vetëm në hartimin e teksteve, por edhe në mënyrat e dhënies së mësimeve. Ekziston mania e njerëzve që merren me teori që këtë të mos e bëjnë të gjallë, po sa më të rëndë, për t'i dhënë asaj peshën «tradicionale» të një shkence «serioze» që duhet «të kesh kokë» ta kuptosh.

Përveç kësaj, dyshoj që në leksionet tona teorike të jetë pasur kurdoherë parasysh spastrimi rrënjos i frazeologjisë «lumë» dhe «ujë» të trashëguar gjatë punës që karakterizonte metodën e perifrazave e të fra-

zave të gjata, me pak ide, që s'ishin gjë tjetër veçse karakteristika të mungesës së eksperiencës dhe të sintetizimit të ideve, të nxjerrjes së konkluzioneve të drejta teorike dhe praktike të punës dhe të luftës sonë.

Nga ana tjetër, mendoj se në këto leksione, për të ilustruar tezat teorike, sillen shembujt që kanë përdorur në kohën e tyre klasikët, të cilët kanë sintetizuar dhe kanë vënë në teori eksperiencën dhe luftën e proletariatit. Kjo, natyrisht, ka qenë rruga e drejtë që duhet të na frymëzojë edhe ne në mësimin e nxjerrjen e konkluzioneve teorike të punës e të luftës që zhvillon Partia jonë.

Në leksionet tona teorike, pedagogët shembujt e klasikëve nuk duhet t'i harrojnë e t'i neglizhojnë, por do të ishte gabim që ata të kufizohen vetëm në ta. Në rast se teorinë tonë ata e kuptojnë kështu, të ngrirë, atëherë pikërisht e kuptojnë dhe e mësojnë këtë si dogmë. Në qoftë se këtë e kuptojnë në zhvillimin e saj krijues, atëherë teorinë duhet ta sqarojnë, ta pasurojnë dhe ta vërtetojnë me zhvillimin aktual të saj si një armë të pandryshkur në veprim. Pedagogët teorikisht këtë e thonë orë e çast, kurse në praktikë janë larg saj, ata janë larg ta kuptojnë se praktika lind dhe vërteton teorinë dhe jo vetëm në të kaluarën historike, por edhe në zhvillimin e ndryshimet historike aktuale. Shumë prej këtyre pedagogëve këto u duken gjëra të vogla, fakte të mira dhe të hidhura të luftës së përditshme. Jo vetëm kaq, po ata kanë mendimin dogmatik se me leksionet e tyre teorike qëndrojnë mbi këto fakte e ndodhi, të gjitha i kanë shpjeguar nga katedra, një herë e përgjithmonë.

Vajtja e tyre në bazë konsiston më shumë në një kontroll burokratik. Si pedagogët, edhe shokët e Partisë, këto leksione «teorike» i punojnë me kuadrot në seminare ose shkolla politike dhe nuk nisen për të marrë eksperiencën e bazës, anët e mira, gabimet që vërtetohen në jetë e në luftë, që në fakt janë vërtetimi dhe kontrolli se sa i kuptojnë e si i zbatojnë kuadrot në jetë këto parime teorike që u mësohen. Natyrisht, nga këto kontolle nuk sillet veçse ndonjë korrigjim didaktik ose ndonjë vërejtje mbi kapacitetin retorik të njërit apo të tjegrit. Këtë na e provon e gjithë kjo praktikë e hidhur që s'e kemi parë si duhet me kohë.

Në të gjitha këto drejtime mendoj se është urgjente të bëjmë një kthesë vendimtare në front të gjerë në sektorin teorik të Partisë, duke filluar frontalisht në drejtim të stilit, të frysës së të kuptuarit të teorisë dhe të pasurimit të saj, të metodës së përpunimit të saj dhe të dhënies e të të mësuarit të teorisë.

Të gjitha praktikat e leksioneve duhet të shikohen, por në radhë të parë mendoj të shikohen, të korrigohen, të pasurohen dhe të bëhen aktuale sa më parë disa probleme teorike mbi çështjet e kohës si në lidhje me planifikimin revolucionar e me luftën kundër burokratizmit.

Mendoj se mund të rishikohen e të ritrajtohen disa tema, si për shembull:

- a) Politika marksiste-leniniste, bazë në çdo veprim dhe për çdo problem.
- b) Qeverisje me frysë revolucionare apo qeverisje burokratike?
- c) Pasuria e popullit ruhet e zhvillohet me frysë

revolucionare marksiste-leniniste dhe jo me kodifikime burokratike.

c) Kontroll revolucionar i masave apo kontroll burokratik?

d) Legjislacioni ynë revolucionar, marksist-leninist, është penguar nga procedura burokratike e praktikës së legjislacionit borgjez e mikroborgjez.

Mund të ketë edhe tema të tjera, por mendoj që në trajtimin, përpunimin, grumbullimin dhe përfundimin e kësaj pune të shihet që pedagogët të ngarkohen të punojnë me koncepte të reja pune e të zembrapsin tej çdo gjë të keqe, të vjetëruar, dogmatike në konceptet, stilin, metodën e punës të përdorur deri tani.

Kuptohet që këtë punë nuk mund ta bëjë dot çdo njeri. Ne duhet të ngarkojmë për këtë qëllim shokë me kulturë të gjerë, politike dhe teorike, që, duke i pasur këto cilësi dhe duke i udhëzuar si duhet të veprojnë, t'u rekomandojmë posaçërisht që të venë në bazë, të mbështeten tek ajo, të lënë në shtëpi formulimet stereotipe, parafytyrimet ose konceptet e paravendosura në trurin e tyre. Këtë punë ata duhet ta konsiderojnë, në radhë të parë, një spastrim të mirë të gjërave jo të drejta të bagazhit të tyre ideologjik, kulturor e politik që mundet dhe sigurisht, ku më shumë e ku më pak, të ketë zënë ndryshk. Pa e bërë këtë gjë, puna që do t'u ngarkohet, nuk do të dalë e mirë.

Gjithashtu mendoj se si metodë pune, një nga gjérat kryesore, është ajo dhe kryesisht ajo e njohjes me materialin e gjallë të problemeve e të zhvillimit të vërtetë në praktikë dhe në jetë. Kjo të mos bëhet në asnjë mënyrë nëpërmjet raporteve e statistikave, sidomos kur

këto bëhen nga njerëz jokompetentë, pa kulturë dhe burokratë që i bëjnë vetëm për të kaluar radhën, për të qenë në rregull me eprorët.

Duke përcaktuar mirë problemet dhe njerëzit që do t'i trajtojnë këto probleme, këta duhet t'u qepen në bazë fakteve të shumta, të mira dhe të këqija, t'i klasifikojnë ato, t'i shqyrtojnë një nga një imtësisht, t'i diskutojnë një nga një, t'u gjejnë origjinën, mënyrën e zbatimit të drejtë apo të shtrembëruar, të nxjerrin për çdo gjë rezultatet e mira dhe të këqija e më në fund nga një material i tillë i pasur, i analizuar, i përpunuuar, të arrijnë në konkluzione politike, organizative, ideologjike, financiare. Ata të bëjnë bilancin për çdo problem se cili duhet mbajtur, si duhet mbrojtur e zhvilluar ky në të ardhmen në rrugë e me mjete revolucionare dhe cili duhet hedhur poshtë e luftuar sepse nuk vlen dhe çfarë vigjilence duhet të tregohet që të mos përsëritet më. Këto konkluzione të drejta duhet të mbështetin dhe të vërtetojnë teorinë tonë marksiste-leniniste që na udhëheq, të vërtetojnë forcën teorike të Partisë sonë dhe politikën e saj të drejtë.

Të tilla konkluzione duhet të janë të gjalla, jo të ngrira, të shërbejnë për edukim e veprim, të ilustrohen jo vetëm me citate të klasikëve, por edhe me direktivat konkrete të Partisë në çdo kohë, për çdo problem dhe me shembuj, sidomos me shembuj pozitivë e negativë, nga eksperienca e masave, nga lufta e përditshme. Të synohet dhe të arrihet ajo që me këta shembuj luftarakë të vërtetohet në jetë parimi teorik dhe politik që nga praktika del parimi, i cili formulohet, kthehet përsëri në masat dhe bëhet mjet i sprovuar për luftim. Kjo

dhe vetëm kjo do të bëjë që masat dhe çdo anëtar partie të kuptojnë mirë teorinë, me këmbët mbi tokë dhe jo me formula havadan. Vetëm kështu masat dhe anëtari i thjeshtë i Partisë nuk do ta kuptojnë teorinë si një «gogol» dhe monopol të disa «kokëve të mëdha».

Partia ka arritur një sukses të madh në këtë drejtim në luftën konkrete kundër revizionizmit modern. Artikujt e «Zërit të popullit» i kanë edukuar dhe i kanë armatosur mirë masat dhe komunistët. Këta janë artikuj ideologjikë dhe politikë njëkohësisht, por ka shumë që edukohen e mbruhën ideologjikisht me ta si jo më mirë, pa e kuptuar ose e kuptojnë se edukohen vetëm politikisht, pse kanë mendimin e gabuar që këta artikuj janë vetëm artikuj politikë.

Pse ngjet kjo? Për arsyen se këta njerëz kanë mendimin, natyrisht të gabuar, se, që të jetë artikulli teorik, duhet të jetë disi i errët, i rëndë në të kuptuar, me terma abstraktë dhe i mbushur me citate të klasicëve të marksizëm-leninizmit. Këto mendime të gabuara në kuptimin e filozofisë marksiste duhet t'i zhdukim pikërisht, duke i vënë në dorë masës materiale të tilla si ato të «Zërit të popullit» kundër revizionizmit modern që, kur t'i lexojë, jo vetëm t'i kuptojë shpejt e deri në fund, por edhe t'i ngjallet një etje e madhe për to, shumë më e madhe nga «frika» që ndien sot për t'iu futur të lexojë një gjë që mban titullin dhe frymën e «filozofisë».

Kjo «frikë» është futur, po ne sa më parë duhet ta zhdukim, ta çlirojmë masën nga kjo barrikadë që e pengon të ecë si duhet përpara, të mësojë, të përparojë dhe të punojë mirë e pa gabime ose pa shumë gabime.

Vetëm dëshiroj të theksoj se në këtë problem të madh Partia kërkon kontributin e të gjithëve, në radhë të parë tonin, të anëtarëve të Komitetit Qendror dhe veçanërisht të anëtarëve të Byrosë Politike. Duhet të kuptojmë mirë se propaganda e Partisë nuk mund të jetë fusha e disa specialistëve dhe ne të gjithë, pa përjashtim, të mos japim kontributin tonë të nevojshëm, absolutisht të domosdoshëm.

Propaganda e Partisë është formulimi i vijës dhe propagandimi i saj. Formulimin e vijës nuk duhet ta kuptojmë thjesht, si ndërtimin e frazave dhe rreshtimin e tyre pak a shumë, në mënyrë të harmonishme. Kjo është, si të thuash, veshja e jashtme. Çështja qëndron në brendinë e vijës sonë, në soliditetin e saj, në saktësinë e saj.

Kjo vijë, e formuluar dhe e nxjerrë nga përvoja e Partisë dhe e masave punonjëse, duhet të propagandohet gjerësisht e mirë, që të kuptohet e të zbatohet në mënyrë korrekte. Zbatimi duhet të ndiqet dhe ai duhet të na provojë saktësinë e saj, nevojën e korrigjimeve. E kemi, pra, për detyrë të parë që të gjendemi në radhët e para të këtij procesi jetik të jetës së Partisë e të vendit tonë, të jemi në radhët e para për të kontribuar fuqimisht dhe direkt në përpilimin, zbatimin, propagandimin dhe korrigjin e vijës kur të jetë nevoja.

Veçanërisht neve, anëtarëve të Komitetit Qendror dhe të Byrosë Politike, në sektorët ku jemi ngarkuar të punojmë dhe si pjesëtarë të forumit të lartë të Partisë, na bie barra e madhe që, për vijën, orientimet e direktivat që hartojmë, të cilat udhëheqin gjithë jetën

e Partisë dhe të vendit, të marrim përgjegjësinë e plotë personale dhe kolektive, si kur formulohen, ashtu edhe kur zbatohen, çdo gjë ta shohim e ta studiojmë me një sy kritik marksist-leninist, me një vështrim objektiv. Kjo kërkon në radhë të parë zbatim serioz, studim serioz të problemit. Gjithçka që jemi duke bërë para Kongresit është një punë kalitjeje e Partisë, e vijës, e njerëzve, është një punë e madhe voluminoze që nuk duhet të na hutojë e të na çorientojë, përkundrazi të na mprehë, të na shumëfishojë forcat, të na hapë horizonte më të gjera e më të qarta, të na mësojë të gjejmë metodën më të mirë të punës, stilin revolucionar.

Them të mos hutohem, sepse problemet që jemi duke zgjidhur, jo vetëm nuk janë të thjeshta, po ato janë të një diapazoni të gjerë politik, ideologjik, organizativ, teknik etj., janë hallka të lidhura me njëratjetrën. Ne duhet t'i përballojmë frontalisht ato. Një luftë e tillë frontale lyp kontributin e qartë politik dhe maksimal, jo vetëm të udhëheqjes në të gjitha shkallët, por kontributin aktiv, të zgjuar, krijues, të shëndoshë e shpëtimtar të të gjithë Partisë, të të gjithë popullit.

Si në çdo betejë, edhe në këtë, ne duhet të kemi të qartë ku do të shkojmë, ç'duam të bëjmë, cilat janë rrugët kryesore që duhet të ndjekim, cilat janë hallkat kryesore nga duhet të kapemi. Po i patëm këto të qarta, ne do të zgjidhim çdo gjë drejt, shpejt, pa konfuzion, por me qartësi politike dhe me soliditet organizativ.

A mund ta bëjë këtë gjë Partia jonë? A mund që ne, anëtarët e saj, të organizojmë si duhet edhe korrjen

e kësaj fitoreje të madhe? Unë jam plotësisht i bindur se po. Ne do t'ia dalim me plot sukses dhe Partinë e Republikën tonë do t'i bëjmë më të forta se kurrë.

Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha «Raporte e fjalime 1965-1966», f. 205. Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

Tiranë, 1971

**T'I DREJTOHEMI ME NJË LETËR TË HAPUR
GJITHË PARTISË, GJITHË POPULLIT
DHE USHTRISË**

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

8 shkurt 1966

Materiali që është përgatitur, ka mjaft të meta, si në paraqitjen dhe formën e tij, ashtu edhe në trajtimin e problemeve. Pavarësisht nga kjo, mendoj që këtë letër të mos ia dërgojmë ushtrisë kështu siç është, por të përgatitim një tjetër, me anën e së cilës t'i drejtohem gjithë Partisë, gjithë popullit dhe ushtrisë për t'i vënë në dijeni mbi masat që po marrim aktualisht. Në letër të shpjegojmë edhe arsyet politike, ideologjike dhe ekonomike që e detyrojnë Partinë t'i marrë këto masa, që nga pastrimi i burokratizmit në aparatet tonë shtetërore, deri te reformat në ushtri. Ne jemi duke ia shpjeguar Partisë në bazë masat që po marrim. Në

¹ Në këtë mbledhje u diskutua mbi projektletrën e paraqitur për marrjen e disa masave organizative në forcat e armatosura.

një formë ose në një tjetër edhe populli po i merr vesh, prandaj kudo po ziejnë diskutimet rreth tyre dhe është kriuar një entuziazëm i madh. Megjithatë ka edhe interpretime të ndryshme, njëri, për shembull, thotë se «kjo është një masë e mirë», tjetri, që nuk është në thelb të çështjes, e kundërshton; dikush thotë «përse të vete unë në fshat», tjetri del vullnetar dhe vete etj., etj. Çështjet që lidhen me ushtrinë të futen në kuadrin e madh të të gjithë kësaj pune. Në këtë letrër të shpjegojmë dhe të gjithë ta kuptojnë se drejtimi i punës së Partisë në ushtri nuk është aspak një çështje e re, por një çështje e përhershme e Partisë.

Partia ndodhet kudo. Ajo ka qenë, është e kurdoherë do të jetë edhe në krye të ushtrisë. Ashtu siç ka udhëhequr e udhëheq kudo gjithë jetën e vendit, ajo ka udhëhequr e udhëheq edhe Ushtrinë tonë Popullore. Tani janë kriuar të tillë kushte që kudo kërkohet një punë shumë e kualifikuar. Pra çështja e drejtimit të Partisë në ushtri nuk është një reformë, sepse Partia, ashtu si në gjithë sektorët e jetës së vendit tonë, edhe në ushtri ka drejtuar nëpërmjet anëtarëve të saj dhe komiteteve të Partisë. Kur themi që ushtarët dhe oficerët e Ushtrisë sonë Popullore duhet të jenë të lidhur në mënyrë të natyrshme me Partinë, me këtë nuk shtojmë ndonjë gjë të re, vetëm se forcojmë atë ç'ka kemi thënë kurdoherë. Prandaj në letrër, kur të vijmë te kapitulli i ushtrisë, të shpjegojmë se gjatë Luftës Nacionalçlirimtare Partia e krioi dhe e udhëhoqi ushtrinë partizane, të cilën e pati kurdoherë nën drejtimin e saj. Në këtë pjesë të nxjerrim edhe rolin e komandantit, edhe atë të komisarit gjatë luftës

dhe të mos e quajmë si një reformë vendosjen e komisarit dhe të komiteteve të Partisë në ushtri. Këtë çështje në material ta nxjerrim në mënyrë historike.

Në letër të shpjegojmë gjithashtu përse ishte e nevojshme të viheshin gradat, përse na duhej ta linim formën partizane të organizimit të ushtrisë dhe përse tani e tutje ato nuk janë më të nevojshme. Këtë konkluzion ta nxjerrim nga i gjithë zhvillimi i punëve në vedin tonë dhe i masave që po marrim. Pasi të themi se gradat deri tani ishin të nevojshme, të theksojmë momentin politik dhe ushtarak kur u vunë ato, pikërisht kur në drejtim të politikës së brendshme duhej kalitur pushteti popullor i porsavendosur, kur ushtria jonë ishte fare e re dhe, me hyrjen në masë në radhët e saj të njerëzve që nuk kishin marrë pjesë në luftën partizane, pra që nuk e kishin përgatitjen dhe kalitjen e nevojshme, duhej një disiplinë e fortë, kur duhesin goditur shpifjet e armiqve se vendi ynë ishte gjoja vend bashibozukësh, në duar të bandave të armatosura, ku gjoja sundonte anarkia etj. Partia mendoi se në ato kushte duhesin vënë gradat, sepse me gjithë ata njerëz të pakalitur, analfabetë, që nuk e zotëronin artin ushtarak, duhej bërë punë, por duhej edhe njëfarë autoriteti e discipline, një organizim më i fortë, kurdoherë nën drejtimin e Partisë. Prandaj të dalin të gjitha arsyet që na detyruan t'i vinim gradat atëherë, që të jemi në gjendje t'i shpjegojmë edhe arsyet përse duhen hequr tani.

Nga shtrimi i këtij problemi të arrijmë në përfundimin se gradat nuk duhen më, për arsyet se sot ndërgjegjja e masave popullore është rritur shumë, se vetë

Partia është forcuar. Ushtarët që vijnë tani në ushtri janë më të kalitur nga ana e formimit të tyre dhe me një ndërgjegje më të lartë; disiplina e njerëzve është e ndërgjegjshme, ata janë në gjendje ta përvetësojnë më shpejt e më mirë artin ushtarak. Për këto arsyenuk është më koha që çdo gjë në ushtri të bëhet duke e vënë theksin vetëm te komandimi, as duke përdorur mënyrat brutale në trajtimin e njerëzve që s'janë tjetër veçse forma të shfaqjes së burokratizmit në ushtri. Tani duhet përdorur më shumë puna edukative për bindjen e tyre. Kur ushtarët dhe kuadrot e ulët do të sqarohen nga ky dokument, atëherë do t'i thonë komandantit t'u flasë në mënyrë më njerëzore, me gjuhën e Partisë, sepse secili ka tru dhe kupton, po ka njëkohësisht edhe zemër, edhe ndjenja, prandaj nuk është nevoja që komandanti t'u bërtasë ushtarëve.

Ushtria jonë është ushtri e popullit, prandaj masat që po marrim për forcimin e saj të mëtejshëm, kanë lidhje me interesat e mëdha të tij. Këto masa nuk merren vetëm për disa interesa të ngushta. Gjersa Partia drejton kudo, ajo drejton edhe në ushtri me anën e komiteteve të Partisë. Ajo nuk pengon punën e askujt, përkundrazi, atje ku vë dorën e ku ka më shumë syrin Partia, çdo gjë shkon më mirë. Për shembull, sekretari i parë i komitetit të Partisë të rrethit nuk e pengon aspak kryetarin e komitetit ekzekutiv të kryejë funksionin e tij në pushtet, por e frymëzon të kryejë mirë çdo detyrë që ka. Kështu do të ndodhë edhe në ushtri. Sekretari i komitetit të Partisë të repartit nuk do ta pengojë komandantin e repartit në zbatimin e detyra-

ve të tij, përkundrazi, do ta ndihmojë më shumë për kryerjen e tyre.

Ka zëra që thonë: «Nuk ka ushtri pa komandant». Këta zëra te ne janë shprehje të një kuptimi jo të drejtë politik të problemit. Partia nuk e ka shtruar kurrë çështjen që të heqë komandantët, por ama ka theksuar gjithmonë se komandanti duhet të veprojë vetëm brenda kuadrit të vendimeve të Partisë. Në letër duhet të bëhet e qartë çështja që vërtet Partia drejton në ushtri, po edhe komandanti është komandant. Roli i tij në repart është kurdoherë shumë i rëndësishëm. Komandanti aty ka rolin e vet, ashtu sikurse ka rolin e tij edhe komisari. Këto masa duhet të çojnë në atë që presim, domethënë që disiplina e vetëdijshme të ngrihet në një shkallë me të vërtetë të lartë në ushtri. Prandaj të gjithëve t'u japim të kuptojnë politikisht gamën e madhe të masave dhe jo disa të thonë se duhet të mbahen gradat, jo përsë të vete atje, jo pse të rri këtu, jo pse m'u shkurtua paga, ose pse ai paguhet më shumë e unë më pak etj. Në qoftë se dikush nga kuadrot do të ankohet se iu ul shumë paga, tjetri, që ka 20 vjet në punë, po nuk merr aq të ardhura, do t'i thotë: «Nuk ke turp që ankohesh? Edhe në qoftë se ke marrë kaq shumë, mos kujto se është vepruar mirë. Kjo masë merret që të kalitësh edhe veten, të kalitësh edhe të tjerët».

Në letër ne duhet të bëjmë edhe sintezën e masave që po marrim tani në luftën kundër burokratizmit, të vëmë në dukje mirë drejtësinë e vijës së Partisë në këtë luftë, por pa bërë teorira. Aty të flasim si duhet edhe për rolin e masave. Populli kupton, se ka 25 vjet

që po flasim për rolin e këshillave popullorë, të cilët qëndrojnë dhe duhet të qëndrojnë kurdoherë mbi komitetet ekzekutive. Gjithashtu të kuptohet mirë që edhe Kuvendi Popullor është mbi Qeverinë, se gjithashtu është organ i zgjedhur nga populli. Po kështu të vëmë në dukje ç'të mira do t'i sjellë Partisë lufta kundër burokratizmit, të themi se Komiteti Qendror ka marrë masa për shkurtimin e organikave dhe për forcimin e mëtejshëm të aparateve administrative. Komiteti Qendror mori vendim që shumë shokë të udhëheqjes, të Byrosë Politike, të Plenumit, të Kryesisë së Këshillit të Ministrave dhe të Qeverisë të venë të punojnë në bazë, afër masave. Ndonjë që mendon cekët mund të thotë se këta që po dërgohen në rrethe nuk kanë punuar mirë, por ne t'i themi popullit se këta janë nga njerëzit më të mirë, janë nga ata që gjatë 25 vjetëve e kanë zbatuar me konsekuencë vijën e Partisë, janë njerëz që dikur kanë pasur një nivel të ulët, kurse sot janë bërë udhëheqës të shquar dhe me punën e tyre kanë përgatitur kuadro të tillë që, pas largimit të tyre, do të jenë në gjendje t'i zëvendësojnë atje ku ishin, kurse vetë këta kuadro të shquar me kapacitetin që kanë po venë të forcojnë akoma më shumë bazën. Meqenëse Partia me punën e saj ka krijuar një situatë të tillë në vendin tonë, ka përgatitur zëvendës, ajo tanë e gjykon të nevojshme, që shokë udhëheqës të shkojnë të punojnë në bazë, ku të ngrenë e të përgatitin jo një, po me dhjetëra, qindra e mijëra kuadro dhe të çojnë atje frymën e Partisë. Të vëmë në dukje në këtë letër se si mijëra punonjës, oficerë të vjetër e të rinj të ushtrisë sonë dhe të orga-

neve të punëve të brendshme, ministra, anëtarë të Byrosë Politike etj. po shkojnë vullnetarisht kudo, për drejtimin e punëve në rrëth, po edhe në prodhim, në ndërmarrje, në fshatra etj.

Të bëjmë gjithashtu të ditur direktivën që Komiteti Qendror i ka dhënë Qeverisë për rregullimin e pagave, sipas së cilës do të merren masa që pagat e punëtorëve e të nëpunësve të ulët e në përgjithësi të nëpunësve të mesëm të mos preken, por të preken vetëm ato të nëpunësve të lartë, duke i ulur në një nivel të arsyeshëm në përpjesëtim më të drejtë me pagat e punëtorëve. Në letër duhet të shpjegohet përsë do të bëhet një gjë e tillë, me qëllim që ta kuptojnë të gjithë që kjo është një masë e drejtë dhe në rrugën marksiste. Në qoftë se pagat e nëpunësve të lartë gjer tani kanë pasë qenë caktuar të mëdha, ishte gabim, po edhe kjo mund të shpjegohet me arsyet e vështirësive të fillimit pas Çlirimt, kur kuadrot tanë, të portsalalë nga lufta, kishin mbetur zbathur, zhveshur, pa shtëpi e plaçka, mbasi gjithçka ua pati djegur armiku, prandaj ishte me vend dhe e arsyeshme që asokohe ata të ndihmoheshin ca. Tani jeta në vendin tonë është përmirësuar, prandaj s'ka përsë pagat të mbahen më në atë nivel. Në këtë pjesë të letrës të shpjegohet që situatat aktuale kërkojnë që të gjithë kuadrot ta shohin me një sy të drejtë këtë masë, me shpirtin e sakrificës, duke vënë mbi çdo gjë interesat e larta të atdheut. Komiteti Qendror e kupton se sakrificat janë të domosdoshme dhe të arsyeshme të bëhen; të gjithë të kuptojnë drejt se tani jemi në situata kur duhet të bëjmë ekonomizime, të rrojmë e të vishemi thjesht

dhe se niveli i jetesës i gjithsecilit të ngrihet sipas punës dhe proporcionalisht me nivelin e jetesës të të gjithë popullit.

Këto probleme është e nevojshme të vihen në këtë dokument që populli t'i shohë të tëra në unitet dhe të jetë në gjendje kështu të gjykojë se Partia e ka drejt rrugën, në të gjitha drejtimet. Çështjen e kam që të nxjerrim një dokument të plotë, në të cilin populli të shohë edhe politikën, edhe anën edukative të këtyre masave që po merren, edhe anën e tyre organizative, edhe perspektivën. Vetëm në këtë mënyrë do të bëhet më e qartë perspektiva. Prandaj të mos zgjatemi, ta përgatitim këtë, se edhe eksperiencën e kemi për një gjë të tillë. Në vija të përgjithshme kështu mendoj unë të trajtohen çështjet në këtë letër.

Thirrja për problemet e planit të ri pesëvjeçar ishte një dokument i rëndësishëm. Edhe vendimi «Mbi luf-tën kundër burokratizmit për një metodë dhe stil revolucionar në punë» ishte gjithashtu një tjetër dokument shumë i rëndësishëm po ky mbeti brendapër-brenda Partisë. Tani do të dalë edhe letra, që do të jetë dokumenti i tretë i rëndësishëm historik i Partisë sonë i këtyre kohëve të fundit. Porsa të punohet kjo letër me masat punonjëse, mbarë populli ynë do të ngrihet në këmbë. Unë jam i bindur se populli do ta presë me entuziazëm të madh këtë letër, prandaj të flasim me popullin drejtpërdrejt, haptazi, t'ia bëjmë të qartë përsë i marrim këto masa. Pra, letra të lexohet përpara masave dhe të punohet me to.

Edhe një herë dua të theksoj se është e domosdoshme të vihet në dukje që këto vendime të Partisë po

merren në saje të ndihmës që kësaj i ka dhënë gjithë populli, në saje të sugjerimeve, propozimeve, këshilla-ve e kritikave të të gjithë punonjësve. Nga kjo ndihmë Partia dhe udhëheqja e saj kanë përfituar shumë. Prandaj që të zbatohen tërë këto masa me interes të përgjithshëm, i gjithë populli duhet t'i mbështetë me të madhe ato, sepse kështu ai ndihmon veten, mbron interesat e tij. Natyrisht, botimi i këtij dokumenti kërkon një mobilizim total, në radhë të parë nga Partia, e cila do t'i zbatojë gjer në fund këto masa. Populli do të thotë me siguri se rruga ku na udhëheq Partia është e drejtë.

Rëndësi ka edhe formulimi i dokumentit, me që-llim që të mos i jepet asnjë armë armikut të na luf-tojë. Kur të themi në letër, për shembull, se burokratizmi ka pasë krijuar vështirësi në popull, prandaj Komiteti Qendror ka marrë masa të rrepta për të zhdukur të gjithë ata faktorë që e ngjallin atë, nuk është nevoja të flasim në detaje, populli këtë e kupton. Në qoftë se do të themi në letër që burokratizmi nuk zhduket me një dekret, prandaj vetë populli të luftojë pa mëshirë kundër të gjitha llojeve e mbeturinave të tij, kudo që ato mund të duken, kudo që ato mund të ekzistojnë, sepse ai do të ketë kurdoherë përkrahjen e Partisë, të jemi të bindur se një gjë e tillë do ta rritë shumë fry-mën revolucionare në masat. Pra, të mos praktikojmë mënyrën gazetareske të trajtimit të problemeve në këtë dokument, po të vëmë në dukje si duhet rezultatet që do të kemi nga kjo punë. Rezultati kryesor i saj është pjesëmarrja e gjerë e masave në një mënyrë të papërshkruar në drejtimin e jetës së vendit. Në letër

të dalë mirë në dukje se masat që ka marrë Partia kohët e fundit e kanë ngritur popullin në këmbë. Të gjitha masat punonjëse, me mençurinë dhe me eksperiençën e tyre të madhe, në saje të këtij mobilizimi të lartë, kanë hartuar një plan të paimagjinueshëm, si asnjëherë tjetër. Kjo tregon njëkohësisht edhe zotësinë dhe forcën e madhe frymëzuese e organizuese të Partisë, tregon me ç'frymë revolucionare e shpirt krijues i ka edukuar ajo punonjësit e vendit tonë.

Edhe ushtria jonë, të vihet në dukje në letër, po bën gjëra shumë të mira. Ajo jo vetëm po forcohet ushtarakisht, por po bën ekonomizime gjer tek ushqimi e veshmbathja, në mënyrë që të bëhet sa më pak e kushtueshme dhe në rast nevoje apo rreziku, t'u përshtatet më lehtë situatave të vështira.

Si konkluzion, në letër të dalin qartë si pjekuria e Partisë, ashtu edhe entuziazmi i madh dhe urtësia e mençuria e masave tona punonjëse.

Sigurisht ju mund të keni edhe ide të tjera mbi këtë letër, prandaj t'i shprehim të gjitha dhe ta përgatitim si duhet këtë dokument me rëndësi të madhe. T'i futemi mirë kësaj pune, se nga njëra anë ne jemi duke punuar në praktikë, nga ana tjetër po punojmë që popullit t'i japim pasqyrën mbi çka është duke u bërë. Tani po flitet mjaft mbi këto çështje, po, kur t'i japim në dorë edhe këtë dokument, popullit do t'i thuhet: ja arsyet, ja qëllimi i Partisë, ja edhe ç'rezultate kemi nga këto masa që janë marrë dhe t'ia shpjegojmë ç'sy-nojmë që edhe ai t'i dijë.

Me një fjalë të gjitha çështjet kryesore të veprimtarisë sonë, të lidhura mirë, në mënyrë të rrjedhshme

e sintetike, mund të trajtohen në një dokument prej 30-40 faqesh. Ky do të bëhet, mendoj unë, një dokument shumë i vlefshëm për momentet politike në të cilat ndodhemi dhe pas daljes së tij nuk do të ketë më njeri as në radhët e punonjësve, as në ushtri që t'i keqinterpretojë këto masa.

Prandaj le të caktojmë një grup shokësh për ta përgatitur këtë letër, duke i trajtuar çështjet kështu siç i thamë.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbali i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH që gjendet në AQP

TE PUNOJMË ME RITMIN E PUNETOREVE

*Fjala në takimin me disa anëtarë të plenumit të KQ
të PPSH dhe sekretarë të parë të komiteteve të Partisë
të rrtheve¹*

8 shkurt 1966

Analiza që i bëri Byroja Politike e Komitetit Qendror problemit të burokratizmit ishte shumë e shëndoshë, marksiste-leniniste. Shokët vetë bënë autokritikë të drejtë e të fortë dhe kritikan të tjerët. Asnjëri nuk iu shmang autokritikës. Por çështja është që mbi këtë autokritikë dhe kritikë, mbi këtë ndihmë që marrim nga njëri-tjetri, si ne këtu në qendër, ashtu edhe ju në bazë, duhet të reflektojmë thellë. Jam i bindur se ju, për ato që lexuat në materialet, keni thënë se të gjitha janë të drejta. Ashtu është, të gjitha sa janë shkruar aty janë të drejta, por mendoj se ka edhe shumë gjëra që duken se janë të kuptueshme që në vështrimin e parë, po në fakt janë shumë të thella, prandaj duhet reflektuar mirë e thellësisht mbi to.

1 Pjesëmarrësit e këtij takimi kishin ardhur për të lexuar materialet e Byrosë Politike të KQ të PPSH të datës 3-4 shkurt 1966, lidhur me luftën kundër burokratizmit.

Ju thoni se i keni kuptuar si duhet të gjitha. Kjo është e lehtë për t'u thënë, por në fakt shumë e vësh-tirë për t'u zbatuar. Vallë a janë zhveshur të gjithë nga fryma e rehatisë dhe e komoditetit? Ne duhet të kemi parasysh se një gjendje e tillë është pasqyruar për një kohë të gjatë në jetën dhe në punën tonë, prandaj ajo nuk mund të zhduket lehtë. Të mos mendojmë se vetëm me një të lexuar të këtyre materialeve u zhdukën të metat. Në qoftë se nuk e përgatit fort veten për luftimin e këtyre të këqijave, përpiku sa të duash për t'i zhdukur, ato do të kthehen përsëri me vrap. Mund të bësh një autokritikë të mirë dhe të kesh përshtypjen e kënaqshme për vete, duke menduar se me këtë unë ia hap zemrën Partisë, por në qoftë se nuk i kuption thellë këto gjëra, kur të kthehesht në punë, në mos pas një muaji, pa kaluar shumë kohë do të fillosh përsëri nga avazi i vjetër.

Njëqind herë e kemi kritikuar një kuadër me përgjegjësi, megjithatë ai merr guximin dhe më bën një letër mua, sepse shoku Milo Qirko i paska bërë një kritikë përparrë disa punëtorëve. Shoku Milo ka bërë shumë mirë që e ka kritikuar përparrë shoferëve, sepse ai nuk ka punuar mirë, prandaj le t'i skuqen veshët.

Duhet t'i kuptojmë mirë këto gjëra shokë, por një-kohësht edhe t'i zbatojmë. Për t'i zbatuar duhet të futemi jo në leksionet, por në praktikën e vërtetë revolucionare, në shkollën e jetës së Partisë, e cila është shkolla më e madhe. Në këtë frysë edhe leksionet duhet t'i ripunojmë, t'i përgatitim në mengenenë e Partisë, e cila na mëson që populli duhet të edukohet të flasë lirisht, të kritikojë lirisht çdo veprim, çdo fjalë

të cilidto kur nuk përputhet me vijën e Partisë. Kjo është mengeneja e Partisë, që do të thotë t'u japësh mundësi punonjësve të të kritikojnë dhe ti të jesh i kënaqur ndaj atij që të kritikon. Të bësh kështu do të thotë të jesh marksist. Atij që të kritikon t'ia dish për të mirë që të ka hequr veshin, jo t'i zemërohesh, bile ca më keq në qoftë se shkon më tutje, duke menduar: «Ti që më kritikove, po më re në dorë, di unë çfarë të bëj me ty». Një mendim dhe qëndrim i tillë asgjekundi nuk bien erë marksiste.

Prandaj në të gjitha këto gjëra duhet të futemi thellë, si në aspektin ideologjik, ashtu edhe në atë politik. Të mos shkohet me mendimin se për çdo hap e për çdo veprim që të duhet të ndërmarrësh do të gjesh receta të shkruara në libra dhe deftere. Kjo është e pamundur. Partia ka këshilluar kurdoherë që komunistët dhe sidomos kuadrot udhëheqës, çdo mbrëmje kur venë në shtëpi, t'i bëjnë pyetjen vetes: «Si punova unë sot?», «punova mirë, i shërbeva si duhet Partisë dhe popullit apo jo?». Këtë ne nuk e bëjmë të gjithë, por duhet medoemos ta bëjmë, të analizojmë çdo veprim tonin, t'i trajtojmë këto çështje në mendjen tonë të zhveshur nga çdo mbeturinë politike, ideologjike, mikroborgjeze.

Tani e shohim edhe më qartë se sa i rrezikshëm ka qenë e mund të bëhej akoma burokratizmi me konceptet, format dhe metodat e gabuara të punës që kemi pasë adoptuar. Por Partia jonë ka vitalitet të madh dhe do ta zhdukë këtë sëmundje.

Si ndodhën ato fenomene kaq shkatërruese në Bashkimin Sovjetik? Ç'u bënë gjithë ata bolshevikë dhe

revolucionarë të vjetër me një stazh revolucionar shumë më të madh sesa ne, që kanë bërë 50 e ca vjet luftë revolucionare, që kanë punuar nën udhëheqjen e Leninit, të Stalinit dhe të Partisë Bolshevik? Si ndodhi kjo? Mos vallë për një ditë? Jo shokë, kjo ndodhi se atje kishte zënë vend burokratizmi dhe të gjitha mbeturinat u lanë të gjallërohen. Ishte e natyrshme që për këta njerëz që u pajtuan për një kohë të gjatë me to, burokratizmi të bëhej një natyrë e dytë e tyre. Revisionizmi modern përsitoi nga kjo situatë, pastaj e mori me lehtësi gjendjen në dorë. Prandaj ne duhet të nxjerrim mësime nga kjo që ka ndodhur atje, të marrim masa rrënjosore kundër burokratizmit në rrugë të drejtë partie, me pjekuri dhe pa u hutuar aspak.

Në popullin tonë, në kuadrot e çdo kategorie dhe të çdo sektori ka një entuziazëm të madh. Të tërë tregohen të gatshëm të shkojnë në prodhim. Megjithatë ka edhe njerëz që hezitojnë, që tremben të zbatojnë vijën e drejtë të Partisë dhe për këtë të mos çuditemi. Kjo tregon gjithashtu se punët tona nuk ecin si në gjalpjë. Po të mendonim kështu, do të gabonim se do ta merrnim këtë çështje lehtë-lehtë dhe do të linim pa zbatuar vijën e Partisë, ose do të silleshim arrogantë me njerëzit. Për ne, as njëra, as tjetra nuk lejohet. Në qoftë se lëmë mënjanë orientimin e Partisë, vijën e saj dhe biem në ujdi me pikëpamjet mikroborgjeze dhe me ndjenjat e sentimentalizmit të sëmurë të disa njerëzve, mbaroi puna, ne nuk do ta zbatojmë dot drejt vijën, ose do ta zbatojmë me urdhra, me arrogancë.

Mos kujtoni se e tërë kjo punë që kërkojmë të bëjmë është e lehtë? Mendoj se nuk është fort e lehtë

as për ju as për ne, por është e mundshme të kryhet dhe do ta kryejmë se forcat e shëndosha kolosale të Partisë janë në gjendje t'i kapërcejnë të tëra vështirësitë. Edhe ndjenjat e njerëzve Partia është në gjendje t'i kuptojë dhe të gjejë mënyrën si t'i drejtojë në rrugën e interesit të përgjithshëm. Një nga mënyrat më të mira për këtë qëllim është shembulli personal i udhëheqësve. Në këtë shembull njerëzit e popullit të shikojnë se Partia e Punës e Shqipërisë nuk është një parti dogmatike, as oportuniste, por një parti marksiste-leniniste. Këtë rektifikim për gabimet dhe për shtrembërimet që janë vërtetuar, ajo e bën në mënyrë revolucionare. Këtë është fare kollaj ta themi me fjalë, por ne duhet ta ndryshojmë krejt metodën dhe stilin tonë të deritanishëm të punës, të cilin duhet ta analizojë çdo udhëheqës.

Ne e kemi analizuar punën tonë dhe del se kudo kemi arritur disa suksese, por ato nuk janë të mjaf-tueshme. Prandaj kërkohet që të reflektojmë më thellë, se puna jonë kryesore është aksioni, prandaj duhet vepruar. Duke vepruar mund edhe të gabosh, por nuk ka gjë, se nga gabimet mëson dhe ndreqesh.

Rëndësi për ne ka të lidhemi me bazën, me masat e të mos mbetemi në zyra, sepse të mirat materiale për popullin krijohen nga njerëzit me punë në bazë, në prodhim. Kur hyjmë në zyrë të përgatitemi e të përcaktojmë masat për të konkretizuar një veprim tonin revolucionar në bazë, të përcaktojmë disa orientime kolektive e veprime të shpejta dhe jo për të bërë fjalë e diskutime të gjata dhe të kota nëpër mbledhje. Mbledhjet t'i bëjmë vetëm atëherë kur janë të domosdoshme

dhe jo thjesht për faktin se ato janë parashikuar të bëhen.

Pra, shokë, të shkoni te njerëzit atje ku punojnë e jetojnë, por jo me atë frymë e metodë të vjetër si shkohej gjer tanë si nga ju, ashtu edhe nga ne. Një metodë dhe stil i tillë duhet të ndryshojnë krejtësisht. Kur ke vendosur të shkosh në një kooperativë bujqësore për zgjidhjen e një problemi që nuk ka gjetur rrugë, duhet t'i vësh detyrë vetes që çështjes t'i shkosh gjer në fund dhe, si ta përfundosh, të kthehesë e t'i thuash komitetit të Partisë, byrosë ose sekretarit të parë që kjo çështje mbaroi, çdo gjë u zgjidh gjer në fund. Në rast se në këtë kooperativë më vonë ngjet diçka, për shkak se çështja që ke ndjekur në fakt nuk ishte zgjidhur, atëherë ti, që ke pasë njoftuar se ajo ka përfunduar, do të mbash përgjegjësi dhe udhëheqja kolektive do të ketë plotësisht të drejtë të të thotë që ke gënjer, se puna që ke bërë nuk ka qenë e vlefshme, por e kotë. Në qoftë se një gjë e tillë përsëritet një herë, dy herë ose tri herë, atëherë udhëheqja të thotë: «Largohu që këtej, shko në bazë, mëso!». Kjo është edukatë marksiste. Partia nuk na do ne përsytë tanë të bukur, por për t'i bërë punën.

Tjetri mund të thotë: «Si më hiqni mua, unë kam marrë pjesë në luftë, kam gjithë këto dekorata që e vërtetojnë këtë». E kaluara nuk mund të justifikojë gabimet e përsëritura që bën sot. Po bëre dy, tri, katër herë gabime, dekoratat mbaji për vete, por këtej nga kjo punë largohu, se nuk mjafton të rrojmë vetëm më të kaluarën, duhet të punojmë gjer në fund dhe kurdoherë e më mirë. Jeta është luftë, prandaj kuadrot

duhet të jenë vazhdimisht në frontet e para të çdo lloj lufte e pune. Kjo gjë nuk arrihet aq lehtë. Që të arrihet, në radhë të parë, kërkohet të ndryshohen konceptet mbi punën. Kur bëjmë një mbledhje, sikur dalim të kënaqur prej saj, na duket se punën e kryem mirë dhe me kaq ajo mbaroi. Jo shokë, vetëm me mbledhje nuk kryhen punët. Pas mbledhjes duhet vepruar për të vënë në jetë ato që janë vendosur.

Këtu ka rëndësi edhe çështja e kompetencave. Të marrësh dhe të ushtrosh kompetencat që të përkasin, nuk është një fjalë e kotë. Ato duhen marrë e duhen zbatuar. Secili duhet të jetë përgjegjës për ato që i takojnë t'i zbatojë. Përgjegjësi, për ato që ka në kompetencë t'i kryejë vartësi i tij, të mos pranojë që ky t'i vijë orë e çast të bisedojë me të, se kjo në një mënyrë ose në një tjetër do të thotë të ndahen fajet bashkërisht. Përgjegjësi duhet të drejtojë në mënyrë të tillë që secili të kryejë detyrat e veta dhe të mos lejojë të ndodhë që, me dashje ose pa dashje, vartësi ta futë në ortakllëk për të kryer ato punë që janë në kompetencën e këtij të fundit. Kudo është Partia, por ka edhe përgjegjësi që u ngarkohen t'i kryejnë shokë të veçantë. Në qoftë se vartësi do të pyesë për një punë që duhet ta zgjidhë vetë, eprori i tij t'i thotë: «Mos më merr në telefon për këto gjëra, këtë punë e ke ti në kompetencë, prandaj kryeje vetë». Ky fare lehtë mund t'i thotë bëje kështu ose ashtu, por atëherë do të mendojë se vartësi nuk është asgjë, ai edhe për gjëra të vogla pyet, prandaj mund t'ia hipë në kurrit shumë lehtë. Pra, vartësi, kur të vijë tek eprori, duhet të mendojë mirë, të vijë të kërkojë ndihmën e tij për një vështi-

rësi që për të është e pakapërcyeshme. Secili duhet të bëjë të njëqind përpjekjet për të kapërcyer çdo pengesë dhc vështirësi gjersa ta kryejë detyrën mirë, deri në fund.

Mund të rrish të flasësh shumë për këto gjëra, por çështjet nuk zgjidhen vetëm me fjalë. Këto që themi, në teori i dimë të gjitha, por ama t'i zbatojmë, se edhe eksperiencë kemi. Ne duhet të kuptojmë se nuk ecim në një shkretëtirë, por përpara një vepre kolosale që kanë ndërtuar Partia dhe populli ynë me abnegacion dhe sakrifica të mëdha. Të gjitha këto që ka bërë Partia jonë brenda një kohe kaq të shkurtër në të gjithë sektorët dhe në kushte kaq të vështira janë arritur në saje të vendosmërisë së madhe revolucionare të të gjithë punonjësve, të komunistëve dhe të kuadrove tanë. Të gjithë, kush më shumë e kush më pak, kanë luftuar e punuar me një shpirt të lartë sakifice, kanë luftuar e luftojnë kundër mbeturinave dhe për kapërcimin e vështirësive. Është një punë shumë pozitive që Byroja Politike e ka analizuar drejt problemin e burokratizmit. Por me gjithë këtë punë kolosale prapë ka mjaft të meta e vështirësi, prandaj gjithë këtij entuziazmi që ka përfshirë tanë kuadrot, bazën, punonjësit në të gjithë sektorët, ne duhet t'i përgjigjemi me një punë të pjekur e të kualifikuar. Të japim ne të parët shembullin, atë shembull që e kemi dhënë kurdoherë.

Nesër do t'i propozojmë Byrosë Politike për të marrë vendim që disa nga anëtarët e saj, zëvendëskryeministra, ministra, anëtarë të Komitetit Qendror dhe kua dro të tjerë të lartë, të shkojnë të punojnë në rrethe.

Ata, kudo që kanë punuar, i kanë kryer si komunistë e si udhëheqës detyrat, kanë një stazh lufte e pune shumë të gjatë, por tani jemi në një moment që besnikërinë dhe pjekurinë e tyre të madhe të fituar gjatë 25 vjet lufte e pune të pandërprerë në drejtim të Partisë, të ushtrisë dhe të pushtetit popullor, ta vënë akoma më mirë në shërbim të Partisë dhe të masave të popullit. Kjo masë është e mundur të merret tani sepse ata jo vetëm kanë përgatitur zëvendësit e tyre, por me këtë eksperiencë që kanë fituar kanë mundësi më të mëdha për të shpënë në bazë këtë frysme të re, këtë metodë dhe stil të ri pune dhe, së bashku me ju, të mobilizojnë masat e gjera të Partisë dhe të popullit. Tek ato do të krijohen një gjallëri dhe frysme e papërshkruar revolucionare kur të shohin se midis tërë atyre kuadrove e punonjësve që venë në bazë, ka edhe anëtarë të Byrosë Politike, edhe zëvendëskryeministra, edhe anëtarë të Komitetit Qendror dhe të Qeverisë. Këta anëtarë të Byrosë Politike, zëvendëskryeministra apo ministra, megjithëse do të venë në bazë, përsëri do të vazhdojnë të janë në udhëheqje të Partisë e të Qeverisë se ata janë nga shokët që e kanë të pastër aktivitetin e tyre revolucionar. Ata nuk do të venë në bazë si instruktorë, por hëpërhë do të janë si të deleguar të Partisë dhe të Qeverisë. Çështja është që të mos i prishim format ekzistuese të organizimit, por t'i ruajmë ato. Vërtet ata do të janë me funksionin e të deleguarit në rreth, por në fakt do të janë në rolin e sekretarit të parë apo të kryetarit të pushtetit pa i spostuar nga puna ata që i kryejnë efektivisht këto

funksione, sepse do të ketë punë edhe për ata që janë, edhe për kuadrot që venë atje.

Natyrisht, ndonjëri që është anëtar i Byrosë Politike dhe që do të jetë tani në rolin e sekretarit të parë të Partisë në rrëth, dikur mund të ketë qenë në udhëheqje të një rrëthi, por, ngaqë është shkëputur për një kohë të gjatë, ai nuk e njeh si duhet dhe në detaje zhvillimin e jetës në bazë sepse, sado që ka pasur kontakte me të, këto kanë qenë vetëm për probleme të caktuara. Tani ai ka nevojë të rimarrë përsëri një valë të madhe nga fryma e bazës, por njëkohësisht edhe do të ndihmojë me eksperiencën e vet organizatën e Partisë të rrëthit dhe të gjithë shokët e udhëheqjes atje.

I deleguari i Komitetit Qendror nuk do ta spostojë nga detyra e tij sekretarin e parë të komitetit të Partisë të rrëthit, por ky e di ama se ai që vjen është anëtar i Byrosë Politike. Edhe anëtari i Byrosë Politike që shkon atje, gjithashtu e di se shoku që gjen në rrëth është një shok me kapacitet, por që edhe ai ka njëkohësisht të metat e veta. Posa të shkojë në rrëth ai do t'i thotë sekretarit të parë për shembull: «Merr mirë në dorë pjesën tënde të punëve, çështjet ideologjike, të kulturës e të arsimit, çështjet e edukimit dhe të ngritjes së ndërgjegjes së njerëzve, se për këto punë ti ke eksperiencë, prandaj futju mirë kësaj, kurse për komitetin ekzekutiv mos u preokupo shumë, sepse atje pasqëtaj do të kesh një shok tjetër me kapacitet dhe eksperiencë».

Vajtja e shokëve të këtij niveli në rrëth do ta forcojë, me siguri, udhëheqjen e Partisë e të pushtetit atje.

Pastaj anëtari i Byrosë Politike ka edhe disa kompetencia më shumë nga sekretari i parë i komitetit të Partisë të rrethit dhe Partia kurdoherë e porosit t'i zbatojë ato. Drejtuesi i një rrethi, me ca vështirësi e ngre zérin për t'i folur një ministri për zgjidhjen e një problemi, kurse anëtari i Byrosë Politike i thotë ministrit të Komunikacioneve, bie fjala, që «brenda dy ditëve mallrat që kanë zënë depot të evadohen menjëherë nga Durrësi dhe për këtë çështje nuk do të bisedojmë më, sepse të kam lajmëruar prej shumë kohësh përpara, prandaj kjo punë duhet të kryhet me doemos». Ka fjala kuvend këtu. Domethënë kur të ketë shokë me kompetenca kaq të gjera në rrethe, administrata do të mendojë mirë se nuk do të lejohet t'i zvarritë punët, nuk mund të thotë jo ka faj ky, jo ka faj ai. Këto gjëra udhëheqësi, anëtari i Byrosë Politike, nuk i lejon. Pastaj, ai jo vetëm që ka kompetenca të gjera, por do ta mësojë dhe duhet ta mësojë edhe shokun e rrethit si t'i thotë një shoku përgjegjës që të rregullojë apo të zgjidhë një problem.

Ne duhet të vendosim kudo një frymë pune me të vërtetë revolucionare. Kur të vijë anëtari i Byrosë Politike në një rreth për të punuar bashkë me ju si i deleguar i Komitetit Qendor, më pas ai do të zgjidhet atje si sekretar i parë i komitetit të Partisë të rrethit. Duke punuar dhe duke jetuar midis jush do ta nlohë më nga afër gjendjen e rrethit dhe nuk do të ketë nevojë që të vijë sekretari i një organizate-bazë ose drejtori i një ndërmarrjeje e ta vërë në dijeni mbi gjendjen e punëve, sepse këtë ai do ta dijë nga takimet e vazhdueshme që do të ketë me njerëzit. Në qoftë

se do të vendosë të shkojë për një vizitë në një qendër prodhimi nuk do të marrë takim vetëm me drejtorin e ndërmarrjes dhe me sekretarin e Partisë, por do të takohet, në radhë të parë, me punëtorët, do t'i pyesë e do të mësojë prej tyre si shkojnë me punën, ç'nevoja kanë, përse nuk realizohen detyrat në këtë sektor apo në atë tjetrin, kush e ka fajin për këtë etj. Për këto gjëra do të pyesë punëtorët se ata i krijojnë të mirat materiale, kurse për njerëzit e zyrave do të interesohet vetëm si punojnë, a i shërbejnë prodhimit dhe, po nuk i kryen detyrat, do të marrë një nga punëtorët më të mirë e do t'ia propozojë byrosë së komitetit të Partisë që ta vëré në krye të ndërmarrjes, kurse drejtori që është të hiqet prej andej se nuk po e bën punën.

Masat për çështje të tilla duhet të merren shpejt dhe të mos presim sa të bëhet mbledhja e zakonshme e byrosë duke u nisur nga fakti se ajo e paska në nomenklaturë e ku ta di unë. Organi që e ka në nomenklaturë, kur është rasti, mund të mblidhet edhe jashtë radhe. Po të ecim në këto gjëra si kemi ecur deri tani, punët do të na pengohen. Anëtari i Byrosë Politike, që vete në bazë, mund t'i mbledhë punëtorët e ndërmarrjes dhe t'u thotë: Partia jeni ju dhe nuk është drejtori apo sekretari i organizatës, Partia është në mes jush, prandaj është detyra juaj që drejtorin apo sekretarin, kur nuk janë në rregull, t'i vini në rrugë, t'i ndalonit që të mos ecin shtrembër, t'i kritikoni kur bëjnë gabime e sidomos kur i përsëritin ato dhe t'i hiqni kur vazhdojnë të mos punojnë mirë. Kështu do të këshillohen punëtorët që të jenë ekzigjentë ndaj përgjegjësve, do

t'u thuhet që brenda ligjeve dhe normave të Partisë të bëjnë kërkesa për të mirën e punës, të kritikojnë ata që s'punojnë dhe, kur të kenë diçka që nuk po e realizojnë dot se i pengojnë disa njerëz, t'ua thonë udhëheqësve të Partisë, natyrisht shkurt, sepse edhe këta mund të jenë të lodhur nga puna dhe kanë nevojë edhe të çlodhen që të punojnë prapë nesër.

Këto takime të bëhen në mbrëmje, pas punës dhe jo sikurse veprohet tani që shumë mbledhje bëhen në orarin e punës. Atëherë ku është këtu disiplina e punës, disiplina e prodhimit? Për këto s'mendojnë të gjithë. «Do të bëjmë mbledhje se kemi punë të mëdha», thotë dikush. Aq më keq kur bëhen mbledhje të kota, të papërgatitura, kur kuadrot venë në to pa pasur asnje shënim se ç'do të diskutojnë, duke u nisur nga një koncept megalomanie sikur fjala e tyre është xhevahir. Këto janë të palejueshme. Mbledhjet, shokë, kur është nevoja, të bëhen jashtë orarit, bile edhe natën. Stalini edhe natën punonte. Të punojmë, pra, të gjithë me rrimin e punëtorëve, se atëherë do ta kuptojmë më mirë edhe punëtorin që punon intensivisht 8 orë dhe që mbledhjet e prodhimit i bën jashtë kohës së punës.

Pa futjuni një herë punës kështu si na mëson Partia. Ne kemi nevojë për një mengene të tillë, pastaj të shikosh si do të kërkosh llogari kur, mbasi të kesh punuar 8 orë ditën, të të thérresë edhe komiteti i Partisë dhe të detyrohesh të dëgjosh me mërzitje disa kuadro të tij që vijnë në mbledhje fare të papërgatitur. Kjo punë që bëjnë disa nga kuadrot tanë nuk është as efikase, as revolucionare. Koncepte të tilla mbi punën

duhen ndryshuar dhe duhen zëvendësuar me koncepte revolucionare. Për atë metodë e stil jorevolucionar pune që ndeshim në praktikë ne kemi përgjegjësi të madhe, por do ta ndryshojmë gjendjen, sepse brumin e Partisë dhe të popullit e kemi shumë të mirë.

Neve na duhet të punojmë si revolucionarë, të reflektojmë mbi këto çështje që u ngritenë këtu se këto masa që po marrim janë të menduara mirë. Për to ne do t'i themi çdo gjë edhe popullit, ashtu siç i thamë edhe për planin e ri pesëvjeçar, për të cilin ai u mobilizua, diskutoi, dha mendime të vlefshme dhe bëri që të përgatitet një plan shumë i mirë. Populli të kupton për ato që i thua. Kur ne t'i themi se duhet të jetojmë thjesht, të mbahemi me prodhimet tona, ai e pranon këtë. Ne do t'i themi që pagat e nëpunësve të lartë, duke filluar nga ajo e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror, do t'i ulim; do t'i flasim gjithash tu edhe për heqjen e gradave në ushtri, do t'i shpjegojmë edhe pse i vumë ato edhe përsë po i heqim. Ky është një zinxhir i tërë. Kur t'ia bëjmë të ditur të gjitha këto, atëherë masat do të thonë, ja, kjo Parti është jona, Parti e vërtetë, serioze, që nuk ka vetëm fjalë, por ato i shoqëron edhe me vepra; do të thonë, ja, Partia po bën atë që do populli, masat që po merr ajo janë të drejta.

Mbase efektin e madh të këtyre masave që po merr Partia, nuk e shohim sot, por atë do ta shohim nesër. Populli, në fakt, këto dobësi e të meta i ka parë dhe ne do t'i themi atij që këto të meta e dobësi, kundër të cilave tani po marrim masa dhe po i korrigjojmë, nuk i zbuluam vetë, por na këshillove e na sinjalizove ti

popull dhe tani erdhi koha që gjërat të vihen në vend, ashtu siç po vihen. Por mësimet që nxorëm duhet t'i kemi parasysh vazhdimisht që këto të meta të mos na përsëriten herë tjetër.

Të kemi parasysh që forca jonë e madhe qëndron te populli dhe te Partia. Këtë do t'ua shpjegojmë mirë Partisë dhe masave, por njëkohësisht do t'i themi popullit që atë të mos e pengojë asnijëherë arroganca e ndonjë funksionari për të ngritur zërin, por t'u thyejë hundët atyre që shkelin ligjet e Partisë dhe të popullit. T'i themi popullit që respektin për Partinë të mos e konfondojë kurrë me qëndrimin revolucionar që duhet të mbajë ndaj personave që gabojnë.

Masat që po marrim, shokë, kanë një rëndësi shumë të madhe parimore, jetike, politike, ideologjike dhe organizative. Ato do t'u japid një hov të madh rritjes së patriotizmit të masave tona punonjëse, edukimit revolucionar politik dhe ideologjik të Partisë dhe të popullit, zhvillimit të mëtejshëm dhe me ritme më të shpejta të ekonomisë dhe të kulturës në vendin tonë, rritjes së mirëqenies së masave tona punonjëse. Ju, shokë, punoni të gjithë në bazë dhe e shikoni vetë se është ngritur në këmbë i gjithë populli, i madh e i vogël, dhe po punon me vrull, si kurrë ndonjëherë tjetër, edhe tani në kohën e dimrit, duke hapur tarraça, duke grumbulluar plehun, duke pastruar kanalet kulluese e duke bërë plot punë të tjera. Gjithë këtë vrull të madh në punë e frymëzon vija e drejtë e Partisë. Ky vrull për korrigjimin e të këqijave që na kishin ndodhur, përbën atë vlerësim të lartë që masat punonjëse i bëjnë punës së Partisë. Gjatë kësaj pune të

madhe në praktikë mund të vërtetohen edhe gabime, por jemi të bindur se ne në parime nuk gabojmë.

*Botohet për herë të parë si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

PERGATITJA E PLANIT TË RI PESEVJEÇAR KËRKON PUNË SERIOZE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

9 shkurt 1966

Për studimin dhe aprovimin e projektplanit të pesë-vjeçarit të katërt propozoj të mos ndjekim metodën e gjertanishme. Mendoj të mos mblidhemi këtu 10-12 orë, të bëjmë disa pyetje për Komisionin e Planit të Shtetit e të na jepen disa përgjigje, me të cilat mund të jemi ose mund të mos jemi dakord dhe të pranojmë shifrat me disa ndryshime të vogla. Plani i ri ështëjeta e vendit tonë për një periudhë të tërë pesëvjeçare, prandaj kërkohet një punë shumë serioze për përgatitjen e tij. Në Kryesinë e Këshillit të Ministrave jeni të tërë anëtarë të Byrosë Politike, prandaj është formal shqyrtimi i planit edhe në Kryesi. Më e drejtë është që Qeveria t'ia përgatitë Byrosë Politike projektplanin dhe të eli-

¹ Një nga çështjet që u diskutua në këtë mbledhje ishte procedura që duhej të ndiqej për shqyrtimin e shifrave të projektplanit të katërt pesëvjeçar.

minohet mbledhja e Kryesisë. Rishikimi i projektplanit të ri pesëvjeçar në Byronë Politike mendoj të bëhet në disa mbledhje të saj. Për çdo kapitull kryesor të projektplanit, për shembull, për ndërtimet, bujqësinë, industri-në, financat, transportin, eksportin, importin, kuadrot etj., etj., të mos i raportohen Byrosë Politike shifrat e materialit që na paraqitet, të cilat gjatë kësaj kohe ne do t'i kemi mësuar përmendësh, të mos jepet një informacion stereotip si ky që na është dhënë edhe kësaj radhe që, po ta krahasosh me atë të 15 vjetëve më parë, është gati krejt i njëllojtë. Në relacion duhet të arsyetohet me llogari, përse dhe si është arritur në këto shifra, ku janë vështirësitë, ku nuk janë, ku duhen marrë masa, ku nuk duhen marrë etj. Për çdo kapitull të dalin qartë mundësitet tona reale, të binden anëtarët e Byrosë Politike se kjo mund të realizohet, kurse kjo tjetra nuk mundet. Unë rekomandoj që nënë Byronë Politike të mos na vijnë më gjëra shumë sempliste, po të na paraqitet esenca politike, ekonomike, organizative e planit dhe kjo punë të bëhet për çdo kapitull.

Rekomandoj që, kush do të ketë pyetje, le t'i mbajë shënim për t'i bërë më vonë. Kur të jenë ezauruar të gjitha shpjegimet nga shokët e Komisionit të Planit të Shtetit vetëm atëherë mund dhe duhet të bëhen pyetje nga të gjithë ata që do të kërkojnë shpjegime të tjera për çështjet që nuk do të jenë prekur ose nuk do të jenë svaruar. Ne duhet të jemi të vëmendshëm, të mos bëjmë pyetje për ato që janë shpjeguar një herë, me qëllim që të mos humbasim kohë.

Mbasi të kemi marrë sqarime edhe për pyetjet tona, atëherë mund të themi se fillon mbledhja për diskutimin

dhe për aprovin e projektplanit, megjithatë ai akoma nuk ka marrë formë të prerë. Kjo është gjysma e punës së përgatitur, për arsyen se ai do të kalojë në plenumin e Komitetit Qendror. Në plenum do të paraqiten shifrat dhe do të jepen shpjegimet e nevojshme. Pastaj, secili nga shokët përgjegjës në sektorët e veçantë do të flasë dhe do t'i plotësojë më në hollësi shpjegimet për sektorin e vet, me qëllim që t'ua bëjë më të qartë çështjen të gjithë anëtarëve të plenumit të Komitetit Qendror.

Së fundi, në plenum do të procedohet me pyjetje. Shokët që janë në krye të sektorëve të ndryshëm, të cilëve u takojnë ato çështje, do të përgjigjen dhe atëherë do të vendoset mbi projektplanin dhe projektdirektivat, të cilat, pasi do të diskutohen gjerësisht në popull, do të aprovoohen në Kongresin e Partisë.

Pastaj Qeveria do ta kalojë projektplanin për diskutim në Kuvendin Popullor. Deputetët, është e nevojshme, që materialin ta kenë 10-15 ditë përpara që të mund të marrin pjesë aktive në seancat e komisioneve për të studiuar çështje të caktuara dhe për të marrë të gjithë përgjegjësitë si përfaqësues të popullit. Ministrat duhet të venë në këto komisione dhe t'u japid shpjegime deputetëve. Një procedurë e tillë mendoj të ndiqet, po të jeni dakord të gjithë.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

UDIËHEQËSIT FJALET I SHOQËROJNE ME VEPRA

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH*

9 shkurt 1966

Në këtë mbledhje të Byrosë Politike mendojmë të paraqesim disa propozime për të forcuar punën e Partisë në bazë. Për këto propozime kemi pasur parasysh frymën e vendimeve që morëm, nevojën e madhe që del për të ndihmuar bazën si dhe dëshirën që shfaqen shumë shokë në mbledhjen e kaluar të Byrosë Politike për të vajtur në bazë, ku të jatin ndihmën e tyre. Kemi pasur parasysh gjithashtu që puna në qendër, domethënë në Byronë Politike, në Sekretariatin e Komitetit Qendror, në Qeveri dhe në Kryesinë e Këshillit të Ministrave të mos dobësohet, përkundrazi të forcohet, duke i shkarkuar ato nga shumë gjëra të tepërtë. Shokët që do të venë në bazë do të ndihmojnë edhe për forcimin dhe përmirësimin e punës në udhëheqje.

Një masë e tillë është e domosdoshme dhe urgjente

të merret, së pari, për forcimin e punës, së dyti, nga ana politike, se njerëzit do të shohin që, si të gjithë, edhe udhëheqja e Partisë dhe e shtetit i përgjigjet hovit të madh të masave dhe të kuadrove që kanë kërkuar të venë në bazë. Kjo do të bëjë përshtypje shumë të mirë, njerëzit do të thonë se udhëheqësit e Partisë dhe të shtetit fjalët i shoqërojnë edhe me vepra, shkojnë edhe vetë për të punuar dhe për të jetuar në bazë.

Shoku Enver Hoxha, mbasi bëri disa propozime për të forcuar punën në qendër e në rrëthe, vazhdoi:

Propozoj që shoku Manush Myftiu të vejë sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Tiranës.

Shoku Rita Marko të vejë sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Durrësit.

Shoku Gogo Nushi të vejë sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Beratit.

Të gjithë shokët që do të dërgohen nga qendra në detyrat e reja hëpërhë, gjersa të zgjidhen, të venë si të deleguar, por dua të shtoj që të mos qëndrojnë atje si në gjemba, këtë ta kenë të qartë të gjithë, prandaj, sipas posteve që do t'u ngarkohen, të ushtrojnë mirë kompetencat që u përkasin. Aktualisht këta do të jenë si të deleguar të Komitetit Qendror, por konkretisht do të luajnë rolin e sekretarit të parë të komitetit të Partisë. Prandaj, pa spostuar shokun që është i zgjedhur, i deleguari të bëjë ndarjen e punës me të.

Tani ju urojmë juve, të tre shokëve, dalçi faqebarëdhë në detyrat e reja! Me këtë rast dëshiroj të them disa fjalë.

E para, vija dhe hovi revolucionar i Partisë sonë duhet të shkojnë kreshendo, në rritje, me qëllim që të bëhet një kthesë revolucionare në çdo drejtim, në radhë të parë në Parti, po edhe në pushtet e kudo. Ju, që do të veni në bazë, propozoj në mënyrë të veçantë që, porsa të shkonit, të punoni me një metodë të tillë pune që atje menjëherë të ndihet një kthesë rrënjosore sidomos në funksionet që do të kryeni. Për këtë duhet që të shfrytëzoni eksperiencën më të mirë të punës suaj si anëtarë të Byrosë Politike në kohën kur shkonit që këtej në rrethe. Por, në këtë situatë, më duket se keni mjaft për të bërë në drejtim të përsosjes të metodës së punës, për të cilën duhet të mendoni mirë.

E dyta, ruhuni nga rutina, nga metoda e gjertanishme e punës së komiteteve të Partisë dhe të komiteteve ekzekutive se, me të vajtur atje, ka rrezik që kjo rutinë t'ju bëjë përvete dhe të adoptoni të njëjtën metodë pune që ka qenë praktikuar atje deri më sot, me ndonjë ndryshim të vogël. Këtë ta keni mirë parasysh, ndryshe do të mbyteni në punë dhe gjë s'do të bëni.

Puna juaj kryesore në bazë duhet të jetë me njerëzit në qendrat e punës e në kooperativat bujqësore. Ky orientim nuk është vetëm për ju, por për të gjithë punëtorët e aparateve të Partisë. T'i mësojmë shokët, sekretarët ose instruktorët e komiteteve të Partisë, që, kur të ngarkohen me një punë, të punojnë gjithë ditën me njerëzit dhe të kthehen me detyrë të kryer. Në mbrëmje, edhe pse mund të jenë të lodhur, t'i raportojnë, sipas rastit, sekretarit të parë të komitetit të Partisë. Cse disa shokëve të caktuar që këtë punë, duke e parë.

në të tëra anët, politike, ekonomike, organizative etj., e përfunduan.

Mendoj se duhet të likuidohen rrënjosht metoda e organizimit të mbledhjeve të tepërtë, të fryra, të zgjatura dhe këto të zëvendësohen me mbledhje konstruktive, ku të shihen, në radhë të parë, ana politike, ideologjike dhe ekonomike e çështjes, si dhe masat që duhen marrë për të organizuar kontrollin e zbatimit të detyrave etj., e të bëhen shkurt, në mënyrë operative, por të thellë marksiste-leniniste konkluzionet e punës. Të evitohet gjithashtu thirrja e komunistëve, e kuadrove dhe e punonjësve të ndryshëm gjatë kohës së punës në grupe nga 5 ose 10 veta në aparat, ku presin t'u vijë radha dhe bëjnë muhabet. E gjithë kjo rutinë, kjo metodë pune e prapambetur, duhet të ndryshojë. Varet shumë nga ju, shokë, që do të shkoni në bazë, që t'i jepni një ton të ri punës.

Eshtë e domosdoshme që në të gjitha qoshet e punës së Partisë dhe të pushtetit të zhdukjet çdo shfaqje e metodës së komandimit dhe të zotërojë kudo metoda e bindjes se kështu tjetri do ta kuptojë më mirë kur t'i thuash që duhet të përpinqet më shumë për ta kryer detyrën.

Të kemi parasysh gjithashtu se kur theksojmë që në punën tonë t'i referohemi kurdoherë metodës së bindjes, këtë të mos e kuptojmë sikur jemi të detyruar të qëndrojム 20 orë për të dëgjuar një njeri të ngeshëm që na thotë përralla. Ne, si udhëheqës partie dhe shteti, e kemi për detyrë t'i bindim njerëzit, t'i sqarojmë, por edhe ata që i këshillojmë duhet të mësohen të reflektoj-

në. Ne e kemi për detyrë t'ia shpjegojmë cilitdo një çështje që s'e kupton, mundet, po na lejoi koha, edhe t'ia rishpjegojmë, por jo të vazhdohet i njëjtë avaz, të bisedohet e stërbisedohet me të, se kjo nuk është fryshtë dhe metodë pune partie. Pra t'i luftojmë fjalët dhe muhabetet e tepruara, shpjegimet e gjata e të stërholluara. Partia na mëson të jemi të matur, parimorë, të zgjidhim problemet drejt dhe shpejt. Mund ta mbash tjetrin vetëm pesë minuta por, po të kapesh te thelbi i çështjes, je në gjendje t'i thuash e ke apo nuk e ke drejt. Ai mund të thotë se unë nuk mbeta i kënaqur nga shpjegimet e tua, nuk u sqarova, por le të reflektojë edhe vetë njëçikë. Po të jetë e mundur mund ta presësh edhe një herë tjetër, por ka njerëz që nuk e pranojnë fare mendimin që i jep. Një njeriu të tillë s'ke ç'i bën, nuk ke kohë të humbasësh me të. Ne nuk kemi dalë t'i bëjmë qejfin atij që është i çakërdisur ose që nuk ia do interesë personal të bindet. Megjithatë sekretari i Partisë e ka për detyrë të sinjalizojë, për të mirën e këtij njeriu, disa njerëz, me të cilët ai ka të bëjë, që t'i rrinë afër dhe t'i mbushin mendjen. E them këtë se te disa njerëz kanë zënë vend një sërë huqesh që nuk përputhen me fryshtë, metodën dhe stilin e punës së Partisë. Ata, me gjithë sqarimet që mund t'u japësh, «nuk jemi të qartë», të thonë. Në të gjitha këto drejtime ne duhet të kemi shumë kujdes në qoftë se duam t'i ndërrojmë fryshtë dhe stilin e vjetër të punës.

Tani që do të shkoni në bazë ju, shokë, bëni kujdes që të mos përsëriten më nga drejtuesit e bazës stili dhe metoda e vjetër e punës. Sipas praktikës së gjertanishme, kur vete sekretari i parë në një ndërmarrje, atje do

të dalin ta presin patjetër drejtori, sekretari i organizatës së Partisë, shefi i kuadrit etj. Ne ta ndërrojmë këtë metodë pune. Ata mund të dalin përsëri ta presin sekretarin e parë, por këto të jenë takime pune dhe jo duartrokitje. Sipas rastit mund t'i themi drejtorit të qëndrojë në punën e vet, t'i themi sekretarit të organizatës-bazë të Partisë gjithashtu të qëndrojë në punën e vet se, po ta ndiej nevojën, vij vetë andej nga ty, kurse tani, mund t'i thuhet, kam ardhur të takohem me punëtorët. E rëndësishme është të kuptohet thellë se puna jonë nuk duhet të bazohet te takimi me kuadrot, por te forca e klasës punëtore. Pra t'u themi haptazi punëtorëve: «Unë kam ardhur në rrethin tuaj si sekretar i parë të ndihmoj organizatën e Partisë me këto forca modeste që kam, por duhet që edhe të gjithë ju të punoni në fryshtë e Partisë, të realizoni detyrat. Këtu sundoni ju, jo drejtori ose sekretari i organizatës. Ata s'janë gjë tjetër veçse pjesëtarë të këtij kolektivi, të cilët, më shumë se kushdo tjetër, duhet të bëjnë mirë detyrën që u është ngarkuar dhe, që ta bëjnë mirë këtë, ata duhet të jenë kurdoherë nën drejtimin dhe syrin tuaj e të Partisë. Prandaj kur gabojnë t'i kritikoni, mos bëni lëshime ndaj tyre».

Një fryshtë e tillë pune duhet të përhapet në të gjithë Partinë, me qëllim që komunistët dhe masat të shikojnë më mirë ku kanë qenë të metat dhe si duhet t'i luftojnë ato.

Shoku Manush, i cili do të ketë të bëjë edhe me institucionet kryesore të artit dhe të kulturës, ka një avantazh të mirë, është njeri me kulturë dhe dituri dhe njeh problemet e këtyre sektorëve. Kjo do ta ndihmojë

atë që, kur vjen rasti, edhe Fadil Paçramin¹ ta thërrasë dhe t'i tërheqë veshin fort kur gabon. Kur i thamë Fadilit të shkonte në «Zërin e popullit», nuk deshi, po, kur i thamë të shkonte ministër, menjëherë pranoi. Është skandaloze shokë ajo që po ndodh me Fadilin si ministër i Kulturës dhe i Arteve. Dje mësova se po punohet për të vënë në opera dramën e tij «Shtëpia në bulevard». Si është e mundur ta lejojë një gjë të tillë ministri i Kulturës? Kjo dramë është një vërë në ujë! Si mund të vihet në opera një vepër e tillë që ka bërë Fadili, kur opera nuk janë bërë akoma për trimat që ranë në luftën e madhe për lirinë e atdheut, për mësuesin që ngriti 45 shkolla në Mirditë dhe u vra nga armiqtë, për Skënderbeun etj., etj. Dhe Fadili na lejon të bëhet një opera në mënyrë të poshtër për një vajzë pse paska mbetur me barrë! Kjo është me të vërtetë revoltuese, Prandaj me këta njerëz duhet punuar shumë me kujdes, shoku Manush. Ka rëndësi të madhe një gjë e tillë.

As ju shokët e tjerë që do të shkoni në rrethe mos u kënaqni me atë teatër apo estradë që ekzistojnë, as me atë punë të paktë që bëhet në fushën e kulturës dhe të arteve. Prandaj kërkoni që estradat, teatrot, grupet artistike etj. të gjallërohen, përpinquni të gjeni mjetet dhe mundësitë që ekzistojnë te ne, në mënyrë që jeta në rrethe të bëhet çdo ditë e më e shëndoshë politikisht, që të zhvillohet sa më mirë jeta kulturore, me qëllim që njerëzit jo vetëm të çlodhen, t'u lehtësohet puna, por edhe të edukohen. Kjo ka rëndësi të madhe për jetën dhe për edukimin e punonjësve.

¹ Shih: Enver Hoxha. Vepra, vëll. 30, shënim i 1, f. 124.

Këto këshilla kisha për ju, shokë. Mund të mos i kem thënë mirë, mund të kem ndonjë gjë jo të drejtë, por më duket se, në krahasim me tërë atë punë të gjallë e revolucionare që duhet të bëjë Partia, prapë edhe këto që themi janë të zbehta. Prandaj hidhuni në jetë, punoni e luftoni bashkë me Partinë, me popullin, ndiqni pulsin e tyre, i nxitni njerëzit të gjejnë format e metodat më të përshtatshme për punën që të realizojnë detyrat më së miri.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbali i mbledhjes së Byrosë

Politike të KQ të PPSH

që gjendet në AQP

APARATI I KOMITETIT QENDROR ëSHTË EDHE APARAT STUDIMI

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

10 shkurt 1966

Komiteti Qendror drejton Partinë dhe gjithë jetën e vendit. Ai mblidhet herë pas here dhe merr vendimet e domosdoshme. Ne, sekretarët e Komitetit Qendror, jemi anëtarë të tij, të ngarkuar me disa funksione, por drejtimin e Partisë dhe të jetës së vendit e bën Komiteti Qendror. Çdo anëtar i plenumit të Komitetit Qendror, duke pasur të qartë vijën që merr në mbledhjen e forumit, shkon në krye të detyrës dhe, së bashku me Partinë, që është zemra dhe truri i gjithë jetës së vendit tonë, së bashku me komitetin e Partisë, me punonjësit dhe komunistët, lufton për zbatimin e vijës së Partisë, të përpunuar në kongreset e saj. Pra, në bazë të kompetencave që i ka dhënë Partia dhe duke zbatuar parimin e centralizmit demokratik, anëtari i Komitetit

¹ Në këtë mbledhje u diskutua mbi riorganizimin e aparatit të Komitetit Qendror të PPSH.

Qendror punon e lufton për zbatimin e vendimeve të kongreseve, të parimeve e normave të Partisë dhe të ligjeve të shtetit.

Çështjen e kam, në radhë të parë, që të konceptohet drejt se Komiteti Qendror nuk jemi ne, sekretarët. Në praktikë ka ndodhur që këtë çështje disa shokë nuk e kanë pasur të qartë. Është gabim të mendosh sikur ne, sekretarët që jemi këtu, bëjmë Komitetin Qendror, kurse në të vërtetë këtu ku punojmë ne është vetëm selia dhe aparati i Komitetit Qendror. Një koncept i tillë, pra, të këta shokë duhet ndryshuar krejtësisht, sepse kemi të bëjmë me një çështje parimore.

Komiteti Qendror ka zgjedhur Byronë Politike për të siguruar zbatimin e vendimeve dhe për koordinimin e veprimeve që mund të lindë nevoja të kryhen gjatë intervaleve midis dy mbledhjeve të plenumit. Për këtë qëllim Komiteti Qendror i ka dhënë një sërë kompetencash Byrosë Politike, por pa cenuar kompetencat e veta dhe të anëtarëve të tij. Byroja Politike duhet të mblidhet më shpesh për të shqyrtuar e për të zgjidhur edhe probleme korente që dalin vazhdimisht, për forcimin e mëtejshëm të punës kudo, për të koordinuar punën brenda parimeve dhe normave të Partisë.

Vendimet më të rëndësishme që merr Byroja Politike duhet t'u venë medoemos të gjithë anëtarëve të Komitetit Qendror dhe për to të kërkojmë mendimin e tyre, qoftë përpara, qoftë pas mbledhjes. Këtë duhet ta kuptojmë edhe në parim, ta zbatojmë edhe në praktikë. Mendimi mund të merret edhe pa qenë nevoja për të bërë mbledhje, por nëpërmjet formave që kemi dhe

të tjerave që mund të mendohet se janë të përshtatshme për t'u përdorur. Kjo është e domosdoshme të bëhet.

Po ta kemi të qartë këtë, atëherë për kongresin e ardhshëm¹ do të mendojmë më mirë se në cilat poste kyçë duhet të zënë vend anëtarët e Komitetit Qendror. Këtej lind gjithashtu edhe problemi i zgjedhjes së kandidaturave të ardhshme të Komitetit Qendror. Në këtë forum udhëheqës nuk mund të zgjidhen njerëzit vetëm përfaktin se kanë luftuar ose se kanë disa merita. Për këto merita t'i respektojmë, por në zgjedhjen e kandidaturave të Komitetit Qendror ne duhet të kemi parasysh edhe disa kritere të tjera.

Përveç çështjes së prejardhjes (këtë gjer në njëfarë shkalle ta shikojmë, sepse jemi një vend socialist që prej 20 e ca vjetësh dhe janë bërë ndryshime të mëdha në përbërjen shoqërore të njerëzve), si kriter tjetër të domosdoshëm të kemi perspektivën. Në Komitetin Qendror duhet të sjellim elementë të perspektivës, njerëz që tani përtani mund të mos jenë aq të përgatitur përtu zgjedhur në këtë forum të lartë, por të kenë prirje përtu bërë drejtues të aftë në fusha të ndryshme të jetës politike, ekonomike, kulturore etj., me të cilët ne duhet të punojmë përti përgatitur.

Këto dy kritere kryesore duhet të na udhëheqin, në radhë të parë, për zgjedhjen e kandidatëve përtë plenumin e Komitetit Qendror që do të aprovojë kongresi i ardhshëm. Anëtarët e Komitetit Qendror të jenë shokë me stazh në Parti, njerëz që kanë dhënë prova të

¹ Fjala është për Kongresin e 5-të të PPSH, që zhvilloi punimet më 1-8 nëntor 1966.

mëdha besnikërie, vendosmërie e frysme revolucionare, njerëz me të kaluar të pastër dhe konsekuentë. Të tjetër, të jenë kandidatë për anëtarë të plenumit të Komitetit Qendror, të cilëve mund t'u themi: Ju jeni kandidatë dhe përgatiteni për anëtarë të Komitetit Qendror. Pra, këta shokë është e domosdoshme të jenë në plenum me perspektivë, sepse një pjesë e anëtarëve të plenumit të Komitetit Qendror janë të moshuar, prandaj Partia i përgatit qysh tani kandidatët që do të zënë vendin e tyre në të ardhmen.

Të kemi parasysh gjithashtu edhe shpërndarjen më të mirë, më të studiuar të anëtarëve të Komitetit Qendror. Dihet që në shumë sektorë, në qendër e në bazë, ka shokë nga më të mirët, që janë anëtarë të plenumit të Komitetit Qendror, por a janë shpërndarë ata sipas nevojave? Mos kemi diku më shumë nga ç'duhet e diku më pak? Kjo çështje mendoj se duhet parë me kujdes të madh. Të marrim, për shembull, një ministri. Për sa anëtarë të plenumit kemi nevojë në këtë dikaster? Ta zëmë se kemi nevojë vetëm për 2-3 veta, kurse tani atje ka më shumë. I dimë ne cilat janë zotësitë dhe kapacitetet e tyre? Dakord, atëherë dikush nga ata mund të dërgohet edhe në një sektor tjeter, në bazë, që kështu të kemi një shpërndarje më të mirë të shokëve të plenumit.

Tani që fola ca për plumin e Komitetit Qendror dhe për Byronë Politike, dëshiroj të trajtoj edhe disa çështje që kanë të bëjnë me punën e Sekretariatit të Komitetit Qendror dhe të aparatit. Sekretariati i Komitetit Qendror është një organ i Komitetit Qendror dhe i Byrosë Politike, i ngarkuar për të zbërthyer e për të zba-

tuar vendimet dhe direktivat e Komitetit Qendror e të Byrosë Politike. Ne, sekretarët e Komitetit Qendror nuk mund të japim direktiva jashtë vendimeve të plenumit të Komitetit Qendror e të Byrosë Politike, po brenda këtyre vendimeve. Në këtë kuptim, ne mund të japim direktiva jo vetëm si Sekretariat i Komitetit Qendror, por edhe secili si sekretar, sepse si të tillë edhe ne kemi disa kompetenca. Pastaj, si sekretarë të Komitetit Qendror ne kemi të drejtë që edhe një anëtar të plenumit të Komitetit Qendror, që nuk është në rregull me punën ose për ndonjë çështje tjeter, ta thërrasim, ta këshillojmë dhe ta vëmë në rrugë. Një gjë të tillë ne e kemi bërë dhe do ta bëjmë edhe në të ardhmen, bile duhet ta bëjmë edhe më mirë se gjer tani.

Sekretariati i Komitetit Qendror ka gjithashtu edhe detyrën e ndihmës dhe të kontrollit për zbatimin e vendimeve që marrin plenumi dhe Byroja Politike e Komitetit Qendror dhe, në bazë të drejtimit konkret të punëve, të përgjithësojë eksperiencën. Për ta kryer mirë këtë detyrë është e nevojshme të veprojmë në bazë të disa normave të reja që do t'i përcaktojmë më konkretisht nga sa kanë qenë në të kaluarën. Përveç kësaj, ne kemi edhe të drejtën t'i sugjerojmë Byrosë Politike edhe për probleme që dalin, të cilat duhen shqyrtaur e zgjidhur. Natyrisht, këtë të drejtë e kanë edhe anëtarët e tjerë të Byrosë Politike, pavarësisht se ku punojnë. Pra, përcaktimi i problemeve që duhet të shqyrtohen nga Byroja Politike nuk është vetëm në kompetencatona si Sekretariat i Komitetit Qendror. Nuk mund dhe nuk jemi vetëm ne që i shtrojmë probleme Byrosë

Politike për hartimin e planit të punës, por jemi të gjithë, si Byro Politike.

Pasi caktohen problemet që do të shqyrtojë Byroja Politike, ka rëndësi se kush do të merret me përgatitjen e materialeve që do të paraqiten në Byro. Nuk më duhet me vend që përgatitjen e këtyre materialeve t'i marrim përsipër vetëm ne, si Sekretariat, Sekretarët e Komitetit Qendror, sipas sektorëve që drejtojnë, do të merrin me këtë punë, por duke ngritur komisione ose grupe pune. Në qoftë se Byroja Politike do të marrë në analizë, për shembull, problemin e drithërave, atëherë për studimin e gjendjes dhe për përgatitjen e materialit është mirë të caktohet një komision ose grup pune, s'ka rëndësi si do ta quajmë, i cili të punojë nën drejtimin e sekretarit të Komitetit Qendror që merret me problemet e bujqësisë, ose të ndonjë anëtari të Byrosë Politike, që kujdeset për këtë sektor në rrugën shtetërore, Kur merret një problem që ka të bëjë me arsimin, caktohet një grup pune nën drejtimin e sekretarit përkatës të Komitetit Qendror, e kështu me radhë. Me këtë dua të them se një punë të tillë duhet ta marrë nën drejtimin e vet sekretari përkatës, por ajo mund t'i ngarkohet edhe një anëtari të Byrosë Politike, bile mund të caktohet edhe një anëtar i Komitetit Qendror për të drejtuar komisionin.

Po aparati i Komitetit Qendror ç'rol duhet të luajë? A është ai aparat drejtues? Unë e thashë më parë se drejtojnë Komiteti Qendror dhe Byroja Politike. Aparati i Komitetit Qendror është në ndihmë të Byrosë Politike dhe të Komitetit Qendror. Ai ka për detyrë të kontrollojë zbatimin e vendimeve dhe të ruajë të pastër vijën e

drejtë të Partisë, ka për detyrë të ndihmojë e të kontrollojë bazën dhe të përgjithësojë eksperiencën e saj. Puna e tij është një punë operative partie, por ajo duhet të jetë e një niveli të lartë, me përgjithësimë e konkluzione, që janë në interes të Partisë. Në këtë vështrim, aparat i Komitetit Qendror është edhe aparat studimi. Ne duhet të merremi më mirë me disa sektorë të aparatit, si, për shembull, me Institutin e Studimeve Marksiste-Leniniste e me arkivin, që kanë një karakter të veçantë, janë sektorë studimorë. Në ndonjërin prej tyre ia vlen të vësh në krye edhe një anëtar të Komitetit Qendror. Por me studime duhet të merren patjetër edhe sektorët e tjera të aparatit.

Duke u nisur nga roli që luan e që duhet të luajë aparat i Komitetit Qendror, del nevoja për të rishikuar edhe strukturën e tij, për të bërë një organizim më të mirë të aparatit dhe për t'i zgjedhur më me kujdes njerëzit që do të punojnë këtu. Mendoj se punonjësit e aparatave të Partisë, sidomos të aparatit të Komitetit Qendror, duhet të janë kuadro me kapacitet, të tillë që të mund të kuptojnë përse kanë nevojë Byroja Politike dhe Sekretariati i Komitetit Qendror, cilat janë kërkesat e tyre dhe problemet që i preokupojnë, të kontrollojnë ruajtjen e pastërtisë së vijës, zbatimin në jetë dhe drejt të vendimeve, të punojnë me kuadrin, të janë në gjendje të japid ndihmë konkrete në vend dhe të bëjnë përgjithësimë për vete dhe për udhëheqjen. Këta duhet të janë njerëz me një horizont të përgjithshëm, të tillë që, kur të venë në bazë për të kontrolluar zbatimin e vendimeve dhe ruajtjen e pastërtisë së vijës së Partisë, ta zëmë në lëmin e bujqësisë, natyrisht duhet të marrin

vesh edhe nga bujqësia, por, në radhë të parë, nga ata kërkohet të kuptojnë thellë politikën e Partisë për bujqësinë. Jeta, normat, disiplina dhe mbledhjet e organizatave të Partisë në sektorin e bujqësisë janë të lidhura dhe kanë kuptim vetëm kur të gjitha këto ndihmojnë në zbatimin e plotë të vijës dhe të vendimeve të Partisë për këtë sektor. Instruktori i aparatit të Komitetit Qendror nuk duhet të preokupohet vetëm nëse u mbollën apo jo patatet ose fidanët, por, në radhë të parë, të shikojë anën politike të këtij problemi që nuk na shkon mirë në këtë apo në atë rreth. Ai, kur të vejë në bazë, do të këshillohet me njerëzit, me punëtorët, me fshatarët, me sekretarët e organizatave të Partisë dhe pastaj do të kthehet t'i raportojë sekretarit të Komitetit Qendror si qëndron puna dhe do të propozojë masat që duhen marrë për ta forcuar atë.

Vajtja jonë rregullisht në bazë ka rëndësi, po këtë punë nuk e kishim të organizuar mirë. Instruktorët e aparatit të Komitetit Qendror duhet të shkonin muaj për muaj në zonat e tyre të caktuara, mirëpo eksperienca ka treguar se një punë e tillë si kjo nuk është aq e frytshme, sepse është mirë që instruktori të njohë jo një zonë, por, mundësish, të tëra krahanat. Tani ne do të vemi më shumë në bazë, por nuk është e domosdoshme, më duket mua, të shkojmë kudo. Ne do të vemi për disa çështje të caktuara dhe atje ku është nevoja, atje ku duhet, ku konstatojmë se vërtetohen dobësi, të cilat duhet t'i zhdukim, ose atje ku ka një eksperiencë të mirë, që duhet ta përgjithësojmë. Është e drejtë që vajtja jonë në bazë të përcaktohet nga gjendja konkrete e organizatës së Partisë në një rreth. Një kuadër i aparatit duhet të shkojë

në Tropojë, për shembull, për të zgjidhur këtë ose atë problem që ka rëndësi të madhe dhe të qëndrojë atje ditë me radhë, por, që të vejë me këtë rast edhe në Pukë, edhe në Shkodër, ku problemi që ka lindur në Tropojë nuk na del, nuk ka nevojë. Pra di pse vete dhe si vete në bazë. Këta njerëz që do të kemi në aparatin e Komitetit Qendror do të na ushqejnë ne me të dhëna nga baza, ashtu sikurse edhe ne do t'i ushqejmë ata, do t'i ndihmojmë vazhdimisht që ta bëjnë punën mirë.

Në aparatin e Komitetit Qendror ne duhet të kemi aq instruktorë sa e kërkojnë nevojat e punës. Me organizimin e ri të aparatit, këtu mund të mbajmë përsëri disa specialistë, por detyra e tyre duhet kuptuar më gjërë e më thellë nga ç'është kuptuar deri tani. Specialisti i një fushe që do të punojë në aparatin e Komitetit Qendror duhet të jetë, në radhë të parë, punëtor partie. Instruktorët e Komitetit Qendror të janë njerëz me karakteristikat e Partisë, të kenë një përgatitje të gjithanshme dhe çështjet t'i shohin politikisht. Edhe në qoftë se instruktorit të specializuar për një profil të veçantë i del përpara një çështje që nuk i takon atij, ai duhet të jetë në gjendje të mbajë qëndrim e të japë mendime të drejta. Në këto kushte secili prej tyre mund të ndihmojë edhe sektorët e tjera. Instruktorëve të Komitetit Qendror, për shembull, mund t'u themi që roli dhe detyrat tuaja nuk janë të veçanta, por të përgjithshme. Secili prej tyre do të interesohet edhe për bujqësinë, edhe për problemet e Partisë, për Statutin, për financën, për ndërtimet, transportin etj., etj., me një fjalë, u bie të interesohen për të gjitha. Prandaj ata duhet të janë punëtorë partie të gjithanshëm. Instruktori

i Komitetit Qendror nuk duhet të vejë në bazë me mendimin që mund të ketë shkuar gjer tanë si specialist, as me pikëpamjen e gabuar se «pa mua nuk bëhet puna», se «unë jam në gjendje t'u jap këshilla edhe komitetit të Partisë, edhe sekretarit të tij» etj.

Mendoj se nuk duhet t'i qëndrojmë skllav organizimit të vjetër të punës në aparat. Sikur t'i diskutojmë e t'i rrahim mirë mendimet mbi këto çështje, sepse mbasi t'i sqarojmë këto, atëherë do të bëhet puna më e lehtë. Të fillojmö, në radhë të parë, nga struktura. Ç'duhet të heqim, ç'duhet të lëmë dhe si ta organizojmö punën më mirë? Mund të shikohet çështja e drejtorive në aparatin e Komitetit Qendror. Kështu do t'i kemi përsëri? Natyrisht, këtë duhet ta diskutojmë. Të marrim Drejtorinë e Organizimit, ku bëjnë pjesë edhe një sektor për kuadrin dhe një sektor tjetër për problemet e Statutit. Do t'i kemi këta sektore të gjithë së.bashku në një drejtori, pra do t'i futim në një hallkë, apo do të kemi sektorë më vete për kuadrin dhe Statutin? Pavarësisht se si do të vendoset, ne duhet të mendojmë për të përcaktuar mirë detyrat e tyre. Tani kërkohet që në sektorin e kuadrit ta përqendrojmë tërë punën me kuadrin e nomenklaturës që i përket Komitetit Qendror. Sektori i Statutit duhet të merret vetëm me problemet që lidhen me Statutin, si me pranimet e reja në Parti etj.

Problemeve të disiplinës së Partisë dhe të Statutit duhet t'u kushtojmö një kujdes më të madh, sepse këto, sipas mendimit tim, nuk janë parë si duhet. Shokët që do të punojnë në sektorin e Statutit të janë të kualifikuar. Një pjesë të kohës ata duhet të qëndrojnë në

aparat, jo vetëm për t'i arkivuar statistikat e materialet që do të vijnë nga baza, por për t'i studiuar dhe për të nxjerrë prej tyre problemet që preokupojnë Partinë dhe këto t'ia paraqesin Sekretariatit për t'i diskutuar e për të marrë masa. Kur të jetë rasti, ata do të shkojnë edhe në bazë për të ndjekur problemet e Statutit. Atje do të shkojnë edhe disiplinën, edhe ndërgjegjen e komunistëve etj., se këto janë probleme të rëndësishme partie.

Punonjësit e këtij sektori e kanë për detyrë të shkojnë zbatimin e orientimeve të Byrosë Politike për çështjen e pranimeve. Nëpërmjet statistikave që kanë në dorë ata konstatojnë, për shembull, se Komiteti i Partisë i Rrethit të Beratit nuk po i zbaton drejt orientimet e Byrosë Politike për përqindjen e pranimeve në Parti. Atëherë ata e studiojnë si qëndron puna. Kjo është e domosdoshme të bëhet dhe jo t'i thonë në mënyrë mekanike komitetit të Partisë se ju nuk po e zbatoni drejt orientimin, sepse Berati, fjala vjen, duke qenë rreth bujqësor, nuk ka punëtorë në atë masë sa të pranojë në përqindjen e parashikuar. Këtë problem punonjësit e Statutit në Komitetin Qendror le ta studiojnë bashkë me shokët e rrethit dhe të shkojnë nëse ka apo nuk ka mundësi të pranohen aq punëtorë sa parashikon orientimi i Byrosë Politike të Komitetit Qendror. Ata të shkojnë pastaj edhe stazhin në punë të punëtorëve, që në fakt kanë ardhur nga fshati, sepse nga kjo mund të nxjerrin konkluzione me rëndësi etj., etj. Ose në qoftë se konstatojnë që në ushtri ka dënimë, ata duhet të kërkojnë të dinë pse ndodh kështu, mos vallë nuk bëhet një punë e mirë politike etj.

Me këtë dua të them se instruktori i sektorit të

Statutit duhet të merret me studime të kësaj natyre e jo vetëm me kartotekën. Sektori i Statutit, si një sektor i specializuar, pa dyshim do të punojë që dokumentacionin ta ketë në rregull, por të mos lërë mënjanë studimet që duhet të bëjë për probleme të caktuara.

Edhe në kartotekat, më duket mua, ka një mori çështjesh që kanë marrë një rutinë prej 20 vjetësh. Ekspieriencën e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik për kartotekat ne e kemi adoptuar pa e përpunuuar si duhet për kushtet tona. Nganjëherë kemi pyetur: «Ç'bëhet me kartotekat?», por, në fakt, akoma nuk kemi një punë të kualifikuar në to. Vallë, janë kapabël sot ata shokë që i kemi caktuar për këtë punë me kaq rëndësi? Në qoftë se ata nuk e bëjnë dot, atëherë është më mirë si për ata vetë, ashtu dhe për Partinë që të shkojnë në një punë tjetër dhe këtu të sjellim njerëz që të jenë me të vërtetë në gjendje të nxjerrin konkluzione, ndryshe nuk ndihmohet Partia. Sekretariati dhe Byroja Politike duhet ta shkojnë seriozisht këtë çështje. Tani ne kemi kënaqësinë se në kartoteka janë vënë njerëz të ndershëm, por kjo nuk mjafton për punën. Ata kanë shumë dokumente në duar, nga të cilat duhet të nxjerrin konkluzione.

Punonjësit e aparatit të Komitetit Qendror duhet të jenë edhe njerëz të aftë, me kapacitet. Më kanë thënë për një shok se është nga punëtorët më të mirë të Drezitorisë së Organizimit, por unë nuk e kam dëgjuar atë ndonjëherë të ngrejë ndonjë problem të rëndësishëm. Ai merr vazhdimisht materiale të shumta që vijnë për sektorin e tij nga komitetet e Partisë të rretheve; por asnjëherë nuk ka gjetur rastin, as ka marrë iniciativën të vijë, për shembull, edhe tek unë si Sekretar i Parë dhe

të më thotë: «Shoku Enver, ne kemi një situatë të tillë në Parti».

Ne kemi pasë vendosur një sërë kriteresh në aparat për zgjedhjen e kuadrove, natyrisht, kritere të shëndosha, por jo të mjaftueshme. Ne nuk kemi shikuar si duhet edhe anën e aftësive për detyrën që i kemi ngarkuar çdo kuadri. Kjo është gjithashtu një tjetër kërkesë e domosdoshme për kuadrin që do të punojë në aparatin e Komitetit Qendror. Duke mos e pasur parasysh në atë shkallë që duhet këtë kërkesë, disa nga ata që kanë punuar këtu, nuk na e kanë bërë si duhet punën. Për këtë ne mund të bëjmë autokritikë, fajin e kemi edhe vetë, por ama nuk duhen lënë kështu këto gjëra.

Duhet parë mirë gjithashtu nëse është e domosdoshme të kemi Drejtori të Agjizacionit e të Propagandës dhe Drejtori të Arsimit e të Kulturës. Edhe në këto mendoj se duhet të bëjmë ndryshime, prandaj të reflektojmë më mirë. Mund të mos i mbajmë si drejtori, por të ketë instruktorë sektori, disa prej të cilëve do të ndjeatin problemet e Partisë në fushën e arsimit dhe të kulturës, kurse disa do të jenë për problemet e agjizacionit dhe të propagandës së Partisë.

Një kujdes të veçantë duhet t'i kushtojmë gazetës «Zëri i popullit», si organ i Komitetit Qendror, të cilin duhet ta bëjmë medoemos një organ të vërtetë luftarak, me qëllim që ai të na lehtësojë punën. Organi i Komitetit Qendror duhet të japë direktiva. Unë mendoj që t'u themi komiteteve të Partisë dhe komiteteve ekzekutive të rretheve se kryeartikujt e «Zërit të popullit» përmbyjnë direktivat e udhëheqjes së Partisë, prandaj gjithçka që do të shkruhet në ta, duhet të zbatohet jo vetëm

nga ai për të cilin flitet atje, por për analogji të atyre që shkruhen, duhet të merren masa edhe nga të gjithë të tjerët.

Ç'ngjet tani? Kryeartikujt e «Zërit të popullit» nga shumë njerëz lexohen si «gazetë», si lajme të thjeshta, por ne duam që ata të studiohen e të nxirren mësimë prej tyre. Kur t'u themi shokëve të rretheve që nuk është çështja vetëm për ta lexuar kryeartikullin, por që direktivat që jepen atje të zbatohen, se janë direktiva të Komitetit Qendror, gazeta paskëtaj do të shihet me një sy tjetër. Artikujt duhet të jenë mobilizues, të kenë argumente e ballafaqime, ta ngacmognë mendimin e lexuesit. Do të fli-tet, për shembull, për mbjelljen e patateve? Shumë mirë! Në qoftë se në artikull do të thuhet se drejtori i një ndërmarrjeje bujqësore u shkarkua nga detyra si drejtor dhe u bë punëtor i thjeshtë ngaqë nuk zbatoi detyrën e caktuar për të hapur tokë të re e për të mbjellë patate dhe nuk kishte mbjellë as sipërfaqen ekzistuese, atëherë të shikosh që kjo do të bëjë shumë efekt në gjithë të tjerët. Ata do t'i mbledhin këmbët njëçikë më mirë dhe punën do ta bëjnë si duhet. Ose në qoftë se sekretari i parë i komitetit të Partisë të një rrethi do ta nën-vleftësojë një propozim me rëndësi që bën një inxhinier, atëherë Komiteti Qendror që e sheh se ndërmarrja e transportit ku punon ky inxhinier është bërë problem ngaqë nuk po realizon detyrat, mund të porositë të bëhet një artikull kritik në gazeten «Zëri i popullit», ku të kritikohet edhe sekretari i parë, që nuk ka zbatuar orientimet e dhëna nga Partia për të térhequr mendimin krijues të masave e të specialistëve. Në qoftë se do t'i kritikojmë hapur ata që nuk i kryejnë detyrat, do të

shohim pastaj se me ç'interesim të madh do të lexohet «Zëri i popullit», sepse të gjithë do të shikojnë që ai transmeton direktivat e rëndësishme të udhëheqjes së Partisë. Pra, gjersa kemi «Zërin e popullit», mendoj se ky organ kryen një pjesë të punës që bën Drejtoria e Agjencionit dhe e Propagandës, kështu që mund të mos jetë e nevojshme ta mbajmë më këtë si drejtori. Komiteti Qendror për këto punë ka organin e vet, «Zërin e popullit», ka «Bashkimin» dhe të gjitha organet e tjera të shtypit, që janë gjithashtu organe të Partisë.

«Zëri i popullit», duke vepruar siç thashë, do të marrë një rëndësi të jashtëzakonshme për Partinë. Natyrisht, artikuj të rëndësishëm direktivë mund të shkruajmë edhe ne, sekretarët e Komitetit Qendror, por ajo që ka rëndësi është të kemi njerëz, të cilët jo vetëm të dinë të shkruajnë, po të janë të atij niveli që, kur të bisedojnë me ne, të na bëjnë sugjerime rreth problemeve që duhet të ngrihen në shtyp në formën e artikujve direktivë dhe për masat që duhet të merren, të na shfajqin mendime dhe pastaj t'i vihen punës për t'i shkruar ata, sipas porosive që u kemi dhënë. Idetë kryesore që përmban artikulli duhet të zbatohen medoemos nga sektorët përkatës. Këtë funksion të veçantë për kryeartikujt dhe artikujt e rëndësishëm të «Zërit të popullit», për dhënie orientimesh, për vijën, për udhëzime apo për kontroll, për masa ndëshkimore e për kritika, duhet ta kemi të organizuar mirë, si ne në Komitetin Qendror, ashtu edhe Qeveria.

Tani vjen çështja që u propozua këtu, të ketë një sektor edhe për shtypin. Ky sektor është i nevojshëm, ai do të merret me përgjithësimin e eksperiencës së

Partisë nëpërmjet shtypit, do të transmetojë udhëzimet e veçanta të Sekretariatit, do të merret me kontrollin e zbatimit të tyre etj. Sektori i shtypit do të formulojë materialet për kryeartikujt më të rëndësishëm dhe, pasi t'i shikojë sekretari përkatës i Komitetit Qendror, do t'i jepen shtypit për botim. Ky sektor duhet të konkretizojë mirë drejtimin e të gjitha organeve të shtypit, prandaj atij t'i japim kompetenca për këtë qëllim. Kemi pastaj edhe grupin e studimit që, në kushtet e sotme, do të merret me hartimin e artikujve kryesorë të politikës sonë të jashtme etj. Ky duhet të jetë një grup, të cilit do t'i përcaktojmë disa detyra të veçanta për të ndihmuar në përpunimin e materialeve politike e ideologjike. Ne këtu duhet të formulojmë medoemos orientimin e luftës sonë kundër revizionizmit modern, sepse me këtë punë njëkohësisht edukojmë edhe masat-tona, informojmë edhe botën e jashtme.

Që të shkojnë mirë agitacioni dhe propaganda duhet të ndryshohen edhe metoda e koncepti i punës dhe i përgjegjësisë në të gjitha hallkat. Kur flasim për këtë problem të mos mendojmë se kyçi është këtu në Drejtorenë e Agitacionit e të Propagandës. Jo, kyçi është në të tëra hallkat, sepse është krijuar një situatë që të gjithë presin nga ne, pyesin edhe për gjënë më të vogël, sikur të ishim 15 vjet përpara, kurse tani po shkojnë në bazë me qindra kuadro të aftë për t'u dhënë rrugë-zgjidhje problemeve.

Me problemin e arsimit në Parti gjer tani merrej edhe Drejtoria e Organizimit, edhe Drejtoria e Agitacionit dhe e Propagandës. Drejtoria e Organizimit, për shembull, propozonte sa veta duhej të dërgoheshin në

Shkollën e Partisë dhe ne e aprovonim këtë në Byronë Politike ose në Sekretariat, por si zgjidhen këta njerëz? Ja, për shembull, unë di që një infermier është lejuar dhe ndjek Shkollën e Lartë të Partisë. Për atë vetë dhe për punën që ka është më mirë që ky të lejohet të ndjekë fakultetin e mjekësisë, bile edhe për këtë në qoftë se duhet, por jo Shkollën e Partisë. Kurse Drejtoria e Agjitacionit dhe e Propagandës ndjek zbatimin e programit të arsimit në Parti.

Pra, mendoj, se duhet diskutuar si çështja e Drejtorisë së Agjitacionit dhe të Propagandës, ashtu edhe e drejtorive të tjera. Të gjykojmë me kujdes nëse duhet t'i kemi ose jo këto drejtori. Qëllimi është të shikojmë si mund të na bëhet puna më mirë. Në qoftë se duam të nxjerrim punë të cilësisë së mirë, të mos jemi të lidhur me shumë hallka. Po ta mbajmë si hallkë drejtorinë, kjo do të thotë që punën ta lëmë në dorë të një drejtori dhe sekretari i Komitetit Qendror të mbajë lidhje jo me instruktorin, por me drejtorin. Atëherë puna mbetet njëlloj ajo që ishte. Mendoj ta organizojmë ndryshe punën dhe instruktorët, sipas rastit, mund të lidhen edhe drejtpërdrejt me sekretarët e Komitetit Qendror. Kjo do të varet nga karakteri i punës që kanë, por për këtë nuk duhet të bëhen pengesë hallkat, ato nuk duhet të na lidhin duart. Mbase e kam gabim, ta shikojmë mirë bashkërisht, ta diskutojmë dhe të bëjmë propozimet. Për organizimin e ri të punës në aparat ne të gjykojmë duke u nisur nga mendimi se aparatet janë në ndihmë të udhëheqjes, kurse Partia në bazë është kryesorja, forumet, komitetet e Partisë kanë rëndësi të madhe.

Sido që të vendosim, edhe sikur të kemi, edhe sikur të mos kemi drejtori, sipas mendimit tim, vihet problemi që sekretarët e Komitetit Qendror duhet të kenë edhe ndihmës, të cilët të jenë të një niveli të lartë.

Forma e re e organizimit të punës që propozoj unë, mendoj se e zgjidh çështjen e mungesës së koordinimit të veprimeve në aparat, por ne duhet të përpinqemi të gjejmë njerëz të aftë që t'u përgjigjen kësaj fryme, këtij organizimi dhe funksioneve që do të ketë secili.

Këtu u ngrit edhe çështja e organizatave të masave, me kë do t'i mbajnë ato lidhjet. Deri tani organizatat e masave i kanë mbajtur lidhjet vetëm me Drejtorinë e Organizimit, por ne e kemi parë që një praktikë e tillë nuk ka dhënë fryte. Ato janë organizata politike, prandaj, si të tilla, mbase do të ishte mirë të lidheshin me sektorin e Propagandës e të Agjuracionit, që ka problemet politike e ideologjike, por kjo nuk do të thotë që organizatat e masave të mos lidhen me sektorët e tjerë të aparatit, për shembull, për çështjet e kuadrit duhet të lidhen me sektorin e kuadrit e kështu me radhë. Është e rëndësishme që midis këtyre organizatave të bëhet koordinimi i punëve. Ky koordinim e ka vedin të bëhet këtu, në aparatin e Komitetit Qendror, por duhet pasur kujdes se si do ta bëjmë atë që të mos ndodhin përplasje. Për të gjitha këto organizata duhet të tregohet një interesim i veçantë, sidomos për rininë. Organizata e rinisë, siç thuhet edhe në statut, është ndihmëse besnikë dhe rezervë luftarake e Partisë dhe drejtobet nga Partia. Sigurisht, edhe organizatat e tjera drejtohen nga Partia. Këtu del nevoja të kemi një njeri që t'i ndjekë problemet e organizatave të masave. Ai

do të diskutojë me to, do t'i ndihmojë e do t'i udhëzojë. Ky duhet të jetë një kuadër i përgatitur, i cili do të ketë mjaft punë. Kjo nuk përjashton që, kur ndonjëri nga përgjegjësit e organizatave të masave të ketë probleme të rëndësishme për të shtruar, ai mund të takohet edhe me ndonjë nga ne, sekretarët e Komitetit Qendror se, përveç punëve korente, do të ketë patjetër edhe probleme të veçanta të rëndësishme.

Si konkluzion duhet thënë se aparatet e Partisë kanë rëndësinë dhe rolin e tyre të madh, por ato duhen kuptuar gjithmonë vetëm si apirate në ndihmë të formeve udhëheqëse të Partisë. E theksoj, ajo që udhëheq është Partia. Të gjithë jemi të interesuar që ky rol udhëheqës i saj të vijë duke u rritur e duke u forcuar vazhdimisht dhe për këtë po punojmë e po luftojmë, për këtë po japim të tëra energjitet tona.

Këto ishin disa çështje që mendova të shtroj në këtë mbledhje të Sekretariatit. Nuk e di, ç'thoni ju, shokë, për këto mendime? Unë i shpreha ato ashtu si i mendoj, tani t'i diskutojmë. Ju, shokë, i njihni më mirë çështjet për të cilat diskutuam, sepse jeni të lidhur vazhdimisht më shumë se unë me këto probleme, prandaj mund të flitni duke u bazuar edhe në eksperiencën e madhe që keni. Së bashku do të gjykojmë më drejt mbi to.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

HARTIMI I ORGANIKAVE TË REJA KËRKON KUJDES, THELLIM E PJEKURI

Shënimë

13 shkurt 1966

Për hartimin e organikave të reja duhet të tregohet kujdes, thellim e pjekuri, sepse kjo nuk është një punë e lehtë. Për këtë të mbështetemi në fryshtë dhe në kuptimin e drejtë revolucionar, në eksperiencën e njerëzve që e kanë fituar duke punuar dhe duke drejtuar konkretisht, në vëllimin e punës që duhet kryer me stilin dhe me metodën e re të drejtimit.

Do të jetë gabim në qoftë se priremi vetëm nga mendimi: «Oburra të shkurtojmë sa më shumë!». Të shkurtojmë ato hallka dhe aq njerëz sa duhet, ata që pengojnë, që rëndojnë aparatet, që krijojnë burokracinë. Populli na mëson: «Jo shumë e për lumë, por pak e saktë». Kjo fjalë e urtë duhet të na udhëheqë në këtë çështje. Natyrisht me zigare nuk mund të peshohen këto gjëra. Diku mund të na mbeten disa njerëz më shumë, por kjo nuk prish punë në këtë periudhë të parë që po kalojmë nga një stil e metodë pune jo aq e shëndoshë, në një stil e metodë pune më revolucionare. Të kemi parasysh se dikastereve u duhet njëfarë

kohe që të të ambientohen me këtë stil e metodë pune të re. Veçse të mos shkohet me mendimin se ata që shkurtohen sot do të shtohen mot, siç ka vepruar më parë ndonjë dikaster, por të synohet që, pas një periudhe prove dhe pasi të fitohet eksperiencë, të shkojmë drejt stabilizimit të gjendjes.

Të gjithë shokët duhet t'i kenë parasysh mirë problemet që do të dalin nga zbatimi i kësaj mase që po merr Partia në luftën kundër burokratizmit, sepse është lehtë të bëhet shkurtimi i organikave, por kjo gjë duhet të çojë patjetër në përmirësimin e punës drejtuese. Po të punohet me metodën dhe stilin e vjetër të drejtimit, duke u marrë me cikërrima, atëherë ca më keq, kuadrot do t'i mbulojë rutina, nuk do të dinë ku kanë kokën, do të fillojnë të japid urdhra mbi urdhra, do të përpilen të shfajësohen duke ua hedhur fajin të tjerëve, do t'u ngjallet nostalgja e vjetër e punës me shumë vartës dhe do të fillojnë të kërkojnë prapë shtesë organike etj. Ky është një moment shumë delikat, i cili mund të krijojë një gjendje humtimi te disa kuadro, prandaj duhet ta mbajmë parasysh. Këtyre ne t'u qëndrojmë afër, por për këtë nuk mjafton t'u themi: «Ti i ke të gjitha kompetencat, vepro!». Ai do të veprojë, por kërkon ndihmë të kualifikuar nga ne, prandaj vjen dhe përpjek kokën. Shumë vështirësi e pengesa do të dalin në punë. Ato nuk zgjidhen me «frymën e shenjtë» as duke thënë: «Zbato kompetencat!». Rruga që po ndjek Partia në luftën kundër burokratizmit është e drejtë, revolucionare, por jo lisho, jo e shtruar me lule, prandaj askujt nuk i lejohet të bjerë në vetëkënaqësi, të mendojë se atë e

përcaktuam tash në vija të përgjithshme dhe të flemë se puna do të ecë vetë.

Prandaj na vihet detyrë të caktojmë organika sa më të studiuara, të zgjedhim njerëz të kualifikuar, që ta marrin si duhet shpejt e drejt në dorë situatën dhe t'i ndihmojmë, t'i ndihmojmë vazhdimisht kuadrot. Kjo ndihmë duhet të kuptohet në gjithë gamën, në gjithë piramidën. Të gjithë dhe në çdo kohë duhet të kryejmë detyrat mirë, të mësojmë të tjerët me shembullin e mirë tonin, t'u hapim horizonte ndihmësve në çdo shkallë, të bëjmë një punë të pjekur, zinxhir, dhe të mos lëmë të dobësohet, të ndryshket ose të këputet asnje hallkë e zinxhirit.

Botohet për herë të parë si pas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

NE KEMI NEVOJË PËR NJË PROPAGANDË TË KUPTUESHME, MOBILIZUESE, REVOLUCIONARE

Shënimë

15 shkurt 1966

Besoj se duhen rishikuar edhe përbajtja, edhe format e propagandës dhe të agjitacionit, që kemi përdorur deri tash, pse nuk i përgjigjen plotësisht frysë revolucionare të kohës. Përveç atyre që shtrova më parë në Byronë Politike edhe për Shkollën e Partisë, e cila duhet të përpinqet të bëjë një punë me përbajtje më të shëndoshë dhe me forma më të përshtatshme e revolucionare, duhen studiuar dhe korriguar njëkohësisht propaganda dhe agjitacioni konkret në bazë, në format e ndryshme që i përdor ata Partia.

Metoda dhe stili i deritanishëm i punës, në këtë çështje, nuk duhen konsideruar sikur kanë qenë pa rezultat. Në asnjë mënyrë! Ata kanë ndihmuar pa masë Partinë dhe popullin në sqarimin politik dhe ideologjik të gjërave, por, në qoftë se metoda dhe stili në punë do të ishin më të përpunuar e më të thjeshtë, do të jepnin rezultate më të efektshme.

Në Shkollën e Partisë ne dërgojmë me qindra kuadro partie në vit, të cilët i shkëputim nga baza, nga

jeta, nga lufta e përditshme. Këta kuadro kanë përfitimin e madh se e mësojnë teorinë në mënyrë të organizuar, me baza shkencore, por kanë edhe humbje, për arsyen se mbyllen në shkollë vetëm me librat. Për vajtjen në bazë, sipas programit që ka shkolla dhe ashtu siç bëhet, ka formalizëm. Pra del nevoja e risikimit të programit në këtë drejtim.

Leksionet që jepen atje, siç e thashë edhe në Byro, vuajnë nga dogmatizmi, kanë formulime teorike që nuk lidhen sa duhet me luftën dhe me jetën e përditshme. Ky është një minus tjetër i madh, sepse nxënësi merr nga shkolla njohuri të njëanshme. Ato që mëson janë të drejta, do ta ndihmojnë patjetër në jetë, siç e kanë ndihmuar, por nuk janë të plota. Ky bagazh, si me thënë, ka marrë më tepër vulën teorike dhe nuk është i lidhur ngushtë me jetën dhe me luftën e Partisë dhe të popullit.

Pra, kur shokët mbarojnë shkollën dhe shkojnë në punë, janë si të hutuar, si të shkëputur ngajeta që i rrethon. Ata bëjnë përpjekje që këtë shkëputje ta mundin me formulat që kanë mësuar, me argumente të formuluar, që janë tipike në punën e një intelektuali. Kjo është një anë negative që u ka dhënë ton dhe formë jo të drejtë punës së agjizacionit e të propagandës në bazë, leksioneve dhe, në përgjithësi, punës në kabinetet e Partisë.

Ndodhemi, pra, përpara këtij fakti: disa kuadro ose lektorë nuk u flasin masave të punonjësve me një gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme, nuk u sjellin shembuj të gjallë nga jetë, të cilët kanë filozofinë, politikën dhe ideologjinë e tyre e që përbëjnë kuintesencën

e atyre që kanë mësuar në Shkollën e Partisë, por u flasin me formula, që janë kthyer në sloganë të pakuptueshme për punonjësit dhe shumë herë të mërzitshme!

Ndodh që tjetri nuk e kuption leksionin që bëhet për humanizmin socialist, por në jetë dhe në luftën e përditshme ai e vë në zbatim atë më së miri. Kurse po të mbështetet propaganda në jetën, në luftën, në veprimtarinë e masave dhe këto të janë baza e saj, atëherë argumentimet teorike, të ilustruara me shembuj ngajeta, do të janë të kuptueshme. Çdo njeri, në qoftë se e pyet: «Ç'do të thotë të jesh i sjellshëm dhe çfarë virtytesh duhet të ketë njeriu i sjellshëm?», do të të përgjigjet drejt, do të dënojë lëmoshën borgjeze, paqen borgjeze, hipokrizinë borgjeze. Por kur ti i flet plot me formulime të errëta filozofike për humanizmin socialist ose për humanizmin borgjez, ai jo vetëm nuk të kuption, por me këtë mënyrë i ke humbur kohën vetes dhe atij.

Shokët tanë, që merren me këtë sektor, kanë adoptuar një metodë dhe stil të gabuar pune, ata kanë krijuar një rutinë, kanë formuluar disa leksione të përgjithshme që i përdorin në çdo kohë dhc në çdo vend, por që janë pa shpirt, pasi nuk ecin krahas as me luftën, as me kohën, as me ndodhitë konkrete të jetës së rrethit apo të qendrës së punës, për të cilat destinohen. Ata kanë gjetur rehat dhe ne ua kemi ushqyer këtë tendencë, duke ua përgatitur këto leksione nga lart, s'ka dyshim, nga zyrat dhe nga zyrtarë anemikë, të mbetur mbi libra dhe mbi formula të radhitura. Për këta shokë s'kanë vlerë mendimet e thjeshta, plot

kuptim dhe perspektivë të masës së punonjësve, por vëtëm formulat stereotipe. Këtë metodë duhet ta braktisim sa më parë, ndryshe nuk do të zbatohen si duhet detyrat.

Kur themi që politika dhe ideologjia duhet të dominojnë, se çdo gjë ka politikën dhe ideologjinë e saj, ne, me një propagandë luftarake dhe të zhđervjellët, duhet ta bëjmë njeriun të mendojë, të gjykojë, të shohë anën politike dhe ideologjike të sendeve. Prandaj propaganda dhe agjitacioni i Partisë nuk duhet të jenë të përciptë e me disa formula stereotipe, nuk duhet të jenë naivë e të fjetur, por të jenë të kuptueshëm për popullin, të jenë të gjallë, ata duhet të jenë mobilizues, revolucionarë.

Duhet të reflektojmë thellë për këtë çështje dhe të marrim masat për një kthesë rrënjosore.

*Botohet për herë të parë si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

MENDIMI PËR EKZISTENCËN E INSTITUTIT TË FOLKLORIT ËSHTË I DREJTË

Letër drejtuar shokut Zihni Sako

17 shkurt 1966

I dashur shoku Zihni,

E mora letrën tënde ditën që ishe nisur për në Gjirokastër, më 16 shkurt. Unë e kuptoj shqetësimin që ke për fjalët që qarkullojnë mbi ndarjen më dysh të Institutit të Folklorit, në sektorin muzikor, pranë Ministrisë së Kulturës dhe të Arteve dhe në sektorin e folklorit gojor, pranë Institutit të Historisë e të Gjuhësisë.

Mendimet që kanë shfaqur disa shokë për këtë ndarje janë mendimet e tyre personale. Natyrisht, për të mirën e punës, secili ka të drejtë të mendojë e të bëjë propozime. Kjo, përveç së mirës, nuk ka asgjë të keqe.

Për këtë çështje kam të njëtin mendim me ty, prandaj, po të vijë puna që të diskutohet për të, unë do ta mbroj atë, sepse kam bindjen, që ky mendim për ekzistencën e Institutit të Folklorit është i drejtë.

Unë u gëzova shumë që, si shkrimtar komunist, bashkë me shumë shokë të tjera shkrimtarë, edhe ti iu përgjigje menjëherë thirrjes së Partisë për të punuar e për të jetuar në gjirin e atij populli, ku kemi lindur e kemi kaluar periudhën më të bukur të jetës, moshën e rinisë sonë të parë. Të them të drejtën, pa qenë lokalist, të kam zili për atë që bëre, sepse, sa më tepër kalon mosha, aq më shumë më merr malli, më ndizet dashuria e thellë, në radhë të parë, për gjithë njerëzit e vendlindjes, për shokët e miqtë e mi, po njëkohësisht edhe për qytetin, për rrugët e deri për gurët e Gjirokastrës, vetëm se detyra që më ka ngarkuar Partia, nuk ma lejon edhe mua ta realizoj një dëshirë të tillë. Unë të përgëzoj, i dashur shoku Zihni, për vendimin që more dhe të uroj me gjithë zemër shëndet, lumturi dhe punë të mbarë e të frytshme për të mirën e popullit dhe të Partisë sonë të lavdishme.

Juaji

Enver Hoxha

*Botohet për herë të parë si-
pas originalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

SHKOLLA DHE ORGANIZATA E RINISË KANË INTERESA THEMELORE TË PËRBASHKËTA¹

21 shkurt 1966

Artikullin që keni botuar në gazeten «Zëri i rinasë» të datës 19 shkurt 1966, me titull «Organizata e rinasë dhe shkolla», duke e konsideruar shumë të rëndësishëm, e lexova gjer në fund. Nuk ju thirra këtu për t'ju thënë që të mos bëjmë kritika në shtyp. Kritika duhet të bëjmë, të kritikojmë çdo veprim të gabuar dhe njerëzit që janë autorë të këtyre gabimeve, bile këtë punë ta forcojmë. Ne edhe orientimet e gabuara, edhe një direktivë që rezulton se është e gabuar, duhet t'i kritikojmë.

Por në artikullin që po ju përmend, marrëdhëniet në mes organizatës së rinasë dhe shkollës, më duket se nuk shtrohen në rrugë të drejtë, por, si të thuash, në formën e një polemike pa baza të shëndosha. Në artikull del sikur te ne, për problemet që trajtohen aty, ka dy mendime, dy vija.

E meta e shokëve të arsimit është se ata, duke u

¹ Bisedë me një nga drejtuesit e Komitetit Qendror të BRPSH.

nisur nga ngjarje e fakte të ndryshme, të cilat në disa raste kanë të bëjnë me moszbatimin si duhet në praktikë të vijës, kanë bërë disa gabime, por ju në artikull, pa e kuptuar, keni goditur publikisht jo gabimet e tyre, por një parim bazë të drejtimit, të udhëheqjes së shkollës sonë. Ju kapeni pas një përcaktimi që bëhet në revistën «Arsimi popullor», ku shkruhet se parimi i drejtimit unik të shkollës shtrihet edhe në fushën e punës edukative dhe nxirrni konkluzionin se ky parim «bie në kontradiktë me përcaktimet e njohura të karakterit të organizatës, si organizatë e pavarur politike...».

Para së gjithash, dua të them se, me sa kuptohet, kur thuhet se parimi i drejtimit unik të shkollës shtrihet edhe në fushën e punës edukative, është fjala për aktivitetet edukative që zhvillohen jashtë mësimit dhe që organizohen si nga shkollat e mësuesit ashtu edhe nga organizatat e rinisë e të pionierëve. Siç duket, kjo është një terminologji pedagogjike që përdoret nga specialistët. Por ne e kemi të qartë se e tërë puna e shkollës është punë edukative. Përndryshe, përkufizimi se parimi i drejtimit unik të shkollës shtrihet edhe në fushën e punës edukative do të ishte jo vetëm i mangët, por edhe i gabuar. Kurse gabimi juaj qëndron në faktin se parimin e drejtimit unik të shkollës e konsideroni si një parim që bie në kontradiktë me karakterin e organizatës së rinisë.

Le të shikojmë tani çështjen e parimit të «drejtimit unik» të shkollës. Ky është një parim marksist i përcaktuar nga Lenini. Siç dihet, Lenini na mëson se në shtetin socialist, në kuadrin e parimit të centralizmit demo-

kratik, zbatohen drejtimi ose udhëheqja unike në të gjitha institucionet shtetërore, në ndërmarrje e në administrata. Kuptohet që veprimi i këtij parimi nuk ka pse të mos shtrihet edhe në shkolla, të cilat janë institucione edukative të shtetit tonë socialist.

Por problemin e drejtimit unik të shkollës ne duhet ta shohim edhe më gjerë, në kuadrin e karakterit unik të gjithë sistemit tonë të arsimit popullor. Ky është një parim themelor demokratik socialist i politikës sonë arsimore që siguron karakterin e plotë e konsekuent shtetëror të shkollës sonë dhe drejtimin e saj nga Partia.

Po t'i bëjmë një analizë marksiste çështjes, përpjekjet për zbatimin e frysës demokratike lidhur me karakterin unik të arsimit kanë pasur vend edhe në të kaluarën. Ata që kanë menduar dhe janë përpjekur për të sigruar karakterin unik të arsimit e të shkollave të vendit tonë, sipas mendimit tim, kanë qenë demokratë përparimtarë.

Problemi i edukatës në shkolla edhe sot është objekt lufte e përpjekjesh nga ana e atyre që janë për shkollën laike, kundër atyre që janë për shkollën fetare. Një luftë e tillë është zhvilluar e zhvillohet edhe tanë në shumë vende borgjeze, midis elementëve demokratë përparimtarë, nga njëra anë, dhe reaksionit, nga ana tjetër. Një luftë si kjo është zhvilluar edhe në Shqipëri para Çlirimt. Elementët përparimtarë kanë qenë për ngritjen e shkollës laike shtetërore, kundër ndikimit të fesë në shkollë, kundër drejtimit të dyfishtë të saj nga shteti dhe nga kisha. Ata kanë pasur për qëllim të ndanin shkollën nga feja, të bënin që feja të mos përzuhej në çështjet e edukimit dhe shkolla, pra, të kishte një

karakter unik si dhe një drejtim të vetëm nga ana e shtetit. Edhe në ato raste kur mësimi i fesë është futur në shkollë, këta elementë nuk kanë pasur në mendje që shkolla të mos ishte nën drejtimin e shtetit. Kjo ishte një luftë e drejtë që kanë bërë njerëzit përparimtarë edhe në vendin tonë. Janë, pra, demokratët revolucionarë shqiptarë që e kanë kërkuar karakterin unik të shkollave tona dhe drejtimin e tyre nga shteti. Me çlirimin e vendit dhe me vendosjen e pushtetit popullor mësuesit patriotë u gjuan shumë që shkolla jonë e re u bë krejtësisht unike, u vu plotësisht nën drejtimin e shtetit dhe që iu prenë rrugët çdo ndikimi fetar mbi të. Këtë, thanë ata, e siguroi në Shqipëri Partia Komuniste, e siguroi pushteti popullor.

Mirëpo pas Çlirimt problemi i karakterit unik të arsimit nuk shtrohej vetëm në planin e ndërtimit të sistemit arsimor dhe të drejimit të shkollave. Kjo tani nuk ishte e mjaftueshme dhe nuk u përgjigjej kushteve aktuale të vendit tonë, rrugës sonë drejt socializmit. Tani karakteri unik i arsimit duhej përforcuar edhe me frymën unike të edukatës, e cila nuk mund të ishte tjetër veçse një edukatë komuniste. Prandaj, ne me të drejtë flasim e punojmë sot «për edukimin e gjithanshëm komunist të rinisë». Kjo do të thotë se shkolla jonë bën edukimin e gjithanshëm të rinisë, nën drejtimin e Partisë. Por kjo detyrë që i ka ngarkuar Partia shkollës, nuk duhet kuptuar në mënyrë të njëanshme, për shembull, vetëm për edukimin dhe pajisjen e nxënësve me sjellje të mira. Kjo do të ishte njëlloj sikur të ngatërrrosh pjesën me të tërën.

Të kthehem i tani te koncepti i drejimit a i udhë-

heqjes unike të shkollës në kuptimin e drejtpërdrejtë leninist të kësaj fjale. Këtë koncept, në fakt, ju e konfondoni, nuk e kuptioni drejt. Meqenëse drejtimi i shkollës është unik, thoni ju, puna e saj cenon organizatën e rinisë. Duke vënë në dukje në artikull disa raste jo të mira që kanë ngjarë, ju, në vend që të kritikoni personat përgjegjës, goditni parimin dhe mendoni që shkolla jonë duhet të ketë dy drejtime, edhe të rinisë, edhe të personelit mësimor. Por edukimi i gjithanshëm që bën shkolla jonë e udhëhequr nga Partia, nuk përjashton aspak punën e organizatës së rinisë, e cila përputhet me misionin e shkollës. Kurse ju çështjen sikur e hidhni në zigare, për ju nga njëra anë është shkolla, nga ana tjetër organizata e rinisë.

Del pyetja: Kush është ngarkuar me detyrë të veçantë nga Partia për edukimin e rinisë shkollore, organizata e rinisë apo shkolla? Dhe cilat janë marrëdhëniet që krijohen midis tyre në këtë fushë? Kuptohet që shkolla është institucioni kryesor për edukimin e rinisë shkollore, kurse organizata e rinisë, duke u bazuar në parimet politike të drejtimit të shkollës sonë socialistë, e mbështet, e ndihmon atë. Ne nuk duhet të përzizjmë parimet me disa raste të veçanta që kanë ngjarë e mund të ngjasin edhe në të ardhmen. Organizata e rinisë i mbështet parimet politike të shkollës sonë socialistë, ajo nuk ka si të vejë në kundërshtim me to. Kuadrot e organizatës së rinisë as që duhet të mendojnë se nuk qenka i drejtë edukimi unik dhe se ky edukim cenoka interesat e organizatës. Po të mendojnë kështu, po të nisen nga koncepti që shkolla cenoka një organizatë politike të krijuar nga Partia, atëherë si konklu-

zion del se ajo cenon edhe vëtë organizatën e Partisë që e ka krijuar dhe e drejton organizatën e rinisë.

Në të vërtetë në artikull del se nuk kuptohet çështja që edhe shkolla jonë drejtohet nga Partia. Po ajo është një shkollë politike socialiste, e cila ka marrë përsipër edukimin e gjithanshëm komunist të rinisë dhe, për t'i arritur këtij qëllimi të lartë, ndihmohet edhe nga organizata e rinisë.

Kur flasim për shkollën, nuk kuptojmë vetëm mësuesit, po çdo gjë që ka lidhje me të, programet, tekstet, metodikat e mësimit, mjetet mësimore etj. Të gjitha këto kanë të bëjnë drejtpërdrejt me edukimin e rinisë sonë, i cili realizohet nën kujdesin dhe drejtimin e Partisë. Dhe kur themi Partia, me këtë nuk kuptojmë diçka që qëndron në hava. Me Partinë në shkollë ne kuptojmë mësuesit anëtarë partie, arsimtarët patriotë, programet dhe tekstet mësimore, të cilat përshkohen nga ideologjia marksiste-leniniste, kuptojmë organizatën e rinisë etj., që punojnë e shërbejnë të gjithë, në mënyrë unike, sipas mësimeve të Partisë. Ky është një kompleks i tërë.

Drejtimi unik dhe edukimi i gjithanshëm komunist i rinisë që bëhet nga shkolla, nuk kanë aspak për qëllim të prekin pavarësinë e organizatës së rinisë dhe nuk mund të bëhet krahasimi me kohën kur elementët demokratë përparimtarë, me konceptin e «drejtimit unik» të shkollës, në kuptimin e karakterit të saj përpinqeshin t'u vinin kufi klerit dhe kishës, që këta të mos përziheshin në punët e shkollës. Shkolla jonë e re socialiste dhe organizata e rinisë kanë interesa themelore të përbashkëta. Ju mendoni dhe kërkon që organizata e rinisë

të futet plotësisht në shkollë dhe të ndihmojë për mbarëvajtjen e saj, por, kur shkolla interesohet për aktivitetin që zhvillon rinia, thoni që kjo ju prish pavarësinë. Një gjë e tillë nuk është e drejtë dhe bie në kundërshtim me parimin, sipas të cilit Partia i ka ngarkuar shkollës sonë të edukojë rininë në mënyrë të gjithashme dhe me fryshtë komuniste.

Në artikull jepen disa shembuj për të argumentuar nevojën e bashkëpunimit midis shkollës dhe organizatës së rinisë për edukimin e brezit të ri, ashtu siç bëhet në ndërmarrjet, në organizatat ekonomike, ose në administratë, ku ka kod pune e rregulla, ku ka statut, siç është ai i kooperativave bujqësore etj., që ndihmojnë për edukimin e punonjësve. Por Kodi i Punës, statuti i kooperativës etj., nuk janë faktorët e vetëm që ndihmojnë për edukimin e klasës punëtore, të fshatarësisë kooperativiste, të rinisë etj. Në bazë të të gjithave është puna, që i edukon njerëzit, puna në fabrika, në ara e kudo. Puna te ne ka moralin e vet socialist, ajo ka karakter edukues primordial. Te puna bazohen morali ynë socialist dhe parimet e Partisë. Kur një njeri është duke mësuar zanat, Partia e këshillon atë ta mësojë mirë se do t'i duhet për të ndërtuar jetën e re socialist, i thotë të kuptojë mirë se ka nderin e madh që në dorën e vet i është besuar të ketë një makinë të vlefshme dhe e këshillon ta përdorë këtë si duhet e ta shfrytëzojë sa më shumë, po njëkohësisht edhe ta ruajë me kujdes se është pasuri e përbashkët socialist, e bërë me mundin dhe djersën e popullit etj. Prandaj nga kushdo të shfrytëzohet si duhet e të mbahet mirë çdo vegël e makinë. Dua të them që Partia e ndërton moralin e vet në bazë

të punës së dobishme shoqërore. Çështja e Kodit të Punës, e statutit etj. ka të bëjë me disa përcaktime ligjore parimore mbi të drejtat dhe detyrat e punëtorëve dhe të kooperativistëve, që edhe këto hyjnë në moralin, në sferën e edukimit. Këto janë disa përcaktime, të cilat mund të barazohen me rregullat e shkollës, ku koncepti «punë» është baras me konceptin «mësim». Me këtë dua të them se për nxënësit punë është edhe mësimi, madje kryesisht mësimi, se nëpërmjet tij, domethënë të kësaj pune, ata edukohen, ashtu sikurse edukohet punëtori apo kooperativisti nëpërmjet punës që kryen.

Shkolla jonë udhëhiqet thellësisht nga politika dhe ideologjia e Partisë gjer në atë shkallë, sa edhe mësimi i historisë së revolucionit francez duhet të bëhet në mënyrë revolucionare. Kur bëhet ky kapitull i historisë në shkollë, mësuesi duhet të thotë, fjala vjen, se në ç'drejtim ka qenë revolucionar përparimtar Dantoni, duke vënë mirë në dukje pikërisht atë moment kur ai fliste dhe thoshte me forcë: «Guxim, guxim dhe përsëri guxim», domethënë frymëzonte njerëzit për të mos pasur frikë nga armiqjtë dhe për të luftuar për shkatërrimin e planeve të tyre. Mësuesi mund të vërë gjithashtu në dukje ku qëndronte dashuria e Dantonit për atdheun, duke e konkretizuar edhe këtë me qëndrimin e tij, që, kur donin ta kapnin e ta futnin në burg dhe një miku i tij i bëri thirrje të largohej, ai iu përgjigj: «Unë nuk e marr atdheun në majat e këpucëve». Megjithatë, u duhet shpjeguar se Dantoni më pas u lidh me reaksionin dhe me anglezët, se ishte njeri oportunist, por anët e tij pozitive duhen bërë të qarta politikisht.

Karakteri politik i shkollës kërkon, pra, që mësuesit tanë, në zhvillimin e çdo lënde, të mendojnë konkretisht për edukimin e të rinjve me tipare socialiste. Kjo kërkon që nxënësit tanë jo vetëm të pajisen me dituri, po nëpërmjet mësimeve që zhvillohen në shkollë, çdo ditë të kaliten tek ata cilësi të tilla si vendosmëria, patriotizmi, sjellja e mirë, morali i lartë, iniciativa krijuese në kuptimin që çdo i ri të edukohet, që të mendojë vetë, t'i punojë mendja dhe të mos jetë një automat. Të gjitha mësimet që zhvillohen në shkollë kanë për qëllim t'i edukojnë nxënësit që ata të formojnë në vete gjithë ato veti të larta. Në këtë drejtim shkolla ka një përgjegjësi shumë të madhe. Kjo duhet të kuptohet mirë. Sa e bën ajo këtë, është tjetër punë, po kjo detyrë me rëndësi i është besuar shkollës se me shkollën ata janë të lidhur çdo ditë, për tërë kohën, gjersa dalin në jetë.

Sado që të dijë një djalë që bën pjesë në organizatën e pionierit, prapë ai është i vogël, prandaj nuk duhet ta mbivlerësojmë kaq shumë këtë organizatë. Ajo përbëhet nga fëmijë të moshës 9-14 vjeç, akoma të paformuar siç duhet, që akoma nuk janë në gjendje t'i gjykojnë thellë të gjitha çështjet, kurse mësuesi është njeri i pjekur, patriot, ai mund të jetë edhe komunist, ai është edukator, e ka në shpirt edukimin e brezit të ri dhe për atë punë është përgatitur.

Prandaj, pa e nënvleftësuar organizatën e pionierit, ajo nuk mund të mendohet të vihet në një balancë me shkollën. Duhet kuptuar drejt që është kryesisht shkolla ajo që merret me edukimin e rinisë. Por, në artikullin për të cilin bëjmë fjalë, problemet ju i keni ngritur

duke u nisur nga disa veprime të gabuara që ka bërë në punën e saj praktike Ministria e Arsimit, siç është ai që në mbledhjet e organizatës së pionierit, si rregull, duhet të venë medoemos mësuesit. Ta vendosësh një gjë të tillë si rregull të domosdoshëm, kjo është e gabuar, por, nga ana tjetër, mendoj se është diçka e bukur që vetë nxënësit t'i ftojnë mësuesit që të jenë të pranishëm në mbledhjet e organizatës së tyre. Edhe mësuesi nga ana e tij duhet të ketë gjithashtu kujdes që në mbledhjen e organizatës së pionierit të mos vejë si mësues, po të shkrihet me nxënësit, të sillet ngrohtë, të jetë i dashur me ta. Nxënësit në organizatë mund ta pyesin mësuesin, për shembull, si mendon ai për këtë apo atë problem që diskutohet dhe, sipas rastit, ky t'u thotë vetëm si mendon, ai mund t'u thotë, mirë e keni, kur problemin nxënësit pionierë e zgjidhin drejt, kurse për një çështje tjetër që pionierët nuk e kanë në rregull, t'u thotë se kjo është puna juaj, po unë mendoj ta shikoni më me kujdes këtë problem.

Përse them që mësuesi është mirë të vejë në organizatën e pionierit dhe të rinisë? Duhet të nisemi nga parimi që mësuesi është mirë të dijë si mendojnë, si diskutojnë, si përpinqen nxënësit për të kryer në jetë detyrat. Puna e tij në këtë drejtim do të jetë një ndihmë e madhe për organizatën. Veç duhet pasur kujdes që vajtja e tij në këto organizata të bëhet në mënyrë të natyrshme, jo me urdhër dhe prania e mësuesit atje t'u hapë horizont nxënësve. Një punë e tillë njëkohësisht edhe atij vetë do t'i japë mundësi t'i shohë nxënësit jo vetëm më klasë me libra, por edhe në takime të lira ku do të shikojë, do të zbulojë e do të njohe

gjallërinë, temperamentin, karakterin e nxënësve dhe do t'i drejtojë e do t'i zhvillojë ata në rrugën që duhet. Duke bërë një punë të tillë, mësuesi pastaj do të jetë i drejtë në qëndrimet ndaj nxënësve, nuk do të japë gjykime të nxituara, duke thënë se ky nxënës që po më hidhet kështu në klasë është një mburravec. Pasi ta ketë njojur çdo nxënës, ai do të dijë se ka të bëjë me një djalë ose një vajzë të aftë, me iniciativë dhe që i ziejnë përbrenda energji të mëdha. Mbi bazën e kësaj njojeje, ai do të jetë më gjendje të zhvillojë pastaj një moral të tërë në klasë. Prandaj duhet të kuptohet drejt vajtja e mësuesve në mbledhjet e organizatës së rinisë e të pionierit.

Edhe në ekskursionet vajtja e mësuesit mendoj se është shumë e nevojshme. Në aktivitete të tillë ai do të shohë edhe frytet e punës së tij si edukator. Është e natyrshme që nxënësi, kur del nga muret e shkollës, shfren lirisht energjitë e tij, prandaj gjatë kohës së lirë, gjatë défrimit, lojérave, ekskursioneve, shëtitjeve etj., ai zbulon tiparet e veta, anët pozitive dhe negative, të metat e dobësitë. Atëherë, ç'i prishet organizatës së rinisë që mësuesi të jetë edhe në ekskursion me nxënësit, të hidhet, të kërcejë bashkë me ta, të shfrytëzojë njëkohësisht këto raste për t'u mësuar gjëra të reja interesante, për t'u dhënë edhe edukatë jashtë shkollës, në natyrë, atje ku shfrejnë lirisht ndjenjat e tyre? Kjo përputhet pikërisht edhe me atë që kërkojmë ne dhe për të cilën luftojmë, të rrojmë me bazën. Prandaj, do të ishte shumë më mirë, po të qe e mundur, që mësuesi të hante e të pinte me nxënësit.

Në shkollë ka disa ligje, norma e rregulla që nuk

mund dhe nuk duhet të zbatohen në mënyrë dogmatike, por në mënyrë të tillë që të bëjnë efekt pozitiv edukativ. Por edhe jashtë shkollës e klasës, në ambiente më të lira, mësuesi duhet të dijë t'u japë të rinxje këshilla të vlefshme edukative dhe në asnjë mënyrë të mos u japë të kuptojnë atyre se ka vajtur me qëllimet e një kontrollori dogmatik survejent, por as edhe vetëm si një vëzhgues i thjeshtë. Ai, me punën e tij, t'i bëjë nxënësit të kuptojnë se te mësuesi i tyre ata kanë një njeri të dashur, të thjeshtë, që i këshillon, i mbron, që është i lidhur ngushtë me jetën e tyre.

Në këtë drejtim ka gabime si nga shokët e Ministritë së Arsimit, nga drejtuesit e shkollave, ashtu edhe nga ju. Shokët e arsimit kanë arritur gjer atje sa kanë caktuar mbledhjet e rinisë më shkollë me orë, 3 orë, 5 orë. Përcaktimë të tilla mund të janë të gabuara, ashtu sikurse janë të dëmshme edhe mbledhjet pa fund ose mosbërja fare e mbledhjeve. Shokët e ministritë mund ta kenë tepruar që e kanë përgjithësuar çështjen, duke dalë me konkluzionin se ju i keni mbajtur të rintjtë shkollarë nga 4-5 orë rresht nëpër mbledhje, gjë që i bën ata të vijnë të nesërmen të papërgatitur në mësim. Ky konkluzion mund të jetë i shpejtar, po ama shkolla duhet të preokupohet e të mendojë edhe për këtë, se ka përgjegjësi. Shkolla duhet të interesohet për kohën e nxënësve pas mësimit, sepse mbledhjet e zgjatura e pa kriter, pa një qëllim edukativ, pa pasur parasysh moshën, karakteristikat e nxënësve, kohën e mësimit, të fjetjes, të lojës, janë shumë të dëmshme dhe i përgojnë të përgatiten për mësime. Prandaj të përpinqemi të gjithë për një harmonizim të mirë të këtyre probleme-

ve, qoftë nga ana e organizatës në rinisë, qoftë nga ana e shkollës.

Çështja e kujdesit, e kujdestarisë së mësuesve për rininë, ka një shkallëzim. Organizata e rinisë punën e vet nuk mund ta bëjë dot pa pasur kujdes për rininë edhe nga ana e shkollës. Mësuesit janë edukatorë të brezit tonë të ri. Për më të vegjëlit në moshë duhet pasur kujdes më të madh, kurse për të rriturit, kujdesi duhet të marrë forma të tjera. Këtë e thotë edhe pedagogjia. Organizata e pionierit duhet pasur në kujdes, por jo në kuptimin e tutelës, kundër së cilës luftojmë ne. Nga ana e shkollës duhet pasur kujdes me pionierët, ashtu siç e ka familja, mëna, e cila edhe kur djali ose vajza hanë bukë, edhe kur hedhin çapin, e kanë mendjen tek ata. Në qoftë se këtë çështje nuk e kuptojmë si duhet, atëherë nuk kemi bërë gjë. Nëna tregon kujdes për fëmijën e vogël gjer në atë masë sa e mëson atë edhe si të hajë. Kjo, natyrisht, në pamje të parë mund të duket si njëfarë tutele, por në shkollë kjo bëhet me shkallëzime, sipas moshës, klasës etj. Ndryshe është ky kujdes në fillorë, ndërsa në shkollën 8-vjeçare ai merr forma e nuanca të tjera. Kur nxënësi futet në shkollën e mesme, fillojnë të formohen karakteri dhe personaliteti i të riut. Në këtë stad duhet bërë një punë shumë e madhe. Kjo varet shumë nga veprimitaria edukative politiko-ideologjike, nga horizonti dhe përgatitja pedagogjike e edukatorëve, të cilët do t'u japin nuancat e duhura këtij kujdesi, kësaj pune për formimin e karakterit të njeriut.

Më vonë, kur djali ose vajza del nga shkolla e mesme, krijohet tek ata një psikologji tjetër. Në univer-

sitet shumë rrethana e bëjnë rininë të ketë prirje për më shumë pavarësi. Këtë prirje ne nuk duhet ta frenojmë, po kjo në vetvete përmban edhe rreziqe, të cilat duhen evituar me një punë politike e ideologjike të organizuar mirë nga universiteti, nga organizata e rini-së dhe nga organizata e Partisë e universitetit, ku ka edhe studentë që janë anëtarë partie. Prandaj këto probleme duhen studiuar me kujdes. Është një psikologji e tërë dhe shumë e thellë kjo e kësaj moshe, e cila duhet pasur mirë parasysh.

Natyra e njerëzve të veçantë ndryshon shumë nga njëri te tjetri. Ne mund t'i kuptojmë mirë stadet, kalimin e njeriut nga një shkallë në tjetrën, po në jetë ka shumë gjëra, ka lloj-lloj natyrash dhe që t'i rrish secilit mbi kokë me një kut, nuk është e përshtatshme. Prandaj duhet njojur natyra e secilit dhe të gjenden metodat më të drejta për t'i edukuar nxënësit e studen-tët me frymën socialiste për përgatitjen e njeriut tonë të ri.

Çështja e kujdesit për rininë nuk duhet kuptuar si ajo e tutelës, që ne me të drejtë e kritikojmë. Në shkolla ne nuk mund të pranojmë një tutelë borgjeze, por një kujdes që të ketë parasysh veçoritë që thamë dhe këtu ka rëndësi të madhe, në radhë të parë, puna e Partisë.

Unë jam i bindur se, për sa i përket punës edukative në shkollat 8-vjeçare e të mesme, në mjaft raste, komitetet e Partisë të rretheve nuk janë interesuar sa duhet, nuk kanë bërë punën që duhet të bënin për edukimin e të rinjve dhe të pionierëve, nuk kanë tre-guar kujdes të mjaftueshëm për mësuesit, për problemet

pedagogjike të shkollës, për nxënësit, për punën e organizatës së rinisë, për gjithë këto probleme që ju dalin çdo ditë përpara. Por edhe në ato raste kur Partia është kujdesur, prapë nuk është interesuar që ato të shihen në thellësinë e duhur.

Por me gjithë të metat që vërehen, të mbahet mirë parasysh se organizata e rinisë nuk duhet të ketë një pikëpamje jo të drejtë, sikur shkollat i heqin asaj pavarësinë, sepse në të vërtetë nuk është kështu. Ju e kuptoni që ne synojmë edukimin e gjithanshëm komunist të rinisë dhe të kuptohet mirë se Partia dhe shtetia kanë besuar, në radhë të parë, shkollës këtë edukim. Atë e plotësoni njëkohësisht edhe ju, që jeni një organizatë e pavarur, me statut më vete, nenet e të cilit në asnjë mënyrë nuk shkojnë në kundërshtim me parimet e shkollës sonë, sepse edhe organizata e rinisë, edhe shkolla udhëhiqen nga Partia. Por këto veprime që ngjasin e kanë burimin në kuptimin dhe në kryerjen jo në lartësinë e duhur të detyrës nga ana e ndonjë mësuesi, pedagogu etj. Përse ta hiqte pedagogu nga gazeta e murit e shkollës artikullin e botuar nga organizata e rinisë, ku flitet për qëndrimet e gabuara të një vajze? Ky është një gjest jopedagogjik. Do të ishte më mirë që pedagogu të thërriste më parë sekretarin e organizatës së rinisë dhe të informohej ç'kishte ndodhur me atë vajzë që thuhej se kishte bërë gabime; po të ishte nevoja, ai të këshillonte se nxjerrja e emrit të saj në gazetën e murit nuk ishte diçka e mirë, e përshtatshme dhe të bënte të qartë se organizata e rinisë në shkollë e ka të drejtën ta kritikojë vajzën, por në rastin konkret mund të trajtohej në ndonjë formë tjetër, të tre-

gonte si duhej bërë kjo, pastaj ta këshillonte e ta bindte organizatën për ta hequr artikullin nga gazeta e murit. Duke e hequr artikullin arbitrarisht, pedagogu la të kuptojë se është ai që komandon në shkollë. Përse të binte ai në kundërshtim me organizatën e rinisë, kur kishte mundësi ta zgjidhte ndryshe çështjen? Pra, varet shumë në çdo rast nga mësuesi si do të veprojë. Mund të ndodhë që një mësues të sillet si harbut, po në këtë rrugë ai nuk duhet të lejohet nga organizata e rinisë, e cila duhet të tregojë se është e pavarur. Po të ndodhë një rast i tillë, organizata e rinisë mblidhet dhe diskuton se sjellja e këtij ose e atij mësuesi nuk ka qenë e drejtë. Ajo mund të arrijë edhe në konkluzionin që të dërgojë disa përfaqësues në drejtori, të cilët të ankohen për sjelljen jo të drejtë të mësuesit, sjellje që dëmton edukimin e rinisë. Duke vepruar kështu, organizata e rinisë ruan respektin edhe për shkollën, edhe për mësuesit e saj. Ndaj mësuesit që mund të ketë gabuar, qëndrimi i organizatës së rinisë përsëri duhet të vazhdojë të jetë i mirë dhe vetëm në qoftë se ai e përsërit një qëndrim të tillë dhe e tepron, atëherë prapë të ankohet dhe organizata e Partisë të marrë edhe masa ndaj tij.

Në jetë ka një mori çështjesh që është e pamundur të zhvillohen në të gjithë gamën, ashtu sikurse duam ne. Këtë duhet ta kuptojnë dhe ta zbatojnë të gjithë si duhet e gjer në fund. Prandaj Partia dhe, nën udhëheqjen e saj, organizata e rinisë, në çdo rast, edhe në shkollë, duhet të qëndrojnë në këmbë. Organizata e rinisë është me të vërtetë e pavarur, po ajo duhet të jetë e lidhur ngushtë me shkollën, sepse kësaj i ka be-

suar Partia edukimin e rinisë. Prandaj organizata e rinisë e ka për detyrë të punojë e të mësohet që çdo gjë ta bëjë në mënyrë të përsosur. Por, në fakt, kjo punë tani, veçanërisht, nga organizata e rinisë, bëhet me të meta dhe akoma me më shumë të meta e bëjnë punën e tyre edhe mësuesit.

Ju duhet ta ruani pavarësinë e organizatës. Kjo do të thotë që, kur ngjet diçka jo e mirë në shkollë, rinia nuk duhet të heshtë. Për kundrazi, byroja e organizatës së rinisë duhet të mblidhet, ta shqyrtojë e ta gjykojë atë që ndodhi dhe, kur del se është mësuesi ai që ka gabuar, t'i thotë këtij në mënyrë shoqërore se qëndrimi jo i drejtë që ka mbajtur në këtë rast nuk i duket me vend; t'i thotë se për sa ka ngjarë nuk është mirë të shkojë çështja gjer në drejtori, se kjo është diçka që mund të zgjidhet bashkërisht. Këtu qëndron forca e organizatës së rinisë.

Ose në qoftë se ka raste kur shkolla jep një udhëzim që del jashtë normave të njoitura, atëherë organizata e rinisë, si organizatë politike që është, mund ta marrë fare mirë vetë iniciativën dhe të tregojë se ky qëndrim nuk i duket i drejtë. Shkolla jonë socialiste ka disa rregulla, pa ekzistencën e zbatimin e të cilave nxënësit do të edukoheshin keq, do të dilnin të shthurur nga shkolla. Prandaj organizata e rinisë duhet të punojë që ato rregulla të zbatohen plotësisht, gjë që do të ndikojë pozitivisht për formimin e karakterit të rinisë sonë me normat e shoqërisë socialiste, do t'i ndihmojnë asaj të kuptojë konkretisht ç'është disiplina në punë. Në qoftë se ndodh, për shembull, që mësuesit e shkollës në kohën e mësimtit venë të urojnë një kolegut

e tyre që martohet, organizata e rinisë nuk duhet të pajtohet me këtë qëndrim, por të veprojë, duke e ngri-
tur zërin para drejtorisë së shkollës dhe organizatës së Partisë, sepse një veprim i tillë i trupit mësimor do të ndikojë negativisht te të rintjtë, do të krijojë tek ata tendencën e anarkisë. Kur martoher një shok i tyre, punëtorët në fabrikë nuk lënë punën të venë në dasmë. Një gjë e tillë nuk bëhet dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të lejohet të bëhet as në shkollë. Kush të dojë të vejë në dasmë, le të shkojë pas punës. Duke vepruar në këto raste në mënyrë revolucionare, duke i thënë personelit të trupit mësimor se nuk është e drejtë të lejoni që dikush të lërë mësimin e të vejë për të uruar, se këtë nuk do ta lejojnë as nxënësit dhe nuk është e lejueshme as nga ana pedagogjike, as nga ana e disiplinës shtetërore dhe të punës, organizata e rinisë do të tregojë pavarësinë e saj dhe do të ndihmojë në zbatimin e disiplinës në shkollë. Kështu tregohet pavarësia e organizatës së rinisë, kurse ju, duke u bazuar në disa shtrembërime që janë bërë, keni dalë në artikull me një konkluzion jo të drejtë, pa e analizuar dhe pa e kuptuar çështjen ideologjikisht.

Çështjet që ngrihen në pjesën e dytë të artiku-llit, ashtu si trajtohen, janë të tëra të drejta, por mendoj se më shumë duhet thelluar. Parimi i drejtimit unik të shkollës, e theksoj, nuk është vënë për të cenuar pavarësinë e organizatës së rinisë. Kuptimi i tij është që shkolla ka marrë përsipër edukimin e rinisë, ajo drejton në shkollë edukatën mësimore, morale, filozofike etj., nëpërmjet të gjitha lëndëve.

Këto çështje po i bisedojmë me ty, se je drejtuesi

i rinisë, por mos i shtro me shokët kështu si i diskutuam këtu, duke u thënë se me atë artikullin ju keni cenuar parimet, se pastaj ata do të shqetësohen, do të thonë: «Bobo ç'kemi bërë, si e bëmë ne një gjë të tillë?».

Nuk e di nëse e kuptuat ku e kam fjalën: të kemi kurdoherë parasysh parimin. Tani mos u përpinqni që me të dalë këtej ta ndreqni në mënyrë alarmante këtë çështje. Shokëve të arsimit kritika për shkeljen e parimeve pedagogjike t'u bëhet drejt nga ana jonë, por jo me urdhra, kur puna duhet të bëhet në rrugën e bindjes. Ju duhet t'u bini në kokë gabimeve se nuk janë të tërë të mirë në shkollë. Drejtoret e shkollave në përgjithësi mund të jenë të mirë, po nganjëherë jo vetëm nga mësuesit, po edhe nga ata vetë ka që e shkelin, prandaj të gjithë të kenë parasysh dhe të luftojnë për t'i vënë në jetë parimet.

*Botohet për herë të parë si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

KUSHDO QË SHKON NË BAZË NDERRON VETËM KLIMËN, POR NËNËN, PARTINË, DO TA GJEJË KUDO

*Fjala në takimin me punonjësit e aparatit
të KQ të PPSH¹*

24 shkurt 1966

Shoku Hysni ju komunikoi sot emrat e shokëve që do të largohen nga aparati i Komitetit Qendror ku kanë punuar gjer tani, të cilët do të dërgohen të punojnë në bazë, si dhe emrat e atyre që do të mbeten përsëri këtu. Ju vetë keni gjykuar se vendimi i Komitetit Qendror është rrjedhim i gjithë rishikimit që po i bën Partia punës së saj të madhe. Ju e kuptioni që shkuarja në bazë është një masë e drejtë, e domosdoshme, prandaj, si marksistë që jeni, ndieni një gëzim të madh që do të shkonit atje ku e kërkon nevoja e Partisë dhe e popullit. Kjo është një karakteristikë e revolucionarëve,

1 Takimi u bë me rastin e riorganizimit të aparatit të Komitetit Qendror dhe largimit të një pjese të punonjësve të këtij aparati që do të shkonin me punë në rrethe.

kurse ata që s'janë revolucionarë, këtu midis nesh nuk ka të tillë, nuk ndiejnë e nuk kanë si ndiejnë një gjësim të tillë, përkundrazi, kur largohen nga një vend ku janë mësuar, turbullohen, hutohen, hidhërohen. Tek elementët revolucionarë nuk ekziston hidhërim në raste të tilla, sepse tek ata ekziston kuptimi i madh e i drejtë i detyrave të reja që u ngarkon atyre për të kryer Komiteti Qendror. Natyrisht, njëfarë emocioni e keni jo vetëm ju, po edhe ne që po ndahemi sot prej jush, se nuk do të jemi më në kontakte të përditshme si gjer tani. Megjithatë kontaktet nëpërmjet punës ne do t'i kemi të vazhdueshme, po momenti i ndarjes edhe na mallëngjen, mbasi, duke punuar këtu, ju keni dhënë një kontribut të madh në aparatin e Komitetit Qendror dhe keni ndihmuar Partinë me eksperiencën, pjekurinë dhe besnikérinë tuaj ndaj marksizëm-leninizmit.

Po të bëjmë një bilanc se si kemi bashkëpunuar në aparatin e Komitetit Qendror, me siguri zigareja do të anojë më shumë nga pozitivja. Kjo u detyrohet jo vetëm pjekurisë së udhëheqjes, po edhe pjekurisë, zotësisë dhe eksperiencës suaj. Prandaj në gjithë këtë punë pozitive që ka bërë aparati i Komitetit Qendror, një meritë e veçantë ju takon juve, të gjithëve.

Por, ashtu siç ka pasur dhe ka vazhdimisht gjëra pozitive në punën e përbashkët, ka pasur gjithashtu edhe anë negative, gabime e të meta në punën individuale të secilit. Janë pikërisht këto gabime e të meta që janë reflektuar në aparatet tonë, në punën e Partisë dhe të pushtetit. Përgjegjësinë për to nuk duam t'ju lëmë juve, përkundrazi, sikurse e kanë analizuar këtë

çështje Byroja Politike dhe Qeveria, përgjegjësia kryesore për të metat dhe gabimet që janë vërtetuar në punën e Partisë dhe të pushtetit na bie neve, udhëheqjes, por as ju nuk përjashtoheni nga kjo. Si komunistë, që jemi, ne, të gjithë, nuk duhet ta fshehim përgjegjësinë që kemi jo vetëm përparrë Partisë dhe organeve të pushtetit, por bile as përparrë masave të gjera të popullit. Është kjo arsyja që Byroja Politike së shpejti do t'i paraqesë Komitetit Qendror një letër shumë të rëndësishme, e cila do t'u drejtohet gjithë popullit, gjithë komunistëve, gjithë ushtrisë, ku do të flitet haptazi për anët pozitive, por edhe për ato negative të punës sonë, në mënyrë që Partia dhe populli të shikojnë qartë ku kanë qenë të metat, nga kanë rrjedhur dhe si duhen luftuar ato që të mos na përsëriten në të ardhmen.

Ky do të jetë një dokument me rëndësi historike, i cili do të na frymëzojë vazhdimisht në punën tonë të ardhshme që të mundim të përmirësojmë dhe të zhdukim të metat.

Të gjithë duhet të kuptojmë se gabimet e vërtetuara, pavarësisht nga sukseset e mëdha që janë arritur, rrjedhin, në radhë të parë, nga niveli jo i lartë ideologjik, nga mungesa e vigjilencës politike, nga kuptimi jo i thellë politik nga ana e kuadrove, qoftë të Partisë, qoftë të pushtetit, të problemeve që na vihen përrapa për t'u zgjidhur.

Direktivat e Partisë, në vija të përgjithshme, kanë qenë të drejta, por gjatë zbatimit të tyre janë bërë edhe gabime. Fabrikat dhe uzinat tona prodrojnë gjëra

të bukura e shumë të mira, por krahas tyre ato prodhojnë edhe gjëra jo të cilësisë që kërkohet. Në punë e sipër pluhuri i metalit duhet të pastrohet, makinat, tornot e bukura, të forta e moderne, pra, duhet të mbahen të pastra. Punëtorët e dinë mirë këtë detyrë dhe luftojnë që ta kryejnë deri në një. Edhe komunistët duhet që çdo gjë ta mbajnë pastër dhe më kryesorja për ta është të mbahet pastër vija e Partisë. Kjo kërkon që ata, në radhë të parë, të jenë të ngritur ideologjikisht dhe politikisht, ndryshe do të bëjnë gabime. Çdo gjë në jetë ka politikën e vet. Ne si marksistë, duke qenë të ngritur politikisht, jemi në gjendje ta kuptojmë atë.

Të gjithë e dimë se në çdo drejtim ne kemi bërë përparime edhe në metodën dhe në stilin e punës, po, të jemi realistë, përsëri shikojmë e do të shikojmë të meta. Prandaj gjatë punës dhe nëpërmjet saj ne duhet të bëjmë përpjekje që t'i perfektionojmë vazhdimit metoden dhe stilin tonë, ashtu sikurse perfeksionon punëtori i përparuar revolucionar cilësinë e punës së tij, zanatin e tij. Një nga rezultatet e këtij perfeksionimi është e gjithë kjo punë që po bëjmë. Ja tani shumë kuadro nga aparati i Komitetit Qendror do të shkojnë në bazë dhe puna këtu do të bëhet me më pak njerëz. Populli thotë një fjalë të urtë: «Pak e saktë». Kur ishim gjithë këta kuadro këtu, kishte mundësi të fshiheshin shumë dobësi, shumë mungesa tonat, por tani Partia, Komiteti Qendror na e kanë shtrënguar të gjithëve hesapin, sepse punën na e kërkojnë të një cilësie edhe më të mirë se përpara, dhe

njëkohësish të kryhet me më pak kuadro. Kjo në vë detyrën të gjëjmë stilin dhe metodën më të përshtatshme të punës dhe me kuadrot që mbeten puna të bëhet akoma më e mirë. Plane e mendime kemi shumë për sa i përket përmirësimit të metodës dhe të stilit të punës, se të gjithëve Partia na ka hapur perspektiva të mëdha, po vazhdimisht e kudo qoftë ne duhet të bëjmë shkurttime atje ku këto janë të nevojshme e të mundshme.

Masat që po marrim të mos kuptohen në mënyrë dogmatike. Me rastin e vajtjes në bazë të mendoni, në radhë të parë, se kjo bëhet për interesin e Partisë dhe të popullit, për zgjidhjen e problemeve jo më me stilin e vjetër, por t'ju preokupojnë të gjithëve format dhe metodat e reja më të përshtatshme të punës.

Një dramaturg francez thotë: «Mund ta dëbosh natyrën, po ajo kthehet me të shpejtë përsëri». Pra ne duhet të jemi vigjilentë në drejtim të natyrës së njeriut. E kam fjalën te puna jonë 10-15-vjeçare, e cila duhet të përmirësohet jo në mënyrë shabllone, me disa fraza, po duke qëndruar kurdoherë në këmbë për të gjetur metodën më të mirë të zbatimit. Që t'ju japim një recetë për këtë do të ishte gabim, një punë jo e frytshme, një lloj sikur t'i thuash tjetrit ti rri, vetëm hap gojën të ta hedh ushqimin. Një praktikë e tillë nuk është aspak revolucionare, prandaj çdo komunist e ka për detyrë të mendojë, të shpikë, të racionizojë, të ndihmojë e të korrigojë të tjerët, të luftojë dhe vazhdimisht të propozojë rrugë të reja për përmirësimin e pandërpren-

rë të punës. Duhet luftë dhe jo gjumë, shokë. Për ata që punojnë, që mendojnë, që racionalizojnë ka kurdoherë respekt. Respekt nuk ka dhe nuk duhet të ketë për njerëzit e fjetur, që nuk krijojnë, por që presin vetëm të zbatojnë. Prandaj duhet luftuar vazhdimisht, se lufta e përpjekjet. bëjnë që e vërteta, e drejta, e mira të ecin përparrë.

Edhe e lehtë një punë e tillë nuk është, por ajo nuk është gjithashtu aq e rëndë. E lehtë nuk është se duhet bërë një kapërcim i madh në cilësi dhe kjo nuk bëhet me sustë, po megjithatë duhet të bëhet. A kemi vallë bazë për ta bërë një gjë të tillë? Po, kemi, dhe prova është që një punë të madhe dhe në një kohë kaq të shkurtër prej dy muajsh po bën Partia. Kudo po bëhet revolucionarizm në mendjen e të gjithëve. Ky është një sukses i madh që tregon se Partia ka punuar dhe puna e saj ka dhënë rezultate. Pikërisht në saje të punës së Partisë u bë e mundur që i gjithë ky revolucionarizm, këto organizime në tërë shtetin dhe në gjithë Partinë të bëhen me sukses. Gjatë kësaj periudhe u bënë organikat sipas direktivave të Byrosë Politike. Nuk përjashtohet që në gjithë këtë punë të ketë edhe të meta e gabime, por në përgjithësi njerëzit po vendosen në punët e reja dhe të gjithë i kanë gjetur të drejta këto masa me të vërtetë të domosdoshme. Njerëzit i lanë mënjanë çështjet personale, hallet e jetës së tyre të përditshme dhe i janë vënë punës me të gjitha forcat kudo ku e lypin interesit dhe nevoja e punës. Ky është rezultat i entuziazmit të lartë, i kuptimit të drejtë politik të detyrës që shtrohet para secilit dhe i

moralit të lartë revolucionar që ka edukuar Partia jonë në të gjithë punonjësit.

Ne kemi një bazë të shëndoshë për këtë hop cilësor, sepse tani Partia është rritur, është forcuar politikisht dhe ideologjikisht, megjithëse jo në atë shkallë që duhet, sepse na kanë penguar rutina, burokratizmi, ndryshe Partia do të ishte ngritur edhe më lart. Këtë gjë, domethënë format e edukimit ideologjik dhe politik të Partisë dhe të masave të popullit tani po i rishikojmë rrënjosht. Ne do t'i rishikojmë ato, sidomos në drejtimin që kjo ideologji dhe kjo politikë të asimilohen me lehtësi nga të gjithë dhe të mos ushqehemi me fraza e formula, po me filozofinë marksiste-leniniste të trajtuar në mënyrë të përshtatshme me jetën, me hallet dhe me sukseset e popullit që edhe atyre që kanë një nivel kulturor përgjithësisht të ulët, filozofia jonë t'u duket se është me të vërtetë një gjë e bukur, e kuptueshme dhe e nevojshme për jetën.

Kemi mundësi ta bëjmë një gjë të tillë? Po, kemi, vetëm duhet të shkundemi, ta bëjmë kthesën edhe në këtë drejtim, në mënyrë që filozofinë tonë marksiste-leniniste çdo njeri yni ta ketë si armë për të luftuar në jetë. Kuadrot e Partisë sonë tani janë në gjendje ta kryejnë këtë detyrë të madhe. Ata kurdoherë kanë përballuar furtuna, kanë zgjidhur situata të vështira politike, ekonomike, arsimore, kulturore etj., në çdo kohë, sado të rënda të ishin. Pra, me punën që po bëjmë do të realizohet një hop akoma më i madh përpara, populli do të shikojë rezultatet e mrekullueshme të kësaj pune të madhe revolucionare të Partisë sonë marksiste-leniniste.

Ju, shokë, që po shkoni në bazë nuk do të jeni vëtëm, atje është Partia. Ajo është nëna jonë, e cila ndodhet kudo, në qytet dhe në fshat, në fabrika dhe në uzina, në kooperativat bujqësore, në shkolla etj. Prandaj kushdo që largohet nga aparati i Komitetit Qendror nuk ndërtron veçse klimën, kurse nënën, Partinë, ai do ta gjejë kudo, në çdo pëllëmbë të atdheut, të gjallë, luftarake. Kjo është kryesorja. Për ne asnjë mërzitje nuk duhet të ketë, në çdo qoshe të Shqipërisë që të jemi.

Para ca ditësh më shkruante një letër shkrimtari Zihni Sako, me të cilën më njoftonte se po shkonte në Gjirokastër. Mos thoni se jam Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të Partisë e po ju bëj propagandë, po Zihninë e uroja dhe njëkohësisht i thosha singerisht se, pa qenë lokalist, edhe unë isha i gatshëm. të shkoja atje në Gjirokastër ku ka shkuar ai, se edhe mua më merr malli për vendlindjen, për mjerëzit, bile edhe për gurët e Gjirokastrës, po nuk e bëj dot si ai, se detyra e Partisë nuk më lejon të shkoj në bazë. Kjo është një ndjenjë që vlon në zemrën e të gjithë juve, si ushtarë të Partisë që jeni, si djem e vajza të popullit.

Unë ju them dhe kam bindje të plotë se atje ku do të shkoni do ta ndieni veten shumë mirë, do të ambientoheni shpejt në punë, do të ndihmoni me eksperiencën tuaj për të cilën Partia ka shumë nevojë. Ju keni punuar në aparatin e Komitetit Qendror të Partisë me funksione të ndryshme, kurse tani disa prej jush do të shkojnë në rrethe sekretarë partie, disa kryetarë pushteti etj. Të jemi realistë, ne e kuptojmë se ju do të keni edhe vështirësi, edhe disa shqetësime të tillë si çështje shtëpie etj., por këto nuk kanë të bëjnë me çështje pari-

more. Ato janë të jetës së përditshme, janë të përkohshme. Shokëve sekretarë të rretheve duhet t'u rekomandojmë të bëjnë kujdes për ju që shkoni atje tanë. Nuk është çështja t'ju bëjnë favore, po të tregojnë kujdes për të rregulluar sa më parë jetën që të merrni edhe familjet me vete. Ne nuk ju rekomandojmë t'i lini këtu familjet. Një gjë e tillë ka rëndësi edhe nga ana ekonomike, edhe nga ana shpirtërore dhe morale. Jeta pa familje është e trishtuar. Familja, kalamani janë gëzimi i shtëpisë sidomos pas punës kur kthehet i lodhur.

Atje ku do të shkoni të keni kujdes edhe një çështje tjeter, mos lejoni që në disa vende pune, të bjerë shkurtimi më shumë te gratë. Shoku Gogo, ju e dini, kohët e fundit ka shkuar me punë në Berat, më thoshte se atje kanë bërë një gabim, nuk e kanë pasur parasysh direktivën e Byrosë Politike, se shumë oficerë që tanë po çmobilizohen, po futen në kurse 3, 4 ose 5-mujore që të ruajnë pagën, mirëpo gabimi qëndron, më thoshte ai, se të tërë këta sulmojnë të shkojnë në kurse në Kombinatin e Tekstileve. Po në këto mund të futen fare mirë gratë.

Këto desha t'ju thosha, shokë. Mbase fola më shumë nga sa duhet, por edhe një herë, në emër të shokëve të Byrosë Politike dhe të Sekretariatit të Komitetit Qendror, dëshiroj t'ju falënderoj për ndihmën e madhe që keni dhënë dhe do të vazhdoni ta jepni edhe më mirë një funksionet e reja që ju ngarkohen. Ne ndiejmë kënaqësi të jashtëzakonshme që të gjithë shokët e aparatit të Komitetit Qendror që u caktuan të punojnë në bazë, në bllok siç janë, nuk bënë as vërejtjen më të vogël, nuk shprehën as pakënaqësinë më të vogël.

Për këtë ne ju falënderojmë se kjo përbën një forcë të madhe që ka Partia jonë në kuadrot e saj. Ju uroj nga zemra suksese në detyrat e reja kudo që të shkoni!

Rroftë Partia!

*Botohet për herë të parë si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

DREJTUESI DUHET TË JETË PRAKTIK NË PUNE, PO NJËKOHËSISHT EDHE MENDIMTAR

*Fjala në takimin me sekretarët e parë të komiteteve
të Partisë të rretheve¹*

25 shkurt 1966

Pas dy orë pune, ku ju folën hollësisht shoku Hysni dhe shoku Ramiz, do të ishte e tepërt të zgjatesha, me gjithatë dëshiroj edhe unë t'ju flas për disa çështje. Po shikoj se të tërë fytyrën e keni të çelur, sidomos ju shokët e rinj që shkonit në drejtësim të organizatave të Partisë në rrethe. Vajtja juaj në bazë, ka rëndësi të madhe se populli ju njeh ju për luftën dhe për punën që keni bërë, për besnikërinë tuaj. Ai, gjithashtu, ka besim të madh për të gjitha masat që po marrim dhe për kthesën e rëndësishme që po bëhet në drejtësim të revolucionarizimit të jetës së vendit.

Dëshiroj të theksoj se të gjithë kemi përgjegjësi të madhe për çdo problem që i del Partisë përpëra, prandaj duhet punuar me kokë. Kjo përgjegjësi duhet kup-

I Ky takim u bë lidhur me masat e fundit që u morën për forcimin e organeve të Partisë dhe të pushtetit në bazë.

tuar thellë, jo të bëhet një punë e përciptë duke u mjaftuar vetëm me thënien e një fjale njërit apo tjetrit, pa menduar mirë për ndihmën që kërkojnë e përtë cilën kanë nevojë njerëzit. Nuk duhet të punohet si miza që ngjit të përpjetën duke bërë zhurmë në veshin e kalit dhe kur del në majë, thotë dola në selamet. Po të veprohet kështu, kjo nuk është një punë partie, nuk është një punë e nivelit të sekretarit të parë. Njerëzit vijnë e do të vijnë të trokasin te dera e komitetit të Partisë, prandaj sekretari duhet ta dijë mirë situatën, të jetë në gjendje t'i ndihmojë ata në të gjitha anët për zgjidhjen e problemeve, me metodën e stilin e tij të mirë të punës, me sjelljet dhe me shikimin e çdo problemi në prizmin politik. Kjo nuk bëhet me një të thënë, prandaj duhet t'i përvisheni mirë punës. Drejtuesi duhet të jetë praktik në punë, kjo është një gjë e mirë, po që nuk i sjell të tëra të mirat, prandaj ai duhet të jetë njëkohësisht edhe mendimtar. Nuk e kam fjalën të jetë filozof në erë, por t'i njohë thellë problemet në të gjitha drejtimet dhe t'u japë atyre edhe një frymë revolucionare, praktike, t'i mësojë njerëzit edhe me njérën, edhe me tjetrën anë.

Roli i sekretarit të parë dhe i sekretarëve të tjerë të komiteve të Partisë në rrethe është i madh. Ata bëjnë mbledhje, por këto duhet të janë mbledhje pune, ku problemet të shtrohen si duhet. Në mbledhje edhe raporte do të ketë, shokë. Por, raporti duhet të jetë fryt i një mendimi të pjekur i hedhur në letër, prandaj nuk duhet të përgatitet sipas mënyrës së vjetër. Këtë dua t'ua vë në dukje sidomos atyre prakticienëve, që tani po fërkojnë duart duke thënë se «erdhi koha jonë, pra-

ndaj mund të shkojmë në mbledhje pa reflektuar, të themi atje disa fjalë dhe shko tutje». I theksoj këto se po shkojmë edhe disa tendenca të gabuara. Dje, për shembull, lexova një artikull në gazetë, i cili jep idenë sikur tani mbledhjet nuk do të bëhen me raporte, nuk do të përdoren as telefona, as telegramë. Po, pa e dërgoni njëçikë në Kurbnesh këtë njeri që na ka bërë këtë artikull dhe le të punojë pa telegramë e pa telefona për të zgjidhur problemet që i dalin përpara. Pse, vetëm duke u ngritur nga Kurbneshi dhe të shkosh në qendër të rrethit, në Tiranë apo gjetkë edhe për një gjë të vogël, kështu do të zgjidhen punët? Për çdo gjë, edhe për 10 minuta punë, do të shkohet nga rrethi në qendër?! Nuk duhet të bëhet çdo gjë vetëm me të bredhur, por do të shfrytëzohet edhe telefoni, do të bëhen edhe telegramë, po mund të shkohet edhe personalisht në vend. Të gjitha këto rrugë mund të përdoren sipas rastit, se çdo gjë ka kohën dhe rëndësinë e vet.

Këto gjëra t'i kuptojmë mirë e si duhet, ashtu sikurse duhen kuptuar edhe problemet që u shtruan këtu, sepse kanë rëndësi të madhe edhe nga ana ideologjike. Të marrim si shembull orientimin e Partisë për vajtjen në fshat. Sekretari i Partisë duhet të dijë si është kuptuar ky orientim dhe ç'probleme dalin në zbatimin e tij, e jo oburra, të vemi në fshat, siç thonë disa, pa e menduar pse do të venë e sa do të venë. Politika e Partisë sonë për fshatin është një politikë bolshevike, e matur, e urtë, jo një politikë menshevike, narodnike. Kjo duhet të kuptohet drejt. Partia i ka vënë dhe do t'i vërë rëndësinë e duhur fshatit, bujqësisë, por jo ama të ndodhë siç na kanë thënë që dalin disa njerëz dhe

hedhin parulla me skandencë: «Burokrat, burokrat, lër zyrat e shko në fshat». Sipas kësaj parulle u dashka të braktiset qyteti, se vetëm fshatit duhet t'i jepet rëndësi. Kjo nuk është një parullë e drejtë politike, por një parullë e gabuar që e përcmon qytetin. Të mos lejojmë të hidhen parulla të tillë të pamenduara mirë. Vijën e Partisë ta zbatojmë drejt, si duhet. Në qytet jeton e punon klasa punëtore, janë gjithë këta kuadro të devotshëm që Partia i ka zgjedhur e i ka caktuar të drejtojnë organet e Partisë dhe të shtetit. Sipas kësaj parulle këta na qenkan burokratë! Kjo parullë në fund të fundit do të thotë: «Braktisni zyrat e pushtetit», me një fjalë «braktisni drejtimin e pushtetit, se gjithë puna tani është në fshat».

Të mos harrojmë se në historinë e lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombe të ka pasur raste që disa «filozofë», që në të vërtetë kanë qenë vagabondë të mëdhenj, i kanë veshur me petka filozofike të tillë parulla. I tillë është anarkizmi. Në këtë drejtim kanë devijuar Plehanovi dhe populistët rusë. Në pikëpamje anarkiste e antimarksiste çojnë edhe parulla si ato që thamë më lart, prandaj të bëjmë kujdes dhe asnjeri të mos hyjë në qorrerekak.

T'u vëmë veshin këtyre gjërave, shokë, se jemi njerëz politikë. Parulla të tillë i hedhin ose i shfrytëzojnë elementët armiq, se ato janë shprehje e qëllimeve dhe e ideologjisë së tyre. Për t'i kuptuar këto qëllime të armikut, njerëzit tanë duhet t'i kthehen teorisë marksiste-leniniste. Në raste të tillë mund të studiohen, për shembull, ç'është narodnizmi, ç'është teoria e Za-

suliçit, ku qëndron deviacioni i Plehanovit, ç'është teoria anarkiste e Bakuninit dhe cilat janë pikëpamjet marksiste të Leninit e të Stalinit mbi këto probleme. Kështu ngremë nivelin tonë ideoteorik.

Kini kujdes në këto çështje shokë, sepse zakonisht sekretari i parë, sekretarët dhe shokë të tjerë që punojnë në aparatet e Partisë ndodh që, duke iu turrur ekonomisë, lënë pas dore studimin, ngritjen e nivelit të tyre politiko-ideologjik ose sektorët e tjerë si arsimin, kulturën, drejtësinë e gjer shëndetësinë, sikur të ishin të huaj për këta sektore. Jo, shokë, nuk mund të ecet kështu. Partia, udhëheqja e saj, natyrisht, duhet të ketë kujdes dhe të japë ndihmën e vet për sektorin e ekonomisë, se pa ekonomi të fortë s'ka mbrojtje të fortë, por jo të lihen pas dore sektorët e tjerë që kanë rëndësi kolosale dhe janë të lidhur ngushtë me të. Prandaj interesimi i drejtuesve duhet të jetë i gjithanshëm.

Por, edhe mënyra e intercimit dhe e kujdesit që duhet të keni për të gjitha problemet e Partisë dhe të shtetit duhet ndryshuar krejtësisht, kryekëput. Po nuk bëtë një kthesë rrënjosore nga stili dhe nga metoda e vjetër e punës, në mos sot, nesër, ju do të bini në rutinën e vjetër të zgjidhjes së problemeve.

Ne nuk mund t'ju themi një nga një këto gjëra, se as nuk i dimë si duhet, si shfaqen te njëri apo te tjetri, por ju jeni më shumë në gjendje t'i dini se jeni në takime të përditshme me bazën. Kjo do t'ju hapë horizont t'i kapni të gjitha problemet, të studioni eksperiencën e më të mirëve, të ndihmoni dhe të keni syrin në të katër anët.

Do t'ju këshilloj një gjë: për të gjitha këto që janë thënë nëpër aktive, në mbledhjet që po bëjmë ose për ato që ju i keni lexuar nëpër dokumentet e Partisë duhet të thelloheni edhe më shumë. Ato mund të mos jenë fjala e fundit, por sidoqoftë janë mendime e konkluzione, të cilat kërkojnë një zhvillim të mëtejshëm në jetë, kërkojnë që të gjithë ne të reflektojmë mbi to, jo vetëm t'i lexojmë dhe shko tutje, jo të vuajmë nga megalomania e tmerrshme sikur këto gjëra i dimë mirë, se mund t'i dish në teori, por në jetë është e zorshme të zbatohen ato që di.

Dëshiroj t'ju pyes, që kur Byroja Politike analizoi çështjen e pushtetit, të këshillave popullore, keni menduar ju çfarë do të bëni për këtë problem? Jam më se i bindur se shumica nuk ka menduar. Po përse? «Sepse kemi gjithë këto punë përpara», thotë dikush. Po kush do të mendojë për to? Natyrisht, vetë ne. Udhëheqësi duhet të mendojë për të gjitha. «Këtë porosi të Komitetit Qendror ne e kemi parasysh — mund të thonë disa shokë — prandaj kur të vijë koha do ta zbatojmë». Po si do ta zbatoni? Ja do të thërrisni anëtarët e këshillit populor, atje do t'u paraqitni planin, do t'i pyesni kush ka vërejtje për të, kush nuk ka, do të vihet në votë dhe do të pranohet. Një praktikë e tillë ka qenë një metodë pune shumë e gabuar. Tani të gjithë i bien gjoksit dhe thonë sa gabim kemi bërë, por puna është të mendojmë thellë si t'i ndreqim gabimet se, për t'i ndrequ, duhet të punojmë.

Ta marrim çështjen konkretisht. Tani do të shqyrtohen plani dhe buxheti i vitit 1966, që do të diskutohen në Kuvendin Popullor. Do të vijnë, pra, në Ku-

vend deputetët nga të gjitha rrethet. Por vallë ju, keni menduar se çfarë do t'u thoni atyre? Ma merr mendja se asnje nuk e ka menduar këtë gjë. Po si do të bëhet një punë e tillë, shokë? Këto ditë plani do t'ju vijë nga Qeveria në rrethe. Gjer tani, kur vinte plani, mbledhej këshilli popullor, thuheshin pesë fjalë nga kryetari i komitetit ekzekutiv dhe me kaq puna mbaronte. Tani plani duhet t'u bëhet i njojur të gjithë këshilltarëve dhe deputetëve. Komiteti ekzekutiv i rrethit dhe sekretari i komitetit të Partisë që merret me këtë çështje konkretisht duhet t'ua shpërndajnë atyre planin që ta studijnë dhe të bëjnë një mbledhje të veçantë me ta, ku t'ua shpjegojnë e t'ua zbërthejnë planin dhe buxhetin e vitit 1966 në detaje, pastaj t'u qëndrojnë zjarrit të pyetjeve të deputetëve dhe të këshilltarëve, vërejtjeve të tyre, t'u japid shpjegime për to, si dhe për planin dhe buxhetin shtetëror, në mënyrë që t'i përgatitin deputetët qysh në rrëth (se të atij rrëthi janë) që ta kuptojnë planin, interesin e ndërtimit të kësaj ose të asaj vepre etj. Nga një punë e tillë ata do të vijnë në mbledhjen e Kuvendit Popullor të parapërgatitur. Përsëri edhe këtu do të fillohet një punë serioze me ta, plani dhe buxheti do t'u shpjegohen imtësisht edhe një herë, pastaj ata do të bëjnë vërejtjet e tyre, do të bëjnë kritika, kërkesa etj. Ministrat përkatës do të venë përpara deputetëve dhe do t'u japid shpjegime gjer në një vërejtjeve e kërkesave të tyre e këto do t'ia paraqesin në një mbledhje të veçantë Qeverisë, e cila duhet t'i gjykojë thellësisht ato. Pas kësaj shokë të kryesisë së Këshillit të Ministrave të venë në mbledhje të Kuvendit Popullor e t'u japid shpjegime deputetëve, duke

ua argumentuar një për një si arsyet e kërkesave që do të plotësohen, ashtu edhe ato që nuk do të merren parasysh.

Në këtë mënyrë do të bëhet një punë kolosale, sepse deputetët, si përfaqësues të popullit, do të kenë sjellë në mbledhjen e Kuvendit Popullor mendimet e masës. Edhe pas punimeve të Kuvendit, kur të kthehen në rrëth, ata duhet të venë të jatin llogari përpara zgjedhësve, gjë që në disa raste është bërë në mënyrë formale. Deputeti, kur shkon përpara zgjedhësve, të informojë për ato që u diskutuan në Kuvend, për situatën e vendit tonë, të japë llogari për plotësimin e kërkesave që bëjnë masat e jo ta kalojë radhën me një fjalim të thatë. Po të bëhet kështu, deputeti do të jetë në gjendje që, duke u orientuar drejt, t'i shtrojë popullit ç'u diskutua, ç'u vendos në mbledhjen e Kuvendit Popullor, përsë u vendos një gjë e tillë dhe çfarë duhet bërë për t'i realizuar planin dhe buxhetin e aprovuar.

Në mbledhjet e Byrosë Politike kemi theksuar se Partia duhet të interesohet veçanërisht për edukimin e kualifikimin e këshilltarëve. Kjo të mos kuptohet tanë: «Oburrani këshilltarët të futen në shkolla, të ndjekin shkollat 7-vjeçare apo të mesme», por t'i edukojmë ata me kuptimin politik e ideologjik të ligjeve tona, duke filluar që nga Kushtetuta e gjer te ligji më i thjeshtë.

Ligjin ekzekutivi ia paraqet Kuvendit Popullor. Ne po e rishikojmë çështjen e kompetencave të Kuvendit Popullor dhe të deputetëve. Këta duhet të vendosin për ligjet e jo të na ndodhë si gjer tani që i binte në mendje një drejtori se i duhej shtrënguar rry-

pi dikujt dhe i propozonte për këtë Qeverisë, e cila përgatiste një projektligj, politikisht të mirë, të drejtë, por ama të parakohshëm. Kur populli shfaqte mendimin për ndonjë nen të tij që i dukej i padrejtë, i thoshin se atë e ka parë Partia. Kuvendi Popullor për asnjë rast të tillë të mos heshtë. Deputeti është njeri patriot, prandaj asnijëherë nuk duhet të qëndrojë duarlidhur kur dikush nuk e dëgjon zërin e masës. Populli atë e ka ngarkuar me një detyrë shumë të rëndësishme, prandaj ai, duke ditur mirë brendinë e ligjeve, ka të drejtë dhe detyrë të çojë në Kuvend zërin e popullit për atë ligj që po përgatitet. Kështu ai sjell para Partisë dhe Kuvendit Popullor zërin e masave. Shikoni, pra, ç'rol të madh luajnë deputetët. Këtë rol nuk duhet ta neglizhojmë. Mund të ndodhë, gjithashtu, që populli i një krahine të ngrihet në një mbledhje e të kërkojë nxjerrjen e një ligji, por në qoftë se atij i thuhet që për ligjet mendon Partia, mendon Qeveria, atëherë këtë propozim e merr era. Në këtë rast deputeti ka të drejtë t'i bëjë letër Presidiumit të Kuvendit Popullor, t'i thotë se populli që e ka zgjedhur i ka kërkuar të bëhet një ligj për një çështje të caktuar duke dhënë mendimin e popullit dhe të vetin për të mirat që do të sjellë ky ligj. Presidiumi i Kuvendit Popullor e ka për detyrë të dërgojë njerëz ta studiojnë në vend propozimin e bërë, të dëgjojnë ç'mendon populli dhe në qoftë se rezulton se ai është një ligj që duhet bërë, atëherë Presidiumi i drejtohet Komitetit Qendror të Partisë dhe Qeverisë me mendim të favorshëm që këtë ligj e do populli, prandaj ai duhet të dalë. Anasjelltas populli e thotë mendimin e tij edhe për një ligj që nuk gjen zbatim, që

nuk mbështetet nga masat, por rëndësi ka kujt do t'ia thotë këtë. Pikërisht deputeti i asaj zone e ka për detyrë ta dëgjojë këtë zë dhe bën një letër në të cilën shfaq mendimin e masave se ky ligj nuk është i mirë, se me zbatimin e tij po shkëlet vija e Partisë dhe propozon që një ligj i tillë të abrogohet. Por a veprohet kurdoherë kështu? Pra, Partia të kujdeset për zërin e masave, të mendojmë e të punojmë që ky zë të shkojë atje ku duhet dhe të vihet sa më parë në jetë dëshira e popullit.

Kur propozohet diçka nga masa dhe sekretari i komitetit të Partisë të rrëthit e neglizhon, nuk mendon përtë, atëherë ai nuk meriton të jetë më sekretar. Këtë duhet ta mendojmë mirë ne që jemi zgjedhur nga Partia. Ai që nuk e kryen detyrën, duhet të zëvendësohet. Partia, shteti dhe populli duhet të të japid aq sa meriton. Po nuk e kreve detyrën, asgjë nuk të jepet. Për luftën që ke bërë, populli të nderon, por që të neglizhosh detyrën që të ka ngarkuar sot Partia dhe të mbështetesh tek e kaluara, këtë nuk mund ta lejojmë. Duhet me qenë kurdoherë shërbëtor i popullit. Në këtë çështje duhet thelluar mirë, si politikisht, ashtu edhe teorikisht dhe ta zbatojmë atë në jetë. Edhe ne, edhe ju, duhet të jemi vigjilentë, ju të na shkundni kur nuk jemi në rregull, po kështu edhe ne ndaj jush. Vigjilanca duhet të vijë zinxhir në këto hallka. Aq më tepër duhet të tregojmë kujdes kur na vijnë sinjalizime nga masa. Masat kanë respekt për udhëheqjen, megjithatë, kur vërejnë gjëra të padrejta, ato sinjalizojnë, por hallkat dhe lidhjet me to ne nuk i përdorim si duhet, në mjaft raste i kemi atrofizuar, prandaj t'i gjallërojmë.

Në praktikë ndiqet një metodë e tillë: gjykatësit mbajnë konferenca për t'ia bërë popullit të njoitura ligjet tona. Por shpeshherë kjo punë bëhet në mënyrë të çalë. E kam fjalën sidomos për ligjet me të vërtetë të rëndësishme, për zbërthimin e të cilave në popull duhet të aktivizohen shumë edhe deputetët. Këta duhet të punojnë dhe të japid mendime për një ligj, jo vetëm kur vijnë në mbledhjen e Kuvendit Popullor, por cdhe në takimet dhe në bisedat e ndryshme me popullin. Deputeti duhet ta zotërojë mirë përbajtjen e ligjit dhe për këtë duhet të kujdeset Partia në rreth. Kur përgatitet të dalë një ligj i ri, projekti duhet t'i jepet deputetit një muaj përpara dhe jo ditën e fundit, me qëllim që ai të ketë kohë ta studiojë, ta kuptojë e ta njoë mirë atë projekt. Gjithashtu, sekretari i parë ose një sekretar tjetër i komitetit të Partisë të rrethit duhet të organizojë menjëherë një diskutim me deputetët e rrethit për projektligjin, në mënyrë që këta të shkojnë të përgatitur mirë në zonat e tyre elektorale, të mbledhin masat që i kanë zgjedhur, t'u tregojnë e t'u shpjegojnë projektin dhe të kërkojnë mendimin e zgjedhësve për të. Populli do të diskutojë për këtë ligj dhe secili do të japë mendimin e vet. Këto mendime deputeti i merr dhe i çon në Kuvend. Me këtë mënyrë deputetin ne e kemi edukuar që vërejtjet e popullit t'i dëgjojë me kujdes dhe t'i sjellë në organin më të lartë të pushtetit, në Kuvendin Popullor. Këtu të organizohen seanca të tillë pune ku deputetët të thonë çdo gjë që kanë për këtë ligj, të shoshiten anët e mira dhe të këqija, me qëllim që nga kjo punë të dalë një ligj me të vërtetë popullor. Pastaj në seancën plenare deputetët

do të dinë të flasin dhe ta mbrojnë ligjin. Kështu Ku-vendi do të nxjerrë një ligj të pranueshëm nga i gjithë populli, të kuptueshëm qysh më parë dhe të zbatueshëm. Pra, po të veprojmë kështu, do të bëjmë ligje të mira, të cilat i do populli.

Sa djersë e dituri na duhen neve të harxhojmë që të edukojmë jo vetëm deputetët, por një popull të tërë, që ta bëjmë atë të zotin të kuptojë e të gjykojë, të marrë vendime të drejta dhe t'i mbrojë ato. Kjo nuk është një çështje e vogël. Sa më shumë të mendojmë, aq më madhështore dalin via dhe parimet leniniste të Partisë sonë në të gjitha çështjet. Mjaft prej këtyre çështjeve gjer tani ne u kemi shkuar përciptas, po nuk duhet ecur më kështu.

Si këto janë me qindra problemet që kemi përpara, të vogla e të mëdha. Ato ne do t'i zgjidhim duke bërë një kombinim të drejtë të tyre mbi bazën e parimeve marksiste-leniniste, me një logjikë të fortë, me një organizim të shëndoshë të punës. Nuk është se ne nuk kemi eksperiençë dhe pjekuri, vetëm duhet bërë një kthesë, një hop përpara në cilësi. Kemi mundësi ta bëjmë këtë? Po, kemi.

Këto kisha për të thënë shokë. Në këto mbledhje që po bëjmë flasim vetëm ne, kurse ju, meqenëse jeni shumë, thoni: «E po kush të flasë më parë nga ne? Pastaj, çfarë të themi?». Ne, për çdo problem që na del duhet të mendojmë dhe njëkohësisht të flasim. Më duket se edhe në këtë drejtim duhet të ndryshojmë metodën. Ju do të vini këtu në qendër, edhe ne do të vijmë në rrethe, edhe ju të na dëgjoni ne, po edhe ne duhet t'ju dëgjojmë ju. Ta shkatërrojmë, shokë, atë

mentalitet të gabuar se po vini në Komitetin Qendror vetëm që të merrni udhëzime. Nuk duhet thënë: «Për çdo gjë mendon Komiteti Qendror». Këtë mendim duhet ta çrrënjosim mirë nga koka. Këtu nuk është çështje personash, formulash. Këtu kemi të bëjmë me Partinë, shokë, dhe në Parti mendimet duhet t'i themi haptazi, po ashtu edhe vërejtjet, kritikat që kemi për çdo gjë, kundër kujtdo qoftë t'i themi haptazi, propozimet t'i bëjmë haptazi, të diskutojmë çfarë është e drejtë e çfarë jo, dhe të vihen në jetë ato që janë në interes të Partisë.

Prandaj herë tjetër mendoj të mos bëjmë si gjer tani me këto mbledhje. Jemi dakord?

Aparatet e komiteteve të Partisë në rrethe, në përgjithësi po forcohen, megjithatë akoma mund të bëhen disa plotësime. Mos u qani për një kuadër ose dy. Nuk është një njeri ose dy që do t'ju shpëtojnë nga situata. Ne mund t'ju japim edhe tre kuadro se për tre veta nuk prishet Shqipëria, por nuk qëndron këtu çështja. Puna është që kuadrot që keni t'i aftësoni, t'i ndihmoni, t'i bëni të zotë ta kryejnë detyrën. Të tërë ta kuptojnë mirë këtë situatë, këtë revolucionarizim të madh që kërkohet të bëhet te ne.

Botohet për herë të parë si-pas originalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LUFTËRAT E DREJTA QË BËJNË POPUJT I AFROJNË E I LIDHIN ATA MË SHUMË ME NJËRI-TJETRIN

*Nga biseda me ambasadorin e Republikës
Islamike të Pakistanit*

26 shkurt 1966

*Pasi ambasadori pakistanez shprehu gëzimin që i
jepej rasti të takohej me udhëheqësin e popullit shqiptar,
fjalën e mori shoku Enver Hoxha:*

Ardhja juaj në Shqipëri është një gëzim për ne. Vendimi i qeverisë suaj për lidhjen e marrëdhënieve diplomatike, në rang ambasadorësh, midis Republikës Islamike të Pakistanit dhe Republikës Popullore të Shqipërisë, është çmuar shumë nga Presidiumi i Kuvendit Popullor, nga Qeveria dhe nga i gjithë populli ynë.

Popujt tanë dhe përgjithësisht popujt, sado larg të jenë, nga vetë natyra e tyre, e duan njëri-tjetrin. Kjo e ka bazën edhe te vuajtjet e njëjta që kanë kaluar ata gjatë shekujve, te luftërat e pandërprera që kanë bërë për çlirim e përparim.

Duke e parë historikisht të kaluarën del se popujt

tanë e kanë ndierë në kurri zë shtypjen nga ana e imperialistëve dhe nga klikat shoviniste, qoftë të vendeve fqinje, qoftë të vendeve të largëta. Një fat i tillë i përbashkët i afron, i lidh edhe më shumë ata.

Ndjenjat e miqësisë midis popujve tanë janë reciproke. Ne jo vetëm tani, por prej vitesh kemi vënë re dashurinë vëllazërore dhe të nxeh të që ushqehet nga ana juaj për popullin shqiptar. Ndjenjat e simpatise dhe të respektit për të, ambasadorët pakistanezë, ua kanë shprehur kudo ambasadorëve tanë. Këto janë të njëjta me ndjenjat që ushqejmë edhe ne për popullin tuaj.

Për të forcuar më shumë miqësinë, ne përpinqemi t'ia bëjmë të njojur popullit tonë të kaluarën e lavdëshme dhe të tanishmen e popullit pakistanez. Në përgjithësi, njerëzit tanë nuk e kanë njojur mirë historinë e vjetër të popullit tuaj, i cili qysh tre mijë vjet para erës së re ka krijuar një qytetërim të madh siç vërtetohet sot, ndër të tjera, edhe nga gjermimet arkeologjike në Harapa¹ e gjetkë.

Por historinë tuaj të sotshme plot luftëra dhe vuajtje masat tona punonjëse e njojin mirë, sepse Partia jonë ua ka shpjeguar vazhdimisht. Ato e dinë se si imperialistët anglezë e kanë shtypur dhe e kanë mbajtur në skllavëri të rëndë koloniale për vite e vite me radhë popullin tuaj dhe popuj të tjerë fqinjë dhe se, kur u detyruan të largoheshin, lanë prapa, përvëç prapambet-

1 Qytet i lashtë në bregun e lumit Ind. Në kohën e lulëzimit, midis mijëvjeçarit të 3-të dhe të 2-të para erës së re, ka qenë një ndër qendrat më të rëndësishme tregtare të asaj kohe. Shquhej për urbanistikën e tij shumë të zhvilluar.

jes e mbeturinave koloniale, edhe probleme kufitare të pazgjidhura midis popujve e vendeve të këtij rajoni. Sot, vërtet ka pushuar zjarri në kufirin midis vendit tuaj dhe Indisë, por për një gjë të tillë u desh të derdhej gjaku i pastër i popullit pakistanez.

Ne ju themi sinqerisht, zoti ambasador, se populli shqiptar është prekur jashtëzakonisht dhe ka jetuar së bashku me ju, me shqetësimet tuaja gjatë momenteve tragjike të vjeshtës së kaluar, kur Pakistani u sulmua pabesisht nga agresorët indianë. Në momentet e vësh-tira të përballimit të këtij agresioni, populli shqiptar i dha gjithë përkrahjen e mundshme morale e politike po-pullit tuaj dhe u gëzua pa masë, kur ai, me luftën e tij burrërore në mbrojtje të atdheut, i detyroi ushtritë indiane të luftonin në tërheqje dhe reaksionin indian të pushonte zjarrin. Ne, vazhdimisht, kemi pasur bindjen se fitorja do të ishte nga ana juaj, sepse e drejta ishte me ju dhe jo me shovinizmin indian.

Sulmi indian kundër Pakistanit synonte ta likui-donte Pakistanin si shtet të pavarur, të zhdukte sovra-nitetin e popullit tuaj dhe të realizonte qëllimet ekspan-sioniste të imperialistëve amerikanë, indianë dhe të revisionistëve sovjetikë, por veprimet armiqësore të ty-re nuk e mposhtën dot vendin tuaj. Për të mbuluar disfatën që pësuan reaksionarët indianë në sulmin kundër jush, imperialistët amerikanë dhe revisionistët so-vjetikë organizuan takimin e Tashkentit. Por këtu, për-veç deklaratës me fraza të përgjithshme, nuk u arrit në asnje përfundim, sepse problemi i Kashmirit, për-të cilin u organizua kryesisht takimi, mbeti i pazgji-dhur.

Ne ndjekim me simpati përparimet e vendit tuaj, gëzohemi për përpjekjet e popullit pakistanez dhe urojmë që ai të jetojë gjithnjë e më mirë. Ne njëkohësisht jemi në dijeni për mjerimin e varfërinë e madhe që rëndoijnë mbi popullin indian. Çdo mbrëmje edhe Radio Roma flet për lëmoshat që gjoja Italia u jep Indisë dhe indianëve që vdesin nga uria.

Te shqiptarët, edhe në të ardhmen, populli pakistanez do të gjejë kurdoherë miq të mirë. Pavarësisht se sistemet tona nuk janë të njëjta, ne përpinqemi për forcimin e miqësisë me vendin tuaj dhe vëmë re që edhe qëndrimi i qeverisë suaj është dashamirës ndaj nesh. Miqësia midis vendeve tona e ka bazën në respektimin me rigorozitet të barazisë, të sovranitetit dhe të mosndërhyrjes në punët e brendshme të njëri-tjetrit nga qeveritë e të dyja palëve. Të jeni pra të sigurt se te ne, te populli ynë, ju do të gjeni kurdoherë ndjenja dashurie vëllazërore për popullin dhe vendin tuaj.

Duke marrë fjalën ambasadori pakistanez e falënderoi shokun Enver Hoxha për fjalët dhe për ndjenjat e miqësisë që shprehu, si dhe për përkrahjen që i kanë dhënë Qeveria Shqiptare dhe populli shqiptar çështjes së drejtë të popullit pakistanez. Pasi foli gjerësisht mbi synimet e imperialistëve amerikanë, anglezë dhe të reaksionit indian ndaj vendit të tij, përsëri e mori fjalën shoku Enver Hoxha:

Ju, zoti ambasador, që jeni akredituar si përfaqësues i qeverisë pakistaneze në Shqipëri, konsiderojeni vreten këtu si në vendin tuaj. Nga ana jonë, ne do të bëjmë të gjitha përpjekjet që marrëdhëniet miqësore midis dy vendeve t'i forcojmë gjithnjë e më shumë.

Kjo është një detyrë e përbashkët e të dyja palëve. Jam i bindur se edhe ky takim do të ndihmojë në këtë drejtim. Gjer tani ne kemi pasur vetëm pak marrëdhënie ekonomike me Pakistanin, por dëshirojmë që ato kurdoherë t'i zgjerojmë. Sidoqoftë, në çdo rast, te ju ne kemi gjetur një mirëkuptim dhe qëndrim miqësor.

*Botohet për herë të parë si-
pas shënimeve të mbajtura në
këtë takim që gjenden në AQP..*

KY ËSHTË NJË PLAN I BALANCUAR, TEK I CILI KEMI BESIM E SIGURI

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

28 shkurt 1966

Do të thosha se ky është një plan i balancuar, është një plan tek i cili kemi besim e siguri. Megjithatë duhen bërë korrigjime, disa nga të cilat mund të bëhen në këtë projekt, disa të tjera mund të lihen për t'u bërë në projektpalin pesëvjeçar. Prandaj mendoj që Qeveria t'i shikojë mundësitë në lidhje me një numër propozimesh që u bënë këtu, q'mund të bëjmë tanit dhe q'perspektiva mund të na hapen kur të marrim në studim planin pesëvjeçar. Në rrugën e këtyre propozimeve kisha edhe unë disa gjëra për të thënë.

Për energjinë elektrike mund të pranojmë që të mbahet si rezervë 10-15 për qind e saj, e cila para-

1 Në këtë mbledhje u shqyrtuan projektplani dhe projekt-buxheti i shtetit për zhvillimin ekonomik dhe kulturor të RPSH për vitin 1966.

shikohet për të përballuar të papriturat, por të studiohen mundësia që këto rezerva të shfrytëzohen në mënyrë racionale dhe me ekonomi për shtimin e prodhimit ose për nevojat komunale. Këtu nuk e kam fjalën për ta përdorur këtë rezervë në industrinë e madhe, po të shikojmë se çfarë mund të bëjmë me të në ndërmarrjet e vogla. Të bëhet gjithashtu edhe ndonjë studim ekonomik ku dhe si mund të përdoren rezervat e TEC-eve që kemi.

Nuk është e domosdoshme që energjinë e telpërt elektrike ta përdorim si në dimër dhe në verë. Këtë mund ta përdorim edhe vetëm në dimër, sepse në këtë kohë kapaciteti i saj është i madh, mbasi rezervuarët e hidrocentraleve janë të mbushur me ujë. Mundet që në dimër energjinë elektrike ta përdorim për ngrohje, mund të mendohet për të ndihmuar bujqësinë dhe ndërtimin, mundet që disa objekte të vogla industriale në fshat të punojnë me këtë energji etj. Ja, këtu është qëllimi i vërejtjes sime për këtë çështje.

Për sa i përket lëndës së drurit, raporti midis asaj që pritet dhe asaj që sharrohet më duket se është shumë i disfavorshëm. Teknikisht si janë këto proporcione, si janë të vendosura këto norma, apo mos abuzohet në caktimin e standardeve? Jam i bindur se lënda që presim në pyje nuk shfrytëzohet në mënyrë racionale dhe me ekonomi, por ka shpërdorim të madh të saj në të gjitha drejtimet. Prandaj, që të mos ketë abuzime, keqpërdorime, firo të mëdha, këtë problem ta shikojmë më nga afër e me kujdes, se lënda e drurit është deficitare dhe një nga faktorët kryesorë të ndër-

timit e të bujqësisë. Ne shohim qimen në vezë në shumë gjëra të tjera, kurse këtë çështje që ka kaq shumë rëndësi, që ka të bëjë me miliona, nuk e shohim fare.

Për ndërtimin e veprave ujitëse përse të mos caktohen disa kritere, për shembull, në cilat objekte do të paguajë shteti të tëra shpenzimet dhe ku pjesërisht, duke caktuar edhe shpenzimet që duhet të përballojë fshatarësia, si për punën e krahut etj., kurse shteti të vërë në dispozicion të tjerat si kuadro, specialistë, traktorë, buldozerë. Kjo është e nevojshme të bëhet se nuk është e drejtë që shteti t'i paguajë të gjitha, kurse fshatarësia, e cila do të përfitojë prej këtyre veprave, të mos paguajë asgjë. Duhet parë gjithashtu çështja se ku do të ndërtohen këto vepra ujitëse. Kur këto ndërtohen në disa kooperativa të pasura bujqësore, do të ishte e drejtë që të paguhej çdo gjë nga shteti? Jo, sidomos në këtë rast nuk do të ishte e drejtë. Këto fonde do të ishte më e arsyeshme të kalonin në disa zona ku kooperativat bujqësore janë më të dobëta nga ana ekonomike dhe kooperativistët marrin pak përditë-punë. Për veprat ujitëse që do të ndërtohen në këto zona unë jam dakord që fshatarësia të mos paguajë, kurse për ato që do të ndërtohen në zonat e pasura duhet të shihet kjo çështje.

Për sa u përket autobusëve ne ata do t'i sjellim nga jashtë, po vetëm aq sa na nevojiten për t'i vënë në përdorim në rrugët nationale, prandaj ne duhet t'i shkurtojmë autobusët në linjat e vogla. Disa gjëra si këto ne nuk duhet t'i konsiderojmë si ulje të nivelit të jetesës. Lidhur me lehtësitë në zhvillimin e komuni-

kacionit, duhet të nisemi nga parimi që të ndihmojmë lëvizjet e nevojshme.

Përveç këtyre kisha edhe disa pyetje. Përse dosat si numër mbeten nën nivelin e 1965-s? Përse në ndërmarrjet bujqësore po vazhdohet të subvencionohet miishi i derrit? Si ndodh që në disa kooperativa bujqësore rritja e derrit del me leverdi? Jam dakord që subvencionin duhet ta heqim kur numri i dosave qëndron në vend, ndryshe ku është lufta që duhet të bëjë sektori shtetëror për shtimin e tyre? Rëndësi ka çështja që me 2 ose 2 kilogram e gjysmë ushqim të marrësh 1 kilogram mish, kurse sot harxhohet 4 kilogram ushqim dhe nuk merret 1 kilogram mish.

C'janë këto makineri që na thuhet se po i sorrollatin në portin e Durrësit dhe përse makineria përnjë fabrikë të re çimentoje, për të cilën është dhënë urdhër të ndërtohet, po rri kot? Që të na trimiqisen gjithë këto makineri dhe personat përgjegjës të mos interesohen për to, kjo nuk lejohet. Ne ato i kemi sjellë me devizë, prandaj të merren masa sa më parë. Në se konsistojnë 140 milionë lekë të reja që parashikohen të shpenzohen për punimet gjeologjike, mos janë të ekzagjeruara? Nuk e kam çështjen te disa puse dhe te shtimi i rezervave të bakrit, por tek ajo se mos këto kërkime gjeologjike janë të shumta në krahasim me ato që futen në shfrytëzim. Përse industria ka një nivel shpërndarjeje të njëllojtë me 1965-n, kurse kapacitetet e saj shtohen? Të na jepen disa shpjegime mbi fitimet e 1966-s, është paraparë që këto të kalojnë në buxhet? Përse SMT-të financohen me 102 milionë lekë të reja? Në qoftë se shtetit i duhet t'i finan-

cojë përsëri, kjo duhet t'u shpjegohet fshatarëve, se ata, po nuk e ditën këtë gjë, mund të na thonë pastaj se shteti po na e merr grurin fare lirë, kurse indirekt ia merr më shtrenjtë sepse, në qoftë që, sipas rregullit, fshatari do ta paguajë SMT-në aq sa i kushton shtetit, atëherë gruri do të kushtojë më shumë. Pse kooperativat artistike kalojnë në buxhet?

C'janë këto çmime të reja me shumicë për të cilat flitet në materialin e paraqitur? Byroja Politike duhet të dijë për llogaritë që bëni ju me çmimet si për çmimet me shumicë ashtu dhe për çmimet me pakicë. Kjo do të na ndihmojë të japim një orientim që zërat e formimit të çmimeve të reduktohen e të bëhen sa më të kuptueshme. Nga këto reduktime do të mund të ndërtohen pastaj edhe çmime të reja me shumicë. Nga e gjithë kjo llogari na del edhe një fond disponibël, i cili mund të përdoret kryesisht për ngritjen e nivelistët jetesës së punonjësve. Qeveria është mirë ta bëjë këtë llogari dhe të dalë me propozime konkrete.

Të shihet gjithashtu edhe çështja e amortizimit, sepse është gjetur rruga që ai të qëndrojë në një përqindje të caktuar vite më parë, ndërsa ne mund të vendosim që kjo përqindje të ndryshojë, dhe si pasojë, do të ndryshojë edhe kostojë. Në përgjithësi nuk e kam të qartë se mbi çfarë baze i përcaktojmë ne afatin e përdorimit të makinerive e të pajisjeve si dhe normën e amortizimit. Ka rëndësi të madhe nëse këtë afat e cakton për një kohë të shkurtër apo për një kohë të gjatë. Për këtë ne nuk duhet të bazohemi në të dhënat e sovjetikëve ose të kinezëve, po në kushtet konkrete të vendit tonë. Fabrikën e tekstileve sovje-

tikët që e prodhojnë vetë mbështetje e hedhin poshtë pas disa vjetësh, kurse ne mund ta mbajmë e ta shfrytëzojmë për shumë e shumë vjet. Nga rishikimi i normës së amortizimit mund të na dalin disa të ardhura që mund t'i shfrytëzojmë gjetiu. Në qoftë se e bëjmë këtë, atëherë të gjithë fondin e amortizimit, që mund të na krijohet nga këto industri që kemi ndërtuar, ta zëmë se do të dalë 10-15 milionë lekë, mund ta disponojmë për uljen e çmimeve. Këtë ulje ne mund ta bëjmë pjesërisht në disa lloje mallrash, ndërsa për disa mallra të tjera, çmimet mund të mos lëvizin. Çështja është që çmimet t'i vendosim sa më drejt, sepse kjo është një politikë e tërë, një nga problemet politike më të mëdha. Shteti ynë lufoton për rritjen vazhdimisht të nivelistë jetesës së popullit, por këtë nuk mund ta bëjë në mënyrë automatike, prandaj në Byronë Politike duhet të na jepen disa arsyё që ta bëjmë të bazuar këtë.

Ne na preokupon shumë problemi i çmimeve, që në përgjithësi u ngrit këtu. Duhet të shihet me kujdes ç'mundësi ka që të bëhen ulje çmimesh dhe të luftohet në këtë drejtim. Uljen të mos e bëjmë më sipas parimeve të gjertanishme, pra të ulim çmime jo në bllok zérash njëherësh, po në ato sende për të cilat kemi mundësi e leverdi dhe herë pas here. Sot, fjala vjen, ulim 10 milionë lekë të reja, pasnesër dy milionë lekë të reja të tjera. Ulje çmimesh duhet të bëjmë edhe për ato mallra që tërhiqen më pak e që kemi stoqë, gjersa të mbarohet një stok që ne duhet ta eliminojmë. Ne, pra, t'i ulim çmimet, herë pas here, sidomos në disa mallra konsumi, por këto ulje të mos i bëjmë pa llogari, të shikojmë mënyrën si duhet t'i

bëjmë. Ne nuk duhet të ulim çmimin e çdo lloji këpucësh që janë prodhuar me një vlerë të caktuar, sepse ka këpucë e këpucë. Ato këpucë që na mbeten pa shitur, për arsy se çmimi i tyre është i lartë, t'i ulim dhe kush mori, mori, veç diçka do të ngrihet niveli i atyre që do t'i blejnë ato.

Mund të na thuhet se duhet të kemi shumë mallra që t'i ulim çmimet, po sasia e mallit nuk na pengon, se ne nuk do t'i ulim ato për të tëra mallrat, sepse disa janë të cilësisë së mirë, disa jo. Mallrat me cilësi të dobët përse të mos i shesim më lirë? Ne të përpinqemi për cilësinë, po nuk është e mundur të mos kemi mallra të një vlere më të ulët dhe pikërisht për një sërë mallrash të kësaj kategorie të ulim çmimet.

Ne duhet të shohim edhe shumë drejtime të tjera ku mund t'i ulim çmimet. Kjo do të thotë që për këtë qëllim Qeveria të krijojë një rezervë akoma më të madhe. Kjo rezervë të shërbejë për të shtuar rezervën e fondit të investimeve për këtë vit, po edhe për shtimin e rezervës për vitin e ardhshëm. Qëllimi është që të forcohet ekonomia jonë, të kemi mundësi për një sasi më të madhe disponibiliteti jo vetëm në lekë, po edhe në rezerva materiale, një pjesë të të cilave ta vëmë në dispozicion për uljen e çmimeve. Po edhe kjo nuk është e mjaftueshme. Prandaj mund të shohim edhe gjëra të tjera që, në mos sivjet, për vitin e ardhshëm t'i shtojmë fondet rezervë të Qeverisë. Këto mund të kenë një ndikim negativ për disa kategoritë njerëzish, po na duhen t'i rezervojmë veçanërisht për të realizuar ngritjen e nivelit të jetesës së masave, qoftë në drejtim të uljes së çmimeve, të ngritjes së

pagave të ulëta, pensioneve etj. Pagesat për nënët me shumë fëmijë dhe ndihma për fëmijët e të tjera si këto, duhet të studiohen. Mund të mos i heqim të tëra, po t'i reduktojmë në disa variante. Pra, në qoftë se bëhet një gjë e tillë, rezervat do të rriten. Pastaj me uljen e pagave të larta, ne mund të arrijmë që rezerva e Qeverisë të shtohet akoma. Nga kjo rezervë të mbahet diçka për shtëpitë e pushimit dhe kopshtet, të jepen disa ndihma për nënët me shumë fëmijë dhe me të tjerat të kemi një disponibilitet për të pasur në dorë një rezervë të caktuar, kurse pjesa tjetër që mbetet të disponohet nga Qeveria për disa boshllëqe qëjeta ka treguar se shteti duhet t'i plotësojë financiarisht. Prandaj rezervat janë të domosdoshme. Në qoftë se ne i mbajmë këto dhe i grumbullojmë në dorë të Qeverisë, atëherë do të kemi mundësi të ulim disa çmime, por me kusht që këto mallra, të cilave do t'ua ulim çmimin, të mos kapin tërë sasinë e një grupei mallrash, se ka mundësi të mbeten dyqanet bosh për disa prej tyre.

Po t'i shikojmë më mirë këto çështje, mund të na krijohen edhe mundësi të tjera për ngritjen e nivelistët të jetesës për qytetin dhe për fshatin brenda tërë pesëvjeçarit të katërt. Ne mund të shikojmë edhe përqindjen që japim për rritjen e investimeve dhe ngritjen e nivelistët të jetesës së popullit. Studiojeni edhe çështjen e tatimit për zonat malore. Ne mund t'i falim të gjitha tatimet, por në këtë rast ato duhet të investohen për të ngritur ekonominë e fshatit.

Një nga çështjet që duhet të na preokupojë seriozisht është edhe ajo e rrobave të gatshme. Na thuhet

se nuk mund të rritet prodhimi në seri i konfekSIONEVE të pambukta dhe të leshta, sepse një pjesë e tyre kanë mbetur gjendje dhe ka rrezik të shtohen stoqet. Po ç'do t'i bëjmë ne këto rroba që kanë mbetur gjendje, do t'i lëmë të na myken? Po këpucët stoqe përse të vazhdojmë t'i mbajmë nëpër depo? Më duket se duhet ta zgjidhim mirë çështjen e stoqeve. Mallrat e zhvleftësuara nuk mund të shiten me të njëjtin çmim, prandaj duhet të mendojmë që të ulim çmimet e tyre. Pra vihet pyetja: Është më mirë që këto t'i mbajmë stoqe, kështu siç i kemi, apo t'ia japim popullit, qoftë edhe duke pasur humbje? Më mirë t'ia japim popullit. Zhvleftësimi te ne duhet të luftohet dhe të mos matim shijet e disa qytetarëve me ato të pjesës më të madhe të popullit, se populli ynë është i thjeshtë. Një fshatar, kur sheh një gjë më të lirë, e merr. Kjo mendoj se ka rëndësi përgjritjen e nivelit të jetesës së popullit tonë. Krahas kësaj mase për uljen e çmimeve, të mendohet si të luftohen stoqet. Kjo arrihet jo duke u justifikuar se rrobat dolën jashtë mode, por duke i studiuar kërkesat e tregut dhe duke nxjerrë rroba të qepura bukur, me cilësi, që ato të plotësojnë edhe shijet estetike të popullit, i cili e do të bukurën dhe të thjeshtën.

Të marrim tanë çështjen e rendimentit. Ka kontroll për këtë apo jo? U soll këtu si shembull fabrika e këpucëve, e cila prodhon këpucë me numër 39 e lart se me këto ka leverdi për realizimin e rendimentit. Po këpucët me numër të vogël kush do t'i prodhojë? Kur ne t'i caktojmë fabrikës së këpucëve në plan që të prodhojë 500 mijë palë këpucë të mëdha dhe 300 mijë palë këpucë me numra të vegjël, atëherë nga

këto shifra ajo duhet ta nxjerrë vetë rendimentin mesatar, por llogari do t'i kërkohet patjetër për assortimentet e planifikuara. Këtë duhet ta shikojmë, se kemi me vite që po flasim për këpucët e kalamanëve. Këpucët me numra të vegjël duhet medoemos t'i realizojmë si sasi e cilësi dhe çmimet gjithashtu të realizhen sikurse janë paraparë.

Atyre ndërmarrjeve që ua keni ndarë planin në fizik dhe në vlerë, iu është lënë e drejta që 25 për qind të planit të prodhimit ta zbërthejnë vetë për të përballuar nevojat e konsumatorëve. Këtë ia kérkonin jo të specifikuar, por si vlerë prodhimi. Meqenëse të tërë sa keni pyetur në konsulta janë dakord, le të mbetet 25 përqindshi. Por unë doja të pyesja, do t'i kemi paskëtaj të gjitha llojet e kërkuara të mallrave të konsumit të gjerë që prodhon industria, nuk do të na mungojë gjë më në treg dhe, kjo gamë e gjerë mallrash do të realizohet me këto çmime që kemi? Ne duhet të bëjmë kujdes që 25 përqindshi i planit të prodhimit që ato do të caktojnë vetë të mos na shkojë 60 për qind. Këto duhet t'i arrijmë sipas parashikimit. Jam dakord me atë që thoni ju, po në këtë gamë të madhe nuk e di sa të saktë e keni që në këto 25 për qind të planit të prodhimit nuk do të ketë ndikim në rendiment.

Në qoftë se pranojmë që fabrikat e këpucëve nuk kanë leverdi të prodhojnë këpucë për të vegjël, prandaj i subvencionojmë, atëherë pse ndodh që plani i këpucëve për fëmijë nuk realizohet, megjithëse shteti i subvencionon këto? Këtu nuk është çështja se sasia e planit për këto këpucë është e vogël, çështja është

se ato nuk prodrojnë as këtë sasi të vogël që u është caktuar. Por nuk janë vetëm këto pengesa që nuk realizohet rendimenti. Në radhë të parë është mungesa e një pune të madhe politike me të gjithë punëtorët, se ndodh që nga kjo mungesë edhe punëtori i mirë punon keq, nuk e përdor mirë makinën etj., ose ka raste që punëtori vjen në punë kur i do qejfi, makineria nuk shfrytëzohet plotësisht, nuk përkrahen propozimet për përdorimin racional të lëndës së parë, për novacione etj. Kur propozimet për novacione nuk pranojen, atëherë merret fuqi punëtore plus. Por kostoja varet edhe me sa punëtorë do të realizohet një mall. Këtë tani e ka në kompetencë ministria, e cila, duke pasur një rezervë të madhe rendimenti, për shembull, nga Bulqiza ose nga miniera e bakrit, fare mirë mund t'ua ulë e t'ua kompensojë sektorëve të tjerë. Të gjithë këta faktorë, të marrë së bashku, sjellin mosrealizime të planit, kurse drejtoret e ndërmarrjeve të thonë se «na janë bërë pengesë disa punëtorë që i kemi mangut». Këtu nuk është çështja se nuk u dhamë 3 ose 5 punëtorë, prandaj nuk u realizua plani, por siç e thamë, ka shumë arsyet e tjera të rëndësishme, një prej të cilave është edhe çështja e kuptimit politik, e shkallës së ndërgjegjes së punëtorëve, që i bën ata t'i prodrojnë ose të mos i prodrojnë këta lloj artikujsh.

Ne kemi filluar të bëjmë diçka edhe për strukturen e këpucëve, po si me turp po i futim në qarkullim ato me copë pëlzure, me gomë dhe me plastikë. Kleringun ose devizën që harxhojmë ne për importimin e lëndës së parë për këpucët mund ta balancojmë më mirë, për të shtuar prodhimin e këpucëve sintetike, si-

domos për kalamanët, të cilat i subvencionojmë. Kështu të shihet q'mundësi ka që të bëjmë më shumë këpucë për kalamanët, jo vetëm me shollë, po edhe plastike që të rrojnë më shumë dhe të kushtojnë më lirë. Për zgjidhjen e këtij problemi të mos presim derisa të ngremë fabrikën. Është e mundshme të bëhet një kthesë në këtë drejtim? Nuk e keni studuar ju eventualitetin e një orientimi të tillë? Këtu të kemi për qëllim thjeshtimin, të prodrojmë këpucë të forta dhe me çmime të ulëta. Këpucët që do të prodrojmë t'i përshtaten më mirë vendit tonë, se ne jemi një vend bregdetar mesdhetar, që për një periudhë shumë të gjatë të vitit, mund të përdorim këpucë të thjeshta. Pra, strukturën e këpucëve «ala Bata¹» ne duhet ta ndryshojmë.

Ka edhe sektorë të tjerë, ku mendoj se duhet ta ndërrojmë strukturën e mallrave. Kjo është e nevojshme të bëhet në drejtim të thjeshtimit të mallrave të konsumit të gjerë dhe të uljes së kostos. Thjeshtimi i mallrave të konsumit mendoj të bëhet më shumë nga sa bëhet tani dhe me materialin që kemi aktualisht. Të marrim, për shembull, çështjen e mobiljeve. Jam i mendimit të heqim dorë nga mobiljet që prodhohen tani në zdrukthëtaritë tona, të cilat bëjnë vetëm mobilje luksi që kushtojnë shumë dhe si rrjedhim rëndoijnë buxhetin e punonjësve. Do të thuash kur tjetri ka, le të blejë. Natyrisht, kështu është, kur ka para, le t'i blejë. Por, po të ketë më të lira, ai do.

¹ «Bata», fabrikë në Çekoslovaki për prodhimin e këpucëve.

t'i blejë mobiljet me më pak shpenzime dhe, atëherë, të hollat që do t'i teprojnë, mund dhe duhet t'i përdorë për të tjera nevoja. Nga ana tjetër edhe ndjenja e luksit nuk do të nxitet. Shokët kanë bërë kritika përkëtë çështje, dhe kjo është e drejtë, se kur blejnë mobilje me 60 mijë lekë, kjo u duket një barrë e rëndë jo vetëm për buxhetin e familjes, por edhe nga ana praktike, sidomos kur transferohen.

Edhe pllakat që po bëjmë prej zdrukthi, koçani etj., etj. nuk po gjejnë përdorimin e duhur për të prodhuar mobilje për popullin, po mendohet kurdoherë si e si t'i eksportojmë. Natyrisht, ne duhet edhe të eksportojmë nga këto pllaka, po në radhë të parë duhet t'i përdorim ato për mobileri dhe për disa gjëra të tjera, kurdoherë të thjeshta. Këtu e kam gjithë çështjen që thjeshtësia të sundojë në jetën tonë dhe prodhimet të dalin me kosto më të ulët në mënyrë që tjetri të mund të blejë mallra me çmime më të ulëta.

U ngrit këtu edhe çështja e tubave dhe e pllakave prej eterniti e u shfaq mendimi të mos prodrojmë më shumë, se lënda e parë, azbesti, që importohet nuk gjendet. Ne e dimë që me kredi nuk të jep njeri azbest, por atë mund ta gjejmë duke e blerë jo me dollarë, po duke e këmbyer me bakër. Për sa i përket prodhimit të bërrylave, ne kemi një eksperiencë të hidhur, këto janë gjëra të njoitura. Në qoftë se nuk e keni zgjidhur sa atmosferë janë tubat që do të prodhohen, e zgjidhni, pse, po nuk ditët sa atmosferë janë këta, atëherë është e kotë të diskutojmë. Këtë çështje të tjerët e kanë zgjidhur me kohë, kështu që

me një interesim më të madh mund të ishte zgjidhur edhe te ne.

Në këtë plan nuk ka vend të futet çështja e trajtimit të qumështit të oborreve nga ana e vetë kooperativave bujqësore, por do të ishte mirë sikur të jepnim një direktivë që kooperativat bujqësore, që tani përdorin gati 60 për qind të qumështit për të pirë, një pjesë të kësaj sasie qumështi ta bëjnë për vete djathë e gjizë dhe, po t'u teprojë e po të duan, t'ia shesin shtetit. Qoftë edhe sikur 3 për qind djathë ose gjizë të merrej e industrializuar, mendoj se do të ishte një fitim i madh. Fshatarët mund të industrializojnë më shumë djathë. Ata mund të përpunojnë një sasi më të madhe qumështi edhe si kooperativë bujqësore, edhe si familje, duke ekonomizuar kështu shumë prodhime qumështi dhe, në vend të qumështit t'i japin shtetit djathë. Kjo do të ishte në interes të shtetit dhe të kooperativës. Kjo çështje duhet parë, mendoj unë, nuk duhet lënë pas dore. Në qoftë se për këtë do të duhen voza, atëherë të mendohet se ku do të gjendet lënda e drurit për t'i bërë këto.

Dohen plotësuar edhe kërkesat në perspektivë për prodhimin e reçelrave. Mbështetja planifikimin për këtë artikull nuk e kemi në rregull dhe duhet parë që të mundim të shtojmë konsumin e tij, kështu që të ekonomizojmë ca edhe bulmetrat. Kjo çështje do parë e lidhur edhe me problemin se mund të kemi edhe stoqë me reçel.

Kam edhe një çështje tjeter. Mund të gabohem, po shumë gjëra janë thënë për qymyret dhe për shkriren e mineraleve. Disa prej këtyre kanë mbetur for-

male. Në mineralet tona mund të ketë disa lëndë si squfur etj., që e pengojnë shkrirjen e tyre, prandaj edhe jam interesuar për kaloritë e bitumit. Na thuhet se «qymyri ynë nuk bën», se «ai nuk shkrin as bakrin», sepse «nuk ka kaloritë e nevojshme». Unë bëj pyetjen, si e shkrinin bakrin në kohët e vjetra, këtu e 3 mijë vjet përpara? Atëherë përsë themi se qymyri ynë, i cili ka 3 mijë kalori, nuk bën? Jo, na thuhet, duhet koks. Këto formula janë gjetur lehtë për të na mbushur mendjen që të sjellim koksin nga jashëtë dhe të mos përdorim qymyrin tonë për shkrirje. Natyrisht mund të duhet dyfish qymyr nga yni për shkrirjen e mineraleve, po kjo është çështje tjetër. Përveç kësaj duhet të rriten përpjekjet për të gjetur qymyre me më shumë kalori si dhe qymyre të koksi-fikueshme.

Ose të marrim problemin e rërërave bituminoze. Përse nuk po i japim asnjë rrugëzgjidhje përdorimit të tyre? Nuk mundet që kjo lëndë të shërbejë për nxehje, diku në disa sektorë të industrisë sonë dhe kjo të lehtësohet kështu nga shumë lëndë deficitare që përdorim për këtë qëllim? Ne kemi mbetur gjithash tu në formulën: «Nuk po gjejmë mënyrën si ta shkëputim këtë lëndë djegëse nga gurët dhe lëndët e tjera të huaja». Dua të them se nuk bëhen përpjekjet e duhura për t'u dhënë zgjidhje këtyre problemeve, por e kemi gjetur lehtë që çdo gjë ta zgjidhim vetëm me import. Ne nuk duhet të ecim kështu. Në qoftë se ky ose ai qymyr nxjerr të tilla gaze që pengojnë temperimin e një metali, natyrisht nuk duhet ta përdorim, por në qoftë se këto gaze nuk ndikojnë në shkrirjen

e mineraleve ose në amalgamën që mbetet dhe kjo ndahet fare lehtë nga metali, atëherë përse të qëndrojmë në këto formulime shkencore? Po t'i sjellim nga jashtë qymyret s'ka dyshim që sot ato janë më të mira, po na kushtojnë devizë. Prandaj industria t'i shikojë më me kujdes këto gjëra.

Çështja e fundit që kisha është ajo e orientimit të shkollave për pesëvjeçarin. Këtë problem nuk e zgjidhim dot menjëherë, por çështjen e orientimit të shkollave tona duhet ta studiojmë më mirë nga sa e kemi studiuar gjer tani. Ne bëmë një studim dhe vendosëm këtu çështjen e shkollave 8 dhe 12-vjeçare. Shkolla 8-vjeçare mendoj se është baza mbi të cilën ne duhet të qëndrojmë. Edhe shkollen 12-vjeçare ta mbajmë. Këtu nuk është fjala thjesht për të mbyllur në Tiranë dy ose tri shkolla 12-vjeçare, po për të menduar ku do të na venë gjithë këta djem e vajza që nuk do të përfshihen në këto shkolla? A është bërë ndonjë studim për këtë problem? Hapja e shkollave 12-vjeçare me profil të përgjithshëm nga të katër anët e kërkon këtë studim. Nevojat e degëve të ndryshme të ekonomisë kërkojnë që të hapim edhe më shumë shkolla profesionale nga sa kemi tani. Atëherë, mund të pyesë dikush, përse nuk kemi orientuar më parë hapjen e tyre në një shkallë më të gjerë? Për këtë çështje ka pasur edhe disa arsyec objektive. Ne nuk kemi pasur kuadro teknikë për shkollat profesionale. Kjo është një arsy. Arsyja tjetër është se për një kohë të gjatë do të kemi nevoja të mëdha për kuadro të lartë për drejtimin e industrisë së re dhe të institucioneve të shumta që janë ngritur në vendin tonë. Veç

këtyre është edhe arsyaja e moskuptimit sa duhet e tē gjithë situatës. Vetë ne jemi prirë të përgatitim më shumë kuadro me kulturë të përgjithshme dhe i kemi orientuar nxënësit të shikojnë nga shkollat e larta. Tani ka ardhur koha të bëjmë kthesë në këtë çështje. Edhe në tē ardhmen do tē na duhen kuadro të lartë, po na duhen e do tē na duhen edhe kuadro të mesëm, teknikë, sepse këta që kemi nuk na mjaftojnë. Pra, do tē na duhet t'u themi të rinxve e të rejave se puna është nder, prandaj ata, në radhë të parë, duhet tē drejtohen në shkollat teknike profesionale. Edhe familja të punojë me ta, duke i mësuar ta duan edhe punën teknike dhe jo vetëm «shkencën e madhe».

Në universitet të shikojmë si t'i lidhim studentët më mirë me jetën. Një nga masat që mund tē marrim është edhe ajo që studentëve tē mos ua japim diplomën pa bërë një periudhë stazhi në prodhim. Kjo praktikë lufton edhe pikëpamjen që krijohet te studenti, i cili mendon se «unë kam mësuar në shkollë të lartë, prandaj jam i destinuar për tē udhëhequr, për t'u bërë njeri i madh». Në qoftë se mbasi mbaron universitetin, studenti do tē punojë në prodhim, kjo do ta forcojë atë. Këtë çështje do tē ishte mirë sikur ta shikojmë rrënjosish, se kështu studenti nuk do tē ushqejë pikëpamjen, sipas së cilës «unë që kam diplomë jam më superior nga tjetri që nuk ka».

Ne sot dërgojmë në universitet rrëth 1000 studentë në vit, dhe nga viti në vit kjo shifër rritet, por ka rëndësi tē theksojmë se mbarojnë rrëth gjysma e tyre. Nga se shkaktohet kjo? Kjo rrjedh nga pikëpamja se duhet bërë seleksionim. Gjersa kemi dërguar

1000 veta për të ndjekur studimet, ata duhet ta mbarojnë universitetin. Ne nuk i çojmë ata në universitet për t'i seleksionuar, por për t'i mësuar. Përveç kësaj shpesh ndodh që një student që nuk ka shkëlqyer në shkollë të bëhet më i zoti në jetë. Natyrisht kjo varet edhe nga prirjet, nga predispozicioni i personit për të punuar ose jo.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbali i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH që gjendet në AQP

T'I PËRVISHEMI PUNËS KONKRETISHT PËR REALIZIMIN E PLANIT

*Diskutim në mbledhjen e Plenomit të 16-të
të KQ të PPSH¹*

4 mars 1966

Nuk do të flas shumë se shokët diskutuan gjerësisht. Ne kemi dy muaj që flasim për këto probleme. Tani ka ardhur koha t'i përvishemi punës konkretisht për realizimin e planit dhe të detyrave që kemi përpala, të gjithë: Partia, Qeveria, dikasteret dhe baza. Për këtë na duhet të mobilizojmë njerëzit që të merren me prodhimin, ndryshe, në qoftë se vazhdojmë edhe 2-3 muaj të merremi me diskutimin e këtyre gjëra, do të kemi shumë deficite në plan. Ju, shokë të Ministrisë së Tregtisë ose të ndonjë ministrie tjeter, mund të vini rrötull për këto gjëra që u thanë, por duhet të dini se nuk mund t'i shpëtoni përgjegjësisë që keni para Partisë dhe Qeverisë për plotësimin e detyrave të planit.

1 Një nga pikat e rendit të ditës të kësaj mbledhjeje ishte «Shqyrtimi dhe aprovimi i projektplanit dhe i projektbuxhetit të shtetit për vitin 1966».

Qeveria duhet të jetë më ekzijgjente ndaj ministrive, në mënyrë që ato të plotësojnë detyrat e tyre ndaj ndërmarrjeve dhe komiteteve ekzekutive të rretheve. Njëkohësisht organizatat e Partisë në rrethe duhet të janë në këmbë për të bërë që komitetet ekzekutive t'u sigojnë ndërmarrjeve lëndën e parë dhe sidomos t'u përgjigjen kërkesave të fshatit, sepse, kur vjen fundi, edhe komitetet e Partisë fillojnë të bëjnë si ministritë, të nxjerrin shumë arsy: jo rrethit tonë nuk iu dhanë ato që ishin parashikuar të vinin nga eksporti, jo s'u bë kjo, jo s'ra shiu, jo nuk pati diell, jo nuk erdhi traktori, nuk vajtën saracineskat etj., etj. Prandaj atë frysme dhe atë hov revolucionar, me të cilët u frysmezuan populli dhe Partia për përgatitjen e planit, që është detyra e parë e madhe në këtë drejtim, duhet t'i mbajmë të gjallë edhe për realizimin e tij dhe ata mbahen vetëm me punë. Tash e tutje duhet ta organizojmë mirë punën dhe të kryejmë detyrat që na janë vënë, ndryshe ky plan që po hartojmë nuk do të realizohet. Për realizimin e tij janë të gjitha mundësítë, vetëm duhet të mos harrojmë një gjë, të mobilizojmë masat. Në qoftë se do të fillojnë justifikimet se «s'ma dha këtë ai ose ky dikaster», atëherë nuk do të na shkojnë punët mirë. Përkundrazi, në rast se do të shkojmë në bazë dhe do të mobilizojmë popullin, pengesat do të kapércehen, detyrat do të plotësohen me sukses.

Kjo punë dhe kjo frysme revolucionare që kanë shpërthyer kudo, kërkojnë që edhe ndërmarrjet të janë ekzijgjente ndaj dikasterit, ndaj kujtdo qoftë, por njëkohësisht të mos harrojnë se ato vetë do t'i zgjidhin problemet duke mobilizuar masat. Po harruam vrullin

zimin e planit dhe të marrim masa për t'i përgatitur sa më mirë materialet e Kongresit.

Për përgatitjen e Kongresit kemi material të pasur, sepse të pasura janë rezultatet e arritura nga lufta e Partisë sonë. Eksperienca e fituar kohët e fundit i ka dhënë Partisë një pasuri të madhe, nga e cila do të arrijmë në një sërë sintezash të drejta parimore, që do të përbëjnë thelbin e Kongresit të ardhshëm. Të gjitha këto do të shërbejnë për forcimin e Partisë dhe për zhvillimin e mëtejshëm të vendit e të ekonomisë sonë.

Përfundimisht datën për thirrjen e Kongresit do të kemi mundësi ta vemosim në një mbledhje të ardhshme të Komitetit Qendror.

Tani, më duket mua, gjë tjeter nuk kishim, prandajtë shkojmë në bazë dhe të realizojmë detyrat që na ngarkohen.

Botuhet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbledhjes së Plenumit të 16-të të KQ të PPSH që gjendet në AQP

USHTRITE REVOLUCIONARE I BËN TË FORTA MARKSIZËM-LENINIZMI

*Fjala në mbledhjen me ushtarët dhe kuadrot
ushtarako-politikë të forcave të armatosura*

5 mars 1966

Të dashur shokë,

Aprovimi juaj unanim i vendimit të rëndësishëm që mori Plenumi i 16-të i Komitetit Qendror të Partisë në lidhje me forcimin dhe kalitjen e mëtejshme të ushtrisë sonë heroike, të cilin jua lexova më parë, fryma revolucionare dhe entuziazmi që shprehët tregojnë se ne jemi në rrugë të drejtë, se ky vendim është i domosdoshëm, i kohës, i natyrshëm, dialektikisht i drejtë dhe në fryshtë revolucionare marksiste-leniniste.

Ne kemi bindjen e plotë se e gjithë ushtria — ushtarët, nënoficerët dhe oficerët, këtë vendim do ta presin me po atë entuziazëm e besim si edhe ju. Të gjithë ne do të vëmë plotësisht forcat tona mendore e fizike, do të vëmë gjoksin dhe zemrën që vendimet e Partisë sonë të lavdishme, si kurdoherë, t'i vëmë si duhet në jetë.

Siq e shihni, në këtë vendim asgjë s'ndryshon në

konceptet marksiste-leniniste të drejtimit të ushtrisë sonë. Ajo ka qenë, është dhe do të mbetet një ushtri besnike e popullit dhe e Partisë, një ushtri me të vërtetë revolucionare. Ushtrinë tonë e ka udhëhequr, e udhëheq dhe do ta udhëheqë vazhdimisht Partia e Punës e Shqipërisë me vijën e saj të drejtë marksiste-leniniste në interes të popullit, të socializmit dhe të komunizmit.

Në goftë se ne bëjmë tani disa reforma e ndryshime, këto janë në format, në metodën dhe në stilin e punës dhe jo në konceptet bazë që udhëheqin ushtrinë si një detashment i madh, si një armë e diktaturës së proletariatit në duart dhe nën drejtimin e Partisë sonë marksiste-leniniste.

Reformat që ne bëjmë herë pas here, jo vetëm në ushtri, por edhe në sektorët e tjerë të jetës, nuk kanë asgjë të jashtëzakonshme. Ato janë të natyrshme dhe bëhen në disa situata e për disa qëllime të caktuara. Në çdo sektor qofshin, bëhen në ato momente kur e lypin arsyе objektive, për kalimin nga një situatë objektive në një situatë të re objektive. Kjo në vetvete do të thotë të bëhet një hop i mëtejshëm cilësor.

Një reformë ose rektifikimi i stilit dhe i metodës së punës që ndërmerr Partia në kohë të ndryshme, kanë si qëllim përmirësimin e cilësisë së punës, si rrjedhim këto janë sintezë e eksperiencës së madhe që grumbullon e përpunon Partia, goftë brenda vendit, goftë nga eksperienca e madhe e lëvizjes komuniste ndërkombëtare, të cilën e zbaton në situatat e reja, në përshtatje me rrethanat objektive dhe kushtet e vendit tonë.

Reformat ose rektifikimet që bën Partia, kur ajo

e gjykon se i kërkojnë nevojat dhe rrethanat, do të ishte gabim të vlerësoheshin me një koncept jomarksist, antidialektik, domethënë me konceptin e gabuar se një reformë ose një rektifikim përbys çdo gjë dhe vë në vend të saj një gjë krejt të re. Ky do të ishte një koncept foshnjor. Partia jonë, si një parti marksiste-leniniste, në vijën e së cilës nuk janë vërtetuar gabime parimore gjatë gjithë jetës, ka krijuar thesarin e saj të madh revolucionar, që jo vetëm nuk duhet të errësohet nga koncepte foshnjore, por e mbështetur fuqimisht në këtë thesar të madh ajo punon e mendon në mënyrë të mrekullueshme për të shkundur pluhurin e «makinës», për të ndërmarrë masa të mëtejshme për fuqizimin e punës, për kalitjen e njerëzve.

Logjika e drejtë e Partisë vepron edhe në këtë rast me vendimin që mori Komiteti Qendror, i cili ka të bëjë me forcimin e Ushtrisë sonë Popullore dhe me edukimin e mëtejshëm të ushtarëve e të kuadrove që ka farkëtuar e ka kalitur Partia jonë. Këtu qëndron kuptimi i madh i këtij vendimi historik në lidhje me ushtrinë, vendim që bën pjesë integrale në Letrën e Hapur që Komiteti Qendror u drejton gjithë popullit, gjithë komunistëve, gjithë ushtrisë. Ky vendim që ju do ta lexoni e do ta studioni, do t'ju shërbejë si një dritë e madhe që lëshon Partia në rrugën tonë plot luftëra të lavdishme.

Përse vendimi mbi ushtrinë nuk doli i veçantë, po u inkuadrua në Letrën e Hapur që Komiteti Qendror i dëjtoi gjithë popullit, në të cilën shtrohen edhe probleme të tjera?

Ju e kuptioni fare mirë se çështjet e ushtrisë janë

çështje të popullit, se ushtria është e popullit dhe e Partisë, ashtu sikurse edhe çështjet e tjera të popullit dhe të Partisë janë edhe çështje të ushtrisë, e cila është pjesë e popullit, forca e armatosur e tij. Kjo është arsyeja që e shtyu Komitetin Qendror të mos marrë vendim të veçantë për ushtrinë. Kjo vërteton edhe një herë më së miri unitetin e popullit me Partinë dhe me forcat e tij të armatosura. Të gjithë, popull dhe ushtri, janë të interesuar për t'i zgjidhur si duhet problemet që kemi përpara. Ato do të zgjidhen me sukses kur të gjithë, nën udhëheqjen e Partisë, mbasi t'i kenë kuptuar drejt dhe t'i kenë ato të qarta, t'i vënë gjoksin punës, kudo që të jenë. Kjo tregon gjithashtu forcën e demokracisë sonë në mendim dhe në veprim.

Vendimin e Komitetit Qendror mbi forcimin e modernizimin e mëtejshëm të ushtrisë, i gjithë populli do ta presë me entuziazëm të madh, sepse ai e kpton qartë që një forcë e madhe përparimtare, një ligj dialektik dhe dinamik e shtyn përpara ushtrinë tonë drejt kalitjes së mëtejshme ideopolitike e teknike, drejt atrimit sa më shumë dhe të plotë me popullin e vet dhe me karakteristikat më të mira të tij. Populli shqiptar, i edukuar dhe i kalitur në luftëra nga Partia, edhe në këtë rast, shikon me kënaqësi të madhe se me Partinë në krye vepron ligji i revolucionit.

Proletariati që lufton me ashpërsinë më të madhe kundër kapitalizmit, që zhvillon pa ndërprerje një luftë klase të ashpër për të rrëzuar borgjezinë dhe për të vendosur pushtetin e tij, frymëzohet e udhëhiqet në luftërat klasore vetëm nga ligjet objektive të revolucionit, nga teoria e Karl Marksit, e cila frymëzon para-

rojën dhe detashmentin e tij të organizuar, partinë marksiste-leniniste.

Përpara armikut të egër të klasës, të armatosur fuqimisht, proletariati e di se duhet të shtrëngojë fort radhët e veta dhe të kthehet në një mur të çeliktë. Por, për të qenë i tillë, ai duhet të jetë i ngritur ideologjisht e politikisht, i kalitur me ideologjinë revolucionare, ai duhet të edukohet dhe të zbatojë taktikën dhe strategjinë e tij revolucionare në luftë, të cilat të kenë epërsi ndaj atyre të armikut për ta luftuar dhe përtatë asgjësuar atë përfundimisht.

Proletariati që lufton dhe që hidhet në revolucion di gjithashtu se i duhet një disiplinë e hekurt, e ndërgjegjshme, e cila krijohet dhe ndërtohet në funksion dhe në bazë të ligjeve të revolucionit, të ideologjisë së proletariatit, të marksizëm-leninizmit.

Pra, sikurse e shihni, gradat nuk luajnë asnjë rol në revolucion dhe në luftën e proletariatit e të popujve. Proletarët dhe popujt në revolucion luftojnë pa grada dhe fitojnë mbi armiqëtë të cilët kanë grada e lulka. Proletarët dhe popujt në revolucion luftojnë dhe fitojnë pa këpucë, me rroba të grisura dhe me barkun bosh, kurse ushtria e kapitalistëve nuk lufton dot pa to dhe thyhet.

Ç'i bën, pra, të forta ushtritë revolucionare? Ato i bëjnë ajo frymë, ato ligje të revolucionit, ato caqe që ka caktuar ai të arrijë, i bën marksizëm-leninizmi dhe partia marksiste që i edukon dhe i udhëheq në revolucion.

Shembulli më i qartë dhe i shkëlqyer në këtë drejtim është revolucioni ynë i madh i udhëhequr nga

Partia, është Lufta Nacionalçlirimtare, është ushtria jonë e lavdishme. Ne luftuam pa pasur grada dhe fituam; ekonomikisht ne ishim të dobët, por luftuam dhe fituam se na udhëhoqën ligjet e revolucionit që mishëroshin në Partinë tonë. Kjo na i bëri zemrën top, mendjen dhe idetë të qarta.

Disa njerëz, që do t'i quaja semplistë, sepse nuk thellohen në problemet, mund të thonë: «Kur qenka kështu, atëherë përsë i vumë gradat më vonë?». Bëmë apo nuk bëmë gabim që i vumë gradat? Komiteti Qendror e ka shpjeguar qartë këtë dhe të gjithë ne mendojmë se momentet dhe rrethanat objektive e kërkonin për një kohë një gjë të tillë. Kjo atëherë kishte anët e saj pozitive dhe në fakt shërbeu pozitivisht.

Fakti është se vënia e gradave nuk ua ndryshoi karakterin dhe hovin revolucionar ushtrisë dhe kuadrove tanë. Dhe ja fakti i madh: kur Partia jonë tregoi se momentet tani janë të tillë që gradat janë të panevojshme, të gjithë kuadrot e ushtrisë njëzëri, me përjashtim vetëm të një personi të çoroditur, i thanë Partisë përnjëherë: T'i heqim.

Pra, vija e Partisë, si në çdo gjë, ashtu edhe në vënien më parë ose në heqjen e gradave aktualisht, ka qenë dhe është e drejtë në përputhje me zhvillimin dinamik të ngjarjeve. Heqja e gradave në ushtrinë tonë nuk është regres, por progres, kjo nuk e dobëson atë, përkundrazi e forcon. Përderisa këtë masë e aprovuan Partia, populli dhe ushtria që janë gjykatësit më të mirë, le të grijë ai semplisti që e ka kokën bosh.

Ka disa të tjera që përsëri mund t'i quaj semplistë, që thonë: «I vumë gradat dhe bëmë si sovjetikët; u

prishëm me sovjetikët, u lidhëm me kinezët dhe gradat i hoqëm, se i hoqën edhe kinezët». Këta njerëz nuk e kuptojnë si duhet çështjen, prandaj ne duhet t'ua bëjmë të qartë universalitetin e marksizëm-leninizmit, forcën e tij revolucionare internacionliste, thesarin e madh të luftërave revolucionare të partive marksiste-leniniste, eksperiencën e tyre që është eksperienca e të gjithëve, nga e cila duhet të përfitojë kushdo që e quan dhe e ndien veten marksist. Këtë eksperiencë kolosale çdo marksist duhet ta dijë, ta shfrytëzojë e ta zbatojë si duhet në rrëthanat dhe në situatat objektive të vendit të tij.

Këta njerëz gjithashtu nuk e njohin dhe nuk e çmojnë sa duhet personalitetin e madh marksist-leninist të Partisë sonë. Ç'të keqe ka, kur qëndrimet në vijë e në veprim të Partisë sonë puqen, janë të njëjtë me ato të partive të tjera komuniste e punëtore marksiste-leniniste? Përkundrazi, ne luftojmë që ky unitet mendimi e veprimi që ekziston brenda radhëve të një partie marksiste-leniniste, të arrihet edhe në lëvizjen komuniste ndërkontaktare për t'i luftuar me sukses dhe për t'i dërrmuar sa më parë e përfundimisht imperializmin, socialdemokracinë, revizionizmin modern hrušovian, titizmin e të tjerë armiq, në fitim të revolucionit botëror.

Marksizëm-leninizmi nuk njeh parti të vogël dhe parti të madhe. Në qoftë se Partia jonë, si parti marksiste-leniniste, përfiton nga eksperienca e partive të tjera marksiste-leniniste, cilado qoftë kjo, e madhe apo e vogël, nuk do të thotë se Partia jonë hiqet prej hunde, ose se kësaj i imponohet prej ndokujt kjo apo ajo. Këtë

mendim e zhvillon propaganda borgjeze kapitaliste, kurse lufta dhe qëndrimet e Partisë sonë vërtetojnë më së miri pavarësinë e saj në mendime e në veprime, kurdoherë të matura, të drejta, të pjekura, marksiste-leniniste.

Edhe për heqjen e gradave në ushtri Partia jonë u udhëhoq nga eksperiencia e saj, nga eksperiencia e Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare dhe nga asnjë eksperiencë tjetër. Por pavarësisht nga kjo, këta njerëz semplistë duhet të dinë se s'jemi vetëm ne që përfitojmë nga eksperiencia e mirë revolucionare e partive motra marksiste-leniniste dhe këtë nuk e fshehim, përkundrazi, mburremi, se edhe partitë e tjera motra përfitojnë dhe frymëzohen nga eksperiencia dhe nga vija e drejtë revolucionare marksiste-leniniste e Partisë sonë. Këtë edhe partitë motra nuk e fshehin, por e thonë haptazi dhe mburren me Partinë tonë.

A ka bërë gabim Partia jonë që ka marrë e ka përfituar kaq shumë nga eksperiencia revolucionare e Ushtrisë Sovjetike e udhëhequr nga Partia Bolshevikë, nga Lenini e Stalini? Jo vetëm s'ka bërë gabim, por ka bërë mirë. Ne jemi ndihmuar nga kjo eksperiencë për forcimin e ushtrisë sonë.

Tani ne bëjmë korrigjime të kësaj eksperience. Ne nuk kemi qenë në gjendje ta aplikonim si duhej atë në ushtrinë tonë, në kushtet tona. Pra, ky korrigjim është i natyrshëm, është i domosdoshëm të bëhet, por kjo nuk na ul ne dhe vlerën e anës pozitive të eksperiencës bolshevikë të Ushtrisë Sovjetike para ardhjes në fuqi të grupit tradhtar revisionist të N. Hrushovit, sepse pas ardhjes së këtij grupi në fuqi edhe parimet

politike, organizative, ushtarake, edhe vetë njerëzit e kuadrot kanë degjeneruar në një ushtri të karakterit borgjez, si në konceptet politiko-ushtarake ashtu edhe në qëllimet e saj. Ajo, nga një ushtri revolucionare, është shndërruar në një ushtri kundërrevolucionare dhe shtypëse e revolucionit dhe e popujve.

A ka bërë gabim Partia jonë që me qindra e mijëra kuadro i mësoi në akademitë sovjetike dhe në shkollat tona ushtarake me artin ushtarak sovjetik stalinian dhe me eksperiencën e madhe të Luftës sonë Nacionalçlirimtare? Partia jonë jo vetëm s'bëri asnjë gabim, por bëri një punë shumë të drejtë. Dhe ja, frytet e kësaj pune të drejtë jeni ju, ushtarë dhe kuadro të Partisë që punoni në ushtri, kuadro me kulturë të gjerë, me koncepte të drejta, me një kalitje dhe ngritje politiko-ideologjike të lartë, marksiste-leniniste, që kuptoni drejt çdo situatë, qoftë ajo edhe shumë e koklavitur, që e keni bërë ushtrinë një shkollë të madhe e të zjarrtë, besnikë të popullit, të Partisë dhe të revolucionit.

A duhet të përfitojmë ne nga eksperienca e ushtrive revolucionare? Patjetër po dhe sa të jetë e mundur më shumë e më mirë, duke pasur parasysh që çdo gjë t'u përshtatet kushteve tona. Kjo nuk do të thotë se ne nënvleftësojmë eksperiencën tonë që është baza e bazave, por kjo bëhet e duhet bërë për të pasuruar eksperiencën tonë me atë të ushtrive revolucionare.

Të mos e marrim ne eksperiencën e luftëtarëve heroikë vietnamezë? Me të dyja duart dhe me të të pasurojmë eksperiencën e madhe të luftës dhe të punës sonë.

Pra, në këtë drejtim nxjerrim si konkluzion, sa qesharak, sa pa kripë, sa pa baza dhe trosh duket mendimi semplist i atyre njerëzve të paktë që thonë se ne vetëm «kopojmë sovjetikët ose kinezët». Partia jonë nuk kopjon, ajo në bazë ka eksperiencën e saj të madhe dhe të lavdishme, por në të njëjtën kohë mëson edhe nga eksperienca pozitive, revolucionare e të tjerëve. Ky është qëndrim marksist-leninist, internacionalist.

Dëshiroj të trajtoj, shkurt, çështjen e drejtimit të Partisë në ushtri me anë të komiteteve të Partisë dhe të emërimit të komisarëve politikë, siç do të bëhet këtej e tutje në vend të komandës unike siç e kemi pasur deri tani, pasi për të gjithë ju kjo çështje ka qenë dhe është e qartë.

Përse ka qenë dhe është e qartë? Sepse forma e drejtimit të Partisë në ushtri me komitete partie, duke emëruar edhe komisarët, formë që u vendos nga Komiteti Qendror, as nuk është një formë e re drejtimi për ushtrinë tonë dhe as që po e kopojmë nga ndokush. Këtë formë ne e kemi pasur në Ushtrinë tonë Nacional-çlirimtare dhe ka dhënë rezultate të shkëlqyera. Në mëmomentet e tanishme, në kushtet e reja që po kalon vendi ynë, kur Partia jonë ka grumbulluar një eksperiencë kolosale në ndërtimin e socializmit dhe mbrojtjen e vendit, forcimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i udhëheqjes dhe i drejtimit të Partisë në forcat e armatosura me anë të komiteteve të Partisë dhe të komisarëve politikë, janë një hop i madh përpara, një hop pozitiv, kualitativ, si në mënyrën e drejtimit, ashtu edhe në kilitjen e mëtejshme ideopolitike-ushtarake të ushtrisë.

Gjatë gjithë jetës së ushtrisë sonë, si në kohët e

lavdishme të Luftës Nacionalçirimitare, ashtu edhe në kohën heroike të ndërtimit të socializmit, kështu do të jetë gjithmonë edhe në të ardhmen, udhëheqja e ndritur e Partisë, pavarësisht nga format që janë përdorur, ka qenë e vazhdueshme, pa as më të voglën ndërprerje, ka qenë e drejtë, marksiste-leniniste dhe vendimtare përfatet e ushtrisë. Partia ka qenë zemra, mendja, forma revolucionare kurdoherë në ngritje, gjë që ka bërë e do të bëjë edhe në të ardhmen që ushtria jonë të jetë kurdoherë ushtri e popullit, ushtri e revolucionit, ushtri e Partisë. Kjo ka bërë që ushtarët dhe kuadrot tanë ushtarake të jenë kalitur me një fryshtë të lartë partishmërie, me një fryshtë sakrifice dhe vetëmohimi deri në vdekje përfshirë mbrojtur nga çdo rrezik popullin, socialistin, Partinë, Republikën.

Pra, asgjë s'ka ndryshuar dhe asgjë nuk do të ndryshojë në konceptet marksiste-leniniste në drejtimin e ushtrisë sonë nga ana e Partisë. Partia mbi çdo gjë, ajo na ka udhëhequr, na udhëheq dhe do të na udhëheqë kurdoherë. Këto koncepte të mëdha marksiste-leniniste të palëvizshme të Partisë përfshirë drejtimin e ushtrisë nuk i kanë cenuar as forma e komandimit unik as mungesa e komisarëve politikë në ushtri.

Nuk duhet të gabohemi dhe të mendojmë se errësosheshin udhëheqja dhe roli i Partisë në ushtri me formën e komandimit unik, ku punëtori i Partisë si zë-vendëskomandant ishte nën drejtimin e komandantit ose se Partia praktikisht vihej nën urdhrat e komandanit. Në ushtrinë tonë, gjatë gjithë periudhës së komandimit unik asnjëherë nuk është errësuar ky rol, asnjë komandant, edhe i ulët të ketë qenë nga niveli ideo-

politik, nuk ka menduar e nuk ka vepruar sadopak në drejtim të errësimit të rolit drejtues të padiskutueshëm të Partisë. Ky është realiteti. Një arsyе që e shpjegon këtë është se kritikat ose vërejtjet që komandanti i ka bërë zëvendëskomandantit për punë politike, s'kanë asnë lidhje me errësimin e rolit drejtues të Partisë. Përkundrazi, komandanti e ka pasur dhe e ka për detyrë edhe në të ardhmen, si njeri partie, që si dje ndaj zëvendëskomandantit për punë politike, ashtu edhe nesër ndaj komisarit, në qoftë se gabon, t'i bëjë këtij kritika të rrepta për punën dhe për dobësitë që do t'i vërtetohen në jetë. Po kështu, anasjelltas, ka ngjarë dhe duhet të ngjasë. Kjo, jo vetëm nuk e cenon drejtimin e Partisë në ushtri, po përkundrazi e forcon.

Arsyeja e dytë që edhe në kohën e komandimit unik nuk është errësuar roli drejtues i Partisë, është fakti se komandantët tanë janë nga njerëzit më të mirë të Partisë në ushtri. Ata për Partinë hidhen në zjarr, në çdo moment.

Arsyeja e tretë dhe kryesorja është se në të gjithë jetën e saj, edhe në kohën e komandimit unik, puna në ushtri është zhvilluar në fryshtë revolucionare, nën kujdesin dhe drejtimin e Komitetit Qendror të Partisë dhe të Drejtorisë Politike të Ushtrisë që është një drejtori e Komitetit Qendror, të organizatave-bazë të Partisë në ushtri, të organeve politike dhe të komandave vetë ku bëjnë pjesë shokë nga më të mirët të Partisë dhe të ushtrisë.

Drejtimi me anën e komiteteve të zgjedhura nga Partia, s'ka asnë dyshim se do ta forcojë akoma më shumë punën e Partisë në ushtri, do të forcojë si pu-

nën ideopolitike, ashtu dhe atë ushtarake, do të forcojë drejtimin, do të forcojë demokracinë, do të kalitë akoma më mirë ushtarët dhe kuadrot, do të kalitë unitetin e çeliktë dhe luftarak të reparteve tona, unitet që duhet të ruhet si sytë e ballit.

Çdo vendim do të diskutohet dhe do të vendoset kolegjialisht në komitetin e Partisë. Kështu vendimi do të dalë më i plotë, më i drejtë dhe pa gabime. Nuk ka ekzistuar dhe s'duhet të ekzistojë asnje pengesë që vendimi të zvarritet në të marrë e në të zbatuar, qoftë në kohë paqeje, qoftë në kohë lufte, siç mund të arsyetojnë disa. Kjo varet nga metoda dhe stili i punës i komitetit ose i komandantit. Asgjë nuk mund të përjashtojë çështjen që edhe në kohën e komandimit unik, komandanti, duke pasur një metodë pune jo të mirë të hezitonte dhe të vonohej në marrjen e në zbatimin e vendimit. Natyrisht, vendimi i marrë kolegjialisht është kurdoherë më i thelluar dhe më i sigurt, ai del më i studiuar dhe krijon besim të madh te të gjithë ata që do ta zbatojnë, ngre në sytë e tyre vlerën dhe besimin për komitetin e Partisë, për komisarin politik dhe për komandantin.

Krijimi i komiteteve të Partisë dhe vendosja e komisarëve politikë nuk e ul, por përkundrazi e ngre dhe e forcon akoma më tepër rolin e komandantëve dhe të shtabeve, sepse pikërisht duke i forcuar këta si kuadro dhe si organizma udhëheqës, forcohet edhe puna e Partisë. Me krijimin e komiteteve dhe të funksionit të komisarit politik, udhëheqja e Partisë mishërohet, shkrihet dhe forcohet me një punë të gjithanshme e të kualifikuar në të gjithë këta organizma të ushtrisë

dhe në kuadrot që punojnë në ta, që zbatojnë orientimet dhe direktivat e Komitetit Qendror për ushtrinë. Është, pra, e kuptueshme që sekretarët e komiteteve të Partisë, komisarët politikë dhe komandantët të janë njërejzit më të mirë, më besnikë, më revolucionarë, si nga ana e partishmërisë ashtu edhe nga ana ushtarake. Komisarët dhe komandantët duhet të zgjidhen anëtarë të komitetit të Partisë.

Si kudo, edhe në ushtri, kur komiteti i Partisë merr vendim, ky vendim zbatohet menjëherë dhe cilido, komandanti, komisari dhe të gjithë oficerët e tjerë, kanë për detyrë që brenda funksioneve dhe kompetencave të plota që kanë, të organizojnë sa më mirë punën në mënyrë të harmonizuar, që vendimi të zbatohet si sahat dhe me plot sukses. Metoda e drejtë e punës dhe drejtimi i sigurt i Partisë, u lejon komandantit dhe komisarit, si dhe gjithë oficerëve dhe ushtarëve që të mos tregohen automatë në zbatimin e vendimit dhe arritjen e suksesit, por duke vepruar me të vërtetë si revolucionarë, brenda vijës së përgjithshme të Partisë, me disiplinë e vullnet të hekurt të kapërcejnë çdo pengesë që u del përpara, me iniciativë të shpejtë, të zhđervjellët dhe me përgjegjësi. Kuadrot tanë dhe ushtarët kanë një eksperiencë të pasur dhe s'është e nevojshme të zgjatem për këtë. Praktika do të na mësojë akoma më shumë si të punojmë edhe më mirë me formën e re të drejimit.

Ushtria jonë është një ushtri politike. Ajo edukohet nga Partia jonë me ideologjinë marksiste-lenini-

niste, me parimet e politikës së Partisë, me parimet e moralit proletar, me ligjet e revolucionit, me artin modern ushtarak revolucionar, me ndjenjat e internacionalizmit proletar. Vetëm një ushtri e tillë e frymëzuar dhe e edukuar në mënyrë të gjithanshme është besnikë e popullit, e Partisë. Në këtë rrugë të drejtë është edukuar dhe do të edukohet ushtria jonë nga ana e Partisë, prandaj ajo ka qenë, është dhe do të jetë besnikë e popullit shqiptar, e socializmit dhe e komunizmit.

Ushtria është një shkollë e madhe me një drejtim unik dhe me një qëllim të vetëm e të shenjtë. Ajo duhet të edukohet politikisht, ideologjikisht dhe ushtarakisht në mënyrën më të përsosur që të jetë vigjilente dhe e gatshme të hidhet në zjarr kur të cenojen interesat e popullit, të Partisë e të socializmit.

Ushtria përbëhet nga njerëzit, nga djemtë e popullit, qofshin këta ushtarë dhe kuadro, prandaj Partia ka një përgjegjësi të madhe përpara popullit, që këtë masë, këtë kolektiv, ta edukojë në mënyrë të vëçantë, në mënyrë të përsosur dhe me një kujdes të madh. Edukimi i ushtrisë është i gjithanshëm: ideologjik, politik, ushtarak, por edhe vetë këto drejtime kanë ndarjen dhe specifikën e tyre. Megjithëkëtë speifikë, edukimi i ushtrisë është një dhe i pandarë. Në bazë të këtij edukimi, strumbullari është, në radhë të parë, edukimi ideopolitik i ushtrisë nga ana e Partisë. Pa ngritjen ideologjike dhe politike të ushtarëve dhe të oficerëve as përvetësimi i armës, i teknikës, i shkencës ushtarake, as zbatimi i urdhërave dhe i vendimeve, nuk mund të bëhen si duhet. Arma, teknika,

shkenca ushtarake, kanë filozofinë, politikën dhe ideologjinë e tyre. Ndryshe është kjo në ushtritë borgjeze, ndryshe është në ushtrinë tonë, pavarësisht se armët dhe armatimet mund të jenë të njëlllojta. Prandaj, në ushtrinë tonë nuk mund të ketë komandant dhe specialist ushtarak, pa qenë njëkohësisht edhe politik, ashtu sikurse nuk mund të ketë komisar politik ose punëtor partie, pa qenë njëkohësisht edhe specialist në çështjet ushtarake. Kështu edhe për ushtarët. Duke i kupuar dhe duke i zbatuar këto çështje në këtë mënyrë, do të kemi një ushtri me të vërtetë me virtute të larta dhe të specializuar, domethënë një ushtri ashtu siç e duan Partia dhe populli.

Tek ushtari, që është thesari i madh, Partia duhet të tregojë kujdesin më të madh për ta bërë atë një njeri të zot, të përsosur, të zhvillojë dhe të kalitë tek ai virtytet më të mira: thjeshtësinë, vendosmërinë, patriotizmin, heroizmin, ndjenjën e sakrificës më të lartë për interesin e popullit, disiplinën e çeliktë e të vëtëdiçshme dhe iniciativën krijuese. Partia të kujdeset që ushtarin ta bëjë të etshëm dhe të aftë për punë, për mësim, për aksione të guximshme, të aftë të gjykojë çdo gjë drejt politikisht dhe në vijën marksiste-leniniste; ta bëjë të aftë dhe të zotin të dalë nga çdo situatë, sado e koklavitur që të jetë; ta bëjë të dojë kolektivin, të rrojë në harmoni me të, të dojë shokun, të jetë i drejtë me të dhe i rreptë e i pamëshirshëm me armiqtë. Këta objektiva të lartë dhe të shenjtë të Partisë, arrihen vetëm me një punë të madhe politike dhe ideologjike të organizuar mirë, në mënyrë të zgjuar.

Kush do ta organizojë këtë punë të madhe? Ju, ushtarë dhe oficerë, së bashku, si një trup i vetëm, nën udhëheqjen e Partisë sonë të lavdishme. Pra, ju e keni kuptuar dhe çdo ditë e kuptioni më mirë se ç'rol të madh e ç'detyrë të lartë ju ka besuar Partia, shokë oficerë. Ju jeni si mësuesit dhe pedagogët e shkollave të ndryshme që çoni vijën e Partisë e të Komitetit Qendror në ushtri. Por ju jeni të ndryshëm nga ata, pse mësuesi dhe pedagogu i shkollës civile i edukon dhe i pajis nxënësit me dituri, bën edhe seleksionimin e tyre kur u vë notën, po dikush tjetër i merr ata në dorëzim për t'i drejtar në jetë dhe në punë. Ju jo vetëm i edukoni ushtarët në mënyrë të gjithanshme, jo vetëm nuk bëni seleksionimin e tyre në të mirë dhe në më pak të mirë, por vini tërë forcat e shpirtit dhe të mendjes suaj që të gjithë të bëhen të mirë dhe ju i çoni vetë ata në aksione, në aksionin më të madh, në luftën për të mbrojtur atdheun dhe kur ta dojë nevoja vriteni tok me ta në llogore e në fushën e ndërit. Këtu qëndron forca e kolektivit të çeliktë të ushtrisë sonë, këtu qëndron dashuria e madhe e ushtarit tonë ndaj kuadrit që e edukon dhe e udhëheq atë. Këtu, në këto lidhje, në këtë brumosje, me këto qëllime të mëdha, me këto detyra e vështirësi, në ditët e gëzuara e të vështira, qëndron madhështia e vijës marksiste-leniniste të Partisë sonë dhe të Komitetit të saj Qendror. Këtu qëndron fryma e unitetit të çeliktë dhe e demokratizimit të vërtetë proletar të ushtrisë sonë.

Detyra e edukimit dhe e drejtimit, shokë ushtarë dhe oficerë, arti i dhënieve së mësimit, bërja e një

leksioni ose e një konference, dëshira për të mësuar, bazohen të gjitha në këto parime të drejta, të cilat arrihen duke ndjekur këtë rrugë dhe këto qëllime të larta.

Prandaj, ç'hyjnë këtu format, formalizmat, gradat, ndarja artificiale oficer-ushtar, distancat, për të mos folur për ndonjë sjellje ose qëndrim brutal dhe arrogant, dënimet ose arrestet për faje ose gabime që mund të bëhen? Këto metoda nuk na duhen neve, nuk janë as metoda partie as në frymë partie. Vetëm në rrugën e Partisë dhe me metoda të drejta partie arrihet dhe shkon më së miri çdo gjë.

Mua më kanë raportuar se asnjë ushtar nuk ka tani në arrest, se dënimet e ndryshme janë ulur shumë, sepse tani frymëzimi i madh revolucionar i Partisë përshkon gjithë ushtrinë. Kjo është një gjë e mrekullueshme. Kur gjejmë rrugën më të lehtë duke e dënuar ushtarin në vend që të lodhemi për ta edukuar e bindur, kur sillemi në mënyrë arrogante me të nuk mund të ketë disiplinë të ndërgjegjshme dhe dashuri për njërit-tjetrin. Vetëm kur sillemi drejt me ushtarin, në rrugë partie, atëherë ka disiplinë të vërtetë në ushtri.

Shpjegoja politikisht efektivit ç'do të thotë disiplinë e një ushtari të revolucionit dhe do të shikosh çfarë discipline të çeliktë e të vetëdijshme do të ketë në ushtri!

Shok oficer! Qëndroji afër ushtarit, duaje atë me gjithë shpirt, kujdesu për të, mos ji kryelartë dhe do të shikosh sa do të të dojë ai, sa me kujdes do ta dëgjojë fjalën tënde, sa me etje do ta përvetësojë mësimin tënd!

Edukoje politikisht, shoku oficer, ushtarin edhe kur i mëson teknikën e thjeshtë të armës! Edukoje politikisht që të mësojë edhe përdorimin e armës, edhe kur duhet ta përdorë atë! Mësoje atë politikisht se çështja e ushtrisë është një çështje serioze, nga më seriozitet dhe se në këtë familje të madhe nuk kanë vend shthurja e familjariteti i sëmurë; mos ki frikë se të bie nderi të flesh, të hash, të dëfresh, të bësh shaka me vëllanë tënd, ushtarin. Përkundrazi ai do të të nderojë, do të të respektojë, do të të dojë me gjithë zemër dhe jo për formë dhe për spaletat!

Edukimi politiko-ideologjik i ushtrisë nuk mund të durojë formalizëm e burokratizëm. Të hidhet poshtë edukimi me formula bombastike, ai të jetë një edukim i gjallë, i kuptueshëm, ku të shpjegohet qartë e thjesht vija e Partisë në ushtri dhe në terren, në proporcionet e nevojshme. Koha është flori për ushtarin dhe duhet të përdoret në mënyrë racionale.

Format e reja të drejtimit në ushtri nuk duhen kuptuar thjesht vetëm në zgjedhjen e komiteteve të Partisë dhe në caktimin e komisarëve dhe nga ana tjetër të vazhdohet me stilin dhe metodat e vjetra të punës, të një pune që ka pasur anë të mira, por edhe të këqija, si formalizmin, rutinën, burokratizmin etj.

Në bazë të eksperiencës së madhe të fituar, edhe në ushtri ne duhet të ndërtojmë një stil të ri pune, më revolucionar, që të bëhet kapercimi në cilësi. Kjo lyp pjekuri dhe Partisë e kuadrove në ushtri kjo cilësi nuk u mungon; kjo lyp thellim, zotësi, dituri, të cilat Partisë dhe kuadrove të ushtrisë sonë nuk u mungojnë.

Komiteti Qendror i Partisë ka besim të plotë se si

kurdoherë edhe tani e gjithmonë ju, ushtarë dhe oficerë
të ushtrisë sonë të lavdishme, do t'i kryeni me nder
edhe këto detyra të mëdha që ju vë përpara Partia.

Rroftë Ushtria!

Rroftë Partia!

*Botuar për herë të parë në
librin: Enver Hoxha «Raporte
e fjalime 1965-1966», f. 254.*

Tiranë, 1971

*Botohet sipas originalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

PËR ÇDO GJË TË GJYKOJMË BASHKË SI ËSHTË MË MIRË PËR POPULLIN

*Nga biseda me drejtuesit e kooperativës bujqësore
të bashkuar të Divjakës në rrethin e Lushnjës*

7 mars 1966

Në takimin me kuadrot drejtues të kooperativës bujqësore të bashkuar të Divjakës në rrethin e Lushnjës, shoku Enver Hoxha u interesua të dinte si venë punët në këtë kooperativë; nëse ka brigada më të favorizuara dhe të tjera më pak të favorizuara nga pikëpamja e vështirësive të punës; ç'shumë të hollash përbëjnë të ardhurat e burrave e të grave nga punët me ditë fikse; cila është gjendja e familjes në këtë fshat dhe nëse ka gra që e thonë fjalën e tyre në mbledhje të ndryshme. Pasi mori përgjigje për këto çështje, biseda vazhdoi:

SHOKU ENVER HOXHA: Te gratë ekzistojnë si gjykimi dhe guximi, vetëm se përpara burrave nuk kanë akoma guxim ta thonë mendimin e tyre. Edhe në shtëpi ato e ndiejnë se nuk e kanë arritur barazinë me burrin. Sipas asaj që thatë ju, unitetin në familje gruaja e kuption duke mos i dalë përpara burrit dhe jo sipas

së drejtës që mund të ketë secili. Ju duhet të krijoni një situatë diskutimesh dhe rrahje mendimesh në familje, natyrisht, pa mbajtur njërin dhe tjetrin kot në-për gojë, por që gruaja të mund të rritë guximin e t'i qëndrojë burrit në mendime edhe në shtëpi, t'i thotë se ti në këtë çështje nuk ke të drejtë. Në familje duhet të ziejnë diskutimet edhe për punët e kooperativës, që gruaja, kur të vejë nesër në punë apo në mbledhje, të jetë në gjendje të flasë. Gruaja mund të të thotë edhe ty, që je kryetar i kooperativës, se nuk po të sheh të shkosh në brigadë; atëherë në këtë rast ti duhet t'i japoësh të drejtë. Po ta bësh këtë, ajo do të marrë guxim të kritikojë jashtë edhe sekretarin e organizatës-bazë të Partisë, edhe brigadierin etj.

Në Myzeqe mentaliteti i burrit ndaj gruas në të kaluarën nuk duhet të ketë qenë si në fshatrat tonë, sidomos në malësi, ku burri ka qenë më shumë kaposh, jo vetëm brenda në familje, por edhe jashtë. Prandaj te ju më shpejt e më lehtë mund të zhduket sundimi i burrit në familje.

Po me të rintjtë dhe të rejat si zhvillohet ky fënumen? Në familjet tuaja çfarë diskutimesh bëhen nga të rintjtë e të rejat? Kush është më energjik, më i hedhur, djali apo vajza? Kush e ndien veten më të sigurt në familje? Kush ka më tepër guxim, vajza apo djali? Ja, për shembull, kryesisht në familjet tuaja.

KRYETARI I KOOPERATIVËS: Këtu ka një ndryshim të madh. Rinia është më aktive si në punë, ashtu edhe në shoqëri e në familje.

SHOKU ENVER HOXHA: Kanë ata në mendjen e tyre pikëpamje që vijnë në kundërshtim me ju? Si-

kur t'i thuash: «Ku po shkon?», kur vajza ose djali vete në kinema ose në mbrëmje, si reagojnë të rinjtë dhe të rejat?

SEKRETARI I ORGANIZATES-BAZE: Na thonë: Mos u merakosni kaq shumë për ne.

SHOKU ENVER HOXHA: Ju thatë se të rinjtë dhe të rejat kanë hov revolucionar, por vjen një moment në jetën e vajzës që ky hov bie. Ndërsa djali ecën përpara, vajza mbetet në vend. Kush e shkakton një gjendje të tillë?

SEKRETARI I ORGANIZATES-BAZE: Këtu në fshat është akoma mendimi i gabuar se, po vajti vajza 18 vjeç, duhet të martohet. Po nuk u martua deri në këtë moshë, fillojnë llafet.

SHOKU ENVER HOXHA: E preokupon vajzën gjetja e shokut të jetës dhe i ç'natyre është ky preokupim, për të mos i dalë nami i keq? Po pas martesës vrulli i vajzës në punë e në shoqëri fillon të bjerë apo të ngjitet?

SEKRETARI I ORGANIZATES-BAZE: Në përgjithësi vajza vazhdon të ecë përpara, po ka raste që martesa asaj i bëhet pengesë në këtë drejtim. Një nga arsyet është ambienti familjar. Mund të ndodhë, për shembull, që vjehrri me vjehrren të jenë njerëz me mentalitete të vjetra dhe nusja nuk arrin ta thyejë dot këtë ambient patriarkal.

KRYETARI I KOOPERATIVËS: Pastaj vijnë edhe hallet familjare. Lindin fëmijët dhe në muajt e parë gruas i mbetet pak kohë për të dalë në punët e kooperativës.

SHOKU ENVER HOXHA: Partia duhet të punojë

në masë për këtë çështje, të zbulojë pikërisht cilat janë rrethanat që pengojnë gruan, këtë faktor të madh e të rëndësishëm në jetën e shoqërisë, pse grua ja përtërin jetën, është gjysma e popullsisë dhe intelektin e ka të njëlllojtë me burrin.

Mbasi shoku Enver Hoxha foli për rëndësinë që kanë problemet shoqërore për Partinë e jetën e popullit dhe për punën e kujdeshshme që duhet bërë për zgjidhjen e tyre, ai vazhdoi:

C'mendoni ju për metodën e planifikimit që po praktikohet sivjet? C'vërejtje keni për këtë çështje? Mund të bëhet më mirë dhe si? Dëshiroj të di jo vetëm si u organizua puna për planifikimin, po edhe ç'mëndime të tjera keni në drejtim të ekonomisë, të detyrimeve ndaj shtetit, të taksave, të kuadrove që ju jep shteti etj., pra, si mendoni ju për këto gjëra?

KRYETARI I KOOPERATIVËS: Metoda e planifikimit është shumë e drejtë. Ne, pasi punuam Thirrjen në brigada, krijuam disa komisione: një për bujqësinë, një për blegtorenë, një për frutikulturën dhe një për ndërtimin. Këto komisione përbëhen nga kooperativistët më të mirë. Në brigadë ne diskutuam për drithërat e bukës dhe për kulturat e tjera, dëgjuam edhe mendimet e anëtarëve. Atje dolën rezervat e kooperativës, doli që duhet bërë punë më e madhe për kanalizimet, për hapjen e tokave të reja, për plehërimet etj. Propozimet e bëra u diskutuan mirë në të gjitha brigadat dhe çdo gjë u shqyrtua nëpër komisionet që ngritëm.

SHOKU ENVER HOXHA: Keni ndonjë rezervë drithi për ata që kanë nevojë të marrin bukë më shumë?

KRYETARI I KOOPERATIVËS: Jo, rezerva nuk

mbajmë, po sipas orientimit të ri, ne mund t'i krijojmë ato. Kjo është një gjë e mirë. Kooperativistët këtë e dinë.

SHOKU ENVER HOXHA: E kuptojnë politikisht kooperativistët këtë apo thonë që shteti na e blen lirë bereqetin, grurin dhe misrin? Atyre u duhet shpjeguar mirë problemi se shteti subvencionon SMT-të, bonifikimet, kanalizimet etj., domethënë çdo gjë kompensohet.

KRYETARI I KOOPERATIVËS: Shifrat e planit të ri pesëvjeçar mendojmë se janë të drejta, të realizueshme, por rezerva ka akoma. Ja një shembull. Në plan parashikohej të hapnim 80 hektarë toka të reja, kurse qysh tani kemi hapur 90 hektarë dhe gjer në fund të vtit do të ecim akoma më përpara.

SHOKU ENVER HOXHA: Për të kontrolluar e për të ndihmuar zbatimin e këtij plani ç'komisione duhen ngritur ose ç'mund të krijoni ju vetë në ndihmë të kryesisë së kooperativës? Duhet të ketë komisione të tilla apo jo?

KRYETARI I KOOPERATIVËS: Mendoj të jenë një ose dy komisione.

SHOKU ENVER HOXHA: Çfarë do të kontrollojnë këto konkretisht?

KRYETARI I KOOPERATIVËS: Ato do të shohin cilësinë e punës, pjesëmarrjen e forcave në punë, grumbullimin e plehut nga anëtarët etj.

SHOKU ENVER HOXHA: Po në sektorin e finançës duhet ndonjë komision për të kontrolluar investimet?

KRYETARI I KOOPERATIVËS: Këtë punë e bën

komisioni i revizionimit, i cili kontrollon anën financiare dhe dokumentet. Revizionimin e pasurisë kooperativiste e bën komiteti ekzekutiv i rrethit.

SHOKU ENVER HOXHA: Mendohet që këtë punë ta bëni ju vetë, me revizorin tuaj, kurse nga komiteti ekzekutiv mund t'ju vijnë kur të kërkonit ndihmë nga ai, prandaj ju vetë duhet të interesoheni për ruajtjen e pasurisë suaj.

Kjo është një kooperativë e bashkuar, pra, një unitet. Por nga fshatrat që e përbëjnë, njëri ka qenë në gjendje më të mirë ekonomike, tjetri në gjendje më të dobët. Në këtë drejtim shfaqen gjë kontradikta?

KRYETARI I KOOPERATIVËS: Kur u bashkuan, fshati Kular ishte në gjendje më të dobët nga ana ekonomike, prandaj kishte disa në Divjakë që nuk e deshën bashkimin me të. Por me përmirësimin e gjendjes ekonomike të kooperativës, këto kontradikta po vijnë duke u dobësuar.

SHOKU ENVER HOXHA: Ne në fillim caktuam edhe një nënkyetar për çdo fshat, me qëllim që secili prej fshatrave të kishte njeriun e tij në drejtimin e kooperativës. Po tani që u hoqën, se kaq nënkyetarë janë të tepërt, thonë gjë fshatarët?

KRYETARI I KOOPERATIVËS: Jo, sepse është forcuar besimi në udhëheqjen e kooperativës së bashkuar dhe po forcohet kështu edhe uniteti.

SHOKU ENVER HOXHA: Merrni ju kredi nga shteti?

KRYETARI I KOOPERATIVËS: Kemi marrë, po vjet dhe sivjet kemi ecur me mjetet tona financiare.

SHOKU ENVER HOXHA: Si e kuption anëtari i

kooperativës marrjen e kredisë nga shteti? Mos vallë kanë frikën se po mbyten në borxh?

KRYETARI I KOOPERATIVËS: Në fillim e kishin këtë frikë se në të vërtetë edhe kreditë që kishte marrë kooperativa ishin të shumta, po tani, duke parë që këto janë shlyer pa vështirësi nga kooperativa, ka njerëz që thonë: «Të marrim kredi nga shteti që ta zhvillojmë më shpejt ekonominë».

SHOKU ENVER HOXHA: Ti (*duke iu drejtuar kryetarit të pushtetit*) je kryetari i këshillit, ç'bëni ju, ç'kompetenca keni, a ju dëgjojnë? Si punon këshilli popullor i kooperativës? Si duhet të punojë dhe ç'kompetenca mendoni të ketë më tej këshilli?

KRYETARI I KËSHILLIT POPULLOR: Kooperativa ka këshillin popullor të fshatit të bashkuar. Veç këshillit, kemi edhe komitetin e tij ekzekutiv, që mbledh një herë në muaj. Herën e fundit në mbledhje analizuam higjienën në fshat dhe nxorëm detyra. Probleme nga masa na ngrihen më shumë për ndërtimet, sidomos për zbatimin e planimetrisë. Ne shohim gjithashtu edhe ndonjë kundravajtje, se ka raste që fshatari bën ndonjë dëm. Do të ishte mirë që anëtarët e këshillit popullor të fshatit të bashkuar të kenë edhe vetë ca iniciativë për të zgjidhur problemet.

SHOKU ENVER HOXHA: Domethënë ju keni kompetenca për ndërtime, për dëmet, për pastërtinë, për luftën kundër grindjeve dhe mërive. Po për çështjet ekonomike nuk keni kompetenca? Ju jeni pushteti i kësaj kooperative, prandaj duhet të interesoheni edhe për këto probleme.

KRYETARI I KËSHILLIT POPULLOR: Edhe për

zbatimin e statutit në rastet kur anëtarët e kooperativës mund të mbajnë ndonjë bagëti më tepër, kryesisë mund t'i shpëtojë një gjë e tillë, kurse këshilli popullor këtë mund ta ndjekë më mirë.

SHOKU ENVER HOXHA: Ne do ta rishikojmë urdhëresën e Qeverisë, po këshilli popullor i fshatit mundet dhe duhet ta ndjekë zbatimin e saj, t'i kërkojë llogari kryesisë së kooperativës kur shkëlet. Kështu duhet vepruar edhe për statutin që thotë kryetari i këshillit. Gjersa statutin e kooperativës bujqësore e keni vendosur vetë, i gjithë këshilli duhet të interesohet të kontrollojë zbatimin e tij, se ai është ligj i aprovuar nga mbledhja e asamblesë së përgjithshme të kooperativës. Kështu këshilli popullor ka mundësi të mos mbetet vetëm me ndërtimet, po të merret edhe me disa çështje të tjera të rëndësishme.

Si mendoni, u duhet dhënë pagë nga shteti specialistëve me arsim të lartë?

KRYETARI I KËSHILLIT POPULLOR: Kjo duhet parë në lidhje me forcën ekonomike të kooperativës. Në qoftë se specialisti me arsim të lartë merr në kooperativë më pak nga kolegu i tij që punon në ndërmarrje shtetërore, atëherë duhet t'i jepet pagë nga shteti.

SHOKU ENVER HOXHA: I mbetet kohë kryetarit të kooperativës të bëjë edhe ca punë prodhuese?

KRYETARI I KOOPERATIVËS: Unë që drejtoj një kooperativë bujqësore me 2 000 hektarë, mund të punoj 5 ditë në muaj.

SHOKU ENVER HOXHA: Nuk do të ishte keq të shikohej edhe problemi i industrializimit të qumështit në kooperativë. Ju mund të grumbulloni qumësht edhe

nga prodhuesit e oborreve. Kujdes të madh mendoj t'i kushtoni gjithashtu oborrit kooperativist. Parimisht dhe në praktikë kujdesin më të madh t'ia kushtoni pronës së përbashkët socialiste, ku çdo anëtar i kooperativës të derdhë energjitetë e tij më të mëdha, po gjersa Partia ka orientuar t'i lihet oborri çdo kooperativisti, edhe për këtë pjesë të pronës duhet treguar kujdes. Prandaj atë ta shfrytëzoni si duhet, të punohet mirë dhe të mos lihet pa plehëruar. Me këtë dua të them që kryesia duhet ta ndihmojë anëtarin edhe në drejtim të oborrit kooperativist, edhe për bagëtitë e oborrit, jo për të nxitur tek ai ndjenjën e pronës private, por me qëllim që çdo anëtar këtë ekonomi ta ketë një ndihmë për të plotësuar nevojat e familjes me perime dhe me prodhime blegtoreale.

Ja, për këto probleme që ngritetët dhe për çdo gjë tjetër ne duhet të gjykojmë bashkë, si duhet bërë, si është më mirë për popullin.

Botohet për herë të parë, me shkurttime, sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

NE RRUGEN E KOLEKTIVIZIMIT FSHATARESIA JONE PO NDERTON NJE JETE TE RE

Fjala në takimin me kooperativistët e kooperativës bujqësore të bashkuar të Divjakës në rrithin e Lushnjës

7 mars 1968

Shoku Enver Hoxha, pas bisedës që zhvilloi me kuadrot drejtues të kësaj kooperative bujqësore, duke dalë për të shkuar pranë një pusi eruptiv që kishte shpërthyer, u ndal e foli përpëra disa qindra kooperativistëve që ishin grumbulluar dhe po prisnin të takohen me të.

Pasi shprehu gjëzimin që ndodhej midis tyre, shoku Enver tha:

Kam besim të plotë se kooperativa juaj do të vazhdojë të përparojë, në radhë të parë, se udhëhiqet nga mësimet e Partisë, por edhe se ju vetë jeni jo vetëm njerëz të mirë, por edhe punëtorë të zotë. Të jesh njeri i mirë do të thotë të jesh njeri politik, njeri që mendon dhe përpinqesh t'i kuptosh çështjet drejt. Në saje të mësimeve dhe të rrugës që na tregon Partia, ne edhe malet

mund t'i rrëzojmë. Ne jemi në gjendje të mundim çdo armik, edhe imperialistët, edhe revizionistët modernë, ashtu sikurse i mundëm gjatë Luftës së Dytë Botërore fashistët italianë, nazistët gjermanë, ballistët, zogistët, bejlerët e agallarët. Të gjithëve u vumë drunë.

Duke dëgjuar mësimet e Partisë, ju vendosët të bashkoheni në kooperativë. Këtë vendim të drejtë e morët se e kuptuat që bashkimi bën fuqinë, që kolektivizimi do t'ju sillte, siç po ju sjell, ditë të mira, pse ai zhduku dhe do të zhdukë një herë e mirë varfërinë. Pra, duke u futur në rrugën e kolektivizimit, fshatarësia jonë po ndërton e do të ndërtojë një jetë të re. Me përqafimin e kësaj rruge ju treguat se keni një kuptim të thellë politik për kolektivizimin e bujqësisë. Populli ynë kurdoherë kështu i ka kuptuar çështjet që janë të lidhura me jetën e tij. Ai e kishte kuptuar me kohë se me luftë e me pushkë mund të fitohej liria e atdheut, se nuk u duhesin varur mëlçitë në qafë pasanikëve, bejlerëve dhe kapitalistëve. Pikërisht për këtë, populli luftoi, çlroi Shqipërinë, mori pushtetin në dorë dhe tani po ndërton me sukses jetën e lumtur, socializmin.

Ju e kuptioni, gjithashtu, se çdo gjë në vendin tonë nuk ndërtohet vetveti, por me punë, me djersë, me përpjekje të pareshtura e me luftë të papërkulur kundër vështirësive, kundër armiqve të jashtëm e të brendshëm.

Këtë kuptim të lartë politik populli shqiptar e ka arritur se ai udhëhiqet dhe edukohet nga Partia e Punës e Shqipërisë, krijesa më e shtrenjtë e tij. Duke ndjekur një vijë të drejtë, Partia studioi dëshirat dhe aspiratat e popullit, i grumbulloi ato, caktoi programin

e luftës dhe të punës që duhej bërë nga vetë populli, nën udhëheqjen e saj, për t'ua arritur qëllimeve. Kjo punë do zotësi. Dhe kur themi Partia e Funës, duhet të kuptojmë se ajo nuk është vetëm Enveri ose vetëm shokët e udhëheqjes. Partia janë të gjithë komunistët, jeni ju, është mendja e gjithë popullit. Po të mos punojnë të gjitha këto forca, punët nuk do të na shkojnë mirë, pasi këto nuk mund t'i kryejnë vetëm 1 apo 5 njerëz, ato i kryen si duhet i gjithë populli me mendjen dhe me punën e tij.

Përse themi të jetë populli në fuqi? Sepse ai, forca e bashkuar e tij, është në gjendje ta ndryshojë botën. Teoria e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit, vija e partisë marksiste-leniniste janë eksperienca, dituria, që gjithë njerëzimi, gjithë popujt kanë grumbulluar gjatë shekujve në punë dhe në luftë. Këta mendimtarë të mëdhenj kanë studiuar luftërat e popujve dhe janë bërë të pavdekshëm me veprën që na kanë lënë. Kur ju studioni Marksin, Engelsin, Leninin dhe Stalinin e mësoni edhe më mirë se luftërat, punët dhe veprat, për të cilat kanë shkruar klasikët tanë të mëdhenj, i kanë bërë njerëzit e ndershëm, klasa punëtore, fshatarësia, te të cilat partia marksiste-leniniste ka besim të madh. Kjo mbështetje te masat është ligj për Partinë tonë.

Revizionistët modernë në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera ish-socialiste, këta tradhtarë të marksizëm-leninizmit, e kanë shkelur atë, duke dalë kundër popullit, kundër klasës punëtore, prandaj pak nga pak po venë në kapitalizëm, po e shkatërrojnë socializmin, po i kthejnë këto vende në çiflig të disa grupeve. Këtë synojnë të bëjnë ata edhe në Shqipëri. Kjo do të thotë

që ne të kthehemë përsëri në kohën e beut dhe të agait, por një gjë e tillë nuk do të ndodhë kurrë, sepse Partia jonë bazohet në teorinë marksiste-leniniste, në forcën dhe në mendjen e popullit.

Në luftën dhe në punën e saj Partia jonë nuk ka gabuar, vija e saj ka qenë kurdoherë e drejtë. Por, ashtu sikurse makinave e traktoreve u ngjitet rrugës ndonjë copë baltë apo ca pluhur, kështu edhe punëve tona u është ngjitur ca burokratizëm, i cili i bën njerëzit të srollaten andej-këtej. Ka disa njerëz që, kur mbarojnë një shkollë dhe bëhen zyrtarë, u rritet mendja, «nuk ka si ne» thonë ata, «nuk kemi nge të merremi me fshatarët». Rreziku nuk qëndron vetëm te shfaqja e jashtme e mendjemadhësisë dhe e fodullëkut, por në faktin se ato kanë hyrë në ndërgjegjen e disa njerëzve. Ka nga këta që janë prekur nga disa vese, të cilat nuk kanë të bëjnë aspak me tiparet e popullit tonë, prandaj ne duhet t'ua shkulim nga rrënjet mbeturinat e vjetra në ndërgjegje. Këto janë si balta që thashë se u ngjitet traktoreve ose makinave. Partia i pa këto të këqija dhe tani u ka vënë tullumbin e madh për ta pastruar «balten», që «traktori» të mbetet përsëri i pastër dhe i gatshëm për punë të mëdha. Partia është kurdoherë në këmbë.

Ju duhet t'i studioni me vëmendje dokumentet e Partisë. Në Letrën e Hapur thuhet se në goftë se nuk ngrihet në këmbë i gjithë populli për të zbatuar deri në një këtë direktivë të Partisë, do të ketë rreziqe si ato që ndodhën në Bashkimin Sovjetik, në Çekoslovaki etj. Prandaj këtë çështje duhet ta marrë në dorë populli dhe kjo do të thotë se zot te ne është ai, i udhëhequr

nga Partia. Ja përse zyrtarët, cilëtdo qofshin ata, duhet të jenë në shërbim të plotë të popullit. Në goftë se një njeri i tillë nuk i shërben atij, kushdo që të jetë, duke filluar që nga funksionarët e lartë e gjer te punonjësi më i thjeshtë, duhet pastruar. Ose bëja mirë punën popullit, ose qërohu andej, ka të tjerë më të zotë dhe më të mirë që e bëjnë atë punë.

Me këtë dua të them që populli t'ia vërë në dukje gabimet cilidho, se për një gabim që bëhet fajin e ka jo vetëm ai që e bën, po edhe ai që nuk flet. Populli është mjeku që shëron çdo të keqe. Ai duhet t'i thotë atij që gabon: «Ku po shkon kështu, kush je ti që sillesh keq dhe shkel interesat e mia?». Në goftë se një kuadër është i mirë, kur i thua: «Shok i dashur, ç'bën kështu, eja në rregull», ai duhet ta ndreqë gabimin, por në goftë se nuk i ka mbetur gjë e mirë dhe vazhdon rrugën e gabuar, atëherë i vini drunë, sepse këtu kemi të bëjmë me interesin e gjithë popullit dhe të atdheut.

Prandaj kur shkoni, bie fjala, në dyqan dhe shihni që shitësi sillet si ai tuxhari i vjetër, ia kërcitni një herë dhëmbët, ngrini zërin ku duhet, pa të shihni si do të bëhet pulë fare. Kështu duhet vepruar edhe me atë zyrtar që ju thotë: «Dil jashtë!», kur i vini në zyrë. «Dil jashtë, ti!», i thoni. Atëherë atij do t'i mblidhen rripat medoomos se Partia e thërret, e qorton për sjellje të tilla dhe e paralajmëron që, po veproi edhe një herë tjetër ashtu, do ta ketë keq punën.

Masat që ka marrë Partia kohët e fundit kanë për qëllim t'i shërojnë këto të këqija, të forcohen kudo pozitat e popullit, që ky ta marrë mirë në dorë çdo gjë.

Kjo tregon forcën e madhe të Partisë, të popullit, të klasës punëtore dhe të fshatarësisë sonë punonjëse. Vetëm një parti marksiste-leniniste është në gjendje të bëjë një gjë të tillë, siç po bën Partia jonë. Tani, te ne, populli është ngritur i téri në këmbë dhe po punon për zbatimin e direktivave të Partisë.

Këto ditë Partia do të marrë edhe një vendim tjeter. Pagave të nëpunësve të lartë do t'u vihet gërvshëra.

Të marrim tani çështjen e ushtrisë. Oficerët janë djemtë tuaj, ata luftuan për çlirimin e atdheut dhe sot që populli është në fuqi, punojnë që ushtarët të jenë të përgatitur politikisht dhe teknikisht, të edukuar e të stërvitur mirë, të dinë të përdorin mirë armët për të mbrojtur socializmin, popullin, atdheun, Partinë. Kur ne u ngritëm në luftë, në revolucion, nuk kishim as grada, as nishane. Dolëm partizanë për të çliruar atdheun dhe jo për grada. Në revolucionet që bëhen për çlirimin e popujve, revolucionarët nuk luftojnë për grada. Megjithatë ne gjatë luftës edhe gradat i vumë, sepse armiqjtë e jashtëm thoshin se partizanët shqiptarë janë çeta bashibozukësh, që vrasin e presin; veç kësaj në ushtri na vinin shumë njerëz jo të ngritur politikisht, kështu që në ato kushte duhej vendosur edhe njëfarë discipline mbi ta.

Tani gradat po i heqim, sepse në ushtri kemi mijëra oficerë, djemtë tuaj, të cilët janë të qartë politikisht, disiplina është më e fortë, edhe dënimet janë pakësuar shumë, se ushtarët dhe oficerët, të gjithë së bashku, janë bij të popullit dhe të Partisë që e pranojnë me gjithë shpirt vijën e saj dhe luftojnë me gjithë shpirt përfat zbatuar atë. Prandaj ata nuk kanë nevojë për grada,

se ato të mënjanojnë ca nga njerëzit. Kur njëri është gjeneral do ta shohë nga lart ushtarin, por, kur nuk ka grada, atëherë fare lehtë shtrohet rrogoz me të, popullorë dhe i thotë ushtarit të revolucionit të ketë mendjen, të mësojë mirë, ta kuptojë drejt politikën e Partisë, ta mbajë mirë armën për qëllimin e shenjtë të mbrojtjes së atdheut. Po e kuptoi ushtari politikisht vijën e Partisë, ai e di mirë detyrën që ka dhe e kryen me ndërgjegje, atëherë nuk është më nevoja ta futësh në burg ose të rrish larg tij. Pra nuk ka nevojë që oficeri të jetë me grada, Kur këto çështje i shtruam me oficerët tanë, të tërë u shprehën se ishin dakord.

Në këtë situatë revolucionare, armiqve të vendit tonë u është bërë «vrima e miut 500 grosh». Armiku mje-gull do, si në Bashkimin Sovjetik, por, kur pastrohen të këqijat, siç bën Partia jonë, për armiqtë krijohet një situatë që s'dinë ku të futin kokën. Partia i ka paralajmëruar ata të kenë mendjen. Ajo ua ka dhënë mundësinë elementeve armiq të brendshëm të punojnë dhe të jetojnë me nder, por u thotë atyre të rrinë urtë se, po të lëvizin gishtin, shpata e diktaturës së proletariatit do të jetë e pamëshirshme kundër tyre. Armiqtë e kanë njohur mirë forcën e Partisë sonë dhe të revolucionit.

Shikoni sa gjëra të mira ka bërë Partia! Ju u pyetët lidhur me planifikimin dhe e thatë fjalën tuaj. Ne i kishim menduar shifrat e bujqësisë që ju dërguam, por ju i rritët ato. Partia e pa këtë çështje dhe vendosi të liheshin kooperativat bujqësore ta bënин vetë planin, se kështu do të bëhej një plan më i drejtë, më i mirë, më revolucionar. Dhe kështu ngjau. Asnjë nuk ju tha juve vëreni kaq ose aq shifrën për këtë apo atë kulturë. Kur

ju dërguam shifrat, ju vetë u ngritët dhe na thatë: «Përse të vëmë kaq kuintalë për hektar në tokat tona, kur ka mundësi të marrim më shumë?». Kjo i shërben përparimit të atdheut, i shërben përmirësimit të mirëqenies së masave të gjera punonjëse, veçanërisht fshatarësisë. Kjo që bëmë ne me planifikimin i hap horizont Partisë dhe do të sjellë me vete edhe shumë gjëra të tjera pozitive.

Tani planin e bëmë, por na mbetet gjëja më me rëndësi: ta zbatojmë atë, gjë që varet kryesisht nga puna dhe nga mendja jonë. Prandaj, që të realizohet plani, çdo njeri, kudo që të jetë, duke punuar në kooperativë si kooperativist i thjeshtë, brigadier apo kryetar, duhet të mendojë dhe jo të bëjë punë të pamenduara; kur i përvishesh punës për të prashitur më përpara nga të gjitha duhet menduar se si duhet prashitur, të prashitet mirë që të realizohet plani, sepse, po u realizua ai, ti do t'i japësh kooperativës dhe vetes më shumë prodhime. Kjo do të thotë forcim i Republikës sonë Popullore, forcim i socializmit për sot e për nesër, do të thotë të kri-johen kështu mundësítë për të ecur gjithnjë përpara.

Jo vetëm për prashitjen, po për çdo gjë duhet menduar politikisht, duhet punuar me të gjitha forcat, në mënyrë të organizuar e jo sipas qejfit. Po e more për të punuar, ta zëmë, këtë pjesë të tokës si normë, atëherë këtë duhet ta mbarosh brenda ditës. Sa më shpejt dhe mirë ta kryesh këtë punë, aq më fitim do të kesh, se kjo të lejon të hidhesh para kohe në një fushë tjetër pune.

Unë jam i bindur se planet tona në bujqësi do të

realizohen edhe sikur koha të mos na mbajë, sepse forca e vijës së Partisë, e mendjes së popullit, i kapërcen të gjitha vështirësitë. Kushdo që shikon kooperativën tuaj mbetet i kënaqur, aq më tepër ju. Edhe në rrethet e tjera, jo si ju që jeni rreth fushor, po sikur në malësitë e Shkodrës të veni, do të shikoni se si atje mijëra fshatarë u janë qepur maleve e kodrave, hapin e punojnë toka të reja dhe kanë ndërtuar tarraca. Kështu veprohet në të katër anët e Shqipërisë. Kudo punohet me një zell të tillë që nuk është parë kurrë gjatë gjithë jetës së lirë të popullit tonë. Këtë vrull të madh pune e çon përpara vija e drejtë e Partisë në të gjitha çështjet, e cila ka ngritur peshë gjithë popullin shqiptar.

Prandaj të mobilizohemi edhe më shumë të gjithë rreth Partisë, me besim të madh tek ajo, të punojmë me heroizëm dhe të themi fjalën tonë për çdo gjë. Edhe sikur ndonjëri ta thotë diçka gabim, ata që udhëheqin të mos ia marrin për keq, sepse jemi shokë e vëllezër. Kur i shtron gjërat drejt, por ndodh që thua padashur edhe ndonjë fjalë gabim, kjo nuk prish punë. Të gjithë bëjmë gabime, por shoku duhet të ta thotë ku e ke gabimin, edhe ti t'ia thuash shokut, që të korrigjoni njëri-tjetrin. Kështu duhet vepruar nga të gjithë, se, kush ta do të mirën, nuk të fërkon krahët, kur e ke gabim. Ai që nuk të do, të ledhaton dhe pastaj të jep drunë kokës. Me një fjalë, pra, të forcojmë kritikën dhe autokritikën pa druajtje, ashtu siç na mëson Partia, të kemi për njëri-tjetrin një dashuri të pastër dhe, kur e ka gabim shoku, të bëjmë të gjitha përpjekjet që ta ndreqim. Por kur ndonjëri e tepron dhe rrezikon interesin e për-

gjithshëm, atëherë duhet të merren edhe masa ndaj tij. Vetëm me një fryshtë tillë revolucionare, me qëndrime të drejta dhe serioze ndaj punës, ne do të bëhem si çeliku.

Popullit dhe vendit tonë të vogël, këtë forcë të madhe që u qëndron përballë deri Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Anglisë, revisionistëve të Bashkimit Sovjetik, Jugosllavisë titiste etj., dhe që bën të mos u trembet syri, ua jep vija e drejtë e Partisë. Popullit dhe Partisë, po të jenë kurdoherë të bashkuar, askush nuk ka çfarë t'u bëjë. Forca e tyre është e tillë sa ata bëjnë gjëra të mrekullueshme në mbrojtje të interesave të atdheut nga të gjithë armiqtë, të cilët na e kanë frikën, sepse e dinë që, po të sulmojnë Shqipërinë, nuk do të dalin dot të gjallë këtej. Titoja me shokë i kanë vënë gishtin kokës, se e dinë që, po të tentojnë të prekin vendin tonë, nuk do të ndahen mirë me shqiptarët, të cilët sytë i kanë pishë dhe do t'i bëjnë vazhdimisht katër, do të jenë vigjilentë, pse të tërë janë bijtë e këtij vendi dhe janë gati të bëjnë çdo sakrificë për të mbrojtur atdheun.

Në Jugosllavi ka disa ditë që ka folur Titoja, po, nga ana tjetër, ka folur edhe Rankoviçi. Të dy kanë vënë kujën se vendi i tyre po shkon drejt katastrofës. Vetë këta krerë të revizionizmit jugosllav thonë se janë në rrezik. Kjo ndodh sepse ata e shkatërruan që pa lindur mirë socializmin në vendin e tyre dhe e shitën Jugosllavinë tek amerikanët e si pasojë gjendja atje shkon vazhdimisht drejt rrënimimit. Kështu ndodh edhe në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera ku janë

në fuqi revizionistët. Një gjë e tillë nuk ndodh në Shqipëri, ku populli udhëhiqet nga një parti e vërtetë marksiste-leniniste, besnikë gjer në fund e popullit të vet, e marksizëm-leninizmit. Të gjitha këto masa që kanë marrë Partia dhe sipas orientimeve të saj Qeveria kohët e fundit, kanë për qëllim që vendi ynë të ecë përpëra.

Jam shumë i gëzuar që erdha sot te ju dhe pashë me sytë e mi që ju keni një kooperativë të mirë, të dalluar, nami juaj bile ka dalë edhe jashtë. Në tregjet e disa shteteve të huaja i pëlqejnë shumë domatet e Divjakës. Prandaj i vini rëndësi domates, po mos harroni të tjerat, bukën në radhë të parë, pastaj blegtorinë dhe të gjitha prodhimet e tjera. Përpinquni t'i nxirrni domatet sa më herët, sepse aq më shumë fitim do të keni. Njerëzit që ju udhëheqin i keni të mirë, kryetari i koooperativës, sekretari i organizatës-bazë të Partisë, kryetari i këshillit popullor janë të tërë shokë të mirë. Këtu ju keni një organizatë partie të fortë, të përbërë nga bijtë tuaj më të dalluar. Ata edhe gabime mund të bëjnë, prandaj u hiqni veshin, i këshilloni, se, po të vepron kështu, do të punojnë më mirë.

Kushtet i keni shumë të mira, tokën e keni afër. Sot morëm lajmin se këtu pranë jush shpërtheu një pus i ri gazi. Kur Partia do të fillojë ta shfrytëzojë atë, edhe Divjaka do të gëzojë e do të krenohet ashtu si gjithë populli ynë.

Ju falemnderit shumë për pritjen dhe vëmendjen. Këtë do t'ua raportoj shokëve të Komitetit Qendoror dhe të Qeverisë, do t'u them se në kooperativën tuaj gjeta

një popull të lidhur ngushtë me Partinë. Ju uroj jetë
të lumtur dhe suksese në realizimin e planit!

Rroftë Partia!

*Botohet për herë të parë si-
pas originalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

TE NA PUNOJË MENDJA TE GJITHËVE SI TA ZBATOJME MË MIRË DIREKTIVËN E PARTISE

Bisedë me kuadrot dhe me disa punonjës të kooperativës bujqësore të bashkuar «Stalin» të Krutjes në rrrethin e Lushnjës

8 mars 1966

Të pranishmit në takim e informuan shokun Enver Hoxha për punën që po bëhet në këtë kooperativë bujqësore të bashkuar lidhur me zbatimin e vendimeve që ka marrë kohët e fundit Komiteti Qendror i Partisë për luftën kundër burokratizmit. Ata dhanë mendime edhe për disa probleme të këshillave popullorë në fshat. Pikërisht këtej, nga çështja e pushtetit, e filloj bisedën shoku Enver, i cili midis të tjerash tha:

Pushteti ka rëndësi të madhe se atë e zgjedh populli. Këshilli popullor duhet të merret me probleme të rëndësishme që preokupojnë kooperativën bujqësore dhe fshatin. Ai do të interesohet edhe për problemet komunale në fshat, siç janë ndërtimet e rrugëve, urave, çezmave etj., po këto nuk bëhen përditë dhe nuk janë kryesoret e punës së tij. Mendoj se do të jetë më mirë

sikur ta lehtësojmë kryesinë e kooperativës nga disa probleme që mund t'i ndjekë e t'i zgjidhë këshilli popullor dhe atë ta lëmë të interesohet kryesisht për problemet e prodhimit. Kështu edhe kompetencat e këshillit zgjerohen. Ja, për shembull, ju keni marrëdhënie me kooperativën e konsumit, domethënë merrni e jepni me të, nënshkruani kontrata, po ngritët çështjen se këto kontrata herë ju, herë konsumi, nuk po i respektoni. Në këtë rast arbitër duhet të jetë komiteti ekzekutiv i rrethit, po edhe ky nganjëherë thotë se nuk i di unë këto gjëra aq sa i dini ju. Atëherë a do të jetë më mirë sikur këshilli popullor i fshatit ta marrë në dorë çështjen e respektimit të kontratave që janë akte ligjore? Këshilli është organ pushteti dhe e vë përpara përgjegjësisë kryesinë e kooperativës bujqësore, në qoftë se ajo nuk plotëson detyrimet që ka marrë përsipër duke lidhur konratë. Konratën nga ana e kooperativës bujqësore duhet ta firmosë kryetari i saj, se përgjegjësinë ai e ka përpara pushtetit dhe popullit. Nesër populli mund t'i thotë kooperativës së konsumit pse nuk na i sollët mallrat që janë parashikuar në konratë, për shembull, cimento, lëndë druri etj., po edhe kryetari i kooperativës së konsumit, në qoftë se nuk i është zbatuar kontrata, do t'i thotë popullit që vërtet unë nuk t'i solla këto materiale, po as kryesia e kooperativës nuk na i dha në kohën e duhur ato që kemi kontraktuar. Në këtë rast populli e kritikon, i kërkon llogari kryetarit të kooperativës dhe ky është i detyruar të japë shpjegimet e veta se kush e ka fajin që kooperativa bujqësore nuk prodhoi këtë ose atë mall.

KRYETARI I KËSHILLIT POPULLOR: Kompe-

tencat e këshillit popullor të fshatit janë të pakta. Në udhëzimet e fundit të Qeverisë thuhet që këshilli popullor të ndihmojë e të kontrollojë edhe kryesinë e kooperativës, kështu që zbatimi i këtij udhëzimi do ta rritë rolin e tij.

KRYETARI I KOOPERATIVES: Revizorët e kooperativave bujqësore mendojmë t'i jepen në kompetencë këshillit popullor.

SHOKU ENVER HOXHA: Komisioni i kontroll-revizionit i kooperativës bujqësore nuk është organ i pushtetit, por është një organ i zgjedhur nga mbledhja e përgjithshme e anëtarëve, i cili kontrollon aktivitetin finansiar ekonomik të kooperativës bujqësore. Tani del çështja që edhe pushteti të kontrollojë më mirë aktivitetin finansiar të kooperativës dhe të nxjerrë më shumë probleme. Prandaj, nga njëra anë revizionimin në çdo kooperativë do ta bëni vetë ju, që jeni të zotët e mallit, nëpërmjet komisionit të kontroll-revizionit të kooperativës, nga ana tjetër, mund t'i drejtoheni edhe komitetit ekzekutiv të rrethit, t'i qani hallin se gjendjen e llogarisë nuk po e sqaroni dot, prandaj keni nevojë për t'ju ndihmuar duke ju dërguar një revizor. Ne duhet të krijojmë mundësitë që çdo kooperativë bujqësore të ketë një revizor të aftë.

Komiteti ekzekutiv i rrethit nuk duhet të hyjë në të gjitha punët e kooperativës bujqësore, sikurse bënte përpara, sepse kooperativa është një organizatë ekonomike shoqërore e fshatarëve. Shteti ka të drejtë të ndërhyjë në ato hallka që parashikon ligji, siç janë lidhjet në mes kooperativave, atje ku ka kontradikta, për çështjet e kredive dhe të ndihmave të tjera të shumë-

llojta. Duke u bazuar në vendimin e Qeverisë Nr. 265, organet shtetërore ndërhyjnë gjer te gjëja më e vogël, po të zotët e mallit jeni ju. Në qoftë se ju nuk veproni drejt, organizata-bazë e Partisë në kooperativë është në këmbë, populli është këtu, prandaj ata nuk duhet të lejojnë një gjendje jo të pëlqyeshme. Në qoftë se ju doni të bëni një shtëpi kulture, bëjeni, përse të ndërhyjë shteti dhe t'ju thotë mos e bëni? Përse ta ndalojë banka e shtetit kooperativën për këtë? Ato që harxhohen janë të hollat e përbashkëta të anëtarëve, prandaj këta vendosin për çdo shpenzim. Por në qoftë se shteti sheh që të ardhurat kooperativa i shpenzon kuturu, ai ka të drejtë t'i thotë kooperativës të ketë kujdes, se kjo shtëpi kulture kushton shumë, prandaj në këtë rast shteti nuk jep kredi për një ndërtim të kësaj natyre. Shteti mund të japë kredi për ndërtime, që kanë të bëjnë me shtimin e prodhimit, prandaj kur ke të holla ose merr kredi është më mirë që më parë të ndërtosh vepra ujitëse, të ngresh bloqe me pemë frutore etj., pastaj të merresh me ndërtime joprodhuese.

Duhet luftuar kudo që mbledhjet e përgjithshme të anëtarëve, të kryesisë së kooperativës dhe të këshillave popullore të bëhen sipas rregullave. Mund të pyesë ndonjëri, gjersa për kooperativat bujqësore interesohen Qeveria dhe komiteti ekzekutiv i rrethit, atëherë përse të ndërhyjë këshilli popullor? Këshilli popullor është baza e pushtetit tonë popullor. Këshilli popullor që është zgjedhur këtu është i lidhur ngushtë me kooperativën e Krutjes, kurse këshilli popullor i rrethit dhe komiteti ekzekutiv i tij kanë lidhje me të gjithë rrethin. Ju që jetoni e punoni këtu, mendoni të gjithë për këtë koope-

rativë, kurse Qeveria rregullon marrëdhëni e përgjithshme në rrugë të drejtë për tërë Republikën. Pra, këshillin popullor të fshatit populli e ka zgjedhur të punojë edhe për mbarëvajtjen e punës në kooperativë.

Në radhë të parë kërkohet që ju të zgjedhurit si këshilltarë të merrni më shumë përgjegjësi e t'i ndani mirë detyrat, kurse kryesia e kooperativës të lehtësohet nga shumë barrë e të merret më shumë me prodhimin, pse prodhimi është çështja më e rëndësishme e saj. Po të mos realizohet prodhimi, kjo tregon se organizata e Partisë nuk është e fortë dhe se propaganda e saj nuk zë si duhet vend. Baza ekonomike e pushtetit tonë popullor është prona socialiste, prandaj puna e Partisë synon në forcimin e kësaj prone. Partia ka për qëllim të sigurojë mirëqenien e popullit, edukimin e njerëzve, kalitjen e tyre në vijën e drejtë të saj, ndërtimin e socializmit, jetën e gëzuar të masave. Kjo do të thotë të kesh çdo gjë që të duhet për një jetë të mirë, të kesh mundësi të marrësh kulturë dhe arsim. Kjo ështëjeta e re socialiste.

Si është regjimi i të ushqyerit në familje? A e përdorin mishin kooperativistët?

NJË VAJZE KOOPERATIVISTE: Ne rritim në shtëpi pula dhe pata. Ato i përdorim edhe për mish.

ZOOTEKNIKU I KOOPERATIVËS: Shumë familje rritin edhe ndonjë derr për ta therur kryesisht për dimër.

SHOKU ENVER HOXHA: Ç'kafshë mbajnë më tepër fshatarët këtu te ju? Lopë, dele apo derra?

KRYETARI I KËSHILLIT POPULLOR: Shumica mbajnë lopë.

SHOKU ENVER HOXHA: Si e përdorni qumështin që merrni nga bagëtitë e oborrit kooperativist?

NJË VAJZË KOOPERATIVISTE: Në shtëpi qumështin e përdorim për vete. Me të bëjmë gjalpë dhe ca djathë. Këta i përdorim më shumë në atë përiudhë të vitit që nuk kemi zarzavate.

SHOKU ENVER HOXHA: A mund ta përdorni më me ekonomi qumështin dhe gjalpin? Ç'sasi nga kjo mund t'i jepni kooperativës së konsumit që ajo t'ju sjellë lëndë ndërtimi ose mallra të tjera për nevojat e anëtarëve?

KRYETARI I KOOPERATIVËS: Këtë çështje mund ta shikojmë më mirë çfarë mund të bëjmë.

SHOKU ENVER HOXHA: Kooperativa juaj është e përparuar, por, nga sa po shoh, në familjet tuaja nuk ka një rregullim si duhet të ekonomisë. Për shembull, në të gatuar ju mund të përdorni më shumë zarzavate, në mënyrë ekonomike, siç bëjnë në Gjirokastër, ku dinë të bëjnë ekonomi dhe s'u vete gjë dëm. Si mendoni ju ta bëni këtë punë, se ka rëndësi. Edhe në këtë drejtim duhet shkuar përpara se zarzavatet kanë lëndë ushqyese me vlerë të madhe. Ato janë një pjesë e domosdoshme për ushqimin e organizmit të njeriut, që mishi nuk e zëvendëson dot. Çështja është që duhen kombinuar mishi me zarzavatet, se kështu shëndetin do ta keni më të fortë. Prandaj duhet luftuar shumë për prodhimin dhe përdorimin e zarzavateve dhe të mos na duken ato si diçka e dorës së fundit. Pastaj të punohet që edhe të mësohet si të gatuhen. Në këtë drejtim ju gratë e fshatit duhet të bashkëpunoni me gratë e qytetit.

Si veni tani me kooperativën bujqësore?

KRYETARI I KOOPERATIVËS: Në kooperativën tonë janë bashkuar 7 fshatra me 530· familje. Kulti-

vojmë kryesisht drithërat e bukës dhe pambukun. Nga pambuku kooperativa jonë realizon mbi 70 për qind të të ardhurave të saj. Në vitin 1965 morëm 3000 kuintalë drithëra buke mbi planin. Në sektorin e blegtorisë kemi rritje të rendimentit të qumështit. Gjer aty nga viti 1960 merrnim 600-700 litra qumësh për lopë, kurse vitin e kaluar morëm 1500 litra. Për këtë vit kemi parashikuar të marrim 1600 litra.

SHOKU ENVER HOXHA: Si arritet ta rritni rendimentin e qumështit?

KRYETARI I KOOPERATIVËS: Punuam kryesisht në tre drejtime: në përmirësimin e racës, në kriimin e kushteve më të mira si për strehimin dhe për bazën ushqimore, si edhe në zgjedhjen e punonjësve për sektorin e blegtorisë.

SHOKU ENVER HOXHA: Si punojnë brigadat dhe brigadierët? Ju duket e lehtë apo e vështirë puna e brigadierit?

BRIGADIERJA E ARAVE: Më parë kam qenë normiste. Po të bëhet çdo mbrëmje llogaria e punës së kryer gjatë ditës nga brigada, puna nuk është e vështirë, por, po ta lësh 2-3 ditë pa e bërë këtë llogari, atëherë, natyrisht, është e vështirë.

SHOKU ENVER HOXHA: Ti ke qenë normiste, domethënë ke kontrolluar punën e të tjerëve. Tani u bëre brigadiere. Si mendon, po sikur të mos ketë normist dhe punën e tij ta bëjë brigadieri? Përveç kohës që të duhet për të kontrolluar punën e atyre që ke nën drejtimin tënd, do të kesh kohë ti të punosh edhe ca vetë në ara?

BRIGADIERJA E ARAVE: Sikur nuk mbetet kohë.

Përpara se të fillojë puna, të gjithëve u jap udhëzime me hollësi.

SHOKU ENVER HOXHA: Po mirë, ja, ua dhe edhe këto udhëzime, po pastaj, çfarë bën vetë?

BRIGADIERJA E ARAVE: Kontrolloj punën dhe, pò të shoh se ndonjëri nuk e ka bërë mirë, marr vetë lopatën dhe i tregoj konkretisht si bëhet.

SHOKU ENVER HOXHA: As 1 ose 2 orë në ditë nuk të mbeten për të punuar vetë në prodhim?

BRIGADIERJA E ARAVE: Kur bëja vetëm punën e brigadierës më mbetej diçka më shumë kohë, kurse tani bëj edhe punën e normistes.

SHOKU ENVER HOXHA: Si e bëni këtu punën politike të Partisë?

SEKRETARI I ORGANIZATËS-BAZE: Përpiqemi të zbërthejmë vendimet e Partisë, duke zhvilluar tema politike, edukative me punonjësit në bazë brigade dhe fshati.

ZOOTEKNIKU I KOOPERATIVËS: Materialet që na vijnë nga lart janë shumë të mira.

SHOKU ENVER HOXHA: Na fol më konkretisht pse, sepse ne mendojmë që janë më të mira ato që bëni ju vetë në bazë.

ZOOTEKNIKU I KOOPERATIVËS: Ja, kam në duar një material që flet për metodën e bindjes. Ky material na ndihmon se si t'ua shpjegojmë problemet kooperativistëve si nga ana teorike, ashtu edhe nga ana praktike.

SHOKU ENVER HOXHA: Fshatari ka nevojë për t'i shpjeguar e për ta sqaruar për problemët që e preoku-

pojnë. Dhe kjo kërkon bindje. Ja, për shembull, kur gruaja ose vajza e tij e re i thotë një fjalë dhe ai ia kthen: «Pusho, ti, aty, rri aty ku je, se jam unë këtu i zoti i shtëpisë!», e bind dot ti atë që t'i heqë këto mbeturina?

Eshtë në interes të punës së Partisë që organizata-bazë të kapë e të trajtojë problemet më të rëndësishme, siç janë edhe problemet shoqërore. Organizata e Partisë duhet të dijë si zhvillohetjeta shoqërore në shtëpi, si i kanë lidhjet të rintjtë me babanë e me nënën, që janë ca më të vjetër, si janë lidhjet e dashurisë dhe të respektit reciprok midis burrit dhe gruas, a gjen gruaja pengesë nga burri, mos vallë burri e ndien veten më superior, a bisedohet e diskutohet në familje për punën që bëni, për filmat dhe për librat.

Çështjet shoqërore kanë rëndësi të madhe për Partinë dhe popullin, prandaj këto ne duhet t'i trajtojmë si Parti. Sado i përparuar të jetë fshati, ku më shumë e ku më pak, në mos në mënyrë të dukshme, në ndërgjegjen e njerëzve ekzistojnë akoma mentalitete të vjetra feudo-borgjeze e fetare, patriarkale e konservatore. Nga ato që ngjasin në fshat organizata-bazë e Partisë duhet të dalë me disa konkluzione të përgjithshme. Kundër këtyre mentaliteteve duhet të bëhet një punë politike dhe shkencore e thellë, por e kujdeshme, që të mos cenohen ndjenjat e njerëzve. Veç formave të tjera të punës që mund të përdorë organizata, ajo mund të udhëzojë të bëhet edhe një leksion, po ama një leksion ku duhet të spikatin pjekuria dhe zgjuarsia e kuadrove të Partisë. Ai të jetë me probleme konkrete, pa prekur fare emrat e shokëve, me përjashtim të ndonjërit

që e ka tepruar, bile edhe ky të qortohet me takt, në rrugë partie, se këto janë çështje delikate. Ky do të ishte leksioni më i mirë, sepse është i lidhur me gjendjen e kolektivit apo të organizatës dhe tjetri, edhe pse nuk përmendet me emër, e gjen veten, gjen mësimin si të veprojë në të ardhmen. Po kështu me takt të veprohet edhe në luftën kundër fesë. Ju në fshatin tuaj keni kishë, e cila nuk mund të prishet pa vullnetin e popullit, po fshatarëve duhet t'ua shpjegojmë se nga kisha dhe xhamia në të kaluarën popullit i kanë ardhur vetëm të këqija dhe sot ato ushqejnë mbeturinat nga të cilat pengohen njerëzit në shumë drejtime.

Organizata-bazë e Partisë, me punën e saj bindëse dhe sqaruese, t'ia bëjë të qartë masës se shumë të këqija e kanë burimin te ideologjitet reaksionare. Pikërisht marksistët i luftojnë këto ideologji në mënyrë dialektike, revolucionare, jo me masa administrative, po me metodën e bindjes dhe jo me një bindje të thjeshtë e formale, sepse kjo do të ishte e përkohshme dhe shpejt do të transformohej në urdhër, kurse po t'ia shpjegosh tjetrit fill e për pe çështjen që nuk e ka të qartë, ai këtë nuk e merr si urdhër, por si bindje të ndërgjegjshme dhe të qëndrueshme.

Këtej e tutje kështu do të bëhet, do të rritet niveli i punës me njerëzit. Këtu do të njihet zotësia e sekretarit të organizatës-bazë dhe e komitetit të Partisë. Partia drejton gjithë jetën e vendit politikisht, ekonomikisht dhe moralisht dhe sekretari i organizatës-bazë duhet të jetë nga shokët më të ngritur në çdo drejtim. Po të jetë kështu, puna do të shkojë medoemos mirë, se të tërë do të bëhen të ndërgjegjshëm. Kur ju thotë, për

shembull, shoqja brigadiere të punoni mirë, kjo zbaton një detyrë të caktuar në harmoni me vijën e Partisë, pse, po të punosh mirë, do të marrësh 15 e më shumë kuintalë pambuk për hektar, do të kesh të ardhura më të mira, do të rrosh mirë, do të hash e do të vishesh mirë, do të kesh më shumë kulturë në fshat, radio e mjete të tjera elektrike në shtëpi, se jetë socialiste nuk do të thotë vetëm të punosh. Që të kuptohen drejt këto, ka rëndësi të madhe që puna e Partisë të bëhet mirë.

Ti, si zooteknik, si njeri partie, duhet të vrasësh mendjen dhe të ecësh me parimin që kooperativistëve jo vetëm t'u mësosh mirë anën teknike të çeshtjes, po këtë ta shoqërosh me një shpjegim të tillë që ata të kuptojnë, në radhë të parë, anën politike të zbatimit të masave shkencore në zootekni. Tani ne do t'i orientojmë rrethet që ato të mendojnë vetë për këtë çeshtje, se nuk do t'ua përgatitim më ne nga qendra leksionet. Direktivën e Partisë ju e merrni dhe e përpunoni në kushtet tuaja.

Më poshtë shoku Enver Hoxha, pasi foli për disa probleme shoqërore lidhur me gruan, pyeti:

Si venë nxënësit tuaj në shkollat 2-vjeçare? Keni libra të shkruar nga specialistët tanë ose të përkthyer për problemet e zooteknisë? Ua mësoni rritësve të viçave e mijëreseve anatominë e kafshëve, fazat e ndryshme të rritjes, karakteristikat e viçave, llojet e ushqimeve që duhet të përdorin, vlerën e tyre etj.?

Më thoni, është mirë që është ngritur shkolla 11-vjeçare në kooperativën tuaj?

ZOOTEKNIKU I KOOPERATIVËS: Për mendimin

tim me këtë profil të përgjithshëm që ka, nuk është mirë. Duhet menduar t'i ndërrohet profili kësaj shkollë, të kthehet në shkollë bujqësore.

KRYETARI I KËSHILLIT POPULLOR: Te disa gjimnazistë tanët është tendenca që të marrin ndonjë bursë për t'u bërë inxhinier e mjek dhe t'i shmangen bujqësisë.

SHOKU ENVER HOXHA: Arsimi ynë ka karakter popullor dhe në universitet do të dërgojmë edhe djem e vajza nga fshati, po do t'i dërgojmë në ato degë për të cilat ka më shumë nevojë ekonomia. Përpara neve na mungonin njerëzit me kulturë të përgjithshme, na mungonin kuadrot e lartë, as mësues nuk kishim, prandaj Partia orientoi që të shtrihet në masë arsimi 7-vjeçar dhe 11-vjeçar. Ajo tregoi kujdes për të përgatitur mësues për këto shkolla dhe tani arritëm që në të gjitha shkollat fillore të kemi mësues me arsimin përkatës. Kështu siç përgatiten mësuesit, përgatiten kuadro edhe për sektorët e tjera të ekonomisë e të kulturës. Universiteti, si gjer tani, edhe në të ardhmen do të përgatitë vazhdimesh kuadro, por do të përgatitë aq sa kanë nevojë sektorët e ekonomisë dhe të kulturës, e jo sa nxjerrin gjimnazet. Pra del problemi të hapim më shumë shkolla profesionale. Tani del nevoja që të gjithë të rinjtë e të rejet të mbarojnë shkollën 8-vjeçare, e cila do të jetë baza e kulturës së përgjithshme. Pastaj ata do të venë gati të gjithë për 2-3 vjet në shkolla profesionale që të bëhen teknikë të mesëm. Për të tillë ne kemi nevojë të madhe, sidomos në bujqësi. Tani ne kemi edhe kuadro për t'i drejtuar këto shkolla. Kështu, kur të kemi plotësuar nevojat e një dege, atëherë për-

kohësisht nuk do të nxjerrim më kuadro për atë degë ose do të nxjerrim më pak dhe pjesa më e madhe e nxënësve do të dërgohet në ato degë që do të ketë më shumë nevojë. Kështu kjo çështje do të jetë kurdoherë në lëvizje te ne dhe Partia do ta shohë me kujdes.

Mund të na thotë shoku që merret me problemet e rinisë, si janë lidhjet e organizatës suaj me shokët përgjegjës të kooperativës, ç'ndihmë konkrete i jepni ju ekonomisë së organizuar, ç'punë bëni në lidhje me edukimin dhe mobilizimin e rinisë, ç'kujdes i kushtonit punës politike të rinisë për prodhimin? Kur shihni se brigadieri ka kthyer 2-3 herë punën e disa kooperativistëve si të papërshtatshme, bëni mbledhje ju dhe e shikoni përsë ka ngjarë një gjë e tillë? Keni durim në lidhje me edukimin e rinisë?

SEKRETARI I RINISË: Rinia e kooperativës është kudo, në ara, në administratë, në blegtori etj. Po kemi disa të rinj që nuk e dëgjojnë kolektivin, nuk marrin pjesë rregullisht në punë. Ata nuk i kemi pranuar në organizatë se, po t'i pranonim, do të na prishnin të tjera.

SHOKU ENVER HOXHA: Po t'i lësh jashtë organizatës të rinj të tillë është më keq. Ata janë njerëzit tanë, çfarë do të bëjmë me ta, t'i lëmë të enden lart e poshtë? Prandaj organizata e rinisë nuk duhet të jetë sektare; as nuk duhet të tërhiqet përpara vështirësive që mund t'i dalin për t'i edukuar ata. Nuk është mirë të lihen jashtë organizatës një pjesë e të rinjve me sjellje jo të mira, ose që nuk binden etj. Natyra e njerëzve është e ndryshueshme, nuk është

si thotë filozofi pesimist, Shopenhaueri¹, se natyra e njeriut është e pandryshueshme. Ne, marksistët, themi se njerëzit, me ca durim, edukohen, ndryshohet natyra e tyre. Prandaj duhet me qenë më i gjerë me njerëzit.

Si i keni marrëdhëniet punë-edukim? Si interesohen posaçërisht për ju komunistët dhe organizata-bazë e Partisë?

NJË I RI: Nga ana e shokëve të komitetit të Partisë ndihma për ne është e mirë. Kudo ku kemi ndihmën e anëtarëve të Partisë kemi edhe rezultate më të mira.

KRYETARI I KËSHILLIT POPULLOR: Punën me më të vegjëlit, përgjithësisht me pionierët nuk e kemi në dorë si duhet.

SHOKU ENVER HOXHA: Ne kemi dhënë një porosi që, përpara se të shfaqet një film, është mirë të ngarkohet qysh më parë një njeri ta studiojë atë, të përgatitet t'u flasë spektatorëve të vegjël për anët pozitive dhe njëkohësisht t'u tërheqë vëmendjen edhe për anët negative. Kjo është një formë pune që ndihmon në edukimin e tyre, prandaj i zbatoni këto porosi.

Nga ky takim me ju mësova shumë gjëra. Këtu te ju bëhet një jetë e gjallë me ngjarje të shumta. Si kudo, edhe këtu shikoj një përparim të madh. Njerëzit janë të lidhur me punën, e cila është faktori kryesor i kalitjes së ndërgjegjes së tyre dhe kjo është

1 Filozof idealist gjerman (1788-1860), përfaqësues i irracionalizmit.

shumë pozitive. Lidhja e ngushtë me punën dhe ndërgjegjja e lartë revolucionare që ekzistojnë edhe në fshatarësinë tonë janë një pasuri e madhe për vendin. Fshatarësia ka luajtur një rol të madh në përparimin e atdheut.

Tani na vihet detyrë që punën ta çojmë më përpara, me hapa të mëdhenj. Ne kemi krijuar baza të shëndosha për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë, mbi të cilat duhet të ecim. Sot në të gjitha kooperativat bujqësore janë mundësítë e një zhvillimi të mëtejshëm. Këtë perspektivë e hapën, e ndriçuan vetë masat punonjëse, të cilat realizuan me sukses direktivat e Partisë në çështjen e planifikimit. Planifikimi që bëtë ju në bazë të eksperiencës që kishit fituar, i tejkaloit direktivat dhe orientimet e qendrës. Kjo tregon se ju keni një eksperiencë të madhe në prodhim dhe në organizimin e punës, ju përgatitët një plan më të madh nga kuotat që ju erdhën nga lart dhe shoh se nuk keni asnje frikë ose mosbesim se ai nuk do të realizohet. Por, po të vihem i të gërmojmë, del se ka akoma rezerva, prandaj çdo ditë të përpinqemi t'i zbulojmë dhe t'i shfrytëzojmë ato. Për pesëvjeçarin që vjen, na vihet detyra që këtë plan ta realizojmë çdo vit, njërin pas tjetrit.

Ju e kuptioni që viti i parë i pesëvjeçarit ka rëndësi të madhe në historinë e vendit tonë, pse është viti i parë i një hovi të ri të madh përpara, që do të kryhet me një shpirt revolucionar akoma më të madh. Shpirt të madh revolucionar ka pasur kurdoherë Partia. Ky shpirt e ka çuar atë gjithnjë përpara, po tani, duke lutfuar disa të meta e gabime, shihen një përmirësim, një

shtytje më e madhe. Ky duhet të jetë një vit bazë, një nxitje për ta forcuar më shumë besimin tonë, përtë ecur përpëra gjatë viteve që vijnë. Prandaj këto që kemi vendosur në plan, duhet t'i realizojmë, pse jo vetëm që do të na sjellin të mira materiale të mëdha konkrete, po do të forcohet edhe bindja në popull dhe sidomos në masat e kooperativistëve që kjo vijë, ky stil, kjo metodë pune na dhanë gjithë këto gjëra të mira.

Ju thatë vetë se nga lopët, përpëra, merrnit vetëm 700 litra qumësht në vit, kurse vjet arritët të merrni 1500 dhe këtë vit parashikoni 1600 litra. Prandaj të përpinqemi që të krijojmë bindjen reale te njerëzit që me një organizim dhe punë më të mirë, brenda një viti, ju do të arrini të merrni edhe 100 litra qumësht më shumë për çdo lopë.

Ka rëndësi të madhe për njerëzit, shokë, bindja në forcën mendore dhe fizike të tyre. Në metodën e organizimit të punës të krijohet bindja se puna është kryesorja. Mund të bjerë shumë shi, mund të mos bjerë fare, por, po të punojmë si duhet, do të kemi rezultate të mira. Sigurisht, po të mbajë koha dhe klima të jetë e mirë, patjetër këto do të jenë të favorshme, po me punën e madhe që po bën fshatarësia jonë, pavarësisht nga kushtet atmosferike, ne do të kemi patjetër suksese, do të ecim përpëra. Kjo është me shumë rëndësi. Njerëzit do të thonë: gjithë këto suksese i arritëm pikërisht se punuam, po të mos kishim punuar, nuk do ta kishim realizuar planin. Kjo do të jetë një forcë e madhe që do të ndihmojë për kuptimin më të mirë të kësaj vije.

Prandaj, të vëmë të gjitha forcat që t'i realizojmë deri në një këto detyra të mëdha, shokë dhe shoqe. Për këtë, në radhë të parë, ka rëndësi që të gjithë të bëhem i ndërgjegjshëm dhe t'i bëjmë edhe të tjerët të ndërgjegjshëm për politikën e drejtë të Partisë. Për të gjithë ne, për të gjithë punonjësit të bëhet e qartë se është e domosdoshme që çdo njeri të jetë një organizator i mirë në punën që ka, të mos e kuptojë këtë si çështje shumë të thjeshtësuar, por ta kuptojë politikisht. Ka forma organizimi të punës që i ndihmojnë Partinë, kryesinë, pushtetin, atëherë duhet punuar që çdo njeri të arrijë që këto forma t'i zbatojë dhe t'i përmirësojë vazhdimesht. Agronomi mund të të udhëzojë si ta prashitësh misrin dhe ashtu duhet të bësh, po çdo njeriu duhet t'i punojë mendja për të gjetur format dhe mënyrat për ta prashitur edhe më mirë nga sa udhëzon ai. Zootekniku udhëzon rritëset si t'i trajtojnë viçat, po ai jep vetëm një orientim të përgjithshëm, prandaj mendja e tyre duhet të vihet në lëvizje dhe të gjejë format dhe rrugët më të përshtatshme si ta zbatojë sa më mirë këtë orientim. Një gjë e tillë nuk bëhet pa menduar. Kudo ne kemi njerëz punëtorë revolucionarë, njerëz partie, kemi një rini të mrekullueshme që, po t'ua shpjegojmë si duhet politikisht detyrat, mobilizohen dhe dinë si t'i kryejnë ato. Të na punojë, pra, mendja të gjithëve si ta zbatojmë më mirë direktivën e Partisë. Po të bëhet kështu, ne me siguri do të kemi suksese të mëdha në realizimin e detyrave.

Do të flas edhe për një çështje tuajën. Ju e dini shumë mirë që punët e bujqësisë janë si hallkat e një

zinxhiri të madh që vijnë njëra pas tjetrës. Në qoftë se lë mangut ndonjërën, atëherë ka pasoja në gjithë zinxhirin, prandaj çdo gjë, nga fillimi e gjer në fund, duhet të ndiqet me kujdes. Të gjitha punët kanë procesin e tyre, kryerja mirë e të cilave varet vetëm nga lufta dhe puna që do të bëhen. Të jetë e qartë për të gjithë, se këshillat e sekretarit të organizatës-bazë të Partisë, të kryetarit të këshillit popullor ose të kryetarit të kooperativës janë të domosdoshme dhe në këtë drejtim ne kemi një detyrë të madhe. Ne, udhëheqësit, duhet ta kuptojmë se jemi zgjedhur në udhëheqje jo për t'u kapardisur, po për t'ua bërë të qarta të gjithëve detyrat që do të kryejnë.

Po si do t'i plotësojnë sekretari i Partisë, kryetari i kooperativës etj., këto detyra? Në qoftë se do të mendojnë të japid vetëm urdhra, do të gabojnë. Gjithash tu në qoftë se do të mendohet që sekretari ose kryetari të jenë kudo, të copëtohen fizikisht, edhe kjo nuk ka si të bëhet. Rëndësi ka që drejtuesi të ketë syrin në të gjithë sektorët ku punohet dhe këtej të nxjerrë ku janë dobësitë e si duhet të ndreqen. Ai duhet të mendojë thellë, të thërrasë njerëzit, të këshillohet me ta, të marrë mendimin e tyre, t'i nxitë ata të mendojnë dhe të sugjerojnë. Nga e gjithë kjo punë, nga të gjitha këto këshilla, të përpinqet të mësojë dhe, mbasi të gjejë zgjidhjen më të drejtë të çështjes, të dijë pastaj të vëré në lëvizje vartësit e bashkëpunëtorët, t'i bëjë këta njerëz me iniciativë, që të kuptojnë thelbin e organizimit të punës dhe rëndësinë e një udhëzimi teknik. Domethënë njerëzit udhëhiqen nga ne, ata presin shumë, presin jo vetëm këshilla, po edhe mënyrën si

ta zbatojnë një direktivë, një orientim. Po edhe ne presim gjithashtu nga masa. Kjo është ndihmë e madhe reciproke.

Të përfitojmë sa më shumë, shokë, nga kushtet e mira klimaterike të këtij viti, të punojmë tokat mirë, të mbjellim në kohën e duhur dhe me sukses, t'u bëjmë të gjitha shërbimet e nevojshme kulturave bujqësore, të mos pritet që çdo gjë të zgjidhet në mënyrë spontane, përkundrazi të ecet në mënyrë të organizuar. Të gjitha këto duhet t'i dinë mirë dhe t'i kenë të qarta kooperativistët, të kuptojnë se ngritja e rendimentit dhe shtimi i prodhimit do të shërbejnë, në radhë të parë, për përmirësimin e jetës të gjithë koooperativistëve, por edhe si një kontribut që jep koooperativa bujqësore për ndërtimin e socializmit në Shqipëri. Të arrijmë që me punën e Partisë dhe të kooperativistëve, të ngrihet prodhimi në një shkallë më të lartë. Në qoftë se nuk do t'ia arrijmë kësaj, nuk kemi për të pasur suksese.

Detyrimet ndaj shtetit kooperativistët t'i kuptojnë si një detyrë të madhe politike, pse shteti është i tyre dhe përparimi i fshatarësisë nuk mund të kuptohet pa aleancën e saj me klassën punëtore, pse fshatarësia ka nevojë për rroba e këpucë, për vegla pune, për materiale ndërtimi etj., që bëhen nga mendja dhe nga duart e punëtorëve. Nga ana tjetër edhe punëtori duhet të hajë e të pijë, pra ka nevojë për produktet që prodhon fshatarësia kooperativiste. Çështja e çmimeve varet nga një punë e kujdeshme dhe nga rezultati i harmonishmë i të gjithë sektorëve të jetës së vendit tonë.

Ne duhet të punojmë që të prodhojmë sidomos

drithëra buke. Kemi besim që në vitet e ardhshme do të arrijmë të marrim edhe më shumë drithëra nga ç'kemi marrë dhe për këtë do të bëjmë të gjitha përpjekjet. Për këtë qëllim edhe shtimi i prodhimit të patates, që e kemi bërë një aksion të madh, do të na ndihmojë shumë. Në vitin 1970 ne do të arrijmë të mbjellim më shumë patate, gjë që do të na ndihmojë të vijmë duke e shkurtuar importin e drithit, derisa ta ndërpresim fare.

Patatja jep rendimente të mëdha. Në kushtet e sotme një hektar tokë e mbjellë me misër jep 15-20 kuintalë, kurse me patate mbi 80 kuintalë. Pataten në të ardhmen ne do ta bëjmë miell dhe do ta përzicjmë me miellin e grurit për të bërë bukë shumë të shijshme. Pra, të bëjmë kujdes të jashtëzakonshëm për pataten. Populli ynë e njeh këtë kulturë dhe patjetër do të kemi suksese në këtë çështje të rëndësishme.

Masat e rëndësishme që po merr Partia, siç është vendimi për luftën kundër burokratizmit, problemet që ngre Letra e Hapur e Komitetit Qendror etj., janë shpëtimtare. Me këto masa ajo nuk do të thotë se aparatet e shtetit dhe të Partisë sonë kishin humbur frymën revolucionare, nuk do të thotë se aparatet tona ishin degjeneruar në llumin e tendencave borgjeze e mikroborgjeze, po disa të meta që kishin zënë vend ishin serioze, prandaj duheshin shkulur nga rrënjet. Për këtë qëllim duheshin marrë të tilla masa, duhej praktikuar një metodë e stil i tillë revolucionar që të ngriheshin në këmbë Partia dhe populli. Për t'i arritur kësaj duhet folur haptazi me njerëzit se atëherë populli të kupton më mirë. Po t'i thoshe përpara një njeriu se transfero-

hesh në një vend tjetër ose ulesh në përgjegjësi, ishte telash i madh. Kurse gjatë kësaj kohe rreth 40 mijë veta kanë lëvizur dhe i kanë pritur mirë qoftë transferimin, qoftë edhe uljen e pagës. Ata, sa u bëri thirrje Partia, të gjithë thanë: «Jemi ushtarë të saj, po shkojmë atje ku na dërgon ajo».

Edhe në ushtri u hoqën gradat dhe u rivendos funksioni i komisarit, u ngriten komitetet e Partisë. Para se të zbatoheshin këto masa, u bisedua dhe të gjithë dhanë mendim pozitiv, ishin plotësisht dakord me mendimin e Partisë. Masat që u morën ata i gjykuani të drejta dhe po i zbatojnë me entuziazëm. Për këtë ndihmuan edhe bindja, shpjegimet politike, sqarimet që iu dhanë njerëzve me kohë. Ushtarët dhe oficerët tanë në çdo kohë janë gati të venë të vriten për atdheun dhe Partinë. Ata nuk luftojnë për të siguruar grada. Edhe kur ishim partizanë nuk kishim grada. Askush nuk të njihte nga gradat, po nga lufta që bëje. Kur jepej urdhër nga komandanti dhe komisari, partizanët e zbatonin, hidheshin edhe në zjarr me fjalën e Partisë në gojë. Këtë e bënin ideali i Partisë, politika e saj e drejtë, qëllimi i lartë për të cilin luftonin. Ne atëherë dolëm në mal për të çliruar popullin e atdheun, për të vendosur pushtetin popullor dhe jo për grada. Për të tilla ideale të larta vriteshin atëherë partizanët. Ata ishin të ndërgjegjshëm për detyrat e tyre, të gjithë duheshin shumë me njëri-tjetrin. Edhe tani njerëzit luftojnë për ndërtimin e socializmit, janë edhe më të ngritur ideologjikisht, kanë më shumë eksperiencë. Pra edhe në këto kushte të kesh grada nuk pajtohet me karakterin tonë revolucionar.

Në vendin tonë çdo ushtar e di politikisht përse shërben në ushtri, përse na duhet ushtria dhe çfarë duhet të mbrojë ajo, di se oficeri është vëllai i tij dhe ia dëgjon fjalën, pra nuk ka nevojë për grada.

Masat që kemi marrë kohët e fundit ndihmojnë për ta forcuar pushtetin tonë popullor. Po të mos merreshin këto masa, nuk do të ishte mirë. Partia jonë qëndron në pozita të forta, sepse ecën në rrugën marksiste, prandaj ajo është në gjendje të bëjë të tilla reforma të mëdha revolucionare. Populli ynë i ka pritur me gjëzim këto masa. Ai e di se çdo reformë që bën Partia është në të mirën e tij, prandaj i përqafon shpejt ato.

Populli është i thjeshtë, i drejtë, punëtor. Edhe Partia është e thjeshtë, e drejtë, punëtore, pse është pjellë e popullit të vet. Masat që po merr janë në rrugë të drejtë revolucionare popullore. Populli i aprovon ato dhe shton besimin e dashurinë ndaj Partisë. Kështu kilitet uniteti dhe vendi ynë bëhet më i fortë në atë shkallë që, sado i vogël që është, përballon vështirësi të shumta. Kjo ka krijuar një situatë jashtëzakonisht të mirë për gjithë popullin e Shqipërisë.

Lufta që ka bërë dhe bën Partia jonë ka ngjallur një admirim të madh edhe jashtë vendit te të gjithë popujt. Bile ka edhe armiq, të cilët, në radiot dhe gazetat e tyre janë të detyruar të flasin me respekt për Shqipërinë. Por ne të mos e humbasim vigjilencën. Të punojmë që jo vetëm ata që janë të paqartë të sqarohen, po edhe ndonjërin që është në pozita të lëkundura të mos ia lëmë armikut. Si kurdoherë, edhe tani ka armiq që hedhin parulla kundër Partisë e pushtetit popullor. Prandaj njerëzit duhen sqaruar, kurse elementët

armiq duhen paralajmëruar të kenë mendjen, të ulin kokën e të punojnë; të mos i ngrenë veshët se ndryshe u ikën koka. Pra kundër armiqve të jemi të pamëshirshëm. Direktivat e mëdha të Partisë në lëmin ekonomik dhe politik t'i bluajmë mirë në kokë, t'i thellojmë e t'i zbatojmë.

Në Indonezi ka ndodhur një tragjedi e madhe. Nuk kemi akoma një lajm të saktë, vetëm dimë që partia atje është në momente të rënda. Janë vrarë e grirë me dhjetëra e mijëra komunistë nga reaksioni, me udhëheqjen nuk dimë ç'ndodh. Radiot e huaja thonë se Aidi-tin e të tjerë i kanë vrarë, po asgjë nuk është e sigurt, mund të jetë edhe propagandë për të demoralizuar njëzet. Partia gjer tanë nuk ka dalë me ndonjë deklaratë, brenda edhe mundet, po jashtë asgjë nuk po merret vesh. Kjo të lë të kuptosh se ose ka ngjarë diçka në drejtim të udhëheqjes, ose partia nuk e ka marrë veten akoma.

Përse ngjau atje kjo katastrofë? Partia dukej sikur ishte në pozita të forta. Shokët indonezianë na thoshin se ishin të organizuar edhe për një luftë kundër reaktionit, se partia kishte forcat e veta në ushtri, në aviacion e kudo, se partia ishte një nga pjesëtaret më me influencë të NASAKOM-it, në të cilin përfshihen grupe e parti përparimtare me Sukarnon në krye. Kjo ishte pak a shumë politika e një fronti të përbashkët për luftë kundër imperializmit. Nga ana tjetër, atje ekzistonte edhe grupi i gjeneralëve që përfaqësonin reaktionin më të madh dhe që ishin të lidhur me SHBA-në.

Nuk është hera e parë që ngjet kjo në Indonezi.

Edhe më 1948 reaksiioni likuidoi udhëheqjen e partisë në orvatje për të marrë fuqinë në dorë. Më vonë partia e mori veten. Reaksionarët më se një herë kishin organizuar komplotë për të vrarë udhëheqjen dhe për të rrëzuar Sukarnon që nuk favorizonte sa duhet grupin e gjeneralëve. Edhe kur organizuan puçin e parë reaksionarët ishin përsëri kundër Sukarnos, i cili për të dytën herë u ndodh përpëra një puçi ushtarak dhe s'mori masa kundër reaksiونit. Ai është një borgjez, ka disa ide përparimtare, por pozita e tij ndaj nesh është e lëkundshme, për të mos thënë më tepër. Prandaj ne nuk flasim asnje fjalë të mirë për të, por nuk dimë ç'mendon dhe ç'bën atje partia komuniste.

Gjeneralët reaksiونarë indonezianë organizuan një komplot për të marrë fuqinë në dorë, ndërsa Untungu, komandant i gardës presidenciale të Sukarnos, më 30 shtator të vitit që shkoi pushkatoi 6 gjeneralë reaksiونarë. Kryesori i këtyre, Nasutioni, shpëtoi dhe menjëherë mori kundërmasa. Mbi këtë grusht shteti nuk jemi akoma të qartë, po fakt është se veprimi i Untungut nuk u quajt që në fillim nga partia si një puç kundërrrevolucionar, përkundrazi ajo e mbështeste. Duket qartë që këtu ka pasur gisht edhe partia, po nuk e kishte organizuar mirë, prandaj fare lehtë reaksiioni u kthyte dhe e goditi rëndë atë. Shikoni ç'është puçi, ai nuk zgjidh asgjë. Problemet i zgjidh vetëm revolucioni, masat popullore në luftë revolucionare, ashtu siç bëri Partia jonë gjatë luftës, e cila edhe agjentët, spiunët dhe oficerët e armikut i vriste, edhe luftën e vazhdonte. Tani në Indonezi po luftohet nga të katër anët. Duke vrarë 6 gjeneralë udhëheqja e partisë atje kujtoi se e

likuidoi reaksionin; tani është ky që u kthye dhe po bën kërdinë mbi komunistët.

Sukarnoja këta 2-3 muaj ka qenë i mbyllur në pallat dhe nuk ndihej fare. Ditët e fundit ai doli përsëri në dritë. Si duket ka qenë në përgatitje për të rimarrë forcat në dorë, formoi një qeveri të re dhe hoqi Nasutionin e disa të tjerë nga postet si ministra. Kjo qeveri ka, si të thuash, njëfarë pamjeje demokratike kundër grupimeve ushtarake. Sukarnoja foli se Partisë Komuniste Indoneziane do t'i ngrejë një monument se ajo ka luftuar për lirinë e Indonezisë. Këto janë fjalët e Sukarnos, kjo është demagogjia e tij. Çfarë mendon të bëjë tani partia, nuk dimë gjë. Në qeverinë e parë të Sukarnos kishte edhe komunistë, kurse tani nuk ka. Vëtëm kaq dimë. Dimë gjithashtu që kohët e fundit sekretarin e sindikatave indoneziane e kanë dënuar me vdekje, por nuk e kanë ekzekutuar akoma. Edhe Untungu është dënuar me vdekje. Në qoftë se Sukarnoja mendon t'i forcojë pozitat e tij, këta do të falen.

*Botohet për herë të parë, me
disa shkurtimë, sipas origjinalit
që gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

MASA GJYKON ME MPREHTËSI DHE SYTË I MBAN TE PARTIA

Nga biseda me anëtarët e byrosë së Komitetit të Partisë, të Komitetit Ekzekutiv dhe të kryesive të organizatave të masave të Rrethit të Lushnjës

8 mars 1966

Gjatë qëndrimit në rrethin e Lushnjës, shoku Enver Hoxha bëri një takim me anëtarët e byrosë së Komitetit të Partisë, të Komitetit Ekzekutiv dhe të kryesive të organizatave të masave të Rrethit të Lushnjës. Ai i pyeti shokët për disa çështje të luftës kundër burokratizmit dhe, pasi mori përgjigjet e u informua për disa drejtime kryesore të punës së Partisë në rrëth, shoku Enver Hoxha tha:

Dëshiroj të theksoj se në lidhje me metodën dhe stilin e punës ne nxorëm mësimë të mëdha dhe kemi besim se do të kemi rezultate shumë të mira. Megjithatë, të kemi kujdes të mos e zbatojmë shablon ose të themi se kjo është metoda më e mirë që kemi gjetur, por ta shikojmë si do të vërtetohet në jetë. Puna që po bëjmë është e mirë dhe duhet ta pasurojmë vazhdimisht

me eksperiencën e Partisë në bazë, pse ka shumë mundësi që kjo eksperiencë të na mësojë ta bëjmë atë edhe më mirë. Për ta bërë më mirë duhet që mbi këtë vijë të drejtë të përgjithshme, të reflektojmë të gjithë lidhur me metodën e punës dhe kurdoherë të përpinqemi të gjejmë forma e metoda të reja pune. Këtu çështja është më e vështirë se, që të gjejmë metodën më të mirë të punës në të ardhmen, duhet të na punojë mendja vazhdimisht si ta bëjmë atë. Natyrisht, vetëm puna me një frymë të re do të na japë rezultate të mira.

Ne përpara kishim si metodë pune në Byronë Politike, në Qeveri dhe në Sekretariat të bënim nga një mbledhje në muaj, po mbasi puna nuk na ecte, i bëmë nga dy në muaj. Mirëpo e pamë se as kështu puna nuk na ecte dhe shikonim se angazhonim mjaft shokë, mbasi çdo mbledhje kërkon të përgatiten materialet përkatëse mbi çështjet që do të shqyrtohen. Vetë praktika na mësoi se nuk bënim dot dy mbledhje në muaj, prandaj përsëri filluam të bëjmë nga një. Pastaj morëm disa masa të tjera, shkurtuam materialet që të na vinte vetëm thelbi i çështjes, duke u nisur nga fakti se shumë herë në këto materiale na bëhej propagandë. Jo vetëm kaq, po për diskutimet në Byronë Politike vumë edhe disa norma, vendosëm që secili problemin ta shprehte me pak fjalë, duke e argumentuar këtë, se në Byronë Politike nuk është nevoja të rrish ta shtjellosh çështjen, po të thuhet ku është thelbi, të thuash: «Unë jam përkëtë variant dhe parashtroj arsyet që më detyrojnë të jem përkëtë», pra, ta zëmë kaun për briri. Po edhe kështu shpesh bëheshin diskutime të zgjatura. Kjo nuk është një metodë pune e mirë.

Në mbledhjet e Byrosë Politike dhe të Sekretariatit të Komitetit Qendror ne merrnim disa çështje në shqyrtim, kurse në Qeveri merreshin shumë më tepër. Tani, me metodën e re të punës, brenda këtyre dy muajve ne kemi bërë mbledhje të Byrosë Politike, të Qeverisë dhe të Sekretariatit më shumë nga sa kemi bërë gjatë 6 muajve, mbledhje edhe substanciale, edhe ekspeditive e me vendime të rëndësishme, e megjithatë nuk e kemi ndier veten shumë të ngarkuar. Praktika po na mëson se nuk ka rëndësi të caktojmë sa mbledhje në muaj duhen bërë. Ne duhet të bëjmë mbledhje sa herë e shikojmë të nevojshme.

Të gjitha masat që morëm kohët e fundit jo vetëm dolën nga Byroja Politike, po gjatë kësaj kohe filloi një lëvizje e gjerë për zbatimin e tyre në të katër anët e Shqipërisë. Ne vetë në udhëheqje dhamë shembullin duke kritikuar metodën e punës sonë jo të zhđervjellët që e kishit marrë edhe ju. Tani që ndryshuam ne këtë metodë, edhe ju po lëvizni, por puna nuk ka mbaruar me kaq. Ky është vetëm fillimi, ta ndjekim gjer në fund këtë çështje.

Tani filluam punën me një stil të ri, por ka rrezik të kthehem përsëri në stilin e vjetër, prandaj të mos dehem nga fillimi i mirë, po të reflektojmë vazhdimisht, si e qysh ta përmirësojmë konkretisht punën në vijën revolucionare që po ndjekim. Kjo nuk është as e lehtë, por as e vështirë për ne, sepse Partia jonë ka tani një eksperiencë të madhe. Fakti është se një sinjal jep ajo dhe të tërë, komunistë e pa parti, ngrihen më këmbë. Ata e kuptojnë se në këtë drejtim ne nuk kemi écur mirë, prandaj duhet ta përmirësojmë punën. Sidoqoftë,

kujdes ne duhet të kemi, pse mund të na mbulojë përsëri rutina e vjetër.

Të kemi parasysh se ne që merremi me punë partie ose pushteti, jemi të tërë punëtorë partie. Ne që punojmë në aparatet e Partisë duhet ta njohim punën e pushtetit se jemi përgjegjës edhe për pushtetin, edhe për ekonominë tonë të re, për tërë ndërtimin e socializmit. Ne duhet të mendojmë që të gjejmë format më të përshtatshme për një punë politike sa më të mirë për ngritjen ideopolitike të njerëzve, të mendojmë si ta kalitim njeriun e ri me virtytet e larta të Partisë, të pjekur nga ana politike dhe ideologjike, të kujdesej mi që çdo punonjës të përvetësojë sa më mirë teknikën e punës në çdo sektor që e kanë caktuar. Përgjegjësia jonë e madhe qëndron në atë që, duke qenë punëtorë partie, të punojmë në mënyrë që t'i bëjmë njerëzit, në radhë të parë anëtarët e Partisë, po edhe të gjitha masat, të kenë një përgatitje të mirë ideologjike dhe të mendojnë politikisht, pse vetëm kështu ata mund të kryejnë detyrat në lëmin shoqëror, ekonomik e kulturore, në ndërtimin e socializmit, për të krijuar mirëqenien e përgjithshme.

Dua të them me këtë se edhe detyrat e pushtetit duhet të kryhen të shoqëruara me një punë politike intensive. Që të bëhet kjo, nuk do të thotë që ne të marrim punën e njëri-tjetrit, që punëtorët e Partisë të marrin kompetencat e punonjësve të pushtetit, duke vënë çështjen që Partia udhëheq. Punëtorët e Partisë nuk duhet ta kuptojnë kështu këtë çështje, prandaj për kryerjen e gjithë këtyre detyrave të përbashkëta, po edhe

specifike, Partia dhe pushteti duhet të koordinojnë veprimtarinë e tyre.

Veprimitaria e Partisë në drejtim të edukimit të punonjësve duhet të jetë e madhe, intensive. Përmbi të gjitha këtu të kemi parasysh se çdo gjë varet nga njeriu. Në qoftë se njeriu e kupton detyrën që ka, në qoftë se është i ndërgjegjshëm, i ngritur politikisht dhe ideologjikisht, pra që të dijë të punojë me hov revolucionar dhe me perspektivë; atëherë do të jetë më lehtë për realizimin e planit. Prandaj detyra e punonjësve të Partisë është që të bëjnë një punë të studiuar, duke marrë parasysh periudhat e ndryshme të vitiit në sektorë të ndryshëm, por jo në mënyrë mekanike. Kështu, për shembull, kur vjen radha e triorimit duhet të bëhet medoemos kjo punë, kur afron koha për mbjellje duhet të punohen tokat, të mbillen etj.

Lidhja e anëtarëve të Partisë dhe e udhëheqësve me masat është një nga detyrat kryesore të Partisë, ndryshe ajo do të mbyllej në guaskën e vet. Pa lidhjet me masat, Partia nuk ka si i gjykon veprimet e saj. Masa me mprehtësinë e vet gjykon për çdo gjë dhe sytë i mban te Partia, prandaj ai që ka teserën e Partisë në xhep duhet të jetë i drejtë, i ndershëm, i sakrificës. Për një komunist që nuk i ka këto cilësi masa mund të heshtë përkohësisht dhe këtë e bën për respektin që ushqen ndaj Partisë, po kur ai e mbush kupën, masa flet: Situata e sëmurë e organizatës së Partisë në Këmishtaj është marrë vesh në të gjithë fshatin. Atëherë, gjersa është kështu, pse shokët e komitetit të Partisë të rrëthit mbështeten vetëm në bisedime me dy veta, me sekretarin e organizatës-bazë të Partisë dhe me kryeta-

rin e kooperativës? Në këtë rast të bisedojmë jo vetëm me udhëheqësit, po të vemi në organizatën-bazë dhe problemin ta shohim në vend, të analizojmë të mirat dhe të metat, familjaritetin e sëmurë që ekziston në këtë organizatë. Po të ketë njeri që dëshiron të mendohet akoma, sekretari i komitetit të Partisë të rrëthit të kërkojë që mbledhja të ndërpritet, të vazhdojë më vonë, që të mund të shqyrtohet rrënjosht problemi dhe të zgjidhet drejt, ndryshtë ai do të zgjidhet me mballoma.

Në qoftë se nuk zgjidhim gjë në organizatën-bazë, prapë duhet të mendojmë që problemit t'i gjejmë rru-gëdalje, të vemi të konsultohemi me masën, ta shqyrtojmë drejt me të, në mënyrë që popullin ta përgatitim politikisht dhe, kur të marrim vendim, ai të jetë i qartë e të mbetet i kënaqur.

Çështja është që shokët e Partisë duhet të ndërrojnë metodën e punës. Sekretari i organizatës-bazë, kuptohet, është një nga më të ngriturit, më të aftit për t'i gjykuar drejt problemet, për të drejtuar mbledhjen dhe për t'i ndihmuar shokët në mendime, në gjykime, në qëndrime. Ai duhet të jetë një njeri, i cili, qoftë jashtë mbledhjes ose edhe në mbledhje, kur t'i vejë një shok e t'i qajë një hall, çështjen t'ia zgjidhë në mënyrë të pjekur.

Në organizatat-bazë duhet të ndihet edhe roli i sekretarit apo i anëtarit të byrosë të komitetit të Partisë të rrëthit. Si e gjykon ju, a është e frytshme ndihma që jepni? Po me horizontin që hapet tani, ç'mendime keni për metodën tuaj të punës? Ju përpara, shkonit të përgatitur, informoheshit më parë mbi gjendjen e organizatës, mbi predispozicionin e anëtarëve të Partisë,

shkonit me pikëpamjen që organizata-bazë duhet të nxitet të vetëveprojë, të diskutojë, të japë mendim, apo shkonit me mendimin që ju, komunistë të organizatës, mendoni e flisni si të doni, kjo s'ndryshon gjë, pse unë e kam gjetur që këtu lart zgjidhjen e çështjes? Gjer në ç'shkallë ka qenë një metodë e tillë pune dhe a është e lehtë të shkëputesh prej saj dhe të praktikohet një formë e re pune?

Një çështje e rëndësishme për punëtorët e Partisë, duke filluar që nga ju sekretarët, është që duhet të mos kufizoheni vetëm në disa probleme ekonomike. Kur shkoni në fshat, në përgjithësi gjëja e parë për të cilën interesoheni është plani, sa e qysh është realizuar ai dhe u qepeni shifrave. Pastaj pyesni nëse u bë mblehdha e rinisë, e gruas, nëse ka pasur kritika dhe gjëra të tjera të kësaj natyre. Interesimi më i madh kryesisht ka qenë për çështjet ekonomike. Kjo është gjë e mirë, se edhe këto janë të rëndësishme, po interesimi i parë dhe kryesor i Partisë duhet të jetë për punën me njerëzit që i realizojnë këto plane. Punëtorët e Partisë të synojnë që njerëzit të bëhen të ndërgjegjshëm me qëllim që ata t'i ndjekin mirë mbjelljet, t'i mbajnë mirë traktorët, të zgjedhin farën, të bëjnë në kohë e me cilësi prashitjet etj., etj., të përcaktojnë çfarë duhet bërë nga ana e pushtetit, që ky të japë të tërë ndihmën, të marrë të gjitha masat e nevojshme, që nga ana teknike këto detyra të realizohen.

Por nuk është vetëm kjo puna jonë si punëtorë partie. Ne duhet të interesohemi, në radhë të parë, për organizatën-bazë, c'qëndrim mban atje secili komunist, si është gjendja shpirtërore e masave.

Ne duhet t'ia arrijmë asaj që organizatat të mos bëjnë sehir kur është fjala për çështjet që preokupojnë masat, qofshin ato edhe çështje familjare dhe kjo është e domosdoshme. Për shembull, një baba nuk e lë vajzën të vejë në kinema, atëherë t'i themi shoqes së saj të vejë ta bindë këtë baba dhe ta udhëzojmë se si ta bindë, ose njëri u grind me gruan dhe ka rrezik të ndahet, detyra e punëtorit të Partisë është t'i pajtojë; ose kur dëgjon që pa të drejtë njëri mban nëpër gojë njerëzit, komunisti ta këshillojë; ose një djali është jokorrekt në sjelljen ndaj vajzave, atëherë merre dhe mësoji moralin proletar etj. Nga të gjitha këto çështje ne, si punëtorë partie, duhet të nxjerrim disa konkluzione pse puna me njerëzit është një detyrë e veçantë dhe neve na bie barra ta bëjmë këtë. Në qoftë se sekretari ose organizata-bazë nuk janë në gjendje ta bëjnë këtë punë, komiteti i Partisë duhet ta udhëzojë organizatën jo vetëm se si ta bëjë mbledhjen, po t'i tregojë se ç'problem duhet të analizojë ajo, duke u bazuar në njohjen e gjendjes. Në qoftë se në kooperativën bujqësore janë të theksuara, për shembull, konceptet konservatore e patriarkale për gruan, e cila nuk trajtohet mirë, atëherë komiteti i Partisë i thotë organizatës-bazë ta analizojë çështjen dhe të dalë me konkluzione se ç'duhet të bëjë për ta ndrequr frontalisht këtë, se nuk është çështja e një gruaje, por është problemi i gruas në përgjithësi. Një çështje e tillë nuk zgjidhet as në një ditë, as në disa vjet, por kur del përpara një problem jetik i rëndësishëm për gjithë rrethin ose për kooperativën bujqësore, udhëheqja duhet të dalë me konkluzionin që gjendjen ta përmirësojë me etapa, nëpërmjet një pune

politike dhe ideologjike të menduar mirë dhe kjo të mbështetet me një veprimtari konkrete.

Çështjen e gruas, pra, ta prekim frontalisht. Shokëve, në kooperativat bujqësore ku shkova, u bëra pyetjet: Pse ngjet që në fillim vajza e re është dinamike në punë, kurse vjen një moment që ndalet hovi i saj në kohën që fejohet? Përse fejesa t'i bëhet vajzës pengesë, gjersa për të kjo është një ngjarje e madhe, e gjëzuar, me rëndësi për jetën e saj? Përkundrazi, gjersa është kështu, hovi revolucionar në punë vajzës duhet t'i shtohet, pse tani ka pranë edhe shokun e jetës. Ky është një moment që ne duhet ta studiojmë me kujdes, t'i gjejmë edhe çelësin, i cili do të ndihmojë që ky hov të mos ulet. Duket qartë se këtu ka diçka që pengon, mundet që faktor negativ është burri.

Pasi martohet, gruaja lind. Edhe lindja është një gjëzim i madh në jetën e saj, pse ajo përtërin jetën, prandaj, as në këtë rast, nuk mund të themi që gjëzimi i ul hovin në punë, përkundrazi këtë ne e konfondojmë me një situatë objektive. Nga pikëpamja fizike gruaja ka nevojë për një ndërprerje të punës prej 3 muajsh para dhe pas lindjes dhe këtë ne duhet ta kuptojmë; gjatë kësaj kohe ajo nuk mund dhe nuk duhet të punojë. Këtë e parashikon edhe ligji. Burri gjëzohet për lindjen e fëmijës, po atij mund t'i ngjallen kuçot e vjetra dhe të kërkojë që gruaja e tij pas lindjes të rrijë në shtëpi dhe të rritë fëmijën, se s'ka kush e bën këtë. Prandaj, në qoftë se ne nuk e kuptojmë politikisht problemin e çerdheve, bëjmë gabim. Cerdhet e kopshtet kanë rëndësi të madhe jo vetëm për rritjen e mirë të fëmijës, për të cilët duhet të kemi kujdes, por sidomos për faktorin

nënë, përfaktorin grua. Duke siguruar çerdhe, ku grua-ja çon fëmijën, ne i themi asaj me këtë të ecë përpëra, të mos tronditet nga ndërprerja e përkohshme e punës, i themi se fëmijën ta kemi siguruar, prandaj hidhu në punë. Kështu do të luftohen jo vetëm mbeturinat e vjetra të burrit, po edhe të vjehrrit dhe të vjehrrës, do të luftohen huqet e tyre dhe nusja e re do të lehtësohet.

Këto probleme nuk mund të trajtohen si duhet vetëm në leksionet që dërgohen nga lart. Leksionet e qendrës mund të janë vetëm orientuese nga pikëpamja e vijës politike, kurse përfundimisht tjerat, përfundimisht rastet konkrete duhet t'u punojë vetë koka shokëve të bazës.

Prandaj, kur shkojmë në bazë, të ndjekim një metodë pune që ta bëjmë organizatën-bazë luftarake, të aftë që t'i kuptojë drejt problemet dhe zgjidhjen e tyre e të mos presë vetëm çfarë t'i dërgojë Tirana. Shokët e bazës, pra, të mendojnë vetë sipas karakteristikave dhe kushteve të çdo kooperative përfundimisht tilla probleme shoqërore që t'i zgjidhin frontalisht me mundësitë e tyre. Mund t'i dijë më mirë Tirana hallet e të gjitha fshatrave tuaja? Ju këto halle i dini vetë më mirë, ato i di dhe është në gjendje t'i përballojë ashtu si duhet organizata-bazë.

Pra, puna jonë si udhëheqës partie është një punë e gjerë dhe e gjallë me njerëzit. Kështu në punën me rininë, me gruan, në luftën që duhet të bëjmë kundër fesë dhe shumë fenomeneve të tjera negative, të përpinqemi që të kalojmë nga metoda individuale e bindjes, në një punë më të gjerë në kolektiv. Atë ne duhet ta bëjmë më të zhđervjellët, më të kuptueshme, pse kështu do të kemi një zhvillim të jashtëzakonshëm të mendimit

dhe të veprimit revolucionar masiv. Puna e Partisë është një punë me përgjegjësi të madhe, jo një punë shkel e shko, burokratike, me formula. Një punë e tillë burokratike nuk ecën, nuk jep rezultate. Qoftë në Parti, qoftë në pushtet nuk duhet të ketë burokratizëm. Sido-mos në pushtet është mjaft ngjitëse sëmundja e burokratizmit, pse atje ka njerëz që vijnë nga aparatet e pushtetit të përbysur. Rreziku më i madh është po të ketë në Parti burokratizëm pse, po u prek Partia nga burokratizmi, atëherë sëmundja mbulon gjithçka. Në Parti vërshon presioni i mbeturinave të vjetra që mbar-tin njerëzit, prandaj na vihet detyrë që të tillë njerëz t'i pastrojmë nga këto mbeturina, të bëjmë me ta një propagandë të zgjuar, të shkathët, të kuptueshme, t'i kalitim politikisht dhe t'i bëjmë sa më të lidhur me punën.

Në bazë të orientimit të Partisë ne duhet të reflek-tojmë dhe të gjejmë kurdoherë zgjidhjen më të drejtë të çdo problemi. Të shkojmë kurdoherë nga parimi që përpara se të vemi, për shembull, për të kryer një de-tyrë në fshat, duhet të reflektojmë shumë në bazë të vendimeve që kemi marrë. Gjatë gjithë natës, bile edhe rrugës kur jemi duke u drejtar për atje, të mendojmë cila është forma më e mirë e punës që duhet të kryejmë për t'i dalë mbanë kësaj pune dhe jo të themi atje pesë fjalë. Kjo nuk do të ishte e mirë.

Ne kudo kemi me të vërtetë njerëz shumë të mirë. Njerëz të mirë kemi edhe në dy kooperativat bujqësore që vizitova. Ata kanë mendime me vlerë për çështjet e pushtetit, të organizatave shoqërore dhe të ekonomisë. Dy shokë të këshillit popullor dhe të kooperativës kanë

qenë instruktorë partie dhe puna që bëjnë tregon se ata janë njerëz të zotë. Po të kemi kudo në bazë njerëz të tillë që punojnë e mendojnë thellë, puna do të marrë me siguri një hov të madh.

Shokët e këshillave popullore të dy kooperativave kérkuan të marrin më shumë kompetenca, duke arsyetur që kryesia e kooperativës të interesohet e të përgjigjet vetëm për prodhimin, kurse për të gjitha çështjet e tjera të marrë përgjegjësi këshilli populor. Ky tani mblidhet dhe interesohet gjoja për shëndetësinë, por në fakt asnjë rol nuk luan, interesohet për punët komunale, po edhe atje shkel e shko bëhet puna. Në të dyja këto fshatra vura re se në shumë vende toka vete dëm, fshati ka qenë dhe akoma është i shpërndarë, pse edhe shtëpitë e reja kështu janë bërë. Shumë tokë përdoret për të bërë rrugë të gjera, si bulevardet në qytete, pra, vete dëm, në një kohë që me të mund të zgjidhen mjaft halle. Po të caktohet që rrugët kryesore të fshatit të kenë vetëm gjerësinë e nevojshme për të kaluar qerrja ose makina dhe rrugët e tjera për këmbësorët nga një metër, do të kurset mjaft tokë. Këshilli atje mund të vendosë sa duhet të jenë rrugët e fshatit dhe të gjitha pjesët e tjera që mbeten, të punohen. Vëtëm nga rrugët në Divjakë, mund të ekonomizohen më shumë se 10-12 hektarë tokë. Po pse shpërdorohet toka me rrugë aq të gjera në vend që të përdoret ajo për prodhim? Ja një front pune për pushtetin në këto fshatra.

Në Divjakë dhe në Krutje më thanë se kooperativa e konsumit lidh vetë kontratë me kryesinë e kooperativës bujqësore për sasinë e lëndës së drurit që i duhet

kësaj për nevojat e veta, kurse për nevojat e anëtarëve kooperativa e konsumit nuk çan kokën fare. Megjithatë unë pashë se si Divjaka ashtu edhe Krutja janë mbushur me shtëpi të reja. Po ku e gjen makinën individi, i cili e sjell lëndën për të bërë shtëpi nga një rreth tjetër? Kjo tregon se anëtarët e këtyre kooperativave drutë, çimenton etj., i kanë gjetur në rrugë jo të drejtë. Në fshat ne kemi kooperativën e konsumit për të bërë tregti me kooperativat bujqësore dhe anëtarët e tyre, po ajo nuk bën një tregti të zgjuar, mjaftohet të thotë kaq e kam planin për kooperativën dhe për anëtarët, po deshët merrni beze ose kalema, për të tjerat, që mund t'ju duhen juve s'më përket mua kjo punë. Përse të mos interesohet kooperativa e konsumit për këto nevoja të fshatarëve? Bashkimi Qendror i Kooperativave të Konsumit ka planifikuar që anëtarët e kooperativave bujqësore të dorëzojnë kundrejt pagesës 20 për qind të sasisë së qumështit që disponojnë, pa u interesuar fare për nevojat e tyre. Kjo është një tregti e fjetur, që i nxit anëtarët të bëjnë batakçillëqe, në një kohë kur Partia bën një punë të madhe që punonjësit të jenë të ndershëm. Fshatari ynë është i ndershëm, po ai ka nevojë të ndërtojë edhe shtëpi, ka nevojë edhe për artikujt e konsumit të përditshëm. Mirëpo për të tillë nevoja kooperativa e konsumit as që mendon. Pra punonjësit në të dyja këto kooperativa bujqësore më ngritën shumë probleme.

Duke ardhur nga qendra, brenda dy ditëve unë shkova në dy kooperativa, kurse ju që jeni vazhdimisht këtu, duke pasur plus edhe gjithë ata instruktorë, duke pasur edhe aparatin e komitetit ekzekutiv mund të bëni

shumë gjëra. I aktivizoni ata të gjithë me radhë. Njëri nga ju mund të shkojë në një kooperativë, të marrë takim me sekretarin, me disa komunistë, me fshatarë dhe, po t'i dëgjojë me kujdes, ata do t'i ngrenë shumë probleme dhe ai do ta njohtë si duhet situatën. Ne që vijmë nga qendra për disa ditë, edhe të duam, atë punë që bëni ju, nuk e bëjmë dot. Prandaj ju punoni të lidheni e ta njihni më mirë bazën, t'i njihni mendimet e njerëzve dhe nibi këtë bazë njohtoje të dilni me konkluzione për çdo problem, në radhë të parë për punën politike me punonjësit, me anë bisedash, referatesh të kuptueshme etj. Nga takime të tillë ju do të kuptoni nëse del nevoja e një referati që duhet të bëni me popullin për një problem të caktuar, mund të konstatoni që nga ana teknike kuptimi i një problemi nuk është i qartë, prandaj të bëni përpjekje që ai të kuptohet edhe teknikisht. Kur konstatoni, fjala vjen, se për një urdhëresë nuk ka kuptime të qarta, kjo është një çështje që i përket atij që drejton pushtetin, prandaj thirreni dhe i thoni të marrë masat e duhura. Ai sigurisht do të dërgojë njerëz në vend për ta shtruar këtë çështje. Kështu, pra, nga një punë e gjallë me masat, juve ju dalin shumë probleme perspektive. Këto duhen njohtur dhe keni mundësi t'i njihni. Format dhe metodat e punës përpikuani t'i perfeksiononi. Kjo do të jetë një ndihmë e madhe për Komitetin Qendror.

Prandaj situatën duhet ta njohim mirë kudo. Njerëzit ne duhet t'i mësojmë të jenë kurdoherë objektivë në paraqitjen e gjendjes, me anët e mira dhe me të metat, sepse ndodh shpesh që, kur vete në bazë ndonjë nga ne, shokët e udhëheqjes, mendohet që sa të jetë e mundur

të mos na thuhet gjë, «të mos i prishim gëzimin», të mos i themi se «punët nuk venë mirë» etj. Ky nuk është qëndrim i drejtë sepse niset nga pikëpamja e një respekti jo të shëndoshë. Tjetrit ç'ke, thuaja troq, kjo nuk ecën kështu, këtë nuk e kam arritur për fajin tim dhe këtë tjetrën nuk e arrij dot më, pse tani varet nga ju. Ne duhet të krijojmë kudo një situatë luftarake dhe besimi në vetvete. Kritika dhe autokritika kudo të jenë të forta, të bazuarë dhe të vlejnë për t'i ndrequr gabimet. Vetëm kur Partia është luftarake, atëherë secili është zot në punën e tij.

I pyeta shokët e Krutjes se ç'e donin gjithë atë shtëpi të madhe kulture. Ata më thanë se e do populli. Mirë, dakord, populli mund ta dojë, por, po të isha unë, do të ngrija zërin, do t'i thosha popullit se nuk është aspak e arsyeshme të shpenzohen 8-9 milionë lekë për një shtëpi kulture që nuk e ka as Lushnja akoma, e cila është qendra e rrethit. Ndërtimi i saj më duket diçka e parakohshme. Kur ndërtohet një shtëpi kulture, duhet të matesh. Një të tillë e ka bërë Gjirokastra, po ajo është qytet i madh, banorët janë të grumbulluar dhe kanë mundësi t'i ndjekin çdo natë aktivitetet e saj. Kur se në kooperativën bujqësore «Stalin» të Krutjes janë bashkuar 4 fshatra, larg njëri-tjetrit, banorët e të cilëve e kanë të vështirë të vijnë gjithnjë deri në qendër të kooperativës bujqësore për të ndjekur aktivitetet e shtëpisë së kulturës. Dua të them se ky është një objekt i madh për kooperativën. Edhe zyrat e kooperativës po të kësaj madhësie janë parashikuar. Është e vërtetë se tani populli ynë që është i lirë e përparon ka shumë gjëra që i do, po sikur këto shpenzime të tepërtë të

shfrytëzohen për diçka tjetër, sidomos për shtimin e prodhimit, do të ishte më mirë, kurse për shtëpinë e kulturës të shpenzoheshin 2-3 milionë. Jua them këtë që të keni më shumë kujdes në të ardhmen. Unë nuk doja t'ua prishja zemrën se i kishin hedhur themelet dhe nuk u thashë gjë, po kujdes, ecni me kujdes, shokë, në këto çështje.

Te ju gjithashtu po bëhen edhe ndërtesa të mira banimi. Kjo tregon që niveli i jetesës së masave punonjëse po rritet gjithnjë, por edhe këtu të ruhet thjeshtësia, e cila është një nga karakteristikat më të mira të popullit tonë dhe shembullin për këtë ta jadin komunistët. Ata të janë kurdoherë modestë. Nuk them që sekretari i organizatës-bazë në Krutje të mos bëjë shtëpi të re, po pashë se shtëpia që është duke ndërtuar ai, ia kalon shumë niveli të jetesës së kooperativistëve. Ngri-tja e një shtëpie të tillë nuk tregon modesti. Natyrisht, ai paratë i ka fituar me djersë, po anëtari i thjeshtë i kooperativës do të mendojë: Ja, e bëri edhe sekretari i Partisë pallatin e tij!

Ju, shokë të Lushnjës kjeni parasysh se tërë puna që keni është në fshat dhe për fshatin. Bujqësia është kryesorja për ju, të gjitha të tjerat janë të dorës së dytë e të tretë, prandaj bëni që jo vetëm ju, udhëheqësit e Partisë në rreth, po të gjithë, pushteti, administrata, t'i kenë sytë nga fshati. Kooperativa e konsumit që furnizon edhe qytetin, të mos mendojë të furnizojë Lushnjen në radhë të parë, po të mendojë së pari për fshatin, pastaj për qytetin. Lushnja është një rreth i rëndësishëm bujqësor, prandaj kjo detyrë duhet pasur kurdoherë parasysh.

Edhe artizanati gjithashtu të mendojë në radhë të parë për fshatin, ku të çojë edhe lopata e shata, pse shpesh në fakt atje nuk ka as vegla pune. Atëherë përsë punon artizanati? Duket pra se punonjësve të këtij sektori nuk u është bërë e qartë politikisht kjo çështje. Partia thotë: «Mos rrini në zyrë, shkoni në bazë se atje është puna». Po të venë në fshat ata të artizanatit, do t'i njohin më mirë nevojat e fshatarësisë dhe do të marrin masa për t'i plotësuar ato.

Të gjitha këto probleme, shërbimet e të gjitha të tjerat me radhë duhet të harmonizohen dhe të mos e harrojmë fshatin, pse, kur të jetë fshati mirë, do të jetë mirë edhe qyteti. Me këtë nuk dua të them që të mos e zbukurojmë qytetin, jo, se ai është qendra e rrethit dhe fshati këtu do të marrë shembullin e qytetërimit. Edhe në këtë drejtim qyteti i vjen në ndihmë fshatarësisë. Në qytet fshati merr edhe ndihmë morale, intelektuale dhe shumë gjëra të tjera. Sidoqoftë në konceptet tona të jetë e qartë që jo çdo gjë për qytetin dhe fshati të lihet në dorë të dytë. Këtë ta kuptojnë drejt shokët që kanë të bëjnë me fshatin.

Punët na shkojnë mirë, kudo në vendin tonë ka një situatë shumë të gjallë luftarake, pavarësisht se ka edhe disa njerëz që hezitojnë të venë atje ku i dërgon Partia. Vështirësitetë nuk duhet të na trembin, ato janë të zakonshme, jeta i ka këto se njerëzit nuk janë të gjithë njëlloj, po forca e Partisë, drejtësia e vijës së saj duken qartë dhe përqafohen nga masat. Ka edhe ndonjë që turbullon ujërat, po këto janë përjashtime, mund të zënë vend një, dy, tre muaj, pastaj me punën e Partisë do të eliminohen.

Ju kujtohet se, kur para disa vjetësh u çmobilizuan një numër i madh oficerësh, u krijua një gjendje e vështirë, pse, sa u çmobilizuan, të tërë mbetën nëpër dyert e organeve të Partisë dhe të pushtetit. Kjo ndodhi sepse puna me ta nuk u organizua mirë. Më vonë çeçot tanë, trima në luftë, na u bënë mekanikë, kryetarë koooperativash, sekretarë organizatash-bazë etj. Kurse këta që shkojnë tani në fshat kanë një kuptim të drejtë që në fillim për këtë masë revolucionarizuese, sepse edhe niveli i punës së Partisë është rritur. Po sado i vendsur të jesh, secili që vete në një punë të re ka edhe njëfarë shqetësimi, derisa të stabilizohet familjarisht. Ka edhe ndonjë shok që, kur vete në fshat, i vjen rëndë të marrë me vete gjithë ato mobilje që ka bërë, se tani që transferohet, këto i ka si pengesë.

Fajin për këto mobilje të rënda nuk e kanë vetëm këta shokë. Mania e disa njerëzve për të blerë gjëra të kushtueshme është njëra anë e së keqes. E keqja tjetër qëndron te orientimi i industrisë. Zdrukthëtaria «Misto Mame» nuk përgatit veçse mobilje luksi me rimeso të lustruar, të veshura me copë të shtrenjtë, të rënda, të kushtueshme. Pse, i keq ishte krevati që pamë dje në familjen ku hëngrëm drekën? Ai ishte i pastër e i thjesh-të. Ç'është tani gjithë kjo farë mobilje që na bëhet, e cila influencon për keq edhe në masë? Na ka dalë një marifet i bukur që, po t'i thuash tjetrit të bëjë një shtëpi të re me plitharë ose me kallama, menjëherë të thotë: «Kushton shtrenjtë, prandaj e bëjmë me tulla e çimento», gjë që nuk është e vërtetë. Kuptohet në qytete bëhen e do të bëhen ndërtime të forta e me shumë kate, pse aty këto kanë më shumë leverdi, po në periferi ose

në fshatra pse të mos bëhen edhe me plitharë dhe kallama?

Këtë vit do ta këmi ca të ngarkuar, pse do të bëjmë Kongresin e 5-të të Partisë. Sot na vihet detyra që këtë punë që e bëmë në qendër ta vazhdojmë në ndërmarrjet dhe ta përfundojmë sa më parë, që njerëzit të mbledhin mendjen, të dijë secili ku do të vejë.

Në radhë të parë kujdes t'i vini realizimit të planit. Tani ne po punojmë për hartimin e planit pesëvjeçar, po përgatitim direktivat e Kongresit. Këto direktiva do të jenë të plota, revolucionare. Me punën që po bëhet dhe duke u mbështetur në gjithë eksperiencën dhe vendimet e rëndësishme të Partisë, me siguri do të dalë një plan real, mobilizues, revolucionar, për realizimin e të cilit ne do të vëmë të gjitha forcat tona. Gjersa të mblidhet Kongresi, në saje të mobilizimit të madh të punonjësve, do të kemi edhe të korra të mira, në popull do të ketë gëzim e siguri, pse ai do të shohë rezultatet e punës së vet.

Tani ne po presim të shohim çfarë do të bëjnë sovjetikët me kongresin e tyre, pastaj t'u japim një dru të mirë. Ata do ta bëjnë këtë muaj kongresin. Na kanë dërguar edhe neve ftesë, po ne nuk pranuam fare, as ta merrnim në dorëzim. Kanë ftuar gjithashtu një delegacion nga Partia Komuniste e Kinës dhe nuk dimë nëse kinezët do të venë apo jo. Sikur të na pyesin ne, do t'u themi se nuk kanë përsë të venë. Në Moskë do të mblidhen përfaqësuesit e partive të ndryshme revizioniste, ku do të aprovojnë vijën e tyre revizioniste në kongresin e sovjetikëve, vijë me të cilën ne jemi në luftë të papajtueshme. Prandaj në qoftë se Partia Komuniste e

Kinës nuk do të dërgojë delegacion në këtë kongres, me këtë qëndrim ajo do të ndihmojë popullin sovjetik.

Në Shqipëri, sado që është vend i vogël, ka një gjendje shumë të shëndoshë, kurse në Jugosllavi gjendja është shumë e rëndë, për të cilën Titoja dhe Rankoviçi kanë folur në mënyrë shumë alarmuese. Ata e thonë haptazi që reformat e tyre po gjejnë pengesa shumë serioze në popull dhe në parti. Titoja e fton popullin jugosllav të ketë durim. Ai vetë ngre çështjen që në Jugosllavi po zhvillohet nacionalizmi i shfrenuar republikë mië republikë. Rankoviçi, nga ana e vet, thotë se shovinizmi po rrezikon ekzistencën e federatës dhe këtë e shpjegon me punën që bëka atje «armiku i klasës». Në fakt, midis popullsive të kombësive të ndryshme po duken kontradikta sidomos midis serbëve nga një anë me kroatët e sllovenët nga ana tjetër. Mali i Zi është i varfër, Bosnja dhe Hercegovina po kështu. Tani këto kontradikta akoma nuk kuptohen mirë. Shefat e grupave po flasin mbuluar, po duket që të tilla kontradikta ekzistojnë brenda në komitetin qendror. Titoja megjithëse është në balancë, anon më shumë nga kroatët e sllovenët, kurse serbët, Rankoviçet me shokë, janë të pakënaqur, se duan që UDB-ja të ndihet më shumë.

Tani në Jugosllavi po marrin një vendim që çdo ndërmarrje ekonomike jugosllave të dalë për «ndihma» me tabaka nëpër vendet kapitaliste, të gjejë ortakë për t'u mbajtur në këmbë. Me një fjalë, të venë të kërkojnë kredi nëpër vendet kapitaliste dhe t'i ndajnë fitimet së bashku sipas aksioneve, si çdo ndërmarrje kapitaliste. Kjo rrugë, sipas tyre, me siguri do t'i bëjë edhe më të forta ndërmarrjet që do të gjejnë kapitale dhe kështu

ndërmarrjet më të mëdha do të hanë të voglat. Ky orientim tani ka kaluar nëpër republikat, si në Kroaci e Slloveni, që janë më të përparuara nga Serbia e republikat e tjera.

Situata në Jugosllavi është e tillë që po e çon vendin me shpejtësi në kapitalizëm. Sa për formë Titoja tha se «duhet të marrim masa, të kemi kujdes, se kemi marrë përsipër të jemi shembull për të tjerët». Për këtë ka të drejtë se vetëm në saje të këtij «shembulli» ai ka marrë miliarda dollarë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, prandaj tani që nuk po e jep dot më këtë «shembull», jo vetëm nuk do të marrë më miliarda, po amerikanët do t'i kërkojnë «haraçin», do t'i rrëmbejnë pasuritë dhe do të skllavërojnë popujt e Jugosllavisë. Prandaj bërtet Titoja të kihet kujdes, se jep shembullin e «socializmit specifik».

Të kemi kujdes edhe për një gjë tjetër shokë, secili nga ne të përgatitë zëvendësin, atë që ka pas vetes, tan grejë në nivelin e tij.

Këto kisha për të thënë. Është detyrë t'i kemi parasysh këto probleme se janë të rëndësishme, janë jetike për ne.

*Botohet për herë të parë si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

EKSPERIENCA E PARTISË DO TË NA MËSOJË SI TA BËJMË MË MIRË PUNËN

*Fjala në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

14 mars 1966

Kjo është një mbledhje e Sekretariatit, si të thuash pa rend-dite, ose me një rend-dite me karakter informativ, ku jeni ftuar edhe ju, shokë të organizatave të masave e shokë të tjerë, për të shkëmbyer bashkërisht mendime për problemet që pamë ne në ato rrethe ku shkuam ditët e fundit. Natyrisht kjo do të jetë një formë pune jona që do ta zbatojmë edhe në të ardhmen, por nuk do të jetë e vëtmja në metodën tonë të punës. Ne duhet të mendojmë vazhdimisht që ta perfektionojmë atë.

Shoku Hysni ngriti në diskutimin e tij një varg çështjesh për mënyrën, format dhe metodën e punës që mund të zbatojmë si ne këtu, ashtu edhe organet udhëheqëse të Partisë në rrethet ku ai ka qenë vetë ditët e

¹ Në këtë mbledhje u raportua nga përgjegjësit e ekipeve që ishin në disa rrethe gjatë muajve shkurt-mars 1966.

fundit. Ato që tha ai janë shumë të vlefshme. Edhe ju gjithashtu keni për të thënë mendimet tuaja dhe do të sillni këtu eksperiencën pozitive lidhur me metodën e punës së Partisë në bazë.

Por unë dëshiroj ta shikojmë si qëndron ky problem që këtu te ne në qendër. Bie fjala, si zhvillohen mbledhjet e takimet e sekretarëve të Komitetit Qendror me ju. Nëqoftë se takimet dhe bisedat tonë me ju do t'i bëjmë si edhe më përpara, një gjë e tillë do të ishte shumë e vështirë edhe për ju edhe për ne. Me këtë nuk dua të them se ju duhet të vini rrallë te ne, por kur të vini këtu, të jeni më të armatosur nga sa vinit përpara. Veç përgatitjes që duhet të bëni para se të vini këtu, duhet të keni parasysh edhe kohën që do t'i marrim njëri-tjetrit. Që t'i kemi parasysh këto çështje duhet të na punojë mendja të gjithëve, juve edhe neve.

Unë, për shembull, po shoh që ju po mbani shënimë. Kjo është një gjë e mirë. Çdo shok që diskuton këtu bashkë me eksperiencën e bazës sjell edhe eksperiencën dhe mendimet e tij. Por në qoftë se ju, nga njëra anë mbani shënimë dhe, nga ana tjetër, mendoni të vini përsëri te ne t'ju udhëzojmë për këto probleme që po diskutojmë sot se si t'i shtroni në bazë, kjo do të thotë se ne nuk po e ngremë nivelin e punës sonë. Ne as materialisht nuk kemi kohë ta bëjmë një gjë të tillë. Nuk mund të kemi kohë që për të gjitha problemet e Partisë, që janë me qindra dhe që ju na i sillni e përsëri do të na i sillni herë pas here, të mendojmë për secilën prej tyre veçanërisht, t'jua japim juve si ushqim të gatshëm e pastaj ju të veproni. Kjo do të ishte e pamundur.

Unë mendoj se për problemet që shtrojmë këtu e

që ju i mbani shënim, duhet të mendoni edhe vetë, të vritni mendjen, që t'i zhvilloni më tej ato. Ju vetë e dini çfarë keni shkruar në fletoren tuaj, por për mendimin tim rëndësi ka nëse është mbajtur esenca e çështjeve, apo janë mbajtur disa fraza pa rëndësi. Ju, shokë, duhet t'i bëni një analizë metodës suaj të punës kur vini këtu, që të mbani shënim ato gjëra që janë më esenciale e më të nevojshme.

Por vallë a mjafton puna vetëm me mbajtjen e shënimeve? Jo, në asnjë mënyrë! Rëndësi ka se si vepron në praktikë në bazë të tyre, a i merr ato ashtu kallëp apo i sheh në mënyrë krijuese e të zhdërvjellët. Se mund të ndodhë që një, dy apo tre probleme për të cilat ke mbajtur shëним, hëpërhc nuk paraqesin urgjencë. Atëherë ato i lini mënjanë dhe kapuni pas atyre problemeve, ndjekja, zgjidhja e të cilave është e domosdoshme, e kohës, se prej tyre varen edhe shumë çështje të tjera. Pra, duke bërë një zgjedhje të tillë të problemeve me të cilat do të merreni, juve do t'ju duhet të reflektoni thellë për to, do të studioni, do të vritni mendjen. Për këtë do t'ju ndihmojnë shënimet që keni mbajtur këtu. Ja, kur diskutoi shoku Xhorxhi Robo, ngriti një çështje lidhur me ndërtimin e Partisë, që të tjerëve mbase u ka shpëtuar, ose nuk e kanë vënë re se nuk kishin shkuar në bazë për atë problem. Për këtë çështje që u ngrit, duhet reflektuar. Shënimet që keni marrë këtu vetëm sa ju nxitin, por më punë e sipër ju do të bazoheni në gjithë eksperiencën e Partisë. Megjithatë nuk mjafton me kaq. Ju, qoftë për këtë problem, qoftë për probleme të tjera, që mund t'ju dalin përpara, mund të takoheni edhe posaçërisht me shokë që i ndje-

kin ato dhe të zhvilloni diskutime e të thelloheni që njohuritë t'i keni sa më të plota. Në qoftë se do të veproni kështu, atëherë me siguri do të jeni në gjendje t'i veni çështjes deri në fund dhe kështu do t'i ndihmoni konkretisht shokët e bazës.

Këto që po themi këtu janë eksperiencia juaj dhe e Partisë, prandaj, kur një shok thotë: «Mendoj të bëhet kështu», në qoftë se nuk ka kundërshtime, atëherë mendimi i shokut jo vetëm të dëgjohet me vëmendje, por të mbahen shënime rreth tij dhe, kur të dalë që këtej, secili t'i shkojë edhe më thellë zhvillimit të mendimit që u shfaq këtu, ai të merret si eksperiencë që duhet pasur parasysh dhe të pasurohet më tej. Në qoftë se ka kundërshtime, ose shfaqet një mendim tjetër, atëherë mendimi i parë mund të mos mbahet parasysh.

Nga mungesa e një metode të frytshme pune ne vuajmë, prandaj ndodh që në bazë çojmë formula të thata e jo mendime të thelluara. Në këtë drejtim ne duhet të reflektojmë mirë.

Pra, ta kuptojmë drejt, shokë, se mbajtja e shënimeve dhe përpunimi i tyre kanë një rëndësi të madhe.

Tani do të ndalem në **disa konstatime rreth metodës dhe stilit** në punë të organizatës së Partisë të rrethit të Lushnjës dhe në **disa probleme ekonomiko-shoqërore**.

Duke vajtur në rrethin e Lushnjës, përveç problemeve të përgjithshme, dëshiroja më shumë të merrja kontakt me bazën në kooperativë, me komunistët dhe fshatarët, të bisedoja me ta drejtpërdrejt, pa i lajmëruar më parë se do të veja, në mënyrë që të mos më

përgatitnin fraza, por të flitnin lirisht, hapur. Gjithashtu dëshiroja të merrja mendimin e tyre për një varg problemesh shtetërore, partie, shoqërore, politike dhe organizative, të shikoja si i gjykonin, si i kuptionin, si i zgjidhnin ato në praktikë, në ç'forma i shtronin dhe çfarë zgjidhje u gjenin.

Përshtypja ime e përgjithshme është e mirë. Ne kemi në bazë njerëz të pjekur, seriozë, punëtorë dhe politikiشت jo keq të ngritur. Ata i kuptojnë mirë problemet që u shtrova, luftojnë gjithashu për t'i zgjidhur drejt ato, por natyrisht kultura e tyre nuk është në atë shkallë që problemi politik ose shoqëror ta shohin në një prizëm të gjerë dhe t'i jepin një zgjidhje të plotë. Por edhe ndihma nga udhëheqja e Partisë në rreth ka qenë e cekët, formale, ajo nuk e ka kuptuar se sidomos problemet shoqërore kërkojnë një zgjidhje frontale, por është kufizuar në punën individuale. Puna frontale ka qenë e sipërfaqshme, e përgjithshme, me formula dhe jo e diferencuar.

Më poshtë po theksoj problemet kryesore që u mundova të plotësoj me mendimin e bazës, po vë gjithashu në dukje disa vërejtje të shkurtra mbi dy kooperativat që vizitova, si dhe disa konkluzione që bëra në vend, të cilat ua thashë edhe shokëve të bazës dhe udhëheqjes së rrethit.

Problemet që unë dëshiroja të sqaroja ishin përafërsisht këto:

- 1) Si mendojnë ata të zbatojnë planin dhe të kontrollojnë zbatimin e tij?
- 2) Ç'mendojnë ata të ndryshohet në gjendjen e

tanishme të trajtimit e të drejtimit nga ana e kryetarit të kooperativës, kryesisë dhe brigadierëve?

3) Ç'mendojnë për punën e deritanishme të këshillit popullor, të kompetencave të tij e të kryetarit dhe në ç'drejtime duhet përmirësuar kjo punë?

4) Ç'mendojnë ata për punën e organizatës-bazë të Partisë dhe si duhet të organizohet e të punojë kjo këtej e tutje?

5) Si punojnë organizatat e rinasë dhe të gruas dhe si duhet të jenë lidhjet e tyre me kryesinë?

6) A vlerësohet roli i gruas në drejtimin politik dhe teknik? Ç'arsye e pengojnë gruan dhe të renë që të ngrihen në një radhë me burrin dhe të riun në punë drejtuese?

7) Si organizohet puna politike me masat, format dhe përbajtja e saj? Si lidhet ajo me punën dhe me prodhimin?

8) Si mendojnë ata të jenë lidhjet me seksionin e bujqësisë në rrith dhe me kooperativën e konsumit?

9) Çfarë prodhimesh të kooperativës mund të industrializojnë ata vetë dhe si mund ta bëjnë këtë?

10) A u bë mirë bashkimi i shumë kooperativave në një dhe çfarë vështirësish hasin në organizimin teknik të punës e të drejtimit? Si zhvillohet ndjenja e unitetit lidhur me disnivelin ekonomik që ekzistonte dhe që mund të ekzistojë në mes fshatrave të ndryshme që formojnë kooperativën? (Këtu e kam fjalën për ndjenjat e pronës së dikurshme ose për ndjenjën kur çdo fshat ishte kooperativë më vete dhe që tani është bashkuar.)

11) Cilat brigada janë më të favorizuara nga të ar-

dhurat për ditë-punë: të arave, të blegtorisë apo të frutikulturës? Ku synohet më shumë? Në rast se ekziston një gjë e tillë, si do t'i bëhet hallit?

12) Si qëndron uniteti në familje, roli dhe ndikimi i plakut, i burrit, i gruas dhe i të rinjve? A shfaqen kontradikta të brendshme dhe si zgjidhen këto?

13) Gruaja apo burri punon më shumë? Gruaja është më e kujdeshme në punë apo burri, gruaja është më ekonomë apo burri, gruaja e ka më të zhvilluar ndjenjën e përparimit apo burri, gruaja ka më shumë iniciativë apo burri?

Të gjitha këto pyetje u bënë edhe për të rejat e të rinjtë. Në ç'kohë të moshës së saj, në ç'momente të jetës së saj e reja e humbet disi personalitetin dhe përse?

14) Ç'mendojnë ata për metodën e re të planifikimit? Ç'vërejtje kanë se mund të bëhet më mirë?

15) Ç'mendojnë ata për kreditë bujqësore që u jep shteti? A i rëndon kjo ata apo jo?

16) Sá dinë ata për të gjitha këto rektifikime që po bëhen në vendin tonë? Ç'mendojnë ata për këto dhe sa reperkusione kishin këto gabime më jetën dhe në zhvillimin e fshatit? Cila hallkë burokratike shtetërore i kishte penguar ose i kishte mërzitur më shumë koooperativistët?

17) A lexohet shtypi në bazë, si lexohet dhe sa përfitohet prej tij?

Mbi vizitën në kooperativën bujqësore të Divjakës

Kjo është një kooperativë e madhe me më tepër se 2 000 hektarë tokë, dhe tokë të mirë. Vjet kooperativistët ndanë nga 17,5 lekë të rinj për ditë-punë. Divjaka është fshat i hapur, me shtëpi gati krejt të reja dhe shumë komode. Ajo ka toka me përbërje të ndryshme, disa nga të cilat ranore.

Kooperativistët janë specializuar në prodhimin e domates së hershme për eksport. Gati 30 për qind të të ardhurave të përgjithshme i kanë nga ato. Ata e prodhojnë bukën, i japid edhe shtetit teprica. Kooperativistët e marrin bukën në furrën e përbashkët nga 800-900 gram për frymë. Kjo sasi u mjafton. Kudo më folën hapur dhe çështja e bukës nuk ishte preokupante.

Shkolla 8-vjeçare ishte mjaft e madhe. Atje mësonin mbi 500 nxënës. Të gjithë mësuesit ishin nga fshati. Spitali ishte i mirë, kishte dyqane, restorant, shërbime të artizanatit. Tani po ndërtonin edhe një shtëpi kulture mjaft të madhe. Grupet kulturore ishin të zhvilluara.

Të gjithë janë optimistë për realizimin e planit të viti 1966, pse e kanë bërë vetë dhe mirë, sipas planifikimit të ri nga poshtë.

Kryetari i kooperativës, sekretari i organizatës-bazë të Partisë dhe kryetari i këshillit populor më bënë përshtypje të mirë, iu përgjigjën me pjekuri pyetjeve të shumta që u drejtova. Mendimi i tyre është që të zgjidhet një komision nga asambleja, i përbërë nga njërezit më të mirë të sektorëve të ndryshëm, pa pasur

asnjë me pagesë, pra, me baza vullnetare, i cili të kontrollojë zbatimin në jetë të planit, të ndihmojë dhe të sinjalizojë kryesinë për të metat dhe për masat që duhet të marrë. Drejtimet e kontrollit dhe të ndihmës mund të shikohen pastaj më konkretisht. Komisione të tjera mendonin se nuk duheshin.

Si kudo në kooperativat e bashkuara edhe atje, këshilli popullor në bazë fshati nuk është më dhe në qendër kanë një këshill për të gjithë kooperativën e bashkuar më një ose dy përfaqësues nga çdo fshat. Ata ishin dakord që këshillat popullorë t'i krijonin rishtas në bazë fshati, por thanë se duhej një koordinim i tyre me qendrën e kooperativës që të lehtësoheshin lidhjet me rrëthin.

Problemin e gruas dhe të rinisë shokët e bazës e shihnin drejt, kishin besim të madh në këto organizata dhe çështjet shoqërore të tyre nuk i shikonin keq. I këshillova gjatë se si duhej të punonin për ta përmirësuar këtë problem të madh dhe për ta shpejtuar zgjidhjen drejt dhe në mënyrë progresive të tij.

Pengesat nga kooperativat e konsumit janë ato që dihen, natyrisht, kanë edhe këta fajet e tyre.

Bisedova për problemin e rritjes së derrit dhe del ashtu siç e shtruam edhe në Byronë Politike. Specialisti i rritjes së derrit në kooperativë më tha se tek ata kilogrami i mishit të derrit kushton 7,5 lekë të rinj, kurse në ndërmarrjen bujqësore shtetërore 12,5 lekë. Derrin në kooperativë e rritin 70-80 kilogram dhe jo 37 kilogram për dosë, siç na thotë plani në qendër. Ai më tha se mënyra e rritjes së derrave në tufa të mëdha, pa ua

ndarë parcelat e ushqimit, nuk është e rekomandueshme etj.

Gjatë qëndrimit në Divjakë vizitova disa familje: një familje dëshmori dhe një familje që i kishte dhënë strehim një naftëtari të Qytetit Stalin, jo vendas, por që kishte ardhur të punonte në këtë kooperativë. Që të dyja familjet ishin të kënaqura. Kooperativistja nuk kishte pranuar që punëtori të paguante qira shtëpie.

Pastaj u fola kooperativistëve për gjendjen aktuale, për vendimet e fundit të Komitetit Qendror dhe për de-tyrat që u dalin në realizimin e planit. Kudo kishte shumë entuziazëm dhe vendosmëri.

Kur isha në këtë kooperativë na erdhi një sihariq: 300 metra larg shpohej një pus, ku shpërtheu gazi metan e u vu nën kontroll.

Mbi vizitën në kooperativën bujqësore të Krutjes

Në një bisedë të gjatë që pata atje me shokët drejtues dhe kooperativistë, konstatova se kuadrot dhe kooperativistët ishin mjaft të ngritur dhe të aftë, gjë që ka bërë që kjo kooperativë e madhe, e bashkuar, me afro 2 500 hektarë, të shkojë mirë dhe të ketë sukses në zhvillimin e saj, sidomos në drithëra e në pambuk që janë aty drejtimi kryesor. Me blektorinë ishin gjithashtu mire, kurse me derrin jo. Zootekniku i lartë i kooperativës më bëri përshtypje si njeri i zoti, i gjallë dhe i interesuar.

Përshtypje të mirë më la gjithashtu edhe kryetari i këshillit populor të fshatit, djalë dinamik e i zgjuar, që ka qenë për një kohë instruktor partie. Në diskutimet e mëtejshme me të ai doli me propozime për zgjerimin e kompetencave të këshillit, si për shembull, në drejtimin e furrave të bukës, të mullinjve të bluarjes dhe në aktivitete të tjera të këtij lloji.

Kryetari i kooperativës dukej shok i mirë dhe në drejtimin e saj ka treguar aftësi. Sekretari i organizatës-bazë të Partisë dukej shok i zgjuar.

Duke gjykuar nga rezultatet, në këtë kooperativë dukej se organizata e Partisë punonte mirë, por pas bisedimeve konstatova se mund të kishte rezultate më të mëdha në qoftë se do t'i jepej bazës një ndihmë më e kualifikuar. Ne duhet t'i ndihmojmë shokët e bazës që t'u punojë mendja dhe kjo ka mundësi t'u punojë shumë, vetëm se këtu frenojnë formalizmi dhe stereotipimi. Po të arrijmë t'i zhdukim këto fenomene negative me një ndihmë më të kualifikuar nga ana e rrethit, Partia në bazë do të forcohet pa masë. Për këtë ne duhet të mendojmë seriozisht.

Në këtë kooperativë më bëri përshtypje se në organizatën-bazë të Partisë me rreth 110 anëtarë partie, 35 ishin gra. Mjaft gra ishin brigadiere dhe në udhëheqje. Ato diskutonin lirisht dhe jepnin mendime të pjekura. Dukej që shokët e Partisë atje nuk ishin sekitarë, megjithatë në këtë drejtim duhet të bëhet më shumë.

Në Krutje vura re maninë për të ndërtuar gjëra të mëdha e të kushtueshme. Atje po ngrinin një shtëpi kulture dhe kinema që do të kushtojnë 8-9 milionë

Ickë të vjetër, një shkollë 11-vjeçare të madhe, zyrat e kooperativës gjithashtu të mëdha dhe krejt moderne etj. As vetë Lushnja nuk ka të tilla ndërtesa, prandaj i këshillova shokët që këtej e tutje të mos bënin më gjëra të kushtueshme, që Krutjen dhe udhëheqjen e saj duhet t'i karakterizojë thjeshtësia.

Tregtia në fshat nuk është aktive, ajo synon vetëm të marrë nga fshati dhe jo të plotësojë sa duhet dhe si duhet nevojat e tij.

Kooperativa e konsumit lidh kontratë me kooperativën bujqësore për ato materiale që kjo ka nevojë, por këto janë të kufizuara nga planifikimi jo i rregullt. Materiale të rëndësishme, si lëndë druri, çimento e të tjera për nevojat e ndërtimeve të përgjithshme të kooperativës, si stalla, depo, shtëpi kulture etj., konsumiçon pak në fshat, kurse materialet e ndërtimit për nevojat personale të kooperativistëve janë akoma shumë më pak, për të mos thënë aspak. Kooperativisti ndërton shtëpi, meremeton dritare, shtron dysheme etj. Ai, pra, ka nevojë të madhe për lëndë ndërtimi, bën përpjekje dhe vete i gjen. Vihet pyetja: Ku i gjen? Ku i merr? Natyrisht, jo te privatët, se të tillë nuk ka që t'i shesin. Ai këto i blen jashtë rrethit, sigurisht në forma jo të rregullta dhe nga kontingjentet e dyqaneve të konsumit në rrethet e tjera, si dhe në ndërmarrjet shtetërore. Midis të tjerave ai blen edhe hekur, edhe çimento, edhe dërrasa, gjen edhe makinë për t'i transportuar dhe i sjell në fshat. Kooperativa e konsumit as çan kokën për këto nevoja të fshatit. Përgjegjësi i dyqanit thotë: «Kam planin», po kur vjen puna për t'i dorëzuar mallin kooperativës, shpesh kontratën e shkel

edhe kur e ka planin dhe mendjen e ka të fjetur, ndër-gjegjen «të qetë».

Gjithashtu kooperativa e konsumit nuk i zbaton si duhet parimet e tregtisë socialiste, ajo as që lufton përklientët e saj. Vihet pyetja: Ku t'i gjejë ajo këto materiale? Atje ku i gjen vetë fshatari që ndërton ose remeton një shtëpi. Vegla pune s'ka në dyqanin e konsumit në fshat, këto i prodhon artizanati, prandaj, po ia dha ky në bazë të «planit» konsumi i merr dhe i çon në fshat, ashtu siç janë, po s'ia dha, atëherë faji i hidhet artizanatit dhe shitësi i dyqanit të kooperativës së konsumit as që e prish qejfin. Ç'tregti e keqe! Ne duhet ta largojmë kooperativën e konsumit nga kjo rrugë që nuk është tregti, por rehati.

MBI DISA PROBLEME TË PARTISË DHE TË PUSHTETIT NË KOOPERATIVËN BUJQËSORE TË DIVJAKËS DHE TË KRUTJES

1. — Mbi problemin e gruas

Çështjet shoqërore që kanë të bëjnë me jetën e popullit kanë rëndësi të madhe për Partinë. Sado i përparuar të jetë një fshat, mentalitetet e vjetra vazhdojnë të ekzistojnë. Kundër këtyre mentaliteteve borgjeze, në mes tyre edhe fetare, Partia duhet të bëjë një punë të menduar, shkencore që ato të luftohen me sukses, natyrisht, jo në mënyrë brutale, as duke prekur ndjenjat e njerëzve, po me një punë të thellë

politike. Nuk mund të japim urdhër, që kisha ose xhamia që ekziston në fshat të prishet, por t'i shpjegojmë masës se nga kisha dhe xhamia kurdoherë kanë ardhur shumë të këqija, nga të cilat edhe sot e kësaj dite njerëzit vuajnë. Marksizmi i lufton ideologjitetë reaksionare dhe fetare, jo me masa administrative, por me anën e bindjes. Por bindja e njerëzve nuk realizohet me një punë të thjeshtë, shkel e shko, pasi çdo punë e sipërfaqshme transformohet shpejt në urdhër, gjë që është e dëmshme për Partinë, kurse, duke e shpjeguar çështjen fill e për pe, njeriu bindet, e zbaton me ndërgjegje atë që i thua, nuk e merr si urdhër.

Një punë e madhe dhe e vazhdueshme bindëse me masat duhet edhe për problemin e gruas. Derisa janë të pamartuara, vajzat e reja vazhdojnë të punojnë me hov revolucionar në kooperativë. Më vonë, kur fejohen, sidomos pasi martohen e bëhen me fëmijë, hovi i tyre bie. Në këtë drejtim Partisë i duhet të bëjë një punë të madhe politike, mbasi kudo te ne vihet re se vjen një moment që gratë e ulin hovin në punë, gjë që nuk duhet të ndodhë. Fejesa nuk duhet ta dobësojë vrullin revolucionar të femrës, përkundrazi, ajo e bën dhe duhet ta bëjë më të gjëzuar, më të qetë, se i plotësohet një dëshirë e zemrës, një dëshirë e natyrshme e saj. Pas martesës femra lind fëmijë, duke krijuar e duke përtëritur kështu jetën. Edhe ky moment në jetën e saj është një tjetër gjëzim i madh, prandaj as kjo ngjarje nuk duhet ta pengojë, nuk duhet t'ia presë hovin në punë.

Atëherë shtrohet pyetja: Përse bie hovi i femrës në punë pas fejesës dhe martesës? Duket qartë se këtu

ka diçka që nuk ecën. Këtë fenomen negativ në jetën e femrës në këto momente nuk duhet t'ia veshim vetëm asaj, atë duhet ta kërkojmë gjetkë, edhe te burri. Duhet, pra, të zbulojmë, të gjejmë burimin e këtij fenomeni dhe të marrim masat për ta zhdukur.

Natyra e gruas nuk duhet sforcuar. Me këtë kam parasysh se pas martesës vjen një kohë dhe ajo mbetet shtatzënë. Është e natyrshme që në këtë periudhë, pa humbur dashurinë për punën, ajo i kushton një kujdes të dorës së parë jetës së re që do të lindë. Shpirterisht në këtë kohë ajo ndihet e gjëzuar dhe mbetet revolucionare, por nga ana fizike gruaja shtatzënë bie, nuk është në gjendje që në arë, në prodhim, të punojë me të njëjtën forcë siç ka punuar përpara. Prandaj Partia në këtë periudhë e ka për detyrë të kujdeset që gruaja të mos sforcohet.

Pas lindjes, fëmija gradualisht rritet, shëndeti i gruas përtérihet dhe ajo është në gjendje të hidhet përsëri në punë me vrullin e parë. Pikërisht në këtë kohë Partia duhet të ketë kujdes që të mbahen lart hovi i saj për punë, ashtu si dhe gjëzimi i ri në jetë, që i vjen nga lindja e fëmijës. Për këto arsyе Partia ka porositur vazhdimisht që kudo ku punon gruaja, të ngrihen çerdhe, sepse jetën që nëna e lind, përpinqet ta rritë, prandaj t'i krijojmë kushtet që hovi në punë jo vetëm të mos i bjerë, po përkundrazi t'i zhvillohet edhe më shumë.

Por, pikërisht në kohën kur gruaja lind, nxjerr krye tendenca e burrit për ta sunduar atë, fillojnë pretendimet e tij ndaj gruas. Është e natyrshme që ajo pas lindjes dobësohet nga shëndeti. Në këtë kohë, qoftë

edhe në mënyrë të pandërgjegjshme, fillojnë përpjekjet e burrit për të dominuar mbi gruan. Ai e sheh gruan në një gjendje fizike të vështirë dhe që përkohësisht nuk mund të punojë, pavarësisht se ndien dashuri e dhimbje për të dhe përfëmijën, burrit i lind instinkti i zotit të vetëm të shtëpisë, sikur vetëm ai sjell të ardhura në familje.

Prandaj është e domosdoshme që çdo kooperativë të krijojë kushte për ta lehtesar gruan që të marrë pjesë në prodhim, domethënë t'i sigurojë asaj një vend ku ta lërë fëmijën që kështu të punojë e qetë. Në këtë mënyrë do të krijohen kushte që në familje të mos ketë ndryshime lidhur me pozitën ekonomike midis burrit dhe gruas. Po çerdhet e kopshtet përfëmijë kanë një rëndësi të madhe, jo vetëm përritjen e mirë të të porsalindurit, për të cilin duhet të kemi kujdes, po si-domos edhe përfaktin se gruas do t'i krijohen mundësitë të ecë përpara dhe jo vetëm të mos pësojë asnje tronditje nga pjesëmarrja e saj përsëri në punë, po përkundrazi të hidhet edhe më me vrull përpara, dhe me pjesëmarrjen e saj në jetën ekonomike të luftojë edhe kundër mbeturinave të vjetra të burrave, edhe kundër huqeve të pleqve, në drejtim të saj.

Ka edhe faktorë të tjerë që ndikojnë në frenimin e hovit revolucionar të gruas pas martesës, si për shembull, qëndrimi i pleqve në familjen e burrit. Brezi ynë po rritet në socializëm, prandaj pikëpamjet tona në përgjithësi nuk janë si të prindërve. Të rintjtë kanë bërë përparime të mëdha, kurse pleqtë kanë më shumë pikëpamje konservatore ndaj gruas, ndaj nuses së djalit. Atëherë çfarë të bëjmë me ta, me prindërit e burrit?

Ata na kanë bërë kokën, na kanë rritur e ushqyer dhe na duan, ne i kemi prindër, pra, nuk duhet t'i hedhim poshtë. Atëherë, si duhet t'i zgjidhim çështjet që lindin në familje? Duke iu nënshtruar pikëpamjeve prapanike të vjehrrit apo të vjehrrës? Jo! Por njëkohësisht nuk duhet hyrë as në luftë e në konflikte të ashpra me ta, pasi kështu do të errësohej edhe jeta e vajzës, edhe e tyrja. Në asnje mënyrë nuk duhet vepruar kështu. Pikërisht këtu nevojitet puna edukative e Partisë, e cila duhet t'i bëjë njerëzit të ndërgjegjshëm mbi mënyrën se si këta të mbajnë qëndrim ndaj mentaliteteve të vjetra të prindërve, si t'u marrin krahët këtyre mentaliteteve. Një gjë e tillë do të arrihet vetëm në rrugën e bindjes, duke iu përshtatur secili kushteve të familjes dhe prindërve të vet, sepse prindërit e njërit nuk janë e nuk ka si të jenë njëlloj nga pikëpamja e ngritjes dhe e formimit me prindërit e tjeterit, nuk janë e nuk mund të jenë njëlloj të ngritur dhe të kenë të njëjtin formim njerëzit, për shembull, si në Myzeqe ashtu edhe në Gjirokastër. Prandaj, duke u mbështetur në vijën e drejtë të Partisë, të punojmë me brezin e vjetër duke e bindur që të braktisë gradualisht pikëpamjet e prapambetura, të sillemi me të me dashuri dhe të kemi besim se do të vijë me siguri koha që pleqtë do ta ulin presionin e tyre ndaj grave. Puna bindëse e Partisë ka rëndësi të madhe për përmirësimin dhe lehtësimin e gjendjes së gruas në familje, sidomos të së resë, e cila pëson më shumë nga ky presion.

Ka pastaj edhe disa pengesa të tjera që Partia duhet të punojë për t'i zhdukur. Vajzat në moshën 20-vjeçare te ne janë rritur pas Çlirimt, janë formuar me

edukatën e Partisë, prandaj ato janë në gjendje dhe të zonjat ta ruajnë shumë mirë nderin e tyre. Megjithatë, kur dikush shikon një vajzë që bisedon me një shok të saj, fillojnë pëshpëritjet, të cilat vazhdojnë vesh më vesh. Këto pëshpëritje janë mbeturina të kohëve të kaluara, kur njerëzit merreshin me gjëra të vogla. Dihet se atëherë gratë më shumë nuk punonin dhe, duke mos pasur me se të merreshin, vinnin re ç'bënte njëri dhe tjetri, mbanin njerëzit nëpër gojë. Këto mbeturina kanë ardhur; në radhë të parë, nga qytetet, ku gratë nuk punonin fare jashtë familjes. Një mbeturinë e tillë ekziston akoma dhe na dëmton. Prandaj këtë mund dhe duhet ta zhdukim, në radhë të parë në veten tonë, dhe me një punë të dendur politike, edukative edhe te të tjerët. Përse të mendohet keq, përse të pëshpëritet vesh më vesh për një vajzë të re, e cila ka të drejtë të punojë, të shëtitë, të flasë e të bisedojë me këdo njëlloj si edhe djemtë? Prandaj, përrapa se të vemi t'i themi të moçmit që të mos merret me gjëra të tillë të dëmshme, të korrigjojmë në radhë të parë veten, pasi mbeturina të tillë ekzistojnë edhe te ne. Pastaj ne duhet të edukojmë edhe njerëzit e tjerë në këtë drejtim, se këto çështje kanë të bëjnë me ndjenjat, me ideologjinë e tyre. Kjo është një detyrë e madhe partie.

Në Parti çdo gjë duhet menduar thellë, ajo nuk lejon një punë të sipërfaqshme, automatike ose burokratike. Njeriu i Partisë burokratizmin nuk duhet ta pranojë, po ta luftojë. T'i largohemi, pra, punës me rregulla e formula stereotipe në Parti, të mbështetemi më shumë në punën e gjallë me njerëzit, t'i nxitim

këta të flasin, të kritikojnë, të japin mendime, të propozojnë. Komunistët tregojnë kujdes për mbledhjet e organizatës së Partisë, shumë herë ato dalin të gjalla, por disa herë bëhen të fjetura. Kjo duhet të preokupojë udhëheqjen e organizatës që të mendojë: Përse mbledhja nuk u bë e gjallë, mos vallë ngaqë tema nuk u trajtua mirë, ngaqë ajo nuk ishte e përshtatshme, apo sepse ai që ishte ngarkuar nuk e kishte përgatitur si duhet?

Anëtari i Partisë, porsa merr rendin e ditës, pavarësisht kush do të referojë, përpëra se të vejë në mbledhje duhet të mendojë thellë për problemin që do të shistrohet që të japë atje mendimin dhe ndihmën e tij. Po të veprojë kështu secili, atëherë organizata e Partisë do të bëhet e gjallë, luftarake, të gjithë do të diskutojnë dhe do të merren vendime të drejta. Por shumë herë ndodh që, ndërsa në mes tyre shoqet komuniste diskutojnë lirshëm, në organizatën e Partisë nuk diskutojnë ashtu siç bëjnë me njëra-tjetrën.

Gjithashtu ndodh shpesh, qoftë në familje, qoftë nëpër mbledhje, që, kur një grua ose vajzë ngrihet të kritikojë kryesinë ose kryetarin e kooperativës, këta bëhen uthull, jo vetëm pse u kritikuani, por sidomos sepse ajo që i kritikoi është grua, ndonjëri bile edhe ndërhyr e ia pret fjalën. Në këto raste jo vetëm komunistët e tjerë, por as sekretari i organizatës së Partisë nuk ndërhyr ta mbrojë gruan, që merr guximin të kritikojë, dhe ta inkurajojë atë. Kështu femra druhet të kritikojë. Po t'i japin të drejtë sekretari dhe shokët komunistë, të shikosh pastaj si do të ngrihen e do të marrin kurajë gratë e tjera, si do të kritikojnë ato, sepse tek ata do të shikojnë njerëzit e drejtë e të

vendosur të Partisë që i mbrojnë. Kur një shoqe ngrihet të diskutojë, duhet të lihet të flasë deri në fund. Në qoftë se diçka nuk e ka në rregull, t'i vihet në dukje, ashtu sikurse i duhet thënë kur një mendim e ka drejt.

Natyrisht, në kahasim me të kaluarën, sotjeta në familjen fshatare ka ndryshuar shumë, burrat konsultohen me gratë e tyre për problemet ekonomike dhe çështje të tjera të familjes, dhe në mjaft raste të ardhurat nga puna e përbashkët kanë filluar t'i administrojnë gratë. Megjithatë të rralla janë gratë që u qëndrojnë burrave në shtëpi për çështje që këta nuk kanë të drejtë. Aq më shumë në zgjidhjen e problemeve ekonomiko-shoqërore dhe të kooperativës, diferenca midis burrit dhe gruas është më e dukshme. Gratë në përgjithësi marrin më pak pjesë në diskutime në mbledhjet e asamblesë, të organizatës së Partisë etj., sepse ato e ndiejnë akoma veten më ulët se burrat nga pikëpamja e intelektit, ndërsa kur bisedojnë midis tyre, japin mendime të drejta. Kjo do të thotë se ato nuk kanë guximin e duhur të flasin përpëra burrave.

Për të inkurajuar dhe për të ndihmuar gratë që të marrin pjesë më gjallërisht në diskutimin e në zgjidhjen e problemeve të kooperativës, është mirë që, në radhë të parë, vetë kuadrot drejtues të japin shembullin dhe t'i ndihmojnë bashkëshortet në këtë drejtim. Ata duhet t'i inkurajojnë ato, në mënyrë që, kur nuk kanë kryer mirë ndonjë punë dhe gratë ua vënë në dukje këtë, ta pranojnë ndershmërisht vërejtjen apo kritikën e tyre, të mbajnë qëndrim të drejtë, kështu që gratë të marrin kurajë të mësohen të kritikojnë, kur

të jetë rasti, edhe jashtë familjes kryetarin, brigadierin, përgjegjësin e skuadrës etj.

Këtë fenomen të rëndësishëm shoqëror Partia duhet ta studiojë seriozisht dhe të marrë të gjitha masat, politike dhe ideologjike, që hovi i gruas në punë dhe në jetën shoqërore të mos bjerë në asnje mënyrë, përkundrazi të rritet vazhdimi.

A mund të na lejohet neve të lëmë të topitet hovi i gjysmës së popullsisë së vendit, sidomos i njërit prej clementëve më revolucionarë, siç janë gratë dhe vajzat e reja? Kush do ta studiojë dhe do ta zgjidhë drejt këtë problem me kaq rëndësi për vendin tonë? Natyrisht, Partia. Por, siç dihet, gjendja e gruas ndryshon jo vetëm sipas zonave e rretheve, po edhe sipas kooperativave e fshatrave; bile edhe sipas familjave. Prandaj organizata e Partisë duhet të punojë individualisht dhe me çdo familje, për t'i edukuar gratë dhe pjesëtarët e familjes së tyre dhe njëkohësisht të punojë për problemin e gruas edhe në mënyrë masive frontale.

Partia porosit që gratë të ngrihen, të zhvillohen, të kenë iniciativë, të marrin pjesë në prodhim apo në drejtimin e punëve të kooperativës, të Partisë, të shtetit e kudo. Është e kuptueshme që këto probleme nuk mund të zgjidhen menjëherë vetëm se duam ne, por këto direktiva të Partisë duhet të zbërthehen dhe zbërtimi i tyre bëhet kur kuptohet drejt situata e gruas. Punëtori i Partisë në kooperativë mund të marrë iniciativën dhe të propozojë që kjo ose ajo grua kooperativiste është e aftë të bëhet brigadiere. Ky është një qëndrim i drejtë. Por duhet pasur parasysh se gratë që ngrihen në përgjegjësi duhet jo vetëm ta meritojnë

besimin për punën që u ngarkohet, por edhe të ndihmohen, të tregohet kujdes që ato të mos thyhen nga presioni i opinionit konservator.

Kur një e re apo grua ngarkohet për herë të parë me përgjegjësi në kooperativë, komunistët dhe sekretari i organizatës-bazë duhet ta mbajnë atë afër, ta ndihmojnë e ta inkurajojnë, derisa të marrë mirë veten në punën e re dhe të jetë në gjendje vetë për ta çuar atë përpara. Mungesa e interesimit dhe e ndihmës në këto raste është në dëm të zhvillimit të saj.

Për t'i bërë gratë të afta edhe për punë drejtuese, nevojitet që Partia të bëjë një punë të gjithanshme edukative, me qëllim që të forcohet, në radhë të parë, ndërgjegjja e tyre, për t'u rritur besimin në forcat e veta.

Për vendin tonë ka rëndësi të madhe që gruaja të ngrihet në një nivel më të lartë. Organizatat e Partisë duhet ta analizojnë mirë këtë problem të rëndësishëm, pasi rezulton se nuk po e shikojnë si duhet. Në qoftë se duam që ekonomia popullore në përgjithësi dhe ajo e kooperativave në veçanti të ecë shpejt përpara, që mirëqenia e të gjithëve të ngrihet vazhdimisht, organizata e Partisë duhet të mendojë për t'i bërë të ndërgjegjshme dhe për t'i mobilizuar të gjitha forcat e kooperativës, e në radhë të parë gratë, të cilat janë njëloj si edhe burrat nga pikëpamja e intelektit.

Partia ka për detyrë të punojë që të gjithë të ecin, por veçanërisht gratë duhet të ndihmohen më shumë në këtë drejtim. Në bazë të veprimtarisë së saj, Partia ka, në radhë të parë, punën me njerëzit. Njeriu është faktori kryesor, vendimtar, që realizon çdo gjë. Po

qenë njerëzit të mirë, të ndërgjegjshëm, politikisht të qartë e të vendosur, çdo direktivë e Partisë do të kuptohet, do të zbatohet dhe punët tona do të ecin mirë përpëra. Por punës së gjallë me njerëzit nuk i vihet rëndësia e duhur. Prandaj duhet të punohet seriozisht që të zhduket në front kjo dobësi, në radhë të parë në drejtëm të punës për edukimin e grave.

Shpesh edhe tani ne hasim vështirësi për të gjetur një përgjegjëse të organizatës së gruas në këtë ose atë rrëth. Përgjegjëset e gruas që kemi sot kanë qenë në luftë, në përgjithësi ato janë shoqe që kanë qenë partizane, por gratë e luftës tani arritën moshiën 45 vjeç, prandaj Partia duhet të mendojë që krahas tyre të ngrejë në përgjegjësi të tjera, më të reja, për ta drejtuar këtë organizatë. Por në organizatën e gruas, ashtu sikurse dhe në atë të rinisë, me vështirësi të madhe vijnë të punojnë kuadro të mësuar. Pse ngjet kjo? Unë mendoj se një nga arsyet që këta kuadro e nënvleftësojnë punën me këto organizata është se mendojnë që, po të vijnë aty, do të humbasin dijenitë e tyre. Deri në njëfarë shkalle ata kanë arsy, sidomos kur organizatat që kanë nevojë për kuadro të mësuar, i përdorin këta për cikërrima, për shembull, për të bërë ftesa përmbledhje, për të grumbulluar statistika etj.

Është vënë re se tani që po bëjmë riorganizimin, në shumë raste, gratë po na i lënë pa punë. Është preokupante për Partinë kjo shfaqje negative. Këtë problem ne dhe shokët e Partisë në bazë duhet ta shikojmë me shumë kujdes, me qëllim që probleme të kësaj natyre të zgjidhen kurdoherë në rrugë të drejtë. Këtu nuk është çështja për të mbrojtur 1, 2 apo 5 gra, por

masën e grave. Mentalitetet e vjetra që shfaqen te burrat në format më të ndryshme, Partia duhet t'i lutojë duke punuar sistematikisht dhe në mënyrë të zgjuar.

Gruaja në kooperativë punon më mirë, më me ndërgjegje, ka më shumë iniciativë, është më e ndershme dhe më ekonomie, po për arsyе fizike, në disa sektorë, si në ata të kanalizimeve, në ndërtim dhe në sektorë të tjerë, ku punët janë më të rënda, gratë përgjithësisht bëjnë më pak ditë-punë nga burrat. Këta të fundit bëjnë shumë ditë-punë edhe për arsyе se në sektorët e blektorisë, ndërtimit etj., ku ata marrin pjesë, punohet më shumë me ditë-fikse, kurse në punët me ditë-fikse gra ka më pak.

Problemi i gruas në përgjithësi dhe veçanërisht në fshat, zhvillohet pozitivisht, me karakteristikat e veçanta të fshatit. Ngritja kulturore e grave, sidomos e të rejave, paraqitet mirë. Këto të gjitha janë me shkollë. I tillë është edhe niveli i tyre politik. Megjithëkëtë, në çështjen e gruas ne duhet të vazhdojmë të bëjmë një punë më të gjerë, më sistematike për ta çliruar atë plotësisht nga disa mbeturina dhe pengesa.

Faktori punë është një faktor i madh për çlirimin ekonomik, ideologjik dhe politik të gruas. Pikërisht në këtë faktor, ne duhet ta bazojmë vazhdimisht luftën tonë të mëtejshme për të zhdukur çdo pengesë në rrugën për emancipimin e plotë të gruas. Po s'u mbështetëm në këtë faktor, po e lamë atë të venitet, atëherë do të veniten edhe liria e gruas, iniciativa dhe barazia e saj me burrin në jetë, në shoqëri dhe në familje, ajo do të mbetet nën sundimin e ligjit të vjetër të familjes pa-

triarkale me mbeturinat e saj akoma të gjalla në ndërgjegjen e njerëzve. Sido që ka edhe faktorë të tjerë që veprojnë, por, po u dobësua, për një arsy ose për një tjetër, faktori i madh punë, çdo gjë që ka të bëjë me çlirimin e gruas do të dobësohet.

Eshtë fakt se gruaja në fshat punon gati pa ndërprerje. Ajo punon në kooperativë, në shtëpi, në oborrin kooperativist. Megjithëkëtë ajo e ndien dhe në përgjithësi i përulet autoritetit të mashkullit, atavizmit të burrit. Këndeja rrjedhin një varg pengesash në rrugën e zhvillimit të saj, të shoqërisë në fshat.

Tashti, në regjimin tonë socialist, vajza derisa mbaron shkollën 8-vjeçare, trajtohet pak a shumë njëlloj me djalin. Djalë e vajzë shkojnë bashkërisht në shkollë dhe e mbarojnë këtë normalisht. Asnjë pengesë nuk ka në këtë drejtim. Kjo duhet të jetë një periudhë shumë e përshtatshme që organizata e rinisë nëpërmjet asaj të pionierit, me një punë më të zgjuar se deri tanë (megjithëse mund të themi se kjo punë në mjaft raste bëhet krejt formale në qytet, pa le në fshat), të fillojë të hedhë dhe të forcojë bazat e para për kalimin e vajzës në një jetë të re, të barabartë me atë të djalit dhe ta mësojë vajzën që në këtë moshë të përballojë me guxim vështirësitë dhe çdo shfaqje negative që do të hasë në jetë.

Pas shkollës 8-vjeçare fillon një periudhë shumë interesante për vajzën. Ajo hidhet në jetën e re plot gjësim. Në fshat këtë e shohim, në radhë të parë, në punë, ku ajo ka iniciativë, guxim, s'ka druajtje, djali nuk mund t'i dalë përpara ose ta pengojë. Prindërit, gjithashtu (flas për prindërit konservatorë) nuk i sjellin

shumë pengesa në punë, por tek ata fillon kujdesi për ruajtjen e vajzës, se mos i dalë «nami i keq», «mos e mbajnë nëpër gojë». Ky kujdes pastaj, dalngadalë kalon në shtrëngesë.

Prandaj mendoj se në këtë periudhë organizatat e Partisë, të rinisë dhe të gruas, duhet të bëjnë një punë të dendur, të zgjuar, të shumanshme me të gjitha palët, me vajzën, djalin dhe me prindërit për të kalitur e për të forcuar ndjenjat e së resë përparimtare dhe njëkohësisht për edukimin e tyre moralo-politik, lidhur me të drejtat e gjithsecilit dhe për marrëdhëniet familjare e shoqërore në mës tyre.

Këto probleme Partia nuk i ka kapur si duhet, në fazë të ndryshme, dhe në bazë të një analize të studiuar të ndërtonte punën për edukimin moralo-politik të njerëzvc, në radhë të parë nga ana e saj, pastaj edhe në bashkëpunim me organizatën e rinisë e me atë të gruas.

Unë kam biseduar një ditë me sekretarin e parë të Komitetit Qendror të BRPSH për disa keqkuptime në lidhje me shkollat në drejtim të punës së përbaškët për edukimin e rinisë shkollore. Komiteti Qendror i Rinisë jo vetëm duhet të reflektojë mbi këtë bisedë, por njëkohësisht edhe ta zgjerojë më tej mendimin. Shokët e rinisë që merren me rininë shkollore, të kenë kurdoherë parasysh se shkolla dhejeta në familje janë ato institacione dhe ambiente shoqërore që luajnë rolin vendimtar në edukimin e të rinjve dhe të të reja. Ta lësh pas dore këtë faktor, të mos mbështetesh në të, të mos e bashkërendosh si duhet punën e organizatës së rinisë me punën edukative që bëjnë shkolla dhe

organizata e gruas, atëherë puna e rinisë do të jetë pa baza të shëndosha dhe do të reduktohet në disa manifestime jo të frytshme.

Njohuritë që ka sekretari i organizatës së rinisë e udhëheqësi i pionierëve në shkollë, nuk mund të barazohen kurrë me ato që kanë mësuesit dhe nënët, që njohin çdo gjë te nxënësit dhe fëmijët e tyre. Në këto njohuri të mëdha të nënave dhe të mësuesve mbi zotësinë, prirjet, ndjenjat, ndershmërinë, sjelljet etj., të nxënësve, që janë një orientim i pagabueshëm për organizatën e rinisë dhe për familjet e nxënësve, duhet të mbështetet dhe të ndërtohet puna edukative e organizatave shoqërore. Por këto njohuri nuk vlerësohen si duhet dhe nuk organizohet puna për të përfituar nga kjo eksperiencë.

As Ministria e Arsimit dhe e Kulturës nuk përfiton si duhet dhe sa duhet nga ato për të bërë studime të thella dhe për të përcaktuar orientime të drejta didaktike, pedagogjike, psikologjike për t'i spastruar ose për t'i zëvendësuar metodat e marra nga të huajt, të vjetra apo të reja qofshin këto, të cilat mund të janë të përshtatshme për kushtet e rinisë në vendet e tyre, me zhvillime ekonomike dhe shoqërore të ndryshme, me botëkuptime e koncepte të ndryshme për rritjen dhe për edukimin e fëmijëve, si dhe për familjen dhe shoqërinë, por jo për ne.

Ky duhet konsideruar si një problem i madh partie, të cilin ne duhet ta studiojmë thellë, ta studiojnë bashkërisht mësues e pedagogë, organizata e gruas, ajo e rinisë dhe e bashkimeve profesionale. Të mos e konsiderojmë këtë si një problem të përciptë dhe të lehtë,

por nga më seriozët. Ai paraqet interes dhe është delikat, pasi siç e përmenda, kushtet ndryshojnë jo vetëm nga fshati në fshat, por edhe nga një familje në tjetër. Prandaj, duke u bazuar si duhet në eksperiençën e deritanishme, të cilën duhet ta krehim mirë, të hartojmë një plan pune dhe studimi shkencor, për të përcaktuar forma pune më të drejta për edukimin e gjithanshëm të rinisë.

Nga kjo do të dalin shumë detyra të reja për organizatat e masave, të cilat duhet t'i rishikojnë planet e punës ideopolitike, morale, propagandistike, të riformojnë brendinë e leksioneve dhe të gjejnë forma të reja pune.

Në moshën e rinisë zhvillohen te njerëzit prirjet, ndjenjat e pastra dhe përparimtare, krahas të cilave veprojnë në jetë edhe të vjetrat, konservatoret. Kështu, të rejat, mbi të cilat puna e organizatës nuk ka qenë vepruese, pasi fejohen fillojnë të bien shpirtërisht, dhe, në vend që prirjet e tyre përparimtare të lulëzojnë, ato fillojnë të mendojnë se fejesa ka qenë objektivi kryesor i jetës së tyre. Duke menduar kështu, e reja fillon tërheqjen, u nënshtronhet pak nga pak vullnetit të të fejuarit ose zakoneve prapanike. Në përgjithësi ajo nuk largohet nga puna, nuk e humbet dashurinë përtë, por nuk e ka më hovin e mëparshëm revolucionar, tërhiqet ose fillon tërheqjen ngajeta aktive kolektive. Këtu veprojnë faktorët e dyanshëm, edhe të së resë, edhe të të riut.

Këto janë momente kruciale në jetën e vajzës dhe të gruas, gjatë të cilave Partia, me punën e saj dhe të organizatës së rinisë, duhet ta ketë mbaruar me suk-

ses ciklin e parë të edukimit të së resë me ndjenja me të vërtetë socialiste, ta ketë forcuar tek ajo besimin, ta ketë armatosur për të kapërcyer pengesat në jetë. Simbas mendimit tim këto janë momente delikate në jetën e gruas së re, pasi këtu gjejnë terren ndjenjat dhe pikëpamjet e vjetra e prapanike, të cilat i farkëtojnë asaj vargonjtë e traditës, se gjoja është e dobët për punë, se «tani u bë nënë e duhet vetëm të rritë fëmijë», «ka kush punon për të», «për të punon burri» etj. Pra, fillon sundimi ekonomik i burrit, sidomos atavizmi fizik, dhe mendor i forcës së tij. Kështu, pak nga pak, gruaja fillon të bjerë, të tërhiqet ngajeta, por jo nga puna, të tërhiqet si personalitet moral dhe politik i rëndësishëm i shoqërisë dhe t'i lërë burrit epërsinë.

Partia ka bërë e po bën një punë të madhe për përparimin e gruas. Shkolla dhe puna janë nga faktorët e rëndësishëm që i kanë dhënë hov përparimit të femrës te ne. Partia e ka pasur atë nën kujdes dhe, sidomos kohët e fundit, i ka dhënë një gjallëri aktivitetit për ta mbrojtur gruan' dhe për ta ndihmuar atë të ecë përpara. Partia dhe njerëzit përparimtarë kudo njobin dhe respektojnë cilësitë e larta të gruas. Me plot bindje e pa prapamendim, vetë burrat pohojnë se gruaja punon më mirë nga ata, është më e ndërgjegjshme, më e ndershme në punë dhe shumë më e kujdeshshme. Por, pavarsisht nga këto pohime, puna për t'i ngritur gratë në përgjegjësi drejtohet nga burrat dhe jo nga gratë. Kryetari i kooperativës bujqësore të Divjakës më tha se gratë atje vendosen më pak në punë drejtuese, pasi hasin vështirësi në komandimin e burrave. Pikërisht këtu ka një kompleks

psikologjik që duhet të zgjidhet, ideologjikisht dhe politikisht.

Por, që kjo çështje me kaq rëndësi të zgjidhet drcjt, përveç rasteve të veçanta ose grupeve të veçanta grash, që kanë karakteristikat e tyre, problemi i gruas duhet të shikohet frontalisht. Ky nuk zgjidhet brenda një viti, por është një problem i përhershëm, zgjidhja e të cilët kërkon etapa të gjata, çdonjëra prej të cilave ka problemet e saj të ndryshme të zhvillimit cilësor. Çdo brez ka problemet e veta. Koncepte të vjetra zhduken, të tjera koncepte të reja marrin formë. Por pikërisht këtë zhvillim nuk e lëmë të bëhet spontanisht, atë e udhëheqim me kujdesin më të madh në drejtimin që dëshirojmë.

Si në problemet e tjera, ashtu dhe në këtë duhet ta orientojmë Partinë të mos ecë kuturu, por të studiojë thellë, të nxjerrë konkluzionet, jo një herë e përgjithmonë, por sipas zhvillimit dialektik, të zbatojë edhe masat e nevojshme organizative, politike dhe ideologjike që do të udhëheqin zhvillimin ritmik në rrugë të sigurt.

Organizatës së gruas Partia i jep rëndësi të madhe, po për studimin e kësaj çështjeje nuk duhet të veprohet ashtu si mendohet tashti, sikur kjo është një çështje që i përket vetëm gruas, prandaj le të merret me të organizata e saj. Kështu të mos mendohet për asnjë çast.

Problemi i gruas është një problem i madh partie. Vetë Partia duhet t'i vlerësojë lart punën dhe detyrat e organizatës së gruas dhe ta ndihmojë atë me orientimet e saj, që edhe ajo ta ndihmojë pastaj Partinë. Organizatat e Partisë shpesh nuk e kuptojnë drejt rolin e organizatës së gruas, e konsiderojnë atë si diçka që ka

vlerë sa për të bërë vetëm ndonjë konferencë, ndonjë shtëpi apo fshat model, ose për t'u mësuar grave si të bëjnë gjellë. Kurse organizatën e gruas duhet ta vlerësojmë ashtu si duhet, ta ndihmojmë që dhe ajo të na ndihmojë ne në zgjidhjen sa më mirë të këtij problemi.

Për këtë çështje të madhe shoqërore, Partia duhet të jetë e bindur se situatën më reale të gjendjes së gruas, vetë gratë e dinë më mirë, prandaj ato vetë do të na sqarojnë si është gjendja, ç'duhet të bëjmë për ta zgjidhur sa më mirë këtë problem të madh shoqëror, ku duhet dhe sa duhet të rrahë çekani. Këtë thesar të madh shkencor dhe praktik, ne e nënveftësojmë. Partia në përgjithësi s'po e kap mirë këtë punë, prandaj na duhet të bëjmë një kthesë, të orientojmë dhe të krijojmë mundësitet që gra dhe burra, por sidomos gra, të merren me studimin e këtij problemi të madh shoqëror, i cili është vendimtar, sepse çështja e gruas, si gjysma e popullatës, është çështja e një pjese vendimtare në prodhim, çështja e mëmës, e lindjes, e rritjes dhe e edukimit të brezave të rinj që përtërijnë dhe fuqizojnë atdheun, socializmin, komunizmin.

Duhet, mendoj unë, që Partia dhe veçanërisht çdo komitet partie rrathi, ta studiojë më thellë, në përgjithësi dhe në veçanti, problemin shoqëror të gruas që kështu të dimë më mirë gjendjen, zhvillimin dhe nevojat e saj për të ndërtuar një punë të përshtatshme dhe shkencore në çdo etapë të jetës së saj. Në fazën e rinisë Partia të mendojë si duhet për të hedhur bazën e shëndoshë të moralit të fortë proletar në të rejat, për të kalitur bazën e personalitetit të tyre qysh në moshën

e re e më vonë, në etapat e tjera të jetës, si grua, si nënë dhe si punonjëse, pra, gjatë gjithë jetës ta edukojë, ta ngrejë, ta ndihmojë vazhdimisht për të kapërcyer çdo pengesë në jetë.

Natyrisht, organizatat shoqërore kanë një rol të madh, të cilin ato duhet ta luajnë si duhet dhe, si për këto probleme që përmenda, ashtu dhe për të tjera si këto, të mendojnë thellë e të dalin me propozime e studime. Në planet e mbledhjeve të Byrosë Politike dhe të Sekretariatit të Komitetit Qendror të tilla probleme duhet të përbëjnë këtej e tutje objekte nga më kryesoret që duhet të merren në shqyrtim.

2. — **Mbi problemin e shtypit, veçanërisht në lidhje me fshatin**

Ky është një problem shumë serioz që duhet ta zgjidhim drejt, pasi është shumë i rëndësishëm.

Gazeta patjetër vete në fshat dhe në përgjithësi lexohet, por, kur vete, sa lexohet dhe si lexohet e sa përfitohet prej saj, ky është një tjetër problem dhe në këtë drejtim ka dobësi të mëdha.

Shpërndarja e shtypit në fshatra është një problem që mund të përmirësohet me një varg masash organizative, relativisht të lehta, por problemi më i rëndësishëm qëndron te leximi dhe përfitimi. Pikërisht këtu qëndron vështirësia. Këtij problemi Partia nuk i ka kushtuar kujdesin e duhur. Leximi kolektiv i gazetës është një formë, po jo e tëra dhe më e plota. Kjo formë ka qenë një nga rekomandimet tonë, por sidomos këtë punë në

fshat ne nuk e kemi kontrolluar si duhet. Leximi kolektiv nuk bëhet në rregull, për të mos thënë fare, por edhe në qoftë se bëhet, ata që ua lexojnë punonjësve as që janë mësuar t'i bëjnë ndonjë koment asaj që lexojnë, as udhëzohen çfarë duhet të zgjedhin për t'u lexuar kooperativistëve, mbasi këta, duke qenë në punë, s'mund të dëgjojnë t'u lexohet e gjithë gazeta. Fshatarëve, pas një seleksionimi, duhet t'u lexohet problemi më i rëndësishëm, si dhe artikuj të ndryshëm, që, duke qenë të zgjedhur me kriter, të formojnë dita-ditës tek ata një bagazh të pasur kulture politike, ideologjike, teknike etj. Leximi kolektiv, në qoftë se bëhet dhe duhet të vazhdohet të bëhet, por i studiuar, duhet të nxitë kureshtjen dhe dëshirën e kooperativistëve që gazetën të mësohen ta lexojnë vetë në shtëpi dhe të reflektojnë mbi ato që lexojnë.

Në këto drejtime ne çalojmë me të dyja këmbët. Arsyjeja e analfabetizmit, që ishte pengesë në vitet e para të çlirimtës në fshatrat tona, tani është zhdukur. Në qoftë se kemi arritur njëfarë suksesi në qytete, ku prapë të mos harrojmë se kemi dobësi të mëdha, në fshatra as kuadrot nuk e lexojnë shtypin dhe ata që e lexojnë, nuk e bëjnë këtë punë me seriozitet e me kriter, si një nevojë të domosdoshme. Kjo vjen se Partia nuk u ka mësuar atyre mënyrën dhe metodën si të punojnë për të marrë këtë ushqim të përditshëm dhe vetë kuadrot e rrëthit nuk e lexojnë dhe vazhdojnë të mos e lexojnë në rregull shtypin, të mos nxjerrin si duhet prej tij mësimë e konkluzione për vete dhe përbazën. Prandaj duhet t'ë mendohet për të organizuar një

fushatë të madhe edukimi për leximin dhe përfitimin që duhet nxjerrë nga shtypi. Kjo të mos bëhet si flakë kashte dhe të kuptohet si një fushatë në vete, duke u kënaqur me trajtimin e këtij problemi në një ose dy artikuj të gazetës dhe të kujtojmë se me këtë puna mbaroi. Redaksia e gazetës duhet ta ketë preokupacionin e saj numër një çështjen e shfrytëzimit të shtypit se gazeta shtypet që të lexohet dhe të përfitohet sa më shumë prej saj. Po shkuan punonjësit e gazetës me mendimin se ata kanë për detyrë vetëm të shkruajnë e të shtypin dhe të harrojnë propagandën e gjerë që duhet bërë për leximin e artikujve dhe vendosjen e formave më të mira për studimin e tyre, ta dinë se nuk e kanë bërë detyrën. Pra, është e domosdoshme që me anën e shtypit masiv të ndërtojnë një metodë pune për t'i mësuar njerëzit si të lexohet gazeta, si të studiohet, si të nxirren konkluzione dhe si të zbatohen këto drejt në jetë. Puna edukative nuk duhet të kufizohet në disa artikuj didaktikë, po të gjenden një varg formash e mënyrash që nëpërmjet artikujve të ndryshëm, të nxiten njerëzit të studiojnë dhe prej tyre të nxjerrin vazhdimisht konkluzione direktive, që dalngadalë të formojnë te lexuesit atë edukatë që dëshirojmë ne. Për këtë edukatë nuk kanë nevojë vetëm masa e madhe e lexuesve, por edhe kuadrot, sepse edhe këta në këtë çështje nuk qëndrojnë shumë lart nga masa.

Kuadrot e Partisë dhe të pushtetit në rreth e kanë për detyrë numër një të mendojnë format më të përshtatshme për t'i edukuar punonjësit që ta studiojnë çdo ditë gazeten dhe të orientohen prej saj në punën e tyre të përditshme.

Kjo është absolutisht e domosdoshme, sepse do t'i ndihmojë organizatat dhe njerëzit të ngrihen, do t'u çelë atyre horizonte pune e mendimi, do t'u zhvillojë iniciativën e gjithçka tjetër dhe nuk do të presin javën ose muajin sa t'u kalojë si veri instruktori, sekretari ose kryetari i rrethit. Shokët e sektorit të agjizacionit dhe të propagandës të mos mendojnë se Partia do ta zhvillojë si duhet këtë luftë jetike vetëm me disa direktiva të thata. Mua më duket se duhet menduar thellë për këtë problem, ky duhet zbërthyer dhe shoqëruar me një varg masash organizative, me leksione, pllakata etj., etj.

Kur shkon në fshat, në muret e shtëpisë së kulturës do të shikosh të njëjtat fotografi, po atë hartë, po ato parulla të përgjithshme të dikurshme, ndërsa librat e gazetat i ka mbuluar pluhuri.

Direktivat shpesh jepen të cunguara, të thata, pa kripë, shumë herë edhe vetë ai që i jep nuk i ka thelluar, nuk i ka bluar, as që ka reflektuar në lidhje me gjendjen e fshatit.

Problemet thellësisht shoqërore që ngrenë gazetat herë pas here, as që i preokupojnë punonjësit e Partisë për të bërë analiza të përgjithësuara në rrethin ose në kooperativën e tyre dhe të dalin me një varg masash, të cilat shumë herë janë me një diapazon të gjatë për t'u zgjidhur. Këto probleme jetike, që kanë të bëjnë me botëkuptimet e njerëzve, i lënë t'i zgjidhë spontaneiteti, ose kufizohen vetëm me një punë të vogël praktike dhe natyrisht kështu ato zgjidhen shumë çalë.

Ne nuk kemi gazeta lokale në të gjitha rrrethet, prandaj shtypi ynë qendror duhet të mos harrojë se ka

marrë përsipër barrën ta plotësojë si duhet këtë mungesë. Por a e plotëson ai tani këtë detyrë? Jo, shumë çalë. Patjetër shtypi ynë përgjithëson eksperiencën e gjithë Partisë dhe të pushtetit dhe ka dhënë e po jep një kontribut të madh në edukimin e punonjësve. Por në shtyp ka shumë të meta ndaj të cilave, kuadrot që punojnë në këtë sektor, janë në gjendje të bëjnë më shumë e më mirë në qoftë se reflektojnë më thellë dhe në qoftë se këta do t'i ndihmojmë vazhdimisht, jo vetëm ne këtu në qendër, jo vetëm ne sekretarët e Komitetit Qendror ose aparatet përkatëse të Partisë e të pushtetit në qendër, jo vetëm instruktorët e Komitetit Qendror, por edhe udhëheqja e Partisë dhe e pushtetit në rreth e në bazë.

Ndihma e bazës dhe e komiteteve të Partisë të rretheve për shtypin mendoj se është shumë e dobët, për të mos thënë se ato s'ndihmojnë fare. Edhe disa artikuj që u kërkohen të shkruajnë sekretarët e komiteve të Partisë të rretheve dhe që ata me zor i bëjnë, nuk ngrenë shumë peshë, sepse në ta gjen të njëjtat fraza të përgjithshme dhe konkluzione të njoitura. Kjo më bën të them se sekretarët e komiteteve të Partisë dhe shumë kuadro të tjera në rrethe, sado që janë në gjendje të mendojnë e të krijojnë, sado që kanë kulturë dhe eksperiencë, problemeve shoqërore politike nuk u futen thellë, u qëndrojnë larg, nuk kuptojnë akoma si duhet sa i rëndësishëm është për Partinë një thellim i tillë. Ata kanë adaptuar një metodë pune dhe gjykimi që nuk jep shumë fryte, për arsy se nuk u përgjigjet kërkesave të bazës, e cila tani është ngritur në një shkallë të tillë që do diçka më shumë. Këtë nuk para e

kuptojnë kuadrot tanë. Kapërcimin në cilësi ata jo se nuk duan ta bëjnë, por nuk dinë ta bëjnë. Në këtë drejtim ne duhet t'i mësojmë, pasi kam përshtypjen se, kur i largon dhe i detyron të mendojnë e të veprojnë ndryshe nga rutina e vendosur, ata kujtojnë sikur nuk kanë bërë gjë, e quajnë si kohë të humbur. Pra, edhe në këtë drejtim ne duhet të mendojmë thellë dhe ta përmirësojmë këtë gjendje.

Në rrethe ne kemi si korrespondentë të gazetave shokë me eksperiencë. Këta duhet t'i mësojmë ta bëjnë punën mirë. Por puna e tyre, mendoj unë, në asnje mënyrë nuk duhet të jetë e pavarur dhe e shkëputur nga bashkëpunimi i ngushtë me komitetet e Partisë të rrëtheve ku punojnë. Ata japid informacione dhe le të vazhdojnë t'i japid ato, por gazetat duhet të bëjnë një gjë, që mendoj se nuk e bëjnë: informacionet e tyre nuk mjafton vetëm që të shtypen, por nga të gjitha këto informacione, që duhet të përpunohen seriozisht, të nxirren ide e konkluzione, nga të cilat të dalin artikuj të ndryshëm bazë dhe jo artikuj havadan. Korrespondentët bëjnë reportazhe me kritika, me autokritika, bile edhe për komitetet, edhe për drejtuesit. Këto duhet të vazhdojnë t'i bëjnë, po rrallë kam parë që korrespondenti i gazetës në rreth të bëjë përgjithësimin e eksperiencës së punës të rrethit, në një sektor ose në një tjetër, gjë që ka shumë rëndësi. Një punë e tillë nuk mund të bëhet vetëm nga korrespondenti, këtë ai duhet ta bëjë bashkë me shokët e komitetit të Partisë të rrethit. Të tillë artikuj duhet të jenë të thellë që të sqarojnë disa probleme të mëdha, të mos i trajtojnë këto në mënyrë vulgare, por t'u venë gjërave deri në fund,

t'i ngrejnjë çështjet në platformë të lartë politiko-ideologjike ose teknike, si të thuash, të përgjithësojnë eksperiencën e rrethit në një çështje, me anët e mira dhe me gabimet, gjë që do t'u shërbejë jo vetëm rrethit, por të gjitha rretheve. Kjo nuk bëhet si duhet dhe komitetet e Partisë e komitetet ekzekutive të rretheve këtë e lënë në dorë të fundit.

Si këto ka dhe shumë gjëra të tjera, por si konkluzion dua të them se ne duhet të punojmë seriozisht dhe të gjejmë format e metodat më të mira për ta përmirësuar shtypin, që ai të lexohet mirë e thellë në masë dhe sidomos në fshat.

3. — Mbi disa probleme të këshillave popullore

Shumë gjëra mëson njeriu nga vajtja sado e shkurtër në bazë. Gjatë dy ditëve të qëndrimit tim në rrëthim e Lushnjës, siç thashë, vizitova dy kooperativa bujqësore, atë të Divjakës dhe të Krutjes.

Kooperativa «Stalin» e Krutjes dhe ajo e Divjakës kanë një aktivitet të gjerë e të gjithanshëm. Në problemet ekonomike, shoqërore, politike e ideologjike si kudo, edhe në këto kooperativa, shihet një përparim i madh, bile në shumë gjëra ato janë shumë më përpara nga kooperativat e disa rretheve të tjera, por përparimi konsiston, në radhë të parë, në faktin se në to njerëzit janë shumë të lidhur me punën. Ky është faktori kryesor i kalitjes së ndërgjegjes së njerëzve. Prandaj është shumë pozitive që puna në kooperativat tonë, ashtu si edhe për punëtorët në qytet, është bërë

një faktor vendimtar për kalitjen e ndërgjegjes së kooperativistëve. Lidhja e ngushtë me punën dhe ndërgjegjja e lartë revolucionare që ekziston te punonjësit e fshatit përbëjnë një pasuri të madhe për shoqërinë tonë të re. Në vendin tonë udhëheq klasa punëtore, por të mos harrojmë se fshatarësia ka luajtur e luan edhe sot një rol të madh në përparimin e vendit.

Në kooperativat bujqësore që vizitova kishte një rëz shumë të mirë, të cilët dhanë ide të vlefshme për zgjidhjen e problemeve të kooperativës dhe të pushtetit në bazë.

Gjatë bisedës në lidhje me kompetencat e këshillit popullor doli se në kooperativat e bashkuara ekziston vetëm këshilli popullor i përbashkët i fshatrave që bëjnë pjesë në kooperativën e bashkuar, ndërsa këshillat popullorë të fshatrave të veçanta nuk ekzistojnë më. Për t'u ardhur më afër në ndihmë fshatarëve për nevojat që kanë, gjykohet se do të jetë mirë që këta këshilla të ekzistonin.

Këshilli popullor i fshatit të bashkuar dhe komiteti i tij ekzekutiv, kanë pak kompetenca, ata tani merren me disa çështje të kufizuara. Gjatë diskutimit të këtij problemi doli që këshilli popullor do të ishte mirë të merrej edhe me ndjekjen e veprimtarisë ekonomike të kryesisë së kooperativës, sidomos për rastet kur ajo e neglizon atë, ose kur ndien nevojën për ndihmën e këshillit popullor, për mobilizimin e kooperativistëve, kur ndonjë çështje si, për shembull, grumbullimi i plehrave, hapja e tokave të reja etj., nuk ecën.

U shfaq gjithashtu mendimi se komisioni i kontrollit dhe i revizionimit, që zgjedh asambleja për kontro-

Ilin e veprimtarisë ekonomiko-financiare të kooperativës, të kthehet si organ në duart e këshillit popullor, sepse kjo do t'i japë mundësi atij të kontrollojë veprimtarinë ekonomiko-financiare të kooperativës, të vihet në debat me kryesinë dhe si rrjedhim të zhvillohet një luftë e dyanshme për të çuar përpara prodhimin dhe tërë jetën e fshatit. Ky komision, thonë ata, do të qe më mirë të varej nga organi i zgjedhur i popullit se në këtë mënyrë do të ngrihet ca edhe autoriteti i pushtetit në fshat, pasi duke qenë komisioni i kontroll-rezisionimit nën vartësinë e këshillit popullor të fshatit, çështjet ekonomiko-financiare të kooperativës do të zgjidheshin më mirë.

Rezisionimin e sektorit finançiar-ekonomik, natyrisht, do ta bëjë vetë kooperativa me anën e komisionit të saj të kontroll-rezisionimit. Në rast se një kooperative bujqësore i lind nevoja të ndihmohet me revizorë përveç atyre që ka, atëherë kryesia mund t'i drejtohet komitetit ekzekutiv të rrëthit për t'i dërguar një revizor tjetër.

Këshilli popullor mund të interesohet gjithashtu edhe për zbatimin e statutit të kooperativës, kur kryesisë i shpëton kontrolli në këtë drejtim, si dhe për ndjekjen e zbatimit të vendimeve të Qeverisë në kooperativat bujqësore. Kështu, pra, këshilli popullor nuk do të ketë një numër të kufizuar kompetencash dhe të merret me çështje fare të vogla.

Ai mund të ndjekë e të kontrollojë edhe zbatimin e kontratës, si nga ana e kooperativës së konsumit përfurnizimin e kooperativës bujqësore me mallrat e kontraktuara, ashtu edhe nga ana e kooperativës bujqësore

për produktet që kjo, gjithashtu, në bazë të kontratës, duhet t'i dorëzojë kooperativës së konsumit.

Këshilli popullor mund të thérresë në raport kryesinë e kooperativës edhe në rastet kur kjo nuk ka realizuar prodhimin sipas planit të vendosur nga asambleja, mund të thérresë në raport një brigadier që nuk punon mirë, mund të kujdeset gjithashtu edhe për ndërtimet, për problemet komunale, të shëndetësisë, për kopshitet e çerdhet e fëmijëve etj.

Kryesisë së kooperativës bujqësore do t'i jepej këshitu mundësia të merrej kryesisht me çështjet ekonomike, me realizimin e planeve të prodhimit, do të lehtësohej edhe nga disa barrë të tjera, si, për shembull, nga drejtimi e kontrolli i veprimtarisë së furrës së bukës etj., detyra këto që përmenda, të cilat duhet t'i kryejë këshilli popullor.

Komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të rrëthit nuk duhet të ndërhyjë në punët e kooperativës bujqësore sikurse bëhet deri tani, mbasi kooperativa është një organizatë vullnetare ekonomike masash e fshatarëve. Shteti mund të ndërhyjë vetëm për ato çështje që parashikon ligji, për shembull, kur shkelen kontratat nga ana e kooperativës bujqësore dhe ajo e konsumit, për përdorimin jo si duhet të kredisë që i është dhënë etj. Kurse në çështjet e pasurisë së kooperativës s'ka përse ndërhyn shteti, pse zot i mallit është asambleja, e cila mund të vendosë të bëjë çdo gjë. Në qoftë se kryesia do të gabonte për një ndërtim, aty është Partia dhe masa e kooperativistëve, prandaj ata do të ndërhyjnë, do ta vënë në vend gabimin dhe nuk do ta lënë kryesinë të bëjë gabime të tjera. Në qoftë se asambleja e gjykon

të nevojshme dhe vendos të bëjë një shtëpi kulture, përse të ndërhyjë shteti në këtë çështje? Përse ta ndalojë banka kooperativën të prishë paratë e saj? Banka, si organ shtetëror, kur sheh se kooperativa i prish paratë për një punë joprodhuese dhe shtetit njëkohësisht i kërkon kredi për të ndërtuar një kanal, ose për të ngritur një bllok pemësh frutore, nuk i jep kredi dhe në rastin konkret e këshillon kooperativën që në vend të shtëpisë së kulturës, me paratë që disponon, të bëjë më parë kanalin dhe shtëpinë e kulturës ta ndërtojë më vonë. Kurse këshilli popullor i fshatit që është baza e pushtetit popullor, i lidhur ngushtë dhe i interesuar për problemet e kooperativës, mund të ndërhyjë në këto raste, pse këshilli popullor i fshatit është zgjedhur nga populli i atjeshëm për të punuar për mbarëvajtjen e punës në fshat.

Pra, parimi që pushteti të mos ndërhyjë më shumë nga sa duhet në punët e kooperativës bujqësore si organizatë ekonomiko-shoqërore masash, nuk preket. Zot në kooperativë është populli. Po edhe vetë këshilli popullor atje është zgjedhur nga ky popull. Prandaj interesimi i këshillit popullor të kooperativës nuk e prish parimin e mosndërhyrjes së shtetit në punët e kooperativës bujqësore. Ky interesim nuk mund të kon siderohet ndërhyrje në punët e brendshme të kooperativës. Ndryshe është me komitetin ekzekutiv të rrëthit.

Nga këto që thashë dalin shumë përfitime, vetë kryesia e kooperativës do të lehtësohet nga shumë barrë dhe ata që janë zgjedhur në këshillin popullor të fshatit si këshilltarë, do të marrin më shumë përgjegjësi dhe

do të ndajnë barrën e rregullimit e të administrimit të kooperativës.

Dëshiroj të theksoj, ose më mirë të ritheksoj, se kur shkoj në bazë dhe marr kontakt me udhëheqjen e Partisë dhe të pushtetit në një rrëth, domethënë me anëtarët e byrossë, disa herë më ka ndodhur (mbase kjo u ngjet edhe shokëve të tjerë) që udhëheqja e rrëthit pret të flas vetëm unë dhe ajo të mos flasë. Kur unë kërkoj që të parët të flasin shokët e rrëthit, fjalën e merr sekretari i parë. Kjo është e natyrshme, po ajo që është jo e natyrshme është çështja se flet vetëm sekretari i parë, kurse të tjerët heshtin, rrallë shfaqin mendime ose diskutojnë. Pjesëtarët e tjerë të takimit e quajnë të mjaftueshme të flasë sekretari, sikur unë të isha një i huaj, ndërsa në kooperativat bujqësore nuk ngjet kështu me udhëheqësit e tyre dhe me ata të Partisë. Atje flasin të gjithë, ndërhyjnë dhe shfaqin mendime për një problem ose për një tjetër. Por edhe kur flet sekretari i parë i rrëthit, siç e dimë, ai flet vetëm për ekonominë, për bujqësinë dhe për asnjë problem tjetër. Kur u bën pyetje të ndryshme jashtë problemit ekonomik, shokët e rrëthit ka raste që gjenden të papërgatitur si duhet dhe të përgjigjen në mënyrë të sipërfaqshme. Edhe për këtë përgjigjet sekretari i parë, me përjashtim të rastit kur i vë gishtin direkt sekretarit që është ngarkuar me atë sektor, për të cilin drejtohet pyetja. Natyrisht, kjo nuk është një punë e rregullt dhe duhet ta ndryshojmë.

Kur një udhëheqës vete në rrëth, ai interesohet jo vetëm për ekonominë, por edhe për jetën e Partisë, për

gjendjen politike, për kulturën, për arsimin, për kuadrot, ai dëshiron të njohë ngritjen e cilitdo anëtari të byrosë, mendimet e tij etj.

Karakteristik ishte takimi kësaj radhe me shokët e byrosë së komitetit të Partisë në Lushnjë. U bëra disa herë pyetje se ç'mendonin për vendimet e rëndësishme që ka marrë Partia kohët e fundit, a kanë ndonjë vërejtje për to, ç'thonë Partia në bazë e masat e popullit, si mendojnë ata ta organizojnë punën, të përmirësojnë stilin dhe metodën e punës. Me sa hapët gojën ju që nuk ishit atje, aq e hapën edhe ata. Foli pesë minuta sekretari që merret me organizimin, duke sjellë vetëm një shembull dhe pesë minuta të tjera sekretari i parë. Atëherë si zakonisht u detyrova të flisja unë.

A janë pa mendime shokët? Absolutisht jo! Unë mendoj se edhe këtu ekziston një metodë e gabuar e punës dhe një intelektualizëm i sëmurë te kuadrot, një frymë jo e shëndoshë prej nëpunësi që nuk guxon të flasë se mos nuk i lidh mirë frazat, se, po të flasë, mos nuk i shpreh qartë mendimet dhe krijon përshtypje të keqe, prandaj ai mendon «heshtja është flori». Këto koncepte ne duhet t'i spastrojmë sa më parë.

U fola shokëve mbi metodën dhe stilin në punë dhe mbi rolin e punëtorit të Partisë.

Metoda dhe stili i ri i punës, që po vërmë tani në jetë, mendoj se do të na japë fryte shumë të mëdha. Por atë ne nuk duhet ta zbatojmë shabllon, të themi se tani kjo është më e mira dhe s'ka më tjetër. Kjo metodë pune, natyrisht, është më e mirë, megjithatë edhe këtë ne duhet ta pasurojmë vazhdimisht me eksperiençën e madhe të Partisë. Eksperienca e Partisë duhet

dhe do të na mësojë si ta bëjmë më mirë punën për të zbatuar në jetë këtë vijë të drejtë të përgjithshme që po përpunojmë në lidhje me metodën dhe stilin e punës. Të gjithë duhet të reflektojmë për orientimin e ri, duke u bazuar edhe në eksperiencën e kaluar. Për të gjetur metoda më të mira të punës në të ardhmen duhet të na punojë vazhdimisht mendja.

Me metodën e re të punës që jemi duke praktikuar brenda këtyre dy muajve në mbledhjet e Byrosë Politeke, të Qeverisë dhe të Sekretariatit nuk na ka dalë ndonjë vështirësi për përgatitjen e tyre. Këto kanë qenë mbledhje me të vërtetë substanciale për probleme të rëndësishme partie dhe ekspeditive. Prandaj rëndësi nuk ka çështja që të caktojmë nëse duhet të bëjmë dy ose tri mbledhje në muaj, rëndësi ka mënyra e përgatitjes së tyre dhe çështjet që shtrohen në to.

Gjatë kësaj kohe ne jo vetëm kemi marrë mjaft vendime të rëndësishme, po u lëvizën edhe gurët e shahut nga të katër anët e Shqipërisë. Metodën tonë të mëparshme jo të zhđervjellët të punës e kanë marrë dhe e kanë praktikuar edhe shokët e bazës. Por tani, ashtu si ne, edhe ata janë duke e ndryshuar metodën e vjetër. Po puna me kaq nuk ka mbaruar, ky është vetëm fillimi.

Tani ne kemi marrë një varg masash, kemi filluar punën me një metodë e stil të ri, po, të mos harrojmë se, pa e kuptuar, mund të kthehem e të vazhdojmë prapë metodën e stilin e vjetër të punës që mund të na tërheqë. Prandaj të kemi shumë kujdes, të mos dehem nga ndryshimi që i kemi bërë metodës dhe stilit të punës gjatë këtyre kohëve të fundit.

Metoda dhe stili i ri në punë duhet të na nxitin

vazhdimisht të reflektojmë, por natyrisht jo të filozofojmë, por të mendojmë si ta përmirësojmë më shpejt punën në një rrugë të drejtë revolucionare. Kjo nuk është aq e lehtë, por nuk është as e pakapërcyeshme për ne, sepse Partia ka një eksperiencë të madhe. Fakti është se, porsa Partia dha sinjalin, të gjithë u ngritën në këmbë dhe panë se në këtë drejtim nuk kemi ecur mirë. Partia jonë është e pjekur, ajo reflektoi për gabimet që janë vërtetuar në praktikë dhe na tregoi rru-gën si duhet ecur paskëtaj. Prandaj të punojmë me kujdes që ta ndryshojmë në thelb mënyrën e vjetër të punës. Mundësitë për këtë ekzistojnë, kjo nuk është diçka e rëndë, por e theksoj edhe një herë, të kemi kujdes të madh që të mos na mbulojë përsëri rutina e vjetër.

Shokët që punojnë në aparatet e Partisë duhet t'i njobin mirë edhe punët e pushtetit, se për këtë janë përgjegjës përpara Partisë. Çështjeve të pushtetit që kanë të bëjnë me problemet e ndërtimit të socializmit, sidomos zgjidhjes së plotë të tyre, Partia kudo duhet t'u japë rëndësi. Prandaj për këtë qëllim ajo duhet të bëjë përpjekje, në radhë të parë, për të gjetur format më të përshtatshme për zhvillimin e një pune politike të menduar mirë me njerëzit që do t'i zgjidhin këto probleme, për ngritjen ideopolitike të tyre, domethënë për kalitjen e njeriut të ri me virtytet e larta të Partisë. Punëtorët e Partisë duhet të përpiken që të gjithë punonjësit, me parti ose pa parti, të bëhen njerëz me një formim të lartë ideologjik e politik për të kryer si duhet çdo detyrë që u ngarkohet në jetën shoqërore dhe ekonomike, në ndërtimin socialist të vendit, të bëhen të

ndërgjegjshëm që të marrin në dorë dhe ta përvetësojnë sa më mirë teknikën kudo që të jenë, me qëllim që në vendin tonë të krijohet bollëku, të lulëzojë ekonomia, jeta e njerëzve të bëhet e gjëzuar. Këtu qëndron përgjegjësia e tyre e madhe.

Të njëjtën gjë mund të themi edhe për shokët që punojnë në aparatet e pushtetit. Edhe ata përpara çdo gjëje janë njerëz partie, njerëz politikë. Funksionet ekonomike që ata janë ngarkuar të kryejnë, nuk duhet t'i mendojnë as t'i marrin të shkëputura nga politika dhe ideologjia e Partisë, pér arsy se politika dhe ideologjia nuk mund të ndahen nga ekonomia, nga industria, nga bujqësia etj. Pra edhe shokët e pushtetit çdo detyrë, çdo veprim të tyre, duhet t'i kuptojnë më parë politikisht e ideologjikisht dhe jo në mënyrë automate. Në rast se përfaqësuesi i një kooperative i drejtohet, pér shembull, kryetarit të pushtetit në rreth pér një kredi që i duhet kooperativës pér ngritjen e shpejtë të ekonomisë së saj, ky, si njeri partie, kur e di se shteti nuk ka mundësi t'ia plotësojë tërësisht kërkesën, duhet t'ia shpjegojë politikisht këtë të dërguarit të kooperativës, në mënyrë që ai të bindet, t'i ngrihet ndërgjegjja e perspektiva dhe të ketë besim se shteti sot kaq ka, kaq i jep, kurse plusin që i duhet, të vrasë mendjen dhe të bëjë të gjitha përpjekjet ta plotësojë nga ekonomia kollektive, ose në qoftë se nuk disponon, të mobilizojë të tëra forcat në dispozicion të kooperativës pér të punuar në mënyrë të jashtëzakonshme me qëllim që të plotësojë shumën që i nevojitet. Pra edhe punët e pushtetit duhet të shoqërohen me një punë politike intensive.

Duke i kuptuar drejt këto çështje, punëtorët e Partisë nuk duhet të marrin punën e njërit dhe të tjetrit, duke dalë përpara me termin «udhëheq Partia». Secili duhet të bëjë punën që i përket. Punëtorët e Partisë nuk duhet të mendojnë se nga ata varet fati i jetës së vendit. Jo. Punëtorë partie nuk janë vetëm ata që punojnë në aparatet e Partisë, po edhe komunistët në aparatet e pushtetit. Punëtorët e Partisë janë ngarkuar që në bazë të situatës, të planit dhe të orientimeve të dhëna, të punojnë që njerëzit të bëhen të ndërgjegjshëm politikisht e ideologjikisht. Shokët që punojnë në aparatet e pushtetit, që edhe këta janë gjithashtu njerëz partie, Partia i ka ngarkuar, në radhë të parë, të kuptojnë drejt politikisht e ideologjikisht rolin e pushtetit dhe të mobilizohen për të zbatuar detyrat që u ngarkon plani. Njëkohësisht ata, duke qenë përgjegjës nga ana shtetërore për realizimin e planit në koordinim me të gjithë punën e Partisë, të marrin masat e nevojshme që ky plan të realizohet. Kështu Partia, si një trup i vetëm, në organet dhe aparatet e Partisë dhe të pushtetit, harmonizon të gjithë punën.

E dimë të gjithë se planet dhe detyrat nuk shkojnë kurdoherë përpara siç duam ne. Prandaj, në radhë të parë, Partia duhet të bëjë një punë të pandërprerë për edukimin politik dhe ideologjik të njerëzve. Në bujqësi punët fillojnë që nga përgatitja e tokës dhe e farës për mbjellje e derisa prodhimi futet në hambar. Gjatë gjithë proceseve të punës del nevoja të merret një numër i shumtë masash tekniko-organizative, por që prodhimi të realizohet, në radhë të parë, është e domosdoshme të merren masa për t'u shpjeguar njerëzve kuptimin

politik e ideologjik të detyrave që kanë përpala, në mënyrë që të bëhen të ndërgjegjshëm për t'i kryer ato më së miri. Por në jetë me njerëzit nuk ecën çdo gjë lisho. Idetë dhe ndjenjat e tyre nuk mund të janë të klasifikuar si në një skedar. Tjetrit mund t'ia mbushësh mendjen dhe aty për aty të të japë fjalën se është gati të shkojë në prodhim, po pas ca kohe i del përpala një hall familjar dhe i kthehet mendja, ose një njeri jo i mirë i hedh një thumb dhe e fut si të thuash në një rrugë kryq. Dikush tjetër mund ta japë fjalën të shkojë atje ku do t'i thotë Partia, po brenda në ndërgjegjen e tij, siç e provonjeta, ai thotë «le të hesht tani sa të kalojë kjo valë, të mos dukem, por edhe sikur të më marrë kalemi të lëviz, do të them jam i sëmurë, gruan e kam tbc», dhe kështu dredhon fjalën që ka dhënë. Prandaj puna e Partisë me njerëzit duhet të jetë e vazhdueshme, intensive, e organizuar dhe joshabllone.

Detyrat e përbashkëta, por edhe specifike, të punonjësve të Partisë dhe të pushtetit duhet të koordinohen gjatë gjithë veprimtarisë së tyre. Veprimtaria e Partisë për edukimin e njerëzve duhet të jetë e madhe dhe e vazhdueshme. Mbi të gjitha Partia ka parasysh që kryerja e çdo detyre varet nga njeriu. Në qoftë se njerëzit i bëjmë të sjellshëm, të ndërgjegjshëm, të ngritur politikisht dhe ideologjikisht, revolucionarë, me perspektivë e hov në punë, realizimi i planit do të bëhet me lehtësi. Prandaj detyra e punëtorit të Partisë është që të bëjë një punë të studiuar me njerëzit dhe jo në mënyrë automate.

Edhe shokët e Partisë në rreth duhet ta ndërrojnë metodën e punës në drejtim të ndihmës për bazën. Se-

kretarin e organizatës-bazë të Partisë, për shembull, e kanë zgjedhur komunistët jo vetëm pse ai është nga më të ngriturit midis shokëve, po edhe nga më revolucionarët dhe se është njeri i aksionit. Organizata-bazë e ka gjykuar se ai është në gjendje t'i drejtojë dhe t'i ndihmojë shokët në mendime, në gjykime, në punë, t'i udhëzojë ata si të punojnë e të veprojnë drejt. Ai duhet të jetë i lidhur ngushtë me komunistët edhe jashtë mbledhjes së organizatës. Kur një shok ndien nevojën për ndihmë, duhet të vejë te sekretari, t'i qajë hallin dhe ky të jetë i gatshëm dhe në gjendje t'ia zgjidhë problemin në mënyrë të pjekur. Megjithëse sekretari i organizatës-bazë është komunisti me cilësitë më të mira, sekretari i komitetit të Partisë të rrethit nuk duhet të mbajë lidhje e të mbështetet vetëm tek ai dhe të kujtojë se kështu e ka në dorë organizatën-bazë. Kjo nuk është e drejtë, po një metodë pune e gabuar.

Me këtë nuk dua të them që udhëheqësi i Partisë i rrethit të mos mbështetet te sekretari i organizatës-bazë, por, në radhë të parë, ai duhet të njohej mirë vetë drejtpërsëdrejti njerëzit që ka organizata-bazë, mendimet e komunistëve, hovin në punë, tërë veprimtarinë e tyre. Atëherë sekretari i komitetit të Partisë të rrethit, si shok më revolucionar dhe më i ngritur që është, duke e njojur mirë gjendjen, do të marrë masat më të përshtatshme që, organizata ku ka shkuar, të hedhë çapin aq sa është në gjendje. Një organizatë-bazë tjetër më e mirë mund të jetë në gjendje të hedhë dy çapa përraga, pasi atje përgatitja e komunistëve e formimi i tyre revolucionar janë të ndryshme, sepse ashtu siç është me njerëzit, është edhe me organizatat-bazë. Të gjithë jemi

anëtarë partie, po midis nesh ka njerëz më të zgjuar, ka të tjerë më pak të zgjuar, ka më të hedhur, ka më të përmbajtur, ka elementë më revolucionarë, ka më të fjetur, pra, nuk janë të tërë të prerë me një gërvshërë.

Detyra e Partisë në përgjithësi dhe në veçanti e udhëheqjes që grumbullon e përgjithëson eksperiencën e tërë kolektivit, është që të plogështit t'i bëjë më të gjallë, ata më pak revolucionarë t'i bëjë më revolucionarë, frikacakët t'i bëjë trima, të lëkundurit në karakter dhe në moral t'i forcojë. Këto ndryshime pozitive që duhet të realizojë organizata-bazë e Partisë në efektivin e saj, te çdo komunist, të mos bëhen vetëm për t'u dukur, por të punohet në mënyrë që secili që ka ndonjë nga dobësitë e përmendura më lart, t'i kuptojë mirë ato që i thotë sekretari i Partisë dhe nga këshillat, edukata, shembulli i tij pozitiv, të arrijë të bindet, të bëhet i ndërgjegjshëm, të korrigjohet dhe të punojë mirë.

Çështjen e kam që nuk duhet mbështetur vetëm te sekretari i organizatës, po te e gjithë organizata-bazë. Në një qendër pune organizata-bazë është Partia. Por të mos harrojmë që kjo si tërësi ka edhe të metat e dobësitë e saj, që lindin nga individët që e përbëjnë, nga ndryshimet që ekzistojnë midis njërit e tjeterit, nga ngritja dhe kuptimi i problemeve, hovi dhe iniciativa e gjithsecilit. Nga diskutimi kolektiv i një problemi, organizata mund të dalë me një direktivë që duhet të vihet në jetë nga të tërë anëtarët. Por, në zbatimin e direktivës nuk veprohet njëloj nga të gjithë komunistët. Disa anëtarë partie punojnë mirë, disa nuk e zbatojnë si duhet vendimin, disa kanë mbeturina të theksuara, disa që kanë pasur nga këto, me ndihmën e organizatës

dhe me punën që ata kanë bërë në veten e tyre, i kanë zhdukur ato. Me këtë dua të them se puna e udhëheqjes së Partisë në rreth ndaj bazës duhet të jetë më intensive dhe më e zgjuar. Po nuk mjafton edhe kjo.

Partia duhet të punojë edhe me masën e popullit që është «toka», mbi të cilën mbështetemi. Janë masat e popullit ato që e pajisin Partinë me cilësitë më të mira, po ato i transmetojnë edhe të metat e tyre. Puna e Partisë me masat duhet të jetë barometri që vërteton se sa e ngritur është Partia dhe sa është në gjendje ajo t'i korrigjojë të metat e saj dhe të mësave, a është ajo në gjendje t'i zbulojë e të punojë që t'i zhdukë mbeturinat mikroborgjeze. Prandaj kontakti i dendur i udhëheqësve të Partisë të rrethit me masat është një nga punët, nga detyrat më kryesore të Partisë, ndryshe Partia do të mbyllej në guaskën e saj.

Të gjithë punonjësit tanë sytë i drejtojnë te komunistët, te Partia. Prandaj ai që ka teserën e Partisë në xhep, duhet të jetë i drejtë, i ndershëm, njeri i sakrificës. Kur anëtari i Partisë nuk është i tillë, punonjësi pa parti, fundi i fundit për respektin e madh që ushqen ndaj Partisë mund të heshtë një herë, dy, pastaj, kur kupa mbushet, ai flet. Kështu, kur krijohet një situatë e sëmurë në radhët e komunistëve, kjo nuk ka si të mos përhapet në fshat, ashtu siç ka ndodhur, për shembull, në kooperativën bujqësore të Këmishtajt të rrethit të Lushnjës, ku ka mungesë uniteti në organizatën e Partisë, grinde e mosmarrëveshje. Në këto kushte sekretari i komitetit të Partisë të rrethit nuk duhet të bisedojë më në mënyrë të kufizuar vetëm me sekretarin e organizatës-bazë ose me kryetarin e kooperati-

vës. Çështja tashmë nuk mund të mbetet vetëm te këta, po i duhet drejtar për zgjidhje edhe organizatës-bazë të Partisë. Bile derisa masa e di gjendjen e krijuar, atëherë përsë të mos i drejtohet edhe gjykimit të saj?

Në fshat të gjithë e njohin sekretarin e komitetit të Partisë të rrithit. Ai nuk e ka vështirë që të vejë në çdo kohë, bile edhe për darkë, te një kooperativist dhe të konsultohet për këtë problem që preokupon Partinë, nesër të bisedojë me një tjetër e kështu me radhë të kërkojë mendimin e tyre, derisa të marrë opinionin e masës dhe pastaj ta çojë këtë në organizatën-bazë të Partisë. Duke pasur në dorë të dhënat që ka marrë nga njerëz të ndryshëm pa parti, ai është në gjendje të vlerësojë si qëndron çështja, kush e ka fajin. Në organizatën-bazë çdo komunist thotë mendimin e tij, por sekretari i komitetit të Partisë të rrithit, që është konsultuar edhe me disa familje dhe ka marrë opinionin e tyre, i jep organizatës të dhënat e pikëpamjen e masës dhe si e gjykon ai vetë çështjen. Pastaj organizata bën vlerësimin e këtij gjykimi. Pra, kur një çështje ka kapërcyer kufirin e organizatës-bazë dhe ka marrë dhenë, në rast se duam ta zgjidhim drejt e rrënjosht, duhet marrë edhe mendimi i masës, ndryshe ajo do të zgjidhet me mballoma.

Pas gjykimit e vendimit që do të marrë organizatës-bazë, popullit i duhet folur hapur në rast se kryetari i kooperativës dhe sekretari i organizatës-bazë të Partisë nuk janë në rrugë të mirë, në mënyrë që, kur të merret masë ndaj tyre, ai të jetë i qartë.

Ja, pra, një metodë pune që duhet rishikuar. Mun-

det që kjo që them të mos jetë shumë e drejtë, po të shohim ç'do të na japë.

Prandaj të gjejmë format e metodat më të mira që njerëzit t'i bindim për masat e drejta që merr Partia ndaj atyre që shkelin normat dhe ligjet e saj.

Deri tani, kur punëtorët e Partisë shkonin në fshat, gjëja e parë për të cilën interesoheshin të dinin nga sekretari i organizatës-bazë dhe nga komunistët ishte si që realizuar plani. Pastaj bëhej pyetja: u bë apo nuk u bë ky ose ai leksion, u bë apo jo mbledhja e rinisë ose e gruas etj. Domethënë ai interesohet në përgjithësi për disa gjëra të kësaj natyre, po më shumë për çështjet ekonomike. Natyrisht, ekonomia është dhe duhet të jetë baza, prandaj punëtorët e Partisë duhet të punojnë që njerëzit të bëhen të ndërgjegjshëm për realizimin e detyrate dhe të mobilizohen për këto me të gjitha forcat e tyre kudo që punojnë. Kështu komunistët do t'i ndjekin më mirë problemet ekonomike, siç janë mbjelljet, shfrytëzimi në maksimum i traktorëve, mirëmbajtja e farës, prashitjet në kohë etj. Punëtori i Partisë për këto probleme mund të interesohet të dijë edhe ç'masa do të merren nga pushteti. Por nuk është vetëm kjo detyra e tij. Përveç jetës së organizatës-bazë dhe qëndrimit të çdo komunisti, punëtori i Partisë duhet të njohë edhe çdo gjë tjeter të domosdoshme dhe, nga rastet e veçanta, nga çdo ngjarje negative që ndodh në fshat, në kooperativë, në marrëdhëniet në punë, ndaj pronës së përbashkët, ndaj njëri-tjetrit apo në marrëdhëniet familjare etj., duhet të nxjerrë konkluzione të rëndësishme për punën e organizatës-bazë të Partisë.

Puna e udhëheqjes së Partisë nuk është e thjeshtë.

Ajo duhet të kalojë nga metoda individuale e bindjes, në një punë partie me veprim frontal. Partia ka punuar në këtë drejtim edhe më parë, po kjo duhet bërë akoma më e zhdërvjellët, më revolucionare, njëkohësisht dhe më e thjeshtë e më e kuptueshme nga masat, se kështu do të kemi rezultate më të mëdha.

Puna e Partisë është me përgjegjësi të madhe, nuk lejohet që ajo të bëhet shkel e shko, në mënyrë formale e burokratike. Në Parti nuk duhet të ketë burokratizëm dhe rutinë. Në rast se burokratizmi dhe rutina zënë vend në Parti, atëherë fare lehtë ato do të përhapen në aparatet e pushtetit, ku këto sëmundje ngjiten më shumë. Bürokratizmi në Parti është më i rrezikshëm se në pushtet; ai lind nga presioni i mbeturinave borgjeze e mikroborgjeze të njerëzve mbi komunistët, prandaj Partisë i vihet detyrë që anëtarët e saj t'i pastrojë nga këto mbeturina dhe t'i kalitë me një propagandë politike të zgjuar, të shkathët, të kuptueshme e të lidhur me punën.

*Botuar për herë të parë në
librin: Enver Hoxha «Raporte
e fjalime 1965-1966», f. 274.
Tiranë, 1971*

*Botohet i plotë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin
Qendror të Partisë*

TRADHTARET REVIZIONISTË HRUSHOVIANE SHKOJNE NË KONGRESIN E TYRE ME NJË BILANC DËSHTIMESH TË MËDHA

Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»

22 mars 1966

Udhëheqja revizioniste sovjetike po u jep tani dorën e fundit përgatitjeve të saj të mëdha pér montimin dhe reklamimin e Kongresit të 23-të të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, i cili do të hapet në Moskë më 29 të këtij muaji. Makina propagandistike revizioniste është munduar shumë të krijojë midis njerëzve një entuziazëm fals, një atmosferë të rreme pritjeje vendimesh «të rëndësishme» e «kthesash» rrënjosore. Duket se organizatorët e tij nuk do të kursejnë asgjë pér të spekuluar me shifrat e përqindjet e planeve të kaluara dhe të ardhshme, me kozmonautët dhe bombat atomike, me kopshtet e fëmijëve dhe arsimin e lartë. Mjeshtrit revizionistë të paradave do të mundohen shumë që zhurma dhe bombasticiteti i papërmbajtur të mbulojnë dhe të mbytin, të paktën gjatë kohës së kongresit, realitetin e hidhur. Por vështirësitë e mëdha dhe kontradiktat e thella që kanë mbërthyer udhë-

heqjen revizioniste sovjetike, nuk mund të fshihen e të maskohen lehtë.

Kongreset për çdo parti komuniste janë ngjarje tepër të rëndësishme në jetën e tyre, ato janë mbledhje në të cilat bëhet bilanci i punës së kryer dhe caktohen detyrat e së ardhmes, në të cilat analizohen thellë sukseset e gabimet dhe partia jep llogari përpara popullit të saj për çfarë ka bërë dhe ç'do të bëjë. Ato kryejnë një verifikim shkencor skrupuloz të vijës së partisë në të gjitha drejtimet, mobilizojnë forcat për beteja të reja revolucionare. Por me se shkon në kongres udhëheqja e re sovjetike, me ç'bilanc del ajo përpara popullit sovjetik, çfarë programi i paraqet ajo atij, për çfarë i bën thirrje të punojë e të luftojë?

Vija hrushoviane, e formular dhe e kanonizuar në kongreset e 20-të e të 22-të dhe që është adoptuar e mbrojtur tërësisht nga udhëheqësit e rinj të partisë, dështoi plotësisht dhe në të gjitha frontet. Këmbëngulja dhe ndjekja me kokëfortësi e politikës së tradhtisë ndaj marksizëm-leninizmit, revolucionit dhe socializmit i vunë revizionistët hrushovianë përpara vështirësish, dështimesh dhe kontradiktash serioze, të cilat nga dita në ditë zgjerohen e komplikohen. Gjendja e punonjësve sovjetikë është keqësuar, vendi është përfshirë nga një frymë pesimiste e disfatiste, prestigji dhe autoriteti ndërkombëtar i Bashkimit Sovjetik janë ulur.

Që nga Kongresi i 20-të i PK të BS, kur Nikita Hrushovi shpalosi flamurin e tij të leckosur të revizionizmit, kanë kaluar vetëm dhjetë vjet. Por sa goditje të mëdha ka marrë populli sovjetik, ç'peripeci ka kaluar ai, çfarë traumash të rënda ka pësuar ndërgjegjja e tij!

Në kongrese e plenumi udhëheqësit e tij i premtuan parajsën komuniste, kurse në praktikë e futën në skëterrën hrushoviane. Mbi kurrizin e tij u eksperimentuan reforma pas reformash, organizime e riorganizime, korrigjime e kthesa, të cilat çuan në një çorganizim të madh dhe konfuzion të pashembullt. Sa herë iu premtua atij se, në mos këtë vit, tjetrin, në saje të «masave» që kishte marrë udhëheqja, të «analizës shkencore» që ajo i kishte bërë situatës, në saje të «frymës leniniste» që ajo kishte vendosur në parti e në pushtet, në saje të «stilit leninist» në punë, të «ndreqjes» së të metave etj., gjendja e punonjësve sovjetikë «do të përmirësohej» në mënyrë rrënjosore, në vend do të krijohej bollëku, njerëzit do të hanin me lugë të florinjtë dhe krerët hrushovianë do të flinin mbi dafinat e «fitoreve»! Por jeta e përditshme e popullit nuk rregullohet dot me fjalë, ajo nuk mbahet gjallë me iluzione e gënjeshtra. Realiteti, faktet konkrete nxorën shumë shpejt në shesh gjithë demagogjinë, falsitetin dhe sharlatanizmin e atyre njerëzve të cilët, me mënyra të djallëzuara, puçiste, me intriga e me komplate, uzurpuan udhëheqjen e partisë dhe të shtetit në Bashkimin Sovjetik. Metodat idealiste, pragmatiste e oportuniste që adoptuan ata, u ktheyen në goditje të rënda për vetë autorët e tyre. Ata ranë vetë në kurthet që ngritën kundër leninizmit, popullit sovjetik dhe revolucionit botëror. Dëbimi i Hrushovit shprehu qartë dështimin e tërë vijës së tij tradhtare, të metodave dhe reformave të tij, dështimin për t'u imponuar popullit sovjetik dhe lëvizjes komuniste ndërkombëtare revizionizmin hrushovian.

Njerëzit që zëvendësuan Hrushovin dhe që janë shokët e bashkëpunëtorët e tij më të ngushtë, pas heqjes së tij, bënë shumë manovra për të riparuar të çarat e rënda që ai i kishte shkaktuar vijës së tyre. Por derisa mbetën themelet e shtrembra, ndërtesa nuk mund të ngruhej e drejtë. Duke eliminuar teprimet, rrëmbimet dhe sharlatanizmat e Hrushovit, ata nuk shkuan më tej nga një korrigjim i thjeshtë i një stilë, i cili mund të ketë ndonjë farë rëndësie për individin, por që s'ka asnjë rëndësi për vijën që ai përfaqëson. Mbeti vija oportuniste, tradhtare, antimarksiste e kongreseve të 20-të e të 22-të dhe e programit të PK të BS, mbetën vështirësitë e kontradiktat politike e ekonomike, mbetën disfatat e rënda të vijës hrushoviane. Bile heqja e Hrushovit i nxori ato më në pah, i thelloi ato edhe më tepër. Pyetjeve të shumta që dolën pas dëbimit të tij, nuk iu dha kurri ndonjë përgjigje nga udhëheqësit e rinj. Ata u munduan, me anë të disa fjalëve të përgjithshme e sofizmash të zakonshme, të mbyllnin gojët e njerëzve, por rezultatet qenë të vajtueshme. Problemet themelore të jetës së sotme politike e ekonomike që kanë preokupuar këta dhjetë vjetët e fundit shoqërinë sovjetike, mbetën pa u zgjidhur.

Tani Brezhnjevi, Kosigini, Mikojani, Susllovi etj. kanë thirrur Kongresin e 23-të të Partisë. Por si do t'uа shpjegojnë ata anëtarëve të partisë së tyre, popullit sovjetik, komunistëve dhe njerëzve përparimtarë të botës qëndrimin thellësisht armiqësor ndaj çështjes së Stalinit, si do ta shpjegojnë heqjen e Hrushovit ose afrimin e bashkëpunimin me imperializmin amerikan, politikën shoviniste ndaj vendeve socialiste, sulmet thellësisht

armiqësore ndaj PPSH dhe RPSH, si dhe ndërhyrjet përqarëse në partitë komuniste? Çfarë do të thonë ata për numërimin në vend të ekonomisë sovjetike dhe rënien e bujqësisë, për minimin e virtheteve socialiste dhe për degjenerimin borgjez të shoqërisë sovjetike? Sigurisht, ashtu si kanë bërë edhe herë të tjera, edhe në këtë kongres ata mund të kombinojnë disa «shifra e fakte» që «të vërtetojnë» «sukseset» e tyre, por çështjet që përmendëm më lart janë nga ato probleme që nuk mund të kapërcehen. Demagogjia në asnje rast nuk mund të ketë sukses, po, kur ajo përbën metodën themelore të punës dhe të sjelljes, siç po ndodh tani me udhëheqësit e rinj sovjetikë, kthehet në një armë vdekjeprurëse kundër vetë atyre që e përdorin. Mjafton t'u hedhësh një sy gjendjes së tanishme në Bashkimin Sovjetik, tendencave të politikës së brendshme dhe të jashtme të udhëheqësve të tij, për të parë qartë krizën e rëndë që po kalon vija revizioniste hrushoviane.

Çështja e Stalinit nuk mund të zgjidhet nga revizionistët hrushovianë

Çështja e Stalinit u ka mbetur revizionistëve hrushovianë si një kockë e fortë në grykë. Ata i janë kthyer e rikthyer kësaj çështjeje sepse kanë hasur në një mos-aprovim e rezistencë gjithnjë më të vendosur nga komunistët dhe populli sovjetik, si dhe nga punonjësit e revolucionarët në vendet e tjera. Njerëzit sovjetikë asnjëherë nuk kanë qenë të bindur për sulmet e tërbuara dhe akuzat e ulëta e false kundër Stalinit. Për më

tat revizioniste? Një gjë e tillë nuk mund të ndodhë kurrë, sepse të rehabilitosh Stalinin, të korrigohet, në kuptimin e plotë të fjalës, qëndrimi ndaj Stalinit, do të thotë të mohohet revizionizmi, të likuidohet tradhtia hrushoviane. Udhëheqësit e sotëm të Bashkimit Sovjetik janë autorët e sulmit kundër Stalinit, kundër revolucionit, kundër komunizmit. Ata me sulmin kundër Stalinit, filluan rrugën e tradhtisë së hapur, me sulmin kundër Stalinit filluan veprën e diversionit kundër Bashkimit Sovjetik dhe lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Prandaj të mendosh për një çast se hrushovianët vetë muqë të rehabilitojnë Stalinin, është njëlloj sikur të pranosh se ata do t'i varin vullnetarisht vetes litarin në qafë, sepse me këtë ata do të likuidonin gjithë bazën e kështjellës së tyre, do të hidhnin në erë gjithë vijen e kongreseve të 20-të e të 22-të, të cilat në themel të tyre kanë antistalinizmin.

Reabilitimi i J. V. Stalinit do të bëhet patjetër, por jo nga revizionistët. Ai do të bëhet nga marksistë-leninistët revolucionarë, nga bolshevikët e vërtetë, nga populli heroik sovjetik, duke përmbysur klikën revizioniste e tradhtare që sot sundon në Bashkimin Sovjetik.

Me ose pa Hrushovin, hrushovianët mbeten tradhtarë të komunizmit

Një nga problemet e mprehta, të cilit udhëheqësit sovjetikë nuk po dinë t'i japid rrugë, është edhe vetë çështja e Hrushovit, domethënë arsyetimi dhe justifikimi i grushtit të shtetit që i bënë atij ish-nxënësit dhe bash-

këpunëtorët e tij më të ngushtë. Deri tanë, në fjalimet e tyre dhe në shtyp, ata dënojnë vazhdimisht «subjektivizmin», «bombasticitetin», «ngutjen në shqyrtimin e çështjeve të rëndësishme», «largimin nga mbështetja shkencore» etj., por asnëherë nuk i lidhin këto «mall-kime» me emrin e Hrushovit, megjithëse të gjithë e kuptojnë se i adresohen atij. Mundet që në kongres të thonë edhe ndonjë fjalë kundër tij, por askush nuk mund të presë që ata të shkojnë më tej dënimëve të përgjithshme dhe të parëndësishme. Në rast se do të thoshin të vërtetën, atyre do t'u duhej të zbulonin komplotet e mëdha që ata, së bashku me Hrushovin, kanë bërë kundër partisë dhe popullit sovjetik, do t'u duhej të zbulonin prapaskenat, intrigat dhe metodat puçiste në ndërrimin e rojeve në krye të udhëheqjes së partisë e të shtetit. Trajtimi gjerësisht i çështjes së heqjes së Hrushovit, do të conte në burimet e hrushovizmit, do të conte në zbulimin e asaj që ata e fshehin me kujdes, se atë e hoqën pasi ai falimentoi si në politikën e jashtme ashtu edhe në atë të brendshme. Por e gjithë kjo është një situatë mjaft qesharake. Nga njëra anë mbrojnë kongreset e 20-të dhe të 22-të, tërë vijën revizioniste të Hrushovit, nga ana tjetër e kritikojnë ideatorin dhe fryshtuesin e tyre për «subjektivizëm», «mosnjohje të realitetit», «konkluzione të papjekura» etj. Se kush ka qenë Hrushovi dhe ç'punë të ndyra ka bërë, kjo dihet tanimë mirë nga të gjithë. Por në qoftë se ai ka qenë i tillë, siç thonë tanë zëvendësit e tij, a nuk janë reflektuar ato, sadopak, edhe në vendimet e kongresit të 20-të, të 21-të e të 22-të, në programin e partisë dhe në vendime të tjera të rëndësishme, të cilave ata u

qëndrojnë besnikë? Deri sot nuk kemi dëgjuar që pasardhësit e tij të kenë bërë qoftë edhe korrigjimin më të vogël në këto dokumente, përveç betimeve të besnikërisë deri në fund dhe sigurimeve se ata janë të vendosur t'i zbatojnë me këmbëngulje në çdo kohë dhe në të gjitha rrethanat.

Komunistët dhe populli sovjetik nuk mund të mos shohin pozitën e vështirë në të cilën e ka vënë veten udhëheqja sovjetike në përpjekjet e saj të dëshpëruara për të fshehur blofin e madh në lojën e heqjes së Hrushovit. Me ose pa Hrushovin, hrushovizmi mbetet gjithnjë hrushovizëm. Taktikat mashtruese, hipokrizitë dhe lojnat e fjalëve nuk e ndryshojnë aspak situatën. Është vija revizioniste ajo që ka dështuar, janë mbrojtësit e saj ata që kanë falimentuar. Këtë të vërtetë e kuptojnë mirë të gjithë anëtarët e Partisë Komuniste dhe qytetarët sovjetikë. Me manipulimet që mund të bëjnë në kongres udhëheqësit e tyre rreth kësaj çështjeje, jo vetëm që nuk do të bindin dot njeri, por ata do ta demaskojnë edhe më tepër veten, do të dalin edhe një herë tjetër botërisht si përçues kokëfortë të vijës tradhtare, oportuniste, antimarksiste hrushoviane.

Duke ndjekur eksperiencën titiste, udhëheqësit revizionistë sovjetikë krijuan kushtet për rivendosjen e kapitalizmit

Në qoftë se do të bëhej bilanci i aktivitetit të udhëheqësve të rinj që nga rënia e Hrushovit e deri më sot, do të vihej re fare lehtë se pasardhësit e tij ka-

në shkuan shumë më tej në rrugën revisioniste, se ata i kanë sjellë dëme të reja, edhe më të mëdha, popullit sovjetik, kanë zgjeruar edhe më shumë sulmet kundër vendeve socialiste dhe aktivitetin përçarës në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, janë afruar dhe kanë shtuar më shumë bashkëpunimin me imperializmin amerikan dhe me reaksionarët e ndryshëm.

Reformat e reja ekonomike që po vihen tanë në zbatim në Bashkimin Sovjetik çojnë drejt vendosjes së formave të marrëdhënieve kapitaliste në prodhim. Duke adoptuar eksperiencën e klikës së Titos në administrimin dhe drejtimin e ekonomisë, udhëheqësit revisionistë krijuan të gjitha premisat e kushtet për rivendosjen e kapitalizmit. Me gjithë propagandën e madhe që revisionistët hrushovianë kanë bërë për të bindur opinionin publik se «reformat» e reja janë zbatimi në praktikë i «fjalës së fundit» të shkencës ekonomike të socializmit, se ato shënojnë një «kthim» te Lenini, se ato «pasqyrojnë» realitetin objektiv dhe tendencat e zhvillimit të shqërisë së sotme sovjetike, një mosbesim i dukshëm, rezistencë dhe skepticizëm vihen re kudo në Bashkimin Sovjetik. Kjo gjendje shpirtërore e masave punonjëse detyroi edhe vetë Kosiginin, Brezhnjevin e të tjerë që, në plenumet dhe në fjalimet e tyre të kohëve të fundit, të pranojnë botërisht se niveli i të ardhurave kombëtare ka rënë, se rritja e rendimentit nuk po bën asnje hap përpara, se ritmet e shtimit të prodhimit industrial janë zvogëluar nga viti në vit, se cilësia e mallrave vazhdon të jetë e dobët etj. Për sa i përket gjendjes së bujqësisë, ajo po kalon tanë krizën më të rëndë. Nga eksportues, Bashkimi Sovjetik është shndërruar në im-

portuesin më të madh të drithërave në botë, buka e përditshme e njerëzve sovjetikë varet tanj nga kapriçiot e tregtarëve amerikanë ose kanadezë të grurit.

Njerëzit sovjetikë nuk mund të mos e shohin se masat e reja që kanë ndërmarrë udhëheqësit hrušovianë, janë vazhdim e thellim i mëtejshëm i reformave shkatërrimtare të Hrušovit, të cilat e çuan ekonominë sovjetike në këtë gjendje amullie e rënjeje të vazhdueshme. Ata nuk mund të mos shohin në reformat e udhëheqjes së re sovjetike zbatimin në Bashkimin Sovjetik të eksperiencës së klikës titiste.

Kush ka studiuar me vëmendje esencën e reformave të fundit të zbatuara në ekonominë sovjetike, ai me siguri ka konstatuar se ato ngjajnë si dy pikë uji me reformat ekonomike titiste, se rruga e zhvillimit të ardhshëm në Jugosllavi dhe pasojat që po rrjedhin atje nga zbatimi i vendimeve të Kongresit të 8-të të LKJ dhe të reformës ekonomike titiste, paralajmërojnë edhe zhvillimin e ardhshëm dhe degjenerimin e plotë në të cilin po e futin Bashkimin Sovjetik udhëheqësit e tij tradhtarë revizionistë. Për sa u përket problemeve të perspektivës së zhvillimit të Bashkimit Sovjetik, Kongresi i 23-të i PK të BS do të jetë një kopje e kongresit të 8-të të titistëve. Çfarë rezultoi nga kongresi i titistëve, ç'rrugë e ç'perspektiva hapi ai përpara popujve jugosllavë?

Dihet tanimë se Jugosllavia është vënë plotësisht nën kontrollin politik e ekonomik të imperialistëve dhe të borgjezisë reaksionare, të përfaqësuar nga klika titiste. Në vend është krijuar një gjendje e rëndë, gjë që në plenumin e fundit të titistëve u shpreh fare qar-

të. Ekonomia jugosllave po kalon vështirësi të mëdha: ndërmarrje po falimentojnë, të tjera, për të shpëtuar nga falimentimi, me udhëzim të klikës titiste, po u nënshtronen kapitaleve të huaja, papunësia po rritet dhe niveli i jetesës së punonjësve ulet vazhdimesht. Si rrjedhim i politikës borgjeze kapitaliste që ndjek klika titiste, po nxjerrin kokën me forcë nacionalizmi dhe shovinizmi i shfrenuar. Vetë Titoja, Rankoviçi, Kardeli e të tjerë krerë të titizmit lëshuan alarmin. Përse? Natyrisht, ata shqetësohen sepse e pësuan si ai magjistari që lëshoi xhindet dhe nuk i mblidhte dot më për t'i pasur nën kontroll. Por titistët shqetësohen edhe nga fakti se, duke e ditur që Jugosllavia është pasqyrë përgjithë revizionistët e tjerë, shfaqja e këtyre fenomeneve në një mënyrë kaq të acaruar mund të prishë punë në Bashkimin Sovjetik e në vende të tjera, ku po zbatohet me zell eksperienca titiste dhe ku po nxjerrin kokën të njëjtat shëmtime, karakteristike të shoqërisë borgjeze, kapitaliste.

Në të vërtetë, veç rrjedhimeve shkatërrimtare që po sjellin në ekonominë sovjetike reformat e hrushovianëve, ashtu si edhe në Jugosllavi, edhe në Bashkimin Sovjetik ka filluar të futë hundët kapitali i huaj. Kapitali monopolist i vendeve kryesore imperialiste, që dikur, në kohën e Revolucionit të Tetorit, u përpoq të siguronte ndërhyrjen e tij në tregun rus me ndihmën e intervencionit të armatosur, por që para qëndresës heroike të bolshevikëve dështoi me turp, tani, me përkrahjen e hrushovianëve, në rrugë paqësore, legalisht, po futet gjithnjë e më shumë në Bashkimin Sovjetik. Ekonomia sovjetike, pavarësisht se është ekonomi e një

vendi të madh, dalngadalë po futet në kthetrat e kapitalit monopolist të SHBA-së, të Francës, të Anglisë, të Japonisë etj. Dihet se monopoleve perëndimore thirrjen për të investuar kapitalet e tyre në Bashkimin Sovjetik ua bëri N. Hrushovi. Pasardhësit e tij filluan menjëherë ta vënë atë në zbatim: në fillim pa zhurmë, në-përmjet marrëveshjeve të fshehta, kurse tanë më hapur dhe duke i bërë jehonë edhe me anë të shtypit. Kështu, kohët e fundit po zhvillohen bisedime midis Bashkimit Sovjetik e Japonisë lidhur me investimet e kapitalit japonez në Siberi. Vetë agjencia sovjetike e lajmeve TASS njofton se po diskutohet çështja e pjesëmarrjes së Japonisë në eksplorimin e Siberisë, veçanërisht bashkëpunimi në industrinë e gazit, të naftës dhe të përpunimit të drurit. TASS-i thekson se «shfrytëzimi i gazit të Siberisë do të ndihmojë në shkallë të gjerë në zhvillimin e rajoneve industriale japoneze në bregun e detit të Japonisë» dhe se «Siberia është një treg i madh përshtjen e makinerive japoneze» etj., etj. Pra, kapitalit japonez i hapen me të vërtetë perspektiva të rëndësishme, jo vetëm ekonomike, por në radhë të parë politike. Në fakt, duke hyrë në marrëveshje me imperializmin japonez dhe duke e tërhequr atë në tregun siberian, hrushovianët inkurajojnë hapur tendencat agresive e ekspansioniste të militarizmit japonez.

Duke inkurajuar vërshimin e kapitaleve të huaja në ekonominë sovjetike, udhëheqësit revisionistë sovjetikë shpresojnë se do të rregullojnë disi bilancet e tyre, sidomos për sa i përket tregtisë së jashtme, dhe se do të kapërcejnë vështirësitë e mëdha ekonomike në të cilat e kanë futur Bashkimin Sovjetik. Por historia ka pro-

vuar dhe eksperimenti jugosllav flet qartë, se një rrugë e tillë do të sjellë me vete vështirësi akoma më serioze dhe rrjedhime katastrofike për popujt dhe për fatet e revolucionit në Bashkimin Sovjetik.

Politika tradhtare e revisionistëve hrushovianë për rivendosjen e kapitalizmit në Bashkimin Sovjetik duket edhe në lindjen e disa fenomeneve të shëmtuara në mënyrën e jetesës, të kulturës dhe të problemit nacional. Para disa ditësh, në një artikull të saj, revista «Komunist» e Moskës ankohej se disa shkrimtarë janë larguar nga traditat e mira të letërsisë sovjetike dhe nga parimet e realizmit socialist. Sikur e keqja të ishte te disa shkrimtarë, kjo mund të rregullohej lehtë. Por këta shkrimtarë nuk dolën rastësisht. Ata lindën si kërpudhat pas shiut në atmosferën e përgjithshme të frymës liberale, dekadente, që ka pushtuar tani jetën let rare e artistike të Bashkimit Sovjetik, si rezultat i politikës antisocialiste e antimarksiste të udhëheqjes revisioniste në fushën e kulturës. Përderisa dyert e Bashkimit Sovjetik u janë hapur të gjitha rrymave borgjeze të artit perëndimor, përderisa librat, filmat, ekspozitat e të tjera mallra të kulturës shpirtërore të imperializmit po mbulojnë vendin, çfarë mund të pritet më tepër? «Shkëmbimet kulturore» me vendet perëndimore kanë nxitur imitimin e mënyrës amerikane të jetesës, degjenerimin e rinisë dhe shtimin e korrupcionit. Rubrikat sensacionale për vjedhjet, grabitjet, mashtrimet, spekulimet etj., po mbushin tanigjithnjë e më shumë gazetat sovjetike. Kush është fajtor për këtë? Udhëheqësit sovjetikë mund të dërgojnë në gjyq ndonjë armik të hapët të popullit sovjetik të tipit Sinjavski ose Daniel, të cilët

shpifin e shajnë hapur historinë dhe luftën heroike të popullit, por sa të tjerë armiq të fshehur, ndër të cilët edhe vetë ata që qëndrojnë në krye të partisë e të shtetit, e shajnë dhe e fyejnë popullin sovjetik, mohojnë dhe tallen me traditat e tij të lavdishme revolucionare? Ata mund të dënojnë për propagandë antikomuniste e shpifje kundër Bashkimit Sovjetik dy shkrimtarë ekstremistë, por ky është një blof i madh, sepse fajtorët kryesorë janë vetë udhëheqësit e sotëm sovjetikë, të cilët, me sulmet dhe shpifjet e tyre të shfrenuara kundër Stalinit e veprës së tij, kundër rendit sovjetik dhe socializmit, me tërë vijën e tyre oportuniste e tradhtare, nxitën tendencat antisovjetike dhe i hapën rrugën për të dalë në sipërfaqe këtij llumi të ndyrë të shoqërisë sovjetike. Prandaj, në qoftë se është fjala për të gjykuar fajtorët, në gjyq duhet të dalin, në radhë të parë, udhëheqësit revizionistë hrushovianë, si tradhtarë të betuar të popullit të madh sovjetik dhe të atdheut të Leninit e të Stalinit. Dhe ne jemi të bindur se dita e këtij gjyqi të madh të revolucionit nuk do të jetë e largët.

Qysh në kohën e N. Hrushovit në Bashkimin Sovjetik u dukën shenjat e shfaqjeve nacionaliste e shoviniste. Në fillim ato shpërthyen në formën e antisemitizmit. Por më vonë, dhe veçanërisht kohët e fundit, ky nacionalizëm e shovinizëm po acarohet midis ukrainasve e rusëve, midis gjeorgjianëve e armenëve etj., etj., ashtu si në Jugosllavi që po shfaqet midis serbëve e kroatëve etj. «Ç'të mbjellësh, do të korrësh», thotë një fjalë e urtë e popullit. Duke hequr dorë nga viaja marksiste-leniniste dhe duke vënë në bazë të veprimtarisë së saj vijën tradhtare revizioniste, udhëheqja hrusho-

viane nuk mund të mos hapte këto plagë të vjetra të shëmtuara, karakteristike të zhvillimit kapitalist. Prandaj edhe në organet udhëheqëse të Bashkimit Sovjetik mund të ndodhë ajo që ndodhi në plenumin e fundit titist, që vetë udhëheqës revizionistë të nacionaliteteve të ndryshme të zhveshin shpatën e shovinizmit e të nacionalizmit si zëdhënës të borgjezisë së tyre nationale.

Udhëheqësit revizionistë sovjetikë kanë hapur fjalën se mund të lejojnë ribotimin e librit të njohur të J. Stalinit «Mbi çështjen nationale». Natyrisht, kjo bën pjesë në përpjekjet e përgjithshme të hrushovianëve për të krijuar përshtypjen e qëndrimit gjoja objektiv ndaj Stalinit. Por mund të ketë edhe një arsy e tjetër: hrushovianët, duke parashikuar rrezikun e ardhshëm të acarimit të problemit nacional, kërkojnë të shfrytëzojnë mësimet marksiste-leniniste të Stalinit për të evitar katastrofën. Por jo vetëm në çështjen nationale, por edhe për çdo problem tjetër teoria marksiste-leniniste nuk mund të zbatohet duke ruajtur bazën revizioniste. Vetëm marksistë-leninistët dhe revolucionarët e vërtetë sovjetikë, të mbështetur në mësimet e Leninit e të Stalinit, pasi të përbysin udhëheqësit revizionistë hrushovianë, mund ta sjellin Bashkimin Sovjetik në rrugën e drejtë të socializmit e të komunizmit.

Brezhnjevi, Kosigini, Susllovi, Mikojani e shokët e tyre janë shkaktarët e vështirësive të mëdha ekonomike e politike në të cilat po kalon populli sovjetik. Ata duhet të përgjigjen për tradhtinë e tyre para partisë e popullit sovjetik. Por asnjë nuk pret që në kongresin e tanishëm udhëheqësit revizionistë hrushovianë të pranojnë hapur përgjegjësitetë e tyre. Kjo do të thoshte të

nënshkruanin vëtë aktin e kapitullimit dhe të falimentimit të vijës revizioniste që kanë zbatuar. S'ka asnje dyshim se, si zakonisht, edhe kësaj radhe, ata do të mundohen t'i shmangen përgjegjësisë së tyre duke akuzuar Stalinin, ndoshta me ndonjë fjalë edhe Hrushovin, që në kohën e tyre nuk kanë marrë këto «masa efektive» që po merren tani. Por kjo është një taktkë shumë e vjetruar, së cilës i ka dalë krejtësisht boja. Dështimet në lëmin ekonomik, në industri, bujqësi, në lëmin kulturor e politik, në çështjen nationale etj., prekin drejtpërsëdrejti çdo qytetar, ato ndihen shpejt e rëndë nga i gjithë populli dhe nuk mund të fshihen dot me manovra demagogjike. Nuk mund t'i drejtohesh me qortime gjithnjë së kaluarës për të sotmen, aq më tepër kur kushdo e shikon qartë se i vetmi preokupim i udhëheqësve të tanishëm sovjetikë është formimi dhe konsolidimi i shtresës së privilegjuar, i borgjezisë së re, që përbën bazën e regjimit revizionist, forcën kryesore që frymëzon dhe përkrah politikën tradhtare, kapitulluese, antimarksiste që ndjekin pasardhësit e Hrushovit.

Udhëheqësit revizionistë hrushovianë shkojnë në kongresin e tyre si lakenj të politikës agresive të imperializmit amerikan

Në vigjiljen e Kongresit të 23-të, udhëheqësit hrushovianë e ndiejnë veten shumë të shqetësuar, sepse ata e shohin se gjithnjë e më shumë po thellohen kontradiktat e tyre me komunistët e popullin sovjetik dhe me komunistët e popujt e gjithë botës, të cilët

po zgjohen e po kuptojnë tradhtinë e madhe të udhëheqësve revizionistë sovjetikë. Dhe pasardhësit e Hrushovit e dinë mirë se në momente të tilla, kur njërit reflektojnë për tradhtinë e revizionistëve, në rend të ditës si probleme kyçë dalin çështja e qëndrimit ndaj J. V. Stalinit, çështja e qëndrimit ndaj imperializmit, ndaj vendeve socialiste dhe lëvizjes komuniste ndër-kombëtare. Prandaj, me shpresë se do të mashtrojnë naivët, udhëheqësit sovjetikë mundohen t'i dalin punës përpara, duke u hequr sikur duan të rektifikojnë diçka nga vija e mëparshme, t'i heqin asaj teprimet ose metodat brutale të Hrushovit. Me këtë manovër të re demagogjike udhëheqësit hrushovianë mendojnë të fitojnë kohë, sidomos sa të kalojë edhe Kongresi i 23-të.

Manovra hrushoviane për gjoja rektifikime është tanimë një metodë e njojur dhe pjesë përbërëse e takтикës së përgjithshme të udhëheqësve të sotëm sovjetikë për të vazhduar vijën tradhtare hrushoviane, vijën famëkeqe të kongreseve të 20-të e të 22-të, duke përdorur një demagogji më të rafinuar. Kjo duket jo vetëm në fushën e brendshme, por edhe në atë ndër-kombëtare. Ata po përpilen të krijojnë përshtypjen se diçka kanë korrigjuar e po korrigojnë edhe në politikën e jashtme, duke dalë me parullat e «antiimperializmit», të «unititetit të veprimeve» dhe të «përkrahjes së luftës së popujve». Por tanimë të gjitha këto parulla false dhe gjithë kjo taktkë dinake janë demaskuar keq, sepse popujt nuk gjykojnë nga fjalët, por nga veprat. Dhe veprat e udhëheqësve të sotëm sovjetikë janë një aktakuzë e rëndë, ato zbulojnë fytyrën e tyre të vërtetë tradhtare, tregojnë se ata jo vetëm nuk kanë korrigjuar asgjë nga vija e

Hrushovit, por po ecin me vendosmëri në këtë rrugë e po futen gjithnjë e më thellë në moçalin e tradhtisë.

Janë pikërisht udhëheqësit e sotëm sovjetikë ata që kanë thelluar e zhvilluar më tej bashkëpunimin e gjithanshëm sovjeto-amerikan, duke tradhtuar për hir të tij interesat jetike të popujve, janë ata që po përpinqen me çdo mjet të nënshtronjë popullin heroik vietnamez dhe të shpëtojnë imperializmin amerikan nga disfata në Vietnam, duke hyrë në gjithfarë pazarllëqesh të ndyra në kurrit të popullit vietnamez; janë ata që kanë lidhur një «aleancë të shenjtë» me imperializmin japonez dhe forcat e tjera reaksionare; janë ata që po përpinqen me çdo mënyrë të arrijnë një marrëveshje të re me imperialistët amerikanë për të ashtuquajturën mos-përhapje të armëve bërthamore, si mjet për të siguruar monopolin e shantazhit bërthamor sovjeto-amerikan kundër vendeve të tjera; janë ata që e kanë lënë të qetë imperializmin në Evropë duke ndjekur politikën e «pajtimit» e të ruajtjes së statukuosë në këtë zonë dhe duke i zgjidhur duart imperializmit amerikan për të zgjeruar agresionin në Lindje. Udhëheqësit e rinj sovjetikë jo vetëm s'kanë bërë asnjë hap pozitiv për të korrigjuar gabimet fatale të së kaluarës, por e kanë thelluar akoma më tej përçarjen në lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

Nga atrimi me imperialistët, ku i la Hrushovi, udhëheqësit e rinj kaluan në bashkëpunimin e hapët me ta, në koordinimin e qëndrimeve, në veprimet e përbashkëta politike, të cilat janë mishëruar në marrëveshjet dhe komplotet konkrete për vendosjen e sundimit të dy fuqive të mëdha në botë. Ata u bënë aleatë aktivë

të SHBA-së dhe i ndihmojnë ato në zbatimin e strategjisë globale.

Udhëheqësit sovjetikë, në bashkëpunim të ngushtë edhe me imperializmin amerikan, minojnë e sabotojnë lëvizjet çlirimtare antiimperialiste të popuje. Një shembull nga më të shëmtuarit janë përpjekjet e tyre për krijimin e forcave të armatosura të OKB-së, të cilat nuk do të jenë gjë tjetër veçse një xhandarmëri ndërkombëtare në shërbim të politikës hegemoniste të dy superfuqive. Revisionistët hrushovianë nuk kanë lënë gjë pa shpifur kundër revolucionit në Indonezi dhe, me qëndrimin e tyre armiqësor e denigrues kundër Partisë Komuniste Indoneziane, kanë inkurajuar dhe nxitur forcat e djathta reaksionare. Ata bëjnë gjithçka për të futur pyka dhe për të mbjellë përçarje në radhët e forcave antiimperialiste të Azisë, Afrikës e Amerikës Latine dhe për t'i larguar ato nga lufta kundër imperializmit e kolonializmit.

Vija kapitulluese e tradhtisë së interesave të popujve të tjerë dhe e bashkëpunimit me imperializmin duket akoma më qartë në qëndrimin që udhëheqësit revisionistë sovjetikë mbajnë ndaj luftës së popullit vietnamez kundër agresionit amerikan. Ata bëjnë çmos duke përdorur presionet e hapëta dhe të fshehta, demagogjinë e shfrenuar dhe manovrat diplomatike më të stërholluara për ta detyruar popullin vietnamez që të heqë dorë nga lufta e tij e shenjtë dhe të pranojë «paqen» amerikane. Sa për sy e faqe ata hiqen si miq të popullit të Vietnamit, por, nga ana tjetër, përkrahin «ofensivën e pages» të imperializmit. Qëllimi i tyre është të futin një këmbë në Vietnam dhe çështjen e tij ta zgjihu-

dhin pastaj në kuadrin e bashkëpunimit sovjeto-amerikan. Por lufta e popullit të Vietnamit ua ka djegur të gjitha planet e tyre djallëzore. Ajo i ka dhënë goditje të tmerrshme jo vetëm politikës agresive të imperializmit amerikan, por ka demaskuar rëndë edhe lojën me dy faqe të revisionistëve hrušovianë, qëndrimin e tyre kapitullues, politikën e sabotimit të luftërave çlirimtare dhe të braktisjes së interesave të popujve të tjerë. Zjarri i luftës së Vietnamit i bëri hi e pluhur fjalët boshe të revisionistëve sovjetikë mbi internacionalizmin proletar, mbi përkrahjen dhe mbrojtjen e vendeve socialistë, mbi ndihmën ndaj popujve që luftojnë kundër imperializmit etj. Kjo luftë tregoi se ata ndjekin vetëm një politikë, politikën shoviniste të kombit të madh, të nacionalizmit borgjez, politikën e ndarjes së zonave të influencës me imperialistët dhe të ndërhyrjes në punët e brendshme të popujve.

Revisionistët hrušovianë — përçarës dhe armiq të lëvizjes komuniste ndërkombëtare

Mjaft qartë duket kjo vijë edhe në qëndrimet që udhëheqja revisioniste mban ndaj lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Ajo mundohet të realizojë të njëjtat synime të Hrušovit, por me taktika e metoda më të rafinuara. Me iniciativën dhe nën parullat e tyre u organizua mbledhja përçarëse e marsit të vitit të kaluar në Moskë, u mblodhën disa parti komuniste të Amerikës Latine në Havani, u zhvilluan konsultime me partitë komuniste të Evropës ku sundojnë revisionistë moder-

në etj. Sot revizionistët hrushovianë janë bërë përçarësit më të mëdhenj edhe të organizatave demokratike ndërkombe të. Duke kërkuar t'u imponojnë atyre me çdo kusht vijën e «bashkekzistencës paqësore» hrušoviane të heqjes dorë nga lufta antiimperialiste dhe të kthimit në një bisht të politikës së bashkëpunimit sovjeto-amerikan, ata u kanë sjellë atyre një dëm të madh dhe kanë komprometuar rëndë qëllimet për të cilat ato janë krijuar.

Me një ritëm akoma më të madh udhëheqësit sovjetikë vazhdojnë subversionin e korrupzionin në udhëheqjet revizioniste të partive komuniste e punëtore dhe bëjnë një luftë të madhe denigruese kundër marksistë-leninistëve. Ata kanë arritur deri atje sa edhe organizata të tilla, si KNER-i ose Traktati i Varshavës, të cilat ishin krijuar për të mbrojtur vendet socialiste dhe për të ndihmuar zhvillimin e tyre drejt socialistit, t'i përdorin si mjet presioni ndaj anëtarëve të tjerë, si armë për zbatimin e politikës shoviniste të ndërhyrjes e të nënshtimit.

Udhëheqësit e sotëm sovjetikë janë ata, që bashkë me N. Hrushovin, organizuan shpifjet më të përbindshme kundër PPSH në Kongresin e 22-të të PK të BS, janë ata që vendosën bllokadën ekonomike kundër vendit tonë dhe që prenë edhe marrëdhëniet diplomatike me RP të Shqipërisë. Ata organizuan dhe vazhdojnë në forma të ndryshme fushatën antishqiptare duke mobilizuar në këtë drejtim edhe gjithë pasuesit e tyre revizionistë. Ata akuzuan udhëheqjen e Partisë dhe të shtetit tonë si agjenturë të imperializmit. Dhe, megjithëkëtë, udhëheqësit e sotëm sovjetikë, me patur-

pësinë më të madhe, bëjnë sikur nuk ka ndodhur asgjë, sikur PK e BS dhe qeveria sovjetike kurdoherë kanë qenë korrekte ndaj PPSH e RPSH. Këtu gjen shprehje pikëpamja e tyre antimarksiste e shovinizmit të shtetit të madh, sipas së cilës revisionistët hrušovianë mund të bëjnë si të duan, kurse të tjerët, sidomos vendet e vogla, duhet të presin mëshirën e tyre.

Duke u nisur nga koncepte të tilla, udhëheqja hrušoviane sovjetike, para disa ditësh, pati patur pësinë të ftojë edhe partinë tonë që të dërgojë një delegacion të sajin në Kongresin e 23-të. Por Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë, me plot të drejtë, me përbuzje, refuzoi të pranojë edhe vettë shkresën që përmbante këtë ftesë, sepse tanimë midis PPSH e udhëheqjes revisioniste tradhtare sovjetike nuk ekziston asnjë lidhje as në rrugë partie, as në rrugë shtetërore. PPSH as ka pasur, as ka ndër mend të vendosë lidhje me tradhtarët e komunizmit, me renegatët e marksizëm-léninizmit. Ky qëndrim parimor i PPSH është drejtar kundër tradhtarëve revisionistë sovjetikë. Ndërsa ndaj komunistëve revolucionarë sovjetikë dhe popujve sovjetikë Partia e Punës dhe populli shqiptar ushqejnë një dashuri të singertë, të cilën as kanë mundur as do të mundin kurrë ta cenojnë udhëheqësit hrušovianë. Populli shqiptar dhe Partia e tij e Punës kanë qenë, janë dhe do të janë kurdoherë miq besnikë dhe përkrah popujve dhe revolucionarëve sovjetikë, si në ditë të mira ashtu edhe në ditë të vështira.

Për sa i përket Kongresit të 23-të të revisionistëve sovjetikë, ai për Partinë tonë është një kongres ku-

fomash politike, një kongres i përgatitur dhe i montuar fund e krye nga tradhtarët revizionistë, ku nuk ka e nuk mund të ketë vend për marksistë-leninistët e vërtetë. Pjesëmarrja në këtë kongres është përkrahje për tradhtarët, është tallje me revolucionarët konsekuentë sovjetikë. Kongresi që do të mbajnë revizionistët sovjetikë, është një mbledhje renegatësh, ku do të thuren plane të reja për të goditur marksizëm-leninizmin dhe interesat e socializmit. Udhëheqësit sovjetikë le të kënaqen me lakenjtë e tyre, me përfaqësuesit revizionistë të disa partive, që gjithnjë kanë qenë bisht i tyre. Le të përpunojnë bashkërisht planet e veta antimarksiste dhe le të marrin kështu përgjegjësi përrapa gjithë lëvizjes komuniste për tradhtinë e përbashkët.

Vargu i veprimeve tradhtare, antimarksiste e antisocialiste i udhëheqësve sovjetikë, ashtu si edhe ai i dështimeve dhe i vështirësive të tyre të pakapërcyeshme, është shumë i gjatë. Për marksistë-leninistët është e qartë se sa më shumë kalon koha, aq më shumë udhëheqja sovjetike futet në llumin e tradhtisë e të antimarksizmit.

Veprimet e udhëheqësve tradhtarë hrushovianë, gjithë politika që ata kanë ndjekur deri tani tregojnë se në kongres ata do të kërkojnë të sanksionojnë hrushovizmin, por pa Hrushovin. Ata do të mundohen të marrin një vërtetim, qoftë edhe formal, në emër të një kongresi partie, për të ecur në vijën që e përpunuuan së bashku me Hrushovin, për të ecur më tej në procesin e degjenerimit kapitalist të rendit shoqëror në Bashkimin Sovjetik, në rrugën e përçarjes së lëvizjes komuniste

botërore, për ta shtuar e për ta thelluar bashkëpunimin me imperializmin amerikan në emër të sundimit të botës nga dy fuqitë e mëdha.

Por sido që të përpilen, çfarëdo taktikash e demagogjish që të përdorin, udhëheqësit tradhtarë sovjetikë nuk kanë për t'ia arritur kurrë qëllimit të tyre. Marksistë-leninistët dhe revolucionarët kudo në botë po shtojnë luftën e tyre kundër tradhtisë revizioniste. Ngado po krijohen parti e grupe të reja antirevizioniste, të cilat po konsolidohen si nga pikëpamja organizative ashtu edhe në luftë për mbrojtjen e pozitave të marksizëm-leninizmit. Qysh tani këto parti e grupe, të cilat janë organizuar edhe në vende ku sundojnë revisionistët, përbëjnë një rrezik serioz për të ardhmen e hrushovianëve. Udhëheqësit revisionistë gjenden në vështirësi edhe brenda Bashkimit Sovjetik. Komunistët sovjetikë, populli sovjetik e shikojnë se me ç'disfata dhe me ç'qëllime shkojnë në kongres revisionistët hrushovianë. Mbi Partinë Komuniste sovjetike dhe shtetin sovjetik janë grumbulluar shumë re të zesa. Fitoret historike të popullit sovjetik, të cilat ai i arriti me Revolucionin e lavdishëm të Totorit dhe me punën e tij heroike gati 50-vjeçare, ndodhen përpëra një kërcënim serioz. Ky rrezik është më i madh nga ai i intervencionit të Antantës dhe sulmit të Hitlerit. Por populli sovjetik, i cili ka tradita të shkëlqyera revolucionare dhe ka kaluar furtuna të mëdha, nuk do të mashtrohet nga demagogjia e klikës revizioniste. Ai do ta kuqtojë se shkaku i të këqijave, i vështirësive të rënda që po kalon sot dhe i rreziqeve e i kërcënimive që i paraqiten, e ka burimin te revizionizmi, te vija e kon-

greseve të 20-të e të 22-të. Populli i madh sovjetik, bolshevikët e vërtetë nuk do të qëndrojnë indiferentë ndaj ngjarjeve që po ndodhin sot në Bashkimin Sovjetik, ata nuk do të durojnë që një grusht renegatësh t'i gënjejë e t'i tradhtojë për një kohë të gjatë. Një ditë ata do ta kryejnë detyrën e tyre historike — do t'i japin fund sundimit të renegatëve revizionistë dhe do të marshojnë përrpara, krah për krah me revolucionarët e gjithë botës, në rrugën e ndritur që kanë treguar revolucioni socialist, Lenini e Stalini.

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Zëri i popullit»,
Nr. 68 (5478), 22 mars 1966*

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

**MËSUESIT JANE KONTINGJENT PARAROJE
I PARTISË PËR PËRHAPJEN E KULTURËS
NË FSHAT**

Shënimë

22 mars 1968

Roli i mësuesit në fshat është kolosal. Po të dimë ta ndihmojmë mësuesin dhe ta vëmë si duhet në lëvizje, ai do të japë një kontribut të rëndësishëm në ndryshimin e gjendjes arsimore dhe kulturore të fshatit. Përveç detyrës që ka për të mësuar fëmijët, për t'i edukuar ata në mënyrë të gjithanshme dhe me virtytet më të mira, mësuesi mund dhe duhet të zhvillojë një punë të madhe jashtë shkollës për ngritjen kulturore të të gjithë fshatit.

Për ta bërë këtë, natyrisht, ai duhet të ndihmohet nga organizata-bazë e Partisë, e cila e ka për detyrë ta udhëzojë, ta drejtojë e ta frymëzojë, që mësuesi të punojë me pasion e me dashuri të veçantë për të rritur te njerëzit dëshirën për dije dhe kulturë. Ai duhet, gjithashtu, të jetë në lidhje të ngushtë me organizatën e rinisë e me atë të gruas në fshat. Në shumë fshatra ne kemi 5-15 mësues, në pjesën më të madhe nga fshati,

djem e vajza të reja plot zell për punë, plot dëshirë dhe hov revolucionar.

Ky numër mësuesish duhet të jetë një kontingjent pararojë i Partisë për përhapjen e kulturës në fshat. Mirëpo ky kontingjent akoma nuk po përdoret si duhet dhe sa duhet. Organizata-bazë e Partisë në fshat, duke u dhënë kryesisht pas drejtimit të ekonomisë, fare pak interesohet për punën e mësuesit brenda në shkollë, pa lëre pastaj për punën që bën ose duhet të bëjë ai jashtë saj.

Mësuesi ka nevojë të ndihmohet edhe nga ana profesionale. Është e vërtetë se këtë ndihmë ai e merr që nga ministria nëpërmjet njerëzve të saj dhe formave të punës që ka vendosur e deri te seksioni i arsimit i rrithit me seminaret që zhvillon etj., por kjo nuk është e tëra, pse ndihma që i jepet mësuesit në linjën e arsimit, si nga qendra dhe nga rrathi, nuk mund të jetë e përditshme, kurse ajo e organizatës-bazë të Partisë dhe e organizatave të masave në fshat duhet të jetë e përditshme. Natyrisht, në gjendjen aktuale të nivelit kulturor të komunistëve të fshatit, është e zorshme që kjo ndihmë të jetë e kualifikuar për sa i përket anës profesionale, kontrollit të dhënies së lëndës ose të formave didaktike, por mësuesi mund të kalitet nga organizata-bazë e Partisë në drejtime të tjera. Organizata duhet të ndikojë, dhe këtë mundësi e ka, që te mësuesi të kaliten cilësitë e revolucionarit, si durimi dhe këmbëngulja për të realizuar detyrën, çiltërsia në sjelljen me njerëzit, aftësia për t'i orientuar nxënësit që, në mënyrë të veçantë nga disa lëndë, të mësojnë botëkuptimin e shëndoshë dialektik,

i cili do t'u duhet në luftën e në veprimtarinë revolucionare që i pret në jetë. Një mësues që organizata-bazë e Partisë do ta edukojë në mënyrë të tillë që ta dojë me gjithë zemër fshatin dhe të bëhet luftëtar i përparimit të tij, ai patjetër do të dijë të nxitë te nxënësit edhe dëshirën për bujqësinë, për blegtorinë, për çdo punë që lidhet me ndërtimin e socializmit në fshat. Ky është një shërbim i madh që i bën mësuesi punës së Partisë.

Mësuesi vetë ka shumë nevojë të jetë i lidhur ngushtë, shpirtërisht dhe ekonomikisht me jetën në koooperativën bujqësore, prandaj nuk mjafton të thuhet se është i lidhur me jetën e fshatit meqë ai jeton dhe punon atje. Partia, në mënyrë të veçantë dhe të organizuar, duhet ta mbajë mësuesin në korent të problemeve që ka dhe ta sqarojë për çdo gjë. Nga një punë e tillë e organizuar del edhe detyra e madhe që ka Partia për t'i drejtuar mësuesin dhe mësuesen që të punojnë dhe të interesohen edhe jashtë procesit mësimor për përhapjen e kulturës në fshat.

Mësueset dhe mësuesit duhet të ndihmojnë dhe të drejtojnë shtëpinë ose vatrën e kulturës, të nxitin mësimin dhe përhapjen e këngëve dhe të valleve, të jenë organizatorët e shfaqjeve të bukura artistike dhe aktiviteteve kulturore në fshat. Ata duhet të drejtojnë punën për leximin e librave dhe të gazetave; të jenë kryesorët që të formulojnë planet e mbledhjeve të ndryshme të fshatit dhe t'i zhvillojnë ato; të drejtojnë ekskursionet etj. Mësuesit, tok me organizatën e rinisë dhe të gruas, me një punë të organizuar, të harmonizuar dhe të drejtuar nga organizata-bazë e Partisë në fshat, të

marrin përsipër ngritjen masive arsimore e kulturore të të gjithë fshatit. Mësuesit dhe mësueset duhet të aktivizohen të gjithë dhe me zgjuarsi nga Partia për zgjidhjen drejt të problemeve shoqërore në fshat, për forcimin socialist të fshatit, për luftën kundër bestyt-nive fetare, mbeturinave feudalo-patriarkale, mikroborgjeze etj.

Mësuesit formojnë një armatë të madhe në fshat. Po t'u shtojmë edhe kuadrot e tjerë të lartë e të mesëm me profile të ndryshme që punojnë atje, do të dalim me një bilanc të pasur njerëzish të mësuar që, po të organizohen dhe të drejtohen mirë në punët shoqërore dhe kulturore, ne do të kemi rritje kualitative të papara në jetën e fshatit.

Partia duhet ta kthejë më shumë fytyrën në këtë drejtim dhe t'i bëjë organizatat-bazë të ndërgjegjshme se puna e veçantë me mësuesit nuk është kohë e humbur, nuk i bën të heqin kujdesin nga ekonomia, përkundrazi do të ndihmojë që zhvillimi i ekonomisë të ecë më përpara e me hapa më të mëdhenj.

Botohet për herë të parë si-pas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TA VEMË INDUSTRIALIZIMIN E RRUSHIT MBI BAZA SHKENCORE

Shënimë

23 mars 1966

Vendi ynë me diell dhe me klimë të përshtatshme për zhvillimin e vitikulturës, duhet të prodhojë edhe verë të mirë. Në të kaluarën, bile jo të largët, ne s'kisht shumë vreshta. Edhe ato që ishin, qenë vjetruar e bastarduar, nuk kishin rentabilitet. Në shumë krahina, para luftës vreshtat i prishi filoksera. Verë pothuajse nuk prodhohej fare, (shumë njerëz nuk e pinin atë) dhe ai rrush i paktë e jo i bukur që prodhohej, bëhej raki.

Kështu, vreshtat te ne filluan të zhvillohen pas Clirimt, e sidomos në këta 10 vjetët e fundit. Ne kryesisht u kujdesëm dhe përtëritëm vreshtat ekzistuese, të cilat kishin disa varietete të mira rrush vendi, por gjithashtu sollëm edhe rasate të reja nga jashtë, të blera edhe me klering. Ndër to, natyrisht, ka pasur edhe rasate, të cilat nuk u ambientuan me klimën e vendit tonë. Pra, e filluam punën me modesti dhe merrnim ç'na jepnin të tjerët. Duke i shtuar kësaj edhe mungesën e eksperiencës sonë dhc të kuadrove të

specializuar, mund të themi se fillimi i punës për zhvillimin e vitikulturës ka qenë i vështirë.

Megjithatë, ne vazhduam të krijonim dhe po krijojmë akoma vreshta. Gjatë këtyre viteve ndërtuan edhe disa fabrika për prodhimin e verërave dhe të likernave, përgatitëm gjithashtu një numër kuadrosh të lartë dhe të mesëm, natyrisht këta janë akoma të pamjaftueshëm. Si rezultat i punës që po bëjmë ka filluar të rritet interesimi i punonjësve për vitikulturen. Populli filloi ta prodhojë dhe ta përdorë verën, gjithashtu kemi filluar edhe të eksportojmë, bile disa lloje të verërave tona pëlqehen mjaft jashtë për autenticitetin e tyre, për aromën dhe ëmbëlsinë që kanë. Por ky është vetëm fillimi, se në këtë drejtim jemi prapa dhe duhet të bëjmë përpjekje që të specializohemi më shumë.

Ne deri tani i jemi vënë krijimit të vreshtave në sasi, por këtej e tutje duhet të shikojmë më mirë perspektivën, në lidhje me cilësinë e rrushit. Për këtë na dalin shumë detyra. Pa lënë mënjanë shtimin e vreshthane, duhet të qëndsim, si me thënë, këto që kemi. Në vizitat që u kam bërë disave prej tyre, kam konstatuar se, përveç të tjerave:

a) Varietetet janë të shumta, por nuk janë mbjellë në përshtatje me tokën dhe me klasifikimin e tyre; akoma nuk janë përcaktuar orientimet për varietet më të mira që duhen shtuar ose që duhen sjellë nga jashtë, por këtë herë të zgjedhura mirë.

b) Në vreshtat mungojnë kanalizimet, rrënjet i kanë cekët në dhe, kështu që bima nuk merr fuqi, prandaj shumë prej tyre janë të dobëta.

c) Stratifikimi i vreshtit nuk është i rregullt. Zakanisht hardhitë i mbjellim në kodra, sepse nisemi edhe nga tahmaja për të mos lënë një pëllëmbë toke të pashfrytëzuar, por kjo tokë kërkon një kujdes të veçantë për ta ruajtur nga gjerryerjet, ndryshe ajo do të shkasë dhe do t'i dëmtojë hardhitë.

d) Në afërsitë e vreshtit ne nuk po mbjellim drurë industrialë që mund të shërbejnë si hunj për ngritjen e hardhive, gjë që do të ndihmonte në rritjen e prodhimit. Hunjtë për këtë qëllim i sjellim nga larg, prandaj rritet kostoja e tyre.

Si këto ka edhe shumë çështje të tjera, por fakt është se Ministria e Bujqësisë nuk mendon si duhet që të bëjë investime për përmirësimin e vreshtave. Në këtë drejtim do të këshilloja që të merreshin masa nga ana e saj.

Por më keq akoma janë marrëdhëni vreshtë-fabrikë dhe bujqësi-industri. Këtu ka ndarje dhe kaos, nuk ka një punë të koordinuar shkencore. As shokët e bujqësisë nuk interesohen sa duhet për industrinë e verës dhe as ata të industrisë për prodhimin e rrushit. Kësaj i thonë të arsyetosh kështu: «Ti prodroje rrushin dhe, atë që prodhon, do të ta marr unë, fabrika, por kur të më bëhet mbarë. Vonë nuk më bëhet shumë, po t'u prish rrushi». E kujt i vlen një arsyetim i tillë? U vol shpejt ose vonë rrushi, fabrika as që bëhet merak. Kështu veprojnë edhe disa drejtues të bujqësisë, të cilët prodrojnë pa hyrë në lidhje që më parë me industrinë. Kjo bën që vreshtat të mos vilen në kohën e duhur, sipas vendit, sipas varietetit, prodhimi lihet të prishet dhe, kur e merr fabrika, ajo

e përzien rrushin e pjekur e të papjekur, të çfarëdo cilësie dhe e hedh në një kazan. Duke vepruar pa kujdes, natyrisht, do të dalë palo verë, me aciditet të madh, uthull. Në këtë sektor që duhet të ketë një proces pune shumë të stërholluar e delikat, një rregull të vendosur shkencor, nuk ka, veçse burokraci: jo ma solle, jo s'ta solla, jo e mora, jo s'e mora, sikur rrushi të ishte mineral kromi. Bile edhe për kromin duhet të bëhet kujdes, ndryshe nuk ta merr eksporti. As verën nuk ta merr njeri uthull, por kur del uthull dhe mbyllët në shishe, e ka marrë ferra uratën. Fabrika, si pa gjë të keq, të njofton: «Planin e realizova, urdhëro e merr shishet... me uthull»!

Kjo mënyrë barbare të vepruari duhet të marrë fund. Të punojmë që ta ngremë cilësinë e rrushit dhe atë të verës, e jo të vazhdojmë të mbjellim vreshta pa kriter dhe të prodhojmë uthull në vend të verës. Gjetkë kanë institute të veçanta për këtë çështje, kurse te ne Ministria e Bujqësisë e merr këtë punë me një mungesë vëmendjeje të palejueshme dhe industria, nga ana e saj, as që qederoset për të vënë në rrugë një punë serioze, shkencore dhe të koordinuar të industrializimit të rrushit.

Botohet për herë të parë si pas originalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

ME GRATË E QYTETIT E TË FSHATIT DUHEN GJETUR VAZHDIMISHT FORMA TË REJA PUNE

Shënime

24 mars 1966

Fola edhe në Sekretariat për problemin e gruas, e në veçanti të gruas fshatare, por puna me gratë, në fshat dhe në qytet, mbetet problem i madh, një çështje që duhet thelluar dhe organizuar më mirë. Organizata e gruas, si dhe organizatat e tjera të masave, që udhëhiqen nga Partia, duhet jo vetëm të koordinojnë punën, por më parë bashkërisht të rishikojnë në tërësi problemin, të ndajnë dhe të përcaktojnë orientime të drejta pune, të vendosin forma të reja pune të përshtatshme me kohën dhe me situatat, që ka krijuar vetë zhvillimi i gjendjes.

Organizatat e masave janë leva ndihmëse të Partisë dhe, si të tillë, ato, të bazuara në direktivat e Partisë në çdo aspekt të aktivitetit, duhet të përcaktojnë drejtimet e punës së tyre, në specifikat e veçanta, pa krijuar as konfuzion në detyra, as shumë përsëritje, por as edhe shkëputje nga qëllimi i përbashkët.

Për ta bërë pastër dhe mirë këtë, kërkohet një kujdes i veçantë nga Partia për një koordinim të vazh-

dueshëm të punës midis organizatave të masave për të gjitha problemet që ngrihen dhe për një përcaktim nië të studiuar të tyre si dhe të çështjeve të vecanta, që preokupojnë çdo organizatë. Kjo ka rëndësi, sepse shtresat e popullsisë nuk janë të ndara me mure. Gratë, punëtorët ose rinia nuk janë veç e veç, por të gjithë jetojnë dhe punojnë së bashku, prandaj së bashku janë të interesuar për të gjitha punët. Gruan, të renë, të riun do t'i gjejmë edhe në fabrikë, edhe në shkollë, edhe në lagje, edhe në shtëpi. Të gjithë janë nën ndikimin e punës që zhvillojnë Partia, bashkimet profesionale, organizata e gruas dhe ajo e rinisë. Pra, në qoftë se nuk koordinojmë punët, në qoftë se nuk përpunojmë detyrat e vecanta dhe nuk gjejmë larmi formash në metodën dhe në stilin e punës që t'i përshtaten çdo organizate, atëherë do të na krijohet kjo që ndodh sot shpeshherë, paralelizëm në punë, mërzi te njerëzit.

Është e domosdoshme që në këto gjëra të ndalemi dhe të reflektojmë më thellë. Por, që ta bëjmë këtë, duhet që drejtuesit e organizatave të masave të shqyrtojnë rrënjosht veprimtarinë e tyre, metodën dhe stilin në punë. Të marrim, për shembull, problemin e gruas, në qytet ose në fshat. Këtë nuk duhet ta marrim kuturu, duke ecur me mendimin se ky problem është kudo njëlloj. Jo! Po të mendohet kështu, është gabim dhe po ta ndërtojmë punën mbi këtë bazë, nuk do të na japë frytet që dëshirojmë. Problemët e gruas në fshat janë ndryshe, ato të gruas së qytetit ndryshe. Problemët e gruas në një rreth në specifikën e tyre ndryshojnë nga ato të një rrethi tjetër, ashtu siç

ndryshojnë problemet e një qyteti nga ato të një tjetri. Flas, natyrisht, për specifikën e problemit të përgjithshëm të gruas, pse kjo specifikë është e kushtëzuar nga shumë faktorë, siç janë niveli ekonomik, arsimor e kulturor i çdo kooperative, i çdo rrethi ose qyteti, është e kushtëzuar gjithashtu nga feja, nga zakonet prapanike si dhe nga mbeturinat e tyre në ndërgjegjen e burrave dhe të grave etj.

Qëllimi dhe detyra jonë është që, duke i pasur të qarta këto specifika, të dimë të mobilizojmë gjithë masën e grave, t'i organizojmë këto në një punë të zgjuar dhe të frytshme për ngritjen e tyre.

Ka një kategori grash në qytete, dhe flas për ato që janë me arsim dhe me kulturë, që nuk merren sa duhet për të punuar për ngritjen e masës së grave. Kjo gjendje duhet të na preokupojë pa masë. Ne kemi këshilla grash, kemi aktiviste në fabrika, në shkolla, në spitale, në lagje e gjetkë, por, po të bëjmë dhe duhet medoemos të bëjmë një analizë të punës së tyre, do të dalim me konkluzionin se punohet dobët dhe kjo forcë e madhe nuk është rentabël. Ne këtë duhet ta bëjmë rentabël. Këshillat e grave duhet t'i zgjedhim me një kriter më të shëndoshë. Ky kriter duhet të pasqyrojë nevojën e zhvillimit të shumanshëm të grave në përgjithësi dhe të specifikave të tyre në veçanti, pse në atë rajon ku vepron këshilli ka gra të shtresave të ndryshme, me zhvillim të ndryshëm arsimor e kulturor, me profesione të ndryshme, me probleme dhe interesa nga më të ndryshmet. Këshilli i gruas pra, duhet të jetë një ndihmës i fuqishëm i Partisë, që të rrezatojë drejtime pune në gra të kategorive të ndry-

shme, të cilat, të grumbulluara, mundet edhe në forma të vecanta, të rrahin probleme të vecanta të gruas për t'i aftësuar që ato vetë të ngrihen dhe të ndihmojnë në zbatimin e vijës së Partisë.

Të marrim, për shembull, disa kategori grash, si mësueset, pedagoget, mjeket, punëtoret etj. Të gjitha këto kanë problemet e tyre të përgjithshme, por çdo grup ka edhe problemet e tij të vecanta. T'i grumbullosh dhe t'i udhëzosh të gjitha së toku është njëra anë, por jo e tëra dhe këtu haset vështirësia, prandaj shpeshherë është gjetur rruga më e lehtë, të gjitha udhëzohen me disa direktiva tip, standard. Por më kot përpinqemi t'i aktivizojmë të gjitha kategoritë e grave, për disa direktiva standard. Ato në një rast të tillë ishmangen një pune të dobishme shoqërore të përgjithshme, por, në qoftë se këtyre do t'u kërkojmë të kryejnë detyra shoqërore në specifikën e tyre, dhe përkëtë duhet t'i organizojmë më mirë, t'i udhëzojmë më mirë e t'u hapim perspektiva të reja, ato nuk do t'u shmangen këtyre detyrave.

Të mos shkohet me mendimin se kategoritë e ndryshme të grave i kryejnë detyrat në rrugën shtetërore ose bëjnë pjesë në organizatat e tjera të masave dhe, pra, konsumohet vetveti puna specifike e gruas me kategoritë e ndryshme të njerëzve. Në pamje kjo mund të duket e vërtetë, por mendoj se nuk është plotësisht kështu. Në rast se organizata e gruas do t'i përvishet një studimi të këtyre problemeve në specifikën e tyre dhe do të dalë me konkluzione shkencore për vetë punën e saj, atëherë ajo do të nxjerrë konkluzionin e parë se puna e vecantë që duhet të bëjë

organizata me kategoritë e grave nuk konsumohet me punën që kryen ajo së bashku me organizatat e tjera të masave për problemet më të përgjithshme. Çdo gjë e veçantë e çdo kategorie të veçantë grash influencon në grupet e ndryshme që jetojnë dhe luftojnë së toku me to. Vetëm po të mendojmë këtë influencë, sa me vlerë të madhe është zhvillimi dhe zgjidhja në rrugë të drejtë shkencore e problemeve të veçanta të gruas, sa ndihmë e madhe do t'i jepet Partisë në këtë drejtim. Koordinimi i të gjitha këtyre specifikave të punës me gruan do ta ngrëjet atë në mënyrë të gjith-anshme. Mbi të gjitha kjo do të rritë në masën e grave besimin në forcat e tyre krijuar, do të forcojë besimin në rolin e tyre në jetë dhe në shoqëri, ku do të mund të japid një ndihmë më të kualifikuar e më aktive në zgjidhjen e problemeve që interesojnë tërë shoqërinë, do të forcojë tek ato mendimin politik për zanatin e tyre në jetë, për punën dhe vlerat e saj.

Unë kam besim të madh tek organizata e gruas, sepse ajo ka forca të shumta jo vetëm për ta studuar këtë problem të madh, por edhe për ta vënë në rrugë të drejtë, në rrugën e një aktiviteti masiv dhe revolucionar nën drejtimin e Partisë.

*Botohet për herë të parë si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

PARTIA JONË UA THOTË TË VËRTETËN NË SY SI MIQVE ASHTU EDHE ARMIQVE

*Nga biseda me ambasadorin e Republikës
Socialiste të Rumanisë*

29 mars 1968

Pasi u takua me ambasadorin rumun dhe e pyeti për shëndetin e tij, shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Me sa duket klima e mirë e Shqipërisë ju ka përtërirë. Por edhe Rumania klimën e ka të mirë. Vendi juaj është i bukur dhe i pasur. Ambasadori ynë në Bukuresht na ka folur vazhdimisht për zhvillimin ekonomik të vendit tuaj, për ndjenjat miqësore që ushqen populli vëlla rumun ndaj popullit tonë. Këto ndjenja janë reciproke midis popujve tanë dhe ne duhet të bëjmë përpjekje që t'i zhvillojmë vazhdimisht ato.

Është e qartë dhe nuk kemi pse ta fshehim nga njëri-tjetri se midis nesh ka probleme për të cilat nuk mendojmë njëlloj si ju edhe ne. Por nuk do të ishte e drejtë t'i konsideronim ato si të pazgjidhshme. Vtëm filozofët pesimistë thonë se njeriu ashtu si lind, ashtu edhe vdes, se kontradiktat nuk kanë zgjidhje. Ne jemi

komunistë dhe kemi bindjen se mbi bazën e marksizëm-leninizmit gjen zgjidhje çdo problem. Nga pozitat e kësaj teorie ne do të bëjmë të gjitha përpjekjet që ta forcojmë miqësinë edhe me popullin dhe vendin tuaj.

Të gjithë e kemi të qartë se edhe një vend i vogël, edhe një vend i madh kanë nevojë pér miq. Por secili, qoftë i madh apo i vogël, mendon të gjejë miq të mirë, të sinqertë e besnikë. Partia dhe populli ynë kanë shumë kujdes pér këtë, sepse gjatë historisë së vet populli ynë ka vuajtur shumë dhe prej vuajtjeve e luftërave shekullore ka mësuar shumë. Historia e popullit tonë është e pasur, bile më e pasur se historia e mjaft vendeve e popujve të mëdhenj. Në Shqipëri, shekuj me radhë, mbi truallin e stërgjyshërve tanë, kanë kaluar okupatorë pas okupatorësh që kishin pér qëllim të na shfarosnin, por populli ynë kurdoherë ka mundur t'u bëjë ballë aq më shumë tani që populli ynë ka si udhërrëfyes marksizëm-leninizmin, një histori dhe eksperiencë më të pasur, në çdo rast tregohet i drejtë dhe i matur ndaj të gjithë atyre që janë me të vërtetë të sinqertë ndaj tij dhe u tregon vendin të gjithë atyre që i hiqen si miq, por që duan t'i futin thikën.

Vendi ynë në të kaluarën ka qenë i prapambetur. Vetëm nën drejtimin e një partie marksiste-leniniste, sikurse është Partia jonë, mundën të zhvilloheshin me ritme të shpejta dhe të ecnin përpara bujqësia, industria, arsimi, kultura etj., të përmirësohejjeta e popullit tonë. Por, me gjithë përparimet e mëdha, ne kemi akoma pér të bërë, sidomos pér zhvillimin e indus-

trisë përpunuese, industrisë së rëndë e të lehtë, për shtimin e drithërave të bukës, për krijimin e mundësive edhe më të mëdha për plotësimin e nevojave të popullit dhe të ekonomisë. Këto lidhen me punën për konsolidimin e marrëdhënieve socialiste në prodhim, me zhvillimin e mëtejshëm socialist të fshatit, të bujqësisë dhe të blegtorisë. Në këtë drejtim ne i përmbar hemi ligjit të zhvillimit proporcional të ekonomisë, evitojmë krijimin e disproporcioneve midis industrisë e bujqësisë dhe zhvillimin e një sektori në kurriz të një tjetri, sepse këto do të na krijonin situata të vështira. Zhvillimi i ekonomisë te ne është bërë duke u bazuar, në radhë të parë, në atë çfarë kemi në vend, në forcat tona, pastaj edhe në ndihmën internacionale të vendeve socialiste.

Vendimtare e mbi të gjitha për sukseset tona në ekonomi ka qenë dhe mbetet vija e drejtë marksiste-leniniste e Partisë sonë. Kjo vijë e çon vendin përrapa, kurse shhangia nga marksizëm-leninizmi të çon në greminë, në kthimin prapa në kapitalizëm.

Eksperienca jugosllave provon qartë rrezikshmërinë e shhangies nga marksizëm-leninizmi, megjithëse titistët pretendojnë se po ndërtojnë socializmin, se Jugosllavia qenka një vend «socialist». Por kjo është vetëm një perde tymi. Në fakt litari është ngrënë gati gjer në fund, saqë tani krerët titistë, duke filluar nga Titoja, Rankoviçi, Tempoja etj., janë detyruar t'i pranojnë vetë blofin, disfatën dhe jatin publikisht të dhëna që flasin për transformimin e Jugosllavisë në një vend kapitalist. Dhe s'ka si të ndodhë ndryshe, «fshati që duket nuk do kallauz». Restaurimi i plotë i

sistemit kapitalist në Jugosllavi tani duket fare qartë. Ekonomia e këtij vendi është bërë pre e monopoleve imperialiste, të cilat kanë futur thonjtë në trupin e saj. Çdo ndërmarrje në Jugosllavi, në rast se dëshiron të ekzistojë, duhet të bashkojë veprimtarinë e saj me kapitalistët e huaj, gjë që do të thotë të ndajë aksionet me ta. Kjo u ka dhënë mundësi monopoleve imperialiste t'i investojnë kapitalet e tyre atje ku u intereson dhe të kapin kyçet e ekonomisë jugosllave. Këtë nuk e themi vetëm ne shqiptarët, që jemi kundërshtarë gjer në fund të titizmit, por e thonë edhe vetë titistët.

Në një gjendje të vajtueshme e kanë katandisur revisionistët jugosllavë edhe bujqësinë. Ata kanë hequr dorë prej kohësh nga kolektivizimi, nga mësimet leniniste për zhvillimin socialist të fshatit dhe e kanë futur bujqësinë në rrugën kapitaliste.

Degjenerimi i ekonomisë jugosllave është shoqëruar me të gjitha të këqijat që rrjedhin nga një re gjim kapitalist. Në një fjalim që ka mbajtur Rankoviçi ka folur, përveç të tjerave, edhe për shovinizmin serbomadh, që duket qartë se ka ngritur kokën në Jugosllavi. Kjo nuk i pëlqen Bakariçit, që flet hapur kundër serbëve dhe me sa duket është në kundërshtim jo vetëm me Rankoviçin, por edhe me vetë Titon. Në fjalimin që mbajti së fundi në radiotelevizionin jugosllav, ai as e zuri fare në gojë Titon, por foli në mënyrë alegorike për «çelësat» dhe për «çelësin» pas të cilit fshihet dikush. Pra, është e qartë se në udhëheqjen jugosllave ekzistojnë grupe, natyrisht, jo marksiste-leniniste, por grupe kapitalistësh të maskuar. Kontradiktat midis tyre kanë arritur gjer atje, saqë sot

UDB-ja e Rankoviçit lejon të shahet Titoja në popull.

Të gjitha këto janë pasoja të drejtpërdrejta të tradhtisë titiste, të cilat Partia jonë i ka parashikuar prej kohësh dhe është përpjekur t'ua bëjë të qarta edhe të tjera.

Tani, ka shumë punonjës të thjeshtë në Jugosllavi që thonë se shqiptarët e kanë drejt që janë në kundërshtim me rrugën titiste. Kjo ndodh sepse ata po e shohin se çfarë u jep realiteti jugosllav. Atyre iu premtua një mal, por e vërteta është se janë çmimet që po ngrihen sa një mal e jo mirëqenia e masave. Kurse në Shqipëri, me gjithë vështirësitë, çmimet jo vetëm nuk janë ngritur, por janë ulur disa herë dhe kemi besim që përsëri do t'i ulim.

Plagët që përmendëm nuk janë karakteristike vetëm për Jugosllavinë. Ato janë të pashmangshme edhe për të gjitha vendet ku janë në fuqi tradhtarët revisionistë. Të tilla plagë kanë zënë tashmë vend dhe në BS. Këto duken qartë edhe në raportin e Brezhnev-it të mbajtur në Kongresin e 23-të të revizionistëve sovjetikë, i cili është një dokument pa kockë, një dokument, si të thuash, null. Përmbajtja e këtij raporti, që nuk është as mish as peshk, flet për dobësinë e revizionistëve hrushovianë dhe tregon se brenda në vetë udhëheqjen revizioniste sovjetike ka grupe të ndryshme që nuk janë dakord me njëri-tjetrin, por që përpilen ta maskojnë këtë përqarje.

Klikat hrushoviane jo vetëm shtypin e shfrytëzojnë popujt që kanë nën sundim, por synojnë të skllavërojnë edhe popujt e vendeve të tjera. Për këtë qëllim

ato përdorin demagogjinë e kërcënimin dhe shfrytëzojnë çdo lëkundje apo shenjë frike që vihet re në vendet e ndryshme. Eksperiencia na mëson se revizionistëve e tradhtarëve të çdo kallëpi duhet t'u qëndrosh dhëmb për dhëmb e t'i luftosh pa asnje lëshim, ndryshe të shtypin. Qëndrimi i vendosur dhe i drejtë i detyron armiqjtë të prapsen.

Partia jonë ua ka përplasur në fytyrë dhe «ua ka vënë kufirin te thana» revizionistëve modernë. Me luftën e saj të vendosur dhe të vazhdueshme ajo ka bërë që të dështojë çdo komplot që ata kanë kurdisur ndaj Partisë sonë dhe popullit shqiptar. Po të mos e kishim mbrojtur vendin tonë, ashtu siç po e mbrojmë dhe siç do ta mbrojmë edhe në të ardhmen, liria, pavarësia e popullit tonë do të ishin zhdukur dhe socializmi në Shqipëri do të ishte shkatërruar. Por ne i ruajmë të pastra dhe të forta këto, sepse i qëndruam dhe i qëndrojmirë besnikë gjer në fund ideologjisë sonë revolucionare, marksizëm-leninizmit.

Revizionistët modernë flasin shumë për unitetin. 86 parti kanë dërguar përfaqësuesit e tyre në Kongresin e 23-të të PK të BS. Revizionistët sovjetikë po bëjnë shumë përpjekje për të treguar sikur gjoja me të gjithë ata që kanë shkuar në kongresin e tyre, kanë unitet. Por kjo gënjeshtë e tyre nuk shkon. Ne e dimë fare mirë se atje kanë shkuar delegacione edhe nga partia juaj e nga Partia e Punës e Koresë, që vazhdojnë të thonë se kanë edhe pikëpamje të kundërtë me udhëheqjen sovjetike. Por me sovjetikët nuk janë dakord as Ulbrihti me Gomulkën, megjithëse janë revizionistë të hapët. Në stanin e revizionistëve nuk do të ketë

kurrë unitet, sepse ai është i përbërë nga tradhtarë të marksizëm-leninizmit.

Edhe më absurde tingëllon thirrja oportuniste për unitet midis marksistë-leninistëve e revisionistëve, sepse kjo thirrje kërkon të pajtojë të papajtueshmet. E gjithë bota e di se revisionistët modernë kanë luftuar e luftojnë me egërsi kundër Partisë sonë dhe partive të tjera marksiste-leniniste, se ata janë përpjekur e përpinqen me të gjitha mënyrat të skllavërojnë vendet tona. Thirrjet e tyre për «unitet» janë të tëra hipokrizi, por ato tregojnë se revisionistët kanë frikë nga polemika, e cila i demaskon hap pas hapi. Shuarja e polemikës do të ishte një veprim antileninist, do të ishte, në radhë të parë, një dëm i madh për lëvizjen revolucionare të popujve, prandaj ne nuk do të heqim dorë kurrë prej saj. Për këtë qëndrim armiqjtë na quajnë «kokëfortë» dhe na akuzojnë si «luftënxitës». Por populli shqiptar jo sot, por gjatë gjithë historisë së tij, nuk ka sulmuar kurrë asnje vend, as Italinë, as Jugosllavinë, as Greqinë. Përkundrazi, kanë qenë regjimet shoviniste, fashiste e reaksionare të këtyre vendeve që kanë bërë një mijë e një gjëra kundër nesh. Luftënxitës nuk jemi ne, por imperialistët, me ata amerikanë në krye, dhe revisionistët hrushovianë që janë në një rrugë me ta. Le të thonë sa të duan revisionistët sovjetikë se gjoja nuk bashkëpunojnë me imperializmin amerikan për të robëruar e për të skllavëruar popujt, për të shuar kudo luftën nacionalçlirimtare. Jo, bashkëpunimi midis tyre duket dhe kuptohet sot nga të gjithë.

Partia dhe populli ynë i kanë dashur me gjithë

shpirt Bashkimin Sovjetik dhe PK (b) të BS. Por kur erdhën në krye revizionistët hrushovianë, të cilët u vunë kazmën nga themeli fitoreve të mëdha të Revolucionit të Tectorit, ndërtimit të socializmit, Partisë së Leninit e të Stalinit, kur ata filluan të minojnë unitetin e kampit socialist, ne nisëm luftën kundër tyre. Po të kishim mbyllur gojën dhe të mos ua tregonim të vërtetën Partisë dhe popullit tonë, kjo do të ishte një katastrofë, dhe jo vetëm për ne. Ne e thamë hapur të vërtetën mbi tradhtinë hrushoviane dhe ua çorëm maskën revizionistëve sovjetikë. Kjo i detyroi ata të ndryshojnë taktikat e luftës, të kalojnë nga kercënimet e hapëta kundër Partisë sonë dhe partive të tjera marksiste-leniniste në thirrjet për «unitet».

Kështu vepron tani edhe Brezhnjevi kur thotë se «ne do të bëjmë çmos që të merremi vesh me Partinë e Punës të Shqipërisë». Por fjalët e tij janë vetëm demagogji e tym. Ne, në kohën e duhur, kemi thënë botërisht se hapi i parë për t'u marrë vesh ishte që revizionistët sovjetikë të pranonin botërisht veprimet e tyre anti-marksiste ndaj Shqipërisë. Por udhëheqësit sovjetikë nuk mund ta bënin e nuk do ta bëjnë kurrë këtë, sepse janë tradhtarë dhe nuk kanë gabuar rastësisht, por kanë vepruar me ndërgjegje të plotë. Thirrjet e tyre për «unitet» janë vetëm kurthe, në të cilat ne nuk do të biem kurrë. Për këtë na akuzojnë se ne gjoja jemi kundër unitetit. E kush nuk e do unitetin, shoku ambasador? Po ai nuk mund të kuptohet, kur nuk ekziston një unitet i vërtetë mendimi e veprimi në bazë të marksizëm-leninizmit, kur nuk jemi të singertë me njëri-tjetrin. Ç'unitet i thonë atij, kur nga njëra anë cirresh

për të, nga ana tjetër përpinqesh të marrësh Bukureshtin apo Transilvaninë dhe në qoftë se nuk arrin t'i marrësh dot siç ke menduar, t'i vësh pishën një vendi? Në këto kushte mund të flasin sa të duan për unitet, por uniteti nuk bëhet me fjalë. Kështu mendojmë ne.

Ne dëgjuam për veprimin tuaj, që kundërshtuat të pranohej Mongolia në Traktatin e Varshavës. Mendimin dhe qëndrimin tonë ndaj këtij traktati ju i dini. Ne jemi të bindur se revisionistët sovjetikë do ta shfrytëzonin pranimin e Mongolisë në të, për të çuar atje, në emër të këtij traktati, trupa për të rrethuar Kinën. Prandaj Rumania bëri mirë që nuk u komprometua në këtë tradhti. Megjithatë revisionistët sovjetikë nuk e ndalën veprimtarinë e tyre dhe tanë Mongolia është bërë një plasdarm, kuptohet, jo kundër Shqipërisë apo Japonisë imperialiste, së cilës tradhtarët e Moskës po i japid tokën e Siberisë për shfrytëzim, po kundër Kinës.

Çdo shtet, i vogël ose i madh qoftë, duhet të gjejë rrugën e drejtë të zhvillimit, të përparimit e të mbrojtjes së tij. Partisë marksiste-leniniste i takon kurdoherë të thotë mendimin dhe të zgjidhë vetë të gjitha problemet që i dalin përpara dhe jo të bëjë siç thotë njëri e tjetri, siç do njëri apo tjetri, apo ta bëjë vendin e vet han me dy porta. Ne nuk e kemi dhe nuk do ta lejojmë kurrë një gjë të tillë, prandaj revisionistët na quajnë «stalinistë», sepse Stalini qenkësh shumë «sektar» në këtë drejtim, kurse Titoja, që e ka mbushur Jugosllavinë me turistë, me spiunë, që e ka bërë han ku ka hyrë e hyn djalli me të birin, qenka «marksist».

Republika Popullore e Shqipërisë dhe Partia jonë ndjekin vazhdimisht me vëmendje ngjarjet në botë dhe për çdo problem të rëndësishëm ndërkombe tar kanë thënë e thonë hapur dhe me guxim mendimin e tyre. Ne e kemi ndjekur me vëmendje dhe e kemi kuptuar fare mirë edhe gjendjen e Rumanisë, kur revizionistët sovjetikë ju bënin presione, kur bullgarët, nga ana tjetër, bënin të njëjtën gjë, kur hungarezët vazhdojnë akoma të veprojnë kundër jush. Partia jonë i kupton drejt situatat që janë krijuar dhe po krijohen në këto koniunktura. Por ne nuk e kuptojmë se si Çaushesku apo ndonjë tjetër nga udhëheqësit tuaj thonë se në Jugosllavi u ndërtoka socializmi, kur këtë nuk e besojnë as ata që janë plotësisht me jugosllavët. Vetë këta, tani, thonë që çështja e Jugosllavisë u qelb, sepse ky është një fakt që e pohojnë vetë krerët jugosllavë. Ne nuk mund të jemi dakord me një thënie të tillë të udhëheqësve tuaj, prandaj dhe jua themi këtë. Ne nisemi nga parimi që, kur nuk je dakord me një çështje, thuaje hapur. Të thuash hapur e me guxim mendimet e tua, kjo është rruga e drejtë, marksiste-leniniste, të cilën Partia jonë e ka vënë në jetë dhe e mbron me konsekuençë, duke ua thënë kurdoherë në sy të vërtetën si miqve edhe armiqve. Ndërsa, po të thuash ndryshe kur bisedon dhe të veprosh ndryshe prapa krahëve, është një gjë shumë e keqe. Kritika parimore, vënia në dukje e të metave të njëri-tjetrit, i shërben çështjes së përbashkët dhe nuk ka të bëjë fare me ndërhyrjen në punët e brendshme të të tjerëve.

Të gjitha partitë komuniste marksiste-leniniste

tashmë kanë eksperiencë dhe dinë ta interpretojnë si duhet marksizëm-leninizmin. Për veprimet dhe qëndrimin ndaj marksizëm-leninizmit, çdo parti mban përgjegjësi përpala popullit të vet dhe lëvizjes komuniste ndërkontaktare.

Me rastin e largimit tuaj nga vendi ynë, dëshiroj t'ju them edhe një herë që t'u transmetoni shokëve të udhëheqjes suaj se ne shqiptarët do të ecim vazhdimit në rrugën marksiste-leniniste dhe vetëm në këtë rrugë do të bëjmë të gjitha përpjekjet që ta forcjmë miqësinë me popullin dhe vendin tuaj.

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim që gjenden në AQP*

PER PUNËN E PARTISË ME MASAT NUK KA RECETA TË GATSHME

*Nga biseda me drejtuesit e organizatës së Partisë,
të organizatave të masave dhe të drejtorisë së
Fabrikës së Gomës në Durrës*

29 mars 1966

Shoku Enver Hoxha, mbasi vizitoi repartet e ndryshme të kësaj fabrike, ku mori takim me shumë punëtorë e punëtore, zhvilloi një bisedë të shkurtër me drejtues të organizatës së Partisë, të organizatave të masave dhe të drejtorisë. Në fillim ai u interesua të dinte mbi punën e organizatave të masave dhe kujdesin që tregon për to organizata-bazë e Partisë. Këtë e tregojnë edhe disa nga pyetjet dhe këshillat e tij.

SHOKU ENVER HOXHA: Ç'lidhje kanë organizatat e masave me njëra-tjetrën në fabrikë dhe si aktivizohen ato nga ana e organizatës-bazë të Partisë? Si bashkëpunon organizata e bashkimeve profesionale më këshillin e gruas dhe me organizatën e rinisë, për shembull, për punimin e Letrës së Hapur të Komitetit Qendror?

PËRGJEGJËSJA E GRUAS: Letra e Hapur e Komitetit Qendror u punua në organizatën-bazë të Partisë, pastaj në të gjithë kolektivin.

SHOKU ENVER HOXHA: Kur ju erdhi Letra e Hapur, sekretari i organizatës-bazë të Partisë mund të mbildhte drejtuesit e organizatave të masave dhe t'u kujtonte detyrat e veçanta që i takojnë se cilës prej tyre, qoftë për problemet imediate, qoftë për ato të mëtejshme. Organizata-bazë e Partisë duhet të vërë rregull në organizatat e masave, me qëllim që një direktivë ose një dokument i Partisë të zbërthehet në se cilën prej tyre, por zbërthimi të bëhet në një mënyrë të tillë që ato të mos përsëritin njëra-tjetrën. Te ju, si kudo, ka shokë e shoqe që janë njëkohësisht anëtarë partie, anëtarë të organizatës së bashkimeve profesionale, të organizatës së rinisë, disa shoqe janë edhe anëtarë të organizatës së gruas. Në qoftë se në të gjitha organizatat përsëritet e njëjta gjë, ka rrezik që te njerëzit të humbasë interesit për çështjen për të cilën diskutohet.

Njeriu e dëgjon Letrën një herë, dy, por nuk duhet të dëgjojë vazhdimi shët të njëjtat gjëra, sepse pastaj me të drejtë do të mërzitet. Këtë njerëzit mund të mos e shprehin haptazi, por me mendje e thonë: «Pse na thuhen gjithnjë e kudo po ato gjëra?». Prandaj organizatat e Partisë të mendojnë që të zhduket medoemos monotonia. Kjo arrihet në qoftë se ju, shokët e byrosë së Partisë të fabrikës, për shembull, sa doli Letra e Hapur, do të kishit menduar që ta përgatitnit mirë punën. Me përgatitje nuk mjafton të mendohet vetëm të kuptuarit e përbajtjes së saj, por edhe përcaktimi

dhe planëzimi i tërë punës së larmishme që do të bënët ju me masat për zërthimin dhe punimin e Letrës. Ju, pra, duhet të kishit vendosur si ta punonit atë e konkretisht, në radhë të parë ta punonit e të vinit në dijeni organizatën-bazë, sepse anëtarët e Partisë janë kudo, në të tëra organizatat e masave. Kështu anëtarët e Partisë që në përgjithësi e dinë përbajtjen e Letrës së Hapur, sepse e kanë lexuar edhe vetë në shtëpi, kanë reflektuar dhe duhet të reflektojnë medoemos mbi çështjet që ngrihen atje, mbasi ta kenë punuar atë do të venë të përgatitur mirë në mbledhjet e organizatave të masave: të Frontit, të bashkimeve profesionale, të gruas, të rinisë etj. Si komunistë ata duhet të mendojnë mbi çdo gjë, pra edhe mbi Letrën e Hapur, sepse ata kanë detyra partie. Prandaj t'i mësojmë komunistët që jo vetëm t'i lexojnë materialet që botohen, por edhe të nxjerrin detyra se çfarë duhet të bëjnë për vete dhe çfarë duhet të bëjnë të tjerët, në mënyrë që kur të bëhet mbledhja e organizatës-bazë, mbasi të flasë sekretari, atëherë të gjithë me radhë të diskutojnë, të japid të dhëna, të shfaqin mendime plotësuese mbi çështjet që ngrihen në rastin konkret në këtë Letër të Hapur dhe në bazë të tyre organizata e Partisë të hartojuë planin e punës. Veprohet kështu, në mënyrë që komunistët të venë të përgatitur mirë në kolektiv dhe në organizatat e masave, ku bëjnë pjesë e të luajnë rolin e tyre pararojë për zbatimin e detyrave. Pra, pasi u punua Letra e Hapur në organizatën-bazë të Partisë, ajo punohet me tërë kolektivin, për t'i vënë njerëzit në dijeni mbi përbajtjen e saj. Por këtu në kolektiv kjo punë bëhet pa u ndalur në pro-

bleme të veçanta, çështjet shpjegohen në përgjithësi, sepse ju, duke qenë shokët më të ngritur në kolektiv, e keni për detyrë që një pjesë të fishekëve t'i ruani për në mbledhjet e tjera që do të bëhen po për Letrën e Hapur në organizatat e masave.

Për këtë çështje ju, shokë të byrosë së Partisë, duhet të mendoni më thellë dhe të mos vini në mbledhje të organizatës pa u menduar. Ju duhej të hartonit qysh më parë një plan të detajuar me detyra politike, ekonomike dhe shoqërore për të gjitha organizatat e masave, në mënyrë që, kur të mblidhej organizata-bazë, të diskutohej kryesorja, konkretja, jo në përgjithësi duke thënë vetëm që Letra e Hapur është e mirë, revolucionare. Çështja është që komunistët aty të japid mendime dhe të bëjnë që mbi këtë bazë të ngrihen në këmbë të gjithë njerëzit për të realizuar secili detyrën, deri te shfrytëzimi si duhet i tërë makinerisë, deri te kryerja e shërbimit të saj në rregull, se edhe kjo ka politikën e vet. Pra mbledhja e organizatës-bazë të jetë e tillë që të mos harrojë as organizatën e bashkimeve profesionale, as atë të rinisë, as këshillin e gruas. Duke u mbështetur në punimet e organizatës-bazë dhe në punën e anëtarëve të Partisë, ju më vonë do ta punonit Letrën në mënyrë të detajuar, me plan e detyra të veçanta dhe me afate të gjata për çdo organizatë mase.

Në organizatën-bazë vendoset edhe plani i punës që e propozon byroja ose sekretari, i plotësuar me shtesat që bëhen gjatë diskutimeve dhe kështu caktohen detyrat për çdo organizatë mase. Njëri nga anëtarët mund të mos jetë në atë mbledhje. Atëherë ai të thirret dhe t'i thuhet

të mendojë vetë. Pra, të mos u jepet komunistëve çdo gjë e përgatitur, por të mësohen të punojnë të gjithë me kokën e tyre. Kështu herën tjetër asnjeri nuk do të vijë më pa menduar se ç'probleme do të ngrëjë për çështjen që diskutohet. Për shembull, çfarë mund të bënët ju këtu me gratë e fabrikës? Ti, shoqe e gruas, që të bësh diçka, duhet të njihesh me situatën e gruas në fabrikë, të rjohësh çdo grua, karakterin, hovin, me një fjalë të mirat dhe të metat e secilës. Atëherë në bazë të Letrës së Hapur di çfarë të bësh dhe si duhet të ecin gratë, të cilat janë jashtëzakonisht të zgjaura. Një grua, për shembull, është shumë nikoqire, atëherë në bazë të detyrës që nxjerr nga punimi i Letrës atë e ngarkojmë të merret me çështje ekonomike dhe e ndihmojmë ca që edhe teorikisht të jetë në gjendje të flasë përpara grave. Po të bëjë kështu, organizata-bazë e Partisë do të ketë material për të bërë një varg mbledhjesh të ndryshme me gratë. Prandaj, po të veprohet në këtë mënyrë, gratë nuk do të mërziten kur të venë në mbledhjen e organizatës profesionale, sepse edhe atje do të gjejnë diçka të ndryshme nga ato që janë thënë në mbledhjen e organizuar me gratë. Por një grua, që është edhe e re, mund të mos e thérresim në mbledhjen e organizatës profesionale, se do të vejë në mbledhjen e rinisë. Puna duhet të kombinohet në atë mënyrë, që disa gjëra që janë thënë në mbledhjet e bashkimeve profesionale dhe të gruas, të mos i përsëritë edhe organizata e rinisë. Kjo mund të ketë çështje shoqërore për të cilat nuk janë të interesuara organizata e gruas dhe e bashkimeve profesionale. Pra duhet të bëhet një kombinim i tillë që në specifikën e punës së çdo organizate

të zbërthehet e tërë vija e Partisë. Kështu këto bëhen me të vërtetë leva të organizatës-bazë të Partisë në të cilat gjejnë vend të aktivizohen të gjithë anëtarët e Partisë. Procedura ka rëndësi dhe duhet pasur para-sysh që të mos ketë konfuzion, se përsëritjet i mërzitin njerëzit.

Prandaj të përdoren si duhet levat e Partisë, pa harruar problemet e përgjithshme, vijën e përgjithshme të saj, që jep Letra, dhe çdo organizatë të futet njëko-hësisht edhe në specifikat e saj të veçanta, për të cilat interesohet çdo njeri. Në këtë mënyrë ngrihen gratë, ngrihen punëtorët nga ana e bashkimeve profesionale, ngrihen të rinjtë, me një fjalë ngrihet i tërë kolektivi.

Komunisti duhet të përpinqet të gjejë forma të reja pune, më të përshtatshme, më të shpejta, se me të vjetrën nuk të ndjek njeri. Këto dalin nga rrahja e mendimeve dhe nga eksperiencia. Organizata-bazë e Partisë dhe organizatat e masave në qendrat e punës e kanë më të lehtë për ta zhvilluar veprimtarinë e tyre sepse njerëzit i kanë të grumbulluar, por ekziston edhe rreziku i përsëritjes, i punës formale. Në këtë drejtim duhet bërë një edukatë e tërë. Këtu ju jeni çdo ditë bashkë, prandaj thashë që të mos i zbrazni menjëherë të gjithë fishekët dhe armët që ju ka dhënë Partia, por të dini t'i përdorni më me përfitim, në mënyrë të tillë që të gjithë njerëzit të jenë të gëzuar, të kënaqur, të venë në mbledhje me dëshirë, se do të dëgjojnë diçka interesante. Drejt e tha një shoqe këtu, se në bazë të Letrës ne duhet të punojmë edhe me burrat që të pastrojmë ndërgjegjen e tyre nga konceptet e gabuara për gruan. Duke u nisur nga këto pozita, kur ajo vete në

shtëpi, i tregon burrit: «Shiko sa gjëra mësuam ne në mbledhje, për të drejtat e barabarta midis burrave dhe grave na thanë gjëra interesante» dhe kërkon që edhe ai t'i aprovojë ato. Kjo duhet bërë, se Letra e Hapur jep idetë themelore, po nuk i zbërthen të tëra problemet.

Në këto çështje ne nuk kërkojmë filozofi të madhe. Shokët e bazës duhet të mendojnë vetë që nga Letra të nxjerrin esencën politike dhe ideologjike të çështjes, për këtë ata janë në gjendje dhe pikërisht për këtë ka nevojë Partia, që të mos bëhen konferenca për konferenca, me fraza e perifraza pa përbajtje, por çdo gjë të ilustrohet me disa koncepte filozofike të thjeshta dhe të kuptueshme. Nuk e merr për filozofi masa e grave në fabrikë kur shoqja e gruas u thotë shoqeve të saj që gratë duhet ta kuptojnë vetë se luajnë një rol të rëndësishëm në fabrikë, se pa ato fabrika nuk ecën, prodhimi nuk zhvillohet, se pa gruan nuk ndërtohet socializmi, siç ka thënë Lenini. Burrat kanë vendin e tyre, por dhe gratë kanë vendin e tyre. Të dyja palët janë të barabarta dhe Partia e ka drejt kur thotë që pa gratë nuk ndërtohet socializmi. Fitorja më e madhe që ka arritur gruaja është se ajo, me çlirim e atdheut, u çlirua edhe ekonomikisht. Ajo nuk mbeti vetëm një nikoqire e mirë dhe e kufizuar me funksionin e rëndësishëm të rritjes së fëmijëve, por kaloi edhe muret e shtëpisë. Prandaj organizatat-bazë të Partisë kudo duhet të shpjegojnë ku qëndron fitorja më e madhe e gruas, të shpjegojnë se kjo fitore qëndron pikërisht në çlirim e saj nga ana ekonomike. Ju, gratë, në saje të luftës dhe të udhëheqjes së drejtë të Partisë, merrni pjesë në prodhimin shoqëror dhe

këtu bazohet e gjithë veprimitaria e organizatës së gruas në socializëm.

Gratë në fshat edhe përpara punonin, por atëherë konsideroheshin si rob, si skllave. Ato ishin nën një robëri të dyfishtë, si jashtë, ashtu edhe në shtëpi ku sundonte burri. Atëherë ekzistonte pikëpamja se gruaja është e detyruar të punojë dhe si ká përjashta, edhe si rob në punët e shtëpisë. Pra në atë kohë gruaja nuk gëzonte asnijë liri e të drejtë. Që të fitohej kjo liri, ajo duhej të merrej medoemos edhe me punë shoqërore.

Partia jonë e çlroi gruan ekonomikisht dhe politikisht dhe insiston vazhdimisht që gratë, kudo që ndodhen, në qytet apo në fshat, të futen në punë shoqërore, siç është këtu te ju, në Fabrikën e Gomës, ku gratë punojnë për të mirën e shoqërisë në mënyrë të organizuar dhe të bashkuara. Partia edhe në fshat e ka çliruar gruan politikisht dhe ekonomikisht. Tani gratë fshatare kanë hyrë në masë në prodhim. Si rrjedhim i punës së Partisë, tani janë bërë përparime në qëndrimin ndaj gruas, ka ndryshuar deri edhe mentaliteti i plakut për të. Megjithatë tek ai ekziston përsëri pikëpamja se të hollat që fiton vetë gruaja duhet t'ia japë burrit t'i administrojë. Ky mentalitet i vjetër duket edhe të vëllai, prandaj do të duhet punë bindëse për një kohë akoma të gjatë që të zhduket krejtësisht.

Kooperativistja që punon në kooperativë e ndien veten të lirë. Ajo ka respekt për babanë dhe për burrin, por nuk e ka më atë frikë që kishin dikur nënënat tonë se mos i linte burri. Po ta kërcënojë burri gruan, kjo tani i thotë: «Unë jam e lirë, kam të drejtat e mia dhe, po më ndave, nuk mbetem rrugëve». Po të bëjë

ndonjë maskarallëk burri, është gruaja ajo që e ndan e para. Gruaja shqiptare i fitoi këto të drejta. Megjithatë në shtëpi ajo nuk e ka fituar akoma barazinë. Prandaj të punojmë vazhdëmisht me gratë që të çlirohen edhe ideologjikisht, sepse ekziston rreziku që ato, me dashje e pa dashje t'u nënshتروhen burrave ngaqë nuk e kuptojnë në rrugë të drejtë çështjen e dashurisë dhe të respektit. Akoma ekziston te mjaft burra pikëpamja që të sundojnë mbi gratë, që këto t'u nënshتروhen atyre. Ne ende jemi dy breza nga vitet e çlirimt, prandaj te njerëzit tanë ka mjaft mbeturina të kësaj natyre. Kjo gjendje nxjerr nevojën që gratë të mësohen të luftojnë. Ne të organizojmë një punë të mirë politike dhe ideologjike, në mënyrë që edhe në shtëpi gruaja dhe burri të zënë një vend të barabartë, të bëjnë të dy punë edukative shoqërore.

Burri duhet të kuptojë se gruaja, që të ecë përpara, ka nevojë të lehtësohet nga shumë punë të shtëpisë, të cilat janë jashtëzakonisht të mërzitshme, nganjëherë edhe përulëse. Gruaja mund t'ia lajë këmbët burrit në një rast të caktuar, sëmundjeje etj., po që të dy ata janë të barabartë. Ky në këtë rast është një shërbim shoqëror, ashtu sikurse edhe burri mund t'i bëjë shërbime të tillë bashkëshortes, po të jetë e sëmurë. Po babagjyshi nuk e kishte një pikëpamje të tillë. Ai e konsideronte këtë shërbim vetëm për gruan, si një detyrë skllavi.

Gruaja duhet ta bindë burrin që edhe ai në shtëpi të punojë bashkë me të, t'i kërkojë që ai ta çlirojë atë nga disa punë me qëllim që edhe ajo të ketë mundësi të bëjë më tepër punë shoqërore. Kështu burri

gradualisht do ta kuptojë këtë dhe do të marrë një pjesë të punëve të shtëpisë që deri tani kanë rënduar vetëm mbi gruan. Rëndësi ka çështja që burrit t'i futet në mendje se duhet medoemos të punojë edhe ai në shtëpi dhe, po ta kuptojë këtë ideologjikisht, atëherë do ta lehtësojë gruan. Është një e drejtë që të ndahen punët e shtëpisë midis burrit dhe gruas, që kjo të mund të jetë më e lirë. Këtë burrat në përgjithësi nuk e kuptojnë. Kur një burrë në fshat ta kuptojë si duhet këtë çështje, ai do të bëhet me siguri luftëtari më i madh për të ngritur çerdhe e kopshte për fëmijët, kurse tani burrat as nuk e futin në hesap këtë çështje. Këtë, thonë ata, le ta rregullojnë vetë gratë. Çerdhja nuk është një luks, por një institucion ku gruaja çon fëmijën që t'i rritet më mirë dhe t'i krijohen asaj mundësi të çlirohet, të ketë më shumë kohë për punë shoqërore, për të lexuar, për të vajtur në kinema, edhe për ta rritur fëmijën më mirë. Këtë duhet ta kuptojnë edhe burri, edhe gruaja. Po të kuptohet si duhet kjo çështje, atëherë edhe në fshat kryesia e kooperativës do të mendonte si ta lehtësonte akoma më shumë gruan, duke hapur rrjetin e shërbimeve. Ajo do të ngarkonte një ose dy nga gratë më të përparuara, me ditë-punë ose me normë, që të pritnin fustane, të arnonin e të hekurosnnin rroba, punë këto që grave u hanë shumë kohë. Prandaj, në vend që të jenë të zëna gratë e fshatit me punë të tillë, është më mirë të ngarkohen dy-tri gra t'i bëjnë ato.

Në çdo vend duhen gjetur mënyrat dhe mjetet për t'ia sqaruar masës parimet lidhur me jetën, me problemet etj., në mënyrë sa më të kuptueshme. Në

qoftë se një grua vjen e pyet shoqen e këshillit të gruas në fabrikë si është kjo çështje që ka lexuar në Letër, ajo t'ia shpjegojë. Përgjegjësja e gruas në fabrikë i njeh në përgjithësi gratë, po ajo duhet t'i njohë edhe si jetojnë e ç'telashe kanë. Po të ketë lidhje të afërta me to, ajo mund të shohë se disa prej tyre nuk janë të qarta, për shembull, për vendin e barabartë me burrat që u takon, si në punë, edhe në familje. Atëherë përgjegjësja e gruas e kap këtë problem dhe organizon një konferencë me gratë, natyrisht pa i zënë fare në gojë, pa u vënë gishtin se kush janë ato shoqe të paqarta, por e trajton problemin në atë mënyrë që çdo gruaje t'i forcohet besimi se ajo është në gjendje të luftojë për të arritur shkallën e barazisë midis burrit dhe gruas. Në këtë mënyrë u bihet në kokë edhe koncepteve të gabuara të atyre burrave që sillen keq me gratë. Kjo është një punë me rëndësi të madhe politike dhe shoqërore.

Të mos e kufizojmë punën politike dhe ideologjike vetëm në disa leksione që janë përgatitur. Këto leksione duhet t'i thithim dhe me to të mundim të kapim situatën, ngjarjet që ndodhin në kolektiv. Parimet që ngrihen atje t'i zhvillojmë në mënyrë që ta pastrojmë kolektivin nga të metat e dobësitë, të forcojmë te punonjësit ndjenjat e mira, që ata të ecin përpara. Tema standard në asnjë mënyrë të mos zhvillohen, por të bëhen të tillë që i kërkon jeta. Këto, ju anëtarët e Partisë, t'i gjykon me kujdes, kur është vendi t'ia themi tjetrit personalisht, t'ia themi një grupi, dhe kur është e nevojshme t'ia themi gjithë kolektivit. Duhet t'i gjykojmë mirë këto çështje se ashtu si mund t'ia

themi një njeriu, nuk ua themi dot pesëdhjetë ose njëqind vetave. Për këtë çështje nuk ka receta. Zgjdhja e drejtë do të gjendet vetëm duke i rrahur bashkërisht mendimet.

Ne do t'ju japim ndihmë se si të punoni për t'i ngritur punonjësit tuaj ideologjikisht, po më mirë nga sa e dini ju sa i punon koka njërit dhe tjetrit, q'ngritje ka njëri dhe q'ngritje ka tjetri, ku janë dobësítë politike dhe ato ideologjike të këtij apo të atij, nuk mund ta dijë askush tjetër. Prandaj mbi këtë bazë sekretari i organizatës së Partisë e thërret punonjësin qoftë ai me ose pa parti dhe i thotë: për situatën që kemi në fabrikë organizata-bazë ka nevojë që ti të përgatitësh një leksion, ku theksin ta vësh në këtë ose atë problem. Më mirë se ky leksion i lidhur me kushtet e fabrikës suaj e i konkretizuar me shembuj nga jeta e kolektivit, nuk ka si të ketë. Këtu do të futen edhe teoria, edhe politika, edhe ata që kanë gabuar. Në leksion mund të mos ketë citate të Marksit, Engelshit, Leninit e Stalinit, por autori në temën që ka trajtuar ndjek vijën dhe mësimet e tyre, duke ia paraqitur kolektivit çështjen me fjalë të thjeshta që shprehin një nevojë për të. Pra, edhe pa u vënë citate në një leksion të tillë, ai prapë është një leksion marksist.

Botohet për herë të parë, me disa shkurttime, sipas origjinalitetit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

L E N D A

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 31-TË V—IX

1966

TE MËSOJMË NGA BAZA DHE TE PËRGJITHË-SOJMË — Diskutim në mbledhjen e organizatës-bazë të Partisë të Drejtorisë së Organave të Partisë, të Rinisë dhc të Bashkimeve Profesionale pranë aparatit të KQ të PPSH (5 janar 1966)	1—14
USHTRIA ËSHTË SHKOLLA — Nga fjala para efektivit të repartit ushtarak N (7 janar 1966)	15—31
ME ÇFARË PO SHKOJNË REVIZIONISTËT ITALIANË NË KONGRESIN E TYRE TË 11-TË — Artikull i botuar në gazeten «Zëri i popullit» (9 janar 1966)	32—101
BUROKRATIZMI ËSHTË VDEKJEPRURËS PËR DIKTATURËN E PROLETARIATIT — Nga biseda me një delegacion të Bankës Popullore të Kinës (11 janar 1966)	102—114
MBLEDHJET TONA DUHET TË JENË KONSTRUKTIVE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (17 janar 1966)	115—134
VEPRIMI JUAJ SIMBOLIZON VËLLAZËRIMIN E POPUJVE TANË — Letër drejtuar mikes së Shqipërisë, Bozena Neumanova (17 janar 1966)	135—136

TA KALITIM EDHE FIZIKISHT POPULLIN PËR MBROJTJE (20 janar 1966)	137—147
TË GJITHË ATA PUNONJËS QË VENDOSIN TË SHKOJNË NË FSHAT KRYEJNË NJË DETYRË PATRIOTIKE — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (26 janar 1966)	148—159
GJALLËRIMI I JETËS SË PARTISË — PROBLEM KRYESOR (2 shkurt 1966)	160—178
DISA KONKLUZIONE FILLESTARE MBI PUNIMIN E VENDIMIT TË BYROSE POLITIKE PËR LUFTËN KUNDËR BUROKRATIZMIT — Fjala në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (3-4 shkurt 1966)	179—228
T'I DREJTOHEMI ME NJË LETËR TË HAPUR GJITHË PARTISË, GJITHË POPULLIT DHE USHTRISË — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (8 shkurt 1966)	229—239
TË PUNOJMË ME RITMIN E PUNËTOREVE — Fjala në takimin me disa anëtarë të plenomit të KQ të PPSH dhe sekretarë të parë të komiteteve të Parlisë të rretheve (8 shkurt 1966)	240—255
PËRGATITJA E PLANIT TË RI PESËVJEÇAR KËRKON PUNË SERIOZE — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (9 shkurt 1966)	256—258
UDHËHEQËSIT FJALËT I SHOQEROJNË ME VEPRA — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (9 shkurt 1966)	259—266
APARATI I KOMITETIT QENDROR ËSHTË EDHE APARAT STUDIMI — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (10 shkurt 1966)	267—285

HARTIMI I ORGANIKAVE TË REJA KËRKON KUJDES, THELLIM E PJEKURI — (Shënim) (13 shkurt 1966)	286—288
NE KEMI NEVOJË PËR NJË PROPAGANDË TË KUPTUESHME, MOBILIZUESE, REVOLUCIONARE — (Shënim) (15 shkurt 1966)	289—292
MENDIMI PËR EKZISTENCËN E INSTITUTIT TË FOLKLORIT ëShtë i drejtë — Letër drejtuar shokut Zihni Sako (17 shkurt 1966)	293—294
SHKOLLA DHE ORGANIZATA E RINISË KANË INTERESA THEMELORE TË PËRBASHKËTA (21 shkurt 1966)	295—313
KUSHDO QË SHKON NË BAZË NDËRRON VETËM KLIMËN, POR NENEN, PARTINË, DO TA GJEJË KUDO — Fjala në takimin me punonjësit e apa- ratit të KQ të PPSH (24 shkurt 1966)	314—323
DREJTUESI DUHET TË JETË PRAKTIK NË PUNË, PO NJËKOHËSISHT EDHE MENDIMTAR — Fjala në takimin me sekretarët e parë të komiteteve të Partisë të rretheve (25 shkurt 1966)	324—336
LUFTËRAT E DREJTA QË BËJNË POPUJT I AFROJNË E I LIDHIN ATA MË SHUMË ME NJERI- -TJETRIN — Nga biseda me ambasadorin e Republikës Islamike të Pakistanit (26 shkurt 1966)	337—341
KY ëSHTË NJË PLAN I BALANCUAR, TEK I CILI KEMI BESIM E SIGURI — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (28 shkurt 1966)	342—359
T'I PËRVISHEMI PUNËS KONKRETISHT PËR REA- LIZIMIN E PLANIT — Diskutim në mbledhjen e Plenomit të 16-të të KQ të PPSH (4 mars 1966)	360—364

USHTRITË REVOLUCIONARE I BËN TË FORTA MARKSIZËM-LENINIZMI — Fjala në mbledhjen me ushtarët dhe kuadrot ushtarako-politikë të forcave të armatosura (5 mars 1966)	365—384
PËR ÇDO GJË TË GJYKOJMË BASHKË SI ËSHTË MË MIRË PËR POPULLIN — Nga biseda me drejtuesit e kooperativës bujqësore të bashkuar të Divjakës në rrethin e Lushnjës (7 mars 1966)	385—393
NE RRUGËN E KOLEKTIVIZIMIT FSHATARESIA JONË PO NDËRTON NJË JETË TË RE — Fjala në takimin me kooperativistët e kooperativës bujqësore të bashkuar të Divjakës në rrethin e Lushnjës (7 mars 1966)	394—405
TË NA PUNOJË MENDJA TË GJITHËVE SI TA ZBATOJME MË MIRË DIREKTIVËN E PARTISË — Bisedë me kuadrot dhe me disa punonjës të kooperativës bujqësore të bashkuar «Stalin» të Krutjes në rrethin e Lushnjës (8 mars 1966)	406—430
MASA GJYKON ME MPREHTËSI DHE SYTË I MBAN TE PARTIA — Nga biseda me anëtarët e byrosë së Komitetit të Partisë, të Komitetit Ekzekutiv dhe të kryesive të organizatave të masave të Rrethit të Lushnjës (8 mars 1966)	431—451
EKSPERIENCA E PARTISË DO TË NA MËSOJË SI TA BEJMË MË MIRË PUNËN — Fjala në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (14 mars 1966)	452—506
TRADHTARËT REVIZIONISTË HRUSHOVIANË SHKOJNË NË KONGRESIN E TYRE ME NJË BI- LANC DËSHTIMESH TË MËDHA — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (22 mars 1966)	507—533

MËSUESIT JANË KONTINGJENT PARAROJË I PARTISË PËR PËRHAPJEN E KULTURES NË FSHAT — (Shënime) (22 mars 1966)	534—537
TA VËMË INDUSTRIALIZIMIN E RRUSHIT MBI BAZA SHKENCORE — (Shënime) (23 mars 1966)	538—541
ME GRATË E QYTETIT E TË FSHATIT DUHEN GJETUR VAZHDIMISHT FORMA TË REJA PUNE — (Shënime) (24 mars 1966)	542—546
PARTIA JONË UA THOTË TË VËRTETËN NË SY SI MIQVE ASHTU EDHE ARMIQVE — Nga biseda me ambasadorin e Republikës Socialiste të Rumanisë (29 mars 1966)	547—557
PËR PUNËN E PARTISË ME MASAT NUK KA RECETA TË GATSHME — Nga biseda me drejtuesit e organizatës së Partisë, të organizatave të masave dhe të drejtorisë së Fabrikës së Gomës në Durrës (29 mars 1966)	558—569